



Aleksandër Bojaxhi

# *Ditarë*



# Ditarë



Shënime dhe fotografi nga veprimtari alpinistike  
të mbledhura dhe të botuara nga  
Aleksandër Bojaxhi

Titulli: Ditarë

Shënime dhe fotografi nga veprimtari alpinistike  
të mbledhura dhe të botuara nga Aleksandër Bojaxhi

# Hyrje

Gjatë viteve që kam ushtruar sportin e alpinizmit, përgjatë apo edhe pas veprimtarive, kam mbajtur ditarë. Me një pjesë të tyre kam ndërtuar botimin ***Nëpër Bjeshkët e Namuna - kujtime, Botimet TOENA 2005***. Ato ditarë i punoja pas kthimit nga malet sepse kështu veprimtaritë i kisha të gjalla, me ndodhi e me emocione të përjetuara. Ky fakt mundësonte që shënimet t'i pasuroja, me sa dija e mundesha, me ndjesitë e mija gjatë ngjitjeve, si edhe me elementë të tjerë socialë e më gjerë që përjetoja. Ato ishin thuajse të përfunduara e të gatëshme për botim që në vitin 1979.

Me ditarët si më poshtë u morra shumë vonë. Fillova t'i lexoj e t'i hedh në kompjuter në vitin 2016. Pra, shënimet më të afërta për memorien time ishin ato të vitit 1991. Kjo distancë kohore ka bërë që teksta i lexoja të kuptoja se kujtesa më ka lënë për shumë nga ndodhitë që pata përjetuar. Andaj dhe vendosa t'i hedh në kompjuter ashtu sikundër janë hedhur në atë kohë, si ato nga ditari im edhe ato nga ditari i ekipit. Kjo bën që i interesuari për to të lexojë për veprimtari alpinistike që duken të përshkruara në mënyrë “telegrafike”. Me dëshirën që të duken më pak telegrafike nga sa janë, do të shtoj disa nga fotot që

kam. Më duhet të theksoj se me fotografi ekipin tonë e ka pas “pasuruar” aparati fotografik i Niko Petros.

Duke i “botuar” këto shënime në bibliotekën dixhitale të SHBA Tirana synoj që, për brezin e ri, apo ndoshta një ditë edhe për ndonjë historian të sporteve, duke i lexuar ato, të ndërtohet, apo ndihmohet për tu ndërtuar një ide se si zhvilloheshin veprimtaritë alpinistike të organizuara nga Federata Shqiptare e Alpinizmit në vitet kur janë mbajtur ditarët. Por synohet edhe më shumë se kaq: nëpërmjet leximit të tyre, besoj se, mësohen edhe mjaft elementë të jetës sociale, ekonomike dhe më gjërë të asaj kohe.

Ato fjalë apo rreshta që do të hasni këtu të cilat janë me gërma italiane (*të pjerrëta*), nuk janë në rreshtat e shkruara në ditarin e mbajtur. Ato janë shtuar nga unë për t'i bërë fjalitë apo koncepte të veçanta, etj, më të qarta për kohën kur janë mbajtur si dhe veçanërisht për kohën dhe brezin e ri.

Ditarët e ekipit të alpinistëve 17 Nëntori i Tiranës nuk janë mbajtur nga një dorë apo një person. Ekipi ka patur ditarin e tij dhe kjo ka bërë që ato të mbahen nga anëtarë të ndryshëm të ekipit. Madje, me raste, në të njëjtën veprimtari ditar i është mbajtur nga pjesëmarrës të ndryshëm në atë veprimtari të cilët ishin anëtarë të ekipit.

Me raste ato nuk janë shkruar kur mbajtësi i ditarit të ketë qenë i ngeshëm dhe të jetë ulur enkas që të tregojë për veprimet e ditës. Kjo bën që në disa raste kohët e foljeve të mos jenë shkruar si duhet (do të ndërhyjë sa të mundem që t'i korrigjoj). Me raste, sidomos në veprimtaritë dimërore, kushtet për ta mbajtur atë kanë qenë të papërshtatëshme, gjë që shprehet me cilësinë e tekstit të tyre apo edhe me ndërtimin e fjalive. Ndonjë ditar, ose pjesë ditar nga të ekipit, për arsye të shkrimit të palexueshëm, nuk është hedhur.

Pavarësisht se ku (në cilët blloqe a fletore) janë shkruar, ditarët janë hedhur duke respektuar njëpasnjëshmërinë e tyre në kohë. Këtu janë hedhur edhe ditarët e mi personalë.

Ndonjë pasaktësi e mundëshme në emrat e përmendur të individëve apo ekipeve mendoj se duhet konsideruar si gabim njerëzor.

Pjesë të ditarëve që përmbajnë shënime të llojit “lufta e klasave” si dhe personat e përfshirë në to janë hequr ose anashkaluar në më të lartën mundësi.

Në ndonjë rast të veçantë, mënyra se si është parë një veprim apo një ngjarje sigurisht që mund të jetë me nota subjektive, por nuk besoj se do të jetë jashtë realiteteve të zhvilluara.

Nuk mund të pretendoj se në këta ditarë janë përmendur të gjitha veprimtaritë e organizuara ku ka pas marrë pjesë ekipi i alpinistëve të Klubit të Tiranës (asokohe Klubi Sportiv 17 Nëntori), madje as të gjitha veprimtaritë ku unë kam pas marrë pjesë.

Falenderoj anëtarët e SHBA Tiranë, Dorina Mosku, Menduh Zavalani, Bledi Preza, Erika Çabej, Amantia Simixhia si dhe ish kolegen time Anila Isak për ndihmën që kanë dhënë për ndreqjen letrare të këtij materiali.

*Aleksandër Bojaxhi*





# VITI 1974

Veprimtaria Tomor (Kulmak) – Ostrovicë

26 nëntor – 3 dhjetor

Pjesëmarrësit:

|                          |            |
|--------------------------|------------|
| Servet Aliko             | Vlora      |
| Ramo Shaqiri             | Vlora      |
| Aleksandër Bojaxhi (Aci) | 17 nëntori |
| Arjan Duma               | 17 nëntori |
| Krenar Dobi              | 17 nëntori |
| Fatmit Bozdo             | 17 nëntori |
| Avdulla Krantja          | Dinamo     |
| Zija Dida                | Dinamo     |
| Viktor Grama             | Dinamo     |
| Banush Sutkja            | Labinoti   |
| Xhevat Osmani            | Labin      |
| Ndriçim Islami           | Labinoti   |
| Jani Qendro              | Berati     |
| Gëzim Hoxha              | Berati     |
| Bujar Bega               | Berati     |
| Niko Gërxhi              | Berati     |
| Përparim Koroni          | Berati     |

|              |             |
|--------------|-------------|
| Hysen Kore   | Gjirokastra |
| Ferik Koçiu  | Gjirokastra |
| Riza Kore    | Gjirokastra |
| Hysen Kovaçi | Gjirokastra |
| Petraq Rama  | Lushnja     |
| Gramoz Veizi | Lushnja     |

Gjithësej 24 pjesëmarrës.

Unë morra pjesë si përfaqësues i Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit Shqiptar dhe caktova si drejtues të veprimtarisë Servet Alikon. Në këtë veprimtari erdhën për të marrë pjesë edhe Besnik Mustafaraj, Jorgaq Grabocka dhe Toli Biqiku por u refuzuan/kthyen sepse këta alpinistë kishin kategori sportive më të lartë nga sa e kërkonte veprimtaria.

## 26 nëntor

Nisemi nga Berati në orën 10:00. I gjithë grupi në një autobus. Deri në Poliçan 45 min. Kaluam atje disa minuta sa pamë dyqanet dhe sistemuam pajimet. Në orën 12:00 u nisëm për në Teqenë e Kulmakut. Rrugës zuri shi dhe u lagëm deri në palcë. U shkëputëm disa herë grupe-grupe gjatë rrugës. Mesatarisht, rruga u përshkrua në pesë orë. Grupi i fundit arriti me një orë vonesë. Të gjithë u lodhëm. Natën po e kalojmë në teqenë e rrënuar pasi është lënë pas dore. Është e ndarë në disa dhoma. Nesër parashikohet kohë e mirë. Disa fjetën në godinën turistike e cila është në gjendje të keqe (pa xhama, pa tavan, etj.)

Për të ardhur deri në teqe, më mirë do të ishte të vinim me mjet deri tek Lëmi i Kiços (fiton një orë) porse biletat duhen prerë për linjën Berat-Bogovë.

## 27 nëntor

*Elbasani me kalldram*

*Me bugaçe po le nam.*

Këto janë vargje “simpatike” që i këndon një lushnjar. Kemi fjetur ngrohtë, por me copa. Zgjohemi më 06:30. U përgatitëm dhe më 08:00 u nisëm për në majën Çuka Partizane (*Kulmakut*). Arritëm në majë në orën 10. Koha shumë e keqe: mjegull e tufan. Na udhëhoqi shumë mirë Jani (*Qendro*). Ndenjëm brënda 40 minuta (*brënda në “bunkerin” tek baza ushtarake e ndërlihdjes. Aso kohe në majën e Kulmakut ishte instaluar një pikë ushtarake e ndërlihdjes*).



Alpinisti Jani Qendro



Një foto e datës 22 dhjetor 1968. Alpinistë të ekipit Apolonia (Thoma Stambuli, Aleksandër Bojaxhi, Nasi Shtëmbari, Petraq Rista) si dhe ushtarakët e ndërlidhjes që shërbenin në atë kohë në majën e Kulmakut.

Më pas bëmë 2-3 foto dhe filluam zbritjen. Më 12:00 ishim në Teqe. Koha vazhdon e keqe dhe ne rrimë rreth zjarrit. Në majë nuk erdhën një alpinist i Dinamos, dy të Elbasanit dhe një i Vlorës; u kthyen nga rruga.

Pasdite doli një alpinist për të mbushur ujë (Dulla) dhe pas pak filloi të bërtasë: ujku, ujku. Të tjerët filluan të gajasen. Ishte një qen i madh e i bardhë.

Në grup janë dy alpinistë që kanë qenë në grupin e pionerëve që e drejtonte Vangjel Mëlëngu. Tregojnë se dikur, tek flinin në Borgullas, u del gjumi herët dhe shkojnë tek çadra e Vangjelit (ora 01:30 a.m.).

- Profesor, më jep pak tiganin! - i thotë ai që u afrua.

- Ik more lanet se më nxorre gjumin! - i përgjigjet Vangjeli.

Pas pak u nis i dyti, por edhe atij i ndodhi e njëjta histori. I treti shkon ngadalë dhe futet në çadër, por Vangjeli ja këput me tigan turinjve e i thotë:

Merre lanet!

Ai kthehet tek shokët me tigan, por i ënjtur e i nxirë.

## 28 nëntor

Ora 05:30 nisemi për në majën e Zaloshnjës. Kohë e keqe dhe me mjegull. Marrim rrugën deri afër luginës ku futesh për Teqe e pastaj marrim majtas për tek një stan. Aty morëm drejt e për në majë, ku arritëm më 08:30. Rruga ishte e mirë. U kthyem pak më nga veriu e i ramë më shkurt. Arritëm në Teqe më 10:30. Pushuam deri më 12:00. Në majë nuk erdhën tre elbasanas dhe një lushnjar i sëmurë. U nisëm më 12:00 dhe arritëm më 14:30 në Gjerbës. U takuam me grupin tjetër (janë në itinerar me nise nga Korça e në drejtim të kundërt me tonin). Janë 22 veta. Disa u strehuan në shkollë, disa në baza e disa në hotel. Arjani me dy vlonjatë vajtën tek një vendas të cilit i kanë premtuar t'i rregullojnë pensionin (u therr qengji!). Ne të tre të Tiranës na çuan tek një familje nga ku u kthyem ngase nuk na pranoi e moshuara e shtëpisë (ishte vetëm). Mikpritja këtu është përtokë. E tha bukur Dyli i shkodrës (*besoj se bëhet fjalë për Avdulla Rëshketën*) i cili i njeh ngaqë ka qenë ushtar.

- Kam taku 30 vetë. Tan m' marrin n' qafë e m' puthin. Meta tuj u mshi me peshqir. Por nuk m' tha kush "bujrum!"

## 29 nëntor

Fjetëm mirë. Hoteli, i çfarëdo kategorie të jetë, është hotel. Dita kaloi e thjeshtë: mëngjesi në restorant, pastaj rrotull dhe më 10:00 pamë paradën (*që zhvillohej për festën e çlirimit në Tiranë*) në televizor. Në drekë pimë nga një raki dhe u zhdëpëm duke ngrënë arra. Nga ora 14:00 deri 18:00 gjumë, unë e Fatmiri (*Bozdo*). Në mbrëmje na thirri në dhomën e tij veterineri Bashkim Saliu. Ishte edhe Ylli me Banushin (*duhet të jenë të grupit tjetër*),

i cili e kishte shok Bashkimin. Kaluam mjaft mirë për rreth 3-4 orë dhe tani e ka rradhën gjumi.

Për mjete transporti e kemi keq punën. Sekretari i organizatës së partisë na ka premtuar për nesër në mëngjes, nga ora 06:00, se mundet të na bëjë ndonjë gjë *për kafshë barre*.

### 30 nëntor

Zgjimi më 06:30. Deri më 08:00 gjerbasit nuk na dhanë as kafshë e as mjet dhe ne u nisëm më këmbë. 45 minuta vazhdoi e përpjeta deri në rrugën e makinës dhe më pas vazhduam këtë rrugë. Kaluam mbi Zaloshnjë, Mëlovë, Gryka e Dervenit (këtu na zuri ora 11:00) pastaj morëm majtas dhe dolëm në Gostenckë (12:15). Aty pushuam një orë. Shpresuam të na gjenin mushka por nuk doli gjë. Vazhduam rrugën për në Kras. Arritëm në Krasin e Poshtëm më 15:00 dhe në të sipërmin më 16:00. Pritëm jo më shumë se një orë dhe na ndanë nëpër baza. Unë Fatmiri e Krenari (*Dobi*) ramë në shtëpinë e Belul Gjonit. Janë mjaft mikëpritës. Pamë televizor, hëngrëm darkë, pimë nja dy gota raki dhe u kënaqëm me biseda.

Ostrovicë moj Ostrovicë (Ostrovica me pesë cica), do na mundosh nesër. Fatja është Fatmiri (*Fatmir Bozdo*) dhe Nari është Krenari (*Krenar Dobi*) në ekipin tonë.

Xha Beluli tregon se gjatë luftës (*Na Çl*) ka qenë i plagosur në krah dhe në ije. Misioni Anglo-Amerikan i ndihmës e kishte dërguar në Itali (n'atë kohë Italia kishte kapitulluar) ku u kurua. Tregon se spitali kishte shumë të plagosur nga ushtritë aleate si dhe nga robërit gjermanë. Vetëm jugosllavë kishte 33.000 (!) Shqiptarë kish 20 a 30. Atë e kish shëruar një mjek jugosllav me gradë major. Tregon se më 1918 një grup pleqësh i çoi francezët në majën mbi fshatin e tyre dhe i pyeti: - Si quhet ky vend? – Çuka e Frëngut u përgjegj dikush.

- Kjo tregon se ky vend dikur ka qenë i yni, ju përgjegj francezi.  
 (!! ) *(Vështirë të jetë kjo një përgjigje e një ushtaraku francez!)*

Në mbremje fjetëm në një dhomë shumë të mirë.

## 1 dhjetor

U zgjova rreth orës 05:00. Kisha një djegësirë në stomak dhe doja të dilja jashtë. Por vetëm më 06:30 u ngritëm. U përgatitëm dhe më 07:00 dolëm. Mëngjes nuk pranua të hamë. Na gjetën gjashtë mushka dhe në orën 08:00 u nisëm. Hyseni (apo Kërka i Gjirokastrës) dhe një i ekipit të Dinamos shoqëruan kafshët për Qafë Martë. Ne u ngjitëm drejt e lart në Çukën e Frëngut e prej aty, duke ndjekur kreshtën, drejt e në Ostrovicë. Shpati ishte me akull. Arritëm majën më 11:45. Zbritjen deri tek lapidari e bëmë për një orë. Prej aty në Sektorin Një *(të pyjores)* e prej aty në Sektorin Dy ku u rregulluam për bujtje.

Kras – Qafë Martë 3 orë, prej aty në Sektorin 1, 1 orë e 30 min, e në Sektorin 2 një orë e 15 min.

Rruga nga Qafë Marta e këtej është shumë e bukur. Mali i Ostrovicës gjithashtu është mjaft tërheqës dhe nga Qafë Marta në drejtim të Voskopojës ka disa maja me vlerë alpinistike ku mund të organizohet shumë mirë një veprimtari si kjo e jona.

Në sektor, disa nga tanët rregulluan gjeneratorin e dritave, pastaj u futëm nëpër dhoma. Jemi tetë vetë (ne, dy nga ekipi Dinamo e dy nga ekipi Vlorës (Flamurtari). Ishte një odise e tërë ndezja e zjarrit, e cila arriti kulmin me Dullën që në përpjekje për të gjetur lëndë djegëse të lëngët pa një kazan të mbushur me vajguri të përzier me ujë. Mbushi një kuti dhe kur ja hodhi sobës dhe zjarri u shua plotësisht.

Në sektor, përgjegjës i punimeve është një burrë i thyer në moshë dhe që duket mjaft i fuqishëm e zemër bardhë. Përgjegjësi i Ndërmarrjes së Furnizimi të Punëtorëve duket ca si punëzvarritës dhe prej tij dëgjova “humorin”:

- O Bele!
- O mo, oo!
- Ku je?
- Mbërdheee.

## 2 dhjetor

U ngritëm mjaft vonë. Natën soba nuk u shua mbasi kush ngrihej, e rindizte. Nga ora 09:00 hëngrëm mëngjesin dhe pastaj u bëmë gati për nisje. Roja na kontrolloi për batanijet.

Rruga ishte mjaft e bukur dhe ecnim ngadalë. Deri në Vithkuq zgjat 2 orë e 30 min, por ne e bëmë më shumë. Në Vithkuq zumë hotel. Ky fshat është mjaft i madh, i bukur dhe me njerëz të mirë e të ngritur.

## 3 dhjetor

Një ditë e “shplarë” për shënime. Për tu shënuar, një librari e pasur në Vithkuq. Nga ora 10:30 – 11:00 u nisëm për në Korçë ku kaluam një ditë me vara-vingo. Mbetëm keq për lekë por na ndihmoi me 1000 lekë Kërka.

*Shënim: kjo lloj veprimtarie u vu në kalendarin kombëtar të veprimtarive për 2 a 3 vjet rrjesht bazuar në gjykimin se alpinizmi nuk duhej të zhvillohej vetëm në Alpe por ngado. Alpinistët vlerësoheshin nga disa “mëndje” zyrtarësh si ushtarë të veçantë në mbrojtje të atdheut dhe duhej të njihnin mirë mbarë Shqipërinë. Mbështetur në përvojën time në këtë veprimtari, në diskutimet e rradhës për kalendarin e veprimtarive të ardhëshme, ngula këmbë që kjo të mos zhvillohej më, dhe kjo veprimtari u hoq. Për mua, me përjashtim të ngjitjes së majës së Ostrovicës e cila kishte vlera alpinistike, veprimtaria kishte shumë marshim dhe pak alpinizëm.*  
AB



## VITI 1975

Veprimtaria: Bogë - Q. Pejë – Jezerë ana veriore  
Pjesëmarrësit si ma poshtë:

Aleksandër Bojaxhi                      17 Nëntori

Kristaq Korçari

Mario Trinkero

Dashamir Fejzo

Shefki Juma

Arjan Duma

Vasil Stambuli                      Partizani

Qazim Lliço

Robert Llabani

Kujtim Onuzi

Pëllumb Llabanishta

Hasan Temali                      Vllaznia

Qemal Zagonjari

Taxhedin Shehu                      Korabi

Qemal Hakorja

Adil Manga

Azem Muda

Rushit Reçi

Grigor Perikliu

Labinoti

Qemal Biçaku

Llazar Pupi

Lushnja

Hamdi Poçi

Arqile Shyti

Tomori

Toli Biqiku

Jani Qendro

Vangjel Ristani

Vlora

Venigjar Velaj

Kristaq Gega

Lame Nika

Skëndërbeu

Ferdinant Koça

Thoma Furxhi

Gjithësej 31 pjesëmarrës



Kristaq Korçari (m), Arian Duma, Shefki Juma, Aleksandër Bojaxhi, Mario Trinkera (p),  
Dashamir Fejzo

## 6 shkurt

U ngritëm pas orës 6, në hotel Adriatik (*Shkodër*). Kam një dhimbje të fortë koke dhe më vjen për të vjellë. Shëtis pak, hamë mëngjes e pimë kafe dhe kthehemi në hotel për të marrë çantat. Ia ngarkojmë ato për 1 Lek një karroce, që e tërheq një punëtor, për deri tek Axhensia. Aty u vonuam shumë. U bë një përleshje për punën e Ladit (*do jetë një Lad – Vladimir - që nuk është në listën si më sipër*) e në fund, në orën 10:30 u nisëm. Ndalëm pak në Koplik ku na arriti ekipi i Shkodrës. U vonuam edhe sepse sot morrëm “viston” nga Andoni për Qemalin (*me sa duket Andon Tapia dhe Qemal Biçaku do kishin diçka të pa zgjidhur*). Ora 12:45 jemi në Bogë. Gjeka (*i pari i familjes në shtëpinë përballë çezmës*) ka vdekur. Ora 13:20: nisemi. Bëjmë pushime të shpeshta (një orë e 30 min) dhe në orën 17:15 jemi në lugun për në Gropën e Radohinës, në krah të Gropës së Portës. (*para daljes në pikën e*



Alpinistët Aleksandër Bojaxhi, Grigor Perikliu, Shefki Juma drejt Radohinës

*kalimit të Shtegut të Dhenve – ndryshe Portës – janë disa livadhe që njihen apo emërtohen Gropa). Deri këtu shumë mirë. Bëjmë edhe zjarr. Unë fillova eksperimentin: ha biskota (fillova me 4 biskota të pakove 10 lekëshe të kohës, për çdo ushqim, në vend të bukës).*

## 7 shkurt

Llazi i Lushnjës, dje që në pushimin e dytë, na la shëndenë (*u tërhoq nga veprimtaria*). Sot u zgjuam herët, por u nisëm më ora 07:45. Rrugën e bëmë ngadalë, me pushime të shpeshta e pothuajse të gjata. Diku mata pulsin pas një malore të fortë: 139. Mbas 10 min arriti 108. Udhëtimin e lamë (*ndërpremë*) më ora 14:10, në rrëzë të qafës së Radohinës. (1 orë 15 min pushim). Vendosëm të ngremë kampin sepse në përgjithësi njerëzit janë të lodhur. Gjetëm pak ujë që rridhte nëpër shkëmbinj. Çadrën e ngritëm teksa moti ishte me diell. Jemi rregulluar mirë dhe pushojmë. Për nesër kemi rënë dakort të nisemi më ora 05:30 – 06:00. Rregjimi i ushqimit me biskota është shumë mirë. Ndjem në formë dhe uria nuk më merr. Ushqehem me gjëra të ëmbla gjatë rrugës. Puls 100.

## 8 shkurt

Tek e fundit më ora 06:45 u nisëm. Taxhi me të tijët u nisën pak përpara. Ngjitjen e bëmë të siguruar me litarë. Unë qeshë i treti në litar me Marjon e Shilin (*Vasil Stambuli*). Grupi i Taxhit nuk kishte kthetra dhe vuajti shumë. Arritëm në majë pas një ore. Fotografuam dhe u ulëm. Marjon e ulëm për hapjen e strehës (*ka mundësi të jetë ulur tek qafa për të hapur strehën për itenerarin drejt Runicës/Postës Verore të kufirit*). Nga ora 09:00 arritëm tek çadrat. Taxhi nisi për në majë tre alpinitë (*të ekipit të tij*) që nuk kishin doreza. Ne u ngjitëm në majë 11 vetë: unë, Mario, Shili, Pëllumbi, Shefkiu, Arjani, Taxhi, Rushiti, Hasani, Vironi dhe Qemali.

E lamë nisjen (*për më tej*) më ora 10:00. Ata që u kthyen (*nga ngjitja për në majë*) u nisën më parë. Qazimi dhe Kujtimi u kthyen se ishin sëmure (*u nisën për në Bogë*). Qazimit i morra kazmën dhe i dhashë baterinë (*elektrikun e dorës*). Qafën në Radohinë (*Qafën e Radohinës*) e kaluam të siguar. Pastaj nuk vazhduam rrugën e zakonëshme, por pak majtas. Një grup mori edhe më majtas. Rrugës koha u prish. Zuri pak borë, më pas u kthjellua, por njëherësh filloi një tufan i fortë, shumë i fortë. Sidomos në zonën e Qafë Pejës ishte i tmerrshëm. Besoj se nuk ka njeri nga ne që të mos e ketë rrëzuar era disa herë. U futëm në postën (*kufitare*) verore të mbuluar me borë deri në strehë. Në fjetore u sistemuam të gjithë. Shili e Qemal Biçaku erdhën të fundit, të dërmuar (*fizikisht*). Qemali me këmbë të ngrira. Më keq ishte Arqileja (*Shyti*). I bëmë me Shefkun një shërbim të fortë dhe e mbuluam me batanije. Fërkuam nga këmbët Qemalin, Pëllumbin, Adilin, Hasanin, etj. Toil i ka keq duart për faj të tij, sepse punoi pa doreza dhe i futi duart gati në zjarr (*për t'i ngrohur*). Shumë të tjerë i fërkuam apo u bëmë masazh. Deri tani ndjehem mirë. Për çudi mirë! Këmba (*me ligamentin kruciat të këputur*) nga fundi bëri pak naze.

Tufani që i jashtëzakonshëm (1968) (*të kujton janarin e vitit 1968*) dhe pa postën (*godinën e postës kufitare verore ku u futëm*) nuk i dihej fatit tonë për ngrirjet (*që mund të pësonim*). Tërë koha jonë (3 orë) po kalon me shkrirje bore për ujë. Njerëzit tani janë shtrirë dhe na mbetet të flegjë. Ndjehet lodhje.

## 9 shkurt

U ngritëm rreth orës 06:00 por dhoma është e errët. Rimë shtrirë. Mbas orës 08:00 ngrihem i pari dhe dal jashtë. Koha

është e mrekullueshme! Fryn një erë e lehtë dhe është ftohtë. Pastaj fillojnë e dalin të tjerë. Vasili hap, pastron, një dritare nga bora dhe hyri dritë në fjetore. Më vonë u pastrua nga bora edhe dritarja tjetër. Dhoma u gjallërua mirë. Filloi ngrënia, shkrirja e borës, bixhozi (*lojërat me letra*), shakatë. Mbas orës 10:00 vjen Muharremi (*komandanti i postës kufitare*) me 30 a më shumë fshatrë e ushtarë. Në fillim u trembëm se mos ndoshta do na flisnin që kishim hyrë brënda në postë. Porse jo! Ata u gëzuan (*që ne kishim hyrë në godinën e postës*). Ishin të alarmuar për fatin tonë dhe këtë gjë e kishin përcjellë edhe në Tiranë.

Mbrëmë ne diskutuam gjatë, para se të flinim, për tre persona që kalonin (*hamëndje*) nga Vukli a Nikçi në Theth nëpërmjet rrethit të Vizhnjës. Diskutuam (*dhe vlerësuam*) se ata 3-4 alpinistë (*nga ne*) që thonin se i kishin parë, “u kishin bërë sytë”. Por ata ngulnin këmbë. Ne menduam edhe se mund të ishin alpinistë të ardhur nga Jugosllavia, e më pak mundësi, fshatarë

Ata tre fshatarë (*na paskëshin qenë tre kelmendas*) nuk kishin mundur të përcaktojnë mirë numrin (16) dhe gjendjen tonë. Këtë (*hamendjen e tyre*) ata ia njoftuan ushtarëve të postës kufitare të cilët dinin gjendjen (*ndodhjen*) tonë në ato anë (32 vetë). Muharremi kishte njoftuar për tufanin dhe rrezikun e jetës sonë po të vazhdonim të rrinim jashtë. (*Në axhensinë e autobusave në Shkodër ne patëm takuar një të njohur-Syken-, banore dhe mësuese në Theth, dhe i kishim folur për gjithëçka lidhur me veprintarinë që do të ndërmerrnim. Dhe i lamë porosi që informacionin t'ia përcillte për dijeni edhe Muharrem Lleshit, komandantit të postës kufitare Theth*).

Muharremi erdhi aty (edhe Asllani – *kujdestari i postës*) për të parë në vend gjendjen tonë. U futën brenda (*nga dritarja*) e kërciti biseda. Verifikuan gjendjen: Arqileja ishte mirë, Toli kishte vetëm dy fluska të vogla tek gishti i vogël, Taxhi fluska të mëdha, Hasan Temali i kishte gishtat e këmbës keq. Po ashtu

Qemal Zagonjari (por më pak). Keq e kishte këmbën edhe Adil Manga. I ftuan këta shokë që të kthehen, por ata nuk pranuan. Atëherë Muharremi nisi njerëz për Theth, dy fshatarë, për të lajmëruar se ne jemi mirë. Ai kishte rënë dakort me kufirin dhe fshatin për dy sinjale: a. kërkojmë forca të tjera dhe b. të niset helikopteri. *(rezultoi se as duheshin forca të tjera dhe as duhej helikopteri. Të dy këto sinjale do të jepeshin me të shtëna automatiku. Andaj duhej që të niseshin fshatarët poshtë për të sqaruar gojarisht situatën).*

Nga ora 11:00 të ardhurit nga Thethi dolën *(nga godina e postës)* për tu larguar. Ndërkohë vjen një helikopter. Erdhi shumë herë rrotull, bëmë shenja, por nuk u ul. Pasi bëmë shumë fotografi me të ardhurit, ata ikën. Pastaj erdhi rrotull tjetër *(sipas nesh)* helikopter.

U morrëm me gatime, sistemime, tharje, etj. Nga ora 16:00 dhamë urdhër *(Shili e unë ishim drejtues të veprimtarisë)* për tu përgatitur për ngjitje për nesër në majat Prozhëm e Lakoj. Gjallëria e lëvizja u shtuan. Pas 20 min na erdhën Andoni e Minella! U habitëm! U përqafoam, hymë brenda e filloi biseda. Po atë ditë, ora 01:00, (natën; pra pas mesnate) kishin telefonuar Kozmanë (Kiço Negovani). Lajmi ishte përhapur nëpër institucione të ushtrisë, pushtetit, Komitetit Qëndror të PPSH, etj., etj. Ishin interesuar për ne edhe Xhafer Spahiu, Mehmet Shehu, Shefi i Shtabit të Ushtrisë, etj., etj., deri tek Enver Hoxha.

Minella, Andoni e Kozmai u ulën me helikopter në Theth, ku Kozmai mbeti për ndërlidhje.

Shokët e ardhur u infor-muan për gjendjen tonë, na përgëzuan dhe na thanë se edhe ata me sa munden do mbështesin veprimtarinë tonë.

Teksa vinin për tek ne (Minella dhe Andoni), ata shoqëroheshin nga Nikolla i Lulashit *(djali i Lulash Vërrisë nga*

*Thethi, Nikolla, ishte instruktori i qenit të kufirit*) dhe një ushtar. Mirëpo kur ishin në në Qafë Pejë ata panë se po vinin dy njerëz dhe qëndruan për tu zënë pritë. Doli se këta dy persona ishin Qazimi (Liço) me Kërnelin. Ne dërguam Vironin e Qemal Biçakun për të lajmëruar Nikollën (*që ishte në pritë*) se shokët arritën e janë mirë. Vironi e Qemali u kthyen në postë bashkë me Qazimin dhe Kërnelin me dy



Alpinisti Qazim Liço

letra të shkruara nga Kozmai: njëra për mua e Shilin, e tjetra për Minellën. Urdhërohej që kategorikisht të ktheheshim (në letrën për Minellën thuhej që ky ishte urdhër i Mehmet Shehut).

Shili mblodhi shtabin dhe diskutuam se çfarë të bëjmë. Vendosëm të kthehemi në Theth me një pararojë, me një telegram të përgatitur e të drejtuar Xhafer Spahiut (ai kish porositur Minellën për ta sqaruar lidhur me gjendjen tonë) ku tregohej gjendja jonë dhe kërkesa për të vazhduar.

Pas mbledhjes, kur vajtëm (ne, shtabi) tek shokët, Qazimi na thotë se sot duhet të jemi në Theth se na presin makinat në Bogë. Të hënën gjallë a vdekur duhet të jemi në Tiranë! Atëherë u dha urdhër nga Shili që më ora 22:00 të nisemi për në Theth.

## 10 shkurt

Ora 03:30 arrimë të futemi në godinën e kampit të Thethit pasi zgjuam nga gjumi Nuen (thethjan, drejtor i kampit). Na dha batanije dhe ia futëm gjumit deri në ora 08:00.



Koha ishte një mrekulli. U përgatitëm dhe më 10:30 u nisëm për në Bogë pas një ceremonie të shkurtër. Nga ora 16:00 arritëm. Në Fushë të Okolit na prisnin dy gaze (*lloj kamioni*) 3 diferencialësh që na transportuan në Bogë. Aty na priste autobusi (e sigurisht gjumi nëpër sedilje) që na çoi në Shkodër ku hëngrëm darkë. Sa më shumë ulemi drejt Tiranës aq më shumë merret vesh paniku i krijuar me një "kontorno" fantazie të çuditëshme. Ora 20:10 nisemi për Tiranë ku arrijmë në ora 23:00.

## 11 shkurt

Ora 08:00 jemi tek ministri i arsimit, shoku Thoma Deljana. Ora 10:45 dalim nga kabineti i tij. U diskutua gjërë puna jonë dhe e sportit tonë. Ne s'kemi faj (*për meteorologjinë që ka mali*) por përderisa shteti do që të zhvillojë këtë sport dhe subvecionon ai, duhet që të plotësojë të gjitha kushtet për këtë sport duke koordinuar edhe veprimet me ushtrinë.



Aleksandri Vasili e Mario në Shkurt 1975

Pas kësaj më ngarkuan të bëj një shkrim në “Zëri i Popullit” të cilin e dorëzova në orën 15:20. Për pasnesër duhet të shkoj tek Ahmet Shqari (*komentator sportiv i RTVSH*) për bisedë. Shili i dha informacion televizorit. Po zjen bota!

Për të justifikuar dietat që kemi marrë, nesër nisemi për në malin e Dajtit me një program të caktuar.

*Mbajtës i ditarit, Aleksandër Bojaxhi*

## Veprimtaria: Qafë Pejë, 20 deri 29 gusht

### 20 gusht

Dje, ora 08:00, u nisëm nga Shkodra me një autobus më vehte. Shofer është Tonini. Erdhëm shtruar: ndalëm në Koplik, Bogë e Qafë Thore. Ora 12:00 ishim në kamp (*tek kampi i puntorëve - Theth*). Takuam Lulashin (*Lulash Marku apo Vërria, banor i Thethit, mik i alpinistëve, e veçanërisht i Kozma Grillos*). Në postën kufitare nuk ishte asnjë nga drejtuesit e njohur. Në kampin e punëtorëve ishte (*njihnim*) vetëm Luljeta (*banore pranë Kronit të Micanëve; punonte si kamarjere në mencën e kampit të punëtorëve*). Për të siguruar kafshë për transport u ulëm në fshat, në qendër.

Ramë në ujdë për 7 kafshë për datën 20, ora 07:00. Pasditën, e pothuajse darkën, e kaluam me Lulashin në klub e në çadër. Më mundi 2:1 në xing. Ora 17:00: bëmë një mbledhje për programin tonë. Është tendenca që në çdo mbledhje të ngrihen probleme “kardinale” të alpinizmit.

Në veprimtari marrin pjesë:

Vasil Stambuli

Partizani

Komandant

Qazim Liço

Kujtim Onuzi

Vladimir Memisha

Robert Llabani

|                        |            |              |
|------------------------|------------|--------------|
| Aleksandër Bojaxhi     | 17 Nëntori |              |
| Kristaq Korçari        |            |              |
| Mario Trinkera         |            |              |
| Dashamir Fejzo         |            |              |
| Taxhedin Shehu         | Korabi     | zv/komandant |
| Azem Muda              |            |              |
| Rushit Reçi            |            |              |
| Viron (Venigjar) Velaj | Flamurtari |              |
| Kristaq Gega           |            |              |
| Koço Ziso              | Skënderbeu |              |
| Lame Nika              |            |              |
| Gëzim Uruçi            | Vllaznia   |              |
| Hajdar Hasa            | Valbona    |              |

Natën e kaluam në një livadh të vogël (vend ku u ngritën tendat) pranë dyqanit të Zonjës.

Sot u ngritëm rreth orës 06:30. Koha është më e keqe se dje. Shili është komandant në kohë të keqe!

Më 11:00 u nisëm me mushkat të ngarkuara pasi u sorrollatëm, por edhe blemë, në dyqane. Na u bënë 9 mushka (në fakt 8, sepse një kafshë báre ishte gomar). Rrugën e marrim me shumë nge, duke bërë fjalë hera-herës me djalín e Kolë Prekës (Kola njihej si kafshar i fshatit; ai banon në Okol). Ora 16:00 arrijmë në bazë. Koha mjaft e ftohtë dhe frynte erë. Bëra supë brenda në çadër dhe sapo piva kafe. Nëpër çadra është qetësi. Vetëm në çadrën e Marjos e Dashit luhet me letra (Taxhi, Gëzimi) dhe ka fjalë. Shili sapo më solli të fala nga Muharremi, komandanti i postës kufitare). Nuk i rrihet pa vajtur tek shefat, megjithëse dridhet si qeni (*nga të ftohtit*).

## 21 gusht

Natën kam mbërdhirë. Frynte erë e fortë dhe fletët e çadrës bënëin potere. Zuri shi që vazhdoi edhe në mëngjes. Është përsëri ftohtë. Rimë në çadra. Nga ora 13:00 koha diçka u hap. Vajta në Postën kufitare (mbusha ujë) dhe takova Muharremmin, Nikollën dhe ushtarët. Ata më thirrën kur u largova (*nga burimi*). Më ora 16:00 erdhi ekipi i Beratit: Petraq Kule, Vangjel Mëlëngu, Vullnet Zylyftari, Jani Qendro, Vlash Koxhaku.

Pyeta sot Shilin për aktivitetin e tij (*ishte koha kur mbledhja material për historinë e alpinizmit duke biseduar kryesisht me të gjithë ata që i kishin hyrë këtij sporti para meje*). Në mbremje erdhën në çadër Vangjeli e Shili dhe folëm për problemet e alpinizmit. I vënë faj Andonit (Tapisë). Unë nuk diskutoj për fajet e tij, porse ngul këmbë që problemet ngecin në kuadro drejtues të lëvizjes fiskulturore si A. T. dhe D. L. Gjithashtu mundohem të bind se nga komisioni teknik nuk duhet pritur aq sa kërkohet, pasi ai nuk ka të drejtë për të vendosur. Duhet ngulur këmbë më shumë në përbërjen e kryesisë.

Kam ngrënë bukë e dëgjojmë muzikë. Koha është e ftohtë.

## 22 gusht

Mëngjesi i ftohtë dhe me mjegull. Na ngritën në ora 06:00. U sorrollatëm me gjimnastikë, etj. Ora 08:30 u rrjeshtuam e pas “ceremonisë Stambul-iane” u nisëm për ngjitje. Punuam pranë me treshen e Beratit. Unë, Mario, Dashi u futëm në një lug të Malsores, në jug. Shumë e thjeshtë, por sipër doli një tavan mjaft i bukur. E vlerësuam të pestë. Pasdite kaluam mirë dhe qetë. Kur u largua mjegulla, koha u bë mjaft e bukur.

## 23 gusht

Mëngjesi si zakonisht i ftohtë. Na zgjuan më 06:30. Grupi ynë i 17 Nëntorit dhe Koço Ziso shkuam thellë në krahun e perëndimit

të Kullës së Kolajve. Bëmë ngjitje në një majë, e dyta si lartësi dhe si renditje nga pika jugore ku mbyllet ky varg. Unë u ngjita me Koçon. E nisëm për të lehtë, por doli e gjashtë. Ndenja një kohë të gjatë varur në shkallë dhe u lodha shumë. Ndërkohë me radio luajtëm një shaka sikur ishim keq, që të vinte Shili. Mirëpo ai e mori me gjithë mend e na solli Qazimin, i cili erdhi në kohën kur unë duhej të devijojë nga itinerari. Bëra një lavjerrës dhe kalova majtas (isha i futur në një kënd të drejtë - *diedër me sa duket*). Me ndihmën e Qazimit që më udhëzonte, kalova deri afër lugut ku u fut treshja jonë (*duhet të jetë fjala për Dashin, Marion e Kiçkën*). Ishim tepër afër. Më lanë fare forcat. Me një kujdes të shumfishtë u lidha me litarin që më hodhi Mario e u futa në lug. Pastaj dola sipër. I rraskapitur! Koço hoqi materialet (*e vendosura në shkëmb*) e më pas u ngjit, por la një plengël/ gozhdë dhe një karabinë (*karabina është thirrur/quajtur nga ne edhe çelës, edhe çelës gjoksi*). Prej aty hipëm në majë duke ecur 15 min në kurrizore (*kreshhtë*). Bëra shumë fotografi, sidomos për malet. Në majë gdhëndëm në një gur “17N” e në listën e emrave (*të itinerarëve/majave të ngjitura*), shkruajta Maja 17 N. Kështu, si me shaka, “e pagëzuam”. Zbritëm dhe në orën 17:55 ishim në kamp. Mbas një ore erdhi Shili, i cili e mbylli ditën alpinistike me një rreshtim ceremonial ku na raportoi gjatë e me hollësi ngjitjen e tij, si i kaloi dita dhe pse u vonua (Shilit i pëlqenin ceremonitë dhe pompozitetet dhe kur caktohej komandant veprimtarie i bënte këto sa mundej. Ne, si rregull, nuk ia prishnim). Kampi sot është veçanërisht i qetë.

## 24 gusht

U ngritëm aty nga ora 7 e mëngjesit. Koha është në keqësim e sipër. Mbas orës 08:30 u nisëm për në Prozhëm (marshim), por vetëm pasi u bënë qyfyret e zakonshme gjatë leximit të urdhërit të ditës

(d.m.th. planit ditor) nga Vironi. U ngjitëm të parët në majën e Sqtës së Cjapit: unë, Vullneti, Vangjeli, Koço. Më pas erdhën, Jani, Mario, Petraqi e doktori (Vlasi). Kurrizore (*nëpër kreshtë*) kaluam në Prozhëm tre të parët dhe Marjo. Në një moment të fundit të vështirësisë së kalimit të kurrizit (kreshtës) më zuri frika. Nga lodhja më dridheshin këmbët e disi m'u kujtua Allamani (ka mundësi që për herë të dytë, kreshtën ta kem kaluar me të). (Shënim: *këtij momenti i jam referuar me veten time më vonë ngase është një rast i pastër që tregon që e kam patur ligamentin kruciat të këputur. Ende nuk e dija – e diktoi më pas ortopedi Leonidha Konomi. Në pjerrësi ligamenti kruciat nuk e kryente punën e tij dhe ia "kalonte" këtë punë ligamenteve anësorë – kështu ma pat shpjeguar mjeku. Mirëpo ato ligamente nuk janë për atë funksion dhe kjo shkaktonte dridhje të këmbës, etj. Më ka ndodhur edhe një herë tjetër tek udhëhiqja një të katërt me Shilin dhe Ed Sheldinë. Hoqa dorë përfundimisht nga kacavarja dhe pjerrësitë e forta pasi zbrita nga një kacavarje e shkallës 3-A ku punova/ngjita në litar me Artur Shehun në Fushë Dënell itenerarin më të thjeshtë aty. Ishte testi final që i bëra vehtes dhe nga ai moment, nuk kam kryer më kacavarje dhe i jam shmangur maksimalisht pjerrësive në truall. Në borë ishte më ndryshe: bëja një "shesh" për shputën e djathtë, por edhe për të majtën, që e kisha këmbë të pa dëmtuar).*

Pasi u ngjitëm, në zbritje takuam Ladin e Kiçkën (Kristaq Korçari), e më vonë të tjerët. Poshtë tek stani hëngrëm një kos të pazënë. Pasditja kaloi e qetë (ra pak shi). I bëmë një lojë të fortë me radio Shilit, me djemtë që vinin nga Thethi (për të ndihmuar Lamen që po na sillte bukët). Në çadrat e Beratit i thamë se e kërkon A.T. në Theth (*tani që hedh ditarin nuk më kujtohet humori që bëmë*). Lamja erdhi nga dreka me bukët të ngarkuara në kafshët e djalit të Kolës duke i dhënë 6 lekë për çdo bukë. Për nesër pritët kohë e keqe.

## 25 gusht

Koha vërtet e keqe. Mjegull, shi, erë. Në ora 11 një përmirësim, por përsëri një “risulm” resh nga jugu. Tërë ditën rrimë në çadra. Filloi gatimi i kërmijve dhe loja me letra. Nga Shili, në darkë, mora vesh një bisedë që kishte patur me një stacion francez (një kanal të radios marrëse-dhënëse në gjuhën frënge) që kishte hyrë në valën tonë.

Gjithashtu një djalë i Peshkopisë (*d.m.th. anëtar i ekipit Korabi*) pati sot një “bisedë” me një kërmill (*ndodhnin këto me veri-lindorët; më të shumtët prej tyre nuk i hanin kërmijtë e gatuar*) që i pati hipur në çadër e që më së fundi e goditi me shkop. Për nesër duket që përsëri do të jetë kohë e keqe.

## 26 gusht

U gdhi kohë jo e mirë. U ngritëm vonë. Retë relativisht janë lart (mbi maja) e nga ora 10 rreshtohemi për marshim. Një grup drejtohet për në Lakojt (qafë) e ca shkojmë për në itinerarin e dimrit (*është fjala për ngjitjen e majës së Jezerës nga faqja veriore, synim që ishte në dimrin që lamë pas, madje me mendimin se mund të kalohej edhe në Valbonë*). Ishim: Shili, Koço, Taxhi, Gëzimi, Kiçka, Marjo, unë. Ora 10:20 u nisëm. Bëmë ca foto rrugës. Vajtëm tek shpella e Malësorës (e mirë për dhen) dhe ndenjëm pak tek çadrat e gjeologjisë (*n'atë kohë gjeologët fushonin tek liqenet dhe kërkonin për polimetale. Madje në zonën e Qafë Pejës – rrotull godinës së postës kufitare verore – ishin hapur edhe galeri të shkurtëra për të marrë mostra*). Pa kapur qafën takuam kufitarët (4 ushtarë) e bëmë fotografi me ta. Kur dolëm matanë lindi diskutimi i ngjitjes në qafë. Pamë liqenin e madh të tharë gati fare, si edhe një të vogël (tek gjeologët liqenet ishin krejt të tharë). Kishte mbetur një i vogël (edhe ai i Runicës – *Geshtares* ishte thujasë i tharë). Kiçka e Koço u kthyen.

Ne që mbetëm u nisëm për Jezerë. Bora ka shkrirë jashtëzakonisht shumë. Ka mbetur një dëborë mjaft e vjetër mbi të cilën rrjedh ujë i cili në shumë vënde zhduket në ca plasa e të çara, një pjesë e të cilave janë mjaft të thella. *(shënim: bora këtu është e ngrirë dhe këto ujra rrjedhin mbi të. Vetëm pasi kalova disa orë stërvitje në gusht të vitit 2008 në rrëzë të malit Mont Blanc – Francë – në akullmajën Mare de Gras, kuptova se kjo sipërfaqe me borë të ngrirë rrëzë fajes veriore të malit të Jezerës ishte një akullnajë. Jo e madhe, por akullnajë, e cila formohet këtu, ndoshta, ngaqë me sa duket në fagen veriore të Jezerës bie shumë borë).* Kur kaluam borën *(tani më bie të them akullnajën)*, bëmë ca humore me Shilin i cili i mbathur me këpucë gome kineze (atlete) rrëshqiti nja dy litarë poshtë dhe u bë qullë. Kështu që u zhvesh e u shtrydh (ora 14:00). Pastaj dolëm në qafën Jezerë-Kokërhane në 2.200 metra. Aty pushuam pak në një shpellë e nga ora 14:30 u nisëm për Jezerë. Ra mjegull e fortë dhe zuri shi. Ndalua pak, por pastaj vazhduam. Ora 15:45 arritëm në majë unë e Taxhi. Pas pak Marjo e pastaj Shili me Gëzimin *(mendoj se kjo duhet të ketë qenë ngjitja e parë e majës së Jezerës e kryer nga kjo anë)*. Këtu gjetëm një letër të ekipit të Tropojës lënë më dt. 01.08.1975. Shili u lidh mjaft mirë me Petraqin në radio, i cili gjuante nga Gropat e Bukura *(Petraq Kule hera-herës merrte çiften e gjahut në veprimtari. Sipas nesh, ai ishte një gjahtar shumë i mirë)*.

Zbritëm nga Gropat e Bukura. Në hyrje të tyre u takuam me Petraqin dhe me një bari të Grizhës *(Grizha është një fshat midis Shkodrës e Koplikut)*. Nga ora 18:30 arritëm në kamp. Nuk na priti njeri *(një traditë, e cila po “dobësohej”)*. Ata që ndodheshin në kamp duhej që, pasi dikush që na spikaste që po vinim, të rreshtonte alpinistët që ndodheshin aty dhe një nga ne, gjithashtu të rrjeshtuar, në këtë rast Shili, të raportonte për veprimtarinë tonë, etj.). Shili i indinjuar qëndroi gatitu dhe bëri solo një zig-zag. Kiçka na kish



ruajtur komposto dhe na kish bërë ujin gati për çaj që më pas na e serviri Shili.

Pimë komposto e çaj dhe e morëm vehten mirë. Petraqi na dha ca djathë të njomë (që me siguri ia kishte dhënë bariu nga Grizha). Si pa dashur, më vonë, lindi një bisedë nga larg. (Pa ardhur ne në kamp dëgjuam qeshje hysterike-Berti). Del se Berti, Qazimi ----- Dashi si vlëra jo alpinistike (*shënim: nuk e kuptoj se çfarë shkruhet*). Gjatë marshimit mu mbarua filmi. Megjithatë duhet thënë se moti nuk ishte për fotografi. Nuk më eci sot me aparatit fotografik.

## 27 gusht

Në mëngjes zuri shi i lehtë. Pushoi, por gjatë gjithë kohës kishte mjegull mjaft të dendur. Nga dreka mjegulla u largua dhe mbeti kohë e vrenjtur deri në darkë. Pastaj prapë shi. Dita kaloi duke luajtur me letra dhe duke i pyetur shokët më të vjetër (*në këtë grup*) për fillimet e tyre të alpinizmit. Radio njofton për kohë të keqe edhe për nesër dhe ne vendosim të nisemi për në Theth.

## 29 gusht

Dje u ngritëm me nge. Koha përsëri e keqe, me mjegull, kurse më parë ra shi. Filluam të bëhemi gati për të zbritur në Theth. Para se të nisemi u bë sherr për mjekrat (*partia në pushtet na donte të rruar dhe kush nga ne ishte caktuar drejtues veprimtarie apo ishte anëtar partie - po se po - e ndjente si përgjegjësi që kur të ulëshim "në qytetërim" të ishim pa mjekër*). U rruam (unë lashë mustaqet) dhe nga ora 11:30 u nisëm. Nga ora 15:00 arritëm në Theth (kampin e punëtorëve). Bëmë dush dhe më pas kaluam kohë të lirë deri në darkë. Në darkë me Muharremin (*M. Lleshi, komandant i poshtës kufitare*) dhe Llazin (*Llazar Toska komisar i postës*) ja shtruam.

Nga ora 9 e mbrëmjes, Zefi, punonjës i klubit, filloi të bëjë fjalë. Me ndërhyrje (nga Shili) u rregullua që të qëndronim deri më 9 e 30, e më pas deri më 10 (të natës). Më 10 Shili dha komandën “çohu!”. Askush nuk lëvizi sepse kërciste kënga. Pastaj Shili urdhëroi: shokë alpinista mjaft! Nëpër çadra!” Mirëpo ndërhyri Petraqi, dhe pas 15 minutash u larguam edhe ne për të fjetur. Vazhduam me Koçon, Petraqin e Marjon të luajmë tuist (me letra). Mirëpo bërtiti nga dhoma e tij Nuja (drejtori i kampit) dhe lamë lojën. Fjetëm në shtretër tek magazina.

Sot është prapë kohë e keqe. Pas orës 10 u nisëm për tek Shpella e Rrathëve. Na zuri shiu rrugës. Vazhduam përsëri pasi pushoi pak, por prapë na zuri shi e mjegull, derisa me vështirësi gjetëm shpellën. Aty ndezëm një zjarr dhe u thamë disi. U futëm brenda më 11:45 e dolëm në ora 14:00. Ishte mirë për tu futur. Morrëm ca gurë e zbritëm në kamp më ora 16:00. Kishte ardhur Seiti (*Veseli? i caktuar sekretar i shoqatës në vend të A. Tapia*). Ora 17:00 filluam mbledhjen, deri 18:20. Pastaj drejtuesit ikën e bashkë me ta edhe një pjesë e shokëve të veprimtarisë.

Për nesër e kemi keq për makina. Në darkë luajtëm karambol dhe na bëri Shili mëlçi. Pastaj pak pranë zjarrit të Beratit e në çadër.

*Mbajtës i ditarit, Aleksandër Bojaxhi*

# Viti 1978

## 1978, janar-shkurt

Pjesëmarrësit:

|                      |                         |
|----------------------|-------------------------|
| Aleksandër Bojaxhi   | 17 N                    |
| Mario Trinkera       |                         |
| Kristaq Korçari      |                         |
| Kozma Grillo         | Studenti Komandant      |
| Vladimir Memisha     | Dajti??                 |
| Maridon Hito         |                         |
| Qemal Biçaku         | Labinoti                |
| Jani Qendro          | Tomori                  |
| Toli Biqyku          |                         |
| Vasil Stambuli       | Partizani/ zv/kom       |
| Pëllumb Lllabanishti |                         |
| Eduard Sheldia       |                         |
| Kujtim Onuzi         |                         |
| Shkumbin Ramadani    | Flamurtari              |
| Servet Aliko         | Komisar                 |
| Kristaq Gega         |                         |
| Marek-u              | ushtar, radiondërlidhës |
| Tonin-i              | ushtar, radiondërlidhës |

## 31 janar

Nga klubi ynë 17 Nëntori jemi unë Kiçka dhe Mario.

Sot ora 10:00 nisemi nga Klubi Sportiv Vllaznia për në Bogë. Kur dolëm nga zyrat e klubit në rrugë, anës trotuarit bashkë me autobusin tonë, qëndronte edhe një makinë varrimi. Ky fakt shkaktoi “ilaritet”.

Ndaluam në Koplik ku shëtitëm nëpër dyqane. Bleva disa libra. Takuam edhe Palokën, furrtarin pensionist që gatuan e pjek bukë gjatë verës në Theth dhe rri tërë ditën tapë.

Bora kish zënë rrugët pa hyrë në Xhaj, por ishte shtresë e hollë. Ngado na rrethon borë e mjegull, që si një masë e ndyrë dhe e plogët mbulon malet dhe “mbush” luginat.

Kur u afruam tek Kroi i Lugjeve të përpjetat bëheshin të pakalueshme nga bora dhe ne u detyruam disa herë të dalim jashtë makinës, të heqim borën dhe të shtyjme makinën. Shoferi deri këtu u tregua mjaft gazmor e na kënaqi duke treguar ndodhi ordinere për vëllain e tij, si p.sh.:

- Para se të shkonte ushtar kishte qenë mësues. Për të zgjedhur komandantin e çetës së pionerëve të shkollës i ndante fëmijët dy e nga dy dhe i vinte të ziheshin me një takim. Kështu, nëpërmjet sistemit të eliminimit dilte kampioni, i cili caktohej, nga mësuesi, komandant i çetës.

- Jo rrallë atij i vinin fëmijët në shkollë (kishte klasa kolektive) para se t'i dilte gjumi. Flinte në klasë mbi tavolina, e nga dysheku i ftonte nxënësit brënda, i kontrollonte dhe u shpjegonte, pa u ngritur nga dysheku.

- Kur ishte ushtar, një mbrëmje të Viti të Ri ishte roje në periudhën kohore 22:00 – 24:00. Gjatë ditës kishte parë një gomar të cilin e kishte marrë dhe e kishte futur në teritorin që ruante (në Durrës pranë vilës së mbretit Zog), ku ishte artileria bregdetare. Pranë një topi i zbrazti gomarit 72 fishekë.

U bë alarm; u ngritën oficerët nga darka e Vitit të Ri dhe erdhën në vend ngjarje e rrethuan me kujdesin më të madh dhe gjetën të plagosur gomarin. U rreshtua të nesërmen reparti para një gjenerali dhe ushtari ju përgjigj pyetjes që ju drejtua se përse e vrau gomarin. Përgjigja e tij: Na ka thanë komisari se armiku paraqitet në forma të ndryshme. Mua mu duk se u paraqit në formë gomari dhe e qëllova. Gjenerali e urdhëroi që ta varrosë (ndërkohë gomari kishte ngordhur). Ky i bëri gropën, e varrosi dhe mbi varr i nguli tabelën ku shkruhej: Këtu prehet Gomari Xhek, i cili u vra nga rojet vigjilente të artilerisë bregdetare”.

- Pasi kreu shërbimin ushtarak, vëllai u bë shofer. Një ditë, tek udhëtonte për në Korçë, morri në Elbasan ekipin e rezervave (ekipin e dytë) të Beratit i cili kishte ndeshje në Korçë. Gjatë ndeshjes Beratasit u vranë (dëmtuan në lojë) dhe i erdhi rradha edhe këtij të futet në lojë, por ishte i pirë. Pra, u fut në fushë si futbollist beratas në mbrojtje. Vrau (dëmtoi) futbollistë korçarë, por më pas ata i dhanë një shkelm të mirë sa vulli e nxorri zorrët dhe u bë esëll.

Anekdotat shkodrane

- Ç’është Vllaznia e Shkodrës? (ekipi i futbollit)

- Është monument i lashtë kulture ku të gjithë vinë e shohin dhe marrin përvojë.

- Ç’është “Dinamo”? (ekip i futbollit të Ministrisë së Punëve të Brendshme)

- Është shtëpi kulture që ruhet nga shteti.

Kur fitoi Dinamo një kupë a ndeshje futbollit një tifoz shkodran nëpërmjet televizorit e uron ekipin (*nëpërmjet programit Radio Posta*) duke e përshëndetur me këngën “O bylbyl o mbret i shpendëve”, me ironinë se bilbili i arbitrit në ndeshjen e futbollit është ai që nuk lejon Dinamon të mundet (humbasë).

Në të përpjetat, pasi kaluam Kroin e Lugjeve shoferi u tregua frikacak dhe desh na la. Me mundim arritëm tek Kisha (*që nga viti 1967 - mjedise të kishës ishin kthyer në institucion për zyra të ndryshme të fshatit, muze i fshatit si dhe në furrë buke*). Donim të shkonim të gjithë për të kaluar natën tek shtëpia e Gjekës, por fshati na ndau nëpër famije të ndryshme me grupe nga 2-3 veta. Unë e Mario ramë (na caktuan) tek shtëpia e Kolë Prelë Rakajt (djali i tij është Zefi). Janë familje e mirë dhe kaluam mjaft mirë.

## 1 shkurt

Më doli gjumi herët. Megjithatë u ngritëm në ora 07:00. Pimë nga një kafe dhe u mbledhëm tek kisha. Pasi diskutuam vendosëm që të marshojmë, të lemë materialet tek një shtëpi në Okol dhe të vazhdojmë të çajmë borën në drejtim të Shtegut të Dhenve.

Në Okol u stabilizuam tek shtëpia e Zef Malaj dhe më 12:00 u nisëm për të çarë borën (*taktikisht, kur kishte borë që të fundoste, marshonim pa ngarkesë sa të mundeshim dhe të nesërmen në mëngjes, me rrehe të ngrirë, marshonim pa vështirësi*). Çava shumë, sidomos nga Fushë Okoli e tutje. Ishte borë mjaft e shkrifët. Të fundoste në të përpjetë deri në gjoks. Më 15:20 dolëm tek Gropat e Portës.

Në darkë pleqëruam se çfarë na duhej të bënim. Vendosëm të kthehemi për Tiranë dhe të rifillojmë këtë veprimtari në muajin Mars.

## 2 shkurt

Pak pas orës 06:00 u nisëm nga shtëpia e Zef Malajt ku kishim fjetur. Më mirë të them se kaluam natën, ngaqë fjetëm shumë pak dhe keq sepse përtonim (nuk donim) të prishnim çantat (e të nxirrnim thasët e fjetjes).

Dita ishte e bukur, pak e ftohtë, kurse bora ishte e thatë dhe të fundoste. Tek qendra (Kisha) ndaluan dhe me vështirësi u lidhëm me telefon me Shkodrën (kishim ushtarë të ushtrisë sonë me radiomarrëse-dhënëse, por ata nuk u lidhën me askënd, madje, më pas, as në Xhaj). Shkodra na premtoi se do na niste makinë.

Një makinë e kooperativës që shkarkoi dru në Bogë, na morri deri në Xhaj. Aty pritëm shumë: 09:30 deri 16:30. Nga ora 14:00 u futa tek një dhomë e arsimtarëve ku ishte mjaft ngrohtë. Biseduam shumë me dy arsimtarët aty, një i Xhajit e një i Bogës. Më vonë erdhi Toli, e më pas Mario me Kiçkën.

Më 16:30 u nisëm dhe para orës 19:00 arritëm në Hotel Sporti. U lamë, u rruam e u pastruam. Kur dola të takoja Kiçkën e të haja ndonjë supë, takova Marion. Më ktheu, ngaqë do gatuhej në dhomë.

*Mbajtës i ditarit .....*

## Përsëritje

**31 janar 1978**

Rreth orës 10 nisemi nga Klubi Sportiv Vllaznia për në Bogë. Ende pa hyrë në Ducaj, bora bëhet vështirësi serioze për autobusin. Ndhimojmë për hapjen e rrugës nga bora, në fillim ne alpinistët e më pas edhe punëtorët e ndërmarrjes së mirëmbajtjes së rrugëve. Me shumë mundim arrijmë deri tek Kisha (*Kisha e Bogës është mbyllur – por jo prishur – që në vitin 1967. Mjediset e saj shërbejnë si zyra të kooperativës bujqësore Bogë, qendër mjeksore, muze i fshatit, furra që përgatit dhe pjek bukën e fshatit, etj. Ndonëse qendër me shumë veprimtari/funksione, që tashmë me një fjalë duhej thirrur “godinë”, ajo thirret Kisha*).

Afër mbrëmjes ndahemi nëpër baza. Unë dhe Mario caktohem tek shtëpia e Kol Prekës, këtu në Bogë, kurse Kristaqi tek shtëpia ..... Koha është shumë e keqe: e butë dhe bie borë.

## 1 shkurt 1978

Në ora 9 nisemi. Arrijmë në Okol tek shtëpia e Zef Malajt ku stabilizohemi në një dhomë që na e liron i zoti i shtëpisë. (*këtu lamë bazën materiale*).

Nga ora 12 e deri në ora 15:20 çamë borën dhe dolëm deri tek Gropat e Portës (*nën Shtegun e Dhenve*). Në ora 17:00 u kthyem tek materialet. Pleqëruam gjendjen (bora tepër e butë). Vendosëm që të kthehemi dhe të rifillojmë aktivitetin në muajin Mars.

## 2 shkurt 1978

Pas orës 6 dolëm nga shtëpia e Zef Malajt ku kaluam natën. Mëngjesi është i bukur, i ftohtë. Bora e thatë të lëshon.

Si arritëm në qendrën e fshatit, me vështirësi mundëm të lidhemi me telefon me Shkodrën. Na premtojnë se do të nisin makinë. Shpejt, me ngut, hipëm në një makinë të kooperativës dhe arritëm në Xhaj (në ora 9:30), ku pritëm deri në ora 16:30 (*për makinën e premtuar*) dhe u nisëm për Shkodër. Jemi në hotel SPORT.

*Mbajtës i ditarit, Aleksandër Bojaxhi*

## ***Ngjitjet dimërore kategoria e II-të.***

### ***Mars 1978***

Marrin pjesë:

1. Dashamir Fejziu
2. Romeo Manxhari
3. Shkëlqim Terpo
4. Niko Petro
5. Ilir Gorjani
6. Ilir Sade(a)



Alpinistët Dashamir Fejzo dhe Niko Petro



## 6 mars 1978

Nga Shkodra nisemi në orën 11:30 (nga axhensia e autobusëve) në drejtim të Bogës. Në autobus vendosemi sipas grupeve që do të bëjnë ngjitje. Ekipi ynë do t'i zhvillojë ngjitjet me ekipet: Vllaznia, Partizani, Valbona (Tropoja), Tërbuni (Puka), Përparimi (Kukësi).

Në Bogë arrijmë më 13:15. Rruga ishte e mirë, borë nuk kishte dhe shi nuk kishte rënë. Autobusët duhej të na çonin në Fushë Okol, por shoferët nuk pranuan pasi kjo rrugë duhej të ishte e kontrolluar më parë nga ndërmarrja e mirëmbajtjes së rrugëve, prokuroria, dega e punëve të brendshme, etj. Andaj këtë rrugë (Bogë – Okol) e bëmë në këmbë dhe na zgjati rreth 45 minuta.

Kampin vendosëm ta ngrejmë jo në Fushën e Okolit, por para se të fillonin shtëpitë e Fushës së Okolit, në të djathtë të rrugës. Arësyeja ishte se aty kishim më afër ujin e pijshëm. Vendi ku ngritëm çadrat është pa borë dhe afër burimit, që është në formën e një vije uji. Aty ndodhen edhe disa govata ku pijnë ujë bagëtia.

Ekipet e tjera pjesëmarrëse u vendosën tek çezma e Bogës, në të djathtë të rrugës e më poshtë se shtëpia e Gjekës.

Ngritja e kampingut zgjati rreth 30 minuta dhe sistemimi i çadrave zgjati rreth 1 orë e 30 minuta. Tashmë koha bëhet e keqe dhe fryn erë. Rreth orës 16:30 fillon një shi i imët me erë, që hera-herës bëhet më e fortë dhe ndjehet ftohtë.

## 7 mars

Në mëngjes, me alpinistët e kategorisë së III-të që nuk kanë bërë ngjitje (*në veprimtari kombëtare*) bëhet kontrolli i njohurive (*lidhjet e litarëve, mënyrat e sigurimit, etj.*). Në darkë lexohet urdhëri i ditës për datën 8 mars (*meqë është sezon dimëror dhe moti mund të ketë të papritura, si dhe për arsye të orëve të herëshme të fillimit të ngjitjeve*

*në mëngjes, urdhëri i ditës, i cili përcaktonte veprimtaritë që do të zhvilloheshin, shpesh lexohej/njoftohej që në darkë*). Grupi ynë është ndarë në dy toga. Toga jonë do të ngjitet në lugut verior të Okolit.

## 8 mars

Në orën 05:30 u bë zgjimi i kampingut dhe në orën 7 u nisëm për në drejtim të lugut verior të Okolit. Itenerari fillimisht kalon nëpër pyll për rreth 30 minuta e pastaj thjesht në borë. Itenerari nëpër borë deri në krye të lugut zgjati rreth 3 orë. Vështirësia është e kategorisë III-të. Në fund të lugut vështirësia rritet dhe shkon deri në shkallën e IV të vështirësisë. Bora është e ngrirë. Në fund të lugut janë disa maja që mund të ngjiten për një kohë të shkurtër nga vendi ku arritëm, por kanë shkallë të lartë vështirësie. Ne nuk mundëm të ngjisnim asnjërën nga këto maja për shkak të mjegullës shumë të dendur e cila na mundësonte shikim deri në 5 metra.

Përgatitja fizike e ekipit nuk ishte as në nivelin mesatar, por kjo ndodh ngaqë është ngjitja e parë. Duhet ambientim me gjithëçka. Veprimet teknike ishin shumë të mira. Pas ngjitjes koha filloi të priset. Ngjitja u vlerësua e vështirësisë së II-të.

## 9 mars

Koha është shumë e keqe, me vranësira dhe kthjellime të shkurtëra. Majat janë të mbuluara nga mjegulla, andaj dhe ngjitjet nuk bëhen.

## 10 mars

Zgjimi bëhet më 05:30 dhe nisja për ngjitje më 06:30. Nga kampingu shkojmë drejt lugut kryesor të Okolit. Mbërrijmë në majën e Fergut (2.135 m) në orën 09:30. Gjendja e ekipit ishte e mirë; nga ana fizike ekipi ishte në lartësinë e duhur. Përgatitja

teknike ishte e mirëegzekutuar. Të gjitha treshet e litarëve i udhëhoqën anëtarët e ekipit tonë. Ngjitjet i drejtoi Dashamir Fejziu. Kategoria e vështirësisë së itinerarit ishte e IV-të.

Pas kësaj u tentua maja e Livadhit, që sulmohet për herë të parë në sezonin dimëror (2.493 m) me kategori vështirësie të V-të. Edhe për këtë ngjitje treshet e litarëve i drejtoi ekipi ynë. Qëlloi që nga i gjithë grupi ynë, për të parën herë, i pari alpinist që shkeli në këtë majë, pati fatin të jetë Shkëlqim Terpo. Koha gjatë ngjitjes ishte e kthjellët, por frynte erë e ftohtë nga lindja. Në majën e Livadhit ishim më 11:30. Në ngjitje mori pjesë edhe komandanti i grupit të ngjitjeve shoku Azem Hyka. Arritëm në kamp më 14:30.

Edhe tek ngjitja e dytë udhëhoqi Dashamir Fejziu. Toga jonë u lavdërua për disiplinë në ngjitje dhe për rezultate të mira në ngjitje. Na jepet detyrë që nesër të sulmojmë majën e Shtegut të Dhenve (2083 m).



Kujtim nga malet e Bogës

## 11 mars

Zgjimi më 06:30 dhe nisja në orën 7. Arritëm në majën e shtegut në 11:20. Itenerari u përshkrua me një temp të ngadaltë. Në këtë majë togën e drejtoi Dashamir Fejziu. Në ngjitje nuk mori pjesë Shkëlqim Terpo për arësye shëndetësore. Gjendja e ekipit ishte e mirë dhe të gjitha treshet u udhëhoqën nga anëtarët tanë. Në kamp u kthyer në 13:30. Ngjitja u vlerësua e kategorisë së IV-të. Për nesër vendoset të bëhet pushim.

## 12 mars

Është ditë pushimi. Moti në mëngjes është i ftohtë dhe fryn erë me borë. Nga mesdita moti kthjellohet, por era nuk pushon.

Në mëngjes, çadrës së Dashit iu thye njëri nga tubat mbajtës dhe më vonë çadrës sonë i thyhet tubi horizontal. Këto thyerje u riparuan duke futur shkopinj në tubat.

Një grup është nisur për të sulmuar majën e Çardakut. Në atë grup marrin pjesë Azemi, Hasan Temali, Nuredin Seci, Aleksandër Kapo, etj. Maja u pushtua duke ndjekur një ulluk në drejtimin lindor dhe ngjitja vlerësohet e kategorisë së V a. Nisja u bë rreth orës 7 dhe mbërritja në majë rreth orës 14:30.

## 13 mars

Toga jonë duhet të synojë majën e Thores (1775.5 m)- e kategorisë së III të të vështirësisë, dhe majën e Helmit, 1776 m e kategorisë së IV-të.

Nisja u bë në orën 7, orë kur toga ishte pajisur me mjetet e pajisjet e nevojshme, si edhe ushqimet.

Në orën 11:30 arrihet maja e Thores. Prej këtu nisemi për në majën e Helmit, ngjitja e së cilës u arrit në 12:45.

Me urdhër të komandantit të togës Dashamir Fejzo u nisëm për në majën me lartësi 1802 m meqë koha ishte e mirë. Ngjitja u realizua me sukses.

Kthimi në kamp u bë në orën 14:30. Rreth orës 15 mësojmë se katër alpinistë të Valbonës janë larguar pa dijeninë e shtabit në drejtim të majës së Thatë (për këtë nuk dinte gjë as komandanti Azem Hyka). Ata ishin nisur në orën 7:30 dhe u kthyen në kamp në orën 19:00. Gjatë gjithë ditës koha ishte shumë e mirë.

### 14 mars 1978

Zgjimi bëhet më 06:30. Në orën 08:30 bëhet mbledhja e jashtëzakonëshme për të analizuar shkeljen e rregullit të bërë dje nga ekipi i Valbonës. Në mbledhje ekipi i Valbonës reagoi kundrejt gabimit.

Ekipi ynë propozoi që kjo majë e ngjitur të mos u njihet për efekte kategorizimi individual dhe dy alpinistët, Hajdar Hasa dhe Petrit Doçi, të paralajmërohen që për raste përsëritje të përjashtohen nga sporti. Ky propozim mbeti në fuqi dhe u aprovua nga kolektivi i alpinistëve. Për ditën e nesërme shtabi vendosi që të bëhen ngjitje. *(Grupi i Tropojës, i cili ishte pjesë e grupit që u ngjit në majën e Çardakut dhe që u ngjit pa njoftuar shtabin, në majën e Thatë përbëhej nga: Hazir Malaj, Hajdar Hasa, Petrit Doçi, Kujtim Matoshi dhe Isuf Milushi.)*

### 15 mars

Në mëngjes koha prishet dhe filloi shiu, i cili nga mesdita kthehet në rreshje bore. Era fryn e fortë. Sot nuk u kryen ngjitje.

Çadtrat tona nuk e përballojnë erën dhe shiun, prandaj i heqim ato dhe vendosemi në një kasolle që ndodhet mbi rrugën automobilistike (këtë gjë e bënë edhe ekipet e tjera). Në kasolle ndezëm zjarr dhe rreth 20 vetë e kaluam aty shumë mirë natën.

## 16 mars

Koha është e mirë dhe nuk fryn erë. Të gjithë merren me pastrimin personal dhe sistemojnë bazën materiale duke u bërë kështu gati për udhëtim (kthim). Të gjithë ekipet që bëjnë pjesë në grupin tonë mblidhen që të bëjmë bilancin dhe të nxjerrin konkluzionet e ngjitjeve nën drejtimin e Azem Hykës.

Në këtë konkluzion ekipi ynë u përmend si një nga ekipet më të mira, me disiplinë në ngjitje dhe përgatitje të mirë teknike dhe fizike. Gjithashtu, toga jonë u cilësua si toga më e mirë dhe me disiplinë e përgatitje fizike e teknike shumë të mirë. Në diskutimet e bëra, diskutoi edhe Dashamir Fejziu i cili falenderoi shtabin dhe komandantin e ngjitjeve shokun Azem Hyka. Me këto konkluzione iu dha fund veprimtarisë.

Në darkë koha prishet: fillon shi me erë të fortë. Ne jemi të sistemuar tek kasollja.

## 17 mars

Zgjimi bëhet në orën 06:30 dhe deri në ora 08:30 bëhen përgatitjet për nisje. Koha është shumë e keqe: bie shi dhe fryn erë shumë e fortë. Meqë autobusat nuk kanë ardhur, nisjen nga kasollja e shtymë për më vonë.

Më 09:30 nisemi për në Bogë. Tek arritëm aty, një pjesë e alpinistëve futen tek shtëpia e Gjekës, ndërsa pjesa tjetër në shkollë, ku mësuesit e kanë lëruar një klasë për ne që të mos rrimë jashtë në shi. Më 12:15 nisemi dhe mbërrijmë në Shkodër pas dy orësh. Për të fjetur, shkojmë tek hotel SPORT.

Mbajtës i ditarit, Niko Petro.

## Vazhdim i veprimtarisë së nisur në janar-shkurt 1978

Sipas vendimit që morrëm për të ndërprerë veprimtarinë dhe për ta organizuar në muajin mars, më 22 mars ishim përsëri në Bogë. Morrëm pjesë nga klubi ynë:

1. Aleksandër Bojaxhi
2. Kristaq Korçari

**Shënim:** Mario Trinkera nuk erdhi sepse e ëma, shumë e sëmurë, ishte shtruar në spital.

### 22 mars

Në orën 12:00 u nisëm për në Bogë, ku arritëm në 14:30. Më pas udhëtuam nga çezma e Bogës për në Okol. Pas 15 minutash na zuri rrugës një Skodë (lloj kamioni) që do të ngarkonte patate. Shkuam me Skodën deri tek kavaletat e patateve ku takuam Zef Malajn me nusen dhe me të atin, që po mbledhnin patate. Vendosiëm të kalojmë natën në shtëpinë e Zefit, ku tashmë jemi mbledhur dhe po hamë patate. Koha është shumë e keqe. Fryn tufan nga veriu dhe bie borë, e cila shpesh të krijon përshtypjen se vërvitet nga malet. Bashkë me ushtarët (dy ndërlidhësa me radio) bëhemi 14 vetë. Nesër herët do të nisemi për në Theth.

### 23 mars

Në orën 7:00 nisemi nga shtëpia e Zef Malajt për në Theth. Thuajse në mbarim të ngjitjes nëpër pyll takojmë 10 thethjanë që po zbresin nga Shtegu i Dhenve. Pa dalë tek pishat, nën Shteg na arrin Qemal Biçaku i Elbasanit.

*(Thethjanët, me grupe sipas nevojave që kishin, gjatë dimrit, kur bindeshin se rreziku për ortek ishte i ulët, bëheshin bashkë dhe kalonin Shtegun për të dalë në Bogë e prej aty për të shkuar në*

*Shkodër a gjetkë. Kur kjo ndodhte para se të kalonin alpinistët për veprimtaritë e tyre dimërore në zonat mbi Theth, ishte gëzim i madh për ne sepse na lodhte më pak çarja e borës. Por edhe anasjelltas, ka patur raste që rruga Theth - Bogë lihej të bëhej ditën që do të ktheheshin alpinistët dhe çarjen e borës e kemi bërë “me rradhë”).*

Ushtarët u lodhën shumë në zbritje të shtegut. I siguroja unë. Më këputën fare! Ora 19:30 arritëm në godinën e kampit. Në orën 20:00 arritën të fundit të grupit: Kiçka, Koço, Pëllumbi, Edi. U lodhëm mjaft. Deri tani unë e Kiçka jemi më në formë: pak mbi mesatarët. Koha tani vonë po na prishet keqas. Jemi sistemuar tek barakat (*është koha kur në kampin e Thethit, krahas godinës që shërbente si hotel për pushuesit në sezonin veror, u shtuan edhe disa baraka, të cilat përta i takon qetësisë ishin më të mira se godina qëndrore*)

## **24 mars**

Që kur u gdhi binte borë e dendur. Tani ora po shkon 23:00 dhe ende bie. Rrallë herë mund të qëllojë që të bjerë kaq shumë borë. Thonë se është shtrirë dhe ka zënë deri në Breg të Lumit. Mësova se sot qenka e premtja e madhe, kurse nesër do jetë e shtuna e madhe. Kjo paska të bëjë me motin e keq në muajin mars. Por mund të jetë fjala edhe për ditët e shënuara para Pashkës Katolike. Kiçka me Kozmanë janë për darkë tek komandanti i postës. Nesër do jemi përsëri këtu në Theth.

## **25 mars**

Koha jo shumë e keqe. Nuk ra borë. U ulëm tek klubi dhe kaluam atje ca orë. Nesër do të bëjmë disa orë marshim në drejtim të Qafë Pejës. Do zgjohemi në 05:30. Në radio dëgjuam që moti nesër do jetë me re të pakta.



## 26 mars

Në orën 5 koha ishte shumë e keqe, por pa rreshje. Çohemi më 5:30. Më 6:30 të gjithë jemi në udhëtim. Koha u hap nga ora 7:00 apo 7:30 dhe u bë një ditë e rrallë për nga bukuria. Çamë borën deri në Qafë Pejë. Kristaqi (Kiçka) nuk erdhi sepse i dhimte koka. Unë kam dëmtuar pak gjurin.

Për nesër vendosëm të ngrihemi në orën 01:30 pas mesnate dhe të synojmë majat Jezerë, Popllukë dhe Ali. Do të ndahemi në dy grupe dhe çdo grup do të synojë nga dy maja.

## 27 mars

Në ora 2 të mëngjesit u nisëm. Koha vjen duke u përkeqësuar. Kur arritëm tek qershitë (Kroi i Shtrazës) vendosim që të kthehemi. Ora 5 e 30 jemi përsëri tek kampi. Fjetëm shumë. Kemi vendosur që nesër të nisemi përsëri në orën 2. Radio Prishtina parashikoi për nesër mot të thatë e me vranësira.

## 28 mars

Në orën 1:30 u zgjuam dhe në orën 2:00 u nisëm. Dyshja jonë, (unë e Kiçka - Tirana), një dyshe e Studentit dhe një treshe e Partizanit morëm detyrë të pushtojmë majat e Popllukës dhe Alisë. Ngjitjen për në Popllukë e mori përsipër Kiçka dhe u



Aleksandër Bojaxhi në majën e Popllukës  
(Fotografoi Vasil Stambuli)

krye nga ana e Gropave të Bukura. Ka vlerësim të shkallës V të vështirësisë. Arritëm majën në orën 12:00. *(këtu Vasil Stambuli më ka fotografuar. Është fotografi me ngjyra. Është fotografi ku kam dalë vetëm dhe që më pëlqen më shumë se çdo fotografi tjetër që kam nga jeta alpinistike. Fotografia ka qenë e panjohur për mua dhe ma ka dhënë Vasili rreth 6 muaj para se të ndronte jetë, bashkë me 5-6 fotografi të tjera).*

Pas ngjitjes së Popllukës, nga qafa midis Popllukës dhe Alisë, sulmuam Alinë. Udhëhoqa unë. Ngjitja u krye nga korridori që ishte i mbushur me borë. Kreu i korridorit si dhe më pas traversa për në majë ishin segmente të vështirë. U cilësua i vështirësisë V-B. Kiçka nuk u ngjit sepse i dhimbte koka (nuk hëngri bukë, veç kur erdhi ora 13:30. Besoj se andaj i erdhi dhe dhimbja e kokës). Edhe të tjerët nuk erdhën, kështu që në Ali u ngjitëm unë, më pas Shili, dhe më Pas pëllumbi me Edin. Zbritja u bë me sigurim dhe na mori shumë kohë. Në ora 19 ishim në Qafë Pejë; më 19:50 tek shpella e Qafë Pejës dhe në 22:20 në kamp. Pra, pas më shumë se 20 orësh!

## 29 mars

Është ditë pushimi. Jemi mjaft të lodhur. Thahemi e pushojmë. Në darkë bëjmë analizën e ngjitjes. Taxhedini e Koço flasin në mënyrë tendencioze kundra ne *tironsave*. Koço në diskutimin e tij na mërzi shumë. Taxhedini e mbështet. Porse mbetën të vetëm në diskutimet e tyre sepse nuk i përkrahu kush. Megjithatë këta na prishën kënaqësinë e ditës së djeshme. Nesër do të nisemi herët për në Bogë. Shtatë vetë nga grupi janë të verbuar *(kanë dëmtuar sytë për mungesë të syzeve. Gjatë ditës së djeshme frynte erë e fortë dhe ngrinte borë e grimca bore të cilat na përplaseshin në fytyrë dhe ndonjë syresh edhe drejt e në sy. Djelli i lartësisë dhe reflektimi i dritës që të jep bora e pastër e lartësive bëhen pothuajse dy diej bashkë.)*

**30 mars**

Unë u nisa i pari për në Shteg (Bogë) në orën 5:45. Pas meje janë ushtarët dhe alpinistët e rretheve. Ndihmova Janin (e verbuar) që vuan nga sytë dhe me të arrita Bogën më 9:15. Të tjerët vinë mbrapa.

Pjesëmarrësit:

1. Kristaq Koeçari
2. Aleksandër Bojaxhi
3. Kozma Grillo                      Drejtues i veprimtarisë
4. Vladimir Memisha
5. Vasil Stambuli
6. Eduard Sheldia
7. Pëllumb Llabanishta
8. Jani Qendro
9. Qemal Biçaku
10. Koço Ziso
11. Genc Lika
12. Qemal Hakorja
13. Taxhedin Shehu
14. Ushtari Marek
15. Ushtari Tonin

Bogë, 30.3.1978;

*Mbajtës i ditarit, Aleksandër Bojaxhi*

## 29 Qershor – 13 Korrik 1978

Ngjitje alpinistike verore me alpinistë të kategorive të larta në Postën Verore

Marrin pjesë:

1. Dashamir Fejzo, alpinist i kategorisë së parë,
2. Mario Trinkera, Kandidat për Mjeshtër Sporti
3. Kristaq Korçari, Kandidat për Mjeshtër Sporti

**Shënim I.** Ishte caktuar për të marrë pjesë në ngjitje edhe alpinisti Shefki Juma, por për arsye familjare nuk erdhi.

**Shënim II.** Ngjitjet do të kryheshin tek Posta Verore, mirëpo për arsye se vendi i ngjitjeve kishte borë të madhe në rrëzë të maleve Kolaj, Sqeta e Cjapit, Malësore, Arap, gjë që u vërtetua nga grupi që u krijua dhe u nis nga Thethi. Ata e panë situatën dhe raportuan se në zonën rreth Postës nuk mund të kryheshin ngjitje. Atëherë shtabi i ngjitjeve vendosi që ngjitjet të bëheshin



Disa nga alpinistët kacavarës në vitin 1970.

Lart: Venigjar Velaj (m), Gazmend??, Vangjel Zeno, Vullnet Zylyftari, Vladimir ??, Jorgaq Grabocka  
Poshtë: Nasi Shtëmbari, Aleksandër Bojaxhi, Maridon Hito, Bajram Hysa

tek Kroi i Shtrazës (tek qershitë). Ky ishte shkaku që ndryshoi vendi i ngjitjeve. *(shkak tjetër ishte se ne ishim ngushtë me këpucë dimërore. Ato i ruanim për dimër. Në rastet kur malet kishin shumë borë në stinën e ngrohtë, për kacavarjet shkëmbote ne i afrojheshim shkëmbii me atlete. Me to nuk mund të ecje nëpër sipërfaqe të mëdha me borë sepse edhe të lageshin edhe të ftoheshin shumë këmbët).*

## 29.6.'78

Udhëtimi nga Tirana në Shkodër kaloi mirë. Natën e kaluam tek hotel Sporti.

## 30.6.'78

Nisemi nga Shkodra me autobus 25 vendesh. Çantat erdhën mbrapa me kamion dhe tre alpinistë shoqëruan materialet. Nisja u bë në 12:30. Në Bogë pushuam gati një orë sepse drekuam. Në Theth arritën në ora 17:00 dhe çadrat i ngritëm tek dyqanet. Këtu kaluam natën *(dyqanet, klubi dhe njëherësh qendra jo zyrtare e fshatit ishte në "sheshin" para urës që të nxjerr në anën tjetër të lumit të Thethit-Shalës).*

## 1.7.'78

U ngritëm në 7:30 dhe në orën 9:00 shtabi i veprimtarisë na mblodhi për të na njohur me programin e ngjitjeve. Shtabi përbëhet nga:

1. Vasil Stambuli Komandant
2. Kozma Grillo Komisar
3. Vangjel Melëngu zv/komandant

Drejtues togash janë:

1. Kristaq Korçari
2. Viron (Venigjar) Velaj
3. Azem Hyka

Shtabi vendosi të dërgojë disa shokë me në krye Vasil Stambulin, që të niseshin në orën 12:30, për të parë situatën e borës në lartësi për ngjitje, gjë për të cilën kam shkruar në krye.

## 2.7.'78

Pasi u vendos që ngjitjet të bëheshin tek Kroji i Shtrazës, grupi u përgatit për nise. Materialet i ngarkuam në zetar (*lloj kamioni që përdorej në fshat*) dhe ne vazhduam në këmbë. Në të mbërritur, ngritëm kampin, drekuam, përgatitëm darkën dhe më pas biseduam për itenerarët e ngjitjeve. Shtabi u ul të vendosë për itenerarët. Morali në grup është i mirë. Ne jemi shumë mirë me ushqime dhe me bazë materiale, madje me tepriçë.

## 3.7.'78

Zgjimi në orën 6:00 dhe në orën 8:00 të tri togat nisen në drejtim të shkëmbejve duke marrë bazë materiale për ngjitje të kategorisë V të vështirësisë. Këto janë ngjitje të panjohura dhe të pashenjuara (*me bojë të kuqe shënoheshin pikat/vendet ku fillonte një itinerar, si p.sh I-1, I-2, etj.*). Toga jonë, e treta, me Kristaq Korçarin në krye u nis në drejtim të malit të Arapit duke qenë se atje ka shkëmbinj të shkallës V së vështirësisë. Ngjitjen e udhëhoqi Kristaqi dhe në orën 13:30 ngjitja mbaroi me sukses. Ngjitjen e filluam në orën 9:00. Në kamp arritëm në orën 15:15. Përgatitëm një drekë të shijshme dhe pushuam. Shtabi u mblodh dhe vendosi që nesër togat të ndërrojnë vendet.

## 4.7.'78

Zgjimi në 6:00, e më pas pastrim dhe mëngjesi. U rreshtuam më 07:30 dhe më pas u nisëm për ngjitje. Toga jonë u nis drej ullukut qendror. Në këtë ngjitje u vu re mobilizim i ekipit tonë dhe i beratasve. Mario Trinkera së bashku me Stefan Kulen punuan një të

kategorisë VI, kurse Dashi, Kiçka e Koçi Maqina (beratas) një V ku udhëhoqi Kiçka. Vullneti me Tolin realizuan një ngjitje të shkallës V. Ngjitjet u realizuan me sukses dhe pa më të voglin dëmtim.

## 5.7.'78

Zgjimi më 6:00. Në 7:30 toga jonë niset në drejtim të itenerarit që quhet Lugu Jugor e ku shkëmbi është me pllaka (rrasa). Në orën 9:00 jemi të lidhur e të ndarë në një dyshe dhe dy treshe. Dashi e Kiçka janë në një litar dhe punuan një VI të cilën e realizoi një ditë më parë Azemi me togën e tij. Stefani, Mario e Koçi bënë po të kategorisë VI. Vullneti, Toli e Vangjeli në një itenerar tjetër të shkallës VI. Për ekipin tonë udhëhoqi Dashi. Arritja në majë në orën 14:45 dhe kthimi në kamp në 16:30. Vlen të përmenden Kristaqi për gjakftohtësinë që tregoi dhe Stefan Kule për përdorim të mirë të teknikës në shkëmb. Në darkë kaluam rreth zjarrit me diskutime për ngjitjet e kryera gjatë ditës. Në datën 3 na është sëmurrur Vasil Stambuli. Kishte ethe. Si duket mosha bën të vetën, sepse edhe të nesërmen ashtu ishte. Sot ishte mirë dhe shkoi në Theth nga ku bisedoi me Federatën që të shtyhej veprimtaria me kategoritë e dyta meqënëse Shtegu ka borë (*tek Shtegu i Dhenve do të vendosej kampimi dhe ngjitjet, si rregull, kryhen kryesisht në faqen veriore të majës së Shtegut si dhe në dy majat binjake*). Vangjel Melëngu nguli këmbë që ngjitjet të mos shtyheshin dhe njëherësh nguli këmbë që ngjitjet mund të kryheshin këtu tek Kroi Shtrazës, meqë grupi ynë i shtoi (*duke i shënuar me bojë*) këtu itenerarët për ngjitje (*këtu organizoheshin ngjitje me kategoritë e ulëta dhe kishte edhe itenerarë që ishin të shënuar më parë*), kurse një grup mund të vendosej tek Katarakti i Thethit (*edhe atje kishte itenerarë të shënuar*). Porse Vasili bisedoi në telefon pa marrë pëlqim nga shtabi këtu. Nuk di gjë nëse Kozmai ishte në një mendje me Vasilin.



Larja e pjatave

Mario Trinkera është vlerësuar kuzhinjeri më i mirë, kurse Dashi pjatararësi më i shpejtë. Për nesër, data 6, është vendosur të kemi ditë pushimi.

### 6.7.'78

Pas tre ditë ngjitje sot është pushim. Të gjithë lahen e një pjesë shkon tek kampistat në kampin e Thethit se mos shohë ndonjë të njohur. Mbasdite shtabi vendosi që nesër do ketë ngjitje nëse nuk bie shi. Tani është ora 21:00 dhe filluan pikat e para të shiut.

### 7.7.'78

Zgjimi në orën 7:00 dhe jemi të lirë deri në 8:30. Shtabi i mbledhur vendos që të mos bëhen ngjitje ngaqë shkëmbi është i lagur. Por meqë koha është e mirë u vendos që të bëhet kontroll teoriko-praktik tek një shkëmb i vogël. Në ora 13:30 kthehemi në kamp. Drekojmë, pushojmë dhe në darkë rreth zjarrit këndojmë.

### 8.7.'78

Sot Azem Hyka e Mario Hito si dhe Servet Aliko e Viron Velaj u zgjuan në orën 6:00 dhe Vasili me Kozmain i përcollën duke u uruar sukses për realizimin e ngjitjeve në Arap. Dy të parët për faqen jugore, kurse dy të dytët në itenerarin sa del në rreth/Qafë të Vishnjës (*Qafa e Arapit*) ku është një itenerar i shkallës IV së



vështirësisë e ca më tutje një i shkallës VI. Këta e lanë kampin në orën 7:00 duke patur të gjitha materialet e nevojshme. Të tjerët, si edhe ekipi ynë, u nisëm në orën 8:00 për të punuar në shkëmbinjtë që të nxjerrin në Qafë të Vishnjes.

Sot oficer dite ishte Kiçka, por meqënëse mbrëmë ishte i sëmurë nuk erdhi në ngjitje. Dashi punoi me Marjon ngjitje të shkallës VI të vështirësisë. Këtë ngjitje e kanë bërë thuajse të gjitha ekipet. Ngjitjen e udhëhoqi Mario i cili punoi mjaft mirë dhe me gjakftohtësi. Kthimi në kamp në orën 14:30. Ekipet e tjera janë kthyer më përpara dhe po përgatisin drekën dhe darkën, por vemendja e të gjithëve sa janë në kamp është drejtuar tek dyshja Azem-Mario që po bëjnë një ngjitje e cila nuk përshkruhet. Deri në këtë orë ata janë mirë dhe punojnë të qetë.

Nga ora 13:00 u filloi një shi i lehtë, por që ata i lagu mirë, mirëpo Azemi (*që udhëhiqte*) vazhdonte i sigurt në vetvete dhe në orën 19:00 kanë dhënë zig-zagun (*thirrje që tregon se kanë arritur në majë*). Filluan në orën 8:00 dhe dolën në majë në orën 19:00.



Një kujtim me Azem Hykën në malet e Bogës

Kanë përdorur 82 plenga/gozhdë, 3 pyka dhe një shkallë. Itenerari zgjati 13 litarë.

Eduard Sheldia dhe Aleksandër Kapo shkuan tek vlonjatët në Arap ku nuk punuan VI vështirësie, por IV. Vasili i kishte caktuar të punonin tek ulluku nga Vishensi. Në darkë u mblodhëm të gjithë rreth zjarrit ku Azemi e Marjo na tregojnë dhe ne i pyesim për gjërat që kanë kaluar gjatë kësaj ngjitje shumë të vështirë.

## 9.7.'78

Zgjimi në orën 7:00 dhe deri në 8:30 mëngjesi, më pas përgatitja për ngjitje sipas togave, tresheve apo dysheve. Mbi tetë shokë të ekipeve të ndryshme shkuan të sulmojnë ARAPIN nga faqja perëndimore, që në fakt si vështirësi është kategoria IV. Tani u bë rrugë ulluku që ndodhet pranë dhe që është i kategorisë së katërt të vështirësisë. Këtu Vasili futi një dyshe të tijën (*të ekipit Partizani*) dhe tha që kjo është e gjashtë. Këtu kalojnë njëherësh 8 vetë rresht duke ngulur vetëm një gozhdë. (*Duket se është koha kur drejtuesit apo trajnerët e ekipeve kërkonin/donin që anëtarët e ekipeve të tyre të kishin ngjitje të shkallës së gjashtë të vështirësisë, të cilësuar si të tilla pa e merituar/pa qenë të tilla, në mënyrë që anëtarët e ekipit të arrinin kategori sa më të larta sportive. Itenerari në fjalë është realizuar për të parën herë në vitin 1959 nga Vasili vet i dytë gjatë veprimtarisë së kacavarjeve shkëmbore me kacavarësit nga Gjermania Lindore. Për herë të dytë ky itenerar u realizua nga Vasili, Kozmai dhe unë, besoj se në vitin 1969. Ne e vlerësuar të kategorisë së tretë të vështirësisë dhe kishim mendimin që mund ta pranojmë edhe të kategorisë IV-A për hir të thellësisë që ka, si edhe për të stimuluar ndërmarrjen e tij nga kacavarës të tjerë).*

Ne që mbetëm në kamp punuam itenerarë me vështirësi të V. Mario e Dashi punuan një të pestë dhe udhëhoqi Dashi. Kristaqi punoi me Agim Tabakun dhe realizuan një të pestë që

e udhëhoqi Agimi. Kthimi në kamp u bë në 14:20. Ngjitja e Kristaqit me Agimin ishte ngjitje e re dhe këta e vlerësuan vetë kategori V. Dreka, pushim dhe darka rreth zjarrit.

### 10.7.'78

Zgjimi për të gjithë në orën 7:20, përveç Kiçkës dhe M.Hitos që u zgjuan në orën 6:00 për të shkuar në Arap që të bënin të gjashtën e kontrolluar (*itenerari VL i Arapit quhej i kontrolluar dhe ishte i vështirësisë së gjashtë. Realizimi i kësaj ngjitje nga alpinisti ishte një nga kushtet për të marrë titullin Mjeshtër Sporti*). Udhëhoqi Kiçka dhe doli me sukses. Ne të tjerët ngritëm kampin dhe ngarkuam çantat në makinën e kooperativës, e cila na i çoi ato deri tek dyqanet ku ngritëm kampin dhe përgatitëm darkën të cilën e hëngrëm me naze, ngaqë dita e sotme nuk ishte e lodhshme.

### 11.7.'78

Zgjimi sipas dëshirës ngaqë e dinim se autobuzi do vinte nga dreka. Dhe ashtu ndodhi. U nisëm në orën 13:00 dhe mbrritëm në Shkodër më 17:00. Zumë hotel tek turizmi i vjetër (*përballë me Kafën e Madhe*). Pastaj lahemi, vishemi, fusim lekë në xhep dhe dalim që të shohim ndonjë gjë të mirë. Me gjë të mirë atëherë kuptohej ndonjë artikull që ne nuk e gjenim në Tiranë (*është viti kur filloi e tatëpjeta ekonomike e vendit*). Në darkë një banket i vogël me shokët e rretheve tek lulishtja para Turizmit të vjetër me shishet e birrës përpara, duke uruar njëri tjetrin me fjalët më të ngrohta për realizimin me sukses të ngjitjeve, si edhe kthimin dhe gjetjen shëndoshë e mirë të njerëzve të familjes. Në orën 22:00 të gjithë ishin nëpër dhomat e tyre për gjumë.

**Shënim:** në datën 9.7.'78 iku, me leje nga shtabi, alpinisti Kristaq Gega (Flamurtari) sepse në datën 16.7.78 do të martohet. Të gjithë ne e uruam – Të trashëgohet dhe me jetë të lumtur!

Më 30.7.'78 do të martohet alpinisti Stefan Kule, i cili ishte me ne në lëtë veprimtari. Po edhe këtij shoku i uruam – Të trashëgohet dhe jetë të lumtur!

Në datën 11.7.'78 Mario Trinkera mori dy keca nga 500 lekë sejcili dhe prej tyre dolën 8 kg mish. Gjithashtu edhe Dashi mori një kec për 750 lekë dhe i doli 7 kg mish

## 12.7.'78

Zgjimi në orën 5:00. Në orën 6:00 hëngrëm paçe tek Turizmi i ri, pastaj me autobusin e Klubit Sportiv Flamurtari, që ishte sjellë këtu për t'u rregulluar, (*Shkodra aso kohe kishte njëfarë industrie për prodhim, më saktë montim autobusësh*) mbërritëm në Tiranë. Falenderojmë Llaqin i cili i çoi të gjithë alpinistët pranë shtëpive

**Shënim:** Në datën 11, nga ora 10:00 deri më 11:30' u bë konkluzioni i ngjitjeve ku u prekën disa gjëra të thëna edhe herë të tjera. U falenderuan shokët Azem Hyka e Mario Hito për ngjitjen më të bukur dhe më të vështirë të bërë deri më sot në alpinizmin tonë (*është fjala për ngjitjen e faqes jugore të majës së Arapit, në qendër, nga brezi i zi deri në majë*). Shtabi gjithashtu falenderoi gjithë alpinistët për kryerjen me sukses të kësaj veprimtarie.

*Mbajtës i ditarit, Dashamir Fejzo*

## 20 deri 29 gusht:

Pjesëmarrësit:

Aleksandër Bojaxhi

Romeo Manxhari

Shkëlqim Mema (Guxho)

Sokol Doko

Ilir Sada

Ilir Gorjani

Vladimir Cfarku



Ndër alpinistët e parë të veprimtarive në kacavarjen shkëmbore të Shtegut të Dhenve

*Në fillim të viteve 70-të, me propozim të Komisionit Teknik të Alpinizmit, filluan veprimtaritë e organizuara në Shtegun e Dhenve. Kështu u quajt vendi me livadhe e gropa livadhore në veri të malit të Shtegut. Ngjitjet paraprake të bëra në ketë faqe veriore të majës së Shtegut, që në fund të viteve 60-të, poqën mendimin se ky “polygon” shkëmbor do të ngrinte nivelin cilësor të kacavarjes në alpinizmin tonë. Koha tregoi se Maja e Shtegut si dhe majat Mark e Zagorë (sot i quajmë Majat Binjake) si dhe shpatet shkëmborë të pjesës jugore të malit të Radohinës dhe kreshtës në Grykën e Lekës ishin vërtet të vlefshme për të punuar alpinistët që synonin të arrinin kategorinë e parë sportive. Ky vend u kthye në “shkollën” e parë të madhe të alpinizmit për stinën verore në vendin tonë.*

## 18 gusht

Udhëtimi Tiranë-Shkodër. U nisëm pasdite. Na u prish autobusi mbi urën e Drinit në Lezhë. Në Shkodër filloi euforia. Flitet rrugës me zë të lartë, madje edhe edukata e mirësjellja lënë për

të dëshiruar; në hotel kjo ndjehet edhe më fort. Këtu bisedat me zë të lartë vazhdojnë edhe pas mesnate. Duhet të ndërhyj që të vendoset qetësia që kërkon ora.

## 19 gusht

Nga Romeo dhe dy Ilirët nuk u respektua orari i ngritjes dhe paraqitjes në axhensi të autobuzëve. Ilir Gorjani jo korrekt për qethjen e flokëve (*ishin kohë kur partia kërkonte që flokët, basetat, pantallonat, etj., të ishin në “standarde” që donte ajo. Trajneri, inspektori i sportit përkatës, drejtuesi i veprimtarisë e kështu më lart nëpër piramidën e drejtimit dhe përgjegjësisë, kishin shqetësimin se mos i hapeshin probleme nëse nuk shkonim sipas kërkesave të partisë*).

U nisëm me mjaft vonesë nga Shkodra (10:30) sepse nuk ishte rregulluar që makina që do të transportonte materialet, e cila duhej të nisej në të njëjtën kohë me atë që do të transportonte alpinistët. Veç kësaj makina e materialeve donte (*shoferi ngulmonte*) që të shkonte deri në Bogë. Ndërhynë alpinistët shkodranë dhe kjo u rregullua që makina të shkonte deri në Theth (!) pa e kërkuar njeri këtë gjë.

Pasdite u nisëm për në Qafë Thore ku do të organizohet veprimtaria. Kur arritëm aty nuk gjetëm as makinë e as materiale. Sipas marrëveshjes, kjo donte të thoshte se as në Gropën e Portës dhe as në Qafë Thore nuk ka ujë (*në burim*) për grupin tonë prej 94 vetësh. U nisëm për në Theth ku arritëm më 17:20. Pak pas mbërritjes vetëm ekipi ynë u nis për në lagjen Grunas pranë Kataraktit ku do të organizoheshin ngjitjet. Këtu e kishte caktuar shtabi ekipin tonë. Ne ikëm të vetëm sepse të tjerët nuk donin të udhëtonin/marshonin më. Ka ardhur koha që duhet këkuar nga klubi ynë makinë për lëvizjen e ekipit, kjo ndoshta edhe për të shtunat e stërvitjes në malin e Dajtit.

## 20 gusht

U çuam më 07:00. Ndezëm zjarrin që lamë në darkë. Mbrëmë rreth tij diskutuam për mbarëvajtjen e punës. Dje ekipi i .....na vodhi tre bukë. Romeo u tregua i ngutur që qortoi Ladin (është i ri) që bukët ia mori nga arka para syve ..... Mbrëmë u ndje një tendencë për të ngacmuar Ladin, e për të ngarkuar me punë më shumë Sokolin (*modë sjellje me më të rinjtë në ekip*).

Sot sistemuam çadrat, bëmë llogaritë për grupimin e ushqimeve (*ka mundësi që secili të ketë blerë ushqime të përcaktuara sipas një liste*) e nga ora 10:30 u nisëm (*për ngjitje/kacavarje*). Tek katarakti soditëm ca e pastaj filluam. Romeo, Sokoli e Sada në I-4 dhe Gorani, Ladi, Guxho e unë tek I-1. Romeo punoi mirë. Edhe Gorani, i cili ndërroi Ladin.

Bëheshin këto gabime: nuk paralajmërohej rënia e gurit, nuk lihej në një anë vargu i gozhdëve, binin gozhdë e karabina (çelësa), mbahej litari mes këmbëve, Gorani në etapën e fundit vuri pak gozhdë.

Kur zbritëm bëmë një analizë. Veprimtarinë e vrojtoi Gëzim Laçi (Tërbuni i Pukës). Kur arritëm tek çadrat (ekipet e tjera arritën në orën 12:00) u rreshtuam sipas zakonit/rregullit. Darka kaloi normalisht.

## 21 gusht

Zgjimi ora 06:30-7:00. Ora 08:00 u rreshtuam. Jemi ndarë në tre toga. Në vend të Vlonjatëve (*nuk e kuptoj këtë fjalë*) nga një togë kemi unë e Gori (*Grigor Perikliu – Labinoti Elbasanit*). Bëmë ngjitjet. Romeo, Guxho, Sokoli dhe Sada, Gorjani, Ladi. Edhe ekipi i Pukës u caktua me ne dhe kështu me këta u formua toga e tretë.

## 22 gusht

Nikolla është fqinji më i afërt me ne këtu pranë çadrave. I ka vdekur një djalë që ia ka marrë lumi. Tregon se kur vjen shumë ujë nga katarakti (kur bien shumë shira), përroi ka aq shumë ujë sa të merr e të rrëmben me vete. Nusja e djalit (Dedës) i ka vdekur. Ka varur veten. Ajo vuante nga nervat, thotë Nikolla.

Pasi e pyeta, më tregoi se ka pas ekzistuar një rrugë qerresh e kamsorësh, e cila sot .....ndonjë gjurmë e cila vinte nga Vuthaj – Q Pejë, Ali, - Q

Valbonë – Bosh – Q. Fretërve - Qereç – Q. Kolqve. Pra del se ka qenë një rrugë e cila kalonte nëpër Malësinë e Gjakovës.

Ai tregon se dikur Thethi ka patur 600 shtëpi, nga 300 në çdo anë (*të lumit*). Një viti, ana lindore nuk prodhoi bukë dhe të gjithë banorët e atij krahu deshën të largohen, por i ndalën ata të krahut tjetër. As një vit më vonë nuk pati prodhim. Atëherë banorët e lëshuan vendin dhe u larguan. Tregonte se historia thotë se Thethi është braktisur disa herë nga banorët.

Ndarjet me gurë (mur i ulët me gurë e pa llaç) në Qafë Pejë kanë qenë për të drejtuar bagëtitë për në bjeshkë sepse vinin me mijëra dhe dëmtonin kullotat përqark (!) e përziheshin me bagëtitë e tjera.

Nikolla kishte një përfytyrim mjaft të qartë për erozionin në ato anë, aq sa të krijon përshtypjen se ai do të ketë biseduar me



Sokol Doko, Shkëlqim Mema, Romeo Manxhari



njerëz të ditur. Tregon se në tokat rreth shtëpisë së tij, parmenda i ka hasur trung pishe (dëshmi e një pylli ose e çpyllëzimit për të fituar tokë). Tregon se dikur, në kohën e të atit, katarakti nuk dukej nga bredhat e shumtë e të dendur. Në qendrën e sotme të fshatit, ai tregon se dy-tre breza ma parë atje kanë pas qenë tokat më të mira e më pjellore të fshatit, por i përλου lumi.

Ai tregon se dikur lumi nuk ka pas ekzistuar. Kishte burime të shumta për tokat. Prerja e pyllit ndikoi që të shtohen ujrat e të gryhet toka. Ai tha: dikur njerëzit nuk e dinin se kishin lumin nën vete. Jetonin mbi të. Deri vonë ka pas raste që lumi u ka marrë shtëpinë me vete.



Shkëlqim Mema (Guxho), Ilir Gorani, Ilir Sada, Vladimir Cfarku; poshtë Romeo Manxhari, Aleksandër Bojaxhi, Sokol Doko. Alpinistët pjesëmarrës të veprimtarisë në gusht 1978 tek Shtegu i Dhenve

## **24 gusht**

Erdhi Minella e na bëri ndryshime. Për ne këtu u formua shtab drejtues më vete: Jani Qendro Komandant, unë Komisar, Gori zv/kom, Romeo, Maliqi, Qemali, Ylli drejtues togash. Nesër do të shkojmë në Shteg të Dhenve për të bërë ngjitje.

## **29 gusht**

Kërciti sherri. Y. M. mashtroi rëndë në plotësimin e dokumentave. Po ashtu edhe E. R. dhe Q. B. Arritën deri aty sa që pa e bërë ngjitjen në I-8 të Shtegut, të thonë se e kryen.

## **31 gusht**

Sot, ora 02:30 pas mesnate, na erdhën dy Skoda të shoqëruara nga Kozmai. Ai i kishte rregulluar të nisen pas një ndërhyrjeje me shumë peripeci. Ora 03:30, u nisëm. Zuri shi. Pas tre orësh ishim në Shkodër. Thujse gjatë gjithë rrugës na kishte shoqëruar shtrëngata e shiut me vetëtima, mjegulla e dëndur dhe në Duçaj breshri (kamioni ishte i hapur). Në makinë ishim të zbuluar. U lagëm deri në ndërresat e brendshme. Kur ishim në kulmin e shiut dhe të të ftohtit, një korçar shpalosi një çadër tip gjermane. Secili rrëmbeu (u fut) një copëz të saj dhe nën të ndihej kënaqësi e madhe, e për habi ndjehej mjaft ngrohtë.

Mbajtës i ditarit, Aleksandri

## ***Përsëritje***

### **Ngjitje verore 20-29/8/1978**

Pjesëmarrësit:

1. Aleksandër Bojaxhi
2. Romeo Manxhari
3. Ilir Gorani
4. Ilir Sada

5. Sokol Doko
6. Shkëlqim Mema
7. Vladimir Cfarku

## 20 gusht

Dje u nisëm nga Shkodra rreth orës 10:30. Shkodra kishte koordinuar keq mjetin e nisjes sonë dhe mjetin për pajisjet (çantat). Porse duket që ekipi i alpinistëve të Shkodrës, nëpërmjet njohjes e shoqërisë, bindi shoferin që të vinte me pajimet deri në Thore, e më pas e bindën që të vinte deri në Theth. Ne zbritëm në Okol të Bogës. Nga Okoli më 14:40 u nisëm për në Qafë Thore. Kur arritëm aty nuk gjetëm njeri dhe as edhe Skodën (makinen me pajimet). Si duket ekipi i Studentit kishte kontrolluar vendin në Gropën e Portës, edhe në Q. Thore dhe ka konstatuar se nuk ka mjaftueshëm ujë për aq persona sa jemi (94 alpinistë). Nisemi për në Theth. Kur arritëm tek kampi na njoftuan se makina ishte ulur në qendër. Ora 17:20, jemi në qendër. U morëm vesh me Petraq Kulen dhe si ekip u nisëm për në lagjen Grunas, tek katarakti, ku deri më 20:30 arritëm të ngrejmë kampin.

Sot në mëngjes rregulluam ushqimet (jemi dy grupe gatimi), llogaritë, u sistemuam, etj. Në orën 10:30 u nisëm për ngjitje. Soditëm kataraktin dhe rreth orës 11:00 filluam ngjitjet. Romeo, Sokoli dhe Iliri në I-4; Gorani, Ladi, Guxho dhe unë tek I-1. I çova lart deri tek burimi i kataraktit. Tek ngjiteshim, rreth orës 12:15, erdhën ekipet e tjera. Ishin vonuar ngaqë kishin patur debate me Minellën (Kapo), që sikundër thanë, donte që të qëndronin të gjithë në qendër të Thethit ose tek Kroj i Shtrazës. Kur u kthyem u bë rreshtimi i parë i kësaj veprimtarie. Tani po merremi me gatimin e darkës. Dy Ilirët kanë dalë për të gjetur ndonjë kec a qingj mbasi janë/shiten lirë.

Është për t'u theksuar se majave ka aq pak borë dhe burimet kanë shteruar aq shumë, sa duket sikur se janë tallur me atë që u tha para dy javësh për të shtyrë aktivitetin se ka shumë bore *(thënë kështu ata që filluan veprimtaritë në muajin korrik)*.

## 21 gusht

Sot dita filloi me rreshtim dhe paraqitje force. Unë jam caktuar të drejtoj togën e tretë sapo të vijnë edhe vlonjatët. Treshet e ekipit tonë u ngjiten kështu: Romeo, Guxho, Sokoli në I-9A. Në fillim ka një plasë. Si ngjitje merr vështirësi të pestë. Gorani, Ladi, Sada punuan në I-5. Këtu caktova udhëheqës Ladin, por ai druhej dhe më pas e vazhdoi Sada që punoi mirë. Djemtë punuan mirë dhe ishin këmbëngulës.

## 22 gusht

Dje erdhën vlonjatët, por jo drejtuesit që priteshin. Sot vazhduam ngjitjet në shkëmbinjtë rreth kataraktit. Sokoli, Ladi e Gorani tek I-7. Punuan mirë. Romeo, Guxho e Sada tek katarakti i thatë. Këta u munduan shumë. Unë vajta dy herë atje dhe pastaj mbeta aty. U deshën disa orë derisa ata arritën që ta realizojnë ngjitjen. Itinerari kishte një fillim tepër të vështirë për 5-7 metra, pastaj vazhdonte tërësisht e vështirësisë V.

## 23 gusht

Romeon e lamë pushim meqë duket pak i lodhur. Ne të tjerët u ngjitëm në Gumnarë (kategoria III e vështirësisë). Unë u interesova që fillimisht të futej toga ime në punë (Puka, etj.) dhe pas kësaj fillova ngjitjen me anëtarët e ekipi tim. Sokoli, Ladi e Sada një litar. Guxho, unë e Gorani një litar tjetër. Pas pak të parët u ndërruan me të tretët *(taktikë që përdorej në mënyrë që gjatë veprimtarisë të udhëhiqnin itinerarët sa më shumë anëtarë*

nga ekipil/grupi). Si dolëm sipër, bëmë fotografi dhe u nisëm për në Shpellën e Rrathëve, gjë për të cilën unë jam përgatitur që mbrëmë. Tek hyrja e shpellës gjetëm në gjumë dy gjarpërinj: një të madh e një të vogël. I vrau që të dy Guxho, me çekiç.

Hymë brënda, por shpella ishte shembur. Unë që ecja i pari, arrita deri në metër buzë skajit të shëmbjes. Më tej duheshin pastruar gurët që të më nxinte. Aty dukej dritë e cila nga e majta ishte mjaft e fortë. Përballë dukej një shkëmb me bimësi. U kthyem, dolëm dhe zbritëm në kamp.



Ekipi në Gumnarë

## 24 gusht

Filluan demonstrime e kontrole. Me togën time punova tre orë për ato gjëra që duhen. Në drekë erdhi Minella Kapo (në atë kohë Kryetar i Komisionit Teknik si edhe anëtar i Kryesisë së Federatës). Na bëri disa ndërrime në drejtim. Meqënëse pardje në mëngjes Petraq Kule, drejtues i gjithë grupeve të veprimtarisë, u largua sepse ishte caktuar përgjegjës i ekipit kombëtar të qitjes që do të garonte në Finlandë, u caktuan shtab e drejtuesia të rinj (në ato vite nuk e merrje vesht deri në “minutën e fundit” nëse do ta jepte – fjala është për Petraqin - partia pasaportën me vizë).

Komandant Jani Qendro, unë komisar, zv/komandant Grigor Perikliu (kur u hoqën gradat në ushtri, u krijua pozicioni i Komisarit që si rregull ishte anëtar partie. Ky model u fut si një absurd edhe në

*formimin e grupit drejtues të veprimtarive tona. Porse në këtë rast komisari alpin nuk ishte anëtar partie, përveç rasteve të rralla kur kjo rastiste, ngaqë ka patur shumë pak alpinistë që ishin anëtarë partie. Në kujtesën time, gjatë 21 vjetëve që unë kam qenë trajner i ekipit të alpinistëve në klubin e Tiranës, ka qenë vetëm një anëtar partie, një nga alpinistët më cilësorë të ekipit, i pranuar në parti diku rreth vitit 1984).*

Toga e parë, drejtues Romeo Manxhari; e dyta, drejtues Maliq Kosumi; e treta, drejtues Qemal Biçaku; e katërta, drejtues Ylli Mullaraj. Në darkë filluam përgatitjet për t'u ngjitur e për të shkuar në Shtegun e Dhenve.

## 25 gusht

Ora 5:10, lamë kampin dhe në orën 8:15 ishim tek itinerarët e Shtegut. Punuan: Romeo, Agron Devole (vlonjat) e Robert Bici (elbasanas) tek I-7 në Shteg. Kategoria e pestë e vështirësisë. Guxho (udhëheqës), Sada e Sokoli tek Kalaja I-2 e tretë e vështirësisë dhe pas kësaj punuan I-1 në Shteg, ku Sada udhëhoqi në litarin e dytë. Treshe tjetër: Gorani, Ladi e Sadik Tafili (Puka) tek I-6 në Shteg. U kthyem në 17:30 në kamp, të lodhur, por me ngjitje të të bukura e të realizuara.

## 26 gusht

Punuam (u ngjitëm) tek zona e kataraktit. Gorani (udhëheqës) e Guxho në I-4; Sokoli e Sada (të dy udhëhoqën) në I-10. Ladi ka vrarë gjurin dhe gjatë ngjitjes në I-6 dhe sot bën pushim.

## 27 gusht

Përsëri punuam në zonën e kataraktit. Nuk pati asgjë të veçantë. Vetëm unë e Romeo nuk u ngjitëm. Blemë një kec për 1030 Lekë dhe e lamë që ta therrim nesër.

## 28 gusht

Ngjitje tek katarakti njëlloj si dje. Dy Ilirët u nisën të bëjnë ngjitje tek I-8 në Shteg (e gjashtë e vështirësisë), më fort me dashjen e tyre se me aprovimin tim.

Gëzin Laçi na theri kecin. Pasdite u morëm me pjekjen e tij. U poq shumë mirë. Guxho e Sokoli na blenë katër shishe verë dhe në darkë, rreth zjarrit ia kaluam shumë mirë.

## 29 gusht

U morëm me analizën e punës; e rëndësishme është që ia kaluam mjaft mirë. U vumë në dukje dy Ilirëve që të jenë më afër me jetën kolektive. Konkludua që ushqimin duhet ta organizojmë plotësisht kolektiv. Ndër të rinjtë më pëlqyen Guxho e Sokoli. Romeo gjithashtu, por ka nevojë për përgatitje fizike

Dy Ilirët punojnë mirë po t'u rrish mbi kokë. Më shumë kujdes e punë duhet me I. Sadën. Në përgjithësi, si jetë e punë kolektive, them se ekipi ynë punoi dhe jetoi ndoshta më mirë se asnjëherë më parë.

*Mbajtës i ditarit, Aleksandër Bojaxhi*

## Shënim i datës 26.11.1978

Në ditar do të mbahen kryesisht këto shënime, për çdo ditë në darkë:

1. Ngjitjet dhe itinerarët e ngjitjeve për çdo alpinist apo litar (*d.m.th. dyshe apo treshe alpinistësh që ngjitet*).
2. Përshkrime për ngjitjen
3. Të dhëna të ndryshme për bimët, kafshët, ujërat, relievin, malësorët, etj.
4. Përshkrime për itinerarët.
5. Drejtuesit e itinerarëve (kush i udhëheq, prej ku e deri ku, etj).

6. Probleme të taktikës gjatë ngjitjes.
7. Avaritë e ndryshme që i ndodhin ekipi tonë ose ekipeve të tjera në atë ngjitje.
8. Mendime personale si edhe probleme të tjera që kanë të bëjnë me lëvizjen alpinistike apo alpinizmin, nga mbajtësi i ditarit ose shokët e tjerë të ekipit.
9. Mbahen proces verbalet e çdo mbledhje që organizohet me ekipin në periudhën e aktivitetit, prej nisjes nga klubi e deri në kthim.
10. Problemet organizative në alpinizëm, etj.

\* \* \*

*Mbajtësi i ditarit ka përgjegjësi të plotë për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e ditarit. Trajneri, Aleksandër Bojaxhi*



# VITI 1979

## Veprimtaria 5 – 15 shkurt 1979

|                         |              |
|-------------------------|--------------|
| Aleksandër Bojaxhi      | 17 N         |
| Kristaq Korçari         |              |
| Mario Trinkera          |              |
| Shefki Juma             |              |
| Kozma Grillo, Komandant | Studenti     |
| Vladimir Memisha        |              |
| Eduard Sheldia          | Partizani    |
| Kujtim Onuzi            |              |
| Servet Aliko, komisar   | Flamurtari   |
| Venigjar Velaj          |              |
| Kristaq Gega            |              |
| Besnik Mustafaraj       |              |
| Qemal Biçaku            | Labinoti     |
| Genci Lika              | Skënderbeu   |
| Vangjel Mëlëngu         | Tomori       |
| Jani Qendro             | zv/komandant |
| Stefan Kule             |              |
| Vullnet Zylyftari       |              |
| Nuredin Seci            | Valbona      |

Aleksandër Kapo

Gëzim Uruçi

Avdulla Merdani

Qemal Hakorja

Taxhedin Shehu

Vllaznia

Korabi

## 1 shkurt

Ora 17:35, u nisëm nga Tirana me tren për në Laç, e pastaj me autobus për në Shkodër. Në autobus ndodhej një lypës, Ramadani. Ishte i çalë me dy paterica dhe i pisët e i parruar në maksimum. Ishte ulur i vetëm në një sedilje dy vendëshe dhe në sediljen e lirë Kiçka kishte vënë çantën me ushqime. Andaj dhe e ngacmonin duke i thënë se “t’i hodhi aty Ramadani të gjithë morrat”. Ndodhi që, afër Shkodrës shoferi ndali dhe mori dy vajza. Kiçka, për humor, njëres i ofroi vendin e lirë tek Ramadani duke hequr çantën. Vajza plot kënaqësi mori të ulet, por kur pa Ramadanin kërceu e lemerisur e doli në fund të autobuzit.

Në Shkodër zumë vend në turizëm. Unë e Shefkiu në një dhomë. Çantat na i mbajtën poshtë në hollin e hotelit. Kaluam mjaft mirë.

## 2 shkurt

U ngritëm në orën 6:00. Hëgrëm mëngjesin në restorant, më pas dolëm dhe bëmë blerjet që na mungonion. Megjithatë, kur u nisëm për udhëtim na kishin mbetur ende gjëra pa blerë. Ia vlen që gjithçka të jetë e parapërgatitur ose të përkushtohemi që të gjithë që në fillim, para nisjes, që kështu të nisemi pa mangësira.

Ora 09:15, filloi në Shkodër mbledhja për analizën vjetore (të vitit të kaluar) të sportit të alpinizmit. Ishim të lajmëruar për këtë. Në mbledhje plasi sherri në diskutimin midis Minellës

dhe Vasilit. Shili, si gjithmonë, debatin e humbi. Ne na dhanë diplomë si ekipi më i dalluar në veprimtaritë e vitit 1978. Pas analizës, unë e Shefkui vajtëm në bankën e qytetit ku gjetëm një zarf të madh dhe ia nisëm me postë diplomën Muharrem Sinoimerit, shefit të klubit tonë sportiv. Besoj se pas mjaft pakënaqësish të tij ndaj ekipit tonë do të mbetet i kënaqur!

Ora 15:00, u nisëm për në Bogë ku arritëm më 17:30. Unë e Shefkui fjetëm tek Pjetër Kol Ulaj, brigadier i qendrës. Na priti dhe kaluam mjaft mirë. Kishte shtëpi të ndrequr shumë bukur. Aty unë qepa kambalet/gjunjaket/kërciret.

### 3 shkurt

Ora 08:30, u nisëm për në Theth. Unë, Gëzim Oruçi dhe dy të Partizanit ngarkuam pajimet në dy gomerë dhe për 300 lekë na i çuan çantat deri ku fillon pylli. Kozmai, Ladi e më vonë Shefkui gjetën tre djem dhe për 500 lekë i ngjitën materialet në Shteg të Dhenve. Gëzimi për 150 lekë të tjera e pajtoi (për deri tek Shtegu) të zotin e gomarit, një plak 67-vjeçar! Me ne ishte edhe Skënderi, kujdestari i Postës Kufitare, me tre ushtarë. Unë më 13:00 isha në Shteg dhe duke ndenjur pas ushtarëve, zbrita me ta. Ora 15:00, isha në kamp. Zbritëm mjaft mirë porse të lagur, qull. Për rreth 45 min m'u desh që bashkë me Nduen të hap dhomat e kampit dhe t'i pajis ato me batanije, çarçafë e këllëfë jastëku. Pastaj u zhvesha në mbathje e u futa në shtrat. Më pas erdhën Shefkui, Marjo dhe i fundit Kiçka. Kiçka më dha dy ndërresa të thata që ia kisha lënë atij dhe pas orës 19:30 erdhi Shefkui që më kish tharë, bashkë me të tijat, veshjet e lagura. Në orën 20:00 u ngrita dhe rreth 2 orë i kalova me komandantin e ri të postës kufitare Petrit Zeka, me vlonjatët dhe Gëzimin. Më 23:00 ramë për të fjetur.

#### 4 shkurt

Koha mjaft e keqe. Çaji në mëngjes e supa në drekë dhe në darkë u ligjëruan. Vajta me Kiçkën tek shtëpia e Sykes ku u thamë. Aty dëgjuam për hollësitë rreth arratisjes së 11 vetëve të një familje nga lagja Gjellaj (*familja e Shukur*).

Në darkë u vendos të bëhet ngjitje nesër, por do të rimblidhemi rishtaz në mëngjes. Në darkë, deri nga ora 1:00 pas mesnate, unë, Marjo, Kozmai dhe komandant Petriti luajtëm me letra.

#### 5 shkurt

Tek ngrihemi, menjëherë fillojmë me mbledhje. Nuk do nisemi për ngjitje. Koha, midis 09:30 – 11:00, disi u hap. Pastaj filloi shi. Vajtëm poshtë në klub e prej aty në mencë ku hëngrëm drekë. Kaluam atje kohën me Petririn e Nikollën (instruktor i qenit të kufirit). Në darkë u vendos që nesër 10 vetë të çajnë borën deri në Qafë Pejë. Më pas bëmë një pesëkatësh si mbrëmë me Marion, Kozmanë e Petritin. Hëngëm darkë dhe e mbyllëm me fërkimin e dorës së Kiçkës e cila është e ënjtur qëkur zbritëm nga Shtegu.

#### 6 shkurt

Kam fjetur mjaft keq. Nisemi ora 08:00 për Qafë Pejë. Jemi 10 vetë. Nga ekipi ynë, unë, Kiu, Marjo. Deri tek qershitë erdhi edhe Petriti me Nikollën. Kur arritëm tek Shpella e Pejës ishim mjaft të lagur. Ndezëm zjarr dhe u thamë. Më 12:40 ishim matanë qafës. Atje lamë kunjat (*??ka mundësi të ketë qenë një pajisje që ia kisha porositur dhe ma kishte pregatitur Dashi. Përdorej në borë me të njëjtin funksion sikundër një plengë në shkëmb. Krahastuar me piketën që përdoret sot për sigurim në një shpat me borë, ajo ishte më e shkurtër dhe më e gjerë në pjesën që futej në borë. Ndoshka 30x30 cm*). Pushuam. Duke hequr pushimet, ishin tre orë marshim Kamp – Qafë Pejë.

U kthyem tek Shpella ku diskutuam se me çfarë mendimi do të dalim në mbledhje. Ndjehej fryma për të mos lëvizur. Në mbledhje u la të mos nisemi, por, gjithësesi, nesër në orën 07:30 do takohemi të diskutojmë se çfarë do bërë.

Bëmë me Marjon, Kozmanë e Petritin 5-katëshin e zakonshëm me letra; vajta me Marjon tek Liria për të parë kohën në televizor, e që parashikimi thotë që do të jetë keq, e tani gjumë.

## 7 shkurt

Koha mjaft e mirë. Qafa e Pejës ka mjegull por deri më 09:30 dielli e largon. Edhe Qafa e Valbonës ka mjegull por nga dreka edhe ajo pastrohet. Sikur të kishim vendosur të niseshim do kishim fituar. Më 07:30 u mblodhëm dhe vendosëm që nesër ora 06:00 të nisemi. Ekipi ynë u mor mjaft me tharje, arnime, modifikime, etj. Menutë e drekës dhe të darkës ishin më të pasurat e gjithë këtyre ditëve. Në darkë bëmë pesëkatëshin, pamë dhe kohën tek Liria në TV. Parashikohet e keqe. Megjithatë biem të flemë me bindjen se nesër do nisemi herët.

## 8 shkurt

Ngrohëm çajin dhe hëngrëm pak mëngjes. Ora 06:45, u nisëm. Mbetën në kamp Vangjel Mëlëngu (për ndërlidhje) dhe Qemal Biçaku me dhëmballë të sëmurë. Teksa marshonim, u kthye për në Theth Vladimir Memisha.

Në Postën Kufitare Verore arritëm më 12:30. Të fundit arritën më 14:00. Rrugës, tek Sheshi i Pleqve (vend mbi Shpellën e Pejës) filloi borë. Koha e keqe në mëngjes u përmirësua pak para se të fillonte bora.

Tani në Postë, jemi të sistemuar në shtretër me dysheke kashte dhe me nga një batanije për fjetje. Koha për nesër duket të jetë disi e mirë.

## 9 shkurt

Ora 06:30 ngrihemi. Hëngrëm mirë, por Kiçkën e kemi mjaft të sëmurë; as ha e as pi. Ora 08:30, nisemi për në Kolajt (Kullat e Kolajt): unë, Kiu, Marjo, Edi, Kujtimi, Kozmai. Rruga ishte e thjeshtë sepse bora linte gjurmë të mirë. Nga maja pamë rreth 8 dhi të egra në drejtim të majës më jugore të Kolajet. Bëmë mjaft fotografi.

Ora 12:00, u kthyem. Të tjerët ngjitën Arapin e Prozhmin. Koha është e mirë dhe me erë që na e than çdo gjë që e nxorrëm për ta tharë. Drekën e hëngrëm të mirë dhe në darkë Kiçka po e merr veten. Jemi përgatitur që nesër, po të jetë kohë e mirë, të ngjitemi në majën kryesore të Lakojeve (Langojeve).

## 10 shkurt

Koha mjaft e keqe. Hapësira është e mbushur me mjegull të bardhë. Hera-herës bie shi dhe breshër. Era e jugut është tepër e fortë. Bisedova me Vullnetin për rrëshqitjen (rrëzimin) në Jezerë *(një vit më parë grupi që ndërmori një itinerar ngjitje nga ana e Gropave të Bukura, pësoi një aksident të rëndë. E keqja filloi me rrëzimin e Rushit Reçit)*. Tabloja është ajo e përshkruara *(Vullneti më pat dërguar një letër ku më shpjegonte hollësi të aksidentit)* dhe del e dobët figura e H *(cili H?!; nuk ka mbiemër)* për rrugën që mori problemi (rrëzimi).

Bisedova me Gëzimin për ngjitje të vështira. Del se ka kryer një ngjitje të vështirë në dimër në Radohinë me N. Secin dhe Q. Biçakun. Del në pah tronditja psikologjike e Nuredinit, i cili si fillestar futej për herë të parë në shkëmb, e për më tepër në dimër.

*(Kur e pyeta Nuredinin, nëpërmjet e-mailit, për këtë veprimtari, ai më ktheu këtë përgjigje: (8 nëntor 2018). Pëtsbëndetje Aci; fëm për kujtimet. Kjo ngjitje ka ndodhur në muajin mars të vitit 1974 në veprimtarinë e traversës Bogë- Theth, nga mbrapa Radohinës,*

*Visencit, Arapit e dalja/arritja në Postën Verore. Do ta shpjegoj një herë tjetër më hollësisht. Kaq për sot. Të fala e përqaftme!).*

Gjithashtu më foli për një ngjitje të vështirë në Bosh me Kujtim Gjylbegun dhe Qemal Hakorjen duke u futur drejtë pranë Qafës së Boshit nga ana e Thethit. Për të dy rastet spikat përdorimi minimal i bazës materiale.

Nga biseda me Gëzimin, sipas tij, del se ekipi ka përçarje të fortë sidomos prej H (*ka mundësi që ky të ketë qenë një konflikt me rrënjë tek lufta e klasave*). Ndjehet dobësi e aftësive të tij krahasuar me të tjerët. Në bisedë u futën mjaft alpinistë. Spikat kudo puna e dobët e trajnerëve në drejtim të asaj se çka u mësojnë alpinistëve dhe niveli i përgatitjes së alpinistëve dhe trajnerëve.

## 11 shkurt

Vonë u vendos që të ngjitemi. Koha ishte mjaft e keqe, ishte mjegull e bardhë që ka mbuluar tërë hapësirën. Nga Kolajt diçka çahen retë. Kjo është arsyeja që Kozmai mendon të ngjiten grupet që nuk janë ngjitur aty. Nisen. Pas tyre edhe ne, 17 Nëntori e Partizani, por ne për në majën e Prozhmit. (Kërkën e nisëm për në Kolaj sepse ngjitja aty është e sigurt që do të realizohet). Fillimisht, për arsye të motit, pati ca ngurim, madje edhe nga Kozmai, por u nisëm në orën 11:00. Në fillim të itinerarit u shfrytëzuan gjurmët e ngjitesve të parë, e pastaj kur ato humbën, me intuitë arritëm majën më 13:15. Kur po vendosnim letrën në majë mjegulla u hap dhe pamë se ishim në majë të gabuar. Shkuam tek e vërteta pas 15 minutash. Më 14:45 ishim poshtë në godinën e postës kufitare.

U gëzuam tepër: si tiranas nuk ngelëm pas të tjerëve në realizim majash. Më fort këtë më duket se e ndjemë unë e Kozmai që në takimin e kthimit në postë sytë nuk na mbetën pa lot.

## 12 shkurt

Kohë e keqe. Është e vranët, por retë janë mbi majat. Retë lëvizin shpejt nga Thethi për kënde; pra është jug. Ora 08:30 diskutohet për nisje. Ndahemi në dy grupe: në Jezerë nga Gropat e Bukura dhe në Jezerë nga veriu. Ne do jemi nga veriu. Duke vlerësuar motin, kësaj i thonë të hedhësh zarët e të presësh (deri në kthim) se si do të bien. Po mbajti koha, fituam! Kështu lamë Lakojt (që ishte në plan) dhe iu sulëm Jezerës: unë, Marjo, Kiu, Kiçka, Vironi, Caqja (Kristaq Gega), Serveti, Kozmai, Edi, Kujtimi. Nisja 09:20. Dri në fund të Runicës e bëmë për 60 min. Morrëm lugun në rrëzë të malit të Bojës. E nisëm lugun, më fort me këmbënguljen e Vironit sesa këmbënguljes sime e të Marjos që njihnim itinerarin. Më 12:00 ishim në qafën në rrëzë të malit të Bojës. Pushuam 10-15 min, sa na arriti, Kiçka e pastaj vazhduam. Më 13:15 pushuam për të ngrënë.

Pas pak filluam të marrim direkt lartësinë; një majë para Jezerës së Vogël. Kaluam traversë (tërthor) derisa dolëm gati në rrëzë të majës, nën një korridor. Që nga ora 13:15 e deri më 16:30 që arritëm në majë, itinerari ishte mjaft i vështirë, veçanërisht në drejtim të lartësisë. Në mjaft vende nuk e përdorëm litarin (*ngulja e kazmës në borën e ngrirë dhe e kthetrave-pjesa e majës së tyre-mundësonin tre pika mbështetëse shumë të mira*). Afër majës, për 4-5 litarë kaluam me siguri. Kishte tufan të fortë i cili filloi të ndjehej që nga ora 15:00, derisa arritëm në postë më 21:15. Në majë bëmë mjaft fotografi nga gëzimi i fitores.

Tentuam ta zbresim majën nga ana e Popllukës, por u kthyem ngase ishte zbritje e vështirë. U ulëm nga një lug 3-4 litarë larg majës. Ulja u bë në terr. Kur zbritëm unë me Servetin, dy të fundit, në Guci, apo Plavë, u ndezën dritat. Lugu ishte i vështirë. Ramë në gjurmë të shokëve që ishin ngjitur në Jezerë nga Gropat e Bukura. Nëpër tufan arritëm në postë.



Në ngjitjen e majës kontribuoi veçanërisht Marjo dhe Kiu për hapjen e borës, si edhe për zgjedhjen e itinerarit Marjo dhe unë. Në majë më bëri përshtypje thepisia e saj dhe e mjedisit përreth. Nuk e kisha parë ndonjëherë me këtë sy panoramën. Ndihej madhështia e Shnikut, thellësia e Luginës së Valbonës, dominimi mbi çdo lartësi; mpleksja e madhështisë së fitores me vështirësinë e zbritjes. Besoj se kemi bërë një arritje të veçantë në ngjitjet alpinistike dimërore.

### 13 shkurt

Koha mjaft e keqe. Mjegull, rreshje, erë e fortë, por jo aq e fortë sa dje. Forca e saj sa vete e bie. Rrimë tërë ditën brënda. Nga ora 11:30 Taxhedini nisët për në Theth. Thotë se është i sëmurë. Nisët me Dullën dhe Qemalin. Pas 10 minutash Qemali kthehet: “më tha Taxhi të bëj ngjitje nesër (ne kishim biseduar e vendosur që nëse nesër do jetë kohë e mirë, të sulmojmë majat e pastaj të nisemi për në Theth).

Më vonë koha u keqësua më tepër (nga ora 14:30) dhe të gjithë filluan nga romuzet: i mbeti Qemalit ngjitja pa bërë! Për të ngrënë, hamë mirë. Për këtë Marjo ka merita të plota për gjithë këto ditë.

### 14 shkurt

Ora 02:30 pas mesnate disa alpinistë ngrihen dhe punojnë për të shbllokuar derën nga bora. (*Kishim frikë se mos bora që binte na bllokonte brenda në postë*). Punuan deri ora 04:00 dhe u duk se bënë një farë pune. Pas kësaj “turni i tretë” ra në gjumë. Më 06:30 rifillojnë lëvizjet. Më 07:00 merret vendim që të ulemi për në Theth. Për të ngjitur maja, nuk mund të bëhet fjalë! U arrit të mbyllet dera e godinës së postës duke lënë sasi të madhe bore brenda. Dolëm nga dritarja pasi sistemua disa mjedisin e brendëshëm të postës. Më 09:20 jemi në rrugë për Theth. Më

11:00 jemi në Shpellë të Pejës; qull. Ekipi ynë, Kozmai dhe ushtari i ndërlidhjes jemi në fund; me nge. Më 11:20 shkarkon orteku i traversës. Pas 20 min edhe dy të tjerë: njëri pikërisht mbi shpellë, e një në të djathtë (kur e sheh Shpellën). Më ora 13:30 jemi të gjithë në kamp. Në darkë u mblodhëm bashkë: të gjithë duan të nisemi nesër për në Bogë. Dhe Kozmai vendosi: nesër në Theth. Ora 18:00 analiza (e veprimtarisë).

## 15 shkurt

Kohë tepër e keqe. Me reshje. Është vendosur të pihet një gotë kolektivisht tek klubi në Theth. Pas hezitimeve për motin e keq, u nisëm. Shitësja është pushim ngaqë ka qenë dezurn. Unë e Shefkiu u ngjitëm lart (në kamp), të tjerët erdhën pas disa orësh tepër të lagur e duke mallkuar motin. Në darkë bëmë analizën dhe vendosëm të nisemi për Bogë nesër ora 06:30 duke kaluar Shtegun, por kjo pasi të shohim kohën (kishte mendime të ktheheshim nga Kiri, apo Guri i Kuq).

Më 21:00 shtruam një darkë. Janë: 17 Nëntori, (pa Kiçkën, të cilin e ka marrë Dedë Bala në shtëpinë e tij), Partizani, Studenti, dy ushtarët, N. Seci, Komandanti Postës dhe me ushqimet e veta, pasi kishim filluar, erdhi edhe G. Oruçi. Ndenjëm deri 23:40.

## 16 shkurt

Dikush na zgjon ..??.. më 05:30. Pas pak vjen Kiçka me Dedën (*Deda aso kohe punonte si mirëmbajtës i kampit*). Ka filluar të bjerë shi dhe borë. Deri më 07:10 fjalosemi për t'u nisur: ka që duan të nisemi po të pushojnë reshjet, të tjerë që të nisemi pa pushuar reshjet. Dhe në 07:15 reshjet pushuan. Më 07:40 niset grupi i parë. Pas tyre të tjerët. Unë, Kiu e Kiçka nisemi më 08:30 pasi u ndamë me Nduen, komandantin dhe komisarin e postës.

Pas 30 min bëmë pushimin e parë. Në krye të Shtegut arritëm gjithë kryeqytetasit. Më 10:40 ishim në krye të kolonës. Më 13:45 unë e Kozmai, që mbyllnim kolonën, ishim tek kisha. Koha na mbajti pa reshje dhe na u duk (na begenisi) paksa edhe dielli.

Më 16:00, teksa po blinim patate (*Boga ka emër të madh për patatet e saj*), takuam Kiçkën. Kishin arritur, por Kiçka nuk na jepte lekët e udhëtimit (!?).

U nisëm me autobus më ora 16:45. U sistemua të gjithë në hotel Adriatik. Nesër në mëngjes do nisemi për Tiranë.

## Përsëritje

### 5 – 15 shkurt 1979

Ngjitje në zonën e Alpeve në Q. Pejë

Marrin Pjesë:

1. Aleksandër Bojaxhi
2. Kristaq Korçari
3. Mario Trinkera
4. Shefki Juma

### E dielë, 4 shkurt

Dje u nisëm nga Boga në ora 08:40 për në Theth. Në Bogë ishim pardje dhe natën e kaluam nëpër familjet e fshatarëve. Dje në ora 13 ishim në Shteg të Dhenve dhe nga ora 15 e më pas (deri nga ora 17 apo 18) arritëm të gjithë alpinistët tek kampi i Thethit. Në këtë udhëtim pati alpinistë të cilët pajtuan kafshë deri në krye të Fushë Okolit. Pati edhe alpinistë që pajtuan fshatarë për mbartjen e çantave deri në Shteg.

Në kamp takuam Ndue Pal Drenin, administratorin e kampit, dhe u rregulluam nëpër dhoma. Ne të katër jemi në një dhomë. Ishim tepër të lagur.

Sot po vimë rrotull nëpër dhoma dhe po merremi me tharje rrobash. Në ora 15:00 erdhën katër alpinistët e Beratit dhe dy ushtarët e ndërlihdjes. Koha që nga dita e djeshme është shumë e keqe. Bie shi i vazhdueshëm, ka mjegull dhe hera-herës shkarkojnë orteqe. Për nesër të dhënat janë për kohë të keqe. Pas orës 18 do mblidhemi e do bisedojmë për nesër.

## **E hënë 5 shkurt**

U ngritëm pak vonë dhe menjëherë e filluam ditën me mbledhje. Sot nuk mund të bëjmë ngjitje. Nga ora 9:30 deri 11 koha u duk si në përmirësim, pastaj u prish dhe filloi shi. Në ora 10 u ulëm tek dyqanet, pa Marjon, dhe ndenjëm në klub e më pas drekuam në mencën e kooperativës.

Mbasditen e kaluam në kamp. Erdhëm rrotull sa u mërzitëm. Biseduam dhe vendosëm që nesër, 10 veta të nisemi e të çajmë borën deri në Q. Pejë. Të tjerët të përgatisin dru për zjarr. Në darkë pimë nga një filxhan uzo dhe hëngrëm supë. Koha e keqe.

## **E martë, 6 shkurt**

Në ora 10 u nisëm 10 vetë për në Q. Pejë. Nga ekipi ynë jemi unë, Mario e Shefkiu. Bora ishte shumë e qullët. Binte shi. Kur arritëm tek shpella ishim të lagur. Ndenjëm një orë e 30 minuta aty dhe gati u thamë plotësisht në zjarrin e ndezur. Më 12:40 minuta ishim matanë Q. Pejës. Po të heqim ndalesat/pushimet del se nga kampi në Q. Pejë e bëmë për tre orë. Në ora 15 ishim në kamp. Në ora 17 u mblodhëm dhe u vendos që nesër, ora 7:30 do të mblidhemi rishtaz. Me këtë borë, ku majave vetëm ajo e reja mund të jetë një metër, dhe këtë mot, të nisesh drejt majave nuk ka asnjë garanci nga orteku. Kozmai thotë që nesër të ndërmarrim ndonjë gjë tjetër. Çfarë? Le t'ia lëmë të mërkurës, sepse në këtë të martë është skëterrë.

## **E mërkurë, 7 shkurt**

Për habi koha është shumë e mirë. Q. Peja, pak e zënë, por më shumë Q. Valbonës; të dyja janë me mjegull. Nga ora 13 çdo gjë shkëlqente nga dielli. Ortekët oshëtijnë, sidomos nga ana e Radohinës. Që në orën 7 e 30, u vendos që të nisemi nesër, ora 6 për rrugë. Sot çdo gjë e lagur u vu të thahet në diell. Ekipi ynë u kujdes mjaft për përgatitjet: tharje, arnime, riparime, menu e pasur për drekë e për darkë. Në mbrëmje hëna formoi rreth, shenjë e një moti jo të mirë. Edhe televizori jep parashikim për mot të keq.

## **E enjte, 8 shkurt**

Kohë e vrenjtur. Nisemi më 6:45. Ora 13 jemi tek Posta Verore (Sheu i Bardhë). Rrugës, tek Sheshi i Pleqve, na zuri bora, e cila pushoi rreth orës 12:30. U rregulluam në shtretër me dyshekët e Postës dhe me nga një batanie. Tani po gatuajmë dhe po shkrijmë borë për ujë të pijshëm. Koha për nesër ka shenja jo të këqija.

## **E premte, 9 shkurt**

Koha thuafe mjaft e mirë. Ka ca re të llojit që kur shtohen sjellin prishje të motit. Në ora 8 u nisëm për në Koletë/Kolaj. Në orën 10:30 jemi në majë: unë, Mario, Shefkiu, Edi, Kujtimi, Kozmai. Kiçkën e kemi shumë të sëmurë. Mbrëmë as hëngri e as piu. Në darkë vonë ai u ndje më mirë. Në postë u kthyem në 12:30. Maja për t'u ngjitur ishte e thjeshtë: bora bën gjurmë/rehe që të mban mirë dhe itinerari është teknikisht i thjeshtë. Nesër, po të jetë mot i mirë, do të ngjitemi në majën e Langojve/Lakojve.

## **E shtunë, 10 shkurt**

Koha tepër e keqe. Era e jugut fryn mjaft e fortë. Hapësira është e mbushur me mjegull të dendur e të bardhë. Shpesh bie shi

ose breshër. Jemi mpirë duke ndenjur brenda godinës së postës. Kiçka është shëruar.

## **E dielë, 11 shkurt**

Kohë e keqe. Mjegull e dendur dhe erë e fortë.

Nga ora 10, Kozmai hedh mendimin për t'u nisur drejt majave. Diskutuem gjatë. U vendos që grupet që nuk kanë qenë në Kolaj të nisen për atje ngaqë është afër dhe ka siguri ngjitja atje. Më 10 e 30 ata u nisën. Me ta u nis edhe Kiçka. Mario, Shefkiu, Kujtimi e unë u nisëm për në Prozhëm. Fillimisht na ndihmuan gjurmët e ngjitesve të mëparshëm e më pas intuita e malit për të arritur majën përmes mjegullës. Më 13:15 arritëm në një majë, por kur sapo po vendosnim shenjën, u hap mjegulla dhe e pamë turbull majën e vërtetë. Pas 10 minutash ishim atje dhe më 14:50 ishim në postë. U gëzuam shumë për këtë ngjitje. Veçanërisht Mario punoi mjaft mirë. Të gjithë punuam mirë.

## **E hënë, 12 shkurt**

Qielli është i vrenjtur, por retë janë mjaft lart. Era fryn e lehtë dhe vjen nga jugu. Në ora 8:30 vendoset që të nisemi drejt majave. Vendoset që të sulmohet Jezera. 17 Nëntori, Partizani (Eduard Sheldia, Kujtim Onuzi), Flamurtari (Venigjar Velaj, Servet Aliko, Kristaq Gega) dhe Studenti (Kozma Grillo) do synojmë Jezerën nga veriu.

Nisemi më 9:20. Në fund të Runicës morëm lugun në të djathtë, i cili fatmirësisht ishte i mbushur nga bora dhe më ora 12 ishim tek qafa nga duket Jezera. Kaluam djathtas poshtë e më pas në shpatin e Jezerës së vogël filluam të marrim lartësinë. Shpati ishte tepër i thepisur e i rrezikshëm. Ju afruam një brezi shkëmbor dhe, në një koridor të thepisur ku ai (brezi) hapej, morëm vertikalisht lart. Koridori kishte borë të fortë, që në dalje,

sipër, e kishte të ngrirë. Kaluam me sigurim deri në majë duke hapur një litar dhe më vonë edhe një të dytë. Në kreshtë të majës era gati sa nuk na hodhi poshtë. Kur arritëm në majë kishim një gëzim të veçantë. Rreth 20 minuta fotografuam. Pastaj tentuam të zbresim nga ana e Popllukës. Nuk mundëm. U kthyem dhe zbritëm në një lug ku mendohet se u rrëzua grupi që synoi majën në vitin 1977. Në momentin kur unë dhe Serveti filluam zbritjen në lug, në Gusi (*në fakt sot – 2018 – mendoj se është fjala për Plavën*) u ndezën dritat. Me vështirësi kaluam lugun dhe poshtë ramë në gjurmët e grupit që kishte sulmuar sot Jezerën nga Gropat e Bukura.

Tufani sa vinte e shtoej/forcohej dhe, kur dolëm mbi Gropat e Bukura, na hodhi/rrëzoi disa herë. Shtriheshim barkas dhe ngulnim kazmat vertikalisht e thellë për të përballuar shkulmet e tij. Më 21:15 ishim në Postë, të gjithë shëndoshë e mirë.

Si konkluzion: ngjitja ishte mjaft e vështirë, e lodhshme, madhështore. Duke përjashtuar Kiçkën që kishte temp. të ulët – në një vend e pritëm mbi 20 minuta – të tre ne, Mario (veçanërisht), Kiu dhe unë kontribuam mbi të tjerët në punë për realizimin e itinerarit. (*Kozmai i ka pas dhënë Marios meritë të veçantë për këtë ngjitje*).

Në postë e ndjemë edhe më fort se kemi realizuar një ngjitje e cila ndoshta do shënojë diçka me rëndësi në zonat e ngjitjeve.

Ramë për të fjetur pas orës 23:30 pasi hëngrëm mirë.

## E martë, 13 shkurt

Koha mjaft e keqe. Fryn jug i fortë dhe bie borë. Dritaret e godinës së postës janë mbyllur/zënë nga bora. Gradualisht po mbyllet/zihet edhe dera. Aty nga dreka Taxhedini dhe Avdullai, u nisën për në Theth.

## E mërkurë, 14 shkurt

Tërë natën fryu erë e fortë jugu dhe pati reshje bore. Dera dhe dritaret e postës u mbuluan dhe koridori u mbush me borë. Në orën 2:30 pas mesnate 4-5 vetë u ngritën dhe pastruan nga bora derën e koridorin. Në orën 4 ra rishtas qetësia, që u prish në orën 7. Filloi puna e përgatitjeve për t'u larguar dhe për të lënë postën në rregull.

Ora 9:20 nisemi për në Theth. Koha mjaft e keqe. Ideja e hedhur që në këtë kthim të ndalemi e të ngjitemi në majën e Arapit është e pakuptim, sepse koha është jo e përshtatshme. Deri tek Qafa e Liqenit ecëm mirë, por me një devijim të vogël për arsye të mjegullës. Gropën e liqenit e kaluam me vështirësi dhe në ora 11 ishim tek shpella nën Q. Pejë. Në ora 13 ishim në kamp. Pasi dolëm nga Shpella e Pejës ranë mjaft ortekë. Jemi aq të lagur sa nuk thuhet.

## E enjte, 15 shkurt

Nisemi p. dite në një mot tejet të keq, për në klub, që të festojmë mbylljen e aktivitetit. Shitësja e ka mbyllur klubin për arsye të dezheurnit *(është koha kur në çdo qendër banimi, në një dhomë me telefon, në një nga institucionet/zyrat e fshatit, dikush e kalonte natën aty në gatishmëri ushtarake që, në qoftë se na sulmonte papritur armiku, personi merrte njoftim dhe duhej të jepte alarm e të ngrinte fshatin në këmbë. Pas kësaj struktura të caktuara merreshin me mobilizimin e fshatit, etj.)*. Me Shefkiun u ktheva lart në kamp ku hëngrëm drekën e më pas shkuam tek Ndue Pali për t'u larë. Në ora 18 filloi analiza. U pëlqye puna në aktivitet. U propozua që aktiviteti të bëhet me grupe me nga 3-4 ekiye dhe në data të ndryshme, ngase kështu, jo të gjithë do jenë njëherësh nën motin e keq. U propozua që edhe zona e aktivitetit të ndërrohet.

Në darkë, pasi u gjendën 2 litra raki Thethi *(është me gradacion të ulët)* dhe patate *(të tjerat i kemi nëpër çanta)*, organizuam një



“banket” bashkë me ekipet e Partizanit, Studentit, dy ushtarët e ndërlidhjes dhe Nuredin Secin. Ftua edhe Komisararin e Postës Petrit Zeka. Pasi filluam, na erdhi edhe Gëzim Oruçi me hajet e veta, dhe na gjallëroi bisedën/tavolinën. Kiçka është në shtëpinë e Dedë Balës. Mbrëmja jonë u mbyll rreth orës 23:40. Nesër mendohet të nisemi në ora 6. Koha duket sikur po qetësohet.

## E premte, 16 shkurt

Në ora 05:30 vjen Kiçka me Dedën. Ne sapo na ka zgjuar Stefan Kuli. Jashtë koha po prishet dhe rifillon shi e borë. Lindin debate të shumta për nisje. Në ora 7:30 reshjet pushojnë dhe retë fillojnë e ngrihen lart. Ekipet fillojnë të nisen. Ekipi ynë nisët i fundit në orën 8:30.

Në Bogë grupi i parë arrin më 12:30, kurse unë e Kozmai arrijmë të fundit më 13:30. Rrugës kemi çarë borë të madhe. Në Bogë hëngrëm, u thamë dhe firmosëm fletët e pagesave për mushkat. Përfundimisht kjo veprimtari kaloi mirë, si kolektivisht, si edhe me rezultate të mira për ato mundësi që na krijoi koha.

*Mbajtësi i ditarit Aleksandër Bojaxhi*

## 5 – 16 mars 1979

### Ngjitjet zhvillohen në zonën e Bogës

Marrin Pjesë:

1. Andon Tapia
2. Romeo Manxhari
3. Petrika Postoli
4. Edmond Shameti
5. Ilir Tapia
6. Artur Gorishti
7. Sokol Doko
8. Niko Petro



Ekipi në Bogë

## 5 mars 1979

U nisëm nga Shkodra në orën 11:20 dhe mbërritëm në Bogë në orën 13:30. Udhëtimi kaloi shumë mirë. Të gjithë alpinistët erdhën me autobus duke patur me vete çantat e dorës, çadrat dhe kazmat, kurse çantat e shpinës u bartën me kamion, i cili arriti 30 minuta pas nesh. Organizimi për ngjitje dhe ndarja e grupeve nuk u bë në rregull, mbasi komandanti i ngjitjeve Petraq Kuli, për arsye personale, nuk mundi të vijë/paraqitet në aktivitet, kurse komisar, Vasil Stambuli, ishte nisur përpara me makinën e klubit Partizani dhe tashmë ishte në Okol. Ne pritëm deri sa erdhi ai (në orën 15:30). U caktuam të qëndrojmë në Bogë dhe u vendosëm (kampuam) pranë burimit, në krah të majtë të shtëpisë së Gjekës. Koha ishte shumë e mirë. Ngritja e çadrave përfundoi më 18:30. Presim kohë të mirë dhe ngjitje për nesër.

## 6 mars

Zgjimi u bë në 5:45. Gjatë natës patëm ftohtë. Frynte erë. U nisëm në ora 8. Romeo është caktuar komandant toge dhe ka në togën e tij alpinistët e Studentit dhe të Flamurtarit. Ekipi ynë do të ngjitet në majën e Hundës (rreth 1.700 m). E zgjodhëm si ngjitje që të fitojmë një majë (*ngjitjen e një maje*) e ndërkohë edhe përsërisim elementet teknike gjatë ngjitjes për më të rinjtë e ekipit tonë.

Në majë mbërritëm në orën 13. Kur u ngjitëm, morëm rrugën sipër shtëpisë tek burimi, dolëm tek disa stane sipër mullirit e më pas dolëm sipër lugut të madh, që ndan malin e Bridashit nga maja e Hundës dhe Pustecit. Pastaj morrëm traversë dhe dolëm në pyll, ku filluam ngjitjen në borë, duke marrë drejt e lart dhe i dolëm majës nga mbrapa. Aty të dukej sikur po të vazhdoje traversë do dilje në majë por në fakt nuk të nxirrte atje. Këtu

morëm majtas dhe lart rruga duket fare qartë, pastaj morëm në formë traverse dhe dolëm në majë. Kthimin e bëmë nga shpati lindor. Këtej hasëm vështirësi sepse pjerrësia ishte e madhe dhe bora e shkrifët. Do ishte më mirë të ishim kthyer nga rruga e ngjitjes sepse ka më pak rrezik dhe bëhet më shpejt. Ngjitjen e vlerësuam të shkallës së katërt të vështirësisë. Në kamp arritëm në orën 4.

Drekën dhe darkën i hëngrëm në orën 19:30. Kjo vonesë në ushqim na detyroi që të ndaheshim katër e katër për të gatuar. Të gjithë punuam shumë mirë. Në litarë ishim ndarë: Niko-Iliri, Andoni-Petrika-Mondi, Sokoli-Turi.

## 7 mars

Koha shumë e mirë. Fjetëm mirë. Si duket kaq duhej që të përshtateshim. Sot do të ngjitemi në Bridash, duke u futur nëpër koridorin/lugun lindor. Nisemi në orën 7 bashkë me ekipin e Korabit. Nuk duhet të shkosh lart deri sipër mbasi atje bëhet kalimi shumë i vështirë dhe detyrohesh të zbresësh poshtë. Duhet që aty ku pylli është i rrallë të futesh majtas për në lug.

Si litarë pune jemi ndarë kështu: Niko-Mondi-Iliri, Andoni-Turi-Petrika. Sokoli u fut në litar me treshen e Korabit. Në qafë dolëm në orën 13. Në orën 14 ishim në majën e parë dhe në 14:15 në majën e dytë. Nuk vajtëm në majën e tretë sepse kishte rrezik për rënie orteku. Si morëm rrugën e kthimit, në qafë dolëm në orën 15 dhe në kamp ishim në orën 17. Gjatë ngjitjes të gjithë punuan mirë, sidomos Sokoli. U kënaqëm me bukuritë që pamë. Mendojmë të bëjmë një ekskursion për të bërë fotografi me ngjyra. Për nesër koha duket të jetë shumë e mirë dhe e kemi pushim. Deri tani kemi shpenzuar një film (*një rrotull/bobinë*).

## 8 mars

Koha është përmirësuar, por majave ka mjegull. Shiu që filloi mbrëmë nuk vazhdoi shumë dhe nuk u lagëm. U nisëm për në majën e Shtegut ndonëse kishte mjegull. Kur u futëm në lug, aty ku rruga automobilistike kalon në shpatin tjetër të malit, ramë në gjurmët e grupit që ishte ngjitur në Shteg një ditë më parë. Këtu bora është e ngrirë, por pranë majës ajo ishte si miell. Në majë arritëm në orën 11:30 dhe në kamp ishim në orën 14. Të gjithë punuan mirë dhe u treguan të palodhur. Ngjitjen e drejtoi Romeo.

Djemtë e rinj netët e para kishin ftohtë, por tani u mësuan me kushtet e kampit. E kanë të vështirë në gatim dhe në ngrënien e mëngjesit mbasi vonohen shumë. Sokoli me Turin janë duke punuar shumë mirë, sidomos në kamping. Nesër mendojmë të ngjitemi në majën e Thores.

## 10 mars

Moti është pak i mjegulluar dhe është i paqëndrueshëm. Nisemi në ora 7:20 për në majën e Thores. Andoni do qëndrojë dezurn tek çadrat dhe grupin do e drejtoi Niko. Deri në një farë vendi itinerari ishte i njëjtë me atë të djeshmin, por sa dolëm nga pylli për t'u futur në lug, morëm djathtas dhe filluam ngjitjen lart, nëpër disa pemë të larta ahu dhe dolëm në rrugën automobilistike që ishte e mbuluar nga bora. Më pas morëm traversë majtas dhe dolëm tek një gropë e madhe me borë ku më duket se është Liqeni i Thores. Mirëpo maja që kemi në të majtë nuk na duket si maja e Thores (*nga përshkrimi që jepet, del se ata në fakt do ngjiten pikërisht në majën e Thores, e cila është mbi Liqen*). Larg duket një majë tjetër, por ne nuk kemi kohë të shkojmë atje sepse ora është 10:30 dhe koha po na prishet: bën ftohtë dhe po na afrohet mjegulla. Lidhemi në litar dhe fillojmë ngjitjen e majës që kemi

këtu. Në litar jemi: Niko-Turi, Iliri-Mondi, Sokoli-Petrika. Në majë mbërrimë në orën 11:30. Zbritëm shpejt sepse nxitonim ngaqë filloi rënia e borës. Koha po keqësohej. Në kamp arritëm në orën 14. Këtu ka filluar një shi bore ndërsa majat e maleve tashmë nuk duken. Bën pak ftohtë.

Djemtë e rinj tashmë e kanë marrë me kënaqësi ngjitjen në maja. Frika u ka dalë, porse duan që të kthehen shpejt në kamp. U kanë mbetur në mendje pamjet që kanë parë mbrapa malit të Bridashit. Për nesër është pushim, por do jemi pa fat sepse moti është prishur keqas.

## 11 mars

Koha e vrejtur nga dreka filloi të hapet dhe arriti të bëhet shumë e kthjellët. Bëmë konkluzionin e ngjitjeve dhe vumë në dukje punën e mirë të djemve e sidomos të Sokolit dhe Turit. Për nesër mendohen ngjitje në majat e Rabës.

## 12 mars

Mbrëmë u vendos që të ngjitemi në Bridash nga një itinerar tjetër, nga qafa. Moti është i vrejtur dhe majat janë të mbuluara nga mjegulla. Nisemi më 7:20, duke e ngjitur shpatin mbi shtëpinë e Nikollës dhe në ora 9:30 jemi në qafë ku bëjmë 15 minuta pushim. Më pas marrim djathtas, duke u futur në itinerarin e kthimit nga maja kur i ngjitesh asaj nga ana lindore. Mjegulla sa vjen dhe ulet dhe, kur i afrohem majës, që i binte të ishte larg rreth 15-20 minuta, mjegulla dendësohet aq shumë, sa nuk shohim as gjurmët tona. Ndalojmë dhe presim që ajo të largohet, por jo; dhe ne detyrohemi të kthehemi.

Ngjitjen e drejtoi Niko dhe në litar ishim: Niko-Sokoli-Mondi, Turi-Iliri-Petrika. Por Petrika u kthye ngaqë kishte harruar kambalet.

Bora ishte si miell dhe e pa ngrirë. Kjo ngaqë para dy ditësh kishte reshje bore dhe kishte mbuluar gjurmët e maparëshme. Në kamp ishim në orën 12:15, ngaqë rrugën e kthimit e bëmë me rrëshqitje. Më mirë rrëshket Sokoli, por kazmën nuk e mban mirë.

Ekipi ynë është duke bërë ngjitje i veçuar nga ekipet e tjera, me përjashtim të rastit të ngjitjes në Bridash. Andoni po i kushton/tregon shumë rëndësi sasisë së ngjitjeve, që kështu të mundësohet plotësimi i kërkesave për rritje në kategori sportive të secilit.

Sot u vu re një farë lodhje tek të gjithë; të gjithë djersitëm shumë. Edhe koha është e mërzitshme. Po të jetë se do hapet koha do shkojmë nesër ne Bridash.

### 13 mars

Koha vazhdon të jetë e vrenjtur dhe në maja ka mjegull. Shkumbin Ramadani (vlonjat), që është Komandant i grupit tonë, propozoi që sot të bëhet pushim mbasi të gjithë ekipet janë të lodhura. Kjo u pranua nga trajnerët e ekipeve. Më poshtë po tregoj për ndarjen e grupeve në këtë veprimtari:

Në Okol: Partizani, Tropoja, Puka, Kukësi

Në Bogë: 17 Nëntori, Studenti, Peshkopia, Vlora.

Në Ducaj: Elbasani, Korça, Gjirokastra, Berati, Përmeti.

Për kampin tonë Komandant është Shkumbin Ramadani. Për të tjerët nuk e di. Komisari i ngjitjeve është Vasil Stambuli, që shëtit nëpër Bogë me automatik dhe aparat fotografik.

Togat janë ndarë: Studenti e Vlora; Peshkopia e 17 Nëntori. Nuk po e kuptoj se kush është komandant i togës sonë.

Dje u nis për në Çardak ekipi i Partizanit i drejtuar nga Azemi. Niko dhe Romeo shprehën dëshirën për të vajtur, por Vasili u tha se ajo ngjitje nuk u duhej (për efekt kategorizimi), kurse tek ekipi i Partizanit u duhej të gjithëve. I kemi thënë

Shkumbinit që të na organizojë një grup për t'u ngjitur atje, por ai po na e dredh duke na thënë se duhet një drejtues i fortë për atje. Sot lexuam rregulloren e alpinizmit.

## 14 mars

Zgjohemi ora 6. Koha është e vrenjtur dhe mjegulla ka zbritur shumë poshtë. Ne do të nisemi për në majën e Rabës me alpinistët e Vlorës dhe të Studentit, por pak nga mjegulla e pak ngaqë jemi në ditët e fundit, të gjithë po nisemi pa entuziazëm. Morëm shpatin dhe dolëm tek stanet e Negovanit nga ku shohim që mjegulla ka mbuluar majën afër pjesës ku fillon bora. Kur grupi po bënte një pushim Niko, Beni i Vlorës dhe një alpinist i Studentit u nisëm pas gjurmëve të alpinistëve të Korabit që kishin ngjitur ditë më parë majën dhe ndërkohë u bindëm se, që të vazhdonim ngjitjen do të ishte e kotë. Në kamp arritëm në 11:30. Romeo nuk mori pjesë në këtë tentativë për ngjitje.

Mbasi ne ishim nisur, Romeo me Shkumbinin vajtën në Okol për të marrë disa fletëspjeguese (*formular për ngjitjen e majës*) dhe atje gjejnë Vasilin, i cili u thotë se një grup ishte nisur për në Çardak. Për këtë gjë, ne të kampit në Bogë nuk na kishte lajmëruar njeri. Këtë lajmërim duhej ta kishte bërë Vasili ngase këtu ka shumë alpinistë që e duan këtë ngjitje. Romeo shprehu dëshirën që të nisej dhe të arrinte grupin. U pajis me kthetra e kazmë tek ekipi i Partizanit dhe arriti të ngjite majën. Në orën 11:30 ai ishte në majë dhe në orën 15 në kampin tonë.

Sot i mbaruam ngjitjet, si numër, por mund të ngjisnim më shumë sikur të kishim vepruar më të lidhur me ekipet e tjera dhe jo të veçuar. Këtë do e kemi parasysh në aktivitetin e ardhshëm. Nesër mendohet të bëhet analiza e veprimtarive dhe rreth orës 12 të tre grupet do mblidhen në Bogë.

Fragment i një zbritje  
nga maja e Bridashit



## 15 mars

Ngrihemi më 6:15. Moti me mjegull, por era që fryn i zbulon majat hera-herës. Mbrëmë rreth zjarrit diskutuam që të bëjmë edhe sot ngjitje nëse largohet mjegulla. Ky diskutim po vazhdon tani. Andoni insiston që të ngjitemi. Bëhet fjalë për Bridashin që është i mbuluar nga mjegulla. Niko dhe Romeo kishin mendim që sot të mos bëhet ngjitje, sepse djemtë janë të lodhur dhe majat janë përsëri me mjegull, kurse Andoni ngulmon që kjo ngjitje na duhet për punë kategorie sportive të individëve. Vendosi që të nisemi. Është ora 8. Andoni, Petrika, Iliri, Sokoli, Arturi. Mondin e lamë në kamp që të mbikqyrte çadrat, ndonëse ai dëshironte të vinte. U nisëm. Tempa ishte ca i lartë në mënyrë që kohën ta kishim përpara. Bëmë rreth një orë rrugë deri sa arritëm në rrëzë të një shkëmbi. Andonit po i merreshin mendtë dhe Petrikës po i vinte për të vjellë. U vendos që ata të mos vazhdonin me ne. Vazhduam ngjitjen për të dalë në qafën e madhe. U futëm në një borë që ishte e ngrirë. Vumë kthetrat dhe në orën 10 ishim



në qafë, të cilën e kishte kapur mjegulla. Veshëm pulovrat ngaqë tashmë do ecnim më ngadalë, sepse bora ishte jo e lidhur. Kishte filluar të shkrinte. Pas 10 minutash u nisëm përsëri, por tashmë moti u mbyll krejtësisht. Ne vazhduam në gjurmët e ditëve më parë. Në orën 10:40 mbërritëm tek vendi ku u kthyem dy ditë më parë për shkak të mjegullës, e cila na ka kapur edhe sot. Pritëm rreth 15 minuta dhe kjo mjaftoi që të hapecj/ngrihej mjegulla dhe ne të fiksonim itinerarin që duhej të ndiqnim. Vazhduam dhe mbërritëm në majë, të mbuluar nga mjegulla, në orën 11:30. Pranë majës bora ishte e ngrirë, por nën të ajo ishte e shkrifët.

Në orën 12 mbërritëm tek vendi ku u ndamë me Andonin, i cili ishte aty e po na priste. Kishte ndezur zjarr. Nuk qëndruam shumë dhe në orën 13 arritëm në kamp. Aty nuk ishte bërë mbledhja. Grupi i Ducajt kishte ardhur dhe kishte pritur që të vinte edhe grupi i Okolit dhe më pas ishte larguar me justifikimin se ishin të uritur.



Ilir Tapia



Sokol Doko

Mbledhja filloi në orën 14:30. Ekipi ynë u lavdërua sepse bëri ngjitje edhe sot. U diskutua që Komisioni Teknik të propozohej nga masa dhe u përmend fakti se verejtjet për Federatën do mbeten këtu në Bogë. Niko kritikoi komandantin dhe shtabin për çorganizim të ngritjes së kampit, veçimin e grupit të Okolit nga grupet e tjera, mos koordinimin me grupet e Bogës dhe Duajt për ngjitjet e kualifikuara (Çardak ut), Federatën për kontrollin e bazës materiale të rretheve, diskutimin e rregulloreve teknike në masën e alpinistëve dhe pastaj aprovimin e tyre, sepse ka nene kontradiktore.

Në darkë Andoni shkoi tek një mik bashkë me Ilirin. Porse na shqetësoi shumë hapja nga alpinistët e një kavalete (me patate) në Okol. Kjo bëri që të krijohet një komision me Shilin (Vasilin), Azemin, etj., që të kontrollohen të gjitha çadrat e grupeve të Bogës dhe Okolit, por nuk gjetën gjë. Kjo nuk diskutohej. Në çadrën ku flinin Petrika, Iliri, Mondi humbi një makinë rroje e sapo blerë. Këto ndodhi bënë që nata e fundit të mos jetë e gëzueshme.

## 16 mars

Koha është me shi. Është i treti vit që Boga na përcjell me shi. Deri në orën 8 ishim bërë gati për rrugë. Makinat erdhën në ora 12. Në ora 14 mbërritëm në Shkodër dhe në ora 16 do nisemi për Tiranë.

*Mbajtësi i ditarit Niko Petro*

## Me rastin e Kongresit të pestë të Frontit Demokratik Shqiptar. Ngjitje në Malin e Çikës (2045 m)

Pjesëmarrësit:

1. Aleksandër Bojaxhi
2. Romeo Manxhari
3. Shefki Juma
4. Shkëlqim Mema
5. Sokol Doko
6. Dragush Kulheku nga ekipi i të rinjve
7. Ilia Stillo nga ekipi i të rinjve

### Datë 3 qershor

Nisemi me tren ora 6 nga Tirana dhe në orën 11:15 jemi në Vlorë. Nuk ka dalë njeri për të na pritur. Rreth orës 12 takojmë Besnik Mustafaranë, që na njofton se në orën 16 do nisemi me makinë nga Hotel Sazani. Pas kësaj vajtëm në plazhin pranë skelës dhe në 15:30 u mblodhëm tek dhoma e alpinistëve. Aty mësuam se policia ka rrethuar qendrën e qytetit dhe kështu takimi dështon. Alpinistët e Vlorës merren me policinë dhe vendoset që nisja jonë të bëhet në orën 19. Më 19:30 nisemi me makinën e klubit sportiv. Me vështirësi depërtuam nëpër rrugët e bllokuara të Vlorës (me sa duket kongresi mbahet këtu) nga policia dhe në orën 21:30 jemi në Qafë të Llogorasë. Në këtë udhëtim na shoqëruan edhe dy inspektorë të klubit sportiv Flamurtari, Pajtimi dhe Janku.

Nga ekipi i Vlorës marrin pjesë: Servet Aliko, Venigjar Velaj, Besnik Mustafaraj, Ilir Shabani.

Udhëtuam rreth 10-15 minuta dhe arritëm në një livadh të bukur pranë një stani. Aty kaluam natën.

## 4 qershor

Në ora 5:30 nisemi. Besnikun e lëmë roje tek çadrat. Udhëtuam me temp normal dhe me pushime. Dielli na kapi kur ishim në kreshtë. Pranë majës kishte pak borë. Aty na u prish aparati fotografik. Në majë arritëm në 8:45. Soditëm dhe u kthyem tek çadrat në orën 11:30. Më 13 arritëm tek klubi i Llogorasë ku na priste makina dhe inspektorët. Ndenjëm pak aty dhe më 15:30 ishim tek Uji i Frohtë, ku bëmë banjë dhe hëngrëm drekë në një BAR mbi rrugë.

Natën e kaluam në dhomën e alpinizmit të ekipit vlonjat, pas një shëtitjeje të këndshme nëpër rrugët e Vlorës. Nesër do të nisemi në ora 16:15 nga dhoma e alpinistëve me makinën e klubit sportiv.

Sjellja e alpinistëve dhe inspektorëve vlonjatë me ne ishte mjaft e mirë. Duhet të kihet në konsideratë nga ekipi ynë ky qëndrim i vlonjatëve.

*Mbajtësi i Ditarit Aleksandër Bojaxhi*

**Shënim:** gjatë këtyre ditëve u mrekulluam me bukurinë e detit, qiellit dhe malit, si dhe me diellin e nxehtë të jugut. U argëtuam edhe me Vlorën e pastër, të bukur e festive. Përfitim alpinistik ishte njohja me malet e jugut. Itinerari nuk kishte vlerë alpinistike.

Mendoj se të këtilla ngjitje të bëhen 2-3 herë në vit e në secilën të marrin pjesë nga 2-3 alpinistë (për ekip). Kjo do bëjë që klubet të stimulohen që të dërgojnë më të mirët, por edhe do të rritet në çdo ekip përvoja e njohjes së zonave të ndryshme malore.

Vlen të përmendet se vlonjatët, alpinistë dhe punonjës të klubit sportiv, na pritën mjaft mirë. Për këtë e ndjej se u

detyrohemi. Konstatohet se me alpinistët e rinj të këtij qyteti punohet dobët. Ndjehet shkëputje e thellë midis të vjetërve që kanë mjaft vlera e njohuri me të rinjtë që nuk u ndjehet toni asgjëkund.

*Falenderime Vlorës për ftesën!*

*Aleksandër Bojaxhi*

## 8 – 15 korrik 1979

Ngjitjet zhvillohen në Shtegun e Dhenve

Pjesëmarrësit:

1. Andon Tapia
2. Dashamir Fejzo
3. Sokol Doko
4. Artur Gorishti
5. Edmond Shametaj
6. Dragush Kulheku
7. Niko Petro



Ekipi në Shtegun e Dhenve

### 7.7.1979, e shtunë

Në Shkodër mbërritëm mbrëmë, në orën 21:30. Na caktuan për fjetje tek Hotel Sporti. Ekipet e ardhura para dite i kishin caktuar në një konvikt shkolle.

Sot, ora 11 u nisëm të ndarë në tre autobusë dhe me një kamion për materialet. Në ora 14 arritëm në Fushë Okol. U nisëm në këmbë për në Qafë Thore ku mbërritëm në 15:15. Çantat tona ishin shkarkuar aty. Neve na mungonin nga çantat 2 kg pjeshkë, 1 kavanoz reçel; kurse ekipit të Vllaznisë i mungonte një çekiç. Pas pak u nisëm për në Shteg. Ishim shumë të ngarkuar. Më 16:15 mbërritëm dhe aty na zuri breshër. Hapëm çadrat dhe u mbuluam me to. Më vonë u futëm në çadrën e pukianëve. Meqë kishim ngarkesë të madhe, një pjesë të materialeve i lamë

në krye të së përpjetës tek liqeni i Thores, si edhe Sokolin. Kështu që Turi, Mondi e Dragushi u nisën për tek Sokoli. Në orën 18 u kthyen, por ishin të lagur. Nga ora 19 e deri më 20 u morëm me ngritjen e kampit. Ndërkohë erdhën me materialet e lëna Sokoli, Dragushi, Turi e Mondi.

Shtabi i mbledhur ndau togat. Andoni mori fjalën e ngriti këto gjëra:

1. Disiplinë në kamp
2. Disiplinë në ngjitje
3. Sigurimet në ngjitje
4. Ruajtja nga aksidentet.

Për nesër moti duket i dyshimtë. Ne do të shkojmë për ngjitje.

## 8.7.1979

U zgjuam ora 7 dhe u nisëm më 8:15. Jemi në togë me Labinotin. Komandant toge Dashi. Ngjitemi nëpër lugun verior në drejtim të binjakut të Thethit. Në orën 10 jemi nëpër itinerarët të cilët janë caktuar nga Aci (*ishte përgatitur një "libër" me fotografi dhe përshkrime të itinerarëve të Shtegut dhe Majave Binjake, apo thënë ndryshe, majave Mark e Zagorë*) që në Tiranë dhe dyshet janë të ndara: Niko-Sokoli, Iliri-Dragushi, Mondi-Turi (për itinerarët shiko pasqyrën e rezultateve). Të gjitha dyshet punuan shumë mirë dhe në orën 11:30 ishim në majë. Në orën 12:15 filluam ngjitjet e dyta. Mondi u tregua i pasigurtë, Iliri me Dragushin bënë shumë gabime teknike, sidomos në ngjitjen e dytë. Në orën 14 mbaroi edhe ngjitja e dytë dhe u nisëm që të takohemi me anëtarët e tjerë të togës. U detyruam të prisnim deri në ora 15:30 një treshe të Elbasanit (Xh. Filipi. S.) të cilët nuk ia kishin idenë kacavarjes. Koha filloi të vrenjtet dhe ne po mbërdhinim shumë. Në orën 16 mbërritëm në kamp. Ecëm shpejt që të ngroheshim. Më 16:30 hëngrëm një drekë të shpejtë (vezë e

sallam të skuqur). Në ora 18 u mbledh shtabi. Në ora 23 filluan ca pika shi.

### 9.7.1979

Gjatë natës ka rënë shi, por jo shumë. Tani në mëngjes fryn erë dhe është ftohtë. Në ora 7:30 shiu pushon, por jo era. Koha filloi të hapet nga ora 10. Andoni vendos që të mos bëhen ngjitje meqë shkëmbinjtë janë të lagur. Ai porositi që të bëhet studimi i itinerarëve, gjë të cilën e bënë pak ekipe. Ekipi ynë nuk e bën studimin sepse që të shkohet deri tek majat binjake duhen gati dy orë. Çadra jonë e vendit ka futur shumë ujë dhe çunat janë lagur (Turi, Dragushi, Sokoli, Mondi). Këtu në Shteg janë ekipet: Skëndërbeu (Korça), Labinoti (Elbasani), Gjirokastra (Luftëtari), Puka (Përparimi), Tropoja (Valbona), Shkodra (Vllaznia). Ora 11 koha hapet dhe nuk ka më re, kurse era vazhdon të fryjë. I kërkoja Andonit të zbresë në Theth me Sokolin dhe çunat por ai nuk pranoi. Djemve të Gjirokastrës, teksa studionin itineraret I-1 dhe I-2, u ishte shkëputur nga lart një gur i madh dhe shpëtuan për qime pa u dëmtuar; por njëri prej tyre kishte dërmuar gjurin. Kështu të trembur ata nuk bënë ngjitje. Mbasdite rreth orës 15, Dashi i mori çunat dhe bëri ngjitje të vështirësisë së tretë tek Kalaja (*kjo është kreshta shkëmbore në veri e në vazhdim të Shtegut të Dhenve dhe që lidhen në shteg me majën me të njëjtin emër*). U kthyen ora 19. Djemtë punuan shumë mirë. Niko e Sokoli nuk bënë ngjitje sepse Andoni nuk lejoi të bëhen sot ngjitje të shkallës së pestë dhe gjashtë të vështirësisë, megjithëse tropojanët ngjitën I-7 që është e pestë.

Në darkë Andoni, rreth zjarrit, bën diskutime për atë se si duhet të jetë sporti i alpinizmit. Grupi i Thores nuk qëndroi aty duke ngritur si arsye mungesën e ujit të burimit, andaj dhe janë vendosur tek Kroi i Shtrazës. Andoni dhe Ligori (Grigor Perikliu)

vajtën për verifikim dhe thanë se burimi në Thore kishte ujë. Kot janë lodhur se me këtë shi që bie ujë ka.

### 10.7.1979

Koha shumë e mirë. Zgjimi në orën 7 dhe vonohemi për nisje. Andoni na tërheq verejtje, por bën gabim se nuk i lë çunat të kthehen në çadër pas rreshtimit dhe të mbarojnë mëngjesin. Kështu ata shkuan të pa ngrënë në ngjitje. Ai do që të vendosë rregull ushtarak në ngjitje, gjë që nuk bën. Niko e Sokoli bënë dy ngjitje: I-7 e pestë ku udhëhoqi Niko dhe I-4 e katërt ku udhëhoqi Sokoli. Por ne na rezultoi se ngjitja e dytë ishte më e vështirë se e para. Të tjerët punuan tek I-1 dhe I-2 në Shteg. Punuam tek Shtegu meqë janë më afër se majat Binjake. Sokoli punon shumë i sigurtë në shkëmb, por po mundohem që ai të përvetësojë sa më shumë elemente teknike. Morëm vesh se Marjo me pionerë kishte vajtur për xhirim filmi dokumentar në Jezerë. Mbasdite bëmë leximin e librit Shënime mbi Kinën (*të Enver Hoxhës*). Andoni tërhoqi vemendjen se lëshohen shumë gurë gjatë ngjitjes si dhe ceku egoizmin për kategori sportive. Ka shumë vështirësi për plotësimin e treguesve të ngjitjes (*formularëve*) dhe kjo për arsye sepse nuk kanë punuar trajnerët me alpinistët e tyre. Për nesër kemi pushim. Dëshirojmë të shkojmë në Theth, por kjo do varet nga koha dhe nga Andoni.

### 11.7.1979

Sot është ditë pushimi. Zgjimi ora 8. Ora 9 mblihdemi për analizë të ngjitjeve. Dashi: do bëjmë një analizë për ngjitjet. Të gjithë kanë bërë nga pesë ngjitje, përveç Nikos dhe Sokolit që kanë nga katër. Kjo është gjë e mirë, por Dragushi e Mondit duhet të jenë më të kujdesshëm. Na kanë mbetur edhe pesë ditë aktivitet e duhet punë edhe më e madhe. Ekipi ynë nuk ka



harmoni (komunikim) me ekipet e tjera, sidomos katër të rinjtë. Edhe brenda përbrenda Sokoli, Turi, Iliri, Mondi, Dragushi janë të veçuar. Duhet disiplinë. Respektoni të tjerët, e sidomos më të vjetrit në kamp. Duhet të bëhemi një ekip që të duket disiplina e vetëdijshme. Duhet të ruhem edhe nga gërvishtja më e vogël.

Andoni: kemi arritur të realizojmë programin. Dashi ka drejtuar mirë për realizimin e programit. Duhet të punohet teknikisht që të kemi siguri në vetvete dhe për shokun. Duhet disiplinë dhe edukatë. Ne duhet të ecim kompakt. Jeni të veçuar, sidomos katër të çadrës vendase (vendase *d.m.th çadër që është punuar tek Ndërmarrja e Mjeteve Mësimore dhe Sportive-Tiranë*). Tregoheni të ftohtë me shokët e ekipit. Duhet të ketë një dezhorn për ndezjen e zjarrit dhe për detyra të tjera. U hodh dëshira për në Theth. Kjo është dëshirë për të gjithë, por duhet program. Të realizojmë programin e pastaj shohim për të tjerat. Të vemi të gjithë në Theth. Ne mendojmë që ju të merrni sa më parë kategorinë e parë sportive.

Niko: Falenderoj të gjithë shokët që kemi në grup e të cilët janë të mobilizuar në mënyrë të tillë që kanë realizuar nga pesë ngjitje. Për katër shokët që u përmendën është e vërtetë që rrinë pak të veçuar. Ne jemi të detyruar që programin ta realizojmë brenda mundësive duke bërë tre ditë ngjitje e një ditë pushim. Për aktivitetin mendoj se është i shkurtër dhe i ngjeshur. Tetë ditë, tetë ngjitje.

Për çështjet teknike duhet punuar më shumë. Kujdes sidomos tek të rinjtë. Për ditën e pushimit të gjithë dëshirojnë të shkojnë në Theth ose në Kapre. Them se për këtë nuk ka gjë të keqe sepse të gjithë e kanë forcën fizike.

Andoni: çunat, që natën e parë nuk kanë ardhur tek zjarri, nuk duhet të nxjerrin pretekst që nuk kanë ardhur ekipet e tjera tek zjarri. Niko nuk e di përgatitjen fizike të secilit. Nuk është e thënë që të gjithë të bëjnë pushim

Se çfarë thuhet në Tiranë ne do ta shohim që ta zbatojmë. Dobësia në teknikë kapërcehet me sasi ngjitjesh. Kategorinë e dytë sportive duhet ta marrin të gjithë. Ne kemi ardhur këtu që të bëjmë çmos për të arritur kategorinë e dytë sportive (*ngjitjet këtu, në Shteg, të mundësonin të arrije edhe kategorinë e parë sportive si alpinist*).

Mbas mbledhjes bëme debat me Andonin që t'i lërë Turin, Mondin, Dragushin e Ilirin të shkojnë në Theth meqë sot është pushim. Ai nuk i la. Nuk ia mora vesh arsyen, ndonëse ai thotë se djemtë duhet të jenë të freskët për ngjitjet. Kur të mbarojmë me ngjitjet, ai do i çojë vetë në Theth.

Unë me Sokolin vajtëm. Mbërritëm në kampin e Thethit në orën 13. Vajtëm tek dyqanet, tek katarakti. Kur u kthyem tek kampi Thethit takuam Marjon (Trinkera) dhe na tregoi për ngjitjen me pionerët në Jezerë dhe për xhirimin e filmit. Kishin fjetur një natë tek Gropat e Bukura dhe të nesërmen kishin ngjitur majën. Takova edhe Shilin dhe më tha se i kishte bërë telegram Federatës për ndërrimin e vendit të veprimtarisë. Më erdhi zor ta pyesja se përse e kishin ndërruar vendin e ngjitjeve (m'u duk i mërzhitur). Deri në Thore u kthyem me makinë të rastit. Djemtë në Shteg kishin bërë demonstrime dhe u kishte mbetur hatri që Andoni nuk i la që të shkonin në Theth. Nesër mendoj të bëj me Sokolin I-8 meqë ndjehemi në formë.

## 12.7.1979

U ngritëm në ora 6 e, pasi mbaruam me punët e mëngjesit, unë e Sokoli në orën 7:20 ishim tek I-8, kurse të tjerët mbërritën më vonë tek itinerarët e tyre. Në ngjitje do të punojnë Niko, Sokoli dhe Robert Bici i Elbasanit. Sokoli priti të vinte Berti, por ai u kthye në çadër. Dhe në vend të tij u lidh Andoni. Punuam me dy litarë kolektivë të lidhur njëri pas tjetrit dhe kjo na ndihmoi

shumë. Djemtë e tjerë bënë edhe sot nga dy ngjitje dhe janë ambientuar mirë me terrenin. Sokoli, mbasi mbaruam ngjitjen, bëri edhe një ngjitje tjetër, një itinerar të shkallës së pestë të vështirësisë dhe udhëheqës. Në kamp u kthyem në orën 14. Koha shumë e mirë. Disa u lanë tek pellgu ku pijnë ujë bagëtitë. Me ushqimet jemi mirë. Dje në Theth blemë ca verë, por e pimë fshehurazi Andonit, se nuk i dihej se ç'do thoshte, ndonëse Aci na lejon të pijmë verë.

### 13.7.1979

Zgjimi si zakonisht. Vajtëm tek shkëmbinjtë dhe secili u fut në itinerarët e caktuar. Kemi vendosur që të mbarojmë sot ngjitjet e pastaj të bëjmë pushim. Unë nuk bëra ngjitje se isha pak i lodhur. Të gjithë çunat i plotësuan ngjitjet: Iliri – Dragushi bënë një ngjitje, Sokoli – Turi – Mondi bënë dy ngjitje. I vumë të punojnë të tre që të mësojnë të punojnë edhe në treshe mbasi kanë punuar dyshe në të gjitha ngjitjet. Dashi e organizon shumë mirë punën në shkëmb si dhe gjatë pushimit. Sokoli punon shumë mirë dhe i sigurtë. Mirë punon edhe Iliri. Arturi paraqitet dobët dhe ka frikë në shkëmb. Dragushi si për herë të parë ka punuar mirë, nuk ka frikë, është i bindur, por në çadër se ç'ka që ngatërrohet me Arturin. Më duket se ky i fundit e ka fajin, por le të shohim aktivitetet që do vijnë. Si alpinist ka perspektivë.

Poshtë itinerarëve të Shtegut ka salep dhe kemi mbledhur pak për ta provuar. Ka salep edhe sipër itenerarit I-11. Mbasditeve kemi bërë disa herë leximin e librit Shënime mbi Kinën. Tek zjarri ynë vijnë ekipet e tjera dhe nuk na lënë që të këndojmë. Për nesër nuk kemi bukë sepse makina që na kishte premtuar Federata nuk erdhi fare. Koha është ngrohur pak.

## 14.7.1979

Zgjohemi në 7 dhe rreshtohemi në 8. Në urdhrin e ditës u tha që çdo veprim do të bëhet nga komandantët e togave dhe trajnerët e ekipeve. Na u komunikua se një alpinist i ekipit të ..... kishte tentuar mbrëmë në orën 21 të vidhte një arkë me zarzavate të ekipit të Gjirokastrës (dhe të kujt!!), por ata e kishin kapur. E nxorrën para kampit. Shtabi kishte marrë vendim që ta përjashtonte dhe për më tej punën e tij ta shikonte klubi i tij sportiv. Dërguam në Bogë Mondin për bukë. Ngjitje sot nuk do të bëjmë. Këtë e vendosëm mbrëmë (për këtë pyetëm secilin nëse donte). Në Theth mendojmë të shkojmë nesër. Erdhën ata të Kroit të Shtrazës nëpërmjet Shtegut të Dhenve për të bërë ngjitje tek ne, por ata kishin marrë fund fizikisht që para se të arrinin. Nesër e kemi pushim dhe do të bëjmë analizën e ngjitjeve.

## 15.7.1979 e dielë

U ngritëm në orën 7. Koha po prishet. Analiza e togës sonë.

D. Fejziu: kemi punuar mirë dhe kemi kaluar mirë. Kemi bërë përpjekje për rritje në kategori sportive. Nga ekipi i Elbasanit janë dalluar Kujtimi e Xhevati. Ekipi i Elbasanit duhet të bëjë përpjekje për plotësimin me bazë materiale. Nga 17 Nëntori u dalluan Solkoli, Iliri, Niko. Mondin duhet të jetë më i sigurt në shkëmb. Si togë kemi realizuar 108 ngjitje. Kjo tregon punën e mirë të gjithë alpinistëve. Ju uroj për suksese të mëtejshme. Faleminderit për respektin që keni treguar ndaj meje.

Grigor Perikliu: kam mbetur i kënaqur nga kapërcimi i vështirësive për ngritjen e kampingut. Nuk kam parë asnjë keqkuptim dhe për këtë jam i kënaqur. Dashi ka punuar shumë mirë. Dua që gjithnjë të bashkohemi kështu. Ju uroj shëndet dhe suksese.

Robert Bici: jam shumë i kënaqur nga të gjithë. Në itinerarin I-8 u ktheva sepse më ra një gur dhe u shmanga. Por me përpjekjen time dhe të shokëve arrita ta realizoj këtë ngjitje. Uroj që vitin tjetër të realizojmë ngjitje të bukura dhe të jemi bashkë.

Sokol Doko: unë i realizova ngjitjet bashkë me shokët. Do përpiqem që ngjitjet e tjera t'i kryej me shokë dhe pa rrezeqe. Falenderoj të gjithë për shoqërinë që kanë treguar kundrejt meje.

Xhevat Osmani: kam mbetur i kënaqur nga ky aktivitet dhe kam ndjerë kënaqësinë e ngjitjeve. Dashi ka drejtuar shumë mirë në shkëmb. Për I-8 kam verejtje për të vjetrit që na e bënë gogol. Falenderoj ekipin e 17 Nëntorit për ndihmën që na kanë dhënë.

Dragush Kulheku: kam detyra të mëdha për ngritjen në kategori sportive. Falenderoj shokët për ndihmën që na kanë dhënë ne të rinjve. Ngjitjet u realizuan ngaqë shokët punuan me këmbëngulje dhe vullnet. Kishim harmoni me ekipin e Elbasanit. Do bëj stërvitje më shumë për rritjen e cilësive sportive.

Artur Gorishti: në aktivitet veror duhet të vimë me një përgatitje më të mirë teknike. Falenderoj Gorin dhe Dashin për drejtimin. Zotohem se do bëj përpjekje për rritjen e aftësive teknike me anë të stërvitjes.

Edmond Shametaj: aktiviteti veror është më i lodhshëm se ai dimëror. Që t'i kalojmë me sukses aktivitetet e tjera duhet që t'i tregojmë më tepër vemendje stërvitjes.

Thoma Xuxi: jam i kënaqur nga ky aktivitet. Ngjitjet i realizova si për herë të parë në aktivitet veror. Falenderoj shokët drejtues dhe ata të ekipit të 17 Nëntorit.

Filip Bërdufi: falenderoj drejtuesit e kampit dhe togës. Duhet punë më e madhe nga trajnerët për përgatitjen teknike. Duhet të bëjmë përpjekje për rregullimin e të metave. Suksese në ngjitje të tjera.

Unë, Sokoli, Turi, Dragushi u nisëm për në Theth dhe nuk arritëm të vinim në analizën e përgjithshme të ngjitjeve sepse pritëm një makinë ngaqë djemtë ishin të lodhur për t'u nisur në këmbë. Andoni me të drejtë na foli për këtë. Në analizë ishin thënë këto gjëra:

- Aktiviteti dhe ngjitjet shkuan mirë. U bënë 984 ngjitje, nga të cilat 47 kishte bërë ekipi ynë
- Ekipet që u dalluan ishin: Tërbuni (Puka), Labinoti, 17 Nëntori, ekupe që janë të togës së dytë me komandant Dashamir Fejzo. Duhet të punojnë më shumë Skënderbeu dhe Luftëtari.
- U shpallën individët më të dalluar në bazë ekipi. Nga ekipi ynë u shpallën Niko Petro dhe Sokol Doko.

Në analizë diskutoi Eqerem Reso dhe tha që “dëshiroj të dëgjoj një të ri që mori pjesë në aktivitet të tillë për herë të parë”. Kësaj kërkesë iu përgjigj Eduard Shامتaj i 17 Nëntorit, i cili tha: “unë mora pjesë për herë të parë dhe kam punuar me të gjitha forcat në të gjitha drejtimet dhe falenderoj shokët që na kanë



Ekipet e 17 Nëntorit dhe Labinotit, korrik 1979

drejtuar mirë në çdo situatë. Angazhohem për një stërvitje më intensive që të arrij rezultate të mira në ngjitjet e ardhshme”.

Dashamir Fejzo falenderoi alpinistët e togës për bindjen dhe respektin që treguan ndaj tij për zbatimin e rregullave të ngjitjes.

### 16.7.1979 (e hënë)

Koha është shumë e mirë. Zgjimi më 6 dhe më pas ngrënia e mëngjesit dhe përgatitja e çantave për të vajtur në Fushë Okol ku mbërritëm në orën 9. Autobusi erdhi vonë dhe ne ishim në Shkodër në ora 17. Nesër do të nisemi për në Tiranë.

Rezultatet e ngjitjeve janë:

Niko Petro: I-12 Binjaku i Thethit, I-2 Binjaku i Bogës; në Shteg: I-7, I-4, I-8.

Illir Tapia: I-1 Binjaku i Thethit, I-5 Binjaku i Bogës; Kalaja: I-2, I-4, I-3; Shtegu: I-1, I-2, I-4, I-11

Sokol Doko: I-2 Binjaku i Thethit, I-12 Binjaku i Bogës; Shtegu: I 1, 4, 8, 11, 10, 9

Atrur Gorishti: I- 1, ^ Binjaku i Thethit, Kalaja: I-2, 3; Shtegu: I-1, 7, 4, 10, 9

Dragush Kulheku: I-1 Binjaku i Bogës, I-5 Binjaku i Thethit, Kalaja: I-2, 3, 4; Shtegu: I-1, 7, 4, 11.

Edmond Shametaj: I-1, 6 Binjaku i Thethit; Kalaja: I-2, 3; Shtegu: I-1, 7, 4, 10, 9.

Dashamir Fejzo I-8 Shtegu; Andon Tapia I-8 Shtegu.

Sa më sipër janë marrë nga pasqyra e aktiviteteve. Si ekip kemi bërë 49 ngjitje me mesatare vështirësie 3.9. gjatë kësaj veprimtarie koha ka qenë shumë e mirë dhe ditët për ngjitje janë shfrytëzuar mirë.

*Mbajtësi i Ditarit Niko Petro*

## Veprimtaria 18 – 27 korrik 1979 Qafë Pejë

|                    |            |
|--------------------|------------|
| Aleksandër Bojaxhi | 17 Nëntori |
| Shefki Juma        |            |
| Romeo Manxhari     |            |
| Kristaq Korçari    |            |
| Azem Hyka          | Partizani  |
| Eduard Sheldia     |            |
| Kujtim Onuzi       |            |
| Kozma Grillo       | Studenti   |
| Vladimir Memisha   |            |
| Maridon Hito       | Dajti      |
| Kujtim Gjylbegu    | Vllaznia   |
| Qemal Zaganjori    |            |
| Avdyl Rëshketa     |            |
| Shuaip Isufi       |            |
| Nuredin Seci       | Valbona    |
| Taxhedin Shehu     | Korabi     |
| Qemal Hakorja      |            |
| Adil Manga         |            |
| Besnik Kica        |            |
| Qemal Biçaku       | Labinoti   |
| Petraç Kule        | Tomori     |
| Jani Qendro        |            |
| Stefan Kule        |            |
| Venigjar Velaj     | Flamurtari |
| Servet Aliko       |            |
| Koço Ziso          | Skëndërbeu |



## Biseda me Edi Sheldinë

### 1.

Ka hequr pikën e zezë tek I-6 në katarakt. Arsyeja: drejtimi nga poshtë pa përgjegjësi.

Pak eufori nga Edi për formë të mirë, rezultat, etj.

Jo qartësi itinerari në nisje.

Është dëmtuar nga sytë pas veprimtarisë dimërore 1978.

Nga ngjitjet dimërore veçon Alinë më 1978 si më e bukura. E bukur për pjerrësinë, llojin e borës, veprimet teknike të sakta, harmoni në punë (veprimet).

Pyetjes nëse ka bërë vetë ndonjë itinerar origjinal i përgjigjet “jo”. Pse? Sepse e ndjen veten gjithnjë ushtar. Kam dëshirë të bëj diçka vetë por më duket se gjithnjë do të më urdhërojnë të tjerët.

Nuk e shfaq veten edhe gjatë një ngjitjeje sepse i duket vetja se ka shumë komandantë më të vjetër, etj. Do dukej se do i thonë “përse shet mend”, “përse e gabove itinerarin”, etj.

Unë: nuk i lejojmë originalitet këtyre njerëzve, pra alpinistëve.

## Biseda me Petraq Kuli

Rast përjashtimi nga kampi i Mit’hat Fagut sepse pa leje u ngjit në Vishens pas ngjitjes në Radohinë.

Koço Qafëzezi u rrëzua (me gjermanët) pas ngjitjes në Arap. Mungesë këpucë, kazëm, etj. Duhet të shmanget kalimi i zonave me borë.

Djegia e çadrës së Beratit në aktivitet. Lodhur, ftohtë, lënë furnela ndezur, goditur me këmbë në gjumë. U derdh vajguri e u dogj.

Ngjitje të bukura me gjermanët në Arap.

Dimrore (më e bukura) kalimi i Brijasetit (*traversa nga Q. Boshit – Brijas – Valbonë*) dhe kreshta e Tomorit.

.....

Në këtë veprimtari kemi ardhur me grupim të veçantë ushqimesh. Unë, Shefkiu, Romeo bashkë. Kiçka është veçan dhe pjesën më të madhe të kohës së lirë e kalon tek Studenti.

Na u desh të prisnim ditë deri sa të na vijnë materialet nga Boga në Theth. Me sakrificë rregulluam mushkat dhe dolëm në Qafë Pejë dy ditë më vonë nga ekipet e tjera.

Më dt 21 ngjitëm: unë, Shefkiu (udhëheqës) Romeo itinerarin në Malësore në të pestën me tavan.

Më dt 22 ngjitëm: një të gjashtë në Koletë, sipër. Na erdhi Serveti për të parë.

Pas kësaj dy ditë rresht koha ishte e keqe. Ditën e tretë ngjitëm majën e Shtogut: Aleksandri, Shefkiu, Romeo, Azemi, Kujtimi, Q. Biçaku.

.....

## **Biseda me Koço Ziso**

Mars 1968 drejtues K. Grillo e P. Kule. Sulmuam Radohinën në dy drejtime. Pas kësaj zbritëm në Theth e u nisëm për Jezerë. Grupi i Kozmail: Kozmai, Shili, Koço, V. Nasto, A???, A. Hyka, N. Stamo, V. Ristani.

Mars 1978 K. Ziso, etj., 6 veta.

## **Biseda me Azem Hyka**

Jezerë 1968, Mars, Kozmai komandant; 9-10 veta, Tiranës + Skënderbeu.

1969 dy treshe ekipi Partizanit

Çardaku, më e bukura e dimrit

Arapi, më e bukura e verës.

## Biseda me Kujtim Gjylbegu

Në Jezerë Dimër i vitit 1973 ose 74, shkurt. Kom. Grupi.  
Drejtues V. Ristani ose T. Shehu, 20 veta

Ngjitje më e bukur dimërore, Çardaku 1978

Asht ngjit vetëm me Dylin në aktivitet kombëtar.

Ngjitja më e bukur në verë Papingu në masivin qëndror.

.....

## Përsëritje ditari

*(Sa më poshtë është veprimtaria alpinistike e vetme e zezë, në kuptimin social, që kam përjetuar në mal. Kishte ca kohë që nëpër zyrat e lëvizjes sportive në Tiranë ishte shuar qëndrimi klasor – lufta e klasave – ndaj meje. Por në grupimin tonë këtu, bashkë me mua, qëndronin e merrnin pjesë në veprimtari dy alpinistë të cilët kishin shkuar në zyra të sektorit të sportit, në shkollën ku jepja mësim, në komitete partie të rajonit dy, e ku di unë dhe kishin “ndihmuar” partinë dhe ekzekutivin me dokumenta të mjaftueshme që provonin se unë, si djali i një armiku të popullit, duhej të largohesha nga sporti i alpinizmit (në Tiranë janë edhe dy alpinistë të tjerë të këtillë që mungojnë në këtë veprimtari). Mirëpo qëndrimi dhe mbështetja që pata nga drejtuesit e klubit sportiv që përfaqësoja bëri që këta ta humbnin “betejën”. Tashmë, si duket, u kish mbetur me mua ballafaqim i një lloji tjetër: të më shqetësonin nëpërmjet qëndrimeve e sjelljeve jo sportive. Grupi ynë, i tiranasve këtu, kish edhe dy a tre të trembur. Sa më sipër u bë bazë, apo mbështetje që të krijoheshin rrethana aspak sportive të përjetuara nga unë, por jo vetëm nga unë, si të zeza. Me koshiençë dhe aq sa do e shoh të arësyeshme i kam hequr hollësitë e zeza nga ditari – sepse është ditar i mbajtur nga unë - që të dalë sa më në pah ana sportive.*

## Ngjitjet e sezonit veror; 18 – 27 korrik 1979

Pjesëmarrësit:

1. Aleksandër Bojaxhi
2. Shefki Juma
3. Romeo Manxhari
4. Kristaq Korçari

### 16 Korrik

Pasdite, ora 17:35 nisemi me tren e më pas me autobus për në Shkodër. Këtu na priti ekipi ynë që mori pjesë në ngjitjet e kategorive të ulta si dhe alpinistë të ekipeve të tjera. Me ndihmën e anëtarëve të ekipit tonë që do kthehej në Tiranë pasi ka përfunduar ngjitjet, çuam materialet në hotel si dhe bëmë këmbime (plotësime) materialesh. Ramë vonë për të fjetur, në Hotel Adriatik. Fjetëm keq. Ka çimka. Shefkiu doli jashtë e fjeti në lulishte. Ne të tjerët e lamë të ndezur dritën e dhomës.

Nga ekipi ynë që porsa ka përfunduar ngjitjet, sipas thënieve të tyre konstatoj:

1. Kanë punuar mirë.
2. Kanë bashkëjetuar mirë.

Vërej se:

1. Mund të punonin dhe jepnin rezultate shumë më të mira sikur të mos ishin dhënë aq shumë pas pushimeve nga aq sa janë dhënë.
2. Baza materiale është keqpërdorur: kanë humbur 4 karabina, furnela është kthyer e papastruar, trikot janë të nxira nga kusia (e papastruar), gozhdët/plengat të pa drejtuar, çadrat të pa pastruar e të pa arnuara, etj.
3. Duhet punë në drejtim të kujdesit për materialet.
4. Dashi nuk ka punuar për rritjen e tij personale në kategori sportive: nuk është treguar ngulmues.

## 17 korrik

Jemi zgjuar “që kur kemi rënë për të fjetur” (prej çimkave). Përcollëm ekipin dhe më pas kaluam ca çaste të mira me pukjanët. Më duket se këta kanë punuar më mirë se kushdo në ngjitjet që sapo përfunduan me kategoritë e dyta (*në këtë kohë trajner/drejtues i ekipit ka qenë Gëzim Laçi*).

Pasi blemë edhe ca gjëra të tjera (ne, sa më shumë të na i vonosh nisen, aq më shumë blejmë!) u nisëm me shumë vështirësi, me gjithë materialet, deri në Bogë. Aty ekipi ynë dhe ai i Shkodrës, lamë materialet bashkë me Kiçkën, Dylin dhe Shuaipin. Arritëm në Theth. Një “ZUK” (*kamionçinë e prodhimit Polak*) i Klubit Sportiv Studenti që do të merrte (transportonte) materialet tona, duke u nisur nga Thethi, nuk e bëri këtë punë. Ne fjetëm në Theth tek Fran Micani.

## 18 korrik

Disa ekipe u nisën për në Q. Pejë me mushka. Në darkë dy shkodranët që janë në grup me ne u nisën për në Bogë pasi materialet janë ende atje. Klubi Sportiv Vallaznia, të cilin ne e morëm në telefon, nuk na ktheu përgjigje. Përsëri fjetëm tek Fran Micani.

## 19 korrik

Klubet Studenti e Flamurtari u nisën për Q. Pejë. Ne përsëri jemi në pritje. Telefonuam Komitetin e Fizikulturës në Shkodër. Na premtojnë se do niset një makinë mallrash për materialet që kemi në Bogë. Në fakt një makinë e tillë nuk u duk. Materialet tona arritën në Theth në orën 18:15 me një makinë të gjeologjisë. Shoferi na morri vetëm 100 lekë. Fshatarët na kanë premtuar për nesër pesë mushka.

## 20 korrik

Në mëngjes na lajmërojnë se vjen zv/ministri i mbrojtjes Sh. Veli Llakaj. Kjo d.m.th se të gjitha mushkat e fshatit janë në dispozicion të tij. U dogjëm!

Në orën 10:10 makina e gjeologjisë na çon deri tek Kroi i Shtrazës. Me shumë mundime, me ndërhyrjen e Idrizit të Grizhës (*kooperativa buqësore e fshatit Grizhë shfrytëzonte prej shumë vitesh kullotat rreth Sheut të Bardhë. Idrizi ishte përgjegjësi i ekipit/brigadës së blegtorisë dhe e kalonte kohën e shtegëtimit të bagëtive aty*) si dhe kafsharit me emrin Zog materialet tona mbarten nga Kroi në vendin e kampimit (*kampimi ynë në zonën e Sheut të Bardhë vendosej gjithnjë në perëndim të burimit – sepse ne nuk duhej të vendoseshim më pranë vijës së kufirit nga sa ishte vendqëndrimi i postës kufitare. Por lejoheshim të qëndronim sa më pranë burimit, sepse ushtria, ne dhe brigada e blegtorisë e përdornim burimin – Sheu i Bardhë. She quhet çdo burim/përrua që ka ujë gjatë gjithë vitit*). U nisëm në orën 17:00 dhe mbërritëm në orën 20:00. Shumë falenderime fshatarëve të Grizhës! Turp për Shkodrën, si vend organizator, si dhe për Federatën tonë, që ne shpenzojmë pesë ditë për të lëvizur nga Tirana në Q. Pejë.

## 21 korrik

Të gjithë alpinistët kanë pushim. Ekipi ynë (pa Kiçkën) dhe ai i Vllaznisë bëjnë ngjitje. Ne u ngjitëm (Aleksandri, Shefkiu, Romeo) tek Malsorja në itinerarin me tavan të shkallës së pestë të vështirësisë. Ngjitja kaloi shumë mirë.

Tani sapo kemi ngrënë drekën dhe Romeo po na përgatit darkën. Kiçka nuk është në jetë kolektive me ne të tre. Ushqehet vetëm dhe, me raste, me ekipin e Studentit. Ushqimet tona të ambalazhuara kanë arritur shumë mirë, përjashtuar sallamin e llojit ‘llukanik’.

## 22 Korrik

Koha mjaft e mirë. Në orën 8:15 nisemi për ngjitje. Shkojmë në krahun e majtë të kreut të cirkut të Kolajve, në itinerarin I-2 që pata punur më parë me K. Zison. Na u desh që të ngjitemi gati 40 metra me litar nëpër borë të ngrirë që të arrinim në rrëzë të shkëmbit. Kthetrat dhe këpucët me qafa na hynë në punë. Shefkriu punoi udhëheqës. U ngjit mjaft bukur, sidomos pasi kaloi diedrin (dyfaqëshin) ku mori djathtas lart nëpër pllaka dhe të dala tepër të vështira. Romeo u ngjit i dyti. Na ngeci disa herë litari. Duhej që nën-daljet (sqeta) të vendoseshin nga dy karabina, gjë që ne nuk e bëmë (*në atë kohë nuk njihej-më saktë nuk ishte shpikur- nga ne larguesi dhe në vend të tij përdornim dy karabina*). Pothuajse gjatë gjithë ngjitjes asistoi Servet Aliko, i cili më pas, nëpër lugun e thjeshtë, doli në kreshtë ku u rigrupuam. Ngjitja për një litar ishte tepër e vështirë: e shkallës së e gjashtë B të vështirësisë. Prej kreshtës shkuam në majën më të lartë të bllokut. Aty, unë, para disa vitesh kisha gdhendur inicialet 17 N, të cilat sigurisht nuk ishin prishur. Aty lamë shënimet e rastit, bëmë disa fotografi dhe u ulëm poshtë.

Kur po drekonim tek çadrat, nga maja e Arapit dëgjuam thirrje. Pas dy orësh u kthyen 10 vetë nga Arapi. Kujtim Onuzi dhe Eduard Sheldia kishin tentuar ngjitjen e kontrolluar në Arap. Kishin vajtur deri tek guva ku kishin tentuar të kalonin majtas dhe kishin ngecur. Kur u nisën unë i udhëzoja për itinerarin dhe u theksova disa herë që të merrnin djathtas (*aty duhet të kalohet djathtas, por duhet t'i largohesh shkëmbit. Kjo "dalje" kacavarësve u duket se nuk jep rezultat, etj.*). Ata më thanë se nuk e mbanin mend këtë gjë, por as edhe hollësi të tjera të itinerarit (!) që u kisha shpjeguar. Ndër "asistentët" e ngjitjes ishte edhe M.H i cili e kishte realizuar këtë itinerar duke kaluar djathtas, pasi kishte ngecur dhe kaluar një ditë të tërë në tentativën e tij për të kaluar

majtas. Dihet se kacavarsit gjermanë patën kaluar djathtas (1969), unë me dy shokët e mi (Nasi Shtëmbari e Vangjel Zeno) kaluam djathtas. Përse nuk ju tha këtyre djemve që të kalonin djathtas?!

Tek e fundit dy djemtë i ngjitën si kovë nga e majta e guvës duke i tërhequr me litar nga lart. Ata thanë se në të majtë të guvës, ku i ngjitën, shkëmbi është krejt i larë dhe ishte absolutisht i pakalueshëm.

Në darkë Kozmai mbledhi shtabin, dyshen që tentoi itinerarin, si dhe MH, AH dhe mua, si alpinistë që e kanë kaluar këtë itinerar. Biseda filloi ters.....

Kozmai ngriti këto versione në diskutim: 1. Ky itinerar po të jetë se është realizuar më parë dhe nuk realizohet sot, atëhere: a. ose do pranojmë se sot alpinistët janë më të dobët se ata të mëparshmit; b. ose kjo ngjitje nuk ka qenë realizuar.....

Në diskutimin tim shpreha bindjen se ajo dyshe po të marrë djathtas ka forca që ta realizojë itinerarin. Shpreha gatishmërinë edhe për ta drejtuar ngjitjen po qe nevoja.....

Kiçka sot ka ngjitur një të pestë në Prozhëm.

## **23 korrik**

Kohë e ftohtë, me mjegull të dendur dhe hera-herës nga pak shi. Rimë tërë ditën brënda në çadër; gatuajmë. Në darkë, për një bateri elektriku, Romeo e Shefkiu patën një konflikt të vogël por pa dëm dhe që kaloi shpejt.

## **24 korrik**

Koha sikundër dje. Dje Romeo ka patur ditëlindjen, 25 vjetorin, por ne kemi harruar. Unë e Shefkiu dolëm dhe mbledhëm kërmij të cilët i gatuam për drekë. Kështu që shtuam “asortimentet” e drekës së ditëlindjes.



## 25 korrik

Koha e keqe por më e mirë se ditët më parë. Nisemi për pushtim majash. U pushtuan Jezera, Poplluka, Prozhmi (*në rastet me mot të papërshtatshëm për kacavarje, pushtimi i majave "të pushtuara" më parë praktikohej për të patur trupin në lëvizje*). Aleksandri, Shefkiu, Romeo, Azemi, Kujtimi, Q. Biçaku u ngjitën në majën e Shtogut, nga jugu, kategoria e dytë e vështirësisë. Kiçka jo. Këto tre ditë Azemi ka ndenjur afër me ne.

## 26 korrik

Koha mjaft e mirë. Hasëm vështirësi për të fituar të drejtën që sot ekipi ynë të ngjitet në Kolaj tek itinerari I-2, i shkallës së gjashtë të vështirësisë, i kontrolluar për Kandidat Mjeshtër Sporti (*kështu quheshin ngjitjet e kushtëzuara për të fituar rritje në kategori sportive*). Kozmai sot nuk po tregohet shoqëror.....!?

.....Romeo e Shefkiu punuan mirë, por pas dy litarësh ngjitje, me iniciativën e gabuar të Shefkiut, pesë litarët e tjerë të ngjitjes deri në majë ata u ngjitën të zgjidhur nga litari sigurues. Kiçka ka bërë pushim.

Sot Marjo (i ekipit të Dajtit) dhe Azemi (i ekipit të Partizanit) realizuan itinerarin lindor (VL?) të Arapit, atë ku dështuan Kujtimi me Edin. Punuan mirë. Deri tek guva udhëhoqi Azemi. Më tha që deri aty (dy litarë) e ka bërë për 40-50 minuta. U lumtë! Mjaft bukur!

Mendoj se do të ishte më sportive e më njerëzore që ngjitja të ishte kryer kështu: ose nga vetëm një treshe: Azemi, Kujtimi, Edi (*treshe me alpinistë të ekipit të Partizanit*); ose nga dy dyshe: Azemi e Edi dhe Marjo e Kujtimi. ....

Mendoj se ekipi i Partizanit ka forca për të arritur suksese kolektive me anëtarët e ekipt. Ndoshta Partizani kurrë më nuk

do paraqitet në aktivitet herë tjetër me treshe kaq të mirë (*Azemi, Edi, Kujtimi*).

Pasi mbaruam ngjitjen, unë Romeo e Shefkui vendosëm që nesër Shefkui e Kiçka të punojnë në I-4 që (*me realizimin e kësaj ngjitje*) Kiçka të marrë titullin Mjeshtër Sporti. E biseduam këtë me Kiçkën, por ai kishte rënë në ujdin paradite me Servetin, teksa ndiqnin ngjitjet në I-4.

## 27 korrik

Kiçka sot do të bëjë ngjitjen e kontrolluar për Mjeshtër Sporti në I-4 me Servetin. Kërkojmë nga Kozmai që I-4 -ën ta bëjë edhe Shefkui me Romeon, por ai nuk pranoi. Kjo të habit! Ai thotë “s’ka ç’u duhet kjo ngjitje. ....

Megjithatë ne nisemi për atje dhe e bëjmë fakt të kryer, por nuk na jepet komision apo njeri që ta ndjekë këtë ngjitje. Kërkojmë ta ndjekë Azemi meqë është njohës i këtij itinerari. Pas një diplomacie vulgare me Kozmanë arrij që në prezencën e tij të marr Azemin e të nisemi tek itinerari.

Ngjitja filloi e pas dy litarësh punë (ngjitje) Azemi nisët për tek Kozmai nga ku me dylbi mund të ndiqte vazhdimin, kurse unë dola në faqen tjetër të shkëmbit (*itinerarit*) për të ndjekur punën (*ngjitjen*) më nga afër.

Pasi prita rreth një orë dhe nuk doli askush nga ngjitesit aty ku pritej, i shqetësuar dola përsëri tek fillimi i itinerarit. Ç’të shoh: Shefkui kishte marrë drejt e lart në zonë të vështirë. Pas një debati të pafrytshëm me Shefkun, nuk arrita që ta kthej nga itinerari, megjithse një gjë e tillë ishte e mundshme që të bëhej nga ai. Shefkui donte që të vinte rishtaz Azemi (*në rolin e vëzhguesit si një individ i një ekipe tjetër*) apo kushdo tjetër që të vlerësohej kjo punë e re dhe e vështirë (*që kishte bërë*).

.....  
 Ngjitja përfundoi me sukses dhe ishte shumë e vështirë.  
 .....

Sot Kiçka me Servetin e realizoi itinerarin I-4. Besoj se tani asgjë nuk e pengon atë që të marrë titullin Mjeshtër Sporti. Kur u kthyen e uruam. *(kur u diskutuan titujt që do të jepeshin pas kësaj veprimtarie në Komisionin Teknik- unë kam qenë prezent - për Kristaq Korçarin u vendos që ky titull t'i jepej një vit më vonë dhe për vitin në fjalë titulli t'i jepej Koço Zisos. Ky i fundit nuk i kishte të realizuara ngjitjet që kërkonte titulli sikundër i kishte Kristaqi, i cili ishte edhe më i hershëm në këtë lëvizje dhe për pasojë kishte më tepër si ngjitje ashtu edhe përvojë. Argument përparësor që titulli t'i jepej Zisos ishte "sepse Korça si qytet nuk ka asnjë mjeshtër në sportin e alpinizmit!! Ky arsyetim kujtdo besoj se i duket skandaloz. Për më tepër, nuk do prishej lëvizja fiskulturore nëse do jepeshin dy tituj Mjeshtër Sporti për alpinizmin: një për Kiçkën e një për Koçon. Vlen të shtoj se Kristaq Korçarit kurrë nuk ju dha ky titull.).*

Koha u prish keqas sapo u kthyem të gjithë nga mali. Në darkë, me Servetin bëmë një katërshe (lojë me letra) të këndshme në çadër. Kiçka gjatë gjithë kësaj kohe fle me Romeon.

## Korrik, 28

Në orën 11:00 jemi ulur tek Kroj i Shtrazës. Këtu është kohë e mirë. U rruam të gjithë. U bë analiza. Asgjë e veçantë: u vlerësua Partizani ekipi më i mirë. Doli se *(itinerari i kryer nga ekipi ynë dhe i vlerësuar i shkallës së gjashtë të vështirësisë)* e gjashta jonë ish vlerësuar nga të tjerët e pestë A. Pas 18 vjetësh përvojë kacavarje doli një vlerësim itinerari i kryer nga unë *(ekipi ku isha unë)* që vlerësohet më shtrënguar *(më pak)* nga vlerësimi i bërë nga unë. Pra del se, pas 18 vjetësh, unë vlerësova lirë! .....

Megjithatë vlen të dimë se alpinizmi nuk mbaron këtu. Puna, çështja më saktë, është që ne kënaqemi me ngjitjet, e mbi të gjitha të punojmë mirë dhe drejtë (*për kënaqësinë tonë*).

Pasdite vajtëm tek kampi i punëtorëve. Kiçka nuk erdhi megjithëse kemi dy ditë që kemi rënë në ujdi, që të katërt, që të shkojmë atje. Ngritëm çadrat tek livadhet e postës kufitare, gatuam shumë gjellë, bëmë dush, lamë rrobat të cilave edhe u dhamë një hekurosje dhe u kënaqëm me bukurinë dhe qetësinë e mjedisit aty përreth. Pas nesh erdhën aty edhe mjaft alpinistë të tjerë. Konkluzione:

1. U treguam mjaft kompaktë gjatë ngjitjeve që bëmë.
2. Punuam mjaft mirë në shkëmb dhe ndoshta realizuam si litarë ngjitjet më të mira për Klubin tonë deri më sot.
3. Shefkiu punon mjaft mirë në shkëmb, por do trajner nga mbrapa.
4. Romeo mirë, por i do thyer edhe **më** ndrojtja nga thellësia si dhe të ngrihet në përgatitje fizike.
5. Unë në fakt isha më tepër ambasador pranë Komandës për t'i dhënë punë ekipit se sa alpinist (sidomos në pjesën e dytë të kohës së veprimtarisë).
6. Si ekip ishim në përgjithësi më i miri, pas Partizanit, për punën në shkëmb.
7. Ka filluar hapur (kështu më duket) një sulm e cmirë ndaj 17 Nëntorit. ....
8. Nga ne duhet një koncentrim litarësh pune në shkëmb (!?) dhe sa më shumë elementë me kompaktësi veprimesh e mendimesh në ekip.
9. Vlen të ndërmarrim realizime (*itinerar*) të reja origjinale e të përsërisim ato me vlerë. Kjo do bërë jo me aq modesti sa po mundohem të imponoj unë në punën e ekipit. Kjo modesti egzistuese duhet të gjejë shesh publikimi

midis alpinistëve dhe axhitacion figurativ në qytet dhe propagandë në shtyp.

10. Të evidentohen vlerat teknike e fizike të alpinistëve të ekipit dhe të errësohet disi vlera ime si alpinist duke e kaluar këtë në pozicionin si trajner.
11. Mbi të gjitha vlen të konsiderohet më tej fryma kolektive në çdo aspekt të jetës sonë në mal.

*Mbajtësi i ditarit Aleksandër Bojaxhi*

# Viti 1980

Shkurt, Valbonë  
Aleksandër Bojaxhi  
Kristaq Korçari  
Mario Trinkera  
Dashamir Fejzo  
Niko Petro  
Romeo Manxhari

## 2 shkurt

Udhëtimi nga Tirana në B. Curri. Udhëtimi direkt me autobus (*pra jo me segmente te tilla si tren, autobus, traget, etj.*) ishte mjaft i mirë, komod, me pushime të shumta e me interes për kalimin nëpër Fierzë. Koha e udhëtimit: 06:30 – 17:00. Pritja në B. Curri mjaft e mirë. Nuredini e Haziri ishin interesuar mjaft. Nuk është vetëm interesimi por edhe një ndërthurrje me mikpritjen.

Për arsye të zhvillimit të një loje ushtarake hotelet ishin mjaft të ngarkuara dhe një pjesë e alpinistëve u sistemuan në fshatin Bujan.

Një mikrobuses me gjashtë alpinistë arriti në 01:30 (pas mesnate). Janë dy nga Studenti, dy nga Korça, Kiçka si dhe Kozmai që vjen këtë rradhë si përfaqësues i ministrisë.

### 3 shkurt

Mblidhemi në palestrën e shkollës, ku Kozmai rihap problemin e ndarjes në grupe. .... Më së fundi çdo gjë normalizohet.

Ora 11:00 nisemi e autobusi na çon deri në Dragobi. Na përcolli deri aty edhe Kozmai që më pas u kthye. Me ne është edhe Ndue Ukcama, gazetar. Ai do të filmojë gjëra të sajura sa për të dhënë një kronikë në TV.

Ra mjaft shi e borë dhe ne na shkoi e gjithë dita duke kërkuar kafshë transporti. Gjetëm disa dhe nisëm 10 vetë nga ata të grupit të Rrogamit. Të tjerët u shpërndanë nëpër baza. Unë, Marjo e Nuredini vajtëm tek shtëpia e shitësit të Dragobisë, Ram Smajlit, i cili është mik i Nuredinit. Kaluam mjaft mirë.

### 4 shkurt

Aty nga ora 09:00 u nisëm të gjithë për rrugë drejt Valbonës ku arritëm më 12:00. Morëm kontakt me njerëz në fshat dhe rregulluam edhe një orë rrugë për grupin tonë duke na i çuar materialet deri aty ku fillon e përpjeta për tek Buni i Ziçit. Pas një pushimi prej rreth një orë, ngarkuam çantat dhe u nisëm për në Bun. Arritëm aty nga ora 17:00. U sistemuam dhe mbetëm aty ne të 17 Nëntorit dhe Qemal Biçaku. Nuredini me Hazir Malajn u kthyen për të marrë materialet e mbetura, kurse Kiçka dhe beratasit nuk u ngjitën. Ndezëm një zjarr të dobët.

### 5 shkurt

Kemi fjetur jo keq (nuk patëm ftohtë). Pasi vjen Nuredin Seci dhe Haziri (sipas fjalës ne do i prisnim në mëngjes) aty nga ora 08:30 nisemi për në drejtim të majës Gryk e Hapt. Koha është përmirësuar mjaft. Bora nuk para mban. Ndjekim itinerarin e zakonshëm dhe për llojin e borës që është, me temp të lartë. Në afërsi të majës, kur fillon pjesa buzë geminës, Haziri nguroi.

Kjo bën që ai, Dashi e Qemali të tërhiqen. Kështu që në majë arritëm në orën 13:30 unë, Romeo, Marjo, Nuredini e Niko. Bëjmë “ceremoninë” e rastit dhe ulemi poshtë. Aty nga ora 17:00 jemi në kamp. Unë, Marjo, Nuredini dhe Haziri, gjatë ngjitjes, kontrolloam edhe shtegun e uljes për në Lugbat. Duket shumë normal.

Në kamp kanë ardhur edhe shokët e tjerë të togës sonë që kanë ndezur një zjarr të mirë. Nuredini e Haziri duan të ulen rishtaz në Valbonë por unë ja u shtyva uljen për nesër.

## 6 shkurt

Bie shi e borë. Mot i keq ka nisur që natën aty nga ora 23:00. Na ka lagur keqas. Nuredini, Vullneti e Haziri përgatiten për ulje por unë duke parë shënja të një përmirësimi moti e prapësoj nisjen e Hazirit (sepse Haziri i njeh mirë malet këtu) dhe i porosis shokët që të nisemi drejt majave Çet Harushe e Peçmare. Nuredini e Vullneti ulen poshtë kurse ne në ora 10:00 nisemi për në majë. Fillimisht, për 45 min, marrim rrugën për në Grykat e Hapta pastaj kalojmë majtas në një shteg rrëzë shkëmbit e biem (*dalim*) në 2/3 e lartësisë së lugut që zbret nga qafa midis Gryk e Hapt e Çet Harushës dhe që është me rreziqe orteku. Mbajmë anën e djathtë të kësaj gryke e dalim në Bjeshkëz – një cirk mjaft i bukur mes majave të Grykave të Hapura, ....., Çet Harushe e Peçmare. Këtu Gryk e Hapt ka faqe të pingulta, të thikëshme, rreth 200 metroshe. Është një vend i mrekullueshëm për hotele malore. Ka shteg të mirë kalimi edhe me kafshë nga ana e Mbas Kollatës (!?). Është vend i bukur për ngjitje shkëmbore për në Grykat e Hapta si edhe për ski.

Mes mjegullës, që herë pas here hapet, arrijmë në Çet Harushe më 13:20 dhe me kohë më të mirë në Peçmare më 15:00.





Shkurt 1980. Aleksandër Bojaxhi, Mario Trinkera, Romeo Manxhari, Niko Petro

Kthehemi nëpërmjet Grykës së Hapt (nga merr emrin maja pranë) në kamp më 17:30. Aty kemi çaj të bollshëm që e kanë përgatit Dashi (nuk erdhi sepse i dhëmbin këmbët), Kiçka e Toli që u kthye nga ngjitja. Pas pak arritën Nuredini e Vullneti që kanë sjellë edhe një sopatë. Zjarri është i bollshëm e thahemi mirë. Era fryn nga mali në luginë, gjë që flet se do kemi mot të mirë.

## 7 shkurt

Dielli në lindje ka zënë majat; shenjë kjo që Valbona të paktën para dite do të ketë mot të mirë.

Ora 07:00 nisemi dhe nëpër gjurmët e mbuluara (*për në Grykë e Hapt*) më 09:30 jemi në Shtegun e Dëshëve (Shtegun për në Lugbat). Fillojmë zbritjen. Rreth 100 metra poshtë, pastaj kalim

traversë rreth 300 metra djathtas. Këtu fillon pjesa që do kujdes: ulje, pastaj traversë, pastaj ngjitje (të forta këto) dhe pastaj një traversë e gjatë e cila përfundon me ngjitjen që të nxjerr në Lugbat. Aty jemi më 11:00. Fitore pas 11 vjetësh (*synim nga ana ime*)! Aty jap variantin që të ndahet grupi më dysh për tu ngjitur disa në majën e Lugbatit (*Maja e Madhe, 2.625 m*) e disa në Gavën (2.499 m ??). Nuk e pëlqejnë ngase të gjithë duan që të ngjiten në Gavën.

Nisemi për Gavën. Pas 1 orë e 15 minuta arrijmë në shpatet e tij. Pas kalimit të 20-25 metrave në një pjesë të vështirë krijohet një moment ngurrimi në grup. Unë e shfrytëzoj këtë dhe krijohet rishtaz mundësia që të ngjitemi në majën e Lugbatit. Nuredini, Marjo e Qemali nisen për në Gavën. Ne të tjerët për në majën e Lugbatit. Koha priset keqas por më 14:00 jemi në majë.

Kalojmë shtegun dhe të gjithë nisen për në kamp. Vetë pres rreth 30 minuta deri sa kthehet dhe grupi i Gavnit më (16:30 – 16:45). Zbresim me kohë të keqe. Në kamp gjejmë çaj e zjarr. Koha është shumë e keqe.

## 8 shkurt

Ka rënë borë e madhe. Disa herë gjatë natës jemi ngritur dhe kemi shkundur borën nga çadra. Bora ka zbukuruar natyrën por vazhdimi i saj e bën të pakuptimtë qëndrimin tonë aty.

Fillojmë të prishim kampin dhe më 11:00 fillojmë zbritjen. Bora vazhdon të bjerë.

Lëmë kampin dhe ulemi poshtë. Me ndihmën e Hazirit ndahemi në dy shtëpitë më të fundit të Valbonës: unë, Mario, Dashi, Nuredini, Romeo e Niko vendosemi në shtëpinë e Beqir Sadikut (Valbonës), kurse Haziri, Kiçka, Qemali, Vullneti, Jani e Toli tek shtëpia fqinjë, tek ajo e Luigjit (Ndout) (Luigj Pëllumbi).

Thahemi e pushojmë mirë. Njerëzit na presin mjaft mirë.

## 9 shkurt

Dita mjaft e bukur. Vazhdojmë tharjen. Disa gjëra i nxjerrim në diell. Nga dreka nisemi në qendër të fshatit ku takojmë shokët e tjerë (*togë tjetër*) dhe hamë një drekë të mirë. Pasdite nisemi në bazën tonë e përgatitemi për ngjitje në majën e Roshit. Këqka sot nuk është ndier. Është i sëmurë.

## 10 shkurt

Nisemi për në Rosh. Koha e mrekullueshme. Vullneti na futi nga ana e pyllit dhe u munduam mjaft. Duhej të ishim nisur drejt rrugës së thjeshtë nëpër kanal pa u futur fare në pyll. Rrugës takuam Bajram Hysajn i cili “kërkonte”, gjoja, “barin” (*mullarin e barit të ruajtur për stinën e dimrit*). Ne i ramë shkurt (*e kuptuam misionin e tij*) dhe e morëm me vete për në majë kështu që na bëri punë e nder. (*Duket se atë e kishin nxjerrë për të na kontrolluar se mos kalonim matanë/kufirin*).

Maja ishte e thjeshtë por e bukur. U kthëm në bazë të rraskapitur. Ideja që nesër të ngjitemi në Brijas bie poshtë ngaqë njerëzit janë të lodhur.

## 11 shkurt

Ora 03:15 pas mesnate vjen Haziri në dhomën tonë. Ai do vinte mbrëmë (nuk erdhi) më ora 21:00 të më tregonte parashikimin 10 ditor të motit që jepej në televizor.

Ai tregoi se nga grupi i qendrës disa alpinistë kanë ngelur në majë të Kollatës; se paska goditur e gjakosur kokën Maridon Hito dhe është alarmuar kufiri dhe dega e punëve të brendshme Tropojë. Kishte porosi nga grupi i qendrës që unë të mos dija asgjë (të mos njoftohesha) për këto ndodhi.

U ngrita; zgjodha shokët më në gjëndje; informacioni ishte se ata ishin të gjithë mirë dhe u nisa ora 04:00 me pajime teknike.

Vajta në dhomën (në qendër) ku flinin Mario Hito e alpinistë të tjerë të asaj toge. Hasa pengesa për të mos u interesuar dhe vajtur në ndihmë, por pastaj i binda se atyre duhej tu vinim në ndihmë. Morëm me vete Vironin si më të shlodhurin e atij grupi.

Tek u nisëm për të njoftuar postën kufitare për ndërmarrjen tonë, në mal pamë zjarr që lëvizte. U bindëm se ishin pisha të ndezura nga shokët që zbrisnin. Këtë bindje e krijuam edhe pasi morëm vesh se askush tjetër nuk ishte nisur për t'i kërkuar (në fakt, më vonë mësuam, se ata digjnin shami për të bërë dritë). Pas kësaj nisëm lart vetëm pesë veta, sa për tu dalë përpara, për kurajo, kurse unë e Vironi ndezëm një zjarr mbi një livadh rrëzë lugut (Lugu i Prosllopit) që të çonte drejt tyre. Ata arritën tek ne të gjithë shëndoshë e mirë rreth orës 11:00. Pas kësaj morëm të gjitha masat që Tirana të njoftohej se alpinistët janë të gjithë shëndoshë e mirë. U largova nga qendra duke porositur që llafosjet të mbyllen.

Në darkë marr vesh se pijanecët kanë zgjatur e stërzgatur llafosjet. Si duket duan mbledhje e jo ngjitje për nesër.

Nesër kemi për të bërë ngjitje në Brijas. Kemi marrë masat e kemi rënë në ujdi të ngrihemi në 03:30 të mëngjesit.

Në darkë jepet njoftim për mot të keq. Megjithatë gjithshka do vendoset në 03:30 të mëngjesit.

## 12 shkurt

Koha është e papërshtatshme për ngjitje. Kalojmë kohën në shtëpinë e vëllëzërve Beqir, Ibrahim, Sherif (Sadiku) Valbona ku po qëndrojmë.

Disa kuriozitete:

- Xhaxhai i djemve të shtëpisë ku rrimë, me gjithë njerëzit (e shtëpisë), dikur jetonin në Kukaj. Më 3 shkurt 1963, xhaxhai sheh se ka bubullima të mëdha si dhe lëvizje

bore. Nxjerr të gjithë njerëzit e shtëpisë (edhe fëmijët) dhe i vë përpara sepse nuhat rrezik orteku. Sapo ata arrijnë në shtëpinë e fqinjit të tretë bie orteku. I prër/këput si presh pishat dhe vë përpara shtëpitë. Mbyten vetëm kafshë.

- Një fshatar i Kukajve del për të marrë sanë. Një tufë me 6-8 dhi të egra, në borë të madhe, bien në një rreth të hapur të borës në një gur të madh. Ai i ndjek (rreth) deri sa gati vdes (dhitë nuk delnin dot), por nuk i zë. Del nga gropa rreth dhe shkon të marrë njerëzit e shtëpisë. Kur kthehet me ta bie ortek, shëmb rrethin e dhitë ikin.



Maja e Brijasit

### 13 shkurt

Ngrihemi më 03:30 dhe pastaj më 06:00. Koha e keqe. Mbetemi brënda.

14 shkurt (*në këtë kohë nuk e dinim se kjo ditë, nga bota e krishterë, quhej Dita e Shën Valentinit*)

Ngrihemi më 03:30 e pastaj më 06:00. Vinë edhe alpinistë të tjerë. Pleqërojmë e nuk biem dakort për ngjitje. Më 09:00 ngrihem e përgatitem për në Brijas. Më përkrah Nuredini dhe pastaj edhe Haziri. Nisemi më 10:00 nën presionin e shokëve për të mos u nisur.

Çajmë borën me temp të lartë, sidomos Nuredini. Unë, e sidomos Haziri, e saktësojmë mirë itinerarin. Më 15:00 jemi në qafë të Brijzës dhe më 16:30 në majë. Koha mjaft e keqe: ftohtë, erë, mjegull e borë. Uji ngrin. Më 17:30 rikthehem në qafë (ose 17:45). Nga ora 18:00 ecim me elektrikë. Me to japim sinjale për shokët poshtë. Pasi kaluam Ziçin takuam Tolin me Luigjin (tek Luigji qëndrojnë shokët e tjerë). Përqafime, etj. Më 19:45 jemi në shtëpi.

### 15 shkurt

Ora 10:30 fillojmë analizën si togë. Më 15:40 fillojmë analizën si grup. Tani jemi mbledhur për darkën përfundimtare.

*Mbajtës i ditarit Aleksandër Bojaxhi*

## Përsëritje

### 1980. Ngjitjet e sezonit dimëror. 5 – 15 shkurt

Marrin pjesë:

1. Aleksandër Bojaxhi
2. Mario Trinkera
3. Kristaq Korçari
4. Dashamir Fejzo
5. Romeo Manxhari
6. Niko Petro

## 2 Shkurt, e shtunë

U nisëm në orën 7:00 nga Tirana me autobus e jo me tren. Kjo për arsye të anomalive që janë krijuar nga rënia e borës. Udhëtimi kaloi shumë mirë. Ndalëm në disa vende. Në B. Curri arritëm në orën 17:30. Çantat i lamë në një palestër pranë agjencisë së autobuzëve. Hotelet ishin të zëna sepse në qytet kishin ardhur mjaft oficerë (ushtarakë). Disa ekiye u sistemuan nëpër familje. Ne rregulluam vende tek Hotel Valbona. Kristaqi erdhi me mikrobuzin e ekipit Studenti (në orën 2:00 pas mesnate).

## 3 shkurt

Në orën 10:00 u mbledhëm tek palestra ku Kozmai na komunikoi ndarjen e togave sipas udhëzimeve të Federatës. Koha është me shi. Në orën 11:00 u nisëm nga B. Curri me autobus deri në Dragobi, ku mbërritëm në orën 13:00. U grumbulluam në një godinë të pa përfunduar së ndërtuari për të pritur ardhjen e mushkave. Sollën vetëm tre mushka me të cilat ngarkuan materialet ekipet e Korabit, Tërbunit dhe Partizanit. Porse dy nga anëtarët e ekipit të Partizanit nuk mundën të ngarkonin materialet. Materialet i vendosëm tek godina e spitalit dhe na

ndanë për të fjetur nëpër familjet e fshatit. Koha gjatë gjithë ditës ka qenë e keqe. Në Dragobi filloi të binte borë.

#### **4 shkurt**

Si sollën mushkat ngarkuam dhe u nisëm në orën 9:00. Në orën 14:00 ishim tek shtëpia e fundit e Valbonës. Prej këtu u nisëm për në Bunin e Ziçit. Marshuam ngadalë sepse kishim shumë ngarkesë dhe bora fundoste. Çantën e Kiçkës e lamë poshtë sepse ai do vinte me beratasit. Tek Buni arritëm në orën 16:30 dhe ngritëm çadrat pasi ngjeshëm borën. Koha ishte shumë e mirë deri në orën 15:00. Nuk i dihet se si do të vazhdojë.

#### **5 shkurt**

U ngritëm në orën 7:00 dhe koha është shumë e mirë. U nisëm më 8:30 dhe mbërritëm në majën Gryk e Hapt në orën 13:30. Mbërritëm në kamp në orën 15:00. Aci, Marjo, Nuredini, Doktor (Hazir Malaj) u vonuan sepse shkuan për të parë shtegun për kalimin në majën e Gavnit. Në kamp kishte ardhur ekipi beratas dhe me ta edhe Kiçka. Nesër do të ngjitemi në Qet Harushe. Koha duket e mirë por majave fryn.

#### **6 shkurt**

Gjatë natës filloi të bjerë shi. Në orën 7:00 filloi borë. Në orën 8:00 bora pushoi dhe koha u hap. Aci mendoi që të bëjmë një ngjitje në Qetat e Harushës. Në orën 10:00 u nisëm: Aci, Romeo, Marjo, Kiçka e Niko. Bora ishte e qullët dhe të fundoste shumë. Kur dolëm në qafë Kiçka u kthye. Gjatë ngjitjes na pengonte mjegulla dhe orientoheshim me vështirësi. Në orën 14:00 mbërritëm në majë. Kur arritëm në majë mjegulla u shpërnda dhe na u shfaq maja e Pecmarës. U nisëm drejt saj dhe në orën 15:00 ishim në majë. Koha mbajti mirë por



mjegulla na shqetësonte shikimin dhe sytë. Kush kishte syze ishte i pashqetësuar. Zbritja kaloi pa problem dhe në orën 17:00 arritëm në kamp. Kiçka me Dashin na kishin përgatitur çaj dhe na kishin ndezur zjarr.

Për nesër mendohet të ngrihemi herët dhe të bëjmë kalimin e shtegut që të nxjerr në majën e Gavnit.

## 7 shkurt

U zgjuam në orën 6:00. Kohën e kemi të mirë por parashikimi i motit që dëgjuam mbrëmë në radio na thotë se do prishet në pjesën e dytë të ditës.

U nisëm në orën 7:00, jo të gjithë bashkë, por në grupe të vogla nga dy e nga tre. Kur arritëm në qafën e parë u bashkuam të gjithë dhe filluam të vëmë kthetrat. Filloi zbritja nëpër një ulluk i cili në krye kishte një të dalë (kornizë bore), pastaj morëm traversë djathtas teksa zbrisnim/uleshim dhe dolëm tek një shkëmb ku morëm pak poshtë dhe më pas u ngjitëm tek një lug tjetër (rreth një litar). Pastaj morëm traversë djathtas dhe që aty të tregon vetë rruga për të dalë në qafën e Lugbatit. Kur mbërrihet tek qafa ajo merret me zig-zage dhe kalohet majtas tek disa shkëmbinj (tek kjo zonë ka shumë rrezik nga strehat e borës). Në orën 11:00 mbërritëm në qafë. Aty u mbledhëm dhe u propozua që: Vullneti, Jani, Qemali, Haziri të ngjiteshin në majën e Lugbatit (Maja e Madhe 2.625 m), kurse Aci, Marjo, Romeo, Niko, Nuredini të ngjiteshin në Gavën. Kjo nuk u pranua dhe u vendos që të sulmohej Gavni nga të gjithë. Ky ishte një gabim i rëndë taktik sepse ne ishim të lodhur nga ngjitjet e dy ditëve të para, dhe sot rruga ishte e gjatë.

Filluam ngjitjen për në Gavën që duket e lehtë. Kur mbërritëm në rrëzë të Gavnit të gjithë nuk ishin në gjendje të vazhdonin për në majë. Vazhduan Marjo, Nuredini e Qemali. Të tjerët u kthyen

për Lugbat. Kur mbërritëm afër majës së Lugbatit vendosëm të ngjitemi. Mjegulla po shtohet dhe frynte erë. Ne ishim të lodhur por megjithatë vazhduam ngjitjen. Në orën 14:00 mbërritëm në majë. Nuk shikonim gjë sepse kishte mjegull. Bënte ftohtë dhe donim vetëm të iknim. Filluam zbritjen. Era që frynte na kishte mbuluar gjurmët. Në orën 15:30 dolëm në qafën e parë dhe në 16:15 arritëm në kamp ku na priste çaji i ngrohtë dhe zjarri. Mario, Qemali e Nuredini u kthyen me një orë vonesë. Ngjitja ishte e vështirë dhe e gjatë. Ky itinerar nga Buni i Ziçit mund të bëhet kur koha është e ftohtë pasi i gjithë itinerari ka rrezik orteku.

Dashi është i lodhur dhe nuk është në gjendje që të bëjë ngjitje. Kiçkës nuk i merret vesh përse nuk bën ngjitje. Ai ankohet shumë për fjetjen. Për nesër e kemi pushim. Koha po prishet. Filloi të bjerë shi.

## 8 shkurt

Gjatë natës ka rënë shumë borë; rreth 25 cm. Meqë çadrat u mbuluan nga bora na u zu fryma sepse mbetëm apo u gjendëm pa ajrosje. Të gjithë jemi të lagur. Zjarri shuhet nga bora e degëve të pemëve (*zjarri ishte ndezur, me art nga Haziri, në mes të pyllit. Gropa e zjarrit të ndezur mbi borë, gjatë ditëve, nga shkrirja e borës, u thellua mbi një metër. Faktikisht ne nuk afroheshim tek zjarri, por “zbrisnim” tek zjarri*). Pejsazhi ishte shumë i bukur. Vendosëm të zbrisnim në Valbonë. Bëmë fotografi dhe luajtëm me borë.

Qeshim të gjithë me Dashin i cili na tregon për natën që ka fjetur në Dragobi tek Riza Motina. Rizai e pyeti “a e njeh një (*person*) Shpend Egra”. Dashi kujtoi se e pyeti “a ka shpend të egra në Tiranë” dhe ju përgjigj: Në malin e Dajtit ka derra të egër dhe ujqër. Atëherë Rizai e sqaroi se po e pyet për një njeri me emrin Shpend Egra.

E lamë Bunin e Ziçit në orën 10:00 dhe mbërritëm tek shtëpitë e Valbonës në orën 12:00. Vajtëm për tu tharë tek shtëpia e Beqirit (kjo shtëpi e konsideronte Hazirin dajë). Na pritën shumë mirë dhe me zjarrin që na bënë u thamë plotësisht.

Natën do e kalojnë këtu Nuredini, Aci, Mario, Romeo, Dashi e Niko, kurse Kiçka, Qemali, Vullneti, Jani, Toli, Haziri vajtën tek një shtëpi tjetër (Pëllumbi). Këtu kanë kërcitur bisedat sepse kemi gjetur qetësi e ngrohtësi.

## Interval

Ngjitjet janë me shkallë të ulët të vështirësisë por me volum të madh pune; rreth 7 orë një ngjitje. Udhëtimi bëhej pa rregull, me gabime teknike e pa disiplinë. Në ngjitje ndjehej frymë individualizmi. Secili përpiquej të shikonte punën e tij. Në këtë vend mund të rrihet rreth pesë ditë për të bërë ngjitje sepse nuk ka shumë maja për tu ngjitur në këtë zonë.

Më të rregullta janë ngjitjet me alpinistët e kategorive të dyta. Me kategoritë e para një pjesë e alpinistëve vijnë për ekskursione. Koha gjatë ngjitjeve ka mbajtur e mirë prandaj jemi kënaqur me panoramat që kemi parë.

## 9 shkurt

Kur u zgjuam, në orën 7:00, koha ishte me mjegull por në orën 8:00 u hap dhe doli diell. Majat janë të ngarkuara me borë. Sot e kemi pushim dhe do të zbresim në qendër të Valbonës. U nisëm në orën 12:00 dhe atje takuam alpinistët e grupit tjetër (Vlora, Korça, Shkodra, etj.). Këta ishin ngjitur në Jezerë. Grupi i Rrogamit ishte ngjitur në Popllukë, Ali dhe Jezerë nga ana e Gropave të Bukura. Hëngrëm drekë në klub.

Në shtëpinë që rrimë na i kanë bërë borxh duke na shtruar çdo shujtë/ngrënie prandaj menduam të flemë tek shkolla e cila

ka 9 shtretër. Meqë një pjesë nga ne nuk donin të lëviznin nga shtëpitë ku jemi sistemuar, vendosëm që të mbetemi atje, por me kusht që të na lënë vetëm dhomën dhe të mos merren me ushqimin. Këtë gjë/marrëveshje e mori përsipër që ta ujdiste Haziri. Nesër mendojmë të ngjitemi në majën e Roshit, por për këtë duhet marrë leje në postën kufitare ngaqë maja është në kufi. Kiçka është sëmure.

## 10 shkurt, e dielë

U nisëm në orën 7:00 për në Rosh. Ishim që të gjithë. Koha ishte shumë e mirë, porse bora nuk mbante. Ne nuk kaluam në rrugën që marrin fshatarët por u futëm në pyll dhe kjo gjë na lodhi. Në orën 14:15 ishim në majë. Rruga e kthimit ishte e gjatë, ose kështu mu duk ngaqë ndjehesha i lodhur. Dashi na mbajti me humor gjatë gjithë rrugës. Tek shtëpia mbërritëm në orën 17:00. Nesër do bëjmë pushim.



Nuredin Seci dhe Aleksandër Bojxhi  
në majën e Roshit

## 11 shkurt

Në orën 3:15 (pas mesnate) vjen Haziri. Ai, pasi ne u kthyem nga Roshi, kish vajtur në postën kufitare që të lajmëronte komandën që ne u kthyem nga maja. Ata të postës i thanë se një grup alpinistësh (K. Ziso, A. Qirio, A. Rëshketa, K. Gjylbegu, S. Aliko, M. Hito dhe një djalë i vogël nga Valbona) kishin mbetur në majën e Kollatës. Këta kishin dashur të kthehen shpejt për

të parë sportin dhe nuk kishin ndjekur rrugën e ngjitjes por kishin tentuar që t'i binin shkurt. M. Hito, në tentativë për të kontrolluar vendin, rrëzohet dhe vritet (duke çarë kokën), humbet ndjenjat, por e kaloi rrezikun dhe arriti të kthehet në Valbonë. Në Valbonë i thotë komandantit të postës që “kemi kaluar kufirin”. Kjo alarmoi komandantin që lajmëroi Degën e Punëve të Brendshme në B. Curri

Sapo na lajmëroi Haziri, Aci ngriti Marjo Trinkerën, Romeon, Nuredinin, Qemalin, Vullnetin për të organizuar ndihmën. Në postë Aci mori masa që të mos alarmohej Tirana, ndërkohë që një grup shkoi të ndihmonte shokët për zbritjen nga mali. Shokët u kthyen mirë në Valbonë megjithëse “kishin ngrënë dynjanë” gjithë natën nga të ftohtit. Ata patën fat që nata ishte e qetë dhe pa erë.

Të gjithë alpinistët nga shqetësimi kishin ardhur në Valbonë. Kiçkës e Janit u kishte mbetur qejfi që nuk i kishin ngritur për ndihmë. Nga merakun e nga sikleti ja kishin ngopur me të pirë sa ishin bërë tapë.

Për nesër mendohet të shkohet në Brijas po të jetë se do ketë kohë të mirë. Nga ora 19:30 erdhën tek ne Kiçka, Vullneti e Jani për të marrë vesh planin për nesër. Atyre u vinte era e të gjitha pijeve. Këtu kanë kërcitur qyfyret për punën e flokëve (ngacmime midis atyre që janë mirë nga flokët dhe atyre që u kanë rënë). Për nesër koha nuk do jetë e mirë sipas parashikimit nga Radio Tirana.

Na i prishi gjithë qetësinë budallallëku i dembelave dhe pijanecëve të Valbonës. Koço Ziso ..... Ai thoshte “I pashë ata që më donin” (e kishte fjalën për ata që dolën ta prisnin në mal). Kjo as ka të bëjë fare me dashurinë për shokët sepse sa më shumë të shkonin për të ndihmuar aq më konfuzion do të bëhej.



Niko Petro dhe Aleksandër  
Bojaxhi

## 12 shkurt

Sot nuk bëmë ngjitje sepse koha nuk premtonte. Kishte mjegull në maja dhe vranësira. Të gjithë janë mirë sepse kanë pushuar disa ditë rresht. Kjo jo me dëshirën e tyre. Ky pushim na ka bërë ca pesimistë për ngjitjet në maja. Grupi ynë ishte më aktiv dhe më i gjallë sa kohë ishim lart në Bunin e Ziçit.

Në darkë erdhën beratasit dhe të zotët e shtëpisë ku rrinë ata dhe luajtën këtu kapuçash me ca nga ne (*lojë popullore me çorape dhe zar*). Ndenjën deri në orën 23:00.

## 13 shkurt

Nuk është kohë e mirë dhe nuk u bë ngjitje. Bëmë pastrim personal. Vajtëm në qendër të fshatit dhe hëngrëm drekë tek klubi i gjeologjisë. Pasdite ndoqëm transmetimin e ndeshjes së futbollit Partizani – Dinamo (1:1) për kupën e republikës.

.....

## 14 shkurt

Në mëngjes në orën 3:30 u zgjua Aci dhe pa që koha nuk është për ngjitje. Edhe në orën 6:30 koha nuk ishte për ngjitje, prandaj pasi hëngrëm mëngjesin luajtëm domino e letra deri në orën 9:30. Pas orës 9:30 koha sikur po hapej por mjegulla nuk ishte larguar. Acit ju mbush mendja që të nisej për Brijas. I mbushi mendjen Hazirit dhe Nuredinit që ishin të pavendosur dhe e kishin pa qef ngjitjen. Mario e Dashi i thanë që të mos nisen se nuk i dihet kohës pasi ditën nuk e kishin përpara, por Aci nuk pranoi. Ky ishte një gabim, pavarësisht se ngjitja përfundoi me sukses, sepse një natë më parë kishte rënë borë, grupi është i vogël (tre vetë), rruga e gjatë dhe asnjëri nuk garanton ndihmë në rast rreziku. Ata u kthyen në orën 20:00 tek shtëpia. Rrugën e kishin kaluar mirë, kishin patur ftohtë dhe ishin lodhur. Nesër do të bëhet analiza e ngjitjeve në bazë toge dhe grupi.

## 15 shkurt

U ngritëm më 7:30 dhe pasi hëngrëm pritëm të bëhet analiza e ngjitjeve në bazë toge. Bëmë edhe pastrim personal. Nga ora 12:00 u nisëm për në qendër të fshatit (Selimaj ndryshe Valbonë) ku edhe drekuam.

Pasdite filluam mbledhjen përfundimtare. Aci e drejtoi mbledhjen në mënyrë të tillë që të eliminonte debatet dhe grindjet; u bë një konkluzion i rregullt. Kiçka, Ladi, M. Hito ishin përgatitur sipas mendjes së tyre për t'ju kundërvënë Acit, por treguan se janë të trashë. S i Partizanit foli vetëm budallallëqe.

Sonte do ja shtrojmë me këta të shtëpisë. Kemi blerë raki por duhet ujdë me lezet sepse këtu ekzistojnë akoma zakonet.

Për nesër janë porositur autobusët që do të vinë në orën 8:00, sepse pas mbërritjes në B. Curri do të vizitojmë Fierzën (hidricentralin). Koha për nesër duket shumë e mirë.

Konkluzion: ky vend është një poligon i vërtetë për ngjitje të kualifikuara dimërore. Ngjitjet janë të gjata dhe si maja nuk kanë ndonjë shkallë të lartë vështirësie (III – IV – V). Por ka rëndësi se këtu mund të kombinohet lëvizja nga një zonë në tjetrën. Kjo i jep larmi aktivitetit. *(në pjesën e parë të veprimtarisë, mendimet e Nikos në këtë ditar nuk janë positive për veprimtarinë, etj. Ai e ka për të parën herë këtë veprimtari në Valbonë. Në mbyllje duket që ai është i kënaqur me shumëshka).*

Ky aktivitet shënoi sukses sepse u ngjit një numër i madh majash nga alpinistët pjesëmarrës. Kjo u arrit sepse: alpinistët u çliruan nga lëvizja me çantat, pra ishin më të freskët, togat ishin të vogla e si rrjedhim veprimet koordinoheshin më mirë, elementët dembelë që ishin të shpërndarë nëpër toga nuk mund t'i kundërviheshin shumicës punëtore.

Këtu ka rëndësi fakti se mund të bëhen ngjitje edhe në kohë jo shumë të qëndrueshme n.q.s grupi mobilizohet dhe grupi e di mirë itinerarin. Grupet mund të nisen edhe në orë të vona të ditës sepse koha e ngjitjes mund të kufizohet (deri në 10 orë ngjitje).

Ekipi punoi mirë megjithëse u tregua pak i ngathët. Kjo erdhi sepse ishin dy të rinj: Romeo e Niko. Dashi ishte i lodhur dhe jo në formë të mirë sportive; Kiçka vetëm një ngjitje bëri.

Veprimet teknike të ekipit ishin të mira dhe në shumë ngjitje ekipi ynë ishte zemra e grupit. Por ne nuk duhet të krahasohemi me ekipet që kanë filluar të dekompozohen, por duhet të ngremë një ekip model që mbas disa vitesh të jemi një ekip shumë i mirë.

Kompaktësia në ekip nuk ishte në nivelin që kërkohet (ose që duhet të jetë). Kjo erdhi ngaqë u lodhëm pak dhe ndonjë veprim i drejtë që bëhej na dukej si një mundim i panevojshëm (kjo nuk i hedh poshtë mendimet e mëparshme për ngjitjet), por është një faktor që duhet patur parasysh gjatë stërvitjes.



Marjo është i vetmi alpinist që ka shumë llafe dhe jep shumë volum pune në ngjitje

Aci duhet të rregullojë pak disa të meta që janë shkrojtur më parë. Kjo për hir të ekipit.

Disiplina e ekipit ishte e mirë. Vetëm Kiçka e prishi..... Për të ardhmen duhet të futen elementë të rinj që të sigurohet emri i mirë i Ekipit Alpin 17 Nëntori. Federata duhet që me ato rregulloret e veta të bëjë një spastrim të përgjithshëm të alpinistëve dembelë, pijanecë, sepse këta bëhen pengesë për këtë sport.

## 16 shkurt

Mbrëmë ndenjëm deri vonë me të zotët e shtëpisë të cilët kanë mbetur shumë të kënaqur nga ne. U ngritëm më 6:30 dhe më 7:30 u nisëm për në qendrën e fshatit. Autobusi erdhi në orën 10:00. Në orën 12:00 ishim në B. Curri. Fjetëm në Hotel Turizmi. Koha ishte shumë e mirë dhe udhëtimin e bëmë me këngë.

## 17 shkurt

U nisëm në orën 7:00 direkt për Tiranë me autobus. Udhëtimi zgjati rreth 10 orë.

*Mbajtësi i Ditarit Niko Petro*

## Ngjitjet e sezonit dimëror për kategoritë e ulta 5 – 17 mars 1980

Pjesëmarrësit:

1. Shefki Juma kom. Toge
2. Sokol Doko
3. Ilir Tapia
4. Dragush Kulheku
5. Shkëlqim Mema (Guxho)
6. Andon Tapia zv. Komandant i ngjitjeve/veprimtarisë

### E martë 4 mars

Mbërritëm në Shkodër në orën 21:00 sepse treni na vonoi shumë. U sistemua në hotel Sporti dhe u njoftua se nisja nesër do bëhej nga ora 10:00.

### 5 mars

Sikundër duket, mungesa e korrektesës nga organizatorët bën që ta lemë Shkodrën vetëm në orën 12:40 dhe mbërritëm në qendër të Bogës në orën 15:00.

Vendimi i parë ishte të ndaheshim në dy grupe: ne me një grup alpinistësh në Ducaj dhe grupi tjetër në Okol. Në Shkodër na patën njoftuar se do të jemi të gjithë në Okol, por këtu në Bogë u vendos që të rrimë këtu, në Bogë. Prandaj, rreth orës 16:00 filluam ngritjen e kampit tek stacioni pyjor. Presim vendimet e shtabit. Ndërkohë po përgatisim darkën. Me çadrat jemi sistemuar. Problem mbetet Dragushi sepse ka dyshek ajri të parregullueshëm, kurse unë u ndihmova nga kuksianët, pra sonte kam një dyshek që pas disa orësh do të shfryhet. Për sot po e mbyll.

## 6 mars

Shtabi vendosi që toga jonë (17 Nëntori e Tërbuni) nën drejtimin e Shefkiut të ngjitet në Bridash. Veprimet në ngjitje qenë kompakte me përjashtim të Sokolit dhe Ilirit nga ne dhe Zaimit nga Tërbuni. Në pjesën e dytë të ngjitjes, në ulluk, udhëhoqën Ganiu e Beslimi nga Puka e unë nga Tirana. Përgjithsisht terreni ishte i mirë. Në qafë u takuam edhe me ekipet e Partizanit dhe Korçës. U ngjitëm në majë djathtas ullukut. Itinerari ishte i kategorisë së tretë të vështirësisë. Kushtet atmosferike ishin jo fort të këndshme. Erë e madhe nga veriu dhe temperaturë e ulët, ndoshta rreth -5 °C. Pastaj me të njëjtat treshe për litar, të gjithë të pajisur me kthetra, ju ngjitëm majës së Bridashit (vështirësi e pestë). Në litarin tonë (Iliri dhe unë) hyri dhe një alpinist i ri i Partizanit, Vasil Prifti. Ngjitja u kurorëzua me sukses rreth orës 12:30. Në majë fotografuam dhe vendosëm kutinë me emrat tanë.

Toga jonë e filloi zbritjen nga faqja perëndimore në orën 12:50. Nga kjo anë nuk kishte erë. Në orën 15:00 u paraqitëm tek komandanti i kampit. Rreth orës 17:00 filloi shi.

## 7 mars

Gjithë natën na shoqëroi shiu e bora. Ujët hyri në disa çadra, edhe në timen edhe në të Kiut (Shefkiut). Gjithë ditën jemi marrë me tharjen e teshave. Natyrisht që edhe po mërzhitemi. Sonte unë e Kiu do flemë në çadrën e Andonit, pasi ky shkoi tek një mik (*miku i Andonit ka qenë bajraktari i fshatit*).



Pjesëtarë të ekipit në veprimtarinë Bogë mars 1980

## 8 mars

Kudo rrotull kemi borë. Çadrat janë rënduar prej saj. Bora vazhdon të bjerë e përzier me shi. Rrotull, nga lugjet, herë dëgjojmë e herë edhe shohim orteqe që bien. Mërzia po shtohet. Sonte Kiu e unë do të flemë tek një mik i Kiut, e aty do të thajmë edhe teshat edhe thesin e fjetjes.

## 9 mars

Sot kemi përsëri borë ngado. Në kamp ka rreth 20 cm borë. Koha fillimisht po na duket e mirë. Toga jonë dhe tre kuksianë do të tentojmë për një ngjitje në majën e Hundës. Të tjerët pushim. Nisemi nën komandën e Shefkiut. Andoni u ngjit me ne rreth 40-50 minuta. Ngjitjen nuk e nisëm nga ulluku kryesor

mbi qendrën e fshatit; pasi u ngjitëm rreth 90 minuta koha filloi të prishet. kudo mjegull dhe borë e lehtë. Gjatë gjithë ngjitjes çajmë borën e re. Në lartësi ajo është rreth një metër e thellë. Çajmë më të shumtët nga ne duke u këmbyer. Vërejmë se jemi ngjitur më lart nga sa duhet për të marrë itinerarin drejt majës së Hundës.

Pasi zbritëm pak, hymë në një pyll ku u orientuam si duhet dhe më pas hymë në lugun kryesor poshtë majës. Në këto momente çahet reja dhe del dielli. Tani përgjatë itinerarit kemi borë të re dhe diell. Kjo bën që Shefkriu të urdhërojë të marrim djathtas lugut për tu ruajtur nga ndonjë ortek i mundshëm. Duheshin edhe 200-300 metra për të arritur tek shkëmbi ku fillon traversa drejt majës. Po e çaj unë borën. Pas meje janë Sokoli e Iliri. Arritëm tek një pishë e madhe dhe e vetmuar. Djathtas fillon një pllajë e vogël. Majtas është lugu. Shefkriu komandon që të jemi, edhe të ecim, sa më larg pjerrësisë së lugut dhe drejt vendit ku fillon traversa. Pas traversës mbeten pak metra për të arritur majën. Ne të kreut të kolonës e kemi kaluar rreth 30 metra pishën e madhe. Shefkriu më porositi të eci më djathtas, në kurriz/kreshtë. Sokoli kërkon të dalë përpara e të çajë borën dhe hidhet thuajse barkas e majtas këmbëve të mia dhe zvarritet për të dalë përpara. Në këtë moment u dëgjua një krisje dhe një zhurmë e mbytur. Unë vetëm ngrita kokën lart drejt majës. Në moment dëgjoj urdhrin e Shefkriut: Djathtas!! Pa arritur të reagoj sipas urdhrin (ndërkohë këmbët i kam të zhytura një metër në borë), e kuptoj se orteku ka filluar dhe ka përfshirë të gjithë lugun. Kufiri i çarjes së borës që përfshiu orteku ishte në këmbën time të majtë, kurse Sokoli i ..... tashmë para meje ka këmbët në zonën e borës që ka rrëshqitur. Me vonesë dhe të hutuar lëvizëm djathtas sipas urdhrin (ne katër të parët) për tek pishat e vogla, kurse të tjerët mbrapa tek pisha e madhe. Pas

disa minutash edhe ne të katërt zbresim tek pisha e madhe. Aty të gjithë kuptojmë se kemi shpëtuar nga një aksident fatal. Sigurohemi dhe fillon diskutimi. Disa mendojnë se duhet ta vazhdojmë ngjitjen. Kiu, me të drejtë (sikundër e gjykuam më vonë) urdhëron përgatitjen për zbritje. Pak më poshtë pishës shohim se rrugën nga u ngjitëm e ka përfshirë orteuku. I siguruar niset Kiu e pas tij Ganiu. Marrim sa më larg lugut duke tentuar të futemi në pyll aty ku ka pemë sa më të mëdha (ahishte). Mbanim distancë nga njëri tjetri sepse bora kudo paraqet rrezik orteuku. Pas hyrjes në pyll vazhduam duke çarë rrugë të re deri sa pas 40 a 50 minutash u takuam me rrugën e ngjitjes. Nga ora 14:00 ishim në kamp. Orteku ishte dëgjuar aty dhe ata ishin të shqetësuar për ne. Petraqi (Kuli) dhe Andoni e kishin parë rrugën/itinerarin tonë të prerë nga orteuku, por nuk kishin parë ndonjë prej nesh sepse disa nga ne ishin në pyll dhe disa nuk do mund të dukeshin prej mjegullës.

Pavarsisht se shpëtuam mirë, e theksoj se aksidenti do të ishte fatal për të gjithë. Nga gabimet tona rreshtoj: shkujdesja në ecje, mungesa e sigurimit, ecja thujse ngjitur me njëri-tjetrin. Nuk duhej të ngjiteshim nëpër lug, sidomos ngaqë kishte borë të re.

Duhet të theksoj se gjatë zbritjes u kujtova se kisha ditëlindjen (32 vjetorin). Ftova të gjithë shokët e ngjitjes që të pinim nga një gotë çaj në klub, por kur arritëm atje ai rezultoi të ishte i mbyllur.



## 10 mars

Nga shtabi u vendos që të sulmohet përsëri maja e Hundës. Sot koha që mjaft e mirë. Ngjitja që e lehtë sepse edhe itinerari në pjesën ku fillonte bora e madhe u çka dje. Marrin pjesë disa ekipe: Tomori, Partizani, Korça, Tropoja dhe toga jonë (17 Nëntori dhe Puka). Sot me ne ka ardhur Andoni. Kiu është në çadër.

Tani të gjithë alpinistët janë mbledhur tek pisha e madhe. Dje për itinerarin e majës së Hundës ne na ngeli pa bërë traversa. Sot atë po e çajnë Stefan Kule, Ed Sheldia e ca të tjerë. Andoni dhe Aleko Kapo (komisar i ngjitjeve) po i ndjekin nga afër.

Pastaj kaluam edhe ne të tjerët: Sokoli, udhëheqës, dhe unë në një litar me të, kurse Iliri, Dragushi dhe Andoni në një litar tjetër rreth 30 minuta pas nesh. Sokoli dhe unë bashkë me pukianët bëmë fotografi dhe pastaj, veç majës së Hundës, shkuam edhe në drejtim të majës së Pishkamit. Shprehem kështu sepse më vonë morëm vesh se ..... deri në Pishkam mbërriti treshja tjetër Iliri, Dragushi Andoni dhe dy dyshe pukjanësh, ....unë e Sokoli kishim zbritur nëpër traversë dhe pasi pritëm tek pisha e madhe për 30 minuta së bashku me komisarin Aleko Kapo dhe disa shokë të tjerë u kthyem në kamp. Të tjerët u kthyen rreth 90 minuta pas nesh. Shefkui na ka përgatitur një drekë të mrekullueshme.

Në kamp sot ka mbërritur edhe Kozma Grillo. Pasditja kaloi mirë. Duket se moti po ftohet. Vazhdoftë kështu!

Përgjithsisht gjendja e ekipit tonë duket e mirë. Tek Dragushi vërehen shenja lodhje. Për të ky është aktiviteti i parë në borë.

## 11 mars

Toga jonë niset sot për në Boçan. Mendohet të kalojmë nëpër itinerarin e hapur/çarë dje nga toga e Peshkopisë dhe të tjerë. Porse një plak bogian na trgon një drejtim tjetër. Mbërrijmë në

fillim/hyrje të fshatit, morëm djathtas, por jo thellë, dhe ecëm në një traversë deri sa mbërritëm në një rrugë këmbësore të rregullt por me borë të pashkelur. Udhëheq unë e pas meje Beslimi e Iliri. Itinerari duket i bukur. Pasi ecim rreth një orë dalin dy variante. Shefkiu urdhëron të ndiqet rruga e menduar nga Beslimi e unë, .... Disa herë ne ecim shumë më përpara shokëve me qëllim që të zgjedhim rrugën më të lehtë. Pas një ngjitje të lehtë hymë në një pyll e pastaj traversë mbi një zonë orteqesh (reliev me katarakte të shpeshtë) mjaft të gjërë. Kjo nuk paraqet rrezik sepse bora në këtë zonë ka shkarkuar mirë, veçse ecja mbi ortek është e bezdisshme. Kalojmë ortekun, futemi në një pyll dhe më pas fillojmë një të përpjetë të fortë. Bora është e madhe. Fillimisht udhëheq unë e më pas Gani pukjani. Vetëm 10 metra para se të dilnim në kreshtë të majës takuam me gjurmët e itinerarit të ndjekur nga shokët tanë një ditë më parë.

Në majë kryem ceremoninë e zakonshme (*foto, përqaftime, zig- zag*). Prej aty shkojmë në një majë tjetër më të lartë, 15 minuta më tej, majë ku nuk kishte shkuar grupi i një dite më parë. Pastaj kreshtë ku vazhdonin majat rradhazi dhe duke marshuar nëpër kreshtë arritëm në Pikën Trigonometrike mbi Fushë Zezë (Razëm). Rruga dhe koha qenë të bukura. Edhe më i bukur ishte mjedisi dhe panorama e pllajës që shtriheshin në perëndim të Pishkamt dhe djathtas vijës së kreshtës kur shkon nga Boçani në pikën trigonometrike. Vende shumë të bukura për ski. Iliri gjatë gjithë kohës më ngacmon që nuk mora skitë si për vete dhe për të kur u nisëm për këtë veprimtari.

Zbritja, kthimi, filloi nga ora 12:00 sipas të njëjtit itinerar deri në Boçan, dhe pas kësaj u futëm në itinerarin nga ishte kaluar një ditë më parë. Nga kthimi mësuam se itinerari i punuar nga ne në ngjitje ishte më i mirë, më i bukur dhe më pak i lodhshëm. Në kamp mbërritëm rreth orës 15:00.



## 12 mars

Sot është ditë pushimi. U morëm me çadrat dhe materialet. Bëmë një shëtitje poshtë në fshat. Iliri vrau pak kaviljen por nuk i kemi treguar Andonit. Ky pushim ishte i nevojshëm. Nesër mendohet të shkohet në majën e Çardakut.

## 13 mars

Pas rreshtimit u vendos që toga jonë të shkojë në majat e Shtegut dhe të Thores. Rruga është e qetë dhe deri tek stani (*Gropat e Portës*) është e hapur mirë nga disa kalimtarë thethjanë. Shtegu është krejt i mbuluar. Bora arrin disa metra. Nuk duken shtyllat e linjës telefonike dhe pemëve u duken vetëm majat. Fillimisht synojmë majën e Shtegut. Sot unë jam në fund të kolonës me Kiun dhe Beslimin. Mbi Okol më filloi një diare e cila më lodhi. Kiu në Shteg më dha 10 kokrra vitamina C. Nuk e kuptoj se çfarë ndikimi kanë, por i piva. Sidoqoftë është fakt se, pas gjysëm ore nga pirja e tyre, u qetësova.

Ngjitjet ishin pa problem. Vështirësi paraqiti pjesa e fundit që ishte krejt akull dhe kishte pjerrësi të madhe. Në majë kishte korniza bore të rrezikshme. Kryem ceremonitë e rastit dhe zbritëm për t'ju drejtuar majës së Thores. Këtu bora ishte shumë e butë. Në majë qëndruam pak. Bora ishte e madhe. Tek gropat (livadhet) takuam disa fshatarë dhe kufitarë. Aty hëngrëm atë ushqim që kemi dhe vazhduam. Sapo kalojmë Okolin takojmë një grup që zbriste nga maja e Çardakut e që udhëhiqet nga Petraq Kule. Në kamp arritëm mirë. Ilirin sot e trazoi shumë kavilja e vrarë. Nuk duhej të kishte ardhur. Unë gënjeva Andonin (*Andon Tapia, i ati i Ilirit*) duke i thënë se e vrau këmbën në zbritjen e Thores. Sidoqoftë të gjithë duhet të bëjmë kujdes nga lojrat (futbolli) gjatë veprimtarive, sidomos kur ende nuk i kemi realizuar ngjitjet e planifikuara.

Në orën 17:00 u bë mbledhja me të gjithë alpinistët. Petraqi foli për rregullin që duhet mbajtur si dhe u ndal në disa indisiplinime. Në fund komunikoi një urdhër të shtabit: Nesër nuk ka ngjitje për në Çardak. Shokët e togës u revoltuan. Unë bisedova me të veçmas. Argumentat e tij nuk mu dukën bindëse, veçanërisht kur tha: “Ju shkoni, por nuk do t’jua llogaris si ngjitje”.

### 14 mars

Toga jonë u përgatit herët. Në orën 6:30 të gjithë janë gati. Urdhërohemi që, pavarësisht se çfarë u tha mbrëmë, ne nuk duhet të nisemi. U desh të bindemi.

Në orën 8:00 unë e Dragushi, por edhe disa shokë të tjerë si ne që na mungonte një ngjitje e shkallës së dytë të vështirësisë (*për të arritur rritjen e rradhës në kategori sportive*), nisemi nën udhëheqjen e Shefkut në një majë mbi kamping. Shefkut e emëroi atë, me shaka, maja e Xhixhibinozit. U ngjitëm dhe në orën 11:00 u kthyem në kamp. Ngjitja nuk paraqiti asgjë të veçantë. Ndërkohë dy toga të tjera bënë ushtrime demonstrative për nxënësit e shkollës.

### 15 mars

Sot është dita e fundit. Në orën 14:00 u bë analiza. Përgjithsisht aktiviteti u mbyll me sukses. Toga jonë u shpall si një nga më të mirat. Nga ne u ngjitën 9 maja. Pas analizës organizuam një ndeshje futbollit. Ganiu, Ramadani dhe unë (skuadra e pleqve) dhe në skuadrën e të rinjve Sokoli dhe dy djemtë e rinj pukianë, Skënderi dhe ..... U kënaqëm dhe pati shumë humor. Shefkut dhe unë sonte do të flejmë tek pukianët. Çadrën e mbledhëm që sot.

## 16 mars, e dielë

Makinat erdhën relativisht herët (ora 9:00). Më 10:00 u nisëm por mbetën disa ekiye. Më 12:00 ishim në Shkodër. Do vendosemi tek Hotel Sporti. Pasdite do të shkojmë në stadium për të parë takimin Vllaznia – Flamurtari. Biletat na i dhanë që në Bogë. Unë dhe Andoni, meqë gjetëm bileta udhëtimi, vendosëm të kthehemi që sonte për Tiranë. Shokët do vijnë nesër. Mbaroi edhe ky aktivitet me sukses. Besojmë që edhe më mirë do të paraqitemi në aktivitetet e tjera.

*Mbajtësi i Ditarit Shkëlqim Mema*

## Ngjitje në malin e Korabit: 16-20 prill 1980

Veprimtari me rastin e votimeve me ftesë të ekipit të Peshkopisë

### 16 prill, e mërkurë

Nisemi nga Tirana me tren për në Laç në orën 8:50. Për arsye të ndryshme mbetëm vetëm tre vetë që morëm pjesë në këtë veprimtari:

1. Shefki Juma
2. Ilir Tapia
3. Dragush Kulheku.

Nga Laçi u nisëm me autobusin e linjës dhe në 16:15 ishim në Peshkopi. Këtu na pritën disa shokë të ekipit të Korabit (Peshkopisë). Zumë vend në hotel dhe pushuam pak aty ngaqë ndjeheshim të lodhur. Rruga na u duk e gjatë. Më 19:30, si hëngrëm darkë, shkuam me Petritin (anëtar i ekipit të Korabit) në shtëpinë e tij për të ndjekur në TV emisionin për Luftën e Dytë Botërore. Anëtarët e familjes na pritën me ngrohtësi. Na ra në sy bujaria e atyre njerëzve. Pasi mbaroi emisioni u ngritëm

dhe Petriti na përcolli deri në hotel. Për nesër jemi të përgatitur për tu ngjitur në majën e Korabit. Është kënaqësi që na u dha rasti të ngjitemi në majën më të lartë të vendit tonë.

## 17 prill

Pasi u ngritëm në orën 6:00 dhe hëngrëm mëngjesin, dolëm për të blerë ndonjë ushqim për rrugës. Rreth orës 9:00 u grumbulluam të gjithë për tu nisur drejt Radomirës, për në lagjen Tejz të saj, që është më afër majës. Grupi ynë përbëhej si më poshtë:

Puka (Tërbuni) 4 alpinistë; 17 Nëntori (Tiranës) 3 alpinistë; Korabi (Peshkopisë) 6 alpinistë. Nisja u bë rreth orës 10:00. Rruga ishte e gjatë dhe e lodhshme (*n'atë kohë rruga e makinës shkonte deri në Kastriot, dhe për arësye të mungesës së mjeteve të transportit, udhëtimi në këmbë shpesh fillonte që në Peshkopi*). Bënte shumë vapë. Materialet i dërguam me një makinë të rastit që do na i linte në fshatin Sllovë. Pasi morëm atje materialet, u nisëm për në Radomirë ku arritëm në orën 16:30. Këtu na pritën mësuesit e shkollës, të cilët u interesuan për të na ndarë nëpër shtëpitë e fshatarëve. Unë me Lulin e Peshkopisë u caktuam tek shtëpia e Met Madanës, kurse Dragushi me Ilirin e Peshkopisë tek shtëpia e Et'hem Madanës.

## 18 prill

U ngritëm në orën 2:00 pas mesnate. Me pajime dhe ushqime u grumbulluam tek godina e postës kufitare dimërore. Këtu u bashkuam me ushtarët të cilët do na shoqëronin për në majë dhe në orën 3:45 u nisëm në drejtim të majës. Ecnim shpejt që të fitonim sa më shumë kohë. Rruga ishte e gjatë, por jo e vështirë. Në orën 8:00 ishim në majën më të lartë të atdheut tonë, në majën e Korabit. Këtu ndenjëm rreth 25 minuta, bëmë edhe fotografi. Më pas u nisëm për kthim dhe në orën 11:00 ishim në

fshat. Bora gjatë rrugës ishte e ngrirë dhe kjo na ndihmoi që të ecnim shpejt. Pas një pushimi të shkurtër u nisëm për Peshkopi, ku arritëm në orën 18:40. Rrugë e gjatë dhe e lodhshme. Si zumë hotel, morëm ndërresat, bëmë banjë e pasi darkuam, ramë për të fjetur në orën 20:45.

## 19 prill

U ngritëm pas orës 7:00. Pas rutinave të mëngjesit dolëm nëpër dyqanet e qytetit. Lodhja e djeshme është daravitur. Rreth orës 12:00 u nisëm për në llixha për të bërë një banjë meqë na u dha rasti. Pas drekës shkuam për të fjetur. Na doli gjumi nga tingujt e orkestrës frymore të qytetit. Banda ekzekutonte me rastin e votimeve. Ora ishte 17:30. Shkuam në kinema dhe pamë filmin Skënderbeu. Më 20:15, pas kinemasë, shkuam për të darkuar dhe atje u takuam me antarët e ekipit të Pukës. Me ta ndenjëm deri në orën 22:00.

## 20 prill, e dielë

U ngritëm që më 4:15 dhe në orën 5:00 ishim tek agjencia e autobusëve. U nisëm. Në autobus me ne ishin edhe pukianët. Votuam në fshatin Klos, të rrethit të Matit, në orën 7:15. Pas një pushimi arritëm në Laç ku u ndamë me pukianët dhe pritëm trenin. Më 12:15 ishim në Tiranë.

Kjo veprimtari lokale ishte me rëndësi për mua dhe Dragushin sepse ne të dy votuam për herë të parë si dhe u ngjitëm për herë të parë në majën më të lartë të Atdheut tonë, në majën e Korabit 2.751m.

*Mbajtës i ditarit, Ilir Tapia*

**Ngjitjet alpinistike verore** që zhvillohen në Bjeshkët e Namuna prej datës 2 korrik deri në datën 14 korrik 1980 me alpinistë të kategorive të II-ta dhe III-ta.

Marrin pjesë:

- |                    |                       |
|--------------------|-----------------------|
| 1. Andon Tapia     | komandant i ngjitjeve |
| 2. Dashamir Fejzo  | komandant toge        |
| 3. Shkëlqim Mema   | alpinist              |
| 4. Ilir Tapia      | alpinist              |
| 5. Dragush Kulheku | alpinist              |
| 6. Artur Gorishti  | alpinist              |
| 7. Petrika Postoli | alpinist              |
| 8. Shpëtim Rota    | alpinist              |

## 02.07. 1980

Nisemi me tren më 16:20 nga Tirana për në Shkodër dhe në Laç marrim autobusin Laç-Shkodër, ku mbërrijmë më 20:30. U strehuam në hotel Sporti ku nuk fjetëm mirë për arsye të vapës.

## 03.07

U zgjuam më 5:30 dhe u nisëm për në Theth më 8:30. Na mori një autobus 46 vendesh dhe materialet u nisën me një makinë ZIS taksi. Mbërritëm në Okol në orën 10:00. Pas 30 minutash, pasi hëngëm, grupi ynë me alpinistë nga 17 Nëntori, Labinoti, Gjirokastra, Korça, Tropoja, Vllaznia, dhe Tërbuni u nis për në Theth nëpërmjet Shtegut të Dhenve. Mbërritëm në qendër të fshatit më 12:40. Aty pritëm makinën me materialet tona, e cila arriti në ora 19:00. Në orën 21:00 arritëm tek Kroj i Shtrazës ku kaluam natën. Nga grupi ynë u larguan tre ekipe: Korça, Gjirokastra dhe Valbona, sepse anëtarët e këtyre ekipeve nuk ishin të pajisur me leje për tu futur në zonë kufitare (*kështu quhej*

*zona mbi Kroin e Shtrazës- Q. Pejë, etj.).* Ngritëm çadrat dhe në orën 22:00 kishim ngrënë edhe darkën. Shtabi pas mbledhjes doli me vendimin që nesër të bëhen ngjitje të shkallës 3 dhe 4 të vështirësisë si dhe të shikohet bora rrëzë itinerarëve. Në orën 23:00 kampi ishte në gjumë.

## 04.07

Në orën 2:00 pas mesnate filloi një shi shumë i dendur që vazhdoi deri në orën 15:00. Pra rreth 13 orë shi. Ne, ekipi ynë, nuk u lagëm fare, por pati ekipe që u lagën mirë (*cilësi e dobët çadra ve ose çadra të rrënuara nga koha*). Shiu pushoi pas orës 15:00 por filloi të fryjë erë e fortë dhe ne veshëm rroba të trasha që të mos mbërdhinim. Sot u bë edhe kontrolli i bazës materiale dhe rezultoi që ne ishim ekipi më i rregullt. Ekipi i Tërbunit rezultoi pa këpucë shkëmbi dhe ata do të bëjnë ngjitje me këpucë çeke (*këto lloj këpucësh – firma BATA - ne i përdornim për ngjitje gjatë sezonit dimëror*). Darka kaloi mirë rreth zjarrit që bëri ekipi elbasanas (kishte rradhën).

## 05.07

Zgjimi më 6:30. Më pas pastrim, mëngjes dhe në 7:30 nisemi në drejtim të Qafë Pejës. Koha është e mirë dhe këtu poshtë fryn fllad i ngrohtë. Në orën 10:00 jemi në rrëzë të shkëmbit të Kolajve, në pjesën lindore ku ka itinerarë të vështirësisë së katërt. Punuan dy dyshe: Iliri-Dragushi dhe Arturi-Guxho. Tek itinerari i parë: 3 litarë kacavarje, 15 plenga dhe 1 pykë; tek i dyti 3 litarë kacavarje, 13 plenga dhe 1 shkallë. U dalluan Iliri dhe Arturi. Petrika me Shpëtimin punuan një ngjitje të vështirësisë së tretë në Kolaj në vazhdim të itinerarit I-6. Punuan mirë por duhet stërvitje në përgatitje fizike për të gjithë antarët. Kthimi në kamp në 17:30. Ngjitjet u realizuan me sukses deri në majë të malit,

moti atje lart ishte i ftohtë dhe frynte erë veriu që të bllokonte duart (na mbërdhinin). Rrëzë itinerarëve bora ka gjërësi rreth 30 metra. Mendimi i të gjithëve është se në këtë zonë nuk mund të bëjmë ngjitje për arsye të borës (*dhe mungesës së këpucëve për të ecur në borë dhe për të afëruar shkëmbit*).

## 06.07

Arritëm në rrëzë të majës së Malsores në orën 10:15 dhe në orën 11:00 filluan ngjitjet në dy dyshe: Iliri-Dragushi dhe Arturi-Guxho. Është e dyta ditë që Iliri punon mirë. Arturi mirë, me gjithë Guxhon, por që të katërt duan përgatitje fizike për krahët sepse nga kjo u vjen lodhja. Dragushit duhet t'i dalë pak frika sepse kjo e bën që të puthitet me shkëmbin dhe të rrëzojë gurë. Petrika duket i frikësuar dhe punon i tensionuar në shkëmb, kurse Shpëtimi është më ndryshe.

Ngjitjet u realizuan me sukses. Morali në ekip është i lartë. Kur u nisëm, që të tetë ushqimet i morëm (blemë) bashkë, mirëpo Andonit nuk i rrihet dhe si me thënë, u bë copë, deri sa ne i ndamë që të gjitha, deri dhe karamelat duke i numëruar. Tani jemi dy katërshe: Dashi, Guxho, Dragushi dhe Arturi si dhe Andoni, Iliri, Shpëtimi dhe Petrika. Për katërshen e parë kuzhinier është Arturi dhe për të dytën Shpëtimi. Në darkë jemi tek zjarri i përgatitur nga ekipi pukian. Koha po mban mirë.

## 07.07

Zgjimi në 6:30 dhe më 7:15 nisemi për në shkëmb. Sot ekipi ynë do të punojë një itinerar të shkallës së dytë të vështirësisë në Arap dhe po një të tillë tek Koka e Kalit. Në rrëzë të ullkut ishim në orën 9:30. Ngjitjen e udhëhoqi Dashi që punoi mirë. Edhe Iliri punoi mirë. Në orën 11:00 na zuri një shi i cili na futi ethet e të ftohtit. Pasi dolëm në majën e Arapit filluam zbritjen



e cila rezultoi e vështirë për arsye të borës së shumtë që ishte grumbulluar në rrëzë të malit. Më pas shkuam në drejtim të Kokës së Kalit. Marshim i bezdisshëm për arsye të borës dhe shkëmbinjtë të mprehtë (*të krepuar*). Në orën 12:00 ishim në rrëzë të shkëmbit. Treshja jonë me udhëheqës Ilirin u fut tek I-2, që ishte e shkallës së pestë të vështirësisë; jo shumë e gjatë por me variacione të bukura përgjatë itinerarit drejt majës. E bukura e këtij shkëmbi ishin pikat e mjaftueshme të kapjes. Shkëmbi na mori dy orë.

Rruga e kthimit është bërë e mërzitshme. Sot pashë me kujdes kreshtën/kurizin që të çon në Prozhëm: ishte me pulla bore, kurse lugu që të zbret në postën kufitare verore si dhe rrugët e tjera janë të mbuluara me borë. Kurse për stanet e Kllogjes them se janë vende për ski aq sa Guxho thotë: “sikur të kisha skitë do të kënaqesha”. Fshatarët që vinë këto ditë nga Nikçi për në Dukagjin të gjithë rrugën deri tek Rrethi i Vishnjës (*Qafa e Arapit*) e bëjnë duke ecur nëpër borë.

Darka kaloi mirë rreth zjarrit. Andoni sot paradite vajti në Theth për të biseduar me Federatën. Nuk doli në telefon Eqeremi (*Eqerem Shaba – Sekretar i Fedeatës së Alpinizmit dhe Çiklizmit n'ato vite*), por dezurni i ministrisë. Sot shumë ekiye bënë pushim. Nga ekipi ynë nuk bënë ngjitje Arturi, Petrika, Shpëtimi dhe Dragushi.


## 08.07

Pas rutinave të mëngjesit nisemi për ngjitje. Drejtimin e kemi për në Shtegun e Dhenve ku nga ekipi ynë do të punojnë dy dyshe: Iliri-Arturi tek I-8 dhe Guxho-Dragushi tek I-6. Dyshja e parë punoi mjaft mirë dhe e realizoi ngjitjen për një orë. Kjo tregon se Iliri vazhdon të punojë çdo ditë edhe më mirë, më i sigurtë dhe ka sedër në shkëmb. Arturi mirë. Tek dyshja tjetër

Guxho punon në tension aq sa ngatërron litarin duke e futur keq në karabinë. Do përgatitje për krahët sepse e ndjen shumë lodhjen. Dragushi si i gjatë arrin mirë pikat e kapjes, por do përgatitje më shumë për krahët. Dyshja tjetër, Petrika e Shpëtimi punuan në Malsore dhe realizuan dy itinerarë të shkallës së katërt të vështirësisë, I-2 dhe I-3. Këta të dy janë të rinj dhe kanë nevojë për përgatitje të mëtejshme të gjithëanshme. Shpëtimi punon mirë, është iniciator por duhet të punojë më qetë. Petrika punon ngadalë por siguron mirë, i zgjedh si duhet vendet për plengat, por sikundër të tjerët ka më shumë nevojë për përgatitje fizike. Kthimi në kamp në orën 18:00 dhe si çdo natë në orën 20:30 rreth zjarrit.

## 09.07

Në orën 07:15 u nisëm në drejtim të Murit të Radohinës. *(Besoj se ishte viti 1969, kur gjatë një prej veprimtarive të llojit “shkollë alpinizmi”, pjesëmarrja ishte e madhe si në numur pjesëmarrësish edhe në numur ekipesh dhe shkëmbi ku ne zhvillonim temat mësimore me alpinistët fillestarë u “mbipopullua.” Kjo bëri që të mendoj për një poligon të ri stërvitor. Një nga drejtuesit e togave ishte edhe Vullnet Zylyftari dhe bashkë vendosëm të shkojmë në lagjen Okol dhe të shikojmë për shkëmbej të përshtatshëm dhe të ngjashëm me shkëmbin që “braktisëm”. Shkëmbi i kuq i Okolit ishte interesant por duke shkuar edhe më në veri të lagjes në fjalë, na u duk interesante faqja shkëmbore nën majën e Radohinës. Duke e parë e duke u kacavarë në atë faqe gjigande, e tillë si në lartësi dhe në gjerësi, arritëm në përfundimin se ky është një poligon madhështor me mundësi të pafundme në lloje e sasi itinerarësh. E emërtuam Muri i Radohinës dhe shumë shpejt u bë poligon kacavarje për alpinizmin tonë të atyre viteve).* Këtu punoi sot ekipi ynë. Iliri e Guxho punuan në I-8; e shkallës së pestë të vështirësisë dhe në I-6



Alpinistë të rrjeshtuar para nisjes për stërvitje mësimore. Shkolla e alpinizmit Theth 1969

e shkallës së katërt të vështirësisë. Arturi me Dragushin punuan në I-9, kurse Petrika me Shpëtimin në I-6. Gjërat u bënë mirë nga dyshja e parë por jo nga e dyta. Dyshja Petrika e Shpëtimi bënë gabime trashanike në të gjitha drejtimet. Petrika po nuk gjeti vend për të siguruar shokun nuk bën rigrupim madje po t'i ketë mbetur edhe një metër litar ai do vazhdojë të kacavaret. Së dyti, ai i ngul plengat zig-zag dhe kështu litari krijon fërkim të madh e tërhiqet me shumë vështirësi. Kurse Shpëtimi nuk të përgjigjet drejt kur i bën vërejtje. Tjetër, ka frikë nga thellësia aq, sa deklaroi që “unë po e pashë keq zgjidhem dhe iki në Tiranë sepse e dua kokën time”. Dyshet e tjera punojnë mirë. Sot Shkëlqim Mema iku nga kampingu sepse e lajmëruan, nëpërmjet Degës së Punëve të Brendshme të Shkodrës, se duhet të paraqitet urgjentisht atje. Më duket se ai do të prezantonte një raport në lidhje me eksperimentet që ka bërë në punë. Jeta në kamp është në lartësinë morale e shpirtërore të duhur. Në darkë rreth zjarrit.

## 10.07

Sot ekipi ynë, në sajë të përgatitjeve të bëra që mbrëmë në darkë, punoi me shumë vendosmëri dhe ja konkretisht: Iliri e Andoni punuan (u ngjitën) në I-5, e shkallës së pestë, një ngjitje kjo që zgjati pesë orë e gjysëm dhe zbritje që zgjati mbi dy orë. Udhëhoqi Andoni. Dragushi e Arturi punuan I-8, e pestë dhe udhëhoqi Arturi. Dashi punoi me Kujtim Gjylbegun e Vllaznisë I-2 në Kolaj, ngjitje e vështirë që e udhëhoqi Kujtimi. Të pranishëm ishin edhe anëtarët e shtabit Grigor Perikliu e Xhevat Osmani. Ngjitja filloi në orën 10:00 dhe në majë ishim në orën 14:30. Në kamping u mbledhëm më 16:40. Në këtë ngjitje Dashi ka lënë një pykë, dhe ka shënuar emrin e tij dhe të Kujtimit të futur në një konservë peshku.

Petrika me Shpëtimin sot bënë pushim. Sot të gjithë ekipet (përfshirë Andonin si individ) nuk kanë bukë dhe për këtë arsye kanë filluar të hanë bukë misri. Sot zjarrin e ka ekipi i Labinotit.

## 11.07

Është dita e fundit e ngjitjeve prandaj zgjimi u bë në orën 07:30. Deri në orën 13:00 shtabi u mor me nxjerrjen e rezultateve si dhe me mbushjen e pasqyrave për çdo ekip. Shtabi analizoi edhe punën e togave dhe ekipeve. Të gjithë anëtarët e shtabit e lavdëruan shumë ekipin tonë dhe drejtuesin Dashamir Fejzo, por theksuan se edhe dy alpinistët tanë të kategorisë së tretë, Petrika e Shpëtimi, duhet të punojnë më shumë në të gjitha drejtimet. Rezultati ynë ishte ky: u bënë 46 ngjitje nga të cilat 6 të kategorisë së tretë të vështirësisë, 27 të kategorisë së katërt, 10 të kategorisë së pestë dhe tre të kategorisë së gjashtë me një mesatare si ekip prej 4.3. Gjithashtu në raportin e komandantëve

të togave u lavdëruan nga ekipi ynë Ilir Tapia dhe Artur Gorishti. **Mbrëmë** një nga anëtarët e ekipit të Elbasanit kishte ditëlindjen dhe e festoi duke marrë për të gjithë në një gjysëm litri vodka. Kënduam deri në orën 23:00, mirëpo Andoni i kritikoi dhe bëri shumë mirë por me një të metë sepse nuk gjeti kohën e duhur për ta bërë atë ndërhyrje. Kështu, atyre nuk u erdhi mirë, sidomos Xhevat Osmanit i cili akuzoi Andonin për hiç gjëra.

Në orën 15:30 grupi ishte gati për rrugë për tek posta (dimërore) ose kampi i punëtorëve për të kaluar natën, mirëpo në fshat erdhi një makinë e cila na mori deri në Bogë. Në Bogë mbërritëm në orën 21:00 dhe me të shpejtë ngritëm çadrat. Jemi shumë të lodhur.

*(Këtu mbaron ditari. Mbajtësi i tij nuk ka vënë emrin; me sa duket ka patur ndërmend të vazhdonte me shënimet për datën 12. Nga shkrimi dhe stili duket se **mbajtës** i këtij **ditari** ka qenë **Dashamir Fejzo**).*

## Ngjitjet verore në Alpe

Nga 18 deri 27 korrik 1980

Buni i Valbonës

Marrin pjesë:

1. Aleksandër Bojaxhi
2. Romeo Manxhari
3. Sokol Doko
4. Niko Petro

Më 09.07. 1980

Vera e sivjetshme është e vonë. Deri në mesin e qershorit ishte shumë fresk. Pjesa e dytë e qershorit mbajti mirë, por nuk ishte moti që duhej të ishte.

Ne presim që në Alpe të ketë shumë borë dhe të jetë freskët. Sivjet kemi vendosur që periudhën e grumbullimit ta bëjmë në Valbonë, kryesisht për këto arsye: *(ekipet sportive cilësore kishin të drejtë grumbullimi shtatë ditë para fillimit të veprimtarisë. Interpretimi i të drejtës së grumbullimit kishte kritere të caktuara si dhe dietë/pagesë të caktuar)*.

1. Krijohen kushte më të mira për fazën përfundimtare të stërvitjes sepse jemi më afër terrenit të veprimtarisë dhe për pasojë do jemi më të angazhuar.
2. Bëhet një përshtatje në drejtim të klimës dhe afrimit me malin.
3. Aci mendon se elementët e rinj të ekipit që kanë fituar kategorinë e parë sportive duhet të njohin më mirë luginën e Valbonës dhe të mos kufizohen vetëm me ngjitjet shkëmbore.
4. Duke ardhur disa ditë përpara veprimtarisë, shkojmë më të shplodhur në veprimtari sepse nuk kemi që në fillim të saj lodhjen e udhëtimit që me raste të duhen ditë për të marrë veten.

U nisëm me tren nga Tirana në orën 8:50 dhe nga Laçi me autobus në orën 11:00. Këtu ndenjëset na qëlluan të katra të këqia, me shpinë nga drejtimi i lëvizjes. Rrinim skiç dhe kjo na lodhi. Mënd për herë tjetër! Në Fushë-Arrëz drekuam dhe pimë ujë Gline shumë të ftohtë. Në B. Curri mbërritëm në orën 19:00, shumë të lodhur. Darkën e hëngrëm tek turizmi dhe habitem se ku e futa gjithë atë ushqim. Nesër do na nisë vëllai i Nuredinit me makina të rastit (kamiona). Fryn erë shumë e ngrohtë.

## Më 10.07

Koha duket shumë e mirë. Më 6:15 u nisëm për tek agjencia e makinave ku pritëm për makinë deri në orën 11:00. U nisëm më 11:30 me një SKODA. Rrugës ndjemë vapë dhe na mbyti pluhuri (*deri në vitin 2010 rruga ka qenë e pa asfaltuar. Ajo u asfaltua me faza diku midis viteve 2010-2015*). Në Valbonë mbërritëm në orën 13:00. Rrugës makina mori Ibrahimin (në shtëpinë e tij u strehuam gjatë dimrit). Ky na u soll shumë ftohtë. Drekën e hëngrëm në orën 14:00 me shumë oreks dhe po të vazhdojmë kështu do të mbetemi pa një grosh. Çadrat i ngritëm pranë postës kufitare. Këtu do të qëndrojmë kampi ynë gjatë ditëve të grumbullimit.

Një kujtim buzë lumit;  
Niko Petro e Sokol Doko



## Më 11.07

Koha duket shumë e mirë. U zgjuam në orën 6:00, hëngrëm në mencën e minatorëve dhe u nisëm për ngjitje. Do ngjitemi në Qet Harusha, nga lugu i madh. Fshatarët na folën për shteg, por në fakt nuk kishte fare. Rruga ishte ca e lodhshme dhe me shumë miza që të mërzhisin shumë. U kthyem në çadrat në orën 12:00 dhe bëmë plazh deri më 14:00. Pas drekës, më 14:45 u nisëm për Dragobi që të blinim libra (*ishte koha që kishte botime të mira, mirëpo në qytete ato shiteshin shpejt. Edhe fshati kishte plan*

*për libra – sasi librash që silleshin në dyqanet e tyre. Dhe ndodhte rëndom që tituj botimesh që në qytet shiteshin shpejt, shpesh i gjeje në raftet e dyqaneve të fshatrave të thella).* Ky udhëtim – vajtje ardhje - na zgjati pesë orë dhe u penduam që u nisëm.

### **Më 12.07**

Sot nuk do të bëjmë ngjitje. Nga ora 9:00 filloi të bjerë shi. U futëm tek çadra e Romeos dhe luajtëm me letra dhe domino gjithë ditën. Shiu vazhdoi deri në orën 18:00. Fjetëm rreth orës 21:00.

### **Më 13.07**

U zgjuam në 6:30. Më 7:15 u nisëm në drejtim të shkëmbinjve mbi Postën Kufitare për të bërë ngjitje/kacavarje. Itinerari i afrimit kalonte nëpër pyll. Tek shkëmbinjtë arritëm pas dy orësh dhe pamë se ata ishin shumë të lartë dhe pak të vështirë. Prandaj nuk bëmë ngjitje. Për këtë Acit nuk i erdhi mirë. Në kamp u kthyem në orën 12:00. Si zakonisht luajtëm me letra dhe domino. Pasdite u ngjitëm ca tek shkëmbinjtë mbi urën në hyrje të fshatit.

### **Më 14.07**

Në orën 6:15 u nisëm për Kollatë. Itinerari të çonte natyrshëm deri tek stanet e para, pastaj kalohej në ulluk, në drejtim të qafës që dukej sapo dilje nga ulluku. Kur dilje në qafë dukej pika trigonometrike. Qafa nuk duhet kaluar sepse aty kalon vija e kufirit. Në dimër grupi kishte ngelur rreth dy orë larg majës dhe kjo për budallallëk.

Ngjitja ishte shumë e bukur, me panorama të bukura. Nga maja dukeshin si në pëllëmbë të dorës të gjitha majat e larta të Alpeve. Koha gjatë ngjitjes ishte shumë e mirë. Nga një majë tjetër aty afër dukej lugina e Valbonës. Në kamp mbërritëm në orën 14:00.



### Më 15.07

U zgjova në 5:45. Hëngrëm në klub. Niko e Sokoli u nisën për në majën e Thatë. Atje do i priste Sherifi, i cili do u tregonte shtegun për ngjitje; Aci e Romeo vajtën në drejtim të Roshit. Tek stani i Sherifit mbërritëm në orën 09:10. Nuk e gjetëm aty Sherifin i cili ishte nisur në kullotë me dhitë. Teksa po zbrisnim qafën u takuam me Sherifin i cili na ktheu për në stan. Stani ishte shumë i mirë dhe i pastër. Sherifi na gostiti me kos dhe i mbeti merak që nuk kish ardhur Aci, prandaj dhe mbushi për të një kavanoz me kos. Në majë nuk vajtëm ngaqë ishte vonë, por ai na tha që të prisnim deri sa ai të milte dhitë e më pas të na tregonte shtegun. Ne preferuam të kthehemi. Në kamp mbërritëm në orën 12:00.

Koha është shumë e mirë. Pasdite lamë veshjet tona dhe bëmë “plazh”.

### Më 16.07

Sot e kemi ditë pastrimi. U lamë tek dushet e postës kufitare. Koha është si në plazh. Nesër presim të vijmë të gjitha ekipet ngaqë pasnesër është dita e fillimit të veprimtarisë. Ne presim që të vijë Shefkriu. Ai nuk u nis me ne ngaqë e shoqja ka prerë gishin dhe ai duhej të kujdesej për vajzën.

### Më 17.07

U zgjuam në orën 6:00 dhe filluam përgatitjet për rrugë. Në orën 07:30 çuam çantat tek klubi dhe prisnim që të gjenim makinë ose mushkë për të shkuar tek Buni i Valbonës. Nga ora 11:00 erdhën të gjitha ekipet. Pasi drekuam u bë një mbledhje për ndarjen e detyrave të togave. Ndarja u bë kështu:

Valbona, Studenti, Korça tek Buni i Ziçit; Partizani, Korabi, Puka tek Shpella e Rosit; 17 Nëntori, Shkodra, Përmeti, Berati tek Buni (Kroi) i Valbonës

Nga ora 16:00 u nisëm për Rrogam me një makinë që na e rregulloi Nuredini. Në Rrogam Aci kishte porositur Pjetrin, kafsharin që transportonte bukë, për të na ndihmuar me mushka. Meqë ishim shumë si grup, ne morëm vetëm një mushkë. Por ajo mezi ecte. Kur mbërritëm afër bunit, ajo ndaloi dhe nuk lëvizte më. Pjetri filloi ti binte me shkop, por mushka u ul në gjunjë dhe më pas u rrokullis poshtë rreth 30 metra. Ishte fati i mushkës dhe i Pjetrit që pylli, drurët e pyllit, e ndaluan atë. Rezultoi që materialet tona nuk u dëmtuan shumë (bukët ishin thërmuar pak) në orën 20:00 mbërritëm tek Kroj (Buni). Ky udhëtim zgjati 2.5 orë. Në orën 21:00 filluam darkën. Vendi këtu duket shumë i mirë.

## Më 18.07

Në orën 7:00 u nisëm në drejtim të majës së Valit për të studiuar disa itinerarë. Sapo do të fillonim ngjitjen filloi shiu i cili vazhdoi gjatë paradites me intervale. Koha u hap pasdite. Ne do të studiojmë itenerarë për ngjitje kryesisht majat e Valit dhe Alisë.

## Më 19.07

Në orën 7:00 u nisëm për në lugun e Smajlit. Niko me Sokolin do të ngjiten tek itinerari qëndror në të djathtë të lugut që ndan dy majat e Valit. Aci me Romeon do të ngjiten tek lugu tjetër, i cili ndodhet më poshtë këtij itinerari.

Shkëmbi ishte shumë i thërmueshëm dhe nuk mund të ngulje asnjë plengë; gurët ishin shumë të lëvizshëm porse pikat e kapjes ishin të shumta. Kjo ngjitje nuk kishte dalje në majë, por takohej me ulla nga ngjiteshin Aci, Romeo, Ylli. (*val quhet një gur që bie direkt nga masivi malor. Në rrëzë të shkëmbinjve apo faqeve shkëmbore ne gjithnjë hasim gurë të tillë. Mali i Valit është tipik për këtë prandaj dhe do ketë emrin që ka-AB*).

## Më 20.07

Sot e kemi pushim. Një pjesë e jona do të zbresin në Valbonë. Niko, G. Oruçi, Q. Biçaku, do të shkojnë në Theth nga Qafa e Valbonës. Koha gjatë gjithë ditës ishte shumë e mirë. Të gjithë shokët thonë se maja e Valit është e papërshtatëshme për ngjitje mbasi nuk ka siguri në plengat e ngulura si dhe për faktin që shkëmbi është i thërmueshëm.

## Më 21.07

Sot do të bëjmë ngjitje në majën e Alisë. U ngjitëm nga lugu i Valit (*në këtë rast-në këtë emërtesë-fjala val zëvendëson fjalën valishtë që d.mth. një lug mes malesh*). Lugu doli i vështirë ngaqë kishte borë të ngrirë dhe nuk mund të kalohej me atlete. Në ngjitje jemi Sokoli, Romeo, Niko. Ngjitja është shumë e vështirë. Në orën 12:55 ishim në majë (*nuk na përshkruhet itinerari që morën*). Shkëmbi ishte i ngjashëm me atë të majës së Valit. Edhe zbritja ishte e vështirë sepse kishte borë. Romeo, Aci, Vangjeli vajtën në majën e Popllukës. Niko me Sokolin kishin rrëshqitur shumë (*ulur nga mali me rrëshqitje*) dhe po të ktheheshin (*për në majë të Popllukës*) do t'i vononin ata që ishin ngjitur dhe kështu nuk vajtën në atë majë.

Sot pasdite po fryn erë dhe të shohim si do të bëjë koha nesër. Tani ka filluar të bëjë ftohtë dhe ne rrimë pranë zjarrit me triko leshi.

## Më 22.07

Koha është si me mjegull. Ekipi do të shkojë në majë të Rrogamit. Qafa ishte plot borë dhe nuk kalohej (*dua të rikujtoj që në ngjitjet e sezonit veror, alpinistët pajiseshin me atlete, disi të përshtatshme për kacavarje në shkëmb, por jo për të kaluar nëpër terrenin e mbuluar me borë*). Një pjesë e jona u ngjit anës shkëmbit dhe

kështu vajtën në majë vetëm Aci, Romeo, Sokoli, G. Uruçi. Pjesa tjetër nuk u ngjit. Në darkë u bë aq ftohtë sa nuk rrihej pa zjarr.

### Më 23.07

Sot kemi pushim. Disa kanë vajtur në Valbonë. Në përgjithësi këtu po punohet mirë. Tonin e jep kryesisht ekipi ynë. Aci është drejtues i të gjitha grupeve. Ekipet e tjera i nënshtrohen ngjitjeve si pa qejf sepse nga rrethet ishin nisur me mëndje që të bënin qejf.

Nga Buni i Ziçit morëm vesh se ata po “hanin” dynjanë duke ngjitur zhavorin e lugut për tu afruar tek shkëmbejtë. Kozmai ishte i pakënaqur nga tropojasit, që nuk i kishin dhënë asgjë nga stani për vajzën e tij (*ndonëse në ditat nuk përmendet, këtë vit unë kisha marrë në veprimtari djalin tim Gjergjin sikundër Kozmai kishte marrë vajzën e tij Evisin*). Këtu ka filluar të duket një mërzitje tek të gjithë dhe me padurim presin ditën e largimit. Ne jemi i vetmi ekip me triko dhe çorape leshi. Na vjen për të qeshur sepse njerëzia rrinë me mbathje në plazh kurse ne në orën 16:00 presim dru sepse nuk rrihet pa zjarr.

Në darkë u mblodhëm tek zjarri ku ja fillojnë qyfyret. Gëzimi sot (*për qyfyre*) e ka filluar me Vangjelin dhe Qemalin.

### Më 24.07

Sot u ngjitëm në majën e Valit nga lugu verior. Rrugës binin shumë gurë. Në treshe ishim Romeo, Sokoli, Niko. Meqë binin shumë gurë kjo gjë që na bëri të ecnim ngadalë. Ngjitja (sulmi) vazhdoi një orë e çerek, zbritja një orë e gjysëm. Në majë nuk e gjetëm letrën e Qemalit. Ai na tha se e kishte lënë tek maja tjetër.

Në majë gjetëm një letër të vitit 1976 ku janë ngjitur rreth 20 vetë nga ana e fshatit Rrogam. Këta ose janë ngjitur pa u siguruar ose është ngjitur një treshe dhe ka lënë aty letrën.

Pasdite ndezëm një zjarr shumë të madh, aq sa i rrinim disa metra larg. Sipas lajmeve në radio, për nesër parashikohet shi.

## Më 25.07

Në mëngjes zgjimi ishte plot humor. Qeni, të cilin ja kishin falur në fshat Koçi Maqinës nga Berati, kishte ngrënë gjatë natës 27 vezë që ekipi i kishte blerë dje. Toli (u zgjua i pari nga ai ekip) kur pa se kishin ngelur tre kokra i mori dhe i skuqi të treja për vete. Për këto Vangjeli u tërbua. Gëzimi përsëriste: “e dëgjova qenin që në mëngjes duke bërë vokalica”. Një tjetër ja priste: jepini qenit sheqer që ta nxjerrë budingun ose kekun ..... Apo “as Gaqo Çako me Avni Mulën nuk pijnë kaq vezë për të kënduar”, etj. *(kishin filluar vitet gjatë të cilave ishte e vështirë të siguroje/blije ushqime)*.

Koha është shumë e vërenjtur dhe pritet që shiu të fillojë nga çasti në cast. Acì ngul këmbë që po të jetë se koha kthen deri në orën 9:00, atëherë të nisemi për në Jezerë. Këtë nuk e pranoi njeri. Në orën 9:00 u nisëm për në Zhaboret. Në ngjitje po punonin Sokoli, Romeo, Niko. Niko u kthye sepse nuk ndjehej mirë. Në orën 11:00 koha u hap mirë, dhe ne në këtë kohë përfunduam ngjitjet.

## Më 26.7

Sot koha është e mirë. Të gjithë vajtën për të bërë disa ngjitje të lehta nga lindja e Valit. Niko nuk erdhi në ngjitje sepse nuk ndjehej mirë. Pasdite u bë një analizë për ngjitjet. Në përfundim u përcaktua se ky vend nuk është i përshtatshëm për ngjitje shkëmbore sepse shkëmbi është i thërmueshëm dhe bien gurë. Ylli Mullarai propozoi që të bëhej rajonizim i vendeve për ngjitje. Berati shtroi problemin e elementit rë ri. Këtu u vendos që aktiviteti veror të bëhet në Bunin e Valbonës *(ndoshta ka dashur të thotë “aktiviteti dimëror”)*. Në darkë, deri vonë, ndenjmë duke treguar barcaleta.

## Më 27.7

Sot do të grumbullohem në Valbonë. Koha është shumë e mirë. Ne kemi vendosur të nisemi pasi të hamë drekë. Nga ora 10:00 kaloi një nuse me gjithë dasmorët që e shoqëronin. Ne gostitëm më pleqtë me kafe dhe cigare. Gëzimi u bëri fotografi dhe kjo i kënaqi shumë ata. Nga ora 14:00 u nisëm për në Valbonë. Tashmë rrugëtimi dukej i bukur. Në Valbonë mbërritëm në orën 16:45 dhe në orën 17:30 u bë mbledhja e të gjithë grupeve. Mendimi i të gjithë grupeve ishte që kjo zonë nuk ja vlen për të bërë ngjitje sepse shkëmbinjtë janë të thërmueshëm dhe itinerarët janë larg kampeve. Në darkë filloi shi.

## Më 28.7

Në mëngjes na zgjuan në orën 6:00 ngaqë kishte ardhur autobusi. Të gjithë u bënë gati. Por rezultoi se autobusi kishte ardhur për të marrë anëtarët e partisë së punës së fshatit për t'i dërguar (në B Curri) në mbledhjen e pleniumit.

Ne u nisëm në orën 11:45 nga Valbona dhe arritëm në B. Curri 13:30. Nga ora 14:30 filloi një shi që na ndihmoi për të bërë gjumë të këndshëm.

Në Valbonë qëndruan Kristaq Gega – Vlora, Anesti Qirio – Korça, Gëzim Oruçi – Shkodra, për të marrë litarin që kishte lënë në sezonin dimëror Marjo Hito (*në zonën e Kollatës*). Këta u kthyen në orën 2:00 pas mesnate dhe thanë se Gëzimi i kishte sorollatur që të mos e merrnin litarin. Si përfundim litari u gjend por ata ishin rraskapitur.

Gëzimi plotësoi fletën e ngjitjes gjë që Kristaqi nuk ishte dakort. Kjo gjë u bë shkak që ata këmbyen fjalë në autobus.

Në orën 8:00 u nisëm për në Tiranë. Rruga na u bë e mërzitshme.

*Nga ditari personal Niko Petro*

## VITI 1981

Ngjitje alpinistike dimërore me alpinistët e kategorisë së parë e lart

Për ekipin e 17 Nëntorit morën pjesë këta alpinistë:

- |                       |                 |
|-----------------------|-----------------|
| 1. Aleksandër Bojaxhi | Mj. Sporti      |
| 2. Dashamir Fejzo     | Kand/Mj. Sporti |
| 3. Romeo Manxhari     | Kand/Mj. Sporti |
| 4. Shefki Juma        | Kat I           |
| 5. Ilir Tapia         | Kat I           |

**Shënim:** Në këtë aktivitet duhet të merrte pjesë edhe alpinisti Niko Petro, por meqë kishte pengesë nga puna, nuk erdhi (*largimi nga puna – ndërmarrja e institucioni ku punonte alpinisti – bëhej bazuar mbi një shkresë që lëshonte titullari i klubit sportiv ku ishte anëtar alpinisti. Shkresa mbështetej mbi një vendimi të Këshillit të Ministrave për të gjithë sportistët. Ditët e mungesës në punë gjatë ditëve të veprimtarisë sportive, paguheshin*). Ngjitjet do të zhvillohen prej datës 22 deri më 30 janar. Ekipi ynë duhej të nisej nga Tirana në datën 17, por për arsye të rrugëve të bllokuara nga moti u nis më datën 20.

Në këtë veprimtari do të marrin pjesë këto ekipe: 17 Nëntori, Tomori i Beratit, Luftëtari i Gjirokastrës, Skëndërbeu i Korçës,

Labinoti i Elbasanit, Tërbuni i Pukës, 24 Maj i Përmetit, Korabi i Peshkopisë, Studenti, Flamurtari i Vlorës, Partizani, Përparimi i Kuksit.

Siç u tha më lart nisja nga Tirana u bë në datën 20 ora 8:00 dhe mbërritëm në B. Curri në orën 20:35. Udhëtimi ishte i qetë dhe jo shumë i vështirë (problematic) sikundër pritej nga sa na u tha në Tiranë. Në orën 21:00 sistemua materialet në dhomat e hotelit dhe u ulëm për darkë tek Turizmi ku dhe kemi dhomat. Në orën 22:00 të gjithë në gjumë të ëmbël duke qenë të sigurt që nesër në mëngjes nuk do të përcillemi nga pjesëtarët e familjes e duke u puthur gjithandej.

## Dt 21

Zgjimi në 06:30; në 07:30 mëngjesi në restorantin e hotelit me një paçe të shijshme. Nisja për Dragobi ishte lënë për orën 09:30, por meqë shumë ekiye nuk kishin blerë ushqime u shty për në orën 10:30. Na erdhi autobus “skoda”. Udhëtimi ishte i bukur por i rrezikshëm për shkak të shoferit, i cili nuk i vuri gomave zinxhirë. Megjithatë në Dragobi arritëm shëndoshë e mirë në orën 12:00. Menjëherë alpinistët sulmojnë dyqanet për të blerë. Në orën 12:40 ekipi ynë siguroi mushkën e parë ku u ngarkuan ushqimet e ekipit si dhe tre çanta: e Dashit, e Romeos dhe Ilirit. Këta shoqëruan mushkën e quajtur Maria, që u tregua shumë e përgatitur fizikisht. Mbërritëm në Valbonë, tek dyqanet, në orën 15:10 ku dhe siguruam një dhomë për të fjetur në një nga dhomat e ekipit të gjeologëve. Kurse Aci me Shefkiun kanë fjetur me siguri në Dragobi dhe vinë nesër. Në dhomë kemi edhe tre shokë nga të Peshkopisë të cilët kanë biseda të këndshme. Në gjumë në orën 22:00. Moti jashtë i ftohtë dhe me erë të fortë.



**Dt. 22**

U zgjuam më 6:30. Nuk kemi fjetur mirë. Më 07:20 ulemi të hamë mëngjesin me ushqim nga çantat tona. Mëngjes i shijshëm me bukë të thekur e pranë sobës. Dhe tani jemi në pritje të ardhjes së Acit e Shefkiut. Drekën e hëngrëm në klub. Në orën 14:00 duhej të niseshim për në Rrogam, por kjo nuk ndodhi. Më ora 20:00 për parashikimin e motit dëgjojmë edhe Radio Tiranën edhe Radio Prishtinën. Për



Shefki Juma dhe Aleksandër Bojaxhi në Valbonë

motin këtu në Valbonë mbështetemi tek të dhënat e Prishtinës, e cila dha si temperaturë të ulët në zonat malore vlerën -6 gradë si dhe me erë të fortë nga lindja. Në orën 22:00 jemi të futur në thasët e fjetjes dhe kemi sobën të ndezur.

**Dt.23**

U zgjuam në orën 7:00. Kemi kaluar natën më të mirë me gjumë. Pasi hëngrëm mëngjesin në orën 09:30 nisemi për Rrogam. Arritëm në lagjen Gjellaj në ora 12:00. Aci me Dashin shkuan e biseduan me të zotin e shtëpisë më të parë. Quhej Kol Caka, shumë mikpritës por ishte me usta brenda dhe po rregullonte shtëpinë. Dashi shkoi në një shtëpi tjetër. I zoti i shtëpisë ishte Sokol Cani, 82 vjeç. Na priti pak si vrazhdë, por na pranoi me kusht që drutë për zjarr t'i bënim ne. Premë dru dhe kur u ulëm nisëm pyetjet ndaj njëri tjetrit. Mësuam që Sokoli djalë e madh e kishte në burg të dënuar me 8 vjet burg politik. Kjo gjë na ra

si bombë pasi ne duhet t'i shmangim raste si ky. Shpejt u krijua një pretekst i këndshëm që ne të largoheshim e të strehoheshim tek shtëpia u Juk Rëgallës. Ky ka edhe tre vllazër të tjerë. Jemi në dhomën e miqve, e vogël dhe me pak zjarr. Më 22:30 ramë për të fjetur. Për nesër do ngjitemi në majën e Rrogamit si dhe na duhet të bëjmë dru. Këtu jemi keq për ujë ngaqë burimi është larg.

## **Dt. 24**

U ngritëm në orën 7:00. Gjumi jo i mirë për arsye të temperaturës së ulët. Deri në orën 8:00 kemi mbaruar me mëngjesin dhe merremi me përgatitjen e drekës: fasule me pastërma dhe biskota me sherbet. Drekë e shijshme por ca e kripur.

Në orën 14:30 nisemi për të hapur rrugën/borën për në majën e Rrogamit. Morën pjesë të gjitha ekipet. Rruga ishte pa vështirësi teknike. Në orën 17:00 ishim përsëri në dhomën tonë ku gjetëm zjarr shumë të mirë. Darkën e përgatiti Aci: supë për dy ditë dhe krem karamel. Sonte duhet të flemë herët dhe mirë sepse nesër do të vemi në majat e Popllukës dhe Alisë nëse moti do jetë me ne.

## **Dt. 25**

Zgjimi u bë në orën 5:00. Deri në orën 6:00 mbaruam me mëngjesin dhe në orën 7:00 katër vetë nga ekipi ynë: Aci, Dashi, Shefkriu, Iliri u nisën në drejtim të Bunit të Valbonës (Kroni i Valbonës). Romeo nuk mundi të vijë mbasi duket që mbrëmë ai ka pësuar helmim. Kjo gjë i kushtoi shumë pasi ne katër të tjerët e ekipit realizuam dy ngjitje të bukura në majat e Alisë dhe Popllukës. Ne të katër në orën 8:00 ishim tek Buni i Valbonës. Fill pas ekipit tonë arriti ekipi i Valbonës si dhe dy alpinistë të Elbasanit. Kështu që ne, nëntë vetë, çamë borën nëpër lugun e Valit. Në orën 10:40 arritëm në Qafën e Valit. Këtu

dy elbasanasit, që bënin pjesë në togën e drejtuar nga Vullnet Zylyftari, morën drejtimin për në Popllukë. Ekipi ynë dhe ai i Tropojës u ngjitëm në majën e Alisë nëpërmjet lugut/koridorit të tij. Ishte kohë e ftohtë dhe lugu vende-vende ishte i ngrirë. Ekipi ynë u nda në dy dyshe: në të parën udhëhiqte Aci e në të dytën Shefkiu. Ngjitja ishte e suksesshme. Në majë ishim në orën 12:15. Pra sulmi zgjati 90 minuta. Zbritja u bë po nga lugu, një zbritje e bukur deri në Qafë të Valit, e prej këtu nisemi për në majën e Popllukës. Arritëm në majë në orën 13:45. Këtë ngjitje e udhëhoqën Dashi e Shefkiu. Në këtë ngjitje era e fortë të thante fytyrën megjithëse secili kishte edhe kokore edhe xhakovento me kapuç. Kthimi për në bazë ishte i keq për arsye se u ul mjegull shumë e dëndur që na shoqëroi gjatë gjithë lugut. Në orën 16:00 ishim në bazë ku na priste Romeo me çaj dhe supë të ngrohtë.

### Shënime:

Harmonia në ekip është shumë e mirë. Gjithashtu morali i lartë.

Është vënë re se gjatë këtyre ditëve Shefkiut i ka hipur oreks shumë i madh, aq sa të gjithë kanë krijuar përshtypjen që ky është llupës i madh. Nga një anë ai ka pak të drejtë, sepse dhe Aci që ndan ushqimin me garuzhde e ndan duke ju “dridhur” dora, sikur ta kenë lidhur me tre fazor.

Kur u kthyem nga ngjitja Romeon e gjetëm mirë dhe nesër do të vijë në ngjitjen e dy majave të tjera; atë të Rrogamit dhe atë të Valit. Në orën 22:30 të gjithë në gjumë për arsye të lodhjes. Nesër do ngrihemi përsëri në orën 5:00.

### Dt. 26

Zgjimi në orën 5:00 dhe në ora 7:00 jemi në rrugë për në majën e Rrogamit dhe të Valit. Ky i fundit na u duk shumë i vështirë. Pjesa më e vështirë ishte ajo finalja, ku ishte një lug me gjatësi mbi një litar që ishte me akull e shkëmb. Në këtë majë nga ekipi

ynë u ngjitën Shefkiu dhe Iliri, kurse Dashin, Romeon dhe vetë Acin nuk i lejoi Aci për arsye të kohës shumë të keqe, sepse frynte një erë shumë e fortë e me cikla bore që të shkaktonin të ftohtë të madh e të padurueshëm tek duart dhe këmbët. Me të drejtë Aci vendosi që nga grupi ynë të ngjiteshin dy tropojas dhe Iliri me Shefkiun. Rugën e zbritjes e vështirësoi era e fortë. Në majë të Valit ishim në orën 14:50 dhe në bazë në orën 17:00 ku ndezëm një zjarr të mirë. Hëngrem supë të ngrohtë dhe konservë. Besoj se do flemë mirë ngaqë jemi të lodhur.

## Dt 27

Sot e kemi ditë pushimi dhe megjithëse e dinim që do e kishim ditë pushimi gjumi na doli në orën 5:00. Pas mëngjesit, në orën 8:30 ndahemi sipas detyrave që caktuam mbrëmë: Aci me Shefkiun duhet të mbushin 2 bucela, 2 bidona e 5 pagure me ujë rreth 20 minuta larg; Dashi, Romeo dhe Iliri duhet të bënin dru dhe t'i transportonin me slitë, por i transportuan pa slitë.

Në orën 09:30 filloi gatimi i drekës: fasule, supë, gogozhare, sultjash dhe si frut, portokall. Drekë e bollshme dhe e shijshme.

Për darkë supë, sallam dhe salçiqe. Sot koha ishte e ftohtë dhe me erë, sidomos në lartësi.

Shtabi për nesër ka vendosur që të bëhet ngjitje në Jezerë, nëse koha premton. Sidoqoftë Prishtina parashikoi mot të keq, të ftohtë dhe erë të fortë. Le të shpresojmë se do bëjë kohë e mirë. Në darkë përgatitëm ushqimet dhe bazën materiale për nesër. Morali në ekip është i mirë. Me shëndet të gjithë janë mirë veç Romeos që ka bllokim gjoksi.

## Dt 28

Zgjimi në orën 5:00. Për arsye të motit të papërshtatshëm shtabi vendosi që sot të mos bëhen ngjitje. Të gjithë alpinistët bënë

pushim aktiv duke siguruar dru dhe duke mbushur ujë. Dita kaloi shumë mirë duke gatuar gjëra të shijshme dhe të bollshme. Aci po tregohet kuzhinier i kategorisë IV-të. Shefkriu vazhdon si llupës kurse ne të tjerët si të zakonshëm. Për nesër është vendosur të ngjitemi në Jezerë dhe për këtë jemi të përgatitur në të gjitha drejtimet. Prishtina jep mot të ftohtë me temperature deri në – 15 gradë celcius (në zona të banuara) dhe me erë të fortë.

## Dt. 29

Për shkak të temperaturës së ulët dhe borës që binte natën zgjimi u bë në orën 2:30 e më pas në orën 4:30. Për shkak të kësaj kohe grupi nuk mund të ngjitej në Jezerë dhe shtabi vendosi të bëhëj përsëri pushim. Dita koloj si ditët e tjera të pushimeve duke bërë dru, duke mbushur ujë si dhe me gatime të ndryshme. Për datën 30 shtabi vendosi të bëhëj ngjitje në majën e Zhabores, porse Prishtina jep kohë të vretur me rreshje bore dhe pritet furtunë. Të presim mëngjesin nesër. Morali dhe harmonia në ekip është shumë e mirë.

## Dt.30

Zgjimi në 5:00 dhe në orën 6:00 ekipi ynë, i plotë, u nis për në Zhabore. Rruga për në majë ishte me borë të shumtë dhe në të humbje deri në brez, gjë që na lodhi. Në orën 11:30 arritëm në majën e Zhabores dhe në bazë në orën 13:30. Në orën 16:00 bëmë analizën e togës. Më 20:30 darka dhe më pas gjumë.

## Diskutimet

**Aleksandri.** Për këtë veprimtari kemi qenë të plotë nga ana e stërvitjes. Organizimi i ushqimit ka qenë anë e mirë. Iliri është treguar pak pasiv nga ana teknike. Në krahasim me vjet Dashi ishte si nata me ditën. Si ekip ja kemi kaluar mirë dhe kështu ja

kalofshim gjithëmonë. Duhet t'i shohim marrdhëniet me njëri tjetrin si shokë dhe të mos nguroni për iniciativa para meje ngaqë jam trajneri. Uroj që edhe herët e tjera ta kalojmë si këtë rradhë. Në këtë grup ne u dalluam si ekip.

**Shefkiu.** Ne në ekip kemi patur harmoni, dashuri dhe për këtë më vjen mirë. Si grup si në ushqim edhe në ngjitje jemi treguar shumë të rregullt. Përsa i përket shpirtit të iniciativës duhet të angazhohemi më tepër. Për ngjitjet më pëlqeu si Dashi edhe Romeo. Nuk e prisja që Romeo do të shkonte kaq mirë në ngjitjet dimërore. Iliri duhet të punojë më tepër me anën teknike. Mbetem me shpresë që dhe në aktivitetet e tjera të paraqitemi mirë.

**Iliri.** Për aktivitetin dimëror dua të theksoj se që ta përballosh duhet përgatitje fizike dhe këtë unë e shijova. Të meta kam dhe do i rregulloj me kalimin e kohës. Si i ri dua që të aktivizohem në të gjitha punët.

**Romeo.** Veprimtarinë e kisha marrë me dëshirë por nuk më eci për arsye të shëndetit. Do bëj më shumë në përgatitjen fizike. Aktiviteti kaloi shumë bukur. Do të marr pjesë më shumë në jetën e kolektivit.

**Dashi.** Jam dakort me sa thanë shokët. I uroj të gjithë që mbaruam me sukses. Kemi qenë ekipi më kompakt dhe më i mirë. Më pëlqeu jeta kolektive dhe kompaktësia në veprime. Shefkiu ka ndikuar në humorin e ekipit dhe si drejtues shumë i rregullt.

## Dt 31.

NUK është mbajtur ditar dhe nuk është firmosur.

*Nga shkrimi kuptohet se mbajtës i ditarit ka qenë Dashamir Fejzo*

## **Ngjitjet alpinistike dimërore për kategoritë e dyta në zonën e Bogës 11 – 23 shkurt**

**Marrin pjesë shumë ekipe, e ndërmjet tyre edhe ekipi i 17 Nëntorit me përbërje:**

1. Mario Trinkero
2. Shkëlqim Mema
3. Dragush Kulheku
4. Ilir Baraku
5. Agron Shero

### **Dt. 11 shkurt**

U nisëm nga Tirana në orën 8:50 dhe pas tre orë e gjysëm arritëm në Shkodër. U vendosëm në hotel Teuta, turizmi i vjetër. Në orën 18:00 patëm një mbledhje të shkurtër në klubin Vllaznia lidhur me veprimtarinë në Bogë. Pas mbledhjes u ndamë si ekipe dhe shëtitëm paksa nëpër Shkodër, e më pas darkuam tek turizmi i ri. Më pas fjetëm; fjetëm shumë mirë.

### **Dt 12 shkurt**

U zgjuam me shi. Koha ishte prishur gjatë natës. Më pas, me në krye Marjon, u nisëm për në llogoret e kuzhinës për të luftuar me paçet që hëngrëm (lëng nga 2 paçe). Guxhon nuk e kishim as në darkë e as tani pasi vajti tek baxhanaku i tij.

Pas mëngjesit u mblodhëm tek agjencia e udhëtimit dhe u nisëm për në Bogë në orën 10:15 dhe arritëm pas 4 orësh. Gjithë rrugës na shoqëroi shiu. Unë isha në makinën e materialeve, kurse të tjerët me autobus.

Në Bogë u mblodhëm tek dyqanet por aty për arsye të motit nuk mundëm të ngremë kampin. Kështu që komandanti i kampit, Mario, na ndau nëpër shtëpi (baza). Ne u vendosëm tek

shtëpia e Kol Prelës dhe këtu qëndruam. Na pritën shumë mirë. Rreth orës 19:00 i zoti i shtëpisë na ftoi në tryezë. U detyruam të uleshim sepse nuk na lanë të hamë nga ushqimet tona.

Kola ngriti dolli dhe ne e pasuam. Pas bisedave të këndshme e të bukura aty para orës 22:00 shkua për të fjetur.

Dua të them se këta janë shumë mikpritës dhe këtë nuk mundet ta harroj. Ramë në gjumë të gëzuar nga mikpritja e tyre.

### **Dt. 13**

U ngritëm rreth orës 7:30 dhe koha ishte e keqe: reshje bore, ftohtë dhe shumë erë. Rreth orës 9:45 u mblodhëm të gjithë tek dyqanet dhe për të diskutuar për veprimtarinë; u mblodhëm tek dhoma e operativit të Bogës. Më pas u kthyem tek baza jonë ku hëngrëm drekë bashkë me Zefin. Dreka kishte fasule të cilat i bëri Liri me ndihmën e Gonit. Marios i pëlqyen shumë.

Pas drekës Mario, Guxho e Zefi shkuan për vizitë tek Pjetri që është brigadier në kooperativë.

Për darkë përgatitëm pilaf dhe supë të cilës të zotët e shtëpisë i shtuan meze e gjellë me patate. Për darkë këtu tek Kola erdhën edhe mësuesit e fshatit si dhe inxhinieri i pyjeve. Darka kaloi e mrekullueshme ashtu sikundër edhe një natë më parë. Për të fjetur shkua në orën 23:15.

### **Dt 14**

Pas ritualeve të mëngjesit në orën 8:00 u grumbulluam tek dyqanet. Toga jonë dhe ajo e treta u nisëm në drejtim të staneve të Negovanit duke patur si synim itinerarin e majës së Çardakut. U nisëm nëpër një rrugë të bukur dhe tek stanet pushuam pak. Më pas u nisëm dhe arritën në qafën nga ku merret Çardakut e prej aty në majën me lartësi 2025 m. Pasi pushuam u nisëm për kthim pa e synuar majën e Çardakut pasi nuk ishte e mundur.





Një kujtim në malet e Bogës

U ulëm poshtë në 13:15. Koha gjatë ngjitjes ishte e mirë por e ftohtë dhe me pak erë. Në ngjitje morëm pjesë edhe Iliri me Agronin të cilët e kishin këtë për të parën herë. U ngjitën mirë dhe nuk shfaqën shenja lodhjeje. Në bazë përgatitëm drekën e më pas darkën. Pastaj dolëm nga dyqanet dhe pamë Guxhon që skijonte.

Më pas unë e Guxho u hodhëm nga korçarët sepse Guxho kishte harruar atje pincat. Mirëpo Genc Lika i kujton Guxhos se ai i mori dje pincat. Guxho i habitur fut dorën në xhaketën e tij prej shajaku dhe nxjerr pincat. Tek korçarët na kënaqi Tolka me shakatë e tij. Pas kësaj u kthyem në bazën tonë.

## Dt 15

U ngritëm më herët se ditët e tjera dhe pasi u grumbulluam tek dyqanet, morëm rrugën për të ngjitur majën e Bridashit si dhe një majë tjetër. Ngjitja ishte e bukur dhe e vështirë. Gjatë ngjitjes u lidha në litar me Gonin dhe Lirin. Gjatë itinerarit kishte edhe zona orteku, ku ne ecnim me kujdes dhe pa folur. Koha ishte e

mirë. Pasi u ngjitëm u kthym në të njëjtin itinerar. U vonuam ca ngaqë Guxho kishte këmbën të dëmtuar. Mario nuk erdhi me ne se ndjehej i sëmurë.

Sapo u kthym gatuam vezë e sallam për drekë. Rreth orës 5:00 Mario me Guxhon vajtën në mbledhje, kurse Liri, unë e Goni bëmë drekën për nesër si dhe darkën për sot. Tani po shkruaj ditarin që do e vazhdoj më pas.

Në darkë u mblodhëm tek shtëpia dhe pasi hëngrëm ramë për të fjetur.

## Dt. 16

Pasi mbaruam ritet e mëngjesit u grumbulluam tek kisha e Bogës (*kisha nuk funksiononte si institucion fetar që nga viti 1967, por ajo me mjediset e saj shërbente si "institucion" multifunksional për fshatin*). Këtu u ndamë në dy itinerarë: toga jonë në drejtim të majave të Hundës dhe të Pishkanit kurse tjetra në Bridash. Koha ishte e mirë dhe ne u futëm në itinerarin e punuar një ditë më parë nga toga tjetër. Tek arritëm në qafë na u desh të prisnim rradhën për të lëvizur gjë që bëri të ndjejmë ftohë ngaqë frynte erë. Pasi i ngjitëm të dy majat zbritëm poshtë dhe kaluam sikundër ditët e tjera deri sa erdhi koha për gjumë. Nesër e kemi pushim.

## Dt. 17

Pasi mbaruam me veprimet e mëngjesit përgatitëm drekën. Në orën 10:00 vajëm tek Kisha sepse na kërkuan për mbledhje. Këtu komandanti i grupit na komunikoi se të nesërmen do të niseshim për marshim dy ditor. Ne, kategoritë e dyta, për në majën e Radohinës nën drejtimin e Marios. Të tjerët për në Ducaj nën drejtimin e Rushitit të Peshkopisë.

Pas kësaj u kthym dhe pasi përgatitëm materialet filluam të bëjmë ski. Koha është shumë e mirë dhe u kënaqëm. Në darkë

ramë herët për të fjetur. Unë Mario e Guxho do nisemi për Radohinë, kurse Agroni dhe Iliri – ata nuk e kanë arritur ende kategorinë e dytë - janë për në Ducaj.

## Dt 18

U zgjuam më 6:30. Pasi Mario u dha udhëzimet e fundit Gonit dhe Lirit u nisëm për tek vendi i grumbullimit. U bëmë 15 vetë me 3 tenda të tipit “Pamir”. Nisja u bë në 7:30. Itinerari deri në shteg kaloi bukur dhe jo me shumë lodhje. Guxho mori edhe skitë (kjo gjë rezultoi se as duheshin dhe as u përdorën). Pasi pushuam ca morëm në rrëzë të dy majave binjake e më tej në rrëzë të Radohinës.

Arritëm në qafë rreth orës 13:00 dhe pasi hëngrëm drekë me ushqimet që kishim marrë u ngjitëm në njërën prej majave binjake, gjë që u arrit me shumë vështirësi. Nuk bëmë ngjitje tjetër. U kthyem në qafë dhe ngritëm tendat rrëzë një shkëmbi.

Mihali dhe doktori i Fierit dhe më pas unë dhe Themo i Gjirokastrës, premë tre pisha me të cilat bëmë zjarr tërë natën. Temperatura ra shumë; me hamëndje gati -20 a -22 gradë (*historikisht ne kurrë nuk kemi pas marrë termometër me vete*). Unë, Mario e doktori ndezëm kamineton e Marios dhe fjetëm rreth 90 minuta. Më pas na e prishi qetësinë Guxho me ndërhyrjen e tij “brutale”, gjë që bëri që doktori të dalë pranë zjarrit dhe më vonë edhe unë e Mario. Kur dolëm ne, në tendë hyri edhe Eqeremi (Shehu) i Fierit, i cili bashkë me Guxhon fjetën deri nga ora 3:00 e mëngjesit. Gjatë kësaj kohe unë, Mario, doktori, Themo dhe Mikeli (Misha) ndenjem rreth zjarrit. Koha ishte e bukur dhe dukej sikur ishte muzg e jo natë. U hodh mendimi për tu nisur për ngjitje, por nuk ndodhi. Rreth orës 6:00 u ngritëm dhe filluam të mbledhim me shpejtësi pajimet pasi kishte filluar

të binte borë. Pasi u përgatitëm vendosëm të kthehemi për në Bogë dhe kështu bëmë. Ecnim shpejt por me kujdes. Në Gropat e Shtegut pushuam pak. Pastaj zbritëm shpejt në fushë të Okolit e më pas në Bogë

Ndalëm tek shtëpia e Gjeloshit për të pushuar pak Mario, Guxho, doktori, Themo dhe unë. I zoti i shtëpisë na nxorri meze dhe raki dhe ne pimë pak. Më pas u ngritëm dhe ikëm nëpër bazat tona.

Në orën 16:00 Mario, Guxho, Themo, Lulzimi (i Peshkopisë) dhe unë zbritëm në Ducaj me gjithë materiale. Ekipet e Fierit dhe të Korçës do të vijnë nesër. Pasi u rregulluam për të fjetur u ndamë me mendimin për tu takuar nesër. Unë jam në një vend me Gonin, Lirin dhe Ladin e Fierit (Vladimir Mane) në shtëpinë e Gjonit. Liri dhe Goni përgatitën darkën e më pas gjumë.

## **Dt. 20**

U ngritëm në orën 7:00 dhe megjithëse është kohë e keqe (binte borë) u përgatitëm për ngjitje. U mblodhëm tek livadhi mbi fshatin Ducaj dhe pasi pleqëruam situatën u la të pushojmë. Dua të them se alpinistët e kategorive të treta kishin bërë 4 ngjitje gjatë kohës që ne ishim në Radohinë.

## **Dt. 21**

U ngritëm rreth orës 7:30. Binte shi. Përsëri e lamë pushim. Goni me Lirin zbritën në Xhaj dhe blenë bukë misri pasi kemi ngelur pa bukë. Kur u kthyen hëngrëm drekë e më pas luajtëm me letra. Më tej asnjë ngjarje për ta përmendur.

## **Dt.22**

Ngrihemi në 7:15 dhe pasi rregulluam çantat u përgatitëm të bënim mëngjesin e fundit të aktivitetit. Porse nuk arritëm as ta

fillojmë sepse në rrugë u dukën autobusët. E lamë mëngjesin dhe si morëm çantat e çdo gjë tjetër që kishim, si dhe pasi u ndamë me njerëzit e shtëpisë, dolëm në rrugën automobilistike ku dhe na prisnin autobusët. Hipëm në to me gjithë çantat e mëdha pasi ende nuk kish ardhur taksia për to. Sapo do niseshim ja behu taksia ku u desh të fusim disa çanta. Unë erdha në Shkodër me taksinë e materialeve rreth orës 11:00.

U akomodua tek hotel “Teuta”. Në orën 14:00 bëmë analizën tek klubi “Vllaznia” ku diskutoi edhe një burrë, ish sportist. Më pas shëtitëm lart e poshtë nëpër qytet.

Darkuam tek Kafja e Madhe, ku kishim në tryezë edhe Gjon Simonin. U kënaqëm me meloditë e bukura të orkestrës dhe na erdhi keq që u ngritëm herët nga tryeza, më tepër prej Lirit dhe Gonit të cilët shkuan tek një kushuri i Lirit për të parë televizor. Unë e Mario vajtëm tek turizmi për të takuar fierakët me të cilët na shkonte biseda. Patëm vështirësi t’i gjenim, por në momentin që do largoheshim na gjetën ata.

Kaluam ca kohë me biseda poshtë dhe më pas kaluam lart në dhomën e tyre për të treguar barcaleta. Këtu na gjetën Liri me Gonin. Pimë edhe nga një gllënkë “Rozafa” e cila ishte e doktorit (Rakipit) që me vështirësi pranoi që ta hapnim.

Më pas gjumë deri sa në mëngjes na zgjoi Eqerem Shehu i Fierit.

## Dt. 23

U ngritëm në 5:30. Në 6:30 vjen taksia ku futëm çantat e mëdha. Ne nisemi me autobus. Në Laç morëm trenin për në Tiranë. Në Vorë u ndamë me fierakët dhe elbasanasit. Arritëm në Tiranë më 12:30. Guxho iku në Razëm. Edhe kjo veprimtari u mbyll me sukses.

*Mbajtësi i ditarit Dragush Kulheku - firma*

## Aktiviteti veror 10 – 18 korrik 1981

Ditar i mbajtur pas aktivitetit

Pjesëmarrësit: Mario Trinkera, Dragush Kulheku, Shkëlqim Mema (Guxho), Agron Shera, Ilir Baraku.

### 8 korrik

U nisëm nga Tirana në ora 08:50 dhe mbërritëm në Shkodër në orën 13:00. Atë natë e kaluam në Shkodër. Nuk patëm ndonjë gjë me rëndësi që ta hedh në ditat.

### 9 korrik

U zgjuam herët dhe pasi dërguam materialet në agjenci të autobuzave vajtëm të hamë mëngjesin në hotel Turizmi. Nga Shkodra për në Shteg u nisëm aty nga ora 08:30 dhe udhëtuam deri në Qafë Thore. Unë isha me makinën e materialeve, kurse të tjerët me autobus deri në Okol, prandaj dhe nuk e di se çfarë ndodhi në autobus. Në Thore prita ekipin dhe pasi mbartëm materialet, për tek Gropa e Shtegut me 2-3 rrugë vajtje-ardhje, ngritëm kampin. Aty nga ora 18:30 filloi shiu i cili vazhdoi deri në orën 23:00. Ne gatuam në çadrën e vendit (*çadër doku e prodhuar në Ndërmarrjen e Mjeteve Mësimore e Sportive- Tiranë*). Pasi hëngëm ramë për të fjetur.

### 10 korrik

Zgjimi rreth orës 07:30. U nisëm për ngjitje rreth orës 09:00. Grupi ynë (Tirana, Fieri, Tërbuni i Pukës) u nisëm në drejtim të Mark-Zagorës (*majat binjake*). Grupi ynë realizoi dy itinerarë dhe pasi u ngjitëm u nisëm për kthim. Përpara se të fillonim ngjitjet hoqëm keq për të gjetur itinerarët pasi shënimet (*markimet e tyre bëheshin në ngjyrë të kuqe*) ishin zbehur shumë.



Ekipi Apolonia duke drekuar

Kthimin e bëmë shpejt. Arritëm në kamp më 16:15. U paraqitëm tek komandanti, hëngrëm drekë dhe pastaj në pushim luajtëm bamington. Nuk ka shumë ngjarje dhe kështu po e mbyll edhe ditën e parë të aktivitetit. Nesër do të bëjmë ngjitje në shteg tek I-7- ta.

## 11 korrik

Zgjimi rreth orës 06:00; pasi u lamë dhe hëngëm mëngjes u rreshtuam tek sheshi i kampit për tu nisur për ngjitje. Do të nisemi më 08:30 – 09:00 pasi të kontrollohet baza materiale e çdo pjesëmarrësi.

Në ora 09:00 u mblodhëm dhe pasi u kontrollua baza materiale u nisëm për ngjitje. Unë Guxho dhe Eqeremi u nisëm për në Shteg tek I-7. Ngjitjen e realizuam me sukses megjithëse ky itinerar kishte shumë ujë/lagështirë. Pasi mbaruam ngjitjen u

kthyem në kamp dhe u paraqitëm tek komandanti. Më pas dreka dhe kohë e lirë. Rreth orës 18:30-19:00 përgatitëm darkën dhe mëngjesin për nesër. Nesër do të bëjmë I-8, e vështirësisë së VI-të.

## 12 korrik

U zgjuam më 06:30. Unë, Guxho, Mario, Eqeremi, Kujtimi dhe Kastrioti do të bënim I-8 dhe u nisëm në drejtim të saj. Arritëm në rrëzë të saj dhe u përgatitëm për të filluar ngjitjen. Ngjitjen e fillova në orën 09:00. Unë isha i pari (udhëheqës). Kisha një orë që po punoja në shkëmb dhe kur u mata të kaloja një pjesë pak të vështirë, aty më pengoi litari i cili më dha kolpo dhe unë fluturova poshtë. Fat që më mbajti gozhda e dytë nga sipër. Këtu pësova dhe përplasjen dhe theva këmbën (shalën) tek kofsha. Që aty më morën shokët dhe më zbritën poshtë në kamp me shumë vështirësi. Që aty, pasi lajmëruan nga Thethi Shkodrën për ambulancë, mua më morën me barelë dhe më nxorrën në Thore. Aty erdhi ambulanca dhe u nisa për Shkodër. Falenderoj të gjithë shokët që më dhanë ndihmën e parë, sidomos doktorin, Raki pin.

*(këtu e mbyll ditarin me një firmë të tijën Dragush Kulheku)*

## Vazhdimin e ditarit e bën Agroni

Unë dhe Iliri bëmë ngjitje tek I-1 ku isha udhëheqës. Kur zbritëm poshtë morëm vesh se Dragushi ishte rrëzuar tek I-8. Ndërkohë që shokët po e sillnin Dragushin, ne përgatitëm vendin tek çadra e Pukës. Guxho e Kujtimi u nisën për Theth për të lajmëruar. Me ndihmën e të gjithëve dhe veçanërisht të doktorit, Dragushin e rregulluam në barelë dhe e nxorrëm në Thore, e prej atje në Shkodër. Me të ishte edhe Guxho, Raki pi (doktori), etj.



### 13 korrik

Sot është pushim. Pasi u zgjuam përgatitëm dhe hëngrëm mëngjesin. Në orën 09:00 Marjo na bëri një mbledhje e cila u ndërpre nga shiu i cili nuk vazhdoi gjatë.

Ndonëse të mërzhitur nga puna e Dragushit u munduam të shtynim kohën me gjëra të ndryshme, që nga loja me letra e deri tek leximi i librave. Nga ora 11:00 unë dhe Iliri shkua me ekipin e Fierit tek stanet e Thores, ku mbasi bëmë fotografi në një lëndinë shkua edhe tek një faqe pranë humnerës dhe bëmë ngjitje e zbritje (*me nyjen*) margarit. U kthyem në kamp nga ora 17:00 mbasi drekën e kishim marrë me vete dhe e hëngrëm në oborr të stanit. Në kamp përgatitëm edhe hëngrëm darkën dhe fjetëm tek çadra gjermane me Marion, Kujtimin si edhe një shkodran, sepse e jona ishte lagur.

### 14 korrik

U zgjuam më 06:30. Pas mëngjesit, u rreshtuam dhe u nisëm për ngjitje tek Kalaja në I-3 dhe I-4. Aty nga ora 10:00 vjen tek ne në ngjitje Acì dhe pasi ndenji pak, ai nëpërmjet Shtegut zbriti në Theth. U kthyem poshtë në kamp dhe i raportuam zv/komandantit Kujtim Onuzi mbasi Mario ishte nisur për Tiranë. Mbas dreke u detyruam të rrimë brënda në çadër nga shiu që vazhdoi edhe natën.

### 15 korrik

Sot koha ishte e bukur. Pas mëngjesit dhe rreshtimit u nisëm për ngjitje tek I-9. Me ne erdhi edhe Kujtimi, Bruno dhe fotografi i Kukësit. Mbasi bëmë disa foto në ecje dhe në shkëmb, mbaruam ngjitjen dhe u kthyem në kamp. Meqë ishte ditë e bukur dhe me diell bëmë disa foto tek rezervuari i vogël (*lerë për bagëtinë*) aty pranë. Pasditen e kaluam duke luajtur bamington dhe duke

kënduar të shoqëruar me kitarë nga Lavdoshi. Në darkë ra pak shi. Rreth orës 19:00 erdhi një alpinist i Elbasanit që kishte shoqëruar Dragushin dhe më pas erdhi edhe Guxho.

## **Aktivitet veror, 13-28 korrik 1981**

Ngjitjet zhvillohen në zonën e Thethit, stanet e Kllogjes. Marin pjesë:

Aleksandër Bojaxhi, Dashamir Fejzo, Shefki Juma, Romeo Manxhari, Ilir Tapia, Sokol Doko, Niko Petro.

### **E hënë, 13.07.1981**

U nisëm nga Tirana me tren në orën 08:50. Mbërritëm në Shkodër rreth orës 12:30. Në orën 16:00 u nisëm nga Shkodra për në Theth me autobuzat që do të merrnin kampistat. Udhëtimi ishte i mrekullueshëm sepse ishim pak njerëz në autobus. Në Theth mbërritëm në orën 19:00. Ngritëm çadrat tek taracat mbi kamp. Këtë vit periudhën (*ditët*) e grumbullimit vendosëm ta bëjmë në Theth e do të shohim kryesisht zonën e Boshit.

### **14 korrik**

Në mëngjes Aci e unë shkuam në Shteg të Dhenve për të parë se çfarë bënte grupi që zhvillonte aktivitetin atje. Kur patëm mbërritur në Shkodër takuam Guxhon i cili na tha se ishte rrëzuar Dragush Kulheku tek I-8 dhe kishte krisje kocke. E kishin shtruar në spital të Shkodrës. Guxho (Shkëlqim Mema) po interesohej që ta niste për Tiranë pasi duhej të operohej.

Më pas gjetëm një autoambulancë në të cilën ngarkuam çantat deri tek kooperativa (*në qendër*). Ngritëm kampin dhe gatuam drekën.

## 15 korrik

Në orën 07:00 u nisëm për në malin e Boshit. Në kamping mbeti Niko Petro. U kthyem nga ngjitja rreth orës 12:30. Pasdite u interesuam për bukë si dhe për mushkat që do na transportojnë materialet.

## 16 korrik

Bëmë ngjitje tek shkëmbinjtë e kooperativës (*d.m.th.në qendër të fshatit e në anë të djathtë të rrugës automobilistike që të çon në Breg Lum*). Mbaruam ngjitjet shpejt dhe u kthyem tek çadrat.

Pasdite vajtëm tek kampi (Aci, Shefkui, Niko). Niko e Shefkui vajtën tek shtëpia e P. Gj. për mushkë, por megjithëse pritën deri në orën 21:00 nuk dimë ndonjë gjë të saktë sepse ai dukej tip dredharaku. Megjithatë ai nesër do të vijë vetë e do na japë përgjigje. Në darkë pimë pak raki dhe ndenjem deri vonë pranë zjarrit.

## 17 korrik

Edhe sot bëmë ngjitje tek shkëmbinjtë e kooperativës. Niko e Sokoli vajtën në Breg Lumi por nuk i gjetën dyqanet hapur. Pasdite këtu janë grumbulluar të gjithë ekipet për të festuar 25 vjetorin e alpinizmit (*shkollës së parë të alpinizmit*). Nga klubi ynë ka ardhur Andoni (*Tapia*) me zv. Shefin e klubit Xhevair Çomollari. Nga federata nuk ka ardhur kush. Këta, për të organizuar ceremoninë duket sikur kanë ardhur “me lugë në brez”, sa për të përplasur duart dhe për të mbajtur fjalim.

## 18 korrik

Sot koha ishte shumë e mirë. Të gjithë alpinistët ishin grumbulluar për ditën e festës. Mbrëmë nga ora 20:00 erdhi Minella dhe u dha dorën gjithë ekipeve (si duket kjo ishte një

pjesë e ceremonialit të festës). Sot erdhi Eqerem Shaba (sekretari i federatës) dhe udhëzoi që mbledhja të bëhej në sallën e shtëpisë së kulturës Theth.

Kishin ardhur për të na nderuar ne alpinistëve Osman Kraja (rektor i UT), Manol Bozaxhiu, por ne me organizimin tonë nuk i kënaqëm ata.

Në mbledhje referuan: M. Kapo, A. Bojaxhi, M. Trinkero, T. Shehu. Më me vlerë për alpinizmin ishin referatet e Acit dhe Taxhedinit. Një gjë u pa tek këto referate; përshkruhej e shkuara 25 vjeçare e alpinizmit gjatë pushtetit popullor (*gjatë viteve të pushtetit popullor sporti i alpinizmit konsiderohej si sport që lindi dhe u zhvillua gjatë viteve të PPSH në pushtet. Si ditëlindje e këtij sporti konsiderohej korriku i vitit 1956, kohë kur u organizua e para shkollë alpinistike në Thëth. Kështu, veprimtaria malore para*



Pjesëmarrësit e veçantë të takimit

Lart: Vasil Stambuli, Vladimir Memisha, Agim Tabaku, Kozma Grillo, Minella Kapo, Osman Kraja, Petraq Kule, ??, Taxhedin Shehu, Andon Tapia.

Poshtë: Niko Petro, Shkëlqim Mema, Vlash Koxhaku, Aleksandër Bojaxhi, Vullnet Zylyftari, Gëzim Oruçi, Kujtim Onuzi.

*L2B si dhe ajo pas luftës deri në vitin 1956 nuk llogariteshin. Të këtilla vlerësime historike i bëheshin edhe sporteve të tjera)* por nuk u fol fare se si do të jetë e ardhmja e alpinizmit. Kjo mund të ketë ardhur për këto arsye:

- Referuesit nuk ishin përgatitur për të folur.
- Drejtuesit nuk janë në gjendje të përcaktojnë një drejtim.

Pas mbledhjes të gjithë u shpërndanë sipas oreksit; të ftuarit prisnin që të shikonin demonstrimet tona. Xh. Çomollari mbeti i kënaqur nga pritja që i bëmë ne.

## 19 korrik

Sot kishim vendosur për tu nisur (*lart*) por na mbajti kinostudio për të xhiruar një film dokumentar. Fatkeqësisht u prish koha dhe nuk mundën të xhirojnë. Pasdite filloi të bjerë shi. Në darkë bëmë pak debat me Acin për disa probleme:

- Të kërkohej nga federata që të vihem në dispozicion të kinostudios meqenëse në drejtim të propagandimit të këtij sporti jemi shumë mbrapa. Prandaj nëse digjemi në një aktivitet (*d.m.th. nuk bëjmë ngjitjet që duhen bërë*), kjo bëhet për të mirën e punës.
- Baza materiale duhet të përmirësohet sepse me kalimin e kohës është dëmtuar dhe interesimi (*i klubit për ta rigjallëruar*) ka rënë. (*cilësia e dobët*)
- Duhet të jetë shërbimi i mjekut në çdo aktivitet. Aktivitetet të bëhen në vende të tilla që të sigurohet shërbim i shpejtë në rast aksidentesh.

Në këtë kohë (*fillimi i viteve 80-të*) këto debate duken si tendencë për shmangje nga aktiviteti.

Kur ramë për të fjetur koha nuk jepte shenja se do të përmirësohej.

## 20 korrik

Në mëngjes koha ishte shumë e paqëndrueshme, por meqenëse kishim porositur mushkën, dy vetë duhej të niseshin me mushkën. U nisën Aci me Shefkun dhe do të kalonin nga Rrethi i Vishës (*Qafa e Arapit*). Ne të tjerët do të shkonim më këmbë deri tek qershitë dhe aty do të prisnim dy mushka që do na i dërgonte Petriti (*Komandanti i Postës Kufitare*).

Ne arritëm tek qershitë (Kroi Shtrazës) dhe ndërkohë aty kishin ardhur disa mushka nga Breg Lumi. Këto i morën ekipet që ishin aty. Ne ngritëm aty çadrat pasi i premë fare shpresat për mushka. Dy mushkat që dërgoi Petriti i mori ekipi i Partizanit sepse ndodhi një mosmarrëveshje midis Minellës dhe Komandantit të postës.

Tani ne mbetëm vetëm, pa bukë (*por me plot ushqime të tjera*) dhe me një çadër PAMIR. Aci dhe Shefkun kishin vetëm bukë dhe çadër. Kur u kthye një fshatar na tha se Aci me Shefkun ishin lodhur shumë.

Niko me Sokolin vajtën në kamp për të blerë bukë. Në dyqan nuk gjetën dhe më pas vajtën tek Tringu (*Mario Trinkera*). Aty gjetën Ilir Barakun dhe Agron Sheron që u dhanë bukë bujarisht. Kur takuan Tringun ai tha se kishte bërë gabim që i dha pa leje. Në darkë ndezëm zjarr.

## 21 korrik

Mbrëmë nuk fjetëm mirë (*kanë qenë pesë vetë në një tendë që është normalisht për tre vetë*). Në mëngjes na erdhën dy mushka dhe u nisëm për Qafë Pejë. Mbërritëm aty nga ora 11:30. Aty erdhi edhe Aci dhe u nisëm për në stanet e Klllogjes, ku mbërritëm në ora 14:00. Rruga ishte shumë e keqe dhe na lodhën çantat. Kur mbërritëm në Klllogje takuam Shefkun dhe na tha se kishin vuajtur shumë gjatë natës sepse nuk kishin patur ushqime dhe

se ishin lagur. Gjithashtu kishin ardhur edhe dy vetë të ekipit të Gjirokastrës që prisnin mushkat, por mushkat nuk erdhën sepse nuk kaluan dot rrugën.

## 22 korrik

Mbrëmë bëri shumë ftohtë, frynte erë, prandaj gjumin nuk e bëmë të mirë. Sot koha duket e mirë. Nga ora 08:15 u nisëm në drejtim të Radohinës dhe rreth orës 10:00 ishim në rrëzë të saj. Iliri, Sokoli, Shefkriu punuan bashkë; Romeo Dashi punuan bashkë; Aci, Niko gjithashtu punuan bashkë. Të gjithë itinerarët përfundonin në majë. Në majë u takuam dhe bëmë fotografi. Sipas mendimit të të gjithëve, kjo zonë nuk është e përshtatshme për ngjitje sepse shkëmbi është shumë i thërmueshëm. Në rrëzë të Radohinës, Majës së Thatë dhe majës së Livadhit është një gropë (*Livadhet e Bogëve*). Aci mendonte ta shikonte këtë zonë për të bërë ngjitje verore, por si përfundim doli se këtu nuk kishte itinerarë me interes për ngjitje (*ky është një konkuzion i parakohshëm. Livadhet e Bogëve u kthyen në zonë ngjitje, për dimër dhe për verë*). Në orën 16:00 u kthyem në kamping. Gjatë kthimit, meqenëse ishim të ngeshëm, vrojtua disa burime që zhdukeshin nën shkëmbej. Këtu kishte gërryerje/erozion nga uji. Hëngrëm drekën që e kishim bërë që mbrëmë.

## 23 korrik.

Sot koha është shumë e mirë. Ne sot do të punojmë në Vishens sipas këtyre grupeve: Sokoli-Shefkriu në shpatin lindor; Iliri e Niko; Dashi, Aci e Romeo. Ngjitjet kaluan shumë mirë e në kamp u kthyem në orën 14:30.

Në darkë u diskutua për ditën e premte dhe u vendos që Iliri, Romeo e Sokoli të bëjnë ngjitje në itinerarin lindor të Arapit dhe pjesa tjetër e ekipit të bëjë pushim.

## 24 korrik

Koha është shumë e mirë. Iliri, Romeo e Sokoli u nisën për në Arap në orën 8:00. Aci drejtonte poshtë. Ngjitja u realizua shumë mirë. Nuk pati as aksident dhe as gërvishtje. Iliri udhëhoqi dhe punoi shumë mirë teknikisht, tregoi përgatitje të mirë fizike. Romeo punoi gjithashtu shumë mirë. Sokoli punoi shumë mirë dhe tregoi nivel të lartë teknik e fizik. Të gjithëve u erdhi mirë për këtë ngjitje, sidomos neve të ekipit. Më pozitive është se peshën kryesore të ngjitjes e mbajtën dy djem të rinj si nga mosha edhe nga koha që merren me këtë sport. Kjo premtom për të ardhmen. Mbrëmja kaloi me darkën dhe më pas fjetëm.

## 25 korrik

Sot Shefkiu e Niko do të bëjnë ngjitje në shpatin perëndimor të Arapit, Aci e Dashi në majën e Rushkullit; të tjerët pushim.

Ngjitjet vajtën shumë mirë. Mbasdite bëmë tërheqje litari. Ne garuam me Beratin dhe u mundëm. Koha vazhdon të jetë shumë e mirë. Dielli djeg shumë. Burimi ka filluar të shterojë. Të shohim se sa do na mbajë.

## 26 korrik

Sot Aci u nis për të shoqëruar Sokolin, Shefkiun dhe Ilirin që do të bëjnë ngjitje në një itinerar të kontrolluar në Kolaj (*kategorizimi sportiv tashmë kërkonte ngjitje të përcaktuara për kategoritë e larta sportive*). Dashi dhe Romeo bënë ngjitje në Shtog. Niko ndenji dezhuarn tek çadrat.

Ngjitjet u kryen me sukses. Për nesër koha duket se do të prishet. Pasdite u lexua rregullorja e alpinizmit dhe u bënë disa sqarime. Në darkë si zakonisht u mblodhëm tek çadra e madhe dhe kaluam me biseda.



## 27 korrik

U zgjuam herët nga të ftohtit dhe shqetësimi për kohën. Koha duket shumë e keqe; kudo mjegull dhe fryn erë. Aci lexoi urdhrin e ditës dhe tha se n.q.s. koha hapet deri në 08:00 do të bëjmë ngjitje, por kur e pamë se nuk kishte ndërmend të hapej u nisëm më 07:30 dhe më 09:30 ishim tek qershitë. U rruajtëm, dhe u lamë pak. Aty erdhi edhe Minella dhe tha që grumbullimi do të bëhej tek kampi. Kjo sikur krijoi disa mosmarrveshje sepse disa kishin shkuar tek kooperativa (*qendra e fshatit*). U mbledhëm dhe bëmë konkluzioonet e ngjitjeve. Ekipi ynë u vlerësua shumë e sidomos Sokoli e Iliri. Në darkë kemi vendosur të festojmë përfundimin e aktivitetit

Koha është shumë e ftohtë, aq sa të gjithë jemi veshur me triko leshi. Për nesër mendohet të shkojmë direkt në Lezhë, por të shohim sepse shkodranëve nuk ju zihet besë për punë automjetesh. (*transporti*).

*Mbajtës i ditarit Dashamir Fejzo*

## VITI 1982

Fjalët si më poshtë mi tregoi  
Hazir Malaj.  
Mbledhur në Janar 1982



Alpinisti Hazir Malaj (mjek mikrobiolog)

### Nga Tropoja

Bunar = pus

Çetë = qetë = vend me bar i rrethuar me shkëmb

Ecur për ngri = ecur nëpër borë të ngrirë

Mjellacë = borë e qullët

Asht dejë = është pa borë, ka shkrirë bora

Rrehe = gjurmë në borë, brazdë

Ferkem = gjurmë teke në borë a baltë që nuk është brazdë

Suka = kodrinë e rrumbullakosur që dominon në vendin  
rrethues

Telë = bun, stan

Çetina = pisha bastarde si shkurre

Ortek = ortek; lugina/lugu ku bie orteku

Streç = borë që bie nga mjegulla.

Mamroc = borë si oriz i bardhë

## Nga Shala

Goxhek = paramajë e dhëmbëzuar, vend me gurë në shpat të ëmbël

Qafalok = qafë mali e vogël

Rreze = vend mali që e rreh dielli, sidomos pasdite

Prapshti = vend mali që nuk e rreh dielli.

**Shënim:** R.R. kur ngacmohej, ose vihej në provë, i binte të fikët (këtë ja tregoi V i vëllai i R).

Aktiviteti dimëror Rrogam-Bjeshkët e Krasniqes- Liqeni Ponareve - (Markajt); Janar 1982

Pjesëmarrësit:

1. Aleksandër Bojaxhi, Trajneri
2. Dashamir Fejzo
3. Mario Trinkero
4. Romeo Manxhari
5. Sokol Doko
6. Shkëlqim Mema, Përgjegjës i ekipit
7. Niko Petro



Ekipi që realizoi kalimin e kreshtës Rrogam-Bjeshkët e Krasniqes- Liqeni Ponareve - (Markajt) Sokol Doko, Mario Trinkera, Dashamir Fejzo, Romeo Manxhari, Shkëlqim Mema. (Fotografoi Aleksandër Bojaxhi)

## 17 janar

U nisëm nga Tirana rreth orës 7:00 dhe në Laç ndërruam autobusin. Rruga kaloi shumë mirë. Në B. Curri zbritëm rreth orës 16:30. U sistemuam në hotel. Në darkë erdhi Haziri dhe bisedoi me Acin për punën e ndërlihdjes dhe transportit për nesër. Këtu bën shumë ftohtë dhe ka mjegull. Nesër mendojmë të nisemi për Rrogam.

## 18 janar

Në mëngjes me Nuredinin biseduam për makinë. Në ora 12:00 u nisëm me vëllain e Nuredinit, Agimin, (*shofer kamioni*) i cili na çoi deri tek vendi ku fillon zalli (*Llomi i Keq apo Llomi i Mehmetit*). Nuk bëmë as 100 metra rrugë dhe na takoi një fshatar që kishte kafshë të ngarkuara dhe na i mori plaçkat deri në Rrogam. Këtu u vendosëm tek shtëpia e Ndue Gjergjit. Një shtëpi kjo shumë simpatike me dhomë të vogël dhe njerëz mikpritës. Ne që në fillim i thamë që ushqimet i kemi vetë, megjithatë në darkë na shtruan djathë dhe bukë misri. Për nesër koha duket shumë e mirë. Darkën e kaluam me humore për punën e flokëve; ky është një “problem i madh” që duhet zgjidhur. “Ata që janë me flokë janë të mënçur apo jo, po kështu edhe për qerosët”. Për këtë u fut në lojë edhe plaku 102 vjeçar i shtëpisë. Për nesër, do të çojmë materiale deri në bjeshkë.

## 19 janar

Koha është shumë e mirë. U nisëm rreth orës 08:30. Rruga kaloi shumë mirë. Kishte akull gjatë rrugës. Niko, Dashi dhe Romeo rrëshqitën gjatë rrugës por nuk patën ndonjë dëmtim. Në qafë mbërritëm rreth orës 13. Në shtëpi u kthyem në orën 15:30. U lodhëm pak. Me raki festuam 20 vjetorin e Acit (Aleksandrit) në alpinizëm. Niko (*duket*

*që ditarin për këtë ditë e ka mbajtur Niko Petro).*

## 20 janar

Në ditën e sotme duket një prishje e lehtë e kohës, gjë që e dha edhe televizori. Por megjithë këtë nisja u bë në ora 07:30 duke marrë të gjitha materialet e mbetura. Gjatë rrugës (lugut) Niko nuk e ndjente veten mirë. Kishte marrje mendsh dhe këputje të gjithë trupit. Për këtë gjë Aci i tha që të kthehej dhe të qetësohej në shtëpinë ku fjetëm dhe të nesërmen të vinte/ngjitej me ekipin e Tropojës. Mirëpo një gjë e tillë nuk ndodhi sepse Niko u nis për në Bajram Curri dhe prej andej në Tiranë, gjë që ne si ekip na shqetësoi shumë. Ne mbërritëm në qafë në orën 11:30, ku ngritëm çadrat dhe kaluam një natë me gjumë jo të rehatshëm. Në këto dy ditë përgatitje të mirë fizike tregoi gjithë ekipi, por veçanërisht Sokoli.



Në Krasniqe 1982. Sokol Doko, Mario Trinkera, Shkëlqim Mema, Aleksandër Bojaxhi

## 21 janar

Zgjimi në orën 7:00 dhe sipas planit sot duhet të pushtojmë dy maja: Boshin dhe Zhaboren. Në ora 8:00 nisemi në drejtim të Zhabores të cilën e pushtojmë shpejt dhe mirë dhe pastaj vazhdojmë rrugën në drejtim të Boshit. Kjo ishte një rrugë pak a shumë e gjatë dhe në orën 11:00 arritëm majën. Në majë dolëm edhe në fotografi. Pastaj ulemi në kamping. Shohim që po vinin tropojanët e me ta shohim telekronistin, Ilirin, vendas (*me Ilir Buçpapën ishte edhe Hajdar Hasa*). Përshëndetemi me ta dhe i ndihmojmë që të ngrenë çadrën. Pasi hëngrëm bukë Nuredini me Hazirin u nisën të ngjisin të dy majat gjë që e realizuan me sukses.

## 22 janar

Mbrëmë në darkë vendosëm që të lëviznim në drejtim të shpatit jugor të Krasniqes. Është rrugë në një traversë të fortë me pjerrësi vende-vende rreth 60-65° dhe thellësi të madhe, gjë që e bën kalimin të frikshëm dhe një gjë e tillë vonon shumë lëvizjen sepse kalimi (*ecja*) bëhet me sigurim, bora është e ngrirë dhe kur i bie dielli kthehet në ngjitëse; të mbush kthetrat. Sipas planit nuk ecëm (përparuam) deri atje ku duhej dhe vendosëm të ngrinim kampingun. Fjetja është e njëjtë si natën e parë. Futja në çadër bëhet që në orën 17:00 sepse bën shumë ftohtë sado që



koha është e mirë. Dallohet Mario për kuzhinë dhe Sokoli për shërbime.

## 23 janar

Nisemi në orën 08:30 në drejtim të bunit të Qereçit. Rruga është po ajo, e vështirë si e djeshmja, (*dhe ecim*) ku me sigurim e ku pa të. Në gjysmën e rrugës sonë shohim grupin tjetër me drejtues Taxhedinin në kreshtën e Gavnit (*ky grup do të bënte të njëjtin itinerar si ne por në sensin e kundërt*). I takuam në darkë mbasi ne i kishim ngritur çadrat.

Sot Dashit i ndodhi një bllokim në muskulin e pulpës së këmbës së djathtë ku ka patur një dhimbje të tmerrshme gjë që e la pa gjumë gjithë natën megjithë fërkimet që i bënë shokët.

## 24 janar

Zgjimi ora 07:00 dhe sipas planit ne do të bëjmë kalimin në Grykat e Hapura. Nisen të gjithë, edhe telekronisti, i cili do të zbresë në Valbonë me Hajdar Hasën si shoqërues. Në kamp rri Dashi me urdhër të doktorit (*Hazirit*). Të shohim si do të shkojë ngjitja. Morali në grup është i lartë. Ndjehet një farë lodhje nga pagjumësia. Vihet re që Guxho është një pirës uji i tmerrshëm; gjithashtu edhe Sokoli. Marjo po kuzhinjer i dalluar dhe njeri që bisedon shumë.

Radio Iliria, prodhuar dhe  
montuar në vendin tonë.



Të gjithë shokët, me përjashtim të Dashit, sot nuk janë kthyer në kamp. Dashi është vetëm dhe e ndjen shumë merakun e shokëve se nuk e di se çfarë u ka ndodhur. Unë (*Dashi*) prita deri në orën 22:00 tek zjarri duke bërëtitur herë pas here, por përgjigje nuk kishte. Gjithë natën kam ndenjur pa gjumë dhe pa bukë. Mezi prisja që të gdhihej. Falenderoj shokët e tropojës për radion (*ishite radio me bateri, tip Iliria*) që më lanë, se pa të do të çmendesha fare.

## 25 janar

Në ora 5:00, sipas radios, më doli ai pak gjumë dhe mezi prisja që të zbardhte. Më 7:00 dal jashtë por mjegulla e dëndur nuk të lë të shohësh fare majat e maleve. Rri e pres tek zjarri (*për fat, aty ku u ngritën çadrat tona ishte një pishë e madhe e vetmuar*) duke pirë cigare jashtë mase ngaqë nuk di se çfarë të bëj i vetëm. Pres të shohim se çfarë do të na sjellë dita e sotme dhe ja në orën 16:00 dëgjoj zig-zagun e shokëve që po ktheheshin në kamping. Ishin të gjithë mirë. Mësova se mos kthimi në kamping një natë më parë ishte sepse ata i kapi nata në Majën e Grykave të Hapura, për arsye se jashtë planit u ngjitën edhe në majën e Lugbatit (*Maja e Madhe*). Për këtë arsye ata zbritën në Valbonë, ku fjetën tek shtëpia e Beqirit dhe ajo e Ndreut. Në kamp erdhi Aci me Romeon, kurse Sokoli, Guxho, Mario, Nuredini e Haziri shkuan në Majën e Gavnit dhe shpejt u kthyen shëndoshë e mirë. Aci me Romeon përgatitën zjarrin dhe ujin. Darka shkoi me biseda rreth çështjes time që kam ndenjur vetëm për dy ditë (*dhe një natë*) rresht.

## 26 janar

Me urdhër të shtabit drejtues Dashi me Romeon duhet të zbresin poshtë në fshatin Qereç për arsye të këmbëve të sëmura. U nisën



në orën 10:00 pa çanta dhe mbërritën në fshat në orën 19:30 dhe u sistemuan në tek shtëpia e sekretarit të organizatës bazë të partisë shokut Pjetër Ndou, ku na u bë një pritje e ngrohtë. Në darkë ramë dakort që shokët e fshatit të na siguronin dy mushka, gjë që u sigurua. Të gjithë pjesëtarët e kësaj familje pyesnin për Tiranën, etj. Më dt 27.I.82 në orën 12:00 nisemi nga Qereçi në drejtim të Mulaj ku na mori në shtëpinë e tij mësuesi Gjini Malaj, që na bëri një pritje shumë të ngrohtë dhe miqësore. Darka kaloi me pak raki e shumë biseda. Më 13:00 të natës (*duhet të jetë fjala për orën 1 pas mesnate*) filloi një borë e lehtë e cila na shoqëroi gjatë ditës deri në Lekbibaj ku mbërritëm mbas 6 orë rrugë të lodhshme e të vështirë. Një mushkë na u rrëzua por nuk u dëmtua. Në orën 16:00 sigurojmë një skodë (*lloj kamioni*) e cila na solli deri në B. Curri, ku mbërritëm në Hotel Turizmi në orën 20:00. Datat 28 dhe 29 i kaluam në B. Curri dhe pritëm shokët që erdhën më datë 30.I.82 tek shtëpia e Nuredinit. (*Ditar i mbajtur nga Dashi*).

## Fillon ditarin Aleksandri

### Për dt 24

Dashin e lamë tek çadra. Ka dëmtuar këmbën në kalimet e traversave (ka ënjtje dhe dhimbje të kavigjerve). Nisemi ora 07:30. Ora 10:00 jemi gati për kalimin (*është fjala për kalimin nga zona e Currajve në zonën e Valbonës, nëpër atë që ne e quanim kalimi*), por telekronisti kërkon që të ngjitemi fillimisht në majën e Lugbatit ku të ngjitet edhe ai dhe të filmojë. Ja plotësojmë dëshirën. Me të (Iliir Buçpapa) vjen edhe Hajdar Hasa që është në grupin e katërt (*një nga katër grupet e alpinistëve që ishin krijuar dhe caktuar për të kryer ngjitje në zonën e Valbonës*) i cili do të shoqërojë Ilirin

për të vajtur në Valbonë. Më ora 11:00 jemi në majë. Ulemi dhe më 12:20 fillojmë kalimin e Shtegut të Deshëve (*në fakt Shtegu i Deshëve quhet pika apo qafa e kalimit nga Valbona/Ziçi në Motinë*). I pari futem unë. Kalojmë një nga një. Në mes (*të kalimit; itinerarit*) është diçka më vështirë se dy vjet më parë mbasi (*tani*) ka borë më pak. Më 14:45 dalim mbi Ziç. Tentojmë ngjitjen në Grykat në itinerar të ri, pranë shtegut. Ora 15:00 Iliri e Hajdari nisen poshtë për Valbonë. Tentativa jonë zgjati dhe vendosëm të devijojmë e të ngjitmi në rrugën tradicionale, 10 metra më majtas. Kalon Nuredini pjesën shkëmbore e pas tij ne, të gjithë me sigurim. Më 17:00 arrijmë majën. Të fundit ngjiten Haziri e Sokoli.

Zbresim me sigurim duke lënë një kazëm (*për të mundësuar zbritjen dhe për të ndihmuar marrjen e litarit të bërë në dysh gjatë zbritjes*). Kur u tërhoq litari kazma fluturoi. Ne e ndjemë, por nga errësira nuk e përcaktuam. Të nesërmen e pamë por nuk e morëm (*do na vononte*). E mori grupi i katërt (*pas 1-2 ditësh*).

Kur u ulëm të gjithë ora ishte 18:30. Errësirë. Vendosëm të lëmë në shqetësim Dashin të vetëm në çadër e të mos kalojmë në errësirë shtegun/kalimin. Zbritëm në Valbonë në ora 20:45. Unë, Guxho, Nuredini tek Beqir Sadiku; Haziri, Mario, Romeo, Sokoli tek Luigi Pëllumbi. Na pritën mjaft mirë.

Mario Trinkera në  
majën e Brijasit



## Për dt 25

Para orës 8:00 të gjithë u mbledhën tek ne. Guxho e Nuredini shkuan në Valbonë të blejnë dy bukë. Ora 09:10 u nisëm. 10:30 jemi tek Buni i Ziçit; 13:15 ne filluam uljen në shteg dhe më 14:30 dolëm mbi Lugbat (*dolëm matanë në zonën e Currajve*). Pushuam dhe hëngrëm dhe pastaj unë e Romeo u ngjitëm në majën 2.206 metra, kurse të tjerët në Gavën.

Unë (dhe Romeo) u ktheva ora 16:00 në kamp ku takuam Dashin. Këmbën e ka më keq. Edhe Romeos i ka filluar e njëjta gjë si Dashit. Të tjerët ngjitën Gavnin më 16:45 dhe e arritën kampin pak para orës 18:00.

## Për dt 26.

Pas disa diskutimesh e lëkundjesh, Dashi e Romeo, pa materiale, nisen për Qereç që nesër të fillojmë rrugën për kalim në B. Curri. Më 10:00 ne nisemi për Brijas ku arrijmë më 13:15. Pastaj, prej këtu nisemi për Krasniqe. Unë e Mario për Krasniqen Veriore, të tjerët për atë Lindore. Arritëm gati njëherësh ora 14:30. Më 16:30 jemi në çadra. Dita ishte më e ngrohta dhe më e mrekullueshmja. Në darkë shohim se Sokoli ka ngrirje. Mbrëmë këmbët e ngrira i ka futur në zjarr dhe sot ka fluskë. Edhe ai nesër do ulur në Qereç. (*Sokoli kur u kthye një ditë më parë nga ngjitja i afroi këmbët e zbathura në një zjarr të pakët. Ai u harrua tek bisedonte dhe e teproi duke i mbajtur ato pranë zjarrit*).

## Për dt 27

Pak para orës 10:00 unë Guxho dhe Sokoli me materialet e Sokolit, Dashit dhe Romeos si dhe gjëra që nuk na nevojiteshin (*për më tej*) u nisëm për Qereç. Në 2/3 e rrugës për fshat nisëm Sokolin që të merrte Romeon dhe më pas të vazhdonin ata transportimin

e materialeve. Pasi pritëm rreth 30 minuta unë e Guxho u ulëm më poshtë. Pushuam pak tek burimi në hyrje të Qereçit dhe kur do të riniseshim erdhi Romeo me Sokolin. Romeo ishte shumë i shqetësuar dhe nuk merrej vesh se ç'dëshira kishte. U ndamë dhe unë e Guxho u rinisëm për traversë. Arritëm më 15:00 në traversë në lindje të brinjës jugore që zbret nga maja e Gavnit. Vazhduam dhe më 15:30 gjetëm materialet tona, të lëna nga Mario, Nuredini e Haziri të cilët e filluan shpërnguljen e kampit sapo ne filluam uljen për në Qereç. Marshimi ynë (*i gjithë grupit*) ndali në Gropëz, nën Qafë Droçe më 18:30. Ngritëm çadrat. Koha është prishur dhe ka filluar bora. Fjetëm ngrohtë.

### **Për dt. 28**

Më 07:20 me kampin të ngritur filluam marshimin. Në qafë lamë materialet dhe përmes mjegullës e erës më 10:45 arritëm majën e Paqes (*Maja e Hekurave= Maja Marroces*).

U ulëm nga maja dhe vazhduam rrugën për në Liqe të Markajt (Liqeni i Ponareve). Më 13:00 arritëm aty dhe u futëm në pikën gjeologjike (*në baraken e gjeologëve*) ku u kënaqëm me pritjen e Mhillit dhe Groshit. Aty kaluam natën.

### **Për dt 29**

E kaluam ditën me pushin në liqen. U njohëm me kuriozitetet e liqenit, me zbulimet për baoksid dhe folëm për bukurinë e rrallë që ka ky vend deri në lartësitë pranë majës së Marroces.

### **Për dt 30**

Ora 10:00, pasi dolëm në fotografi, nisemi për Markaj. Rrugës bëmë fotografi në ambjentin e bukur përreth. Arritëm në Markaj tek shtëpia e Nuredinit pas orës 12:00. Hëngrëm drekë. Guxho e Haziri u ulën në B. Curri. Pasdite erdhën edhe Dashi, Romeo



Në majën e Brijasit. Sokol Doko, Hazir Malaj, Mario Trinkera, Nuredin Seci, Aleksandër Bojaxhi

e Sokoli. Më vonë edhe Guxho me Hazirin. Bëmë analizën dhe kaluam një darkë të këndshme.

### Për dt 31

Nga ora 11:00 u nisëm për B. Curri ku arritëm shpejt. U stabilizuam në hotel dhe u morëm me plotësimin e dokumentave (të veprimtarisë që kryem). Çdo gjë u mbyll më së miri.

*(Firmosur, Aleksandër Bojaxhi. Ky ditar duket se është mbajtur nga Niko, Dashi dhe Aleksandri. Nga lloji i shkrimit të dorës dyshoj se pak ditar është mbajtur nga një dorë e katërt, ose Dashi ka qenë në pozicion të keq për të shkruar dhe duket një shkrim ndryshe nga ai i tij)*

## **Aktiviteti dimëror për kat. II dhe III Shkurt 1982**

### **14 – 22 Ducaj**

Pjesëmarrësit:

Andon Tapia

Trajneri

Sokol Doko

Arben Qato

Roland Deliallisi

Mazllum Feka

Xhemal Begea

### **13, e shtunë 1982.**

Një ditë më parë u nisëm nga Tirana për në Shkodër dhe udhëtimi shkoi shumë mirë. Patëm ca peripeci për të siguruar fjetjen në hotel.

Të nesërmen u nisëm nga ora 11:00 për në Ducaj me autobus bashkë me ekipet e tjera. Çantat e shpinës i lamë në Shkodër që më vonë t'i merrte kamjoni. Aty lamë Sokolin. Udhëtimi kaloi mirë dhe pasi erdhën çantat në orën 14:00 ngritëm çadrat dhe u morëm me rregullimin e plaçkave. Dita kaloi shumë mirë. Xhemoli

### **14, e dielë**

Koha është shumë e bukur; ditë dimri që nuk është parë ndonjëherë në këto krahina. Dita e parë e aktivitetit për sezonin dimëror. Në orën 08:00 u rrjeshtuam në sheshin para çadrave dhe oficeri i ditës lexoi urdhërin e ditës. Sot ekipet, të ndarë në bazë të togave, do të ngjiteshin në malet e Germit, Vidhgashit me shkallë vështirësie të dytë dhe të tretë. Më 08:15 u nisëm drejt majave; rruga shkoi mirë. Pasi u ngjitëm në majën e Germit vazhduam ngjitjen drejt majës tjetër. Rruga është e vështirë, bora

është e ngrirë dhe u detyruam të përdorim kthetrat. Në orën 11:15 arritëm në majë dhe pasi bëmë një zig-zag të fortë filluam zbritjen nga një itinerar tjetër. Zbritja që akoma më e bukur se sa ngjitja. Ndieje kënaqësi teksa zbrisje duke përdorur kazmën nëpër faqen e bardhë të malit. Në ora 14:00 arritëm tek çadrat. Pasi hëngrëm drekën e përgatitur nga trajneri u morëm me punë personale dhe me përgatitjen e darkës. Kështu dita e parë e aktivitetit kaloi me sukses. Xhemali

## 15, e hënë

Sot dita është e vrenjtur, me borë dhe ftohtë. Piksynimi ynë për sot ishte të ngjiteshim në malin e Majës së Madhe duke kaluar nga maja e Bucinës me shkallë vështirësie 4, kurse Maja e Madhe ishte e shkallës së 3-të. Pasi bëmë përgatitjen për ngjitje, në orën 08:00 bëmë nisjen të ndarë në toga. Në fillim ndoqëm po atë rrugë që bëmë dje e pastaj morëm nga e djathta e Vidhqashtit prej nga dolëm në majën e Bucinës. Gjatë kurrizores patëm ca vështirësi për ngjitjen e majës. Në orën 12:00 arritëm në majë. Ashtu të dërsitur e pa pushuar, duke marshuar përmes borës që binte, vazhduam rrugën drejt Majës së Madhe. Aty u ndamë në dyshe e treshe të lidhur me litar. Në dyshen e parë ishin Sokoli me Rolandin, në treshe ishim Mazi, Beni dhe Xhimi. Aty u përdorën rreth 20 litarë. Në orën 13:00 mbritëm në majë. Gëzim i madh për ne e për të gjithë ekipin tonë. Pasi bëmë fotografi, bashkë me trajnerin e Fierit dhe të Krujës bëmë një zig-zag të fortë.

Zbritja nuk ishte dhe aq e lehtë. Atë e bëmë me sigurim sepse bora ishte shumë e ngrirë dhe paraqiste rrezik (*rëshqitje*) për ne. Pasi zbriti Beni, zbriti Xhimi, Rolandi, dhe i fundit Koli pa litar sigurimi sepse i besoi dy kthetrave të veshura. Më 14:30 mbritëm në kamp ku na përgëzoi komandanti i kampit, njëherësh trajneri ynë, Andon Tapia që ka fituar simpati dhe

dashamirësi tek të gjithë alpinistët për organizimin e aktivitetit. Meritë për këtë ngjitje ka edhe komandanti i togës tonë Sokol Doko që na udhëhoqi deri në fund të ngjites duke u sjellë si vëllai ynë. Xhimi.

## **16, e martë**

Sot ngjitesit u ndanë në dy itinerarë dhe filluam në orën 06:00. Me itinerarin e parë u ngjitëm në malin e Rabës, të shkallës së 5-të të vështirësisë. Të tjerët u nisën në orën 09:00 me qëllim që të njiheshin me zonën dhe me rrugën që duhet të ndiqnin për të shkuar në majën e Rabës me itinerar të shkallës së 4-t të vështirësisë.

Pasi bëmë një pushim të vogël, trajneri i Fierit, Eqerem Shehu, na njohu me zonën dhe na foli mbi rëndësinë e ngjites; gjatë rrugës takuam komandantin. Në orën 12:00 arritëm në kamp. Kurse për ngjitjen e Rabës nëpër itinerarin e shkallës së 5-të të vështirësisë do t'i shkruajë përshtypjet Koli pasi nga ekipi ynë vetëm ai vajti në Rabë. Xhimi

Pasi u nisën në orën 06:00, pushimin e parë e bëmë në ora 08:30 tek stanet. Në ora 09:00 u nisën drejt Rabës. Sa filloi bora e ngrirë u ndamë në dyshe e treshe të lidhur në litar. Koli ishte në litar me përgjegjësin e Pukës, Ganiun. Rruga ishte pak e vështirë për arësye të borës që kishte ngrirë dhe paraqiste rrezik në rëshqitje. Në orën 10:20 mbrritën në majës dhe më 11:30 filloi zbritja. Zbritja ishte më e vështirë se sa ngjitja. Më 12:30 arritëm tek stanet dhe më 14:30 në kamp. Aty na priti komandanti i kampit dhe na uroi për ngjitjen. Koli.

## **17, e mërkurë**

Këtë ditë e bëmë pushim sipas urdhërit të shtabit të ngjitjeve. Gjatë ditës nuk pati ndonjë gjë interesante. U morëm me



rregullimin dhe sistemimin e çadrave, me punë personale. Pasi hëngrëm drekë, mbasdite bëmë leximin e raportit të sh. Enver Hoxha mbajtur në kongresin e 8-të të P.P.Sh.. Në ora 21:00, mbas darkës, u përgatitëm për të nesërmen. Nesër do të bëjmë ngjitje në majën e Rabës, itinerari kategoria e 4-t.

## 18, e enjte

Kohë shumë e bukur që nuk është parë ndonjëherë (!) në këto male në këtë stinë dimri. Për ngjitje u nisëm në orën 06:30; me ne erdhi dhe trajneri ynë. Më 08:10 bëmë pushimin e parë. Kur mbërritëm në majën e parë u ndamë në dy grupe për arësye të fillestarëve. Treshja jonë e parë, Koli, Beni dhe Mazi u nisën në orën 12:30 nga maja e parë dhe në orën 13:15 pushtuan Rabën e kategorisë së 4-t. Në orën 13:45 u nisa unë me trajnerin (*përgjegjës*) e ekipit të Vlorës, Shkumbinin, dhe me Artur Dervishin e ekipit të Fierit. Në orën 14:20 arritëm në majë. Gjatë zbritjes nga maja patëm vështirësi për arësye se rruga ishte e ngrirë dhe shkëmbore. Grupi i parë mbërriti në kamp në ora 15:15, kurse ne mbërritëm në orën 18:00 bashkë me ekipin e Fierit. Xhimi.

## 19, e premte

Në orën 07:00, pasi u lexua urdhëri i ditës, u nisëm në bazë togash në drejtim të malit të Thatë. Toga jonë, nën drejtimin e Kolit, eci më shpejt deri tek lugu, dhe bëmë pushimin në orën tetë. Pas pak erdhi dhe toga e dytë. Pas pushimit u ndamë në dy grupe: grupi ynë vazhdoi marshimin në kurizore (*kreshhtë*) të malit. Rruga ishte e ngrirë dhe me pjerrësi të madhe. Në orën 11:10 mbërritëm në majë. Më 11:20 filluam zbritjen. Rrugës takuam togën tjetër që tashmë ishte afër majës. Më 14:00 mbërritëm në kamp. Mbasdite pushuam dhe vazhduam leximin e raportit të kongresit të 8-të P.P.Sh. Nesër me sa duket kemi pushim.

## 20, e shtunë.

Sot, për të parën herë gjatë ditëve të aktivitetit, kampi dhe natyra ishin mbuluar me borë. Mbasi hëngrëm mëngjesin u muarëm me sistemimin e çadrave. Dita kaloi mirë dhe nuk pati gjë të rëndësishme. Xhimi.

## 21, e dielë

Shtabi i ngjitjeve vendosi që nesër të bëhet pushim dhe sot të bëhen ngjitje të shkallës së 2-të dhe të 3-të. Unë Koli e Mazi bëmë ngjitje të shkallës së dytë, kurse Beni të shkallës së 3-të. Nisja u bë në orën 09:00 dhe kthimi në orën 13:00. Pas ngjitjes hëngrëm drekë. Rolandi dhe trajneri shkuan të shikojnë ndeshjen në televizor kurse ne të tjerët u ulëm pranë zjarrit dhe biseduam. Xhimi.

## 22, e hënë

Dita e fundit e aktivitetit për këtë sezon. Bora që kishte rënë dje mbasdite dhe që vazhdoi gjatë gjithë natës i kishte mbuluar së tepërmi çadrat tona. Në mëngjes, pasi hëngrëm dhe bëmë hallvën tradicionale, dolëm në fotografi si ekip si edhe me ekipin e Fierit. Në drekë shkuam tek shtëpia e një fshatari bashkë me ekipin e Krujës. Kur filluam sistemimin e çadrave, në orën 16:55 në shtëpinë tonë erdhi nga Shkodra trajneri i Pukës, Ganiu, ku kishte shkuar që ditën e shtunë për punën e autobuzëve që do të na merrnin dhe ... e fjetjes. Pasi u takuam me të, na lajmëroi se do të niseshim sonte, sepse autobuzat na prisnin në Dedaj. Në orën 17:30 një skodë na mori nga Ducaj në Dedaj. Atje u hipëm autobuzëve dhe arritëm në Shkodër. Të nesërmen u nisëm për Tiranë. Ky aktivitet shkoi shumë mirë. Në Tiranë u kthyem shëndoshë e mirë.

*Mbajtësi i ditarit Xhemal Begea – firma*

Më poshtë vijon tabela përmbledhëse e ngjitjeve në këtë veprimtari. Kjo tabelë është pjesë e ditarit.

**Ekipi # Nëntorit**  
14-22 shkurt 1982 Dncaj

|        |        |            |         |        |        |       |          |         |       |      |      |      |          |       |       |       |    |
|--------|--------|------------|---------|--------|--------|-------|----------|---------|-------|------|------|------|----------|-------|-------|-------|----|
| 1      | Andon  | Fejzo      | Trajner | -      | -      | -     | -        | po      | po    | -    | po   | -    | -        | jo    | jo    | jo    | 3  |
| 2      | Sokol  | Doko       | I       | po     | po     | po    | po       | po      | po    | po   | po   | po   | po       | jo    | jo    | jo    | 8  |
| 3      | Xhemal | Begeja     | III     | po     | po     | po    | po       | po      | po    | po   | po   | po   | po       | jo    | jo    | jo    | 10 |
| 4      | Arben  | Gato       | III     | po     | po     | po    | po       | po      | po    | po   | po   | po   | po       | jo    | jo    | jo    | 10 |
| 5      | Maze   | Feka       | III     | po     | po     | po    | po       | po      | po    | po   | po   | po   | po       | jo    | jo    | jo    | 10 |
| 6      | Roland | Delidolice | III     | po     | po     | po    | po       | po      | po    | po   | po   | po   | po       | jo    | jo    | jo    | 6  |
| 22 3 3 |        |            |         | Oronit | Vilcas | Bucos | M. N. N. | Psheter | Maden | Raba | Raba | Raba | N. Thote | G. N. | G. N. | G. N. |    |

## Pjesëmarrësit e aktivitetit 13 – 26 korrik 1982

### Zona Shtegu i Dhenve

1. Dashamir Fejzo trajner
2. Artur Gorishti
3. Xhemal Begeja
4. Ardian Kurti
5. Mazllum Feka
6. Aleksandër Tapia
7. Foti Taçi
8. Arben Qato mbajtës i ditarit

### Më 13

Është dita e parë e aktivitetit. Me bileta në dorë dhe çanta në shpinë shumë vende në tren. Gjatë udhëtimit nuk munguan shakatë. Si arritëm në Shkodër u drejtua për tek autobusët që

do na dërgonin në Theth. Pastaj, rimorëm çantat dhe u nisëm për në Shtegun e Dhenve. Udhëtimi u shoqërua me komentet e atyre që vinin për të parën herë në Alpe. Pasi ngjtëm kampin u përgatit darka që na e shërbyen Turi me Guxhon (*mbajtësi i ditarit ka ngatërruar një emër – një anëtar të ekipit - me Guxhon. Në këto ditë Guxho ishte me ekipin e parë dhe kryenta veprimtarinë në Livadhet e Bogëve*).

## Më 14

Ekipi u njoh me terrenin si dhe bëri pastrimin përreth tendave. Erdhën edhe ekipet e tjera dhe kjo u shoqërua me një shi të fortë. Ngjitje nuk u kryen sepse koha ishte e keqe dhe disa ekipe erdhën me vonesë.

## Më 15

Sot u caktua ditë për të sistemuar kampin.

## Më 16

Pas rutinave të mëngjesit ekipet u nisën nëpër vendet që u ishin caktuar për ngjitje. Toga jonë përbëhej nga ne, Apollonia dhe 24 Maj. Ne bëmë ngjitje në Kala (*kresha në veri të Shtegut të Dhenve*). Ato ishin të shkallës së tretë të vështirësisë dhe u realizuan me sukses. Në litarët tanë të ngjitjes u futën edhe alpinistë të ekipeve të tjera ngaqë ata kishin mungesa në bazën materiale që duhet për kacavarje. Ngjitjet në Kala janë fillesa e ngjitjeve (*për nga vështirësia*) në zonën e Shtegut të Dhenve, ku ato pasohen me rritje graduale të shkallës së vështirësisë.

Pas ngjitjeve u kthyem në kamp ku dezurni (Guxho e Foti) përgatitën drekën që na e servirën nën hijen e pishave.

Mbasdite u mbledhëm sepse u lexua rregullorja e alpinizmit si dhe u analizua ngjitja e ekipit “Studenti” që lë/është shumë për të dëshiruar.

## Më 17

Treshja jonë, unë, Turi e Xhimi morëm rrugën për në I-6, e pestë e vështirësisë. Ngjitjen e udhëhoqi Turi, që e realizoi me sukses e duke bërë një hap të ri në rrugën e tij të kualifikimit për të arritur kategorinë e parë sportive. Edhe ngjitjet e tjera përfunduan me sukses. Mbasdite u nisëm për Qafë Thore për të mbushur ujë. Flitet se do të shpërngulemi atje për arësye të mungesës së ujit.

## Më 18

Ekipi ynë, i ndarë me grupe nga 2 e 3 alpinistë me në krye komandantin e togës, nisët për në vendet e ngjitjeve. Në ngjitje nuk erdhi Guxho sepse ai ka dëmtuar këmbën dhe mjeku ka rekomanduar të qëndrojë në kamp. Shokët janë pezmatuar sepse ka mundësi që Guxho të shkojë në Shkodër.

Treshja jonë do të ngjitet në I-7 dhe këtë ngjitje do e udhëheq unë. U realizua me sukses dhe në majë, pasi i dhamë dorën njëri-tjetrit, uruam Turin që të realizojë edhe ngjitjen në I-8. Pasi ushtoi zig-zagu ynë filluam uljen për në kamp. Rrugës takuam alpinistë të tjerë që ktheheshin edhe ata nga itinerarët e realizuar. Në kamp na priste Guxho që po merrej me përgatitjen e drekës. Na erdhën edhe dy syltiashë. Një për prof. Acin (*i sapo ardhur*) dhe tjetrit nuk ia di emrin, por që është trajner i ekipit të Korçës (*Koço Ziso*). Dreka kaloi nën një atmosferë të gëzueshme që përqasej shumë me darkën e zakonshme rreth zjarrit ku Dashi bëhet i pari i bisedave me histori të kujtimeve të tij mbi ngjitjet e realizuara nga ekipi i të rriturve. Mbas përcollëm miqtë, u përgatitëm për ngjitjet e mbasditës për të cilat ishte mobilizuar një pjesë e mirë e ekipit. Ngjitjet u realizuan me sukses.

## Më 19

Sot është caktuar ditë pushimi. Ekipi ynë mori nismën për të shkuar në Theth. Dëshira ishte e madhe sidomos nga ata që nuk e kishin parë Thethin. Guxhos po i keqësohej këmba ndërkohë që mjeku nuk kishte mjete sterile për të ndërhyrë. Ai duhej dërguar në Shkodër. Ne vajtëm në Theth, hëngrëm në klub dhe morëm rrugën e kthimit me dëshirë që të shkojmë përsëri në Theth. Për mungesë transporti, Guxho mbeti në kamp.

## Më 20, e martë

Ndiehemi mirë moralisht si dhe entuziastë. Arturi përgatitet për të ngjitur I-8 (*ky itinerary në faqen veriore të së majës së Shtegut ishte përcaktuar i shkallës së gjashtë të vështirësisë dhe ishte i nevojshëm për të plotësuar ngjitjet për fitimin e kategorisë së parë sportive*). Dhe gjithëkush prej nesh përgatitej për ngjitjen që do kryente.

Ndërkohë që vazhdonin ngjitjet, nga I-8 dëgjohet një “zig-zag” i fuqishëm. Janë Turi me Gonin e Dajtit. Kur mbërritëm në kamp, e uruam Turin dhe i uruam suksese të tjera

Në këtë aktivitet një pjesë e mirë e ekipit, deri më sot, kanë realizuar një pjesë të mirë të ngjitjeve nga numuri total i ngjitjeve që duhen për të fituar kategorinë e dytë sportive. Kjo sepse janë angazhuar në ngjitje edhe mbasdite.

Në darkë mblidhemi rreth zjarrit ku zakonisht hamë si dhe ku mbizotëron atmosfera e shakave. Ia marrim edhe këngës, e në këto raste mbizotëron zëri i Ardit, repertori në këngë i të cilit preferohet edhe nga shokët e Fierit.

## Më 21

Flas për ngjitjet sepse për to kemi ardhur këtu, por një pjesë e mirë e kohës, për nga rëndësia është ajo e dezurnit të ditës.

Në adresë të tij nuk ka asnjë verejtje, por e kundërta. Kjo kur mendon për bidonat e ujit. Uji është bërë pengesë e madhe.

Sot u organizua kampionati ekipor i tërheqjes së litarit. Ekipi u ballafaqua në fillim me ekipin e Dajtit, i cili na dha avantazhin për t'u ndeshur me ekipin e Burrelit. Ky na skualifikoi nga kampionati.

## Më 22

Sapo mbaruam me rutinat e mëngjesit, erdhën në kamp (nga Livadhet e Bogëve) Sokoli me Guxhon që do të ngjiteshin tek itinerari I-B me shkallë të gjashtë të vështirësisë. Ata i propozuan edhe Turit që t'u bashkohej, por ai nuk pranoi: e ndiente veten të paaftë. Që dje ai nuk ndiehet mirë dhe ka rrufë. Ngjitja e tyre përfundoi me sukses dhe mbasditë në orën katër, pasi hëngrëm, ata morën rrugën e kthimit duke marrë me vete edhe tri bukë.

Ngjitjet tona të paraditës përfunduan me sukses kurse ato të mbasdites nuk u kryen për arsye të shiut që ra, i cili pushoi sapo u nisën Sokoli dhe Guxho (*për tek Livadhet e Bogëve*).

## Më 23

Sot e kemi pushim. Dashi, Mazi dhe unë ndenjëm në kamp; pjesa tjetër e ekipit u nisën për në Bogë, duke marrë edhe çanta dore për të blerë bukë meqë na u mbarua. Në kthim, nën shembullin e Turit, ata mblodhën çaj, gjë që bëri që ata të vonohen dhe Dashi të shqetësohej. Ekipi i Fierit na la aparatën fotografik dhe kështu të dy ekipet bëmë disa poza.

Çadrat sot iu nënshtruan një pastrimi të përgjithëshëm, gjë që ishte bërë e nevojshme, sidomos për çadrën ku mbajmë ushqimet.

Mbasditja kaloi e gëzueshme e me lojra të ndryshme, ndonëse nuk ngeli pa na lagur me ca shi.

## Më 24

Është dita e fundit e aktivitetit ku ekipet angazhohen me ngjitje. Urdhëri i ditës udhëzonte që të tregohej kujdes në ngjitje ngase në ditën e fundit tregohet neglizhencë.

Ora 4 dhe ora 6 mbasdite janë caktuar si kohë për të bërë konkluzionet e ngjitjeve. Sot nga ne, Ardi e Mazi realizuan dy ngjitje në I-11 dhe I-2.

Në orën 4 - ekipet e 24 Maj, Apolonia, dhe ne u mbledhëm për të bërë konkluzionin e ngjitjeve. U rrahën mendime të ndryshme nga diskutuesit. Midis tyre ishte edhe Turi që u ngrit i pari dhe tha fjalë të mira për gjithshka. Ai shprehu dëshirën e të gjithë anëtarëve të ekipit për t'u takuar në aktivitete të tjera.

Nga ekipi i Apolonisë foli Engjëll Haskushi, i cili vinte për herë të parë dhe kishte përshtypje pozitive. Ai përgëzoi disa alpinistë të togës sonë që realizuan ngjitje të vështira si Turin, si edhe Flamurin dhe Mediun e 24 Majit. Ai premtoi se me punë e stërvitje ekipi, megjithse i ri, me punë e stërvitje do arrijë nivelet e ekipeve të tjera (*ekipi alpinistik Apollonia i Fierit u formua në nëntor të vitit 1966. Në vitin 1969, në këtë ekip, Aleksandër Bojaxhi fitoi titullin Mjeshtër Sporti*).

Nga ekipi “24 Maj” foli Ligor Çajupi. Edhe ky foli fjalë përgëzuese për veprimtarinë. Foli edhe Dashi, i cili veç fjalëve përgëzuese bëri vërejtje për nxitimin që tregohet në shkëmb e që shprehet me sasinë e paktë të gozhdëve të ngulura dhe neglizhencën e parullave të komunikimit. E mbyllëm me porosinë që të takohemi në orën 18:30 për konkluzionet e përgjithëshme.

Në orën 18:30 ekipet u mbledhën në shesh. Mbledhjen e hapi komandant Kozmai, i cili foli në përgjithësi për ngjitjet të cilat i konkretizoi edhe me shifra për arritjet e sejcilit. Përgëzoi





Anëtarë nga ekipi Apollonia e Fierit në vitin 1968: Teodori, Vangjeli, Aleksandri, Petraqi, Ilia

për faktin që nuk patëm incident dhe kritikoi për numurin e paktë të gozhdëve që përdoren si dhe për zgjimin në mëngjes. Gjatë fjalës së tij ai përgëzoi alpinistët që kishin bërë ngjitje të vështira. Pas tij folën alpinistë nga çdo ekip të cilët folën me euforizëm për ngjitjet e kryera dhe shprehën dëshirën për t'u takuar në aktivitete të tjera.

Mbrëmja e kësaj dite kaloi me këngë dhe hare rreth zjarrit.

## Më 25

Pasi rregulluam çantat dhe sistemuam materialet, duke bërë një ndarje proporcionale të inventarit të “kuzhinës” dhe çadrave, morëm rrugën për në Fushë të Okolit. Rrugës, qeni i stanit pranë kampit kafshoi Ardin. U desht ndërhyrja e mjekut për këtë dëmtim. Shpejtuam se ndoshta autobusët ishin aty, por ndodhi e kundërta. I pritëm gjatë. Aty takuam edhe pjesën tjetër të ekipit tonë i cili kthehej nga Livadhet e Bogëve.

Në autobus u futëm të gjithë me përjashtim të Turit dhe Fotit të cilët do të shoqërojnë kamionin e ngarkuar me materialet tona. U sistemua në hotel e më pas shkua të gjithë për të ngrënë.

## Më 26

Ishim me fat që shiu na zuri nën strehën e Pallatit të Sportit. Prej aty në tren. Udhëtimi kaloi bukur, me siguri me mendimet për çastet e gëzuara që kaluam.

Mbajtës i ditarit Arben Qato

## Livadhet e Bogëve

16 – 26 korrik 1982

- |                       |                     |
|-----------------------|---------------------|
| 1. Aleksandër Bojaxhi | Aci                 |
| 2. Mario Trinkera     | Taljoni             |
| 3. Romeo Manxhari     | Qorri + Kinezi i Ri |
| 4. Sokol Doko         | Qerozi + Ushi       |
| 5. Ilir Tapia         | Qerosi + ushi i ri  |
| 6. Shkëlqim Mema      | Guxho               |
| 7. Bruno Trinkera     | Taljoni i vogël     |
| 8. Hermes Bojaxhi     | Maçoku              |

## 14 korrik

Deri sot qëndruam në Bogë të mbledhur për të kaluar disa ditë të grumbullimit. Dje mbasdite erdhën ekipi ynë (*pjesa që do të shkonte në Shtegun e Dhenve*) dhe i Dajtit. Këta do të kryejnë ngjitje në Shteg të Dhenve. Me ta ishte dhe Guxho që do të qëndrojë me ne tek Livadhet, kurse Dashi, i cili i kaloi ditët e grumbullimit me ne, u nis për në Shteg. Në Bogë qëndroi edhe Kozmai. Sot i kemi ngarkuar materialet në pesë gomerë, dhe në ditën me mëngjesin më të bukur të ditëve që kaluam kënde,

nisemi për në Livadhet e Bogëve më 07:40. Kafshët ecin mjaft ngadalë dhe maloren e fundit për në qafë arrijnë ta ngjisin vetëm dy gomerë. Në orën dy u shkarkuan të gjitha materialet në qafë, në një kohë tepër të keqe: erë e fortë dhe shi e breshër. Moti u prish gradualisht dhe gjatë rrugës ra disa herë shi i lehtë.

Uljen nga qafa e bëmë me etapa, duke u ulur (*me një pjesë të materialeve*) e duke u ngjitur rishtaz për të marrë materialet e tjera të lëna më sipër. Unë e Mario ulëm fëmijët deri në livadh (kishim marrë secili djemtë: Bruno dhe Hermes), të cilët i futëm nën një shkëmb deri sa ulëm çadrat. Me ta u muarr më tej Romeo. Fëmijët e kaluan më së miri këtë kohë të keqe dhe pasi hëngrën diçka fjetën nga ora 17:00 deri 21:30. I zgjuam, hëngrën dhe përsëri fjetën.

Në ora 19:00 i kishim ulur nga qafa të gjitha materialet dhe ishim ndërruar (*veshjen*). Shi i fortë ra rreth dy orë dhe pa ndërprerje.

Mario, Romeo e Guxho u nisën tek stanet për të skjaruar punën e ujit të pijshëm. Rezultoi se burimi ka tre vjet që ka shterruar; dhe ata janë tërhequr në drejtim të veriut të Livadhit, ku është një vend me ujë të bollshëm. Atje ne nuk na volit që të ngremë kampin.

Në ora 22:30 biem për të fjetur me mendimin se do e vendosim nesër se ku do jetë kampi ynë. Aleksandri

## 15 korrik

Sot zgjimi u bë rreth orës 06:00. Dielli ende nuk ka rënë tek çadrat. Mario u nis në drejtim të Rrathëve të Trandafilit për të shqyrtuar burimet që ndodhen rreth e rrotull. Më 08:30 hëngrëm mëngjesin dhe të gjithë ramë dakort që çadrat t'i vendosim poshtë rrathëve të trandafilit. Sokoli, rreth 10 minuta larg vendqëndrimit, gjeti një rrjedhë të mirë uji. Gjithë

shokët u morën me sistemimin dhe tharjen e plaçkave të lagura dhe. Pas drekës pushuam. Rreth orës 16:00, prej qafës lart (*nga erdhëm dhe*) u dëgjua zig-zagu i shokëve të Korçës dhe Kukësit. Sokoli, Aci dhe unë i ndihmuam në pjesën e fundit të uljes së tyre.

Pasi sistemuan çadrat, Aci, Mario, Koço, Iliri, Berzati, dhe unë shkuam dhe pamë burimin e “Sokolit” si dhe mundësinë e vendosjes së kampit atje. U vendos që kampi do të mbetet ku është. Uji aty afër do të përdoret për enët dhe për gatim, kurse për të pirë do të përdorim burimin. Mbetet të vazhdojmë punën me blloqet e borës së ngrirë (*për t’i shkrirë e për të siguruar ujë*) siç e filloi Aci.

Në orën 19:00 u bë mbledhja e parë e grupit. Gjithë shokët qenë dakort me propozimin e komandantit të aktivitetit. Komandanti i togës sonë “17 Nëntori” është Romeo. Nesër Aci, Iliri, Koli dhe unë do nisemi drejt Radohinës, kurse Mario dhe Romeo në drejtim të jug-perëndimit të kampit për rikonicion (*është hera e parë që alpinistët vendosen në Livadhet e Bogëve për të kryer ngjitje*).

Urdhëri i shtabit është që s’duhet të ketë ngjitje me kategori vështirësie më të madhe se katër; (*ky ka qenë një veprim taktik: meqë zona është e panjohur, le t’i hedhim fillimisht sytë tek vështirësitë mesatare*).

Shtabi i aktivitetit:

Komandant Aleksandër Bojaxhi

Komisar Koço Ziso

Zv.komandant Berzat Mane

Po e mbyll se shkoi vonë dhe drita në çadër është e dobët.

Guxho

## 16 korrik

Zgjimi u bë me llak-llaket e Marios që në orën 06:00. Më 06:45 u ngritëm të gjithë. Përgatitja për ngjitje u bë me vonesë sepse shokët e Kuksit dhe Korçës ende nuk ishin të sistemuar plotësisht. Në orën 09:00 u nisëm sipas programeve. Koha ishte shumë e mirë, por frynte pak veri. Mario dhe Romeo (*u nisën për*) në jug të kampimit, Aci e Koli si dhe Iliri e unë në drejtim të Malit të Thatë. Ecëm një kohë të gjatë në borë. Itinerari i Kolit dhe Acit ishte majtas, rreth 20 min larg tonit. Fillimisht itinerari ishte i lehtë. Iliri deshi të devijonte majtas itinerarit që na kishte dhënë Aci. Në pamundësi për të kaluar më lart u kthyem në itinerarin e caktuar. Shkëmbi ishte shumë i ftohtë. Traversa ishte e lehtë në pjesën e parë. Kaluam në një lug dhe pastaj në pjesën më të vështirë të itinerarit, në një pjesë negative dhe me shkëmb të thërmuar. Pjesa tjetër ishte relativisht e lehtë. Problem përbënte rrëzimi i gurëve. Që lart pamë se itinerari që donte të zgjidhte Iliri ishte mjaft më i vështirë nga sa dukej. Në orën 13:00 mbërritëm në Majën e Thatë. Vendosëm letrën aty ku e kishte vendosur dhe Aci me Kolin. Në orën 14:00 mbërritëm në kamp. Hëngrëm drekën e shijshme të përgatitur nga Mario e Romeo. Koli, si kurdoherë i palodhur, na furnizoi me ujë të ftohtë (*burimi*). Sot unë u rrujta. Shokët fjetën pak. Koli dhe unë bëmë banjo dielli së bashku me Nestin (alpinist i “Skëndërbeut” – *Anesti Qirio*).

Gjatë mbledhjes nuk pati gjë të veçantë. Shokët e Skëndërbeut na thanë se prej staneve, liqeni është 10 min larg (*bëhët fjalë për liqenin e Livadheve të Bogëve*), dhe jo si na thanë barinjët – një orë larg. Ata ishin sot atje. Po përgatitemi për darkën nën zhurmën e të palodhurve Hermes dhe Bruno.

Nesër - Koli, Romeo, Iliri dhe unë do vazhdojmë me ngjitje në drejtim të Radohinës. Mario, gjatë zbritjes ka dëmtuar gjurin.

Ka mundësi të ketë ndonjë tërheqje të ligamentit intramedial (mos qoftë e tillë). Ora 19:35. Guxho

## 17 korrik

Sot u vendos që dy dyshet tona, Koli dhe unë, si dhe Romi e Iliri të ngjitemi në majën e Rasës së Bardhë, për të tentuar në itinerar të vështirë (kategoria VI).

Fillimi i itinerarëve që nisëm është me borë. Para eci Sokoli, dhe në dyshen tjetër Romi. Sokoli eci me siguri që ish për t'u patur zili. Pasi kaluam një ballkon (*duke përdorur*) dy (*palë*) shkallë mbritëm në një shpellë mjaft të mirë për rigrupim. Për mua qe pak e vështirë puna në shkallët. Itinerari prej shpellës pati dy mundësi: devijim djathtas pa mbritur tek ballkoni (ishte shumë i thjeshtë) dhe Sokoli kërkoi të sulmonte sipas plasës drejt nën ballkon (*në terminologjinë e asaj kohe ballkon = sqetë = nën të dalën shkëmbore*). Kjo kish pak vështirësi. Tentativat e Kolit për ta kaluar ballkonin pak djathtas qenë të pafrytëshme sepse nuk kishte mundësi për (*të ngulur*) gozhdë (*plengë*). Pas një kohe të gjatë (*pas disa përpjekjeve*) u sulmua ballkoni (*e dala apo sqeta*) majtas. Koli punoi mirë, vendosi dy shkallë dhe pas disa përpjekjeve doli lart. Kalimi në shkallët, për mua pati shumë vështirësi që vinin prej dobësive të mija teknike; mezi hoqa shkallën e parë dhe lashë (*në shkëmb*) gozhdën (*plengën*). Më tej itinerari ishte i qetë.

U zgjata shumë sepse për mua ishte e para ngjitje e kategorisë së gjashtë. Romeo dhe Iliri (*kishin arritur majën*); na pritën dhe kështu zbritëm së bashku. Aci, Mario dhe Koço Ziso shkuan në majat mbi stanet.

Mbasdite, gjatë mbledhjes, na zuri shiu por nuk zgjati më shumë se ½ ore. Nesër do të tentojmë me Kolin itinerarin që bëri sot Romeo me Ilirin dhe ata tonin. Aci dhe Koço do të shkojnë në Radohinë e që aty në Shteg të Dhënve dhe kthim. Ora 20:20. Guxho

## 18 korrik

Koha u gdhi shumë e mirë, vetëm se është veri i ftohtë (i lehtë). Aci me Koçon u ndanë pranë qafës me ne dhe morën rrugën për Radohinë. Ne filluam itinerarin tonë. Udhëheq në fillim unë. Ka kacavjerje. Pastaj fillon pjesa më e vështirë. Koli tenton, dhe me herën e dytë del në një vend të përshtatëshëm, bën sigurim të mirë dhe kalon lart pa qënë e nevojshme (për të), si një ditë më parë, që të përdorte shkallë. Pasi kalon dy dalje të tjera, me mjaft siguri hyn në ulluk. Unë nisem mirë; heq dy gozhdët e para bile vetëkënaqem nga (*mëndje*) lehtësia ime. Por shpejt “paguaj” vetëkënaqësinë. Nga nxitimi nuk i vendosa mirë këmbët, dhe kështu s’munda ta kap dorën e djathtë në pikën më të përshtatëshme. Pasi u lodha nga krahët u lëshova me lavjerës nga 5 metra. Koli e mbajti mjaft mirë litarin. Për fat veprova mjaft mirë me këmbët për të mos u përplasur në ulluk. Stabilizohem në pozicion i varur në litar dhe me këmbët në shkëmb. U qetësova rreth 10 minuta sa m’u shplodhën krahët. Pastaj, i siguruar nga Koli u ngjita me sportive (*ngjitje me forcën e krahëve nëpër një litar të fiksuar*). Më tej ngjitja eci mirë dhe unë isha më i sigurtë. Po kështu mirë ecën dhe Romi me Ilirin (*Romit i ra një shkallë, e fundit[që kishte, nga dora]*). Biles rrugës bëmë edhe disa fotografi.

Aci me Koçon u kthyen shpejt nga Shtegu i Dhenve. Shokët atje ishin shumë mirë. Mua më uruan sepse kisha realizuar ngjitjet për të marrë kategorinë e parë sportive. Në darkë kënduam tek zjarri i kuksianëve. U dalluan (*për këngë*) korçarët. Guxho

## 19 korrik

Sot bëmë pushim. Të gjithë shkuam tek liqeni i Livadhit. Është i mrekullueshëm. Disa nga alpinistët zbritën me leje në Niksh. Nga ne, poshtë në Niksh, zbritëm Romi, Iliri, Koli dhe unë.

Zbritëm shumë shpejt poshtë megjithëse kaluam gabimisht në një rrugë më të gjatë. Gjatë kthimit u vonuam pak sepse hëngrëm mana. Në orën 14:40 ishim (*përsëri*) tek liqeni. Banja (*diellit*) dhe noti sikur na shplodhën ca, por uria na detyroi të ktheheshim në kamp. Këtë plazh këtu do e kishte zili kushdo në Tiranë; si thonë shaka të bësh plazh në 1800 metra mbi nivelin e detit. Shokët e vjetër si Aci, Koço e Mario thonë se asnjë nga liqenet malorë që kanë parë nuk është më i kthjellët se ky. Në orën 18:00 të gjithë ishim për mbledhjen. U vonuan Nesti e Toli (të “Skëndërbeut”) ngase shkuan në Niksh për të blerë bukë. Ata u kthyen shumë vonë ngaqë edhe ndenjën për darkë tek barinjtë. Kjo bëri që të shqetësohet i gjithë kampi e vëçanërisht “xhaxhai” (Koço Ziso) që nga shqetësimi nuk hëngri darkë dhe gjithë kohën çante dru. Nesër, një grup nga ne do të nisen për në Qafë Pejë. Nga ekipi ynë do të shkojnë Romeo, Iliri dhe Sokoli. Do të ngjisin në Kolaj itinerarin I-4 për Mjeshtër Sporti (kat. VI). Suksese treshes! Guxho

## 20 korrik

Sot të gjithë janë zgjuar herët, ora 05:00, sepse grupi u nis për Qafë Pejë. Në ora 08:00 Aci e unë u nisëm për Qafë Kuqe, kurse Mario e Koço me Tolin (këta të dy të Korçës) drejt majës së Arushës.

Aci dhe unë ecëm shumë në një terren shumë të vështirë që filloi pas qafës. Hypëm në disa maja për të parë mundësinë e një rruge kalimi prej Bogës – Bridashit e deri në Livadh të Bogës. Rreth orës 15:00 u kthyem në kamp shumë të lodhur dhe hëngrëm drekën e përgatitur nga Mario. Në orën 17:30 mbërritën shokët e Qafë Pejës. Ata arritën objektivin e ngjitjes (*këtyre dy djemve, Ilir Tapia dhe Sokol Doko, veç realizimit të ngjitjeve që kërkonte tabela e klasifikimit unik sportive për sportin e alpinizmit, për të merituar titullin Mjeshtër Sporti, bënë edhe mrekulli të*



*tjera, jashtë “garës me malin”. Ato ishin bëma të pastra sportive si dhe të pastra humane për të nxjerrë alpinistët e aksidentuar nga shkëmbi në pozicione me rrezik jete. Megjithatë, për habi e për turp të instancave mbi Komisionin Teknik, ky titull sportiv atyre nuk iu dha). Përgjatë itinerarit të ngjitjes patën disa incidente, por për fat përfunduan vetëm me gishtin e madh të këmbës së majtë të Ilirit të dëmtuar. Një gur i madh u rrëzua nga tërheqja e litarit e i ra Ilirit mbi këpucë, i shtypi preçinën, e .... dhe gishtin. Ia vendosëm në qepë e kripë. Të shohim më tej. Guxho*

## 21 korrik

Sot Iliri bëri pushim dhe bashkë me Marion shkuan tek Rrasa e Bardhë për të drejtuar korçarët dhe kuksianët në itinerarët I-1 dhe I-2. Aci dhe unë shkuam tek maja e Arushës, Koli dhe Romeo në majën e Kuqe. Dita dhe dielli qenë të nxehtë. Si Aci dhe unë e ndiemë lodhjen e një dite më parë. Në orën 13:30 ishim tek stani. Zbritja ishte shumë e bezdisshme. Në stan na pritën mirë si dhe shuam etjen. Përgjithësisht të gjitha grupet arritën mirë në kamping. Nesër kemi pushim. Koli dhe unë (meqë Iliri ka problemin e dëmtimit) do të shkojmë në Shteg për të ngjitur itinerarin I-B (faqja lindore e majës së Shtegut të Dhenve). Unë kam mjaft emocione megjithëse puna e vërtetë do jetë e Sokolit që do të udhëheqë, por ai si zakonisht është shumë i qetë. S’po shkruaj më shumë se duhet të flemë. Guxho

## 22 korrik

Në orën 05:15 u ngritëm dhe shpejt morëm rrugën. Skica që na bëri Aci mbrëmë na ndihmoi shumë sepse nuk humbëm kohë deri sa të dilnim tek gryka e Gropës së Radohinës (*sot e quajmë Gryka e Lekës*). Para se të delnim në kampingin e Shtegut (rreth 10 min), hëngrëm mëngjesin. Në orën 08:00 takuam Kozmain

(ai drejtonte veprimtarinë e grupit të Shtegut) dhe Dashin, si dhe shokët e tjerë. Dashi tha se Arturi nuk duhet të futet në treshe (*litar*) me ne (sipas porosisë së Acit) se është pa qef dhe së dyti sepse më dt. 21.07.82 ka ngjitur I-8 si udhëheqës.

Në orën 09:20 nisim itinerarin. Përgjithësisht ecëm mirë deri sa mbrritëm tek terraca. Këtu u vonuam rreth 30 minuta deri sa gjetëm saktë se ku të futeshim tek pllaka. Vendosëm të nisim itinerarin që na tha Acit. Bëmë një piramidë (*njëri ngjitet në supet e tjetrit për të arritur pika kapje*). Sokoli, më pas kaloi traversë rreth 4-5 metra dhe pastaj gjithë kohën vertikalisht. Punoi mjaft bukur dhe me siguri. Pastaj për mua që relativisht më e thjeshtë. Disa herë u ngjita me sportive. Gjatë ngjitjes patëm mjaft etje sepse ishte nxehtë dhe zagushi. Në orën 12:00 ishim në majën e Shtegut dhe në 12:45 në kamping. Shokët që ishin kthyer nga ngjitjet me ne, me në krye Turin, na “ndihmuan” me gjithë shërbimet që na nevojiteshin, pra me ujin dhe me një drekë të këndëshme. Në orën 14:00 filloi shiu, heshtazi e që vazhdoi deri në orën 16:00. Pushuam në çadrën e Dashit e Turit.

Në orën 19:00 mbërritëm në kampin tonë ku shijuam drekën dhe darkën përgatitur nga Mario. Shokët na treguan se shiu në Livadh kishte qenë më i furishëm, madje në Radohinë edhe me vetëtima e breshër. Darka kaloi rreth zjarrit dhe me mjaft hunor. Guxho

## 23 korrik

Koli dhe unë sot bëmë pushim. Gjithë shokët kryen ngjitje në itinerarët e maleve rrotull Livadhit. Në orën 10:00 koha u mvrejt dhe në ora 13 filloi shiu. Gjithë mbasditen ndenjëm nëpër çadra. Një treshe e Kuksit ishte në Kolaj (Qafë Pejë). Erdhën shumë mirë. Në darkë bëmë përsëri zjarr por jemi më të qetë nga llafet e Marios. Ai bashkë me Romeon u nisën për në Tiranë. Iku

edhe Bruno, kështu që “Maçoku”, si pa shok që është, filloi të kualifikohet me këngën e Toles. Guxho

## 24 korrik

Dita është e bukur. Koli, Nesti, Genci, Toli dhe unë drejt majës së Thatë. Aci dhe Koço mbrapa majës së Kuqe për të parë një kalim dimëror për në Niksh, kuksianët në Radohinë. Rreth orës 12:00 të gjithë u kthyen në kamping. Dhe filluam analizën e veprimtarisë. Guxho

## 25 korrik ...

*Pra ditari është ndërprerë këtu*

# VITI 1983

## Ngjitjet kombëtare dimërore. Kategoritë e larta Janar 1983

- Ekipi: 1. Aleksandër Bopjaxhi  
2. Mario Trinkero  
3. Dashamir Fejzo  
4. Shefki Juma  
5. Sokol Doko  
6. Ilir Tapia (*u aktivizua me “31 Korrikun” e Gramshit ku kreu shërbimin ushtarak*)  
7. Romeo Manxhari

Me vështirësi u gjet mjet për të vajtur në Tamarë. Kjo kryesisht sepse Klubi Sportiv Vllaznia mendonte se ne do të shkonim në Bogë. Të nisur në ora 13:00, arritëm në Tamarë pas 3-4 orësh. Tamara na priti shumë mirë por me shi të lehtë. U sistemua në hotel (“17 Nëntori”, “Flamurtari”, “Valbona”). Hoteli kishte 16 vende.

Ndonëse u fol për kafshë dhe Zetor (*lloj makine me karoceri të gjatë që e përdorte fshati; d.mth. kooperativa bujqësore*) për të vajtur në Nikç, së fundi u nisëm me një Zis (*lloj kamioni*). Arritëm atje pas rreth një ore.

Kishte mjaft ushtarë aksionistë në fshat të cilët punonin transhetë (*n'atë kohë shteti punonte sistemin e mbrojtjes nga armiqët e mundëshëm që do mund të guxonin të sulmonin vendin tonë*). Si duket të huajtë (*ushtarët*) me sjelljet e tyre u kishin ftohur vendasve traditën e tyre të mikpritjes. Ne u ndamë nëpër baza vonë, atëherë kur po errej.

U nisëm ora 09:00 me kafshë të ngarkuara me materialet (*çantat tona*) të cilat na i ngritën deri tek baxhohja verore (zgjati 3 orë). Aty ngarkuam çantat dhe u nisëm. Pa çanta ecëm përpara Romeo, Iliri, Shefkui, Vironi e unë. Shkuam deri afër qafës (*për tek Liqeni i Livadheve të Bogës*). Megjithatë për qafën lindën debate: mjegulla nuk të lejonte të përcaktohej nëse ish vërtet ajo. Megjithatë u përcaktua drejtimi se nga duhej të vazhdonim.

Grupi ynë i pararojës u kthye. U ngarkuam me çantat tona dhe vazhduam drejt lart. Pas 10 minutash Shefkui filloi të merrte frymë me gulçima. Ndihej shumë keq. Pasi kaluam gjysmën e rrugës e lashë pas dhe arrita pararojën. Rreth 70 metra poshtë qafës po përgatitej vendi për ngritjen e çadrave: bëra debat me shokët e ekipit sepse doja që çadrat të ngriheshin mbi qafë. Por ata, më tepër nga lodhja, nuk ishin për të vazhduar më tej. Vetëm ekipi i Vlorës e ngriti çadrën mu në qafë. Ne e kaluam natën aty poshtë.

Me Marjon dhe Hazirin vajtëm tek Vlonjatët. Pamë vendin dhe larguam çdo dyshim që mund të kishim për dalje të gabuar në qafë (*mjegulla na vuri në dyshim për itenerarin*). Caktuam vendet për ngritjen e çadrave dhe biseduam me Hazirin për të vizituar Shefkuiun. Ai (*Haziri është me profesion mjek*) vendosi që Shefkui të ulet poshtë e të niset për vizitë tek kardiologu. Kështu, ne mbetëm lart tek çadrat kurse Iliri me Sokolin ulën Shefkuiun poshtë në fshat.

Në mëngjes koha ishte shumë e mirë. Është dita e parë që kemi kohë të mirë. Ngremë kampin lart dhe sistemohemi. Rreth

orës 12:00 vendosëm të nisemi për zbulim (*rikonicion*) - disa drejt luginës, vlonjatët dhe unë tek dy majat mbi liqen. Gradualisht ne fituam lartësi dhe vendosëm të ngjitemi në njërën majë (veriore), pastaj kaluam në atë lindoren. Kështu që u kthyem me dy maja të ngjitura. Ndërkohë erdhën edhe Iliri me Sokolin dhe për nesër jemi të gjithë gati për ngjitje.

Në orën 16:00 fillon nga lartësia një tufan i fortë që pas pak na kapi edhe ne këtu. Gjëndja u bë shumë e rëndë. Kaluam orë në kushte shumë të vështira.

Cikloni fryn si i tërbuar. Presim të qetësohet. Natën, çadra Nepal ku fle Iliri me Sokolin mbulohet nga bora. Del Romeo që u hap një vrimë tek hyrja dhe futen tek çadra Pamir që të pestë.

Gdhiet e njëjta kohë. Megjithatë na duhet të zbresim me çdo kusht. Disa materiale na i ka mbuluar bora. Me vështirësi përgatitemi dhe nisemi. Arrijmë në fshat të raskapitur dhe ndahemi nëpër baza. Ekipi ynë fillimisht u vendos në shkollë, por pastaj kaluam në shtëpinë e Martin Llesh Smajlit.

Ditët e tjera kaluan në fshat. Koha nuk ishte as e mirë dhe as e keqe, kurse ne jemi jashtë çdo forme sportive. Më datë 24 u nisëm për Tamarë ku kaluam edhe një natë e prej aty në Shkodër.

Firma Aleksandër Bojaxhi

### 13 deri 17 janar 1983

Ditari tjetër për të njëjtën veprimtari

Ekipi:

Aleksandër Bojaxhi

Mario Trinkera

Dashamir Fejzo

Shefki Juma

Romeo Manxhari

Sokol Doko

Ilir Tapia

### 13 janar

Arritëm mirë me tren në Shkodër. U sistemua në Hotel Sporti

### 14 janar

Filluan të papriturat. Shkodranët (drjtues të fiskulturës) jo vetëm që nuk e dinë që grupi ynë do të shkojë në Nikç, por nuk e dinë as se nga bie Nikçi. Pas shumë variantesh, në ora 10:00 dolëm tek parku i skodave (kamjonave) prej ku pas shumë andrallash u nisëm në ora 13:00 për në Tamarë, ku arritëm në ora 16:00.

Drejtuesit aty ishin mjaft të gatshëm për të na ndihmuar për çdo problem që kishim. U strehuam në hotel ku kishte 12 shtretër dhe hëngrëm në restorant. Koha u prish dhe filloi shi.

### 15 janar

Moti ishte me shi dhe në lartësi binte borë. Shkuam në restorant për të ngrënë dhe në ora 08:00 kryetari i këshillit na ofroi ‘Zetor’ për ne (*një lloj mjeti transporti që përdorej në bujqësi*) dhe kafshë barre për t’u nisur për Nikç. Meqë binte shi, nisja u la për mbasdite ose për nesër. Ndërkohë zetoristi na tha se po erdhi kryetari i kooperativës, ai nuk do të dojë që të nisë zetorin.

Në ora 10:00 moti u hap, por kryetari i kooperativës, i cili arriti, nuk ishte dakort që të përdorej zetori, por na rregulloi një ZIS (*kamjon*) i cili duhej të ngarkonte qepujka në Nikç e në Vukël. Më ora 12:30 u nisëm dhe më 13:30 ishim në Nikç.

Këtu kaloi kohë, deri në darkë, sa u rregulluam në baza. Dashi, Romeo e Marjo u vendosën tek një mik i Dashit, Iliri me Sokolin tek ushtarët aksionistë, unë e Shefkiu tek Gjok Zef Prendaka. Ishin një familje mjaft e dashur, me interesim të madh për çdo gjë të re. Dy nuset ishin mjaft të mira, Gjystja dhe Mrija, kureshtare për të panjohurat, mikpritëse, mbanin fëmijët mjaft pastër.

## 16 janar

Nga qafat e maleve e lart mot i keq. Me ne vjen edhe Gjoka me gomar sepse e kanë lajmëruar nga Këshilli (qeveria vendore) për transport. Më 08:30 mblidhen të gjithë dhe ngarkohen kafshët e barrës. Haziri nuk do që të nisë Gjokën, mbasi, sikundër duket, Hajdari ka fjetur në Vukël dhe ka sjellë një fshatar me mushkë. Bëmë fjalë e u duk se u rregullua puna. Të gjithë u nisën në ora 09:30 kurse unë e Vironi vajtëm tek Kryetarja e Këshillit dhe vulosëm dëftesat (*për shpenzimet në transport*). Kur u kthyem, mësuam se Gjoka kish ngelur pa ngarkuar. Thirra Hazirin dhe bisedova rishtaz por asgjë nuk u rregullua.

U ndamë me n/kryetarin e këshillit e me të tjerë, si dhe me Gjokën - me keqardhje. I falenderuam tepër.

U përshëndetëm edhe me ushtarët që takonim. Punonin tepër më ngë për ditët e fundit të aksionit për të bërë transhe. Udhëtuam deri më ora 12:00 dhe arritëm tek baxhua verore (Gropa e Zharit). Tentova për t'u mbushur mëndjen kafsharëve për të shkuar më tej, por nuk pranuan. U paguam lekët dhe u ndamë. Më tej vajtëm unë, Shefkiu, Vironi, Iliri (që çante borën) dhe për 50 minuta hapëm rrugën. Pas nesh u nisën të tjerët me ngarkesat.



Veç vlonjatëve, ne të tjerët transportonim me dy rrugë, por jo të gjithë. Më 14:00 u nisëm ne që çamë borën. Menjëherë Shefkiu dha shenja të forta lodhje. U habita! Mendova se do ishte mungesë stërvitje. Kërkonte pushime të shpeshta dhe dikur tha: - Nuk mjafton vetëm pasioni për të vajtur në mal, por duhet edhe stërvitja.

Nga fundi unë avancova, pa Shefkiun, ngaqë ai donte pushime të shpeshta. I mpiheshin krahët, kishte rrafje të forta zemre. Do i sillja ndokënd që ta ndihmonte.

Pas 10 minutash shoh ndalesë dhe kërkesë për të kaluar aty natën. Koha e keqe, lodhja, thënia e Romeos dhe Ilirit që nuk po orientohemi ende për rrugën e qafës krijuan dorëzim e joshje për ndalesë. Ekipi i Vlorës po avanconte. Lashë çantën (!?) dhe u nisa pas tyre. Çdo gjë fliste se edhe pak metra dhe qafa arrihej. U ktheva për të marrë çantën dhe kërkoja që të niseshim të gjithë. U nisa i ngarkuar. Proteston ma fort Dashi, pastaj Romeo. Mario mbeti në dilemë. Më tepër donte të mos ma prishte mua; pas i vajti edhe Romeo. Përpara kësaj gjendjeje dhe faktit që Shefkiu ishte rëndë vendosa të qëndroj edhe unë. Por çfryva: turp për “17 Nëntorin” (*ekipin e Tiranës*). Kemi përgjegjësinë të shpiem njerëzit në Livadhet (*e Bogës*) dhe jo vetëm që nuk vemi përpara, por lëmë të tjerët që nuk e dinë (*rrugën*).

U bëra tepër nevrrik dhe u dëshpërova mjaft me ekipin. Tek e fundit kjo ishte pasojë e përgatitjes fizike të pamjaftueshme (*në fakt kështu e ka dita e parë me ngarkesë fizike në mal*).

Shefkiu piu vetëm një kafe. Unë nuk fjeta veçse 10-30 minuta (*gjumë të thellë*). Ftohtë nuk pata.

Natën filloi bora. Ne flinim 7 minuta larg e nën qafë, djathtas (P) nën një shkëmb. Tropojanët u futën në një si shpellë (*guvë*).

## 17 janar

Vjen Aleksandër Tafili i Vlorës dhe bisedojmë. Pas një ore shkoj unë tek vlonjatët. Pas pak arrijnë Mario e Hajdari. Kemi dalë në qafën e duhur. Nisemi të tre për tek liqeni i cili është i ngrirë dhe me borë mbi të. Vendosëm të mos i lëvizim tendat deri sa të kthejë moti. Vazhdimisht bie borë, herë pak dhe herë shumë. Kur kthehem takojmë Hazirin. Ai ka vizituar Shefkium dhe mendon që ai të ulet poshtë. Thahem pak në zjarrin e trpojanëve dhe shkoj në tendë. Shefkium ende nuk ka ngrënë. Ka ngrënë gjysëm portokalli që i kam dhënë. I bëra një kafe. I ka mbetur hatri që Romeo e Dashi nuk i kanë bërë çaj apo ndonjë perkujdesje që ka thënë mjeku (Haziri).

E binda që të ulet në Nikç. Më 15:30 me Ilirin dhe Sokolin, që i morën barrën në dy çanta, u nisën. Unë u futa në çadër. Isha tepër i mërzitur.

Pas një farë kohe më thërrasin në çadrën e tyre Dashi, Marjo e Romeo. Pimë kafe e biseduam. Dashi tha: Fundja duhet ta kuptosh se nga halli e bëmë. Ishim tepër të lodhur.

Pas pak vajta në çadrën time. Ndenja një kohë të gjatë e gjumi nuk më zinte. Më 21:00 më thirrën rishtaz, Dashi Romeo e Marjo - në çadër ku organizuan pirje rakie, të cilën e kish marrë Mario nga shtëpia. Ndenjëm deri më 24:00. Natën fjeta disa orë.

## Zona Bogë; 1 deri 10 shkurt 1983

Pjesëmarrësit:

1. Romeo Manxhari                      zv/komandant i ngjitjeve
2. Xhemal Begeja
3. Mazllum Feka
4. Ardian Kurti
5. Artur Shehu
6. Aleksandër Tapia
7. Foti Taçi
8. Arben Qato                              mbajtës i ditarit

### Më 1 shkurt, e martë

Treni u nis në 18:55. Në Shkodër mbrritëm vonë dhe ishte e pamundur që të gjithë të zinin dhomë në hotel. Një pjesë e jona fjetën në dhomat e hotelit ku ishte vendosur ekipi i Fierit.

### Më dt 2

Sot u morëm me ngritjen e çadrave, që u vendosën në terren me lagështirë. Kishte borë. U prish koha dhe mbetëm në çadër deri të nesërmen në mëngjes. Unë u futa tek fierakët ngaqë ne kishim vetëm dy çadra Pamir ndërkohë që ishim tetë vetë. Çadrat nuk i rezistuan motit dhe kjo bëri që të futemi ***më datën 3*** në një kasolle e cila na mbronte nga shiu. Pranë nesh, gjithë kohën, kanë qenë edhe alpinistët e ekipit të “10 Korrikut” (Gramsh), të cilët si drejtues kanë Ilir Tapinë. Megjithatë ngushtë (në çadër jemi katër veta: Romi, Iliri, Eli dhe unë), flejmë mirë pa ndierë ftohtë i cili ishte i padurueshëm natën e parë (*me sa duket tashmë çadrat janë ngritur brenda në kacolle*).

Këto dy ditë kaluan pa ngjitje, por të gjithë u angazhuan në punë të ndryshme për sistemimin, pastrimin e mjedisit dhe

çadrave. Nesër do t'i fillojnë që të gjithë ngjitjet me përjashtim të Skënderit të “10 Korrikut” i cili ka vrarë këmbën.

## Më dt 4, e premte

Të gjithë u nisën në drejtim të majës së Humekut me lartësi 2055 m. Itinerari është i vështirë në disa vende. Është vlerësuar i vështirësisë IV. Ngjitja kaloi mjaft mirë. Disa patën problem lagjen e këmbëve për mungesë kambalesh apo këpucë jo cilësore.

Zbritëm dhe me oreks të mirë, hëngrëm një drekë të shijshme. Jemi paksa ngushtë porse mundohemi të mbajmë rregull e pastërti. Tani po thajmë robat e lagura rreth zjarrit. Ne bashkë me ekipin e “10 korrikut” bëjmë togën e tretë me komandant Ilir Tapia.

## Më dt 5

Sot u lodhëm sepse realizuam një ngjitje të shkallës së pestë të vështirësisë. Ngjitja kaloi mirë veçse të ftohtit nga duart dhe këmbët nuk i shmangeshim, si rezultat i pritjeve të shkurtëra që ndodhnin para kalimeve të vështira, ku vetëm kalimi/ ecja një nga një të siguronte nga rreziku. Quhej maja e Livadheve. Aty pamë një fenomen të veçantë: avuj që dalin nga sipërfaqja e tokës dhe fakti që dalin në lartësinë 2.500 metra e bën këtë fenomen interesant.



Një kujtim dimëror në malet e Bogës

## Më dt 6

Rregulli është dy ditë ngjitje dhe një ditë pushim. Pra sot jemi pushim. Me sopatën e ekipit të Gjirokastrës bëmë ca dru për zjarr. Koha është e keqe: reshje bore dhe erë që fryn në drejtime të ndryshme. Ky mot bëri që Iliri e Romeo të mos niseshin për në majën e Thatë, por nuk i pengoi që të dilnin në Bogë për disa punë.

## Më dt 7

Kohë jashtëzakonisht e keqe. Vazhdimisht bie shi e fryn erë. Sipas të dhënave të shërbimit sinoptik ky mot do të zgjasë.

Më dt 8, e mërkurë

E njëjta kohë, por që sot na u mundësua të bëjmë ca dru për zjarr. Koha nuk premton për t'u përmirësuar. Shtegu (*nga pritjet të vijë moti i mirë*) është i nxirë.

## Më dt 9

Aty rreth orës 9 koha u rregullua disi, dhe Mazi, Osmani dhe unë u nisëm për në Bogë për të blerë bukë. Kemi katër ditë të mbyllur brenda nga koha e keqe. Sot u takuam me alpinistë të ekipit të Dajtit të cilët kishin ardhur në Bogë për të bërë dy ngjitje të kategorisë së pestë të vështirësisë, por sikundër duket nuk do të mundën për arësye të kohës së keqe.

## Më dt 10

Koha u rregullua disi. Sot do të ngjitemi në majën e Hundës dhe të Pishkamit. Ngjitja vajti mirë dhe në majë mbrritëm rreth orës 11. Është dita e fundit që bëjmë ngjitje dhe mobilizimi është më i madh se në ditët e tjera. Koha nuk mbajti se arrijtjet do të ishin më të mira. Ne ndienim dobësi në përgatitje fizike që vjen si rezultat i mos frekuentimit të rregullt të stërvitjes.

Mbasdite u bë analiza e veprimtarisë. Folën të gjithë me radhë dhe u bënë sygjerrime dhe kritika që preknin mangësi në përgatitjen fizike si dhe vonesat në mëngjes për përgatitjen e materialit teknik të nevojshëm. U thanë edhe fjalë të mira si dhe u bënë premtime.

## Më dt 11

Mëngjesi kaloi duke përgatitur çantat për kthim. Nuk na eci mbarë sepse filloi shi dhe u lagëm pak. Makinat nuk u vonuan shumë, kështu që dreka na gjeti në Shkodër. U sistemua tek Hotel Sporti.

Mbasdite pamë ndeshjen e basketbollit “17 Nëntori” – ‘Flamurtari’ e cila na la mbresa pak të hidhura jo për rezultatin e saj se sa për atë që na ndodhi ....

*Mbajtës i ditarit Arben Qato*

Më poshtë vijon tabela përmbledhëse e ngjitjeve në këtë veprimtari. Kjo tabelë është pjesë e ditarit.

[illegible]

## 4 deri 12 korrik 1983

Ngjitjet e sezonit veror. Kategoritë e larta  
Ekipi:

1. Aleksandër Bojaxhi
2. Dashamir Fejzo
3. Romeo Manxhari
4. Sokol Doko

Plus Hermes

## 3 korrik

Kemi ardhur në Valbonë më datë 28 qershor për të kaluar ditët e grumbullimit. Gjatë këtyre ditëve kemi studjuar nga afër e nga larg itinerarin qëndror (L) të majës së Brijasit dhe kemi bërë një ngjitje fare të shkurtër në malin e Thatë. Koha ka qenë vazhdimisht me vranësira e shira.

Na kanë sjellë shqetësime për lejet kufitare, të cilat u desht që të firmosen edhe në Degën e Punëve të Brendshme në B. Curri. Për këtë vajti Dashi dy herë në B. Curri.

Vajtëm për ngushëllim tek vëllezërit Pëllumbi me rastin e vdekjes së Ndreut. Beqir Sadikut i ka vdekur motra. Nuk u bëmë mbarë për të vajtur edhe atje. E takuam me të më 2 korrik dhe pimë një kafe në klub.

Sot erdhi makina ZIS e “Partizanit” dhe disa alpinista. Edhe atyre u kanë sjellë të njëjtën pengesë si dhe ne (me lejet kufitare) në Dragobi. Mblodhën lejet kufitare dhe pasaportat dhe u nis Tolka për B. Curri. Ne u nisëm për tek Buni i Brahimit dhe ngritëm kampin në një livadh të bukur. Ilir Tapia nuk na ka ardhur në B. Curri. Shpresojmë të jetë vonuar (*sepse edhe mund te mos i kenë dhënë leje për t’u shkëputur nga puna*) e të vijë nesër. Në darkë, kohën e kaluam jashtë çadrës me një fshatar nga fshati

Tpla që përgjigjet për qumështin e bagëtive. Mbasdite deri vonë ra shi.

#### **4 korrik**

Deri ora 15:00 u grumbulluan të gjithë ekipet. Erdhën “Partizani”, “Minatori R”, “Skëndërbeu”, “Përparimi”. Bëhemi 25 vetë. Iliri nuk erdhi. Para dite vrojtua majën e Thatë dhe deri diku majën e Rrogamit (pjesën lindore). Të gjithë u sistemuan pranë çadrave tona. Është një livadh simpatik me burim uji fare pranë. Mbasdite u ndanë togat dhe u organizua mbledhja e përgjithshme. Me lejet kufitare u hap fjala se duhet të verifikohen edhe një herë në Postën Kufitare këtu, në Valbonë. Kjo punë për të gjithë ne është bërë e bezdisëshme.

#### **5 korrik**

Të gjitha ekipet bëjnë ngjitje dhe studime itinerarësh në malin e Thatë dhe në Rupat. Ne nisemi për në majën e Rrogamit. Fillimisht vajtëm në zonën e shfrytëzimit të pyjeve, pastaj më nga perëndimi për nga livadhet ku kishte edhe ujë. Pastaj ndërmorëm ngjitje të thjeshta në pjesën më J-L të brinjës së Rrogamit. Unë e Dashi ngjitëm një itinerar të kategorisë II të vështirësisë, Romeo e Sokoli një IV apo V. Unë e Dashi dalim më shpejt në kreshtë e prej aty shkojmë drejt majës. Pasi arritëm në majën e parë kryesore (këtu pritëm Romeon e Sokolin të cilët i vonoi ngjitja), filluam uljen për në qafë. Prej aty Romeo e Sokoli u nisën për në majën perëndimore të malit, e pastaj nëpër një lug bore u ulën deri në kamp ku arritën më ora 16:00.

#### **6 korrik**

Të gjithë sulmojmë majën e Thatë. Ne morëm lugun në shpellë për të dalë në itinerarin verior. Nuk arritëm dot, mbasi në krye



lugu na doli me një traversë e cila nuk përkonte me të dhënat që kishim mbledhur.

Korçarët nga Rupat u ngjitën nëpër itinerarin verior dhe arritën majën. Pastaj arritën majën katër alpinistë nga Partizani, një dyshe dhe një treshe nga Kukësi dhe tre të tjerë nga “Partizani”. Treshja e fundit arriti në kamp në ora 24:00.

## **7 korrik**

Është pushim. Kaluam kohën në kamp. Mbasdite ca lojra me tërheqje litari, kërcime, etj.

## **8 korrik**

Nisemi për ngjitje në malin e Thatë. Nuk largohemi më shumë se një orë nga kampi dhe fillon një shi i fortë dhe shpejt të gjithë kthehemi në kamp. Kur stabilizohet koha, mbasdite, fillojnë lojrat....

## **9 korrik**

Përsëri koha është e vranët. Nisemi me mendimin që ngjitja nuk do të kryhet. Arrijmë në malin e Rupës. Pas kësaj unë dhe Sokoli nisemi për të kërkuar shtegun për në majën e Thatë. Ulemi poshtë gati për në rrethin e Bardhë dhe nuk na del asgjë bindëse. Kur arritëm në kamp u informuam më mirë për shtegun. Kemi shpenzuar shumë kohë dhe nuk kemi bërë gjë. Në kthim mblodhëm shumë kërmij.

## **10 korrik**

Nisemi për në majën e Roshit. Nga ekipi ynë nuk vjen Dashi. Në Rosh vijnë edhe katër kufitarë. Në majë ndenjëm të gjithë rreth një orë. Koha jo e mirë (ka vranësira). Bëmë fotografi e biseda. Lexuam telegramin drejtuar sh. E. Hoxha që u përpilua mbrëmë.

Dy shqiptarë, me sa duket barinj, këndojnë matanë kufirit.

U kthyem nga itinerari perëndimor. Në qafë ishte një piramidë kufitare ku qëndruam një copë herë. Mblodhëm shumë kërmij.

## 11 korrik

Unë, Dashi e Koço Ziso nisemi për në majën Kokërhane. (*duhet të kuptohet Kokra e Hanës= Hana e plotë*). Gjejmë thuajse mirë shtegun për të organizuar ngjitje dimërore. Arritëm aty në ora 12:00. Si alpinistë jemi të parët që ngjitemi. Në majë gjetëm një paketë cigare (boshe) “Partizan” të prodhimit të Shkodrës. Sokoli e Romeo u ngjitën në majë të Thatë nga itinerari që sheh Valbonën (J). Bëri (la) përshtypje ngjitja e tyre e shpejtë.

Edhe të tjerët bënë ngjitje: në malin e Thatë dhe në malin e Rrogamit. Që nga dje kemi filluar të gatujmë mjaft kërmij.

## 12 korrik

Romeo, Sokoli e Dashi kryejnë një të pestë në Rrogam që i duhej Romeos si ngjitje e fundit verore për titullin Mjeshtër Sporti. (*Romeos kurrë nuk iu dha titulli Mjeshtër Sporti. Besoj se pengesal/mosdashja ka qenë nga instancat mbi Komisionin Teknik të Alpinizmit*).

Kthehen rreth orës 13:00. Pastaj filloi analiza e veprimtarisë.

Pas analizës largohen të gjithë për në Valbonë. Sokoli vete për darkë tek Deda që e kishte thirrur disa herë. Unë Dashi e Romeo ndenjëm aty. Hermes na siguroi të brendëshmet e një keci të therrur, dhe më pas edhe plëncin e mëlçitë.

Kaluam një darkë të mirë e të qetë. Në çadra u futëm kur filloi shiu, i cili ka rënë çdo ditë.

**13 korrik**

Ngrihemi herët dhe përgatiteni më ngé për kthimin. Më 08:45 nisemi. Në Valbonë, pa arritur të rruhemi, na merr një makinë e na çon në B. Curri.

*Mbajtës i Ditarit Aleksandër Bojaxhi*

**Aktiviteti kombëtar alpinistik veror:  
19 deri 29 gusht 1983; Fushë Dënell**

Pjesëmarrësit:

1. Aleksandër Bojaxhi      trajner
2. Dashamir Fejzo
3. Sokol Doko
4. Arben Qato
5. Aleksandër Tapia
6. Ardian Kurti
7. Artur Shehu
8. Mazllëm Feka
9. Xhemal Begeja
10. Foti Taçi                      mbajtës i ditarit

**Shënim:** Në këtë veprimtari ishte edhe Gjergj Bojaxhi

Ekipet që morën pjesë: “17 Nëntori”, “Dajti”, “Studenti”, “10 Korriku”, “Minatori” i Tepelenës, “Apollonia”, Komandant kampingu Mj. Sportit Kozma Grillo.

## Më dt 19

Bukuri e rallë. Mirë thonë që këto vende janë edhe të bukura edhe të egra. Këto përshtypje na lanë ato pak orë që ndejtëm më datën 18. Sot u ngritëm herët sepse kishim të bënim me një rrugë të gjatë e të lodhshme. Bëmë gati çantat dhe ushqimet dhe në orën 7 u nisëm me profesor Kozmain në krye. Profesori ynë ndenji në Theth bashkë me ushqimet e do na priste ne që të ktheheshim e t'i merrnim. Rrugës na u rrit morali. Kur arritëm në Fushë të Dënellit na u duk fitore. Lamë çantat, ngritëm çadrat dhe hodhëm çantat e zbrazta në shpinë. U nisëm për të marrë ushqimet. Ishte fat për ne që profesor Aci kishte gjetur mushkë dhe e takuam në mes të rrugës. Pasi arritëm në Dënell për lamë ushqimin e shijshëm dhe kaluam një mbasdite të organizuar me një program të pasur.

## Më dt 20

Sot u ngritëm me një ndienjë që nuk mund ta shpjegojmë. Ishte një farë mendimi lidhur me atë se si ishte shkëmbi, si do të ishin ngjitjet.... Në orën 7 dolëm dhe bëmë 10 minuta gjimnastikë. Mëngjesi na shijoi shumë sepse hëngrëm bukë misri me bylmet.

Në orën 8 u rrjeshtuam para komandantit të kampit Kozma Grillo dhe na lexuan urdhërin e ditës. Pastaj bëmë një si marshim të vogël për njohjen e zonës ku profesori ynë na njohu me majat përreth zonës së Dënellit si dhe të Alpeve. E bukur ishte se në një vend të vogël kalonte kufiri i rretheve Tropojë dhe Shkodër. Duke u afruar tek vendi i ngjitjeve u ndanë edhe itinerarët që do të ngjisnim: I-13 e katërt e vështirësisë (A. Qato, F.Taçi, Xh. Begeja); I-15 e katërt: (A. Tapia, M. Feka, një alpinist i Gramshit); I-24, e katërt: (S. Doko, A. Shehu, A. Kurti).

Pasi u kthyem në kamp nga ngjitjet, profesori na përgatiti një drekë të shijshme.

Në orën 18:30 u mbledhëm dhe na u lexua rregullorja e alpinizmit. Më pas bëmë një tendë me degë (për hije) të tillë që kur e shikoje habiteshe sa e bukur ishte.

## Më 21

Sot, për çudi gjumi na doli herët të gjithëve dhe teksa pritëm profesorin për gjimastikën e mëngjesit rregulluam çadrat si dhe përgatitëm bazën materiale për ngjitje. Më pas filloi rutina e mëngjesit. Ne na ndanë për ngjitje si më poshtë: I-11, vështirësi e katërt (A. Qato, F. Taçi); I-7, vësht. 4 (M.Feka, Xh. Begeja); I-12, vësht. 4 (S. Doko, A. Shehu); I-20 vësht. 4 (A. Tapia, A. Kurti). Deri në orën 12 ngjitjet përfunduan. Drekën e hëngrëm në tendën tonë. Pas pak filloi shi dhe ne me shpejtësi hapëm kanalet për kullimin e ujit. Pas pak filloi breshër i tillë sa dukej se do çahet çadra. Kokrat e breshërit ishin me diametër 2-4 cm. Mund të gjeje edhe më të madh. Çadra na u dëmtua.

## Më 22

Sot koha është shumë e mirë por fryn erë e fortë. U dha urdhër që ngjitjet të shtyhen. Në orën 9 shtabi vendosi që të mos bëheshin kacavarje por të ngjiteshin majat në itenerarë të vështirësisë së dytë - majat e Drenit dhe të Kakisë. Ishin ngjitje që do i mbajmë mend për bukuri të shumta që hasëm rrugës.

Interesante ishte që pamë rrugës një hardhuckë në ngjyrë të zezë dhe të verdhë (*salamandra*) që profesori na spjegoj se ato dalin vetëm kur do bjerë shi. Maja e Kakisë është majë ku mund të shohësh më të shumtat e alpeve dhe po të jetë kohë e mirë shikon edhe majën e Korabit, edhe atë të Dajtit pas Kakisë.



Në majën e Kakisë. Ardian Kurti, Aleksandër Tapia, Xhemal Begeja, Foti Taçi, Mazllëm Feka, Artur Shehu, Dashamir Fejzo, Aleksandër dhe Gjergj Bojaxhi, Arben Qato

## Më 23

Sot profesori na e rriti shkallën e vështirësisë së itenerarëve e andaj u ngritëm më herët dhe bëmë një gjimnastikë të mirë, por edhe hëngrëm mëngjes të mirë. Sot punuam:

I-17, vësht. 3 (A. Shehu, A. Bojaxhi); I-18, vësht. 5 (A. Kurti, A. Tapia, F. Taçi); I-26, vësht. 5 (S. Doko, Xh. Begeja); I-23, vësht. 5 (M. Feka, A. Qato).

Ngjitjet u kryen me sukses, e pasi përfunduan Sokoli, Mazi dhe Arturi zbritën në Theth për bukë. Kur u kthyen nga Thethi, Mazi vrau, ose më mirë të themi, plagosi një laraskë të cilën e sollën në kamp e që u kthye në objekt loje. Pas darkës u mblodhëm rreth zjarrit dhe Dashi na tregoi të tjera histori të bukura.

*(këtë ditë unë kam kryer ngjitjen e fundit të karrierës sime alpinistike në kacavarje shkëmbore. I-17 është itinerari më i thjeshtë që ka qenë shënuar në poligonin e kacavarjeve në Fushë Dënell. E zgjodha më të lehtin që t'i bëja një test final këmbës sime të djathtë e cila prej vitesh ka të këputurapo dëmtuar ligamentin kruciat. Për t'u ngjitur bëra si bëra, por për të zbritur hoqa keq. Atje shpati ishte shumë i pjerrët dhe shputa e djathtë nuk e mundësonte, në atë pjerrësi punën që duhej të bënte. Pas kësaj prove unë kam realizuar ngjitje vetëm në itinerarë ku shputa e djathtë siguronte mbeshetje sa më të plotë në truall - AB).*

## Më dt 24

Sot bilbili i mëngjesit për çudi na gjeti në gjumë. Kjo na vonoi për rutinën e mëngjesit dhe kështu e lamë pa bërë gjimnastikën. Ngjitjet u ndanë kështu: I-8, vësht. 3 (A. Tapia, F. Taçi); I-18, vësht. 3 (A. Shehu, A. Kurti); I-14 vësht. 5, (Xh. Begeja, M. Feka, A. Qato). Ngjitjet përfunduan me sukses por na e prishi bukurinë një aksident i vogël që ndodhi me një alpinist të "Studentit". Pas ngjitjeve, unë e Leko zbritëm në Theth, kurse anëtarët e tjerë të ekipit shkuan të lahen në një pellg të madh me ujë. Në urdhërin e ditës ishte thënë se në orën 18:30 do të zhvillohej tërheqje litari midis ekipeve. Pas kësaj u mblodhëm e na u tha se nesër do të bëhen ngjitje të vështira.

## Më 25

Sot, pas rutinës së mëngjesit si dhe urdhërit të ditës, u ndamë kështu: I-21, vësht. 6, (Xh. Begeja, S. Doko, I. Tapia); I-21, vësht. 6, (A. Qato, M. Feka); I-9 vësht. 5, (F. Taçi, A. Tapia); I-10, vësht. 5, (A. Kurti, A. Shehu); I-9, vësht. 5, (A. Shehu, A. Kurti).

Ngjitjet u kryen të gjitha me sukses. Ishte gëzim për ne ky sukses. Zbritëm dhe hëngrëm drekën që e kishim përgatitur një ditë më parë.

Në urdhërin e ditës ishte thënë që sot në orën 17:30 do të bëhej ndeshja finale “17 Nëntori” -Tepelena në futboll. Pak pasi filloi loja dhe ishte 3 me 1 në favorin tonë, filloi një shi i fortë. Ne përfunduam brënda në çadër që ato të mos i shkulte era. Pas shiut vumë re se kishim dëmtime të mëdha. Humbën kunja, në një vend një çadër u gris dhe u shtrëmbërua një tub çadre. Pasi riparua disa dëmet, hëngrëm darkë e ramë për të fjetur.

## Më 26

Sot u ndamë kështu: I-13, vësht. 4, (A. Shehu, A. Kurti); I-12, vësht. 4, (F. Taçi, A. Tapia). Ngjitjet I-25 dhe disa ngjitje të tjera u anuluan për shkak të një aksidenti që ndodhi në itinerarin I-10 nga një alpinist i Fierit (*Engjëll Askushi u shkëput apo u lëshua nga shkëmbi nga një lartësi e cila i shkaktoi dëmtime. U transportua në Theth nga alpinistët e më pas u dërgua në Shkodër. Me kujdesin shëndetësor e rimori vehten pas disa javësh*). Aksidenti erdhi për shkak të moszbatimit të teknikës. Në atë çast u mblodhën menjëherë alpinistët e tjerë (ishte për t’u admiruar kjo gjë). Menjëherë u gjendën dy shkopinj, i lidhën me litar dhe bënë vigun. Komandanti dha urdhër që të gjithë të merrnin bukë/ushqim dhe shumica të nisej menjëherë për të transportuar vigun me të dëmtuarin. Kush ta kapte më shumë vigun, kush të ndihmonte më shumë. Kjo ndodhi gjatë gjithë rrugës.

Kur arritëm në Theth, pas 10 minuta erdhi ndihma e shpejtë dhe e morën.

Ne disi të lehtësuar morëm rrugën e kthimit. Në kamp na priste profesori që na kishte bërë gjithshka gati. Hëngrëm darkë dhe ramë për të fjetur.



## Më dt 27

Ishte dita e fundit e aktivitetit. Edhe koha, si për të na përshëndetur, na doli më e bukur. Majat e maleve sikur na ftonin të bënim nga dy ngjitje. Dhe ashtu bëmë. Veç Mazit e Benit që bënë ngjitje të vëshitrësisë së gjashtë ne të tjerët bëmë nga dy ngjitje. Përvoja e fituar bëri që ngjitjet të na duken të lehta. Pasi përfundonim ngjitjet rrinim në majë dhe sodisnim natyrën. Kushedi se kur do të vinim përsëri këtu në Fushë të Dënellit. Mbase pas shumë vitesh, mbase pas një viti. Ku ta dish? Mblodhëm pajimet dhe me në krye Sokolin u nisëm për në kamp. Do ta them për mburje, por e shihja që tek ekipi ynë kishte më shumë solidaritet se në ekipet e tjera. Kështu më dukej mua.

Gati 50 a 70 metra sipër kampit u mbledhëm të gjithë të ekipit dhe thirrëm parullën tonë alpinistike. Pas kësaj zbritëm poshtë dhe hëngrëm një drekë të shijshme që na e kishte përgatitur profesori ynë.

Ishte thënë në urdhërin e ditës që në orën 16:30 do mblidheshim për të bërë analizën e aktivitetit. Aty dolën të metat dhe të mirat e këtij aktiviteti. Nga ekipi ynë u dalluan Arben Qato dhe Artur Shehu, si alpinistë që vinin për të parën herë në veprimtari verore.

Pas analizës bëmë gati çantat dhe zbritëm në Theth, ku ngritëm çadrat dhe ndejtëm deri vonë duke kënduar e duke kërcyer.

## Dt 28

Aktiviteti mbaroi dhe si shpërblim i ditëve plot punë dhe ngjitje, sot u ngritëm vonë. Secili bëri si bëri dhe e rregulloi mëngjesin e tij në bufe/klub me biskota dhe ndonjë kavanoz me reçel.

Në orën 13 do vinte një skodë (kamion) dhe do na linte në Shkodër. Pritëm gjatë deri sa erdhi dhe në orën 22:30 arritëm në Shkodër. Zëmë vend në Hotel Sporti.

D<sub>t</sub> 29.

U ngritëm shumë herët. Në orën 04:30 ishim në tren dhe arritëm në Tiranën tonë në orën 08:15

*Mbajtës i ditarit Foti Taçi*

Më poshtë vijon tabela përmbledhëse e ngjitjeve në këtë veprimtari. Kjo tabelë është pjesë e ditarit.

|            | 13 | 24 | 15             | 4              | 7              | 12             | 20 | 14             | 23             | 24             | 25 | 18             | 19             | 1              | 8 | 9 | 10 | 3              | 2              | 1              |                |   |
|------------|----|----|----------------|----------------|----------------|----------------|----|----------------|----------------|----------------|----|----------------|----------------|----------------|---|---|----|----------------|----------------|----------------|----------------|---|
| A. Bayler  |    |    |                |                |                |                |    |                |                |                |    | 8              |                |                |   |   |    |                |                |                | A              |   |
| Xh. Bayler | 4  |    |                |                |                | 4              |    |                | 5 <sup>+</sup> |                | 5  | 6 <sup>+</sup> | 6              |                |   |   |    | 5              | 5 <sup>+</sup> |                | 8              |   |
| M. Fells   |    |    | 4 <sup>+</sup> |                | 4 <sup>+</sup> |                |    |                | 5              | 5 <sup>+</sup> |    | 6              | 6 <sup>+</sup> |                |   |   |    |                |                |                | 6              |   |
| D. Fells   |    |    |                |                |                |                |    |                |                |                |    |                |                | 4              |   |   |    |                |                |                | 4              |   |
| A. Gato    |    |    | 4 <sup>+</sup> |                |                | 4              |    |                | 5              | 5              |    | 6 <sup>+</sup> | 6              |                |   |   |    |                |                |                | 6              |   |
| A. Shubin  |    |    | 4 <sup>+</sup> | 4              |                | 4              |    |                |                |                |    |                | 3 <sup>+</sup> |                |   |   |    | 3 <sup>+</sup> | 5 <sup>+</sup> | 5              | 4 <sup>+</sup> | 9 |
| A. Kurbi   |    |    | 4              | 4 <sup>+</sup> |                | 4 <sup>+</sup> |    | 4              |                |                |    | 5 <sup>+</sup> |                |                |   |   |    | 3              | 5              | 5 <sup>+</sup> | 4              | 9 |
| F. Torgi   |    |    | 4              |                | 4 <sup>+</sup> |                |    | 4 <sup>+</sup> |                |                |    | 5              |                |                |   |   |    | 8              | 5 <sup>+</sup> | 5              | 4              | 8 |
| A. Torgi   |    |    |                | 4              |                |                |    | 4              | 4 <sup>+</sup> |                |    | 5              |                |                |   |   |    | 3 <sup>+</sup> | 5              |                | 4 <sup>+</sup> | 8 |
| S. Dicks   |    |    | 4              |                |                |                |    | 4 <sup>+</sup> |                |                |    | 5 <sup>+</sup> | 6              | 6 <sup>+</sup> |   |   |    |                | 5 <sup>+</sup> | 5              |                | 7 |

Tabela e vlerësimit të itenerarëve të shënuar në Fushë Dënell:

Interferençat e kullës së Zharit

|           |            |
|-----------|------------|
| I 1 - IV  | I 11 - IV  |
| I 2 - IV  | I 12 - IV  |
| I 3 - IV  | I 13 - V   |
| I 4 - IV  | I 14 - V   |
| I 5 - IV  | I 15 - IV  |
| I 6 - III | I 16 - IV  |
| I 7 - IV  | I 17 - IV  |
| I 8 - III | I 18 - III |
| I 9 - IV  | I 19 - V   |
| I 10 - V  | I 20 - V   |

Ullëkuçiz:

Fotat për kopjues në listën

## Tetor 1983. Ngjitje në majën e Korabit (2.751m)

Ekipi

1. Aleksandër Bojaxhi
2. Dashamir Fejzo
3. Xhemal Begeja
4. Arben Qato
5. Mazllum Feka
6. Sokol Doko

### 13 tetor

Bashkë me ekipin e “Dajtit” (janë shtatë vetë me gjithë Kozma Grillon) arritëm në Peshkopi me autobuzin e linjës.

Na pritën alpinistët e Peshkopisë që na sistemuan në hotel dhe na shoqëruan në qytet.

### 14 tetor

Që më 08:00 dolëm për makinë dhe pritëm deri afër orës 13:00. Kishte mungesë makinash ngaqë nuk kishte benzinë. Më 13:00 nisemi me një makinë deri në Kastriot. Sokoli e Mazllumi erdhën në këmbë mbasi në momentin që erdhi makina nuk ndodheshin aty.

U nisëm nga Kastrioti. Përpara kaloi ekipi i Peshkopisë (Korabi), kurse ne të tjerët të shoqëruar nga Qemal Hakorja (Korabi) e morëm më shtruar. Pas 90 minutash na arritën dy makina të cilat na morën të gjithëve (përjashtuar pesë të Dajtit). Me makina shkua deri tek Livadhi i Gjatë, diku në JP të Korabit, në një lartësi që me siguri ishte 2.200 metra (*këto makina mbartnin elementë të pozicioneve luftarake që ndërtoheshin në kuadrin e sistemit të mbrojtjes nga armiku J*). Prej aty, pas rreth 90 minuta zbritje arritëm në fshat. U vendosëm në lagjen Tejzë të Radomirës. Unë, Qemali e Kozmai u sistemua në shtëpinë

e Galip Ahmati, një plak i mënçur, i fisëm, i pritshëm, 70 vjeçar që kishte dy djem në shtëpi: Xhelalin dhe Iljazin. Dashi, Koli, Mazi u vendosën tek Ekremi, djalë me shtëpi më vehte i Galipit. Beni, Xhimi e Sokol Hoxha në një familje tjetër. Erdhi dhe Taxhedini dhe ramë në ujdj që ai të nisej nesër për në majë në ora 05:00 kurse ne të tjerët në ora 07:00.



Aleksandër Bojaxhi dhe Qemal Hakorja

## 15 tetor

U nisëm më 07:30. Arritëm tek posta kufitare verore më 08:30. Aty pushuam dhe komandanti na mbajti deri më 09:30. Pastaj u nisëm duke patur tashmë edhe dy ushtarë në grupin tonë. Më ora 10:00 u takuam me grupin e Taxhedinit që kthehej nga maja e ndejtëm bashkë për 30 minuta. Më pas u ndamë dhe arritëm në majë para orës 12:00. Aty ndenjëm rreth një orë duke soditur e biseduar. Koha ishte e mrekullueshme. Më 14:30 ishim poshtë në postën kufitare. Pesë alpinistët e ekipit të Dajtit, që kishin ardhur 20 minuta pas nisjes sonë, i gjetëm aty. Komandanti i Postës nuk i kishte lejuar të vazhdonin. Pasi ramë në ujdj me komandantin që këta pesë alpinistë të ngjiten nesër në Korab, tepër të uritur arritëm në fshat ku kaluam natën.

## 16 tetor

Pesë alpinistët e Dajtit u nisën për në majë më ora 07:00 kurse ne më 07:30 u nisëm për Peshkopi. Alpinistët e “Korabit” u nisën që dje për në Peshkopi.

Pas një ore udhëtim, mua e Kozmain (dy të fundit në kollonë) na merr një makinë. Në Sllovë takuam të tjerët që i mori makina ku ishim ne, dhe na la në Kastriot. Aty hëngrëm një drekë të mirë e të lirë. Prej këtu u nisën të gjithë, me përjashtimin tim e të Kozmait, por që pas 30 minutash na mori një makinë. Rrugës arritëm të tjerët e të gjithë bashkë shkuam në stadium ku ndoqëm takimin e futbollit “Korabi” – “Vetëtima” (Himarë) që u mbyll 1 me 0 për vendasit. Unë e Kozmai i lamë çantat në shtëpinë e Taxhit dhe pasi i nisëm djemtë, me Taxhin për t’i rregulluar për fjetje në palestër, u nisëm me Kozmanë për në Brezhdan, tek shtëpia e Qemal Hakorjes, ku kaluam një darkë mjaft të këndshme.

## 17 tetor

Mëngjesi kaloi i këndshëm dhe i qetë. U larguam me përshtypjet më të mira për Qemalin dhe familjen e tij, e sidomos për të shoqen e Qemalit – Kimeten. Kur arritëm në Peshkopi, u sistemuam në hotel dhe u interesuam.... Më pas blemë mollë të mira. Kur po hanim darkë arritën pesë alpinistët e ekipit të “Dajtit”. Edhe ata ishin ngjitur në majën e Korabit.

Në darkë Dashi vajti në Dovolën. Unë e Kozmai vajtëm për darkë tek Taxhedini. Kaluam mjaft mirë.

## 18 tetor

Nisemi të gjithë për Tiranë me linjën. Kaluam ditë të bukura, ngjitje të bukur, e kujtime të mira.

*Mbajtës i Ditarit Aleksandër Bojaxhi.*

**Shtesë:** kjo veprimtari, e para e zhvilluar gjatë jetës sime alpinistike në muajin tetor, u organizua në përkujtim të ditëlindjes së Enver Hoxhës. Lëvizja sportive kishte shpallur për këtë muaj atë që quhej “Java Sportive e Enverit”. Ne na u caktua ngjitja e majës së Korabit.

Kjo ngjitje u bë pasi kishte rënë bora e parë në Korab. Në shpatin e majës që është në anën e Maqedonisë (Ish Republika Federative Jugosllave) kishte mbetur një hapsirë me borë të pashkrirë. Në itinerarin për në majë ne kaluam në anën tjetër të kufirit (e shkelëm kufirin, sikundër thuhej atëherë) ashtu sikundër bëhet sot kur i ngjitesh majës nga Tejza. Pasi ne kishim mbaruar “punë” me malin e Korabit, patrulla kufitare jugosllave i pa gjurmët që kishim lënë në borë, i fotografoi ato dhe pas kësaj kjo shkelje kufiri u bë problem diplomatik. Shteti ynë, pas kësaj ngjitje, nuk na lejoi të shkojmë më në këtë majë, në dijeninë time, të paktën jo deri në vitin 1992.

# VITI 1984

## Dimërore

Ekipi:

1. Aleksandër Bojaxhi
2. Dashamir Fejzo
3. Romeo Manxhari
4. Mario Trinkera
5. Ilir Tapia
6. Sokol Doko

## 31 janar

Sokolin e kemi nisur më dt. 26 në darkë për Shkodër për të na zgjidhur me kohë problemin e hotelit dhe të biletave të autobuzit për linjën Shkodër – Bogë.

Ne arritëm më dt. 27 me trenin e fundit. Patëm një përcjellje solemne në Tiranë ku erdhi pjesa e mbetur e ekipit (*pjesa e ekipit që nuk u aktivizua*). Udhëtimi kaloi mjaft mirë. Sokoli na kishte zënë vende tek Hotel Park në qendër. Harruam në autobus (*urban*) një çadër/tendë por vajtëm me vrap dhe e morëm.

Më dt. 28 herët në mëngjes u interesuam bashkë me alpinistët e Shkodrës për bileta. I siguruam. (sot rezulton se kazma ime

ishite harruar në tren). Më 09:15 u nisëm nga Shkodra dhe më 11:30 ishim në Bogë. Koha u prish.

Rregulluam të flemë tek Nikollë Malaj në Okol. Ky na mbarti për atje materialet me qerre. Në darkë Marjo e Romeo shkuan tek Rolajt, Koli me Lirin (Ilir Tapia) tek Bajraktari, e unë më Dashin mbetëm aty.

Më dt. 29, pa Marion, çamë rrugën deri pranë Grykës (*Gryka e Lekës*) për në Gropë të Radohinës. U kthyem tek Malajt pas gjastë orësh. Rruga e Shtegut ishte hapur dy ditë më parë nga dy malësorë.

U ulëm tek dyqanet dhe hëngrëm. U bë një dëftesë për transport me kafshë në shumën 50 lekë. Bie shumë shi e borë. Kur u kthyem në Okol (Iliri e Koli mbetën tek Bajraktari); ishim tepër të lagur. Për ekipin arrij në një konkluzion (!?)

Sot ora 08:00 u nisëm me materialet ngarkuar për lart. Ritmi i ulët. Pas katër orësh diskutuam që të lëmë aty materialet dhe të kthehemi. Kjo nuk u pëlqen më të rinjve. Mbajta anën e tyre. Dashi, Marjo e Romeo u ulën në fshat. Ne, pasi u hap rruga deri tek Gryka e Gropës, u thamë sa ishte diell. Ngritëm çadrën, përgatitëm dru për zjarr dhe u sistemuam. Pasi pimë një çaj dhe hëngrëm pak, Koli ndezi zjarrin i cili na thau mirë. Tani në çadër po fillojmë një domino.

## 1 shkurt

Dje koha nuk qe fort e mirë. Nga dreka doli 2-3 orë diell. U thamë u sistemuam dhe përgatitëm dru për zjarr. Nga ora 15:00 ndezëm zjarr dhe këpucët pothuajse i thamë. Një kohë të mirë e kaluam duke luajtur domino. Për të ngrënë patëm proshutë dhe çaj. Furnela dhe Lirit na nderuan. Në mbrëmje koha u prish.

Sot gjithë ditën koha ishte e keqe. Borë e vazhdueshme. Nga larg vazhdimisht dëgjohen bubullima. Kohë për domino.



Nga ora 14:00 një malësor i nisur për tek ne nga treshja që është poshtë (në fshat) na thirri nga Gropa e Portës e na tha që të kthehemi në Bogë. Iu përgjigjëm duke i thënë se do të presim këtu sa të hapet koha, dhe i presim këtu edhe ata. Malësori na tha se ekipet e Vlorës dhe Tropojës (pjesë e grupit tonë për veprimtarinë) nuk kanë ardhë.

Ora 16:00 hodhëm tendën mbi çadrën tonë (çadër mbi çadër) dhe duket që tani jemi rregulluar shumë mirë për çdo situatë. Edhe shtrojet për fjetje i sistemuam mjaft mirë. Ka rënë 20 cm borë e re. Tashmë ka filluar të fryjë verí i lehtë. Në çadër jemi mjaft ngrohtë. Përsëri do të lozim domino e do përgatisim çaj për të shtyrë djathin dhe proshutën. Ora po shkon 17:30.

### 3 shkurt

Dje nga ora 12:00 erdhën tek ne treshja e ekipit tonë dhe një treshe e Tropojës. I ndiemë vetëm kur erdhën. Koha e keqe që vazhdon që nga data 1 sapo ishte qetësuar. Ishin tepër të indinjuar. Përse? Sepse ne nuk kishim zbritur. Fshatarin që na foli dje - ishte Thethjan, ne nuk e kishim kuptuar (ne komunikuam me të thirrura në distancë).

Bëmë debat të gjatë të ulemi apo të rrimë. Më së fundi vendosëm që edhe treshja (tjetër) e ekuipit tonë të qëndronte. Tropojanët u ulën dhe bëmë marrveshjen që nesër, po të bëjë koha e mirë, bashkërisht do të vazhdojmë për Radohinë; po bëri kohë e keqe do të ulemi në Bogë. Sundon mendimi që të stabilizohemi në Bogë për të bërë ngjitje aty, sepse parashikimi i 10 ditorit të ardhshëm është dhënë për kohë të keqe.

Ngritëm dy tenda të llojit/markës Nepal dhe u sistemuam. Zjarr nuk arritëm të bëjmë, kështu që në ora 19:00 ramë që të flemë. Konkluzioni forcohet (!?).

Sot u gdhi kohë e keqe. Sipas marrëveshjes duhej të uleshim. Nga ora 08:00 filluam të përgatitemi. Ora 09:00 u nisëm. Kur ramë në Gropë (Gropa e Portës), propozova të ngjitemi në majën e Shtegut, por nuk ndezi. Ora 10:00 takojmë tropojasit. Po ngjiteshin lart me gjithë materialet të ndihmuar nga fshatarë. Lindi diskutimi ”çfarë të bëjmë?”. Zgjati shumë dhe u vendos të dalim në Theth. Rruga sapo është çarë: kanë kaluar 10 fshatarë *(n'ato vite gjatë gjithë stinës së borës, si rregull nga nëntori në qershor, kohë kur rruga automobilistike është e bllokuar nga bora, për nevojat e tyre thethjanët kalojnë në Shkodër nëpërmjet Shtegut të Dhenve dhe marrin makinë/autobus në Bogë për të vazhduar më tej.)*.

Në Theth, të fundit e kollonës sonë arritën në ora 14:00. U stabilizua shumë mirë në godinën e kampit të punëtorëve. Kushtet këtu i kemi për riaftësim dhe tharje të plotë. Në ora 22:00 jemi të gatshëm, madje që nesër, për rrugë. Sipas televizorit, edhe nesër do jetë kohë e keqe.

Besoj se sonte të gjithë do të flenë me kënaqësinë e ndënjes në Theth.

## 5 shkurt

Dje e kaluam gjithë ditën në kamp. Përsëri u mblodhëm tek vatra. Kaluam një pushim të mirë. Mbi të gjitha hëngrëm shumë mirë. Mbasdite - Dashi, Romeo e Sokoli u ulën tek dyqanet e fshatit dhe sollën gjashtë shishe me verë. Darka u shoqërua edhe me verë. Në ora 20:00, bashkë me Nuredinin shkuam tek Sykja (vajzë e familjes Çarku) sikundër bëmë edhe mbrëmë. Pamë parashikimin e motit në TV. Moti do të kthejë. Vendosiëm të nisemi nesër mbasdite për Gjelaj (lagje e fshatit Theth).

Sot fryn “nji rrem véri”. Nuredini na zgjon herët për t'u nisur për Rrogam. Ora 08:45 nisemi. Më 11:30 jemi në shtëpinë më të sipërme në Nënrreth. Thahemi si dhe hamë drekën. Ora

12:45 nisemi. Më 15:20 jemi në Qafë të Valbonës, më 15:55 tek Buni Valbonës (Kroni Valbonës) dhe më ora 17:00 tek shtëpia e Kol Cakut. Kalojmë darkën shumë mirë. Nesër, ora 07:00 e kemi lënë të nisemi për Jezerë. Megjithatë çdo gjë do të vendoset përfundimisht nesër.

## 8 shkurt

Më datë 6, ora 07:00 dolëm nga shtëpia dhe ndalëm në hyrje të Lugut të Livadhit. Hëngrëm mëngjesin dhe pritëm sa u mblodhën edhe ekipet e tjera. Ora 07:45 u nisëm. Bora fundos shumë. Punojnë më shumë për “çarjen” e saj Aleksandër Tafli, Nuredini e ndoshta edhe unë. Në Qafë të Rrogamit pushuam pak. Mario, Dashi dhe Agroni i Vlorës nuk ranë dakort, për arësye të lodhjes, që të vazhdonin për Jezerë. Qëndruan dhe ngjitën majën e Rrogamit. Ne vazhduam dhe arritëm në rrëzë të shkëmbit për të sulmuar Jezerën. Unë dhe Nuredini shkuam dhe ngjitëm Kokërhanën. E para herë që ngjitet në dimër.

Në ngjitjen e Jezerës - Romeos dhe Ilirit iu shkëput një rrasë bore që formoi një ortek të cilin unë e Nuredini e dëgjua mirë por nuk na shkonte në mendje se kishte filluar nga “trupi” i shokëve tanë. Ishin ngulur fort me kazmat në borë dhe shpëtuan. Në kthim u ngjit maja e Rrogamit. Unë u ktheva nga kjo sepse kishte akull vende-vende dhe nuk kisha siguri.

Më 19:15 arritëm në fshat. Opinioni i fshatarëve për ngjitjen tonë është shumë i mirë.

Kur u bashkuam të dy grupet pas zbritjes nga Jezera, rreth 1-2 orë larg nesh ngjiteshin në zonën e Bunit të Brahimit alpinistët që drejtoheshin nga Vasil Stambuli. U dërguam një zig-zag dhe ata na u përgjigjen me dy të shtëna automatiku (*me siguri të bëra nga Shili!*).

Dje, nga ekipi ynë vetëm unë u nisa për ngjitjen e majave të Alisë dhe Popllukës. Tre më të rinjtë duken tepër të lodhur. Megjithatë është tepër e habitëshme që Sokoli nuk u ndie për të ardhur në ngjitje. Mario e Dashi janë në kufijtë e pamundësive fizike dhe psiqike për të lëvizur nga shtëpia ku kemi rënë.

Në majën e Alisë arritëm më 11:50. Ishim dy tropojas, tre vlonjatë dhe unë. U ngjitëm deri në një litar rrugë pa vajtur në majë. Duhej sigurim dhe ne nuk kishim litar kolektiv, por mbi të gjitha frynte erë aq e fortë dhe e ftohtë sa do të ishte e padurueshme që ne, një nga një, të shkonim e të ktheheshim nga maja. Megjithatë, me ngut arritëm dhe bëmë disa poza. Ngado duket një det reshë që po ngrihen lart me furi. U ulëm në qafën midis Alisë e Popllukës. Caqja (Kristaq Gega) dhe Rustemi (Kurtsmajli) u kthyen. Ne të tjerët vazhduam për Popllukë. Gjatë gjithë ngjitjes ndenja në krye. Na mundoi tepër. Bora e ngrirë (për të bërë qukat, vuajta shumë) dhe era e fortë dhe e ftohtë që na përplaste grimca bore me forcë në sy na çuan në një gjendje psiqike egërsie me malin dhe natyrën si dhe me padurimin “kur do të mbarojë ky tension”? Më së fundi arritëm. Me shumë ngut bëmë ca poza dhe u ulëm nga ana e itenerarit që e ngjit majën nga Gropat e Bukura. Pastaj devijuam djathtas dhe u futëm në Lugun e Valit. Aleksandër Tafili u kthye përpjetë për të marrë çantën time që e kishte lënë Caqja ca më sipër itenerarit të zbritjes sonë (fat i madh që e pamë). Pritëm në këtë të ftohtë sa na u kthye shoku dhe u ulëm deri tek Buni i Valbonës dhe pushuam pak. Këtu nuk ndihet era që fryn.

Në shtëpi arrita ora 16:00. Të gjithë janë aty, por jo Sokoli. E prisja që do i nxirrte rrugë vetes për të shkuar në Valbonë.



Zbritje nga maja e Jezerës

## 9 shkurt

Dje u gdhi kohë e keqe. Borë e mjegull. Për ngjitje u bënë vetëm shaka, shaka e cila u kurdis nga unë e Nuredini që herët në mëngjes (ma fort për të ngacmuar Marjon, por edhe Dashin). Ora 10:00 u nisëm për Valbonë. Aty u grumbulluan të gjitha ekipet të cilat u nisën mbasdite me një autobus të Kinostudios e disa të tjerë, më vonë, me linjën. Ekipi ynë mbeti vetëm. U stabilizuam në dhomën e mësuesit të vizatimit e fizikulturës (kish mbaruar shkollën e mesme për pikturë në Shkodër), Gëzim Haxhiraj.

Sot u gdhi kohë shumë e keqe. Borë e madhe. Na hyri frika se mos ndoshta nuk do dalim nga Valbona me mjet. Mësuesi u nis për Rrogam por u kthye. Më 12:00 bëhet gati për rrugë një makinë ZIS e Kinostudios që do kthehet në B. Curri. Në ora 13:00, Zisi i tërhequr nga një buldozer (deri në Kikaj) dhe ne brenda Zisit, u nisëm. Udhëtimi pati plot peripeci. Arritëm në hotel më 16:45.

Ora ka kaluar nga 21:00 dhe sapo ka arritur autobusi nga Tirana. Ne jemi në kërkim të vendit për fjetje në hotel.

*Mbajtës i ditarit Aleksandër Bojaxhi*

## Aktivitet me kategoritë e ulta në Bogë

20 deri 28 shkurt 1984

Pjesëmarrësit:

1. Aleksandër Bojaxhi      trajneri
2. Dashamir Fejzo          komisar
3. Mazllëm Feka
4. Arben Qato
5. Adrian Kurti
6. Artur Shehu
7. Xhemal Begeja
8. Aleksandër Tapia
9. Bujar Kokoshi
10. Fiti Taçi                      mbajtës i ditarit

Ekipet që morën pjesë: “17 Nëntori”, “Dajti”, “Apollonia”, “24 Maj”, “Minatori” i Tepelenës, “10 Korriku” i Gramshit.  
Komandant i ngjitjeve - Mj. Sportit Kozma Grillo.

### Më dt 20

Sot na eci shumë mbarë. Kemi arritur në Bogë, por jemi të veshur hollë. Pasi ngritëm çadrat filloi borë. Xhimi që vazhdon shkollën e guzhinës na përgatiti supë të ngrohtë e më pas i thamë natën e mirë kësaj dite.

### Më 21

Sapo u zgjuam zgjatëm kokat jashtë që të shikonim kohën. Binte borë që “nuk e çante kokën” që ne ishim këtu për aktivitet. Më nge bëmë veprimet dhe në orën 9 hëngrëm mëngjesin. Unë e Beni ishim dezurn, kështu që lamë pjatat. Zbritëm në Bogë për të vrarë kohën nëpër dyqane si dhe kaluam kohën me një lojë që shpiku Ardi. Në darkë, 7 vetë u mbledhëm në një çadër për të hequr mërzinë (*Ardi ishte udhëheqës i këngës për brezin më të ri të*

*alpinistëve në ekipin tonë. Dashi ishte i tillë për brezin më të vjetër, por edhe për të gjithë, si brënda edhe jashtë ekipit tonë. Njëherësh dollibash i mirë.).*

## Më 22

Sot nuk ka reshje. Pas rutinës së mëngjesit u rrjeshtuam duke marrë secili edhe ca ushqim. Kozmai ndau majat që do të ngjisnim. Profesori ynë në krye të grupit ku bënte pjesë edhe Mazllëm Feka, Arben Qato dhe Xhemal Begeja sulmuan majën e Livadheve, por 100 a 150 metra afër majës u detyruan të kthehen ngaqë moti u keqësua aq shumë sa nuk shikonin njëritjetrin. Grupi tjetër i udhëhequr nga Rahiti ngjiti dy maja të dyta (*të kategorisë së dytë të vështirësisë*). Në këtë grup bënë pjesë edhe Leko, Adriani, Arturi, Bujari, si dhe unë. Ngjitjet u realizuan me sukses. Vlen të theksohet se nga fillimi në fund borën e çau ekipi ynë.

Si u kthyem në kamp, u përgatita shokëve një drekë për të lëpirë gishtat. Shokët e majës së Livadhit u kthyen 2 a 3 orë më vonë. Mbasdite secili u muar me punët e veta. Darkën e hëngrëm nëpër çadra dhe ramë shpejt për të fjetur.

## Më dt 23

Në mëngjes binte shi i përzier me borë. Kjo bëri që ngjitjet të shtyen me një orë. Rrinim shtrirë dhe mendonim për dy ditët që kaluam si dhe për humorin që kishim. Humorin më të fortë e bëri Ardi kur tha: “Profesori o të uli dozën e stërvitjes ose të na porositë benevrekë të reja”. (*besoj se benevrekët do kenë qenë të ngushta për t’u futur aty muskujt e Ardit*). Ç’ishin ..... të ekipeve të tjera mbajtën barkun me dorë.

Pas një ore u rrjeshtuam dhe u ndamë në toga. Toga e Rahitit bëri një ngjitje të vështirësisë së dytë dhe një të tretë.

Ajo që kryesohej nga profesori bëri vëtëm një të tretë. Ngjitjet u realizuan me sukses. Mbasdite shkua në klub, ku shtrua një banket me verë për të festuar marrjen e kategorisë së dytë sportive (të plotësuar me ngjitjet dimërore që kemi bërë deri tani) nga unë, Ardi, Leko dhe Turi.

## Më 24

Kalua një natë që do ta mbajmë mend. Bora, nga ana ku jam unë, binte topa-topa ndërkohë që ne mendonim se na qëllonin nga jashtë me topa bore. Në atë kohë ne dëgjua edhe një si zhurmë dhe u bindëm për një gjë të tillë. Jashtë dëgjua zëra. Ishin profesori, Ardi dhe Turi. Menjëherë dal nga dysheku dhe shoh se çadra e guzhinës kishte rënë, por meqë ishte në të ngritur (në sistemim e sipër), mora kazmën dhe fillova të pastroj çadrën tonë. Pastaj ramë të flinim por gjumi nuk na mori.

Në mëngjes, megjithse morali ynë ishte i lartë, shtabi mendoi që ne të flemë nëpër familje. Me shumë ngatërresa u rregullua në një dhomë të madhe bashkë me ekipin e “Apollonisë”. Aty kalua një darkë të mirë dhe profesori na lejoi që të merrnim edhe nga një shishe birrë. Ramë të flemë. Lagështira e madhe e mureve ishte shqetësuese.

## Më 25

Koha ishte e vrejtur dhe pa reshje. U rrjeshtua përpara dyqaneve. Grupi i profesorit, nën drejtimin e Dashmir Fejzos do të ngjisin majën e Livadhit dhe atë të Thatë. Profesorit i dhimbte koka dhe nuk shkoi në ngjitje. Ngjitja u realizua me sukses.

Grupi ynë, i kryesuar nga Rahiti ngjiti me sukses majën e Bridashit të Vogël dhe një majë tjetër. Kur u kthyem gjetëm një drekë të mirë që e kishte përgatitur profesori. Në darkë më ra për pjesë të qëroja patatet të cilat ma sollën në majë të hundës. Në



darkë, profesori dhe Dashi shkuan tek një mik i tyre, kurse ne ishim më të shpenguar për humor.

## Më 26

Meqë nuk ishin as Dashi e as profesori dolëm më vonë nga thasët e fjetjes, kështu që mëngjesin e hëngrëm në këmbë.

Grupi ynë me Rahitin do ngjisim Bridashin si dhe një majë tjetër aty pranë. Këto maja do të ngjiten edhe nga grupi i profesor Acit. Ngjitjet u kryen më së miri dhe në kthim gjetëm një gjellë të shijshme të përgatitur nga Dashi. Më pas, ca shkuan në klub e ca nga ne u shtrinë. Mbasdite teksa bisedonim, Dashi e kapi papritur Benin dhe nisi ta fërkojë. Ardi e kapi nga krahut tjetër dhe nisi edhe ai masazhin. Kjo gjë i bëri aq mirë Benit, sa nisi të qeshte me të madhe. Deri në këtë moment ai ishte i pezmatuar ngaqë gjatë ngjitjes kishte vrarë syrin.

Në darkë, pas buke, rregulluam tavolinën që të flinte aty Mazi ngaqë nuk kishte vend. Nata kaloi e qetë, përjashtuar gërhimat e shumta të anëtarëve të ekipit të Fierit.

## Më 27

Sot është kohë e keqe. Bora e shiu nuk të lënë të nxjerrësh kokën jashtë dhomës. Kjo kohë vazhdoi deri në drekë. Shtabi vendosi që për ata që kishin nevojë për ngjitje, me qëllim për ngritje në kategori sportive, të bëhej një ngjitje e shkallës së katërt të vështirësisë. Ky grup u nis në orën 2 pasdreke dhe pas vështirësish të shumta arriti në dhomë në orën 6. Ishin bërë si mos më keq nga shiu që vazhdonte të binte. Të gjithë ata që ishin të thatë bënë më të mirën e tyre për të ndihmuar të lagurit.

Në darkë profesori bujti tek një mik. Bëmë mundje unë e Turi e dolëm 1 me 1. Të lodhur sikundër ishim, hëngrëm darkë

dhe ramë për të fjetur nën tingujt e ëmbël të muzikës së radios së Dashit.

## Më 28

Përsëri kohë e keqe. Binte një shi i tillë që vërtet na mërzi. Hëngrëm mëngjesin që na e përgatiti Xhimi. Meqë është dita e fundit e aktivitetit, duket që ushqimet po mbarojnë, që të gjitha. Më shumë na e mbushi barkun grosha që morëm në mencën e fshatit. Pasi hëngrëm, profesori më tha të merrja letrat dhe të bënim një peskatësh. Në këtë lojë fituan profesori dhe Beni. Unë e Turi ishim në ditë të keqe. M'u kujtua diçka që kam harruar ta them por që ma kujtoi tani Turi. Në mëngjes të gjithë bëmë mundje dhe rezultoi që Turi ishte më agresori.

Ishte lënë që në 16:30 të bëhej analiza e veprimtarisë. Analizën e hapi komandanti i ngjitjeve, Mj. Sportit Kozma Grillo. Kur i erdhi radha diskutimeve, e mori fjalën profesori, pastaj unë në emër të ekipit dhe më pas Sokol Hoxha për ekipin e Dajtit. Ekipet e tjera nuk diskutuan.

Pas analizës secili priste darkën për të vallzuar e kënduar. Për darkë pime nga një shishe birë dhe nisëm humorin. Dashi na iku, por ku vajti vallë? Të gjithë u shqetësuan dhe u ngritën për ta kërkuar. Shkuan edhe tek çadra e ekipit të Gramshit ku edhe e gjetën. Me të bërtiturat "O Tirona! O Tirona!", e nxorëm jashtë dhe shkuan në dhomën tonë. Aty vazhduam deri në orën 23. Aty nga ora 4 e mëngjesit zgjohet Ardi dhe sikur ta kishte pickuar dikush fillon e bërtet e bën llafe. Na doli gjumi të gjithëve. Nga ora 8 filluan përgatitjet për t'u nisur për Shkodër. Me këtë mbaroi dhe veprimtaria alpinistike dimërore.

*Mbajtësi i ditarit Foti Taçi*

Më poshtë vijon tabela përmbledhëse e ngjitjeve në këtë veprimtari. Kjo tabelë është pjesë e ditarit.

*Fotografi ligjshme në ditar*  
**NGJITJET DIMERORE 1984**  
*Klubit sportiv "17 Nëntori"*  
**Bagë 21-28 shkurt**

| Nr.                                                           | alpinisti          | Mulliri | Krai | Negoveni | M. Gato | Brilashit | Biroi | Pishkani | Brilashit | Livadh | Livadh | Brilashit | Hunola | M. Thaçë | M. Livadh | Shuma |
|---------------------------------------------------------------|--------------------|---------|------|----------|---------|-----------|-------|----------|-----------|--------|--------|-----------|--------|----------|-----------|-------|
|                                                               |                    | I       | I    | II       | III     | III       | III   | III      | IV        | IV     | V      | V         | V      | V        | V         | V     |
| 1.                                                            | Aleksandër Bojaxhi | -       | -    | -        | 3       | -         | 3     | 3        | 4         | 4      | -      | -         | 5      | -        | -         | 5     |
| 2.                                                            | Dashamir Fejzo     | -       | -    | -        | -       | -         | -     | -        | -         | -      | 5      | 5         | 2      | -        | -         | 2     |
| 3.                                                            | Xhemal Begeja      | -       | -    | -        | 3+      | -         | 3     | 3+       | 4         | 4+     | 5      | 5+        | 7      | -        | -         | 7     |
| 4.                                                            | Arben Qato         | -       | -    | -        | 3+      | -         | 3     | 3+       | 4         | 4+     | 5      | 5+        | 7      | -        | -         | 7     |
| 5.                                                            | Artur Shehu        | -       | 1    | 2        | 3       | 3         | 3     | 3+       | 4         | 4+     | -      | -         | 8      | -        | -         | 8     |
| 6.                                                            | Foti Taçi          | -       | 1+   | 2        | 3       | 3         | 3+    | -        | 4+        | 4+     | -      | -         | 7      | -        | -         | 7     |
| 7.                                                            | Aleksandër Fejzo   | -       | 1    | 2        | 3       | 3         | -     | -        | 4+        | -      | -      | -         | 5      | -        | -         | 5     |
| 8.                                                            | Adrian Kurti       | -       | 1    | 2        | 3       | 3         | 3+    | -        | 4+        | 4      | -      | -         | 7      | -        | -         | 7     |
| 9.                                                            | Bujar Kokoshi      | -       | 1+   | 2+       | 3+      | 3         | 3+    | -        | 4+        | 4      | -      | -         | 7      | -        | -         | 7     |
| 10.                                                           | Mazllëm Feka       | -       | -    | -        | 3+      | -         | 3     | 3+       | 4         | 4+     | 5      | 5+        | 7      | -        | -         | 7     |
| Komisar (Dashamir Fejzo)<br>Komandant (Kozma Grillo)<br>Shuma |                    |         |      |          |         |           |       |          |           |        |        |           |        |          |           | 62    |

## Aktiviteti kombëtar alpinistik veror

Shtegu i Dhenve, 20 – 27 korrik 1984

Pjesëmarrës:

1. Aleksandër Bojaxhi trajner
2. Dashamir Fejzo komisar
3. Sokol Doko komandant toge
4. Mazllëm Feka
5. Xhemal Begeja
6. Arben Qato
7. Adrian Kurti
8. Artur Shehu
9. Aleksandër Tapia
10. Foti Taçi mbajtës i Ditarit
11. Bujar Kokoshi

Ekipet pjesëmarrëse: 17 Nëntori, Dajti, Apollonia, Minatori T,  
5 Shtatori i Skraparit

Komandant i ngjitjeve MS Kozma Grillo.

## **19 korrik 1984**

Kemi mbërritur në Shkodër. Për të fjetur ato 3 - 4 orë që na kishin mbetur, meqë treni mbërriti vonë, vajtëm në një konvikt shkollë.

Sot në mëngjes u ngritëm herët dhe si zakonisht me materialet në shpinë u nisëm për në axhencinë e udhëtarëve. U sigurua një kamion për materialet dhe një autobus për alpinistët. U nisëm për në Bogë. Mazi dhe Dashi udhëtuan me kamionin e materialeve. Meqë mbetëm pak në autobus, me të ne shkuam deri në Qafë - Thore. Këtu erdhi makina me plaçkat si dhe Mazi e Dashi që ishin zbardhur nga pluhuri. Shkarkuam dhe filluam t'i mbartim ato për në Shteg. Në moment u kujtuam se nuk kishim vajguri për furnelat e gatimit, andaj unë e Turi vajtëm me po atë makinë në Theth. Aty blemë vajguri dhe nga fshati vajtëm në këmbë tek Kampi i Punëtorëve. Këtu pritëm dy orë të mira dhe meqë nuk erdhi makinë për në Qafë, u nisëm më këmbë për në Shteg, ku arritëm pas 45 minutash. Me sa kuptuam ne, çantat i kishin lëvizur me mushka nga Qafa e Thores në Shteg. Hëngrëm. Ishim shumë të uritur. Në mbrëmje, nga lodhja, të gjithë mendonin vetëm për të fjetur.

## **20 korrik 1984**

Profesori në gjimnastikën e mëngjesit na bëri ca vrapime e ushtrime nëpër lëndinë. Më pas hëngrëm mëngjesin. U rreshtuam përpara komandantit të ngjitjeve si ushtarët përpara oficerit në komandën "Gati-tu!" Dhe në heshtje dëgjuam Sokolin që na lexoi urdhrin e ditës. Ngjitjet ishin kështu: Beni, Mazi, Xhimi

I-2 e katërt në Mark; Leko, Turi, Kokoshi I-1 e tretë në Mark; Foti, Foti, Ardi I-1 e tretë në Mark; Ardi I-12 e katërt në Zagorë; Leko, Turi, Kokoshi I-11 e katërt në Zagorë; Xhimi, Mazi, Beni I-12 e katërt në Zagorë.

U nisëm me optimizëm ndonëse pamë që ngjitjet ishin disi larg, më larg nga sa e menduam. Deri nga ora 15.00 ngjitjet u realizuan me sukses. U kthyem në kamp. Zorrët me kohë kishin filluar grevën e urisë. Dashi na kishte gatuar shumë gjëra. Pushuam pak dhe në orën 18:30 unë, Turi e Jari (*Bujar Kokoshi*) shkuam për të luajtur futboll. Loja doli barazim. Kur u kthyem hëngrëm darkë dhe ramë për të fjetur.

## **21 korrik 1984**

Si zakonisht, u çuam, hëngrëm mëngjesin dhe morëm detyrën: Beni, Mazi, Bujari I-9 e pestë, Zagorë; Xhimi, Foti, Koli I-11 e katërt, Zagorë; Xhimi, Foti I-6 e tretë Mark, Ardi, Leko, Turi I-4 e pestë Zagorë. Ngjitjet u realizuan me sukses dhe në orën 15 ishim në kamp. Aty na priste një drekë shumë e mirë e përgatitur nga Dashi. Më pas pushuam nëpër çadra. Në orën 17.00 u hodh shorti për ndeshjet e futbollit. Në ndeshjen e parë na ra me Tepelenën. Humbëm. Vështirë të besohet se sa u nxehëm! Nuk na besohej që humbëm! Një shkak për humbjen mund të ishte vendosja e Dashit si portier dhe jo në sulm. Shkuam në çadra për të ngrënë dhe për të biseduar pranë zjarrit për



Ngulja e plengës/gozhdës në shkëmb

ngjitjet e vështira dhe për alpinistët e zotë. Kishte ndonjë nga ne që frikësohej paksa dhe Dashi këtë donte. Na fliste akoma më shumë për traversat me akull, për dimër të tmerrshëm dhe të gjithë dëgjonim dhe qeshnim.

## Më 22 korrik

Sot jemi përsëri në Mark dhe Zagorë (*Marku – binjaku i Bogës; Zagora – binjaku i Thethit*). Të them të drejtën rrugëtimi për atje të vriste shumë, sidomos kthimi/zbritja. Sot na u tha të punonim në këto itinerarë:

Ardi, Xhimi, Foti I-9 e pestë në Zagorë; Turi, Leko I-12 në Zagorë; Leko, Turi I-2 në Mark e katërt; Mazi, Beni, Bujari I-6 në Mark e tretë; Foti, Ardi I-2 në Mark e katërt; Bujari, Beni, Mazi I-8 në Zagorë e katërt. Sapo u kthyem në kamp hëngrëm me oreks të madh dhe ca filluan “pesë katshin”, ca lojën “mos u nxe”. Për darkë Profesori do na zërë kos, por o për faj të batanijes që ishte me vrimë, o për faj të qumështit pluhur që mund të ishte i vjetër, zënia e kosit dështoi. Kjo ishte humbje përsa i takon ushqimit.

Mbasdite luajtëm futboll me “5 Shtatorin”. Gabimin e djeshëm e korrigjuam dhe fituam 4:0. Më pas, ushqimi i darkës, bisedë pranë zjarrit dhe gjumë.

## 23 korrik 1984

Sot përsëri në Mark e Zagorë (*në majat binjake*). Kjo rrugë e gjatë për t’u afruar tek itinerarët e kacavarjes na është mërziur. Është e katërta ditë që po e bëjmë. Na ngushëllon fakti se në të tilla kushte punojnë alpinistët e kategorive të larta. Sot ishim të ndarë kështu:

Beni e Foti në I-4 e pestë Zagorë, Mazi, Xhimi, Sokoli në I-4 e pestë Zagorë; Bujari, Sokoli I-12 e katërt Zagorë; Ardi, Turi,

Leko I-8 e katërt Zagorë; Leko, Turi I-2 e katërt në Shteg; Beni, Mazi në I-11 në AShteg.

I mbaruam ngjitjet me sukses. I mblodhëm të gjitha materialet (*si rregull materiali teknik libej pranë vendit të ngjitjeve për të mos e mbartur atë lart e poshtë kur distanca nga kampi ishte e konsiderueshme*) se kishim kaq ditë që punonim në Mark e Zagorë dhe zbritëm të gëzuar poshtë ngaqë do ishte dita e fundit që ngjisnim e zbrisnim atë rrugë. Mbas drekës të gjithë fjetëm nga një orë. Mbasdite bëra pesë ndeshje (*shahu*) me profesor Kozmain. Më mori tre dhe i mora dy lojë.

Sot ndeshjen e futbollit e patëm me Fierin. Na mundën. Nuk e gjenim shkakun e mundjes! Nejse, futbollit i ka këto. Shkuam pranë zjarrit ku dhe hëngrëm darkën. Nesër e kemi pushim.

## Më 24 korrik

Megjithse e kemi pushim, nuk na rrihet: sikur “kemi krimbat”. U ngritëm më 07:30 dhe sikundër e kishim bërë ndërmend, profesor Aci, Beni, Xhimi, Ardi, Koli u nisëm në itinerarin qafa midis Markut e Zagorës, Radohinë, Qafë - Pejë, Qershitë (*Kroi Shtrazës*), Theth ku do të shkojmë edhe ne, e prej aty në Shteg. Mazi kishte këmbën sëmurë nga ndeshja me Fierin, kurse Turi e Kokoshi e unë sikur s’na i kishte qejfi, andaj zbritën drejt e në Theth. Leko kishte mëndje edhe më të fortë dhe qëndroi me Dashin në kamp.

Sikundër na thanë shokët rrugën e bënë shpejt, por u lodhën ca. Kur vajtën në Arap bënë edhe ca fotografi që do i duheshin Kolit, sepse vitin tjetër kishte synim të bënte (*ngjiste*) Arapin. Nejse, me një fjalë kaluan mirë.

Ne të tjerët nga ora 09:30 u nisëm nga kampi e brenda një ore ishim në Theth. Si përherë, shkuam tek dyqanet e fshatit për të marrë ndonjë shishe me ilaç mizash. Prej këtu vajtëm në mencën

e fshatit, ku bëmë fjalë me përgjegjësin që të na jepte bukë për të ngrënë e, më pas, u nisëm për në kampin e Thethit. Në orën 14.00 arritën shokët e tjerë dhe së bashku, me një makinë u ngjitëm në Qafë - Thore, e prej aty në kampin tonë.

## Më 25 korrik

Sot detyra na ishte caktuar për itinerarët e Majës së Shtegut. Ngjitjet ishin këto: Foti, Mazi I-7 e katërt, Ardi, Beni I-9 e katërt, Turi, Xhimi e katërt, Leko, Bujari I-10 e pestë, Bujari, Turi I-2 e tretë në Kala.

Ngjitjet kaluan me sukses. Shpejtësia me të cilën punoi Leko na la të habitur. Ai do të ishte sepse martohej motra e tij. Pasi bëri ngjitjen, shpejt mori disa porosi nga ne dhe u nis për Bogë. Sikundër morëm vesh më vonë ai kishte mbërritur në mesnatë në Shkodër dhe me trenin e parë kish mbërritur në Tiranë.



Fillesa e kacavarjes në itinerarin I-1 tek Shtegu i Dhenve

Si zakonisht pas drekës ia këputëm gjumit. U ngritëm të freskët dhe filluam të bëjmë punët tona. Sot nuk ka ndeshje futbolli. Luajta përsëri shah me profesor Kozmain dhe më munda 2 me 3. Për këto dy lojë që fitova profesori (*me humor*) më tha se do më falte dy të gjashta, por ishte premtim në erë. Të gjashtat duhet t'i fitosh me djersë.



## Më 26 korrik

Për sot na u caktuan detyra më të vështira. Beni, Foti I-8 e gjashtë; Mazi e Ardi e katërt në Mark; Xhimi, Turi I-10 e pestë në Shteg; Bujari, Engjëlli (*nuk është nga ekipi i Tiranës*) I-6 e katërt në Shteg.

Për mua dhe Benin ishte e para herë që do të bënim një ngjitje shkëmbore të shkallës së gjashtë të vështirësisë. Emocionet e mija në çadër ishin të mjaftueshme që të më hiqnin  $\frac{1}{4}$  e gjumit të natës. Sot në shkëmb isha i qetë fare. E dija se Beni punon i qetë dhe isha i sigurt tek puna e tij. Ngjitja u realizua shpejt dhe mirë. Kur shkuam tek çadra na treguan se edhe Ardi me Mazin punuan mirë. Kjo gjë na gëzoi. Ne quhemi e ardhmja e alpinizmit, këtij sporti kaq të bukur, elegant e burrëror. Sot edhe Xhimi do të shkonte në Tiranë sepse kishte punë dhe kur zbritëm nga ngjitja ai na kishte lënë shëndenë dhe nuk e takuam.

Hëngrëm darkë si ushtarët; hëngrëm fasule sa u shqepëm. Fasulja të mbush barkun e të ndihmon të flesh mirë në vapë.

Mbasdite ftuam tepelenasit të bënim një ndeshje futbollit. Kishim hak për të marrë. I mundëm thellë: 6 me 3. Të gëzuar sikundër ishim shkuam në çadra ku për lamë pilafin që na kishte përgatitur profesori, dhe gjumë.

## 27 korrik 1984

Nata ishte e keqe. Për rreth tre orë shiu nuk kishte të pushuar. Për çudi koha në mëngjes u hap, por bën ca ftohtë.

Profesori aty nga ora nëntë na caktoi detyrë. Të themi të drejtën qejfi nuk na i kishte. Ishte dita e fundit e aktivitetit. Ne kishim shpresë të bënim ndonjë të gjashtë, por komandanti nuk na la: “Ditën e fundit nuk ka të gjashta”. U mërzitëm pa masë. Preferonim më shumë të rrinim pushim se sa të bënim ndonjë ngjitje të shkallës së katërt ose të pestë të vështirësisë. Këtë ia

thamë profesorit dhe ai duke nguruar na lejoi. Turi, Bujari e Koli u nisën për ngjitje, kurse unë, Beni, Mazi e Ardi qëndruam në kamp. Luajta shah me Kozmain, kurse shokët rrinin dhe shihnin.

Duke parë se koha nuk na premtonte gjë të mirë vendosëm që mbasdite të merrnim çadrat dhe çantat dhe të zbresim në Bogë. Grupi bëri këtë ngjitje: Bujari, Turi, Koli I-1 në shteg e katërt e vështirësisë. Ngjitja shkoi mirë dhe kjo ishte ngjitja e fundit që bëri ekipi ynë (*kategoritë e ulta*) në aktivitetin veror.

Na kishin mbetur ca ushqime, por më kryesorja ishin pesë kile makarona. U menduam se çfarë t'i bënim? Profesori vendosi me vetëmohim: gjysmat supë e gjysmat të thata. Vendimi u pranua dhe në drekë e mbushëm barkun me brumë. Si përherë pas veprimtarisë bëhet analiza e saj. Na foli disa fjalë profesor Kozmai, pati disa diskutime dhe duke i uruar njëri tjetrit shëndet, u ndamë.

Me çantat në shpinë u nisëm për në Bogë. Çadrat i ngritëm tek dyqanet. Çantat nuk i hapëm, (*në ato vite çantat e shpinës nuk ishin në modelet që janë sot dhe kjo bënte që, që të mos "prishej" ajo - thesi i fjetjes shpesh ishte në fundin e saj - alpinisti flinte brenda çadrës, por pa u futur në thesin e fjetjes*) kështu që e kaluam natën pa thasë fjetje, ashtu sikundër ishim të veshur, por natën na kërcitën dhëmbët nga të ftohtit.

Në mëngjes, si u rregulluam, bëmë edhe ne mbledhjen si ekip. Pastaj, si zakonisht, në dyqanet e Bogës blemë disa gjëra për Tiranë (për shtëpitë *tona*): sapunë 15 - lekësh, çorape, etj.

Ora 11 arriti autobusi. Me vrap hipëm sipër e vumë një mbi një çantat e mëdha dhe zumë vend edhe për vete. Donim të flinim, por Ardi si gjithnjë gjatë gjithë rrugës na mbajti me këngë. Autobusi na la tek stacioni i trenit, ku hipëm dhe pritëm nisjen e tij për në Tiranë. Ja pra dhe aktiviteti veror mbaroi.

*Mbajtës i ditarit, Foti Taçi*

Më poshtë vijon tabela përmbledhëse e ngjitjeve në këtë veprimtari. Kjo tabelë është pjesë e ditarit.

Shkupa

Zapora

Marku

$\bar{I}_1 - ④$

$\bar{I}_1 - 2 (5)$

$\bar{I}_1 - 3$

$\bar{I}_2 - ④$

$\bar{I}_2 - 3$

$\bar{I}_2 - 4$

$\bar{I}_3 - ④$

$\bar{I}_3 - 3$

$\bar{I}_3 - 6$

$\bar{I}_4 - ④$

$\bar{I}_4 - ⑤$

$\bar{I}_4 - 6$

$\bar{I}_5 - 2$

$\bar{I}_5$

$\bar{I}_5 - 2$

$\bar{I}_6 - ④$

$\bar{I}_6$

$\bar{I}_6 - 3$

$\bar{I}_7 - ④$

$\bar{I}_7 - 2$

$\bar{I}_8 - 6^+$

$\bar{I}_8 - 4$

$\bar{I}_9 - 4$

$\bar{I}_9 - 5$

$\bar{I}_{10} - ⑤$

$\bar{I}_{10} - ④$

$\bar{I}_{11} - 3$

$\bar{I}_{11} - 4$

$\bar{I}_{12} - 4$

for për të  
kopjuar në  
ditar

|                           | MARKU          |                |             |             |             |             |                |                |                |                |                |                | ZAPORA         |             |             |             |             |             |             |             |                |                |                |                | SHKUPA         |             |             |             |             |             |             |             |             |                |                |                | Koha           |  |
|---------------------------|----------------|----------------|-------------|-------------|-------------|-------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|----------------|----------------|----------------|----------------|--|
|                           | $\bar{I}_1$    | $\bar{I}_2$    | $\bar{I}_3$ | $\bar{I}_4$ | $\bar{I}_5$ | $\bar{I}_6$ | $\bar{I}_7$    | $\bar{I}_8$    | $\bar{I}_9$    | $\bar{I}_{10}$ | $\bar{I}_{11}$ | $\bar{I}_{12}$ | $\bar{I}_1$    | $\bar{I}_2$ | $\bar{I}_3$ | $\bar{I}_4$ | $\bar{I}_5$ | $\bar{I}_6$ | $\bar{I}_7$ | $\bar{I}_8$ | $\bar{I}_9$    | $\bar{I}_{10}$ | $\bar{I}_{11}$ | $\bar{I}_{12}$ | $\bar{I}_1$    | $\bar{I}_2$ | $\bar{I}_3$ | $\bar{I}_4$ | $\bar{I}_5$ | $\bar{I}_6$ | $\bar{I}_7$ | $\bar{I}_8$ | $\bar{I}_9$ | $\bar{I}_{10}$ | $\bar{I}_{11}$ | $\bar{I}_{12}$ |                |  |
| X <sup>o</sup> . Beqija 9 | 4              |                |             |             |             |             | 3 <sup>+</sup> | 4 <sup>+</sup> | 4 <sup>+</sup> | 5              | 5              |                |                |             |             |             |             |             |             |             |                | 4              |                |                |                |             |             |             |             |             |             |             |             |                | 5 <sup>+</sup> | 2              |                |  |
| M. Fehri 9                | 4              |                |             |             |             |             | 3 <sup>+</sup> | 4              |                | 5              | 5 <sup>+</sup> | 4              | 6 <sup>+</sup> |             |             |             |             |             |             |             | 3              |                |                | 4              |                |             |             |             |             |             |             |             |             |                |                |                |                |  |
| A. Qato 10                | 4 <sup>+</sup> | 6 <sup>+</sup> |             |             |             |             | 3              | 4              |                | 5 <sup>+</sup> | 5 <sup>+</sup> | 4              |                |             |             |             |             |             |             |             | 3 <sup>+</sup> |                |                | 4              |                |             |             |             |             |             |             |             |             |                |                |                | 2 <sup>+</sup> |  |
| A. Sheshi 11              | 3              | 4              |             |             |             |             |                | 4 <sup>+</sup> | 4              |                | 5              | 4              |                | 4           | 4           |             |             |             |             |             |                | 4 <sup>+</sup> |                |                | 5              |             |             |             |             |             |             |             |             |                |                |                | 3              |  |
| A. Kurbi 9                | 3              | 4              |             |             |             |             |                | 4              |                | 5 <sup>+</sup> | 5 <sup>+</sup> | 4 <sup>+</sup> | 6              |             |             |             |             |             |             |             |                |                | 4 <sup>+</sup> |                | 2 <sup>+</sup> |             |             |             |             |             |             |             |             |                |                |                |                |  |
| F. Raçi 9                 | 3 <sup>+</sup> | 4 <sup>+</sup> | 6           |             |             |             | 3              | 4 <sup>+</sup> | 4              | 5              | 5              |                |                |             |             |             |             |             |             |             |                | 4 <sup>+</sup> |                |                |                |             |             |             |             |             |             |             |             |                |                |                |                |  |
| A. Tapani 8               | 3 <sup>+</sup> | 4 <sup>+</sup> |             |             |             |             |                | 4              | 4 <sup>+</sup> | 5              | 4              |                |                |             |             |             |             |             |             |             |                | 4 <sup>+</sup> |                | 5 <sup>+</sup> |                |             |             |             |             |             |             |             |             |                |                |                |                |  |
| B. Kokoshu 10             | 3              |                |             |             |             |             | 3              | 4 <sup>+</sup> | 4              | 5              |                | 4 <sup>+</sup> | 4 <sup>+</sup> |             |             |             |             |             |             |             |                | 4 <sup>+</sup> |                | 5              |                |             |             |             |             |             |             |             |             |                |                | 3 <sup>+</sup> |                |  |
| S. Doko 3                 |                |                |             |             |             |             |                | 4              |                |                |                |                |                |             |             |             |             |             |             |             |                |                |                |                |                |             |             |             |             |             |             |             |             |                |                |                |                |  |
| A. Bogzhi 1               |                |                |             |             |             |             |                | 2              |                |                |                |                |                |             |             |             |             |             |             |             |                |                |                |                |                |             |             |             |             |             |             |             |             |                |                |                |                |  |
| D. Fajzo -                |                |                |             |             |             |             |                |                |                |                |                |                |                |             |             |             |             |             |             |             |                |                |                |                |                |             |             |             |             |             |             |             |             |                |                |                |                |  |

65  
29

## Korrik 1984 Klllogje

Pjesëmarrës:

1. Aleksandër Bojaxhi
2. Dashamir Fejzo,
3. Ilir Tapia,
4. Sokol Doko.

*Shënimi i një ndodhie në zonë:* në një nga ngjitet në Livadhet e Bogëve ishte dyshja Shili me U. Udhëheq Shili dhe e ndjek U. Por U është trembur. Kur Shili arrin në një pjesë të vështirë, ku kishte një plasë që nuk e nxinte, kërkon që U të dalë përpara (të udhëheqë). Ky, si i trembur, hedh/lëshon çekiçin dhe njofton: “më ra çekiçi”. Me kaq u kthyen të dy poshtë.

Mbasdite vonë Haziri përgatit e fut në një çantë shpine të vogël materialet për ngjitjen e nesërme. Në mbrëmje, kur do flinin, Hajdari që ishte në të njëjtën tendë me të, merr nga çanta litarin dhe e vë për nkrejs/jastëk. Në mëngjes nisen për ngjitje dhe Haziri merr çantën pa ditur që aty nuk është më litari. Arrijnë në rrëzë të shkëmbit, e studiojnë, por kur marrin për t'u lidhur, shohin që s'kanë litar dhe kthehen.

Një dyshe e grupit tonë ngjitej në Arap, itinerari VL. Në litarin e dytë të ngjitjes vjen një treshe e Partizanit (Hasani, Pëllumbi, Andrea) dhe Gëzim Oruçi, po për këtë ngjitje. Grupi ngjites arriti guvën dhe u ul. Pas kësaj të gjithë u kthyen.

Vërehen këto mangësi themelore në ekipe:

- Itinerarët thuajse nuk studiohen fare paraprakisht dhe as nuk merret informacion nga ata që e kanë kryer apo kanë njohuri për të.
- Nuk kanë objektiva apo synime për ngjitjet që do të kryejnë në zonën ku vijnë. Nuk kanë plan ngjitjesh, një radhë ngjitjesh, një kohë të paramenduar për studim apo vrojtim të një itinerari të ri, etj.

- Nuk kanë kryer stërvitje të veçanta për ngjitjet e veçanta që duan të realizojnë.

## Aktiviteti veror i Kategorive të Para dhe Mjeshtra në stanet e Kllogjes.

### 4 – 12 korrik 1984

Pjesëmarrësit:

1. Aleksandër Bojaxhi
2. Dashamir Fejziu
3. Ilir Tapia
4. Sokol Doko

#### 1 korrik 1984

Udhëtojmë me tren nga Tirana për në Shkodër. Arritëm në ora 23:00 e zumë vend për fjetje tek Konvikti i Shkollës Pedagogjike (*në ato kohë gjithnjë ka qenë problem sigurimi i vendeve të fjetjes në hotel; Shkodra, ndoshta, ishte më keq se çdo qytet tjetër*). Pothuajse nuk fjetëm për tre arsye: së pari konvikti ishte lyer me ilaç (*dezinfektuar*), e dyta vapa dhe e treta një dasmë që bëhej prapa konviktit.

#### 2 korrik 1984

Si zakonisht problem kryesor në rrethin e Shkodrës është transporti (*si kudo në Shqipërinë e atyre viteve*), i cili kësaj radhe u krye disi mirë. Në orën 10:00 nisemi; materialet në një makinë dhe alpinistët me autobus deri në Fushë të Okolit, e pastaj në këmbë deri në qendër të Thethit. Ne ngritëm çadrat tek pishat afër baxhos dhe fjetëm mirë.

### 3 korrik 1984

Zgjimi pa orar; fjetëm mirë, por mesi na dhëmb pasi është dita e parë që fjetëm pa shtroje shtëpie. Shokët drejtues mbetën në telefon në kërkim të mushkave deri sa u dhanë fjalën për të nesër në mëngjes. Gjithë ditën e kaluam pa bërë gjë; në darkë ndezëm zjarr rreth të cilit hëngrëm darkë dhe më 22:00 ramë të flemë.

### 4 korrik 1984

Mushkat erdhën në orën 09:00 dhe në 10:00 nisemi për në Klllogje nga ana e Qafës së Pejës. Gjatë gjithë rrugës frynte erë e fortë dhe e ftohtë. Udhëtimi me mushkat e ngarkuara me materialet tona kaloi normalisht. Në ora 14:30 arritëm në vendin ku mushkat nuk mund të ecin më tej (*mbas verës së vitit 1966 – në vjeshtë të atij viti, P.P.Sh. deklaroi që kolektivizimi i bujqësisë përfundoi edhe në zonat malore – shtigjet për kafshët e barrës erdhën duke humbur nga mospërdorimi. Arsyeja: ra numri i bagëtive që dilnin në bjeshkë, etj. Në vitet '60 me kafshë barre shkohej nga Thethi në Nikç. Kafshari më me përvojë në Theth gjatë viteve '60, '70 ka qenë Kol Preka nga lagja Okol. Më pas ai aktivizoi edhe djalin e tij*). Ky vend është në fund të lugut të majës së Arapit, lugut që të çon tek posta kufitare verore. Prej këtu e deri në Klllogje duhet të mbartim materialet të cilat i kemi me shumicë. Sigurisht që pesha është e madhe. Nisemi në të parët, pastaj tre pukianët dhe në fund tropojasit.

Është një malore që me këtë ngarkesë që kemi të nxjerr llapën. Ne e “hamë” gradualisht e me pushime të shpeshta. Në 16:30 arritëm në vendin ku ngritëm kampin. Aci përgatiti supën kurse Iliri sallatën. Ushqimin e hëngrëm pa qetësi e me ngut për arsye të ftohtit të egër që na shoqëroi deri të nesërmen rreth orës 11:00.

Nata qe shumë e ftohtë, andaj dhe zgjimi u bë pa komandë. Nga ora 10:00 vendosëm të bëjmë ngjitje në malin e Prozhmit.

Në majë do të shkonim të gjithë pa përjashtim. U nisëm në 10:30 . Itinerari është i “butë”, po të dish nga ta marrësh, dhe në orën 12:30 arritëm në majë nga e cila sheh të gjithë alpet dhe grykat që lidhin Thethin me Malësinë e Madhe dhe Bogën me Malësinë e Madhe. Aci na tregoi të gjitha majat sipas emërtimeve që kanë. Filluam uljen më 13:00 dhe arritëm në kamp më 14:20.

Aci, siç duket, do jetë kuzhinieri ynë kurse ne të tjerët, ndihmësit dhe pjatatarësit e tij. Morali: si ekip është shumë i mirë, po kështu edhe si kamping. Radio Iliria që ka Dashi është një mjet i mirë shplohje. Në grupin e Kllogjes bëjnë pjesë edhe ekipet e Pukës dhe Tropojës. Duhet të kishte ardhë edhe ekipi i Kastriotit (Krujës), por siç duket ata kanë vajtur në Valbonë ngaqë kanë qenë vjet këtu. Shtabi i ngjitjeve është ky:

Aleksandër Bojaxhi (17 Nëntori) - komandant

Nuredin Seci (Tropoja) - komisar.

Dreka dhe darka kaluan mirë. Vetëm me një të metë, uji i pijshëm. i cili vjen vetëm mbas orës 16:00. Kështu ia do qejfi “kuçedrës”, e cila është brenda në shkëmb! *(Kllogja është keq me ujë. Stanet aty e përpunojnë qumështin në baxhon që është poshtë Qafë Dobraçës. Uji që vjen mbasdite sigurohet, besoj, nga shkrirja gjatë ditës e borës së ngrirë që është nëpër gropa dhe arrin të dalë në “burim” mbasdite)*

## 6 korrik 1984

Edhe sot zgjimi u bë pa komandë ngaqë nuk kemi mot të mirë. Si Radio Tirana edhe Radio Prishtina japin parashikim për mot të paqëndrueshëm. U vendos që sot të punojmë në shkëmb me bazë grupesh të ndarë me dy ose tre vetë në një litar. Grupi im, Iliri, Koli e Dashi vajtëm në Rrushkull. Koli udhëhiqte. Pa u ngjitur një litar Koli i këputet/thyhet çekiçi dhe i bie poshtë, kështu që e lamë këtë ngjitje për herë tjetër dhe u kthyem në

kamp. Aty gjetëm ekipet e tjera që e kishin realizuar ngjitjen në majën e Shtogut. Hëngrëm drekën dhe u nisëm për ngjitje në Shtog. U ngjitëm dhe u kthyem më 15:40. Të gjithë punuam mirë. Koli udhëhoqi. Kemi gjithë ditën pa pirë ujë dhe ora po shkon 16:00. Të shohim sa do të vazhdojë kjo punë. Bora është e ndotur dhe me krimba. Duket se në darkë do të hamë ushqim të thatë. Dhe me kujdes se mos mbytemi ngaqë nuk kemi ujë!

Nata mbrëmë ka qenë e ftohtë. Të gjithë kemi mërðhirë.

## 7 korrik 1984

Koha mbrëmë ka qenë shumë e keqe, me shi dhe borë në lartësitë e maleve. Në çadër është shumë ftohtë aq sa edhe ujët që është në pagure ngrin. U bënë gjashtë ditë që koha është e ftohtë dhe e paqëndrueshme.

Sot zgjimi u bë në orën 08:00 dhe nisja për në shkëmb (*për kacavarje shkëmbore*) më 09:20. Dashi, Iliri e Koli do të punojnë në Shtog në një të pestë. Ngjitja u krye me sukses dhe pas zbritjes nga maja shkuam në malin e Rrushkullit për të marrë materialet që kishim lënë aty një ditë më parë. Mbasdite filloi një shi me borë dhe erë që herë-herë është e fortë. Për këtë arsye detyrohemi të futemi herët në çadra dhe të rrimë aty deri në të gdhirë. Gjumin e bëjmë jo të rregullt për arsye të të ftohtit.

Aci shpallet përfundimisht kuzhinieri i grupit. Radio po na mban gjallë. Gëzohemi që kemi bateri. Radio na thotë që edhe nesër do kemi kohë të keqe. Këtë na e tregon edhe fakti që rreth nesh është vranësi e madhe.

## 8 korrik 1984

Zgjim me orar të caktuar; me sa duket, nuk do kemi më, për arsye të motit të keq. Duket se kështu do jetë deri në fund të veprimtarisë. Përsëri ishte ftohtë gjatë natës. Ujin si përditë e



kemi me orar sepse ai ngrin nga temperatura e ulët. U bënë pesë ditë pa larë sytë. Gëzohem që në këto kushte për ujin që kemi nuk e zë barku askënd! Në kampin tonë erdhi pardje telekronisti tropojan Ilir Buçpapa dhe shkrimtari Skënder Buçpapa. Njëri për të filmuar dhe tjetri për të shkruar ndoshta një roman për alpinistët. Ilir telekronisti filmoi sot të gjitha ekipet me radhë. Ne si ekip dolëm të gjithë. Sot nuk bëmë ngjitje.

Doktor Haziri ka me vete një pushkë gjermane dhe sot doli për gjah për dhi të egra por nuk vrau gjë, ndonëse shtiu shtatë fishekë. Nuk ishte fati ynë që të hanim mish dhie të egër. Moti është me erë të ftohtë dhe ne nuk dalim nga çadrat ku Aci me ca libra ruisht për fëmijë na lexon përralla të shkurtra. Ai edhe na tregon përralla, edhe praktikon gjuhën ruse.

Dreka është supë, vezë të skuqura, sultiash dhe bukë që është aq e fortë sa edhe thika mezi futet e jo më që ta presë. Të shohim si do të dalë koha nesër se deri tani nuk është bërë asnjë ngjitje e bukur. Sot të gjithëve na rruajti telekronisti (*telekronistët të detyronin të rruheshe ngaqë të mbaje mjekër ishte "shfaqje e huaj". Kështu e quante P.P.Sh-jë*). Dashi la mustaqe dhe kështu në kamp u bënë dy me mustaqe: Dashi dhe Rustemi i Tropojës, që i ka të mëdha, ashtu si të Kiçkës (Kristaq Korçarit) tonë.

## 9 korrik 1984

Sot dita ka dalë shumë e bukur, gjë që na gëzoi të gjithëve pa përjashtim. Sot ekipi ynë do të punojë në dy itinerarë: Iliri me Kolin do të bëjnë ngjitje në malin e Shnikut, kurse Dashi me Acin në Rrushkull. Nisemi në orën 08:00 dhe arrijmë në majën e Rrushkullit më 10:30, ku takojmë shokë nga ata të grupit që punojnë në Livadhet e Bogëve. Ndënjëm me ta rreth një orë dhe pastaj filluam zbritjen. Rrugës takojmë Gëzim Oruçin dhe



Dashamir Fejzo, Gëzim Oruçi, Aleksandër Bojaxhi

Berzat Manen të cilët nga Livadhet e Bogëve ishin nisur për të takuar grupin tonë në Klllogje.

Biseduam dhe Gëzimin dhe Berzatin, i cili na bëri disa poza me aparatën e tij, veç e veç dhe si grup. Ndahemi me ta dhe kthehemi në kamp në orën 13:00 ku filloi përgatitja e drekës, të cilën si rregull e bën Aci. Presim Ilirin dhe Kolin që t'i pyesim si vajti ngjitja. Në zjarr kemi vënë groshët e fundit që kemi. Kemi mbledhur kërminj por do i gatuajmë nesër. Kërmijtë nuk i preferojnë as pukjanët e as tropojanët, të cilët e kanë të vështirë edhe t'i prekin. Kur Dashi u bëri një ditë një pyetje teksa po piqte gjashtë copë në prush, “a do ndonjëri ndonjë copë?”, Rustemi me mustakë tha: “Unë i ha po qe se e lyp nevoja e Atdheut”!

Iliri me Kolin e kryen ngjitjen me sukses dhe u kthyen shumë mirë. Rrugës kanë parë dhi të egra. Darka kaloi shumë mirë.

## 10 korrik 1984

Sot kemi festën e 10 Korrikut që është Dita e Ushtrisë tonë Popullore dhe pikërisht sot ekipi ynë bëri një ngjitje të bukur

në Arap nga faqja veri - perëndimore (*është një nga dy ngjitjet e shkallës VI, që pati bërë ekipi i Gjermanisë Lindore në vitin 1959*). Është i shkallës së gjashtë. Udhëhoqi Koli; Iliri i dyti. Dashi me Acin i udhëzuan. Ngjitja filloi në orën 09:45 dhe përfundoi në orën 13:20. Të dy punuan mirë dhe shpejt. Sot Acin i dha fjalën Ilirit dhe Kolit që, bluzën e ekipit të Tiranës që kanë, do t'ua japë për fare. Koli tha “ta marrë Iliri” (*në këto vite klubi ynë ishte shumë ngushtë financiarisht. Pra edhe në bluza dhe gjithëçka që ishin simbole të klubit. Më kujtohet që dikur një bluzelfanellë e klubit tonë, që ishte e rrënuar, i premë mëngët dhe e përdorëm si flamur të Klubit. Di që kam një foto ku kam dalë me Kristaq Korçarin dhe këtë “flamur”*).

Dreka është e bollshme: sallatë me nga dy lugë vaj ulliri, nga dy racione fasule dhe një lugë vaj ulliri. Tani është ora 16:00 dhe po përgatiten kërmijtë për darkë. Të shohim nëse pukjanët dhe tropojanët do i provojnë.

Gjatë ditëve që ishte ftohtë nuk kishim asnjë mizë. Tani që koha u ngroh ato kanë dalë në skenë dhe ne na ndihmon një spërkatës që e kemi marrë me vete. Kërmij hëngrën vetëm Isufi dhe Haziri, të dy të Tropojës. (*pasi hodha këto rreshta në kompjuter, për konfirmim, i nisa një e mail Nuredin Secit në USA. Përgjigja e tij ishte: “Përsëndetje Acin! A jeni mirë? Të saktë jeni! Isufi i ka “hanger” dhe shokët e ekipit e tallnin pas dy ditësh sepse Isufit*



Kohë dreke në ditë pushimi gjatë një veprimtarie verore

*iu thye një dham nga dhamtë e parë dhe i thoshin shokët "Ë'u ka thye se ke hangër kërmillin". Përqafime nga USA!)*

## **11 korrik 1984**

Zgjimi në ora 07:00. Nisja për në shkëmb ora 08:00. Iliri me Kolin bënë dy ngjitje: një të VI në Malsore dhe I-3-shin V në Kolaj. Dashi shoqëroi dy tropojas për ngjitjen e shkallës së VI-të në majën e Arapit, itinerari veri-perëndimor. Aci shoqëroi Hazirin dhe Hajdarin, po në Arap, për itinerarin e shkallës VI (VL) të "kontrolluar" për mjeshtër sporti. *(Klasifikimi Unik për alpinistët përmbante edhe ngjitje të përcaktuara kur ishte fjala për të fituar titullin "Mjeshtër Sporti")*. Këta vajtën deri tek guva/shpella dhe zbritën që ta vazhdojnë nesër. Lanë atje dy litarë dhe zbritën.

Në drekë patëm miq alpinista: Hasani, Pëllumbi, Nokja të Partizanit dhe Gëzim Oruçin e Vllaznisë.

Sot mbasdite Iliri dhe Sokoli u nisën për Nikç, tek dy pleqtë, Deda dhe Gjystina *(këta ishin dy pleq që jetonin të veçuar disi nga fshati, në rrugën për në Qafë - Dobraçe. Pleqtë kishin rënë "në dashuri me ta")* dhe do të kthehen nesër në mëngjes.

Tani unë e Aci kemi nga një çadër në dispozicion. Për darkë kemi porositur verë që presim të vijë nga Thethi. Po erdhi do të kënaqemi dhe do flemë duke parë ëndrra të bukura!

Grupi i alpinistëve që bëjnë ngjitje në zonën e Qafë - Pejës *(kjo nënkupton grupin me kampim mbi She-un e Bardhë)* sot zbriti në Theth sepse nuk kanë bukë. Ne mendojmë të zbresim nesër mbasdite.

## **12 korrik 1984 – (Ndërhyrje nga Aleksandri)**

Për zonën e Klllogjes, për ngjitjet, vlen të theksohet sa më poshtë:

Mali i Vishensit: ngjitja në diedrin verior. Shkalla e V-të e vështirësisë. Zbritja nga lugu perëndimor. Ka edhe ngjitje/itinerarë të tjera, por pa joshje të veçantë.

Mali Radohinës muri verior majtas (*ana lindore*) dhe në qendër. Nga alpinistët tanë aty nuk janë kryer ngjitje (*deri në vitin 1992*). Të dhënat flasin se janë ngjitur alpinistët gjermano-lindorë, që i kanë vlerësuar të pesta, më duket se të dyja B. Gjithashtu e kanë quajtur “muri i frikshëm”.

Rrushkulli (Riskulli, Breshkulli). Nga ana jonë (Kllogje) duket pa vlere ose me faqe shkëmbore ku nuk punon (*mirë*) gozhda (*plenga*). Vlen të bëhen ngjitje në faqen VL; në pjesën ku fillon rruga (qafa) për në Livadhet e Bogëve. Faqja alternohet me bar e shkëmb e merret (ngjitet) me zig-zage. Vlen të synohet fillimisht gjithnjë kalimi (ngjitja) në pjesët më të lehta. Merr vështirësi deri në shkallën e katërt. Rrushkulli ngjitet edhe aty ku faqja lindore kthen për të dalë në qafë sipas një lakimi në drejtim JP. Ka një brez të gjërë e të ulët shkëmbor ku gati në mesin e tij ka një shteg që të nxjerr/çon në majë, kurse në të djathtë një faqe shkëmbore me plasa vertikale e diagonale të lejon/mundëson për një ngjitje deri të shkallës së V-të për në majë.

Rrushkulli nuk ka faqe (shkëmbore) tërheqëse për ngjitje (kacavarje), porse në ato të përshkruarat vlen të zgjidhet një për ngjitje, që ngjitja për në këtë majë të bëhet sipas një itinerari të moderuar. Ky mal ka disa maja. Është si një masiv malor në miniaturë. (*ndoshta emërtesa Breshk[ë] – ulli e përshkruan formën e malit. Emërtesa Rrushkull mund të jetë e emrit të bimës që dominon atje*). Vajtja në majën kryesore këtu bëhet duke arritur në majën e dytë për nga lartësia dhe pastaj vazhdohet me zbritjen dhe ngjitjen në një qafë tepër të ngushtë. Zbritja bëhet duke ecur kreshtës drejt jugut e pastaj rrotullim majtas rrëzë një faqeje shkëmbore të larë. Kthimi më i shpejtë nga Rrushkulli (edhe nga Qafa e Radohinës) për në Kllogje bëhet duke ecur gjithnjë gati në rrëzë të mureve të majës së këtij mali deri sa të arrihet

në grykën, që të nxjerr në Livadhet e Bogëve. Pas kësaj ulemi menjëherë poshtë.

Maja e Shtogut. Itinerarin (*shkëmbor*) më me vlerë e ka në faqen lindore. Pasi ngjitesh deri në lartësi të shpatit me bar ku faqja thyhet djathtas arrihet në një kaminë (*tymtajë*) që përfundon në një tarracë të gjelbëruar. Prej këtu merret faqja e gjërë shkëmbore në diagonal, djathtas, deri sa arrihet tek një shkëmb i dukshëm. Prej këtu i rrotullohesh malit për të dalë në majë. Zbritja kryhet nëpër faqen jugore. Majtas këtij itinerari ka edhe dy itinerarë të shkallës III-A të vështirësisë të cilët të nxjerrin në majë duke lënë djathtas kaminën (*tymtajën*) dhe faqen e gjërë shkëmbore.

Shniku merret (*ngjitet*) me itinerarë të lehtë majtas e djathtas brezit shkëmbor 2-3 katësh të faqes/anës jugore. Këra itinerarë janë të mirë edhe për zbritjen nga maja. Që ngjitja të moderohet (*vështirësohet*) vlen të merret një itinerar në anë të majtë të brezit të parë shkëmbor ku kacavarja zgjatet deri në dy litarë dhe me vështirësi deri në shkallën e pestë. Mali i Shnikut në përfundim ka majën e Shnikut dhe në lindje Majën e Madhe.

Prozhmi ka rrugë/itinerarë ngjitje duke fituar lartësi dhe duke lënë Majën e Kalit në të djathtë. Pastaj kalohet/futesh në lug e më pas në traversën/kreshtën e Prozhmit. E gjithë kjo linjë është në anën J-P të majës. Vështirësia e shkallës së dytë.

Arap. Nga këtu sulmohen/merren itinerari i shpellës – shkalla IV e vështirësisë, faqja V-P, shkalla e pestë e vështirësisë dhe ana V-L e shkallës VI të vështirësisë. Këto janë ngjitje mjaft të bukura.

Në Klllogjen në këtë periudhë të vitit dielli lind pas orës 06:30 dhe perëndon rreth orës 17:00. Ujë ka kur ka borë gropave dhe kur bora shkrin (jo në mëngjes e jo në darkë). **Aleksandri**

## 12 korrik 1984

Mbrëmë Iliri me Sokolin ishin tek dy pleqtë në Nikç. Ia kishin kaluar shumë mirë. Erdhën në kamp në ora 09:00 dhe më 09:15 u nisën për ngjitje dhe realizuan një të V-të në Rrushkull. Udhëhoqi Iliri, Dashi i dyti dhe Koli i treti (në litar). Edhe ekipet e tjera sot kryen ngjitje të bukura. Në orën 15:00 ramë në kamp për të ngrënë drekën dhe për të bërë konkluzionet e veprimtarisë. Aci është përgatitur dhe të shohim se çfarë do hedhim në ditar gjatë diskutimeve

Të gjithë shokët pa përjashtim diskutuan mirë dhe drejtë. Shënimet për këtë analizë janë në procesin (*proces - verbal*) që dërgohet në Federatë.

Më 16:00 nisemi për në Theth dhe mbërrijmë në 19:20 ku kalojmë natën.

## 13 korrik 1984

Zgjimi sekush sikundër desh. Mëngjesi në klub. Më pas lahem i tek dushet e kampit. Mbasditja kalon në hijen e pemëve sipër kampit. Nesër do jemi në udhëtim për në Shkodër.

## 14 korrik 1984

Zgjimi ora 07:00. Dashi

Mbajtës i ditarit Dashamir Fejziu

TABELA e pa hedhur një tabelë ngjitjesh: 17 Nëntori; Puka; Tropoja

***Korrik 1984***

Informacion i mbledhur nga Aleksandër Bojaxhi

| Nr. | Emri mbiemri     | Lindur | Kategoria sportive | Arsimi     | Mosha |
|-----|------------------|--------|--------------------|------------|-------|
| 01  | Nuredin Seci Val | 1953   | Mjeshtër Sporti    | Mesëm      | 31    |
| 02  | Hazir Malaj      | 1942   | Kandidat Mjeshtër  | Lartë      | 42    |
| 03  | Kujtim Matoshi   | 1952   | I                  | Mesëm      | 32    |
| 04  | Hajdar Hasa      | 1947   | I                  | 8 - vjeçar | 37    |
| 05  | Isuf Milushi     | 1952   | I                  | 8 - vjeçar | 32    |
| 06  | Rustem Kurtmajli | 1958   | I                  | 8 - vjeçar | 26    |
| 07  | Ibish Doçi       | 1948   | II                 | Lartë      | 36    |
| 08  | Aleks Sinani     | 1957   | II                 | 8 - vjeçar | 27    |
| 09  | Vladimir Ymaj    | 1960   | III                | Mesëm      | 24    |
| 10  | Gjelosh Arusha   | 1959   | III                | 8 - vjeçar | 25    |
| 11  | Murat Seci       | 1963   | III                | Mesëm      | 21    |
| 12  | Gjovalin Perpali | 1962   | III                | Mesëm      | 22    |

Mosha mesatare si ekip me gjithë trajnerin 29,5 vjeç

Mosha mesatare si ekip pa trajnerin 29,45 vjeç

| Nr. | Emri mbiemri     | Lindur | Kat sportive | Arsimi     | Mosha |
|-----|------------------|--------|--------------|------------|-------|
| 01  | Rahit Hila Tepel | 1951   | I            | Mesëm      | 33    |
| 02  | Avid Zholi       | 1956   | I            | 8 - vjeçar | 28    |
| 03  | Sino Zholi       | 1958   | I            | 8 - vjeçar | 24    |
| 04  | Et'hëm Laçi      | 1957   | II           | 8 - vjeçar | 27    |
| 05  | Iliaz Kuca       | 1958   | III          | 8 - vjeçar | 26    |
| 06  | Rahit Mema 1960  | 1960   | III          | 8 - vjeçar | 24    |
| 07  | Shkëlqim Kocani  | 1961   | III          | 8 - vjeçar | 23    |
| 08  | Karafil Zholi    | 1962   | III          | 8 - vjeçar | 22    |
| 09  | Pëllumb Haska    | 1957   | III          | Mesëm      | 27    |
| 10  | Dervish Kura     | 1957   | III          | Mesëm      | 27    |
| 11  | Merqez Kuca      | 1961   | III          | 8 - vjeçar | 23    |
| 12  | Lulzim Guga      | 1962   | III          | 8 - vjeçar | 22    |



Mosha mesatare si ekip me gjithë trajnerin: 25,6 vjeç

Mosha mesatare si ekip pa trajnerin: 25 vjeç

| Nr. | Emri mbiemri      | Lindur | Kat sportive | Arsimi  | Mosha |
|-----|-------------------|--------|--------------|---------|-------|
| 01  | Xhemal Teta Kruja | 1944   | II           | Lartë   | 40    |
| 02  | Ilir Koni         | 1956   | I            | Mesëm   | 28    |
| 03  | Sefer Rema        | 1958   | I            | Mesme   | 24    |
| 04  | Arjan Sena        | 1962   | I            | Univers | 22    |
| 05  | Fluturim Guni     | 1959   | I            | Lartë   | 25    |
| 06  | Iljaz Shuli       | xxx    | xxxx         | xxx     | xxx   |
| 07  | Bashkim Seseri    | xxx    | xxxx         | xxx     | xxx   |
| 08  | Petrit Dollaku    | xxx    | xxxx         | xxx     | xxx   |
| 09  | Kujtim Kukeli     | xxx    | xxxx         | xxx     | xxx   |
| 10  | Luan Guni         | xxx    | xxxx         | xxx     | xxx   |
| 11  | Shpëtim Nera      | xxx    | xxxx         | xxx     | xxx   |
| 12  | Alfred Avlloi     | xxx    | xxxx         | xxx     | xxx   |

Mosha mesatare si ekip me gjithë trajnerin: 27,8 vjeç

Mosha mesatare si ekip pa trajnerin: 24,75 vjeç; jo e plotë statistika e ekipit

| Nr. | Emri mbiemri     | Lindur | Kat sportive | Arsimi     | Mosha |
|-----|------------------|--------|--------------|------------|-------|
| 01  | Koço Ziso Skënd  | 1936   | Mjesh. Sp    | 8 - vjeçar | 58    |
| 02  | Anesti Qirio     | 1952   | Kand Mj Sp   | Mesëm      | 32    |
| 03  | Mihallaq Çollaku | 1956   | I            | Mesëm      | 28    |
| 04  | Genci Lika       | 1956   | Kan Mj Sp    | Mesëm      | 28    |
| 05  | Apostol Babo     | 1951   | I            | Mesëm      | 33    |
| 06  | Petrika Janaq    | 1959   | I            | Mesëm      | 25    |
| 07  | Petrika Opingari | 1963   | II           | Rezervat   | 21    |
| 08  | Ilia Kita        | 1954   | II           | Mesëm      | 30    |
| 09  | Demirali Nure    | 1958   | II           | Mesëm      | 26    |
| 10  | Arben Deka       | 1962   | III          | Rezervat   | 22    |
| 11  | Petrika Tomço    | 1963   | III          | Rezervat   | 21    |
| 12  | Niko Çika        | 1966   | III          | Mesëm      | 18    |

Mosha mesatare si ekip me gjithë trajnerin: 27,5 vjeç

Mosha mesatare si ekip pa trajnerin: 25,8 vjeç

| Nr. | Emri mbiemri    | Lindur | Kat sportive | Arsimi     | Mosha |
|-----|-----------------|--------|--------------|------------|-------|
| 01  | Gani Avdia Puka | 1950   | I            | Mesëm      | 34    |
| 02  | Beslim Qypi     | 1947   | I            | 8 - vjeçar | 37    |
| 03  | Ramadan Demushi | 1951   | I            | 8 - vjeçar | 33    |
| 04  | Ymer Shkjau     | 1955   | I            | Mesëm      | 29    |
| 05  | Sadik Tafilaku  | 1955   | I            | Mesëm      | 29    |
| 06  | Sabah Tërbuni   | xxxx   | xxxxxx       | xxxxxx     | xxxx  |
| 07  | Përparim Laçi   | xxxx   | xxxxxx       | xxxxxx     | xxxx  |
| 08  | Resmi Toska     | xxxx   | xxxxxx       | xxxxxx     | xxxx  |
| 09  | Ludovik Preni   | xxxx   | xxxxxx       | xxxxxx     | xxxx  |
| 10  | Sadri Laçi      | xxxx   | xxxxxx       | xxxxxx     | xxxx  |
| 11  | Muharrem Alia   | xxxx   | xxxxxx       | xxxxxx     | xxxx  |
| 12  | xxxxxxxxxx      | xxxx   | xxxxxx       | xxxxxx     | xxxx  |

Mosha mesatare si ekip me gjithë trajnerin: 30,4 vjeç

Mosha mesatare si ekip pa trajnerin: 29,5 vjeç (informacion jo i plotë)

| Nr. | Emri mbiemri          | Lindur | Kat sportive | Arsimi     | Mosha |
|-----|-----------------------|--------|--------------|------------|-------|
| 01  | Vangjel Mëlëngu Berat | 1931   | Mj Merit     | 8 - vjeçar | 53    |
| 02  | Vullnet Zylyftari     | 1947   | k. Mje       | Lartë      | 36    |
| 03  | Jani Qendro           | 1950   | Mj sp        | 8 - vjeçar | 34    |
| 04  | Kastriot Hoxha        | 1953   | I            | Mesëm      | 31    |
| 05  | Vlash Koxhaku         | 1947   | I            | Lartë      | 37    |
| 06  | Koçi Maqina           | 1946   | I            | 8 - vjeçar | 38    |
| 07  | xxxxxx                | xxx    | xxx          | xxx        | xxx   |
| 08  | xxxxxx                | xxx    | xxx          | xxx        | xxx   |
| 09  | xxxxxx                | xxx    | xxx          | xxx        | xxx   |
| 10  | xxxxxx                | xxx    | xxx          | xxx        | xxx   |
| 11  | xxxxxx                | xxx    | xxx          | xxx        | xxx   |
| 12  | xxxxxx                | xxx    | xxx          | xxx        | xxx   |

Mosha mesatare si ekip me gjithë trajnerin: 38,1 vjeç

Mosha mesatare si ekip pa trajnerin: 35,2 vjeç (informacion jo i plotë)

| Nr. | Emri mbiemri         | Lindur | Kat sportive | Arsimi     | Mosha |
|-----|----------------------|--------|--------------|------------|-------|
| 01  | Aleks Bojaxhi Tirana | 1943   | Mj Sp        | Lartë      | 41    |
| 02  | Dashamir Fejzo       | 1947   | K Mj Sp      | Rezervat   | 37    |
| 03  | Romeo Manxhari       | 1954   | K Mj Sp      | Mesme      | 30    |
| 04  | Ilir Tapia           | 1962   | I            | Mesëm      | 22    |
| 05  | Sokol Doko           | 1962   | K Mj Sp      | 8 - vjeçar | 22    |
| 06  | Xhemal Begeja        | 1965   | II           | Mesëm      | 19    |
| 07  | Mazllëm Feka         | 1965   | II           | 8 - vjeçar | 19    |
| 08  | Arben Qato           | 1965   | II           | Mesëm      | 19    |
| 09  | Artur Shehu          | 1965   | III          | 8 - vjeçar | 19    |
| 10  | Ardian Kurti         | 1965   | II           | 8 - vjeçar | 19    |
| 11  | Foti Taçi            | 1966   | III          | Mesëm      | 18    |
| 12  | Aleksandër Tapia     | 1966   | III          | Rezervat   | 18    |

Mosha mesatare si ekip me gjithë trajnerin: 24 vjeç

Mosha mesatare si ekip pa trajnerin: 22,5 vjeç

### ***Nga ditari Aleksandër Bojaxhi***

.....

Ngjitja e itinerarit V-L Mali Arapit

Koha e ngjitjes për individ dhe baza materiale

|   |        | 35-40 m | 30 m   | 30 m   | 40 m   | 35 m   | Plenga                   |
|---|--------|---------|--------|--------|--------|--------|--------------------------|
| 1 | Iliri  | 25 min  | 30 min | 85 min | 80 min | 50 min | $2 + 6 + 9 + 6 + 9 = 32$ |
| 2 | Romeo  | 15 min  | 15 min | 40 min | 40 min | 20 min | Pyka 2                   |
| 3 | Sokoli | 15 min  | 25 min | 25 min | 25 min | 15 min | Shkallë 2                |

*Orë pune:* Iliri 270 min; Romeo 130 min; Sokoli 140 min; Karabina 30.

# VITI 1985

## 10 - 18 shkurt 1985

Ekipi

1. Aleksandër Bojaxhi
2. Sokol Doko
3. Ilir Tapia
4. Xhemal Begeja

## 13 shkurt

Kemi arritur në Bogë që më datë 9 shkurt me një kohë mjaft të keqe. Pa hyrë në Bogë na u prish autobusi. Deri mbrëmë kemi kaluar në shtëpitë e fshatarëve. Moti i keq ka qenë me erë të fortë e reshje të shumta.

Sot në ora 10:00 u nisëm me një kohë të keqe: mjegull dhe borë që bie hera - herës. Disa herë na çoroditi mjegulla duke na nxjerrë nga itinerari i duhur. Tashmë jemi vendosur në grykën që të nxjerr në Gropën e Radohinës (*tek Gryka e Lekës*). Jemi 2 a 300 metra nën vijën e pyllit dhe jemi sistemuar mirë. Ekipet e Vlorës, Dajtit dhe Korçës janë rreth 1 a 200 metra më poshtë. Me sa duket u ndjenë të lodhur ngaqë edhe bënë fjalë për t'u ngjitur deri këtu. Jashtë tendës është tepër ftohtë dhe koha është kthjelluar.

## 14 shkurt,

Koha është e mrekullueshme. Nata ishte tepër e ftohtë dhe gjumi i dobët. Ky fakt më shtyn që të vendos që sot të pushojmë dhe të thajmë gjithëçka që është e lagur. Nga ora 11:30 vjen Vironi me Koçon. Fillimisht biseda e tyre filloi me Vironin:

- Me siguri që dje u mërzite që ne qëndruam poshtë. Pak edhe u nxehe.

- Jo, jo! Sepse e di që kur njerëzit lodhen kanë fjalë.

- Jo, po kur të shumtit...

- E lëmë këtë bisedë. Çfarë do të bëjmë?

Biseduam dhe nga biseda mësova se ata kishin si shqetësim se mos kërkoja që ta ngrinin kampin më sipër. Kishin gjithashtu dëshirë që të ktheheshin në Bogë më datë 18 në darkë.

Faktikisht këto ishin punë të vendosura. Mbetëm me mendimin që nesër ora 08:00 të nisemi për Radohinë. Atje do të shihnim mundësinë që një grup të ngjitet në majën e Rrushkullit, në vartësi kjo nga koha/ora kur do të jemi në Qafë të Radohinës.

Pasi u larguan ne bëmë ca fotografi, gatuam dhe u thamë mirë. Ramë për të fjetur në ora 19:30, që d.m.th një orë më vonë se mbrëmë.

## 15 shkurt

Profesor Acì ka marrë me vete edhe duhan DS dhe kohë pas kohe e ndez. Edhe sot pasi u kthyem nga ngjitja e ndezi.

Ora 08:00 u nisëm. Jemi ngritur që më gjashtë për të përgatitur kakaon dhe (*për të shkrirë borë*) pak ujë. Kemi fjetur më ngrohtë. Sigurisht më ngrohtë nga të gjithë. Këto dy netë do të ketë fjetur mirë edhe Sokoli i cili peshon aq sa dhe “leekat” që ka veshur!

Kur arritëm tek Gropa e Radohinës gati u bashkuam të gjithë ekipet. Koha po prishej por kishim shpresë që majën do e

ngjisnim. Rruga u hap mirë dhe në ora 11:00 ishim të parët në Qafë të Radohinës. Në fillim të së përpjetës për në qafë kishte shkarkuar një ortek. Dukej të ishte i djeshëm. Mbi të bora kish marrë të plasur në të dy anët e ullukut ku mbështetej. Megjithatë vazhduam ngjitjen. Dalja në qafë e kishte sipërfaqen me akull nën borë, kurse kreshta e Radohinës ishte thuajse e gjitha me akull. Gjatë kohës që pritëm e u mblodhëm në qafë era e mjegulla u pështjelluan fort. Nga kreshta në drejtimin tonë binin vazhdimisht “dushe” bore të thatë dhe ndërkohë filloi të binte borë e lehtë. Nuk ishte aspak situatë bindëse që të kryhej ngjitja në Radohinë dhe vendosa të kaloja pak djathtas për tek e ashtuquajtura maja e Qafës së Radohinës. Ky mendim nuk gjeti aprovim dhe veprim veçse të atyre që kisha pranë. Bëmë tre foto (*në këtë majë*).

Pasi zbritëm 1-200 metra nuk e ndjemë më shqetësimin e erës dhe mjegullës por rënia e borës vazhdonte. Në dalje të Gropës së Radohinës patëm mundësi të matnim që, mbi breshërin e rënë më datë 11, në dy ditët pasuese që ra borë (datat 12 e 13), kishte rënë paksa mbi një metër borë. Në çadra u mblodhëm të gjithë në ora 13:00

Në ngjitje nuk erdhi Nesti (dje kishte ditëlindjen) dhe Viron Latifi. Të dy për arsye të këpucëve të papërshtatshme. Vironi u kthye në hyrje të Gropës.

Pas drekës pushuam rreth dy orë. Ndërkohë bora shtrëngoi shumë dhe bie si kokër orizi. Ndërkohë filluan problemet me çadrat, sidomos Liri e Koli me Pamirin.

Deri tani kemi kaluar qetë dhe mjaft mirë. Unë kam pak kollë. Moti, vazhdon pa ndërprerje rënia e borës.

## 16 shkurt

Mbrëmë kur sapo na zinte gjumi (21:50) u dëgjua krisma e një orteku. Pas pak, sapo humbi zhurma, një masë bore e tij,

si duket pasi është përplasur në shkëmbinjtë që ndodheshin përpara çadrës, kaloi mbi çadër në krahun ku flija unë. Në çast, duke ndjerë që bora nuk po lëvizte por kishte ndalur, nuk pata shqetësim. *(bora që kaloi mbi çadrën ku isha me Xhemalin, kaloi diagonalisht mbi të. Ndjeva që mbi trupin tim – isha i shtrirë në shpinë – nga supi im i djathtë, nëpër trup e deri tek këmbët isha i shtypur nga bora. Sigurisht që së pari komunikova, qetësisht, me Xhemalin, i cili fillimisht nuk e kuptoi se çfarë kish ndodhur ngaqë çadra nuk mori peshën e borës në anën e tij. Ai nuk u shqetësua, por u habit. Pastaj të dy thirrëm shokët që të na hiqnin borën duke punuar nga jashtë që ne mos të dëmtonim çadrën. Ne që nga brenda nuk mundej ta kuptonim se si e sa ishte “shtypur” ajo nga pesha e borës).* As Xhemali nuk u shqetësua, por u habit. Thirrëm Lirin e Kolin, të cilët fillimisht nuk na besuan *(e morën si shkaka nga ana jonë)* dhe na larguan borën nga çadra. Më pas doli dhe Xhemali dhe me këtë rast i pastruam të dy çadrat.

Gjatë gjithë natës ra borë dhe pas orës 06:30 pushoi. Ne përgatitëm mëngjesin dhe më 07:30, pasi hëngrëm, filluam të ngremë/prishim kampin. Erdhi një alpinist, nga ata të grupit që ishin poshtë dhe i thashë të nisen *(të kthehen për në Bogë)*. Malet janë shumë të ngarkuara me borë për të bërë ngjitje. Më 08:45 filluam zbritjen. Lamë pas korçarët dhe ekipin e Dajtit që ende ishin duke u përgatitur për ulje.

U ndalëm rreth 2-3 orë tek Shtëpia e Bajraktarit, ku u thamë dhe më pas u nisëm dhe ndalëm në qendrën e fshatit.

Pas orës 15:00 filloi të fryjë erë e fortë nga V-L. Gjelina *(vajza e Rrocut, motra e Hanës dhe Aleksit)* nuk m'u nda për një

orë duke kërkuar që të shkoj në shtëpinë e tyre. Së fundi i dhashë fjalën që do shkoja. Ne si ekip jemi sistemuar tek zyra e saj (*meqë n'atë kohë shteti i mbylli institucionet fetare, kisha e fshatit në atë kohë shërbente për shumë funksione: zyrat e kooperativës, qendër shëndetësore, muzeu i fshatit, etj*). Shumë e mirë për nevojat tona në ato kushte moti, por pa zjarr.

Për nesër e kemi lënë që të ngjitemi në malet e Bogës duke ndërmarrë itinerarë të thjeshtë. **Aleksandri**



Pamje nga qendra në jug e fshatit Bogë e fotografuar nga qafa e Bridashit



## 18 - 27 korrik 1985

Pjesëmarrës:

1. Aleksandër Bojaxhi,
2. Dashamir Fejzo,
3. Xhemal Begeja,
4. Ilir Tapia,
5. Sokol Doko.

### 16 korrik

Udhëtuam me trenin e mbasdites për në Shkodër. Sokoli kishte ardhur para dite e na kishte zënë vend në hotel tek turizmi i vjetër. Kaluam një natë me biseda të gjata e me vapë.

### 17 korrik

Me një automjet tip “Skoda” erdhëm në Theth. Na kushtoi 250 lek për person. Mezi e rregulluam me atë çmim, sepse fillimisht na kërkoi nga 500 lek. Skoda ishte e mbyllur, kështu që udhëtimi ishte i bezdisshëm. Ndaluam në kampin e Thethit, sepse shoferi nuk pranoi të na çonte tek qershitë. Aty erdhi një Skoda e ngarkuar tej mase, e cila sillte materialet e staneve të fshatit Grizhë për verim në Qafë - Pejë. Ngarkuam edhe ne çantat aty, por kur Skoda po kalonte lumin, ranë në ujë (lumë) çanta e Sokolit, një arkë me ushqime (që u zhduk; rreth 500 lek) dhe një fëmijë. Çadrat u ngritën tek qershitë (Kroi i Shtrazës). Jemi pak dhe qetë.

### 18 korrik

Ekipi ynë, me dy dyshe, bëri ngjitje tek shkëmbinjtë përballë (*muri Radohinës*). Ekipi i Dajtit vajti tek Arapi kurse Tropojasit bënë vrojtim në një lug që zbret nga Alia. Çunat tanë në kthim studiuan Arapin. Sot delet që kullosnin rrotull na hëngrën shumë

domate, etj. dhe kemi ngelur thuajse vetëm me qepë (*në artikujt e perimeve*).

## 19 korrik

Tropojasit janë pa bazë materiale. I lëmë në kamp. Dajti rishtaz vete në Arap. Ilirin e Sokolin i dërgoj në një itinerar të Arapit, në pjesën e djathtë të faqes që duket prej këtu. Kanë mendimin që nesër të ngjisin Arapin (*faqen jugore nga poshtë lart*). Për këtë dje shfrytëzua edhe mbasditen, dhe me ta, gati dy orë punova tek shkëmbi në pyll.

Unë me Xhimin nëpër lugun pranë nesh u ngjitëm në Ali e u kthyem nga Qafë Peja. Itinerari ishte i mërzitshëm, sepse kish shumë gurë, por për dimër, në kohë me ngricë, është i mrekullueshëm. Të nxjerr direkt e në Qafë të Valit.

Sapo u ktheva me Xhimin, Nardi (Leonard Rama) i Dajtit niset për në rrëzë të Arapit (mori ca ushqime, ujë e veshje). Ai shtoi: “Është vonë dhe ata (*dyshja e Dajtit*) mund të mbeten atje. Kozmai më tha që të vijnë edhe 2-3 nga djemtë me një litar për çdo rast”.

Teksa haja, me dylbi, shokët ndiqnin ngjitjen (Haziri kish sjellë dylbi) e dyshes së Dajtit. Pas pak del fjala se litari i sipërm ka kaluar poshtë, që d.m.th. se Luani ka filluar zbritjen. Në këto biseda ia behu Kozmai pa frymë. U bë e qartë: Luani ishte rrëzuar. U nisëm (jo unë, se isha tepër i lodhur) me vrap për ndihmë, për t’u vajtur në ndihmë nga sheshi nëpër traversë.

U futën (*për ndihmë*) Sokoli dhe Iliri. Nga protestat e Sokol Hoxhës dyshja mori sipër për t’u hedhur litar, por u futën në një vend tepër të vështirë, saqë u tha se më në rrezik tashmë ishin këta të dy (Sokoli me Ilirin) sesa të aksidentuarit. Ndërkohë filloi shi, pak, i cili e solli në vete Luanin. Thënia se dyshja e Tiranës është shumë më keq se ju, i mobilizoi Luanin e Sokolin të cilët vetë arritën që të zbrisnin deri tek traversa qendrore. Tashmë

pothuajse ishte errur. I morëm fjalën dyshes se nuk do të lëviznin që aty dhe se nesër do vijmë që t'i nxjerrim. Unë, *më pas*, u ngjita thujse deri tek pika më e afërt e komunikimit me të dëmtuarit. Pas kësaj u ulëm të gjithë poshtë pasi bindëm Nardin e Kozmain se nuk kishte kuptim ta kalonin natën aty.

## 20 korrik

Sapo zbardhi i pari u çua Kozmai. U nisën të gjithë lart. Vetëm unë (Aleksandri) mbeta në kamp. Nga brinja qendrore e Arapit (shpatulla), Sokoli e Iliri kaluan traversë e pas 100 metrash arritën në terracë. U dhanë të dëmtuarve ushqim e veshje e pastaj i kaluan (*të siguruar*) në shpatull. Prej aty u ulën poshtë dhe prej aty, në krahë, e ulën Luanin deri në kamp. U mjekua dhe u vu të qetësohej bashkë me Sokolin. Më 12:30 çdo gjë ishte stabilizuar. Ekipi ynë më ora 20:00 filloi përgatitjet dhe sistemoi materialet për të sulmuar *nesër* majën e Arapit nga rrëza e tij.

## 21 korrik. Shkruan Dashi

Të gjithë u zgjuam herët për arsye se Iliri me Sokolin do të sulmonin Arapin nga rrëza. Nisja nga kampi u bë në ora 05:10 dhe ngjitja filloi në 07:15. Në orën 13:15 të dy dolën në podin e Arapit që ndodhet në të majtë të faqes shkëmbore. Ishte biseduar që *mbrëmë* në darkë që të bëhej komplet Arapi (*duke fjetur në shkëmb*), mirëpo duke mos patur asgjë të keqe që të ndërpritej tek podi dhe të vazhdohej të nesërmen, vendosëm që të dy shokët që linin aty bazën materiale dhe të zbrisnin poshtë; dhe ashtu u bë. Ngjitjen e udhëhoqi Sokoli i cili pati shumë siguri në shkëmb. Gjithashtu edhe Iliri punoi mirë duke e siguruar. Që të dy shokët kanë një përgatitje fizike e teknike të mirë në shkëmb. Mbasdite dolëm tek kampi i punëtorëve ku takuam disa të njohur. Gjurmë ora 22:30.

*(këtë itinerar e kisha studiuar në vitet 1966 dhe 1967 dhe pata vendosur që në verën e vitit 1968 ta synoja me Petraq Kulen. Ndodh që Pertaqit atë vit t'i ndërrojë jetë i vëllai dhe kur u takuam në Theth ndër të tjera më tha: "Aci më ka vdekur vëllai. Familja dhe të afërmit nuk donin që të vija këtë vit për ngjitje. U kam premtuar që do shkoj të drejtoj veprimtarinë dhe nuk do ngjitem". Pas kësaj unë "nuk ia hodha sytë" kësaj faqeje. Ndërkohë nuk e kisha parë këtë itinerar nga ana e rrethit të Vishnjës, por vetëm nga ana e Qafë - Pejës. Nuk e dija se diku në mes të faqes ky itinerar lidhej me podin që përmendet në këto shënime).*

## 22 korrik

I gjithë ekipi ishte në tension dhe vetëm për këtë flitej, d.m.th për ngjitjen që u la në mes, andaj dhe mbrëmë ramë për të fjetur më herët. Nga ora 2 e natës filloi një erë shumë e fortë (*si dhe, ra shi*), e cila vazhdoi edhe gjatë ditës gjë që na pengoi për ngjitjen, e cila nuk u krye. Presim si do të jetë dita e nesërme, data 23. Në mbrëmje moti u qetësua dhe darka kaloi shumë mirë. Gjumi si zakonisht në ora 22:30.

## 23 korrik

Zgjohemi në orën 05:30 dhe nisemi si ekip për të shoqëruar dhe instruktuar Sokolin dhe Ilirin (Kolin dhe Lirin) se ku do të ecte (*ngjitej*) që të dilte lehtë në majë. Ngjitja filloi në ora 07:15 nga vendi ku u la dy ditë më parë. Kjo pjesë ngjitje është gjysma, por më e vështira, ku në fillim Sokoli kaloi diagonal me shumë mjeshtëri deri tek brezi i zi, i cili ka një gropë, e prej ku, sipër saj, fillon plasa ose ulluku i vetëm që ka ky brez. Prej këtui vazhdoi ullukut deri sa mbaron brezi i zi, të cilin e kaluan shumë shpejt. Për të shkuar deri tek shpella të dy kanë punuar shumë mirë dhe në orën 18:45 dolën në majë ku dhanë dhe zig-zagun. U kthyen

në kamp në orën 20:45, ku ne i pritëm me një zjarr të madh dhe i uruam për këtë sukses të tyrin dhe të alpinizmit tonë.

## **Përmbledhje: Faqja Jugore e Malit të Arapit**

Për ngjitjen e faqes jugore, datë 21 korrik – 23 korrik 1085 u përdorën:

|                 |    |
|-----------------|----|
| - Plenga/gozhdë | 66 |
| - Litarë 40 m   | 2  |
| - Pyka          | 9  |
| - Shkallë       | 7  |
| - Karabina      | 80 |
| - Majth/çekiç   | 2  |

Ngjitja kërkoi 23 rigrupime; Sokoli dhe Iliri

### **24 korrik**

Sot u zgjuam sipas qejfit dhe e kemi lënë që të dalim në Qafë - Pejë me çanta, ngase do jetë zona ku do të vazhdojmë ngjitjet për ditët në vazhdim. Nisemi më 16:10 për në Qafë - Pejë. Katër çanta i vumë mbi mushkat që sjellin qumështin poshtë, kurse atë të Acit, si më të lehtë, e mbajnë me radhë Iliri me Sokolin. Rruga kaloi mirë sado që ajo është e mërzitshme. Mbërrijmë në vendin ku janë sistemuar Tropojanët dhe dy të Dajtit, në orën 19:20. Ngremë çadrat dhe përgatisim darkën me makarona e kuti mishi. Gjurmë më 22:30. Iliri na siguroi 5 litra qumësht nga baxhoja me ndihmën e ushtar Llambros nga Vlora.

### **25 korrik**

U zgjuam në orën 07:00. Aci me qumështin që siguroi Iliri përgatiti mëngjesin të cilin e hëngrëm me shije sepse është

qumësht dele. Dje rreth orës 19:30 morëm vesh se në Valbonë ku zhvilloheshin ngjitje si këtu në Qafë - Pejë edhe në Livadhe të Bogëve, ka rënë nga një lartësi prej 70 metra një alpinist që bënte ngjitje në Malin e Thatë në Valbonë. U mësua se ishte Pullumb Llabanishti i Partizanit. Ai, siç e shpjegojnë, ka kryer ngjitjen dhe në zbritje ka rrëshqitur, ka mundur të kapet tek litari, porse nuk ka mundur të frenojë veten. Është dhënë alarmi nga shokët e tij dhe është nxjerrë pa ndjenja (i vdekur) nga tre fshatarë që kositnin bar në livadhet përreth. Kjo ka ndodhur në datën 22 korrik dhe ne e morëm vesh më 24 korrik. Sot në rreshtimin e mëngjesit mbajtëm një minutë zi në shenjë respekti dhe kujtimi të këtij alpinisti i cili ishte shumë i mirë me shokët. Ai ishte i sapomartuar dhe djalë i vetëm.

Sot ekipi 17 Nëntorit do të punojë tek mali i Lakojeve/Langojeve, Dajti tek Sqeta e Cjapit dhe Valbona në Kllogje. Jemi gjithsej 10 alpinistë nga 12 që ishim në Shkodër. Në Theth është lënë Luan Redhaj, i cili ka dëmtuar këmbën në ngjitjen e Arapit ku ai u shpëput nga shkëmbi. Kozma Grillo u largua sepse ka dasmë në datën 26 korrik. Dezhurn në çadra është Dashi, i cili do të gatuajë atë që kërkojnë shokët: çomlek me sallam dhe oriz, pa llogaritur të tjerat.

**Shënim:** Të gjithë ata që do ta lexojnë këtë ditar ta kenë parasysh se nuk është e lehtë të gatuash sepse nuk gatuan për vete dhe hajde, pasi janë pesë vetë që kanë pesë midë të ndryshme. Aci gjithashtu nuk përton të gatuaj si dhe unë (Dashi). Koli me Lirin nuk ia shkrepin fare, kurse Xhimi, që ka profilin e punës kuzhinier, si duket i është mërzhitur, se këtu nuk e ka me qejf këtë punë. Morali në ekip është i lartë, shokët janë të papërtueshëm. Çdo mbasdite kemi luajtur domino e letra. Në letra i ka ecur Sokolit kurse në domino dyshja Dashi-Aci ka mundur dyshen Koli-Iliri. Shokët e ngjitjeve u kthyen më 16:00.

## 26 korrik

Mbrëmë treshja e Tropojës me Hazirin, Hajdarin e Isufin vranë një cjaq shumë të madh (të egër) me moshë 11 vjeçare dhe shumë të bukur. Ata e groposën në borë pasi i hoqën të brendshmet me një gur të mprehtë (*në mungesë të thikës*), të cilat po mbrëmë u përgatitën dhe u hëngrën të shoqëruara me uzo.

Zgjimi sot u bë më 07:00 dhe grupet u nisën për ngjitje. Ekipi ynë punoi tek Sqeta e Cjapit, ekipi i Tropojës dhe Dashi vajtën tek cjaqi i groposur në borë. Rruga deri atje ishte e gjatë, gati deri tek qafa e Radohinës. Unë (Dashi) dhe Haziri filluam ta rrjepim, gjë që e kryem më së miri, pastaj e ndamë në tre pjesë/ekipe dhe u kthyem në kamp në orën 16:00. Këtu filloi larja dhe zierja e mishit në enë me presion. Janë gjithsej tre tenxhere plot me mish aq sa të shtatë ne që mbetëm në kamp na bie nga 1.5 kg për person.

Ekipi i Dajtit punoi në Arap një ngjitje të kategorisë IV në faqen perëndimore. Sot ekipi i Tropojës u nis për në Valbonë nëpër Gropat e Bukura. Plaçkat i ngarkuan në mushkën e postës kufitare. Po sot është njoftuar me telefon posta kufitare këtu që të na transmetohet mesazhi se ne alpinistët nesër datë 27 të jemi në orën 10:00 në Theth. Aty na pret autobusi për në Shkodër. Është një nisje jo e rregullt mbasi kjo d.m.th. që të lenë aktivitetin pa mbaruar. Është urdhër nga Federata jonë (*me siguri një vendim federate pas aksidentit të ndodhur në Valbonë. Mos harrojmë se në ato kohë mundësia për komunikim nuk është kjo që është sot. Ne ishim në Theth dhe lajmi për fatalitetin në Valbonë erdhi tek ne ditën e tretë!*). Gjatë kësaj kohe që po shkruaj, në furnelë po zien tenxherja e dytë e mishit të cjaqit të egër dhe në orën 21:00 do të hiqet. Është një mish që, që të gjithë ne nuk kemi rast që ta hamë herë tjetër. Mirëpo, kemi mish, por nuk

kemi asnjë pikë verë që ta shoqërojmë! Të shohim si do të shkojë  
darda.

*Mbajtës i ditarit Dashamir Fejzo*

Përmbledhëse e itinerarit jugor të malit të Arapit:

Sokol Doko

Ilir Tapia

U përdorën:

|               |         |
|---------------|---------|
| Plenga/gozhdë | 66 copë |
|---------------|---------|

|             |         |
|-------------|---------|
| Litarë 40 m | 27 herë |
|-------------|---------|

|      |        |
|------|--------|
| Pyka | 9 copë |
|------|--------|

|          |         |
|----------|---------|
| Karabina | 80 herë |
|----------|---------|

|       |        |
|-------|--------|
| Çekiç | 2 copë |
|-------|--------|


|           |         |
|-----------|---------|
| Rigrupime | 23 herë |
|-----------|---------|


Nisja 21 korrik 1985 ora 07:15





## Skica Arapi

Këto janë shtatë skicat që ilustrojnë ngjitjen e faqes jugore të majës së Arapit nga Sokol Doko dhe Ilir Tapia
















**Shënim:** nga fundi i viteve '70 filloi përshkrimi i itinerareve që ngjiteshin nëpërmjet shenjave konvencionale të miratuara nga UIAA. Këto të reja në alpinizëm unë i gjeta në një libër për alpinizmin që gjëndej në Biblotekën Kombëtare – Tiranë. Libri ishte i shkruar në gjuhën rumune. Për të përkthyer disa nga faqet e atij libri na ndihmoi Thoma Çomora, i cili punonte si financier apo ekonomist në Tiranë tek Shtypshkronja e Re. Ndërmjetës u bë Shefki Juma, anëtar i ekipit tonë, i cili punonte në po atë shtypshkronjë. Itinerari nëpër të cilin u ngjitën në majën e Arapit alpinistët Sokol Doko dhe Ilir Tapia, u përshkrua në skicat si më poshtë dhe u hodh në ditar nga Xhemal Begeja.

Legjenda (shenjat konvencionale) për të kuptuar skicat u ripunua në nëntor 2018 nga ing. Menduh Zavalani, anëtar i SHBA Tirana që në krijimin e saj. Ai për këtë legjendë u mbështet tek legjenda e botimit ALPINIZËM (Autorë Kozma Grillo dhe Aleksandër Bojaxhi; Botuar në Shtypshkronja e Re Tiranë 1982), tekst mësimor ky i ribotuar nga Shtypshkronja PEGI 2014.

Në pritje për transport  
të krijohet mundësia  
edhe të fiksosh  
kujtime me shokë





## 14 – 18 tetor, 1985

Pjesëmarrës:

1. Aleksandër Bojaxhi (mbajtësi i ditarit)
2. Xhemal Begeja
3. Mazllëm Feka
4. Ardian Kurti
5. Sokol Doko

### Data 13

U nisëm nga Shkodra me autobuzin në dispozicion. Me ne në autobus ishte edhe grupi i Bogës (*besoj se është fjala për banorë/pasagjerë nga Boga*) si dhe ekipet e alpinistëve të klubeve “Vllaznia”, “Luftëtari”, “Labinoti” e “Përparimi”.

Gradualisht moti i nxehtë (ishim me mëngë të shkurtëra) filloi të ftohej. Kurr arritëm në Bogë ndjemë një qetësi të thellë. Nga të njohurit e vjetër takuam Martinin (furrëtarin). Na tha se i kishte vdekur një nip të cilin e kishte zënë tuneli duke germuar dhe për të bërë varrin e një të afërmi të tij. Pas kësaj na pyeti nëse ka gjë për të ngrënë në Tiranë (*n’atë kohë ishte problem i madh sigurimi i artikujve ushqimorë për familjet tona*).

U ndamë me bogjanët dhe vazhduam udhëtimin. Në ora 15:30 arritëm në Theth. Dërguam fjalë poshtë në fshat që të vinte Frani (*adnministrator i godinës që shërbente si kamp veror pushimi për puntorët dhe nënpunësit*) e të na hapte barakat që i ishin shtuar kampit. Na njoftuan që Frani nuk ishte në fshat ngaqë kishte shkuar në një vdekje. Nata u kalua në çadra. Ishte mjaft ftohtë për shkak të motit të vrenjtur dhe erës.

### Data 14 tetor

Rreth orës 11:00, erdhi Frani dhe na njoftoi se atë ditë, pra sot, kish marrë një shkresë e cila e njoftonte për ardhjen tonë (letra

ishite nisur në datën 6 tetor) dhe se mbrëmë kish qenë në dasëm tek Zef Ujka. Na sistemoi menjëherë.

Moti u prish. Binte borë e lehtë dhe frynte vazhdimisht. Mbi Shpellën e Pejës ra zjarr i madh. Patëm fat që nuk u nisëm sot për ngjitje sepse do kish dalë fjala në fshat se “zjarrin e vunë alpinistat”. Ne mësuam se zjarre kishin rënë edhe në Bogë (Rabë) edhe në Gimaj edhe në Veleçik.

### **Data 15 tetor**

Gjumi na doli më ora 03:00 por e lamë të presim edhe ca për nisjen. U zgjuam rishtaz më ora 5:00 dhe u nisëm pas 30 minutave. Ekipi i Vlorës ju drjtua Majës së Madhe, Prozhmit dhe Arapit; Kozmai e Xhixha (Gëzim Hima) në Kolaj. Unë, Ardi, Baraku (Ilir Baraku), Zhegu, Marseli në Jezerë (Ardi dhe Baraku u ngjitën edhe në Jezerë të vogël). Koli, Xhimi dhe Mazi u nisën për në majat e Alisë dhe Popllukës duke u ngjitur nëpër lugun që është thujtë te Kroi i Shtrazës (Qershitë). Ngjitjet u realizuan me sukses. Jezerën e arrita më 10:25. Pas orës 11:00 koha u prish. Në kthim, tek shpella, na arritën Kozmai me Xhixhën. Zjarri mbi shpellë vazhdonte, por ishte në rënie. Mbi shpellë lëshoheshin teposhtë gurë të mëdhej e të vegjël dhe desh na dëmtuan.

### **Data 16 tetor**

Pushuam. Zbritëm poshtë në fshat ku drekuam, madje blemë arra. Koha sa vinte e përmirësohej dhe tashmë grupi u mësua me të ftohtin aty.

### **Data 18 tetor**

Makina, të cilën e prisnim të vinte në ora 08:00, erdhi në ora 18:00. U nisëm menjëherë për në Shkodër.

*Mbajtës i ditarit, Aleksandër Bojaxhi*

# VITI 1986

## Aktiviteti Alpinistik Kombëtar Dimëror Bogë 5 - 13 shkurt, 1986

Pjesëmarrësit:

1. Dashamir Fejzo
2. Artur Shehu
3. Bujar Kokoshi
4. Foti Taçi (mbajtës i ditarit)

Ekipet që morrën pjesë:

“17 Nëntori”, “Dajti”, “Apollonia”, “Partizani”, “Studenti”,  
“Labinoti” dhe “Vllaznia”

Komandant i ngjitjeve Kozma Grillo

Komisar i ngjitjeve Dashamir Fejzo

### Data 5 shkurt

Sot do të nisemi për në Shkodër dhe jemi shumë të entuziasmuar që filluam më në fund të kryhen ngjitjet në Alpe, pas një ndërprerje prej një viti e gjysëm (*me sa duket për Fotin ky-një vit e gjysëm-ka qenë shkëputje nga veprimtaritë. Ai punonte ditën dhe*

*ndiqte fakultetin e inxhinjerisë natën*). Në orën 15:30 u nisëm nga “Klubi Sportiv Dajti” me makinën e po këtij klubi. Ishim bashkë me ekipin “Dajti” që kishte në krye profesor Kozmain. Për ne si trajnier në veprimtari ishte Dashi. Udhëtimi vajti mirë dhe në orën 19:00 ishim në Shkodër. Zumë vend tek i ashtuquajturi Hotel Kashta. Pasi u rregulluam aty dolëm për të ngrënë. Të gjithë morrëm nga një kokë qingji dhe një pjatë fasule. Koka e qingjit ishte pa trutë. Kjo u bë shkak për shaka. Por megjithatë, uroj që një darkë të këtillë të hamë përherë!

### **Data 6 shkurt**

E kishim lënë nisjen për në Bogë në orën 8:00. Blemë edhe ndonjë gjë që na kish mbetur pa blerë (si gjithnjë) dhe u nisëm. Rreth orës 12:00 apo 13:00 ishim në Bogë. Çadrat i ngritëm po aty ku i kishim ngritur dy vite më parë kur u kthyem nga Shtegu. Kështu që u rregulluam mirë. Unë, Turi dhe Kokoshi u sistemuam në një çadër dhe e rregulluam mirë edhe me gurë anash dhe mushama përsipër. E bëmë si “kala”. Duke u marrë me këtë punë u errësua dhe nuk patëm kohë të bënim drekë. Për darkë përgatitëm çaj, djathë dhe skuqëm nga një vezë dhe marsh për në gjumë.

### **Data 7 shkurt**

Ngrihemi pas një nate të ftohtë dhe pa gjumë. Si duket nga që është nata e parë në alpe pas asaj nate dimri të një viti më parë. Moti ishte i keq dhe prisnim që të përmirësohej sado pak që të fillonim ngjitjet. Mëngjesin e përgatitëm unë me Kokoshin: çaj, djath e gjalpë. Ushqimet i kemi bashkarisht me ekipin “Dajti”, kështu që u vonuam ca deri sa e përgatitëm. Hëngrëm nxitimthi dhe u nisëm me në krye Agron Shehun, i cili ishte pergjegjësi i “Apollonisë” dhe drejtues i togës sonë. Jemi toga

e dytë. U nisëm për të ngjitur majat e Hundës dhe Pishkanit. Mjegulla vinte rrotull por nuk zbriste më poshtë se nga majat të cilat synonim të ngjisnim. Kur arritëm tek traversa, bora ishte e mirë dhe mbante. Kur nisëm të ngjitemi në kuriz të majës, ky na doli i mbuluar me akull. Mbathëm kthetrat dhe vazhduam. Çdo gjë kaloi me sukses, porse një gjë na shqetësonte: mjegulla. Sapo nisëm zbritjen u mbuluam nga një mjegull e dendur aq sa mezi shikonim. Për tu ngjitur në majën e Pishkanit kishim përpara disa gropa të cilave ja kishim frikën, andaj hoqëm dorë nga ngjitja e saj dhe filluam zbritjen. Kur duheshin edhe rreth 30 minura që të arrinim kampin, filloi një borë e madhe. Arritëm kampin nga ora 13:30 dhe ju sulëm supës që na kishte përgatitur Dashi. Mbasdite vajtëm në klub tek Roku ku morrëm nga një gotë verë të vogël dhe në orën 21:30 shkuam të flejmë.

## Data 8 shkurt

Natën fjetëm mirë dhe nuk patëm dhe aq ftohtë. Turi megjithatë është gjithnjë ankues. Çaji ishte gati që mbrëmë dhe vetëm duhej ngrohur, punë që e kishin bërë Dashi me Kozmain, të cilët ishin ngritur më herët. Pas mëngjesit u nisëm për ngjitje. Na caktuan Pishkanin si dhe Biron (?) të cilin lamë pa e ngjitur dje. Shtabi na kishte ndarë në dy grupe, përkatësisht një grup i vogël i përbërë prej pesë vetësh me në krye Xhepin (Rexhep Maçka) të cilët u ngjitën në majën e Biroit, si dhe grupi ynë me në krye Gonin (Agron Shehu) i cili fillimish do ngjitej në Pishkan e më pas në Biron. Rruga ishte e hapur nga bora e një dite më parë dhe nuk e patëm të vështirë ngjitjen. Ndërsa rrugën për në majën tjetër e hapi grupi i Xhepit. Në mes të rrugës së kthimit filloi të binte dëborë sikundër një ditë më përpara. Mbërritëm në kamp qullë dhe u futëm direkt tek dhoma e shtabit, ku Dashi na kishte përgatitur supë të ngrohtë. Mbasdite luajtëm futboll me

të rinjtë e fshatit, ku u dallua Turi, i cili me siguri do të mbetet në rrëfimet e fshatarëve për ca kohë për shkelmat e tij. Ju a lamë lojën (*fitoren*) që t'i kënaqim dhe më pas vajtën e rrëkëlyem nga një gotë të vogël me verë për t'i bërë ballë të ftohtit. Për natën rregulluam të flinim tek dhoma e shtabit meqë Kozmai vajti tek një mik për të kaluar natën.

## Data 9 shkurt

Është e dielë. Gjumi na doli reth orës 6:00 të mëngjesit, atëherë kur na zgjoi Dashi. Për të fjetur, fjetëm mirë. Ndezëm furnelën për të ngrohur çajin të cilin e kishim përgatitur që një ditë më përpara dhe u ulëm pranë sobës që na e kishte ndezur Dashi. Nga ora 7:00 erdhën edhe çunat e ekipit të Dajtit dhe së bashku hëngrëm mëngjesin. Koha ishte e keqe por megjithatë kjo nuk na pengonte për të kryenim ngjitje. Sot u rrjeshtuam më shpejtë se herët e tjera që të niseshim dhe të ktheheshim herët nga mali në mënyrë që të arrinim të shikonim ndeshjen e futbollit Partizani – Flamurtari. Na caktuan të ngjisim majën e Livadhit, e pestë në nivel vështirësie. Me ne erdhën edhe Dashi edhe Kozmai për të parë nëse ulluku nën majën e Livadhit ishte shkarkuar (*nga bora*) dhe ishte tashmë i përshkueshëm (*të kalonim aty*).

Nëse aty do kishte ende dëborë, rreziku i shkaktimit të një orteku do ishte shumë i mundshëm, kështuqë do ishim të detyruar të mos kalonim përgjatë ullukut. Deri tek ulluku shkua mirë. Aty ndaluam dhe Kozmai i tha Dashit që të shkonte më tej bashkë me Xhepin dhe Gonen dhe të shikonin nëse kishte shkarkuar ose jo. Ata u nisën dhe ne u ulëm që të bënim një pushim të vogël. Pas pak shokët u kythen dhe na thanë se ulluku nuk kishte shkarkuar dhe kjo bëri që për ne të anullohej ngjitja e majës së Livadhit dhe na u caktua të synonim majën e Helmit. Kjo ishte një ngjitje e thjeshtë. Pas pesë orësh

ishim sërish në kamp. Kur arritëm mësuam se tërë sallamin na e kishte ngrënë një qen i fshatit. Dreka jonë nuk ishte përgatitur, andaj hëngrëm nga një pjatë makarona në mencën e fshatit. Mbas kësaj shkuaam për të parë ndeshjen e futbollit. Pasi mbaroi ndeshja hëngrëm drekën, e cila ndërkohë ishte përgatitur. Më pas shkuaam tek klubi i fshatit ku kaluam një mbrëmje të gëzuar bashkë me ekipet e tjera. Ramë të flemë herët pas një darke që e hëngrëm në çadër (zakonisht e hanim tek dhoma e shtabit ku dhe mbanim ushqimet).

### Data 10 shkurt

E hënë. Koha është mjaft e keqe dhe bie dëborë pa pushim. Na njoftuan të prisnim deri në orën 9:30, megjithatë edhe pas kësaj ore koha vazhdonte të mbetej e keqe. Nuk dinim çfarë të bënim. Vajtëm në klubin e fshatit për të kaluar pjesën e mbeur të kësaj dite, e cila për ne nuk ishte e mbarë. Morali ynë është i lartë. Shpresojmë që të hapet koha nesër.

### Data 11 shkurt

Mbrëmë Kozmai e Dashi vajtën tek Roku, i cili manaxhon dyqanin e fshatit. Nga kjo përfituam ne, sepse fjetëm në dhomën e tyre. Ishim mirë dhe ngrohtë dhe në orën 6:30 u ngritëm, ndezëm zjarrin dhe ngrohëm çajin e përgatitur një ditë më parë. Koha nuk qe dhe aq e mirë por kjo nuk do na pengonte për ngjitje. Hëngrëm mëngjesin mëngë dhe shkuaam të rrjeshtoheshim. Para nesh në vendin e fillimit të ngjitjes kishin arritur edhe mjaft alpinistë të tjerë. Na u caktua ngjitja e Bridashit të Madh dhe atij të Vogël. Me ne erdhi edhe Dashi sepse donte të shihte itinerarin ku do të kalonin alpinistët e kategorive të larta (*në Livadhet e Bogëve*), veprimtaria e të cilëve do të organizohej pasi të mbyllej veprimtaria jonë. Itinerari kishte shumë dëborë dhe për ta çarë atë ndronim një pas një çarësin e borës.

Me zig-zage vajtëm deri tek qafa. Për rastësi edhe këtë rradhë qafën i pari e kalova unë. Edhe para dy vjetësh ndodhi e njëjta gjë dhe në po të njëjtat kushte. Sa dolëm në qafë filloi një erë e tërbuar që ishte edhe verbuese (*nge borën dhe ta përplas në fytyrë*). E kaluam të gjithë me sukses, madje edhe ata që vinin për herë të parë. Më pas itinerari vazhdonte i shtruar dhe i drejtë rreth 20 minuta. Filluan .... dhe kur duheshin edhe 50 m që të arrinim majën na doli një pjesë me akull. Shokët aty punuan mirë, sidomos Turi, dhe maja u ngjit me sukses. Bridashi i vogël nuk kishte ndonjë vështirësi dhe pas një ore e ngjitëm edhe atë majë. Në rrugën e kthimit na zuri një erë e fortë në qafë, gjë që vështirësoi kalimin e saj. Këtë peripeci e quajtëm “Odiseja e Qafës”. Pjesën nga qafa poshtë e zbritëm për 30 minuta. Rrëshqisnim, binim e zhyteshim në borë. U lagëm por edhe u kënaqëm. Hëngrëm drekë të mirë e më pas luajtëm futboll me djemtë e fshatit. Sot ramë herët për të fjetur.

## Data 12 shkurt

Mbrëmë fjetëm përsëri tek dhoma e shtabit dhe ja kaluam mirë sepse aty erdhën edhe alpinistët e “Partizanit” dhe të “Fierit”. .... ushqimet dhe hëngrëm mirë. Sot u ngritëm herët dhe mbas buke pamë që koha nuk na premntonte për ngjitje. Shtabi vendosi që të prisnim deri në orën 9:30, por moti nuk u përmirësua. Vajtëm tek klubi dhe ja shtruam me një pesë-katësh deri në drekë. Mbasdite luajtëm futboll me djemtë e fshatit. E mbyllëm në barazim dhe pa ndonjë kënaqësi mbasi për pak desh u zumë. Më tej u mblodhëm në dhomë dhe filluam e mbaruam me biseda. Në orën 2:00 të drekës filloi analiza e veprimtarisë. Atë e hapi Kozmai. Nga ana e ekipit tonë foli Arturi. Folën edhe nga ekipet e tjera: Sandri, Kujtimi, Xhepi, Vasili, Gimi, Gonja, etj. Me kaq u mbyll kjo veprimtari. Në mbrëmje e ndezëm mirë sobën, u futëm në thasët e fjetjes dhe biseduam deri nga ora 22:30.



## Data 13 shkurt

Sot është mëngjesi ynë i fundit në Bogën e mbuluar nga bora. U ngritëm herët dhe rregulluam çantat ngaqë na kishin porositur se autobusi do vinte në orën 8:30. Mëngjesin e morëm në dorë dhe nga ora 9:30 autobusi erdhi. Ne hipëm në të por sytë i mbanim gjithnjë nga malet si për tu thënë se do vimë përsëri dhe se këmba jonë do u shkelë gjithmonë. Gjatë rrugës kënduam këngë dashurie aq sa u lodhëm. Ishin ulur afër nesh (të grupit të Tiranës) edhe dy vetë të “Partizanit” dhe këndonim. Buçiste autobusi. Në orën 12:00 arritëm në Shkodër. Menduam të shkonim drejt e në Tiranë meqë treni nisej në orën 14:10. Pasi premë biletat hëngrëm drekë në restorantin e stacionit të trenit, por nuk na pëlqeu. Kështu mbaroi kjo veprimtari e bukur nga ..... dhe shoqëria.

*Mbajtës i ditarit, Foti Taçi*

## Mali i Dajtit

### 19 – 21 shkurt, 1986

Pjesëmarrësit:

1. Aleksandër Bojaxhi (mbajtës i ditarit)
2. Mazllëm Feka
3. Dashamir Fejzo
4. Artur Shehu
5. Bujar Kokoshi
6. Ardian Kurti
7. Ilir Tapia
8. Sokol Doko
9. Gazmand Zajmi
10. Ylli Hoxha

## Data 19 shkurt

Erdhëm dje në Dajt. Buzë mbrëmjes arritën të gjithë (*kemi ardhur në këmbë*) dhe u mbledhëm në dhomën numër 25. Ishte ditë shiu. Sot paradite punuam në teknikë sigurimi me kazëm dhe litar në pjerrësitë mbi Shkallën e Tujanit. U ngjitëm në majë dhe u kthyem po nga rruga e ngjitjes. Në majë nuk erdhën Ylli Hoxha dhe Ilir Baraku. Këta u kthyen për arsye shëndetësore rreth 30 minuta para arritjes në majë. Kur u kthyem nga maja takuam arsimtarët dhe nxënësit e shkollës së Krrabës. (*kam qenë mësues për 13 vite në Krrabë. Në ato vite nxënësit e shkollave pëgjatë ditëve të javës, si dhe punonjësit e ndërmarrjeve gjatë fundjavës, sipas një grafiku të planifikuar nga Komiteti i Fizikulturës së Tiranës, ngjiteshin në malin e Dajtit ku kalonin një natë dhe të nesërmen organizoheshin argëtime të ndryshme deri në drekë. Pastaj zbritja. Në këtë grafik arritën të futen edhe të ardhur nga rrethe të tjera, e sidomos nga Durrësi*). Kaluam një mbrëmje mjaft të këndëshme. Fola me Ardin në telefon. Atij më së fundi i kanë dhënë leje dhe do të vij nesër në Dajt. Sapo u kthyem nga stërvitja filloi një shi i madh i cili ende po vazhdon të bjerë.

## Data 20 shkurt

U nisëm pa Ilirin dhe Yllin dhe kur arritëm në Kampin e Puntorëve shiu i dobët që binte pushoi. U ngjitëm mbi kamp në majën e Sem Rumit. Pa dalë në majë na zuri mjegulla dhe kështu gabimisht zbritëm për rreth 15 minuta matanë malit. Pastaj u ndalëm dhe u kthyem deri sa ramë përsëri në gjurmët e majës. Ishte rast tipik i çorientimit që të bën mjegulla. Gjatë zbritjes, aty nga fundi, na zuri shiu që na shoqëroi deri sa hymë në godinën e kampit. Mbasdite erdhi Ardi. Vazhdimisht binte shi.

## Data 21 shkurt

Mot me mjegull. Ngjitemi në majën e Dajtit (tek antena) dhe më pas futemi (na pranojnë) në mjedisin ku rrinë teknikët dhe punonjësit e antenës. Pamë një film amerikan. Kur zbritëm mora vesht se Sokoli ishte ulur në Tiranë pa marrë leje. (Ardit i dhashë leje pa më thënë. Dje Mazin e lajmëruan të ulej sepse kishte vajzën sëmure. Nuk donte të ulej duke u justifikuar se e shoqja alarmohej më tepër se sa duhej. Më bëri përshtypje që ai nuk u largua dhe aq më tepër më habit fakti se përse Ardi dhe Sokoli nuk e detyruan të ulej, meqë këta formojnë një treshe më të lidhur midis tyre). Kthimin e kemi lënë për nesër në mëngjes duke gjykuar të kapnim në gurorë, rreth orës 07:15, autobusin që kthehet në Tiranë nga minjera e baoksidit e Priskës.

**Shënim:** Më datën 20 unë dhe Dashi thirrëm Mazin dhe mbajtëm qëndrim për mosvajtjen e tij në aktivitetin e katërgjyshit të dytë në Bogë. Ai ishte caktuar të shkonte atje si drejtues toge (*duket se kjo veprimtari në malin e Dajtit ka shërbyer si grumbullim/parapërgatitje e ekipit në prag të veprimtarisë dimërore të rradhës*).

*Mbajtës i ditarit, Aleksandër Bojaxhi*

## Traversa; 25 shkurt – 6 mars, 1986

Pjesmarrësit:

1. Aleksandër Bojaxhi (mbajtës i ditarit)
2. Dashamir Fejzo
3. Ilir Tapia
4. Sokol Doko

### Data 25 shkurt

Dje arritëm në Bogë në një kohë shumë të keqe. U sistemua në familjet e fshatit. Jemi klubet „17 Nëntori“ me 4 veta, „Dajti“ me 4 veta, „Skëndërbeu“ me 2 veta, „Labinoti“ me 3 veta dhe „Luftëtari“ me 2 veta. Dy ekipet e fundit janë pajisur keq, kurse korçarët kanë pak ushqime. Sot koha vazhdon të jetë e keqe. Bie mjaft shi.

### Data 26 shkurt

Xhixha dhe Genci janë të sëmurë ndërsa dy elbasanas nuk u paraqiten për nisje. Nisemi dhe çajmë borën edhe 30 minuta të tjera pasi dalim në Qafë të Bridashit. Koha është e vranët por me tendencë në kthjellim. Kthehemi poshtë në fshat dhe në ora 17:00 mblidhemi dhe vendosim që nesër të nisemi. Me ne do të vinë edhe dy elbasanas, ndërsa Pëllumb Bici do të kthehet sepse nuk ka këpuçë e çorape të përshtatshme për ngjitje.

### Data 27 shkurt

Nisemi më 06:15. Ecim mirë, sidomos Sokoli, Kujtimi dhe Genci. Arritëm më 14:30 në qendër të Livadhit të Bogëve ku ngritëm kampin. Dita ishte shumë e bukur, e qetë dhe e ftohtë. U lashë porosi të gjithëve të flejnë herët dhe të ngrihen kur të na bjerë dielli (dielli perëndoi më 15:30) (*Këtu dielli, për arësye të majave, del vonë e perëndon shpejtë*). Për ca kohë u morrëm me shkrirjen e borës dhe akullit për të siguruar ujë si dhe për darkën.

U shtrimë për të fjetur. Polisteroli e justifikon veten si shtrojë izoluese dhe veçuese e çadrës.

## Data 28 shkurt

U gdhimë pas një nate tepër të ftohtë. Asnjë çadër nuk pati qetësi gjatë natës nga i ftohti i madh. Në çadrën e korçarëve hyjnë për tu ngrohur një elbasanas e një gjirokastrit dhe më pas dolën. Aty ndizej kaminetoja hera-herës edhe gjatë natës. Në çadrën tonë fjetëm thujse ngrohtë (*ne si ekip kishim siguruar/prodhuar thasë fjetje me pëndë pate*), por këmbët i kisha vazhdimisht të ftohta. Natën dola një herë jashtë. Hëna ishte gati e plotë dhe natyra ishte një bukuri brilante por e ftohtë. Dielli në çadrat tona ra në ora 08:30. Në kamp tonë flitej vetëm për natën e akullit. Teksa filloi ngrënja e mëngjesit rezultoi që thikat nuk mund të prisnin bukën e ngrirë. Njëri ekip kaloi në variantin e coptimit të bukës me anë të goditjeve me kazëm (ndoshta edhe për humor), por ajo edhe kështu mezi copëtohej (*Me këtë temperaturë të ulët që parëm fatin e keq të ballafaqoheshim e dijkuptojaa që ekipet nuk kishin bazë material ta përballonin. Përvoja na kishte ballafaquar jo një herë me problematikën e pajisjes së ekipeve. Për arësye se prej vitesh isha anëtar i Komisionit Teknik pranë Federatës së Alpinizmit, isha në dijeni edhe për vështirësitë financiare të ekipeve lidhur me pajimet dhe veshjen*). Vendosa të ulemi poshtë. Marshimi filloi më 12:20. Koha po jepte shënja se do të prishej. Kalonin re pulpore. Në mbërmje mbërritem në fshatin Nikç. I ndamë të gjithë pjesëmarrësit nëpër shtëpitë e fshatarëve dhe i njoftuam që nesër do kemi pushim.

## Data 1 mars

Kohë me rreshje që filluan në mesditë. U mblodhëm në ora 11:00 dhe shëtitëm (për të "vlarë" kohën). Pamë mirë dyqanin e fshatit.

Fillon mërzi e përgjithëshme. Xhixha, Kujtimi dhe Themo janë ende të sëmurë. Sonia (Vilsoni) ka dhimbje të forta në mes që ja ka shkaktuar çanta e shpinës.

## **Data 2 mars**

Kohë me rreshje të shumta. Takohemi në dyqane e streha ku dhe kalojmë kohën.

## **Data 3 mars**

Kohë me rreshje por jo dhe aq sa dje. Unë, Dashi, Sokoli dhe Kujtimi shkojmë dhe shohim Musavadin që ka shpërthyer dhe që tani formon lumin e fshatit i cili fillon në rrëzë të malit të Shnikut. Musavadi është një ujvarë e bukur që ja vlen ta shohësh. Çova fjalë në ekipe që për nesër të përgatiten për ngjitje në malin e Shnikut. Ekipi i “Dajtit” e ka të parin e shtëpisë, ku është sistemuar, të sëmurë rëndë. Këtë e mora vesh pas mbasdites së gëzuar që kaluam në shtëpinë e Dodës me këngë e valle (Doda është vëllai i Martinit). Ne të Tiranës bujtëm në shtëpinë e Martin Llesh Smajlit.

## **Data 4 mars**

Në ora 07:00 e lamë fshatin dhe filluam ngjitjen. Nga ekipi “Dajti” erdhi vetëm Luani, nga gjirokastritët vetëm Sonia (*Vilson Kore*), por pa i mbushur dy orë ngjitje, ky i fundit dhe Rapushi, pa na thënë gjë, u kthyen. Tek arritëm aty ku ndan rruga për Dobraçe dhe për Livadh moti u prish keqas. Vendosëm të kalojmë në Livadhin e Bogëve, si më afër, dhe pasi gjetëm gjurmët tona, nëpër një kohë të keqe arritëm deri në shpat të malit të Forcës së Kelmendit. Koha mbeti e keqe. Kur ramë në fshat i bëmë një vizitë Dedushit. Ishte më mirë.

## Data 5 mars

Ngarkuam kafshët dhe në ora 09:00 lamë fshatin. Dukej që moti nuk do na lejonte për të realizuar ngjitjen. Në mesditë ishim para hotelit në Tamarë. Lajmërova Shkodrën që jemi në pritje për mjet transporti. Nga therrjet që po bëheshin aty Dashi rregulloi për ne një qingj të vogël. Fatmirësisht na dhanë të brendëshmet e dy qingjave. Në ora 14:00 takuam ish alpinistin e ekipit tonë Fatos Idrizi, i cili punonte aty si Operativi i Kelmendit (*pozicion shtetëror mjaft i rëndësishëm për kohën*). Nën emrin e tij dhe mishrat që poqëm kaluam një darkë të mrekullueshme tek shtëpia e Markut (magazininier i sektorit të tregtisë). U mbledhëm aty sepse ai kishte televizor dhe ne ishim përgatitur që gjatë darkës do të shikonim ndeshjen Juventus – Barcelona. Në TV nuk shihej thuajse asgjë. Në darkë erdhi edhe vëllai i Markut, Prela, i cili ish shumë i bisedës aq sa nuk të linte rradhë për të folur.

## Data 6 mars

Fatosi na nxori në Qafë të Prodolecit. Drekuam në mensën e sharave. Me kamionat që ngarkoheshin aty u nisën për në Bajzë ekipet e “Dajtit” dhe “Labinotit“. Ne të tjerëve na u vonuan makinat. Vetëm dy korçarë patën guximin të nisen për në Bajzë në orën 17:30. Këtu në qafë Prodolecit Dashi bleu mish me të cilin kaluam darkën në dhomën që kishte Fatosi në Tamarë. Jo një herë më ka ndodhur që teksa e kam kaluar kohën në një familje fshati gjatë orëve apo ditëve me mot të keq kam mbledhur fjalë të rralla për veshin tim, etj., nga fshatarët. Këtë rradhë gjatë ditëve me shit ë veprimtarisë mbledha fjalë gjatë bisedave me Martinin. Gjithashtu mbajta shënim edhe për gatimet si më poshtë të zonës së Kelmendit.

- *Punimi ose gatimi i jardunit:*

Tamli (*qumështi*) i porsa mjelë kullohet në garzë. Vendoset në një enë, i hidhet kripë sipas dëshirës dhe vendoset në zjarr të ulët duke e trazuar vazhdimisht dhe duke e trokitur lugën në fundin e enës. Kur trokitja fillon të japë tingull të “trashur” d.m.th se gatimi është gati. Masa nuk duhet të shkojë deri në vlim sepse dëmtohet. Pasi fiket zjarri masa duhet të trazohet edhe për ca kohë. Pastaj hidhet në porcione. Hahet kur është e ftohtë.

- *Mishavina (Djath mishevinë)*

Tamli i sapomjelë, i pavluar e i pa skremuar zihet djath. Djathin e kullon duke e lënë një ditë në plugë e pastaj lihet për 10 ditë në tharje. Këtë djathë e shtypim sa ma mirë në një enë. Hidhet në të kripë e hollë si në gjellë (si sasi). Ky djath shtypet dhe rrafshohet në enë. Merret yndyrë e tretur dhe hidhet mbi djathin e shtypur duke krijuar një shtresë mbi të. Pasi ftohet gjalpi, nëse krijohen plasaritje në sipërfaqen e tij, i hidhet përsëri yndyrë që të mbulohen plasaritjet. Kështu djathi rron gjatë pa shëllirë. Është mirë të punohet në muajt shtator e tetor dhe të hahet jo para një muaj nga përgatitja si më sipër.

**Shënim:** Djathi shtypet (presohet) pasi thërmohet duke e patur pranë zjarrit. Nuk duhen lejuar plasaritje ose çarje në djath sepse në to ai zë myk, i cili kur e ha të jep djegësirë në fyt (pak djegësirë ja vlen, por nuk duhet të jetë e tepruar).

- *Gjellë mishevinë*

Hidhet mishevina në enë. Shtojmë pak ujë dhe e përziejme vazhdimisht me lugë druri në zjarr. Sapo të shkrihet hidhet miell misri duke e përzierë deri sa të gatuet (mund të lindë



nevoja të shtohet ujë). Gatimi përfundon kur i del yndyra sipër dhe bëhet masë viskoze. Ndahet në porcione.

- *Djath i zier – Mbreti i Sahanave*

Merret qumësht i sapomjelë, i pavluar dhe i paskremuar. E zëmë djath. Përzihet, gjatë zënies, ngadalë sipër zjarrit në mënyrë që të mos kalojë yndyra në hirrë. Kur i del hirra, djathi hidhet në kullësë (plugë) dhe lihet aty 12 orë. Më pas vendoset në një enë ku e lëmë dy ditë. Gjatë këtyre dy ditëve ky djath merr pak thartirë. Ky process bën që djathi të fitojë elasticitet gjatë gatimit dhe ngrënies.

- *Gatimi me djath të zier*

Në një enë vendosim deri dy litra ujë që e ngrohim deri në vakje. Pas kësaj hidhet gjalp (sipas dëshirës) dhe vlohet. Këtu hedhim miell misri duke e trazuar (hedhim edhe kripë) deri sa masa e formuar të trashet. Djathi thërmohet më vehte. Heqim enën nga zjarri duke e lënë pranë tij. Hedhim në enë djathin e thërmuar dhe vazhdojmë përzierjen deri sa djathi të shkrijë. Sipas dëshitës i hidhet edhe sheqer. Hidhet në porcione dhe hahet i vakët.

**Paragjykim:** Kur stojnicës (guzhinjeres) i derdhet qumshti teksa pret që ta vlojë atë, në atë zjarr hidhen 2-3 kokra kripë në mënyrë që bagëtisë së këtij qumështi (të derdhur) të mos i ndërpritet qumështi.

*Mbajtës i ditarit dhe shënimeve, Aleksandër Bojaxhi*

## Aktiviteti veror i kategorive të dyta;

3- 12 korrik, 1986

Pjesëmarrësit:

1. Dashamir Fejzo Komandant i ngjitjeve (mbajtës i ditarit)
2. Sokol Doko Komandant toge
3. Artur Shehu Alpinist
4. Ylli Hoxha Alpinist
5. Gazmend Zajmi Alpinist

### Data 3 korrik

Rreth orës 14:00 në këtë datë ndodhemi në Shkodër. Ekipet “Dajti”, “Labinoti” dhe “Apollonia” erdhën në ora 23:00 me trenin e dytë. Fillojmë të kërkojmë hotel por nuk gjejmë. Drejtuesit e fizikulturës në Shkodër kanë marrë telegramin tonë pesë ditë më parë dhe nuk e kanë vënë ujin në zjarr. U bëmë presion duke u thënë se do të shkojmë në Komitetin e Partisë. Pati rezultat dhe na rregulluan në një konvikt.

### Data 4 korrik

Të gjithë ekipet në ora 07:30 ishin tek agjensia e autobusave. Erdhi dhe Kreshniku, inspektor në Komitetin e Fizikulturës, i cili u përpoq shumë që të sigurohej transporti ynë. U desh ndërhyrja e Komitetit Ekzekutiv që të sigurohej një autobus 42 vendësh, i cili do na çonte deri në Fushë të Okolit. Arritëm atje në ora 17:00. Filluam të ulim çantat dhe pas pesë minutash filloi një shi aq i rrëmbyer sa na u desh të shtrydhim veshjet e të fillojmë tharjen kur ndezëm zjarrin.

### Data 5 korrik

Kemi vendosur që të presim deri ora 11:00 për ndonjë makinë që të na çojë deri në Thore, por për fat të keq nuk erdhi asnjë

makinë. Shiu nuk pushonte dhe vazhdoi deri në ora 18:00. Pas kësaj ore dolëm dhe ndezëm zjarrin për tu tharë. Të shohim se çfarë do japin lajmet në radio për motin.

### **Data 6 korrik**

Zgjohemi të gëzuar sepse parashikimi i motit i dhënë mbrëmë doli. Më ora 07:00 filluan përgatitjet për marshim, jo drejt Shtegut të Dhënve por për në Qafë Thore. Arsyja është se në Shteg, si fshatarët edhe Gëzin Oruçi, na thanë që nuk ka ujë. Na u duk çudi por e besuam. Tek liqeni në Qafë Thore arritëm më ora 12:00. Urdhërova që të ndalonte marshimi dhe duke marrë vetëm komandantët e togave u nisëm drejt Shtegut për të verifikur nëse vërtet nuk ka ujë (burimi). Mbritëm tek Shtegu dhe pamë që aty kishte shumë ujë. Unë kam qënë këtu në 5 a 6 veprimtari dhe nuk më kishte rastisur të shihja kaq shumë ujë. Shkuam në Thore dhe rifilluam marshimin. Ngritëm kampin në Shteg dhe udhëzoja që nëpërmjet lugjeve të druja që ishin aty të mundësonin sjelljen e ujit sa më pranë kampimit. Njoftova edhe ekipet e Vllaznisë, Partizanit dhe Labinotit që të mblidheshin këtu. Në darkë ndamë togat dhe caktuam vendet ku do të punonim (ngjiteshim) nesër. Ramë në gjumë nga ora 22:00.

### **Data 7 korrik**

Zgjohemi me kohë të mirë dhe të gjithë janë me moral të lartë. Rrjeshtohemi duke kryer të gjitha rregullat si: paraqitjen e forcës, kontrollin e bazës material, etj. Në orën 08:20 nisemi për ngjitje. Do të kryejmë nga dy ngjitje; çdo dyshe ose treshe. Në kamp nuk lamë asnjë alpinist ngaqë këtu jemi vetëm ne alpinistët. Ngjitjet e para u mbyllën në orën 12:00. Të dytat filluan në orën 14:00 dhe mbaruan më 17:00. Kthimi në kamp në orën 18:00. Në darkë rreth zjarrit me trungje pishe dhe me dy radio: një të “17 Nëntorit” e një të Fierit (“Apollonia”).

## **Data 8 korrik**

Parashikimi i kohës për ditën e sotme, sikundër u dha mbrëmë në radio, do të ishte i mirë, por për fat të keq atyre që merren me këtë punë, metereologëve, nuk u doli gjë për arsye se në orën një të natës filloi një “shi për kokrrën e shiut”, i cili pushoi në orën 11:00. Kjo situatë u bë pengesë për të kryer dy ngjitje. Në ora 12:00 moti u hap plotësisht dhe pasi hëngrëm u nisëm për ngjitje të kategorive 3, 4 dhe 5 të vështirësisë. U kthyem në kamp mbas orës gjashtë. Darka kaloi rreth një zjarri të madh.

## **Data 9 korrik**

Ngrihemi më 06:30 dhe në ora 08:00 nisemi për tek shkëmbinjtë. Koha është e mirë por pak e ftohtë. Sot do të punojnë të VI-të tek I-8-ta Agimi e Luani të ekipit „Dajtit“ dhe tek I-B Sokoli me Arturin, të dy të ekipit tonë. Mbas dyshe tonë në I-B u futën Agroni dhe Alberti të “Apollonisë”. Të gjithë punuan shumë mirë. Të tjerët punuan ngjitje të shkallëve të IV-ta dhe të V-ta. Mbasdite koha u prish keq dhe nuk ishte e mundur për të realizuar ngjitje të tjera. Gjatë këtyre ditëve ne na ka gatuar Ylli, i cili nuk ka përtuar. Si ndihmës ka patur Gazmendin.

## **Data 10 korrik**

Mëngjesi i kësaj dite u gdhi i ftohtë dhe me mjegull të dendur, e cila mbajti deri në orën 11:00. Kishte mendime të analizonim shpejt e shpejt veprimtarinë dhe të uleshim në Bogë, po unë ngula këmbë që të prisnim se mos hapej koha dhe vërtetë kështu ndodhi. Koha u hap dhe doli një diell që të përvëlonte. Vendosa që t’i nis për ngjitje për të vetmen arsye sepse ka alpinistë të cilëve u duhen ngjitje të vështirësisë së VI-të. Të tilla sot realizuan Arturi dhe Sokoli tek I-8-ta, Agron Shehu e Albert Isai po tek I-8-ta; Agim Muça dhe Luan Rredhaj tek I-B-ja. Të gjithë këta punuan

shumë mirë. Të tjerët punuan tek itinerarët I-1, I-2, I-6, dhe I-10. Darka kaloi rreth një zjarri të madh.

### **Data 11 korrik**

Zgjohemi dhe përgatitemi për udhëtimin e kthimit. Mblidhemi dhe bëjmë analizën e veprimtarisë. Fola unë si drejtues i veprimtarisë dhe nga një përfaqësues për ekip. Në ora 09:00 nisemi për në Fushë të Okolit ku na mori autobusi dhe na çoi në Shkodër.

*Mbajtësi i ditarit, Dashamir Fejzo*

### **Livadhet e Bogëve (Liqen)**

**18-27 korrik, 1986**

Pjesëmarrësit:

1. Aleksandër Bojaxhi (mbajtës i ditarit)
2. Dashamir Fejzo
3. Ilir Tapia
4. Mazllëm Feka
5. Sokol Doko
6. Ardian Kurti

### **Data 16 korrik**

Arritëm në Shkodër. Dashi dhe Sokoli kanë ardhur që paradite. Ne të tjerët në darkë me dy orë vonesë. Fjetëm në hotel Adriatik pasi mbaroi Dashi grindjen me hotelxhiun në orën 01:30.

### **Data 17 korrik**

Me autobus arritëm në drekë në Tamarë. Shofer ishte Nuri Kopliku, njeri i bisedave i cili ndonëse kishte përfunduar

shkollën pedagogjike (për mësuesi) kishte përfunduar shofer. Rugës na kontrolluan (*policia*) dy herë. Këto kontrolle ishin jo vetëm të zgjatura por edhe të bezdisëshme. Kur po zbrisnim Leqet e Hotit takuam Fatos Idrizin, i cili po shkonte në Shkodër. Në Tamarë gjetëm një Zetor (*lloj kamioni buqësor*) që shkonte për Nikç. Ngarkuam aty materialet dhe u nisëm më këmbë para se të nisej mjeti. Arritëm kohë para Zetorit, i cili arriti më 20:30. Para nisjes, në Tamarë zuri një shi i madh i cili pushoi kur ne u nisëm dhe pas kësaj nuk ra më.

### **Data 18 korrik**

U nisëm për tek liqeni. Karvani me kafshët e barrës u nis më 12:00 mbasi nuk po binim në ujdi për çmimin. Kur arritëm sipër filloi shi, fillimisht i lehtë e më pas i dendur. Çadrat u ngritën dy palëshe: në stan dhe tek liqeni. Si ekiye jemi ne, gjashtë pjesëmarrës, “Dajti” me 3 veta, “Skëndërbeu” me tre 3 veta, “Luftetari” me 2 veta dhe “Labinoti” me 3 veta. Ky i fundit erdhi me vonesë sepse donte të kalonte me grupin tjetër në Qafë Pejë. Koha është e keqe. Mbasdite koha u bë disi e mirë dhe djemtë u nisën për të kryer ngjitjet. Ka ngjitje rrëzë majës së Thatë (gërdhata) e të piketuara (*d.m.th. të shënuara me bojë që tregon se ku duhej të fillonte kacavarja*).

### **Data 20 korrik**

Kryhen ngjitje në të njëjtin vend, por sot alpinistët kryen nga dy ngjitje. Një e V-të është e bukur. Të tjerat janë pa vlerë. Një itinerar i menduar për ngjitje të shkallës së VI duket i paralizueshëm. Moti në drekë ishte me shi.

### **Data 21 korrik**

Ngjitjet kryhen po aty. Unë shoqërova dyshet dhe treshet e alpinistëve që do të ngjiteshin në atë pjesë të malit të Rrushkullit

që është pranë kampit që e patëm ngritur në vitin 1982. Itenerarët aty janë piketuar nga ekipi i Kukësit. Sokoli e Mazi realizuan I-1 të shkallës së V-të të vështirësisë, e cila ishte mjaft e bukur por e shkurtër. Aty janë të mirë edhe itenerarët I-3 dhe I-4 por edhe këta janë të shkurtër. Në drekë fillon përsëri shi dhe në kamp u kthyem të lagur.

### **Data 22 korrik**

Sot shoqërova tre dyshe për tek Rasa e Bardhë, pranë Kampit që ne patëm ngritur më 1982 për ngjitje të shkallëve të VI-ta. Shkëmbi ishte shumë i lagur, andaj alpinistët i futa në një itenerar të shkallës së vështirësisë së V-të, në shkëmb “të thatë”. Dy dyshet tona sot punuan bukur në Qytezën e Kelmendit mbi liqen (Maja e Bukur). Iliri (në litar me Ardin) u lodh më shumë sepse në fillim punoi më pranë qafës, por meqë për të avancuar më tej nuk kish vend për plenga, Dashi e urdhëroi të ulej. Po aty Koli me Mazin morën itenerarin tek guva, e më tej lart tek pisha, e prej aty përsëri lart deri në majë (vështirësi e VI-të). Pas tyre hyri Iliri me Ardin, por kur dolën tek pisha zuri shiu dhe Dashi i udhëzoi të kalojnë nga e djathta (kategoria e V-të e vështirësisë). Mbasdite vonë Koli e Mazi u nisën për në Nikç. Nesër e kemi pushim. Sot unë u laga më tepër se çdo ditë tjetër. Shoqërova tre dyshe për tek të VI-tat si më sipër.

### **Data 23 korrik**

Sot në mëngjes edhe Iliri u nis për tek Dedushi në Nikç. Djemtë e kalojnë kohën në liqen. Unë Dashi e Kozmai shkuam tek stanet e Kllogjes. Synimi im ishte që të afrohesha tek itenerari jugor i majës së Arapit për të parë se mos Taxhedini fuste ndonjë dyshe për ngjitje aty. Meqë koha përsëri u vrenjt dhe nga Thethi

ngriheshin re si nga një kazan gjigant avulli (edhe dje si Tirana dhe Prishtina dhanë parashikim për mot me shi në mesditë), mendova se atje nuk do ketë ngjitje. Për më tepër edhe barinjtë na thanë se nuk kanë dëgjuar që ngjiten, kurse “vjet po”. Tek stani hëngrëm bukë dhe kos që na nxorrën barinjtë dhe u larguam. I punuam të dy rrugë-kalimet lart e poshtë (Klllogje-Livadh). Si zakonisht në ora 19:00 përcaktuam ngjitjet për nesër. Ushqimi shumë i mirë.

### Data 24 korrik

Për sot na u prishën të gjitha planet. Mbrëmë në orën 20:00, pas disa rrotullimesh buzë liqenit, u ul një helikopter. Nga ne pati supozime të ndryshme teksa helikopteri po fluturonte pranë nesh. Në manovrat e tij lart e poshtë, na kapi syri brënda në helikopter Gëzim Oruçin. Kjo tregonte se ishte problem alpinistash. Era e elikës na morri dhe na shpërndau tërë fletëshpjegueset dhe fletoret që kish pranë Kozmai (*ishin formularë ku hidhej veprimtaria dhe në mbyllje të saj dorëzoheshin në Federatën e Alpinizmit*) si dhe i përmbysi pjatën me makarona që po hante. Piloti u ul dhe me shumë frikë lëvizi gurët nën slitat nga shqetësimi se mos i përmysej helikopteri nga ana e bishtit. Nuk më la t'i shkoja pranë por erdhi ai tek unë.

- Ku janë ata që kanë mbetur? – pyeti ai
- Nuk dimë gjë. Si është puna? – ju përgjigja
- Kanë mbetur alpinistë në Arap – shtoi ai
- Ne nuk dimë gjë!
- A do të vish të na trgoth Arapin?
- Vij!
- Po nuk e gjetëm do të të ul në Shkodër.
- Jo! Nuk vij! (I thashë kështu sepse unë e lashë Arapin të mbuluar me re dhe përderisa nuk e gjenin me Gëzimin



brënda në helikopter, mua më mbetej që vetëm të shkoja në Shkodër me atë farë veshje që kisha. Dhe kot së koti!)

Ndërkohë në çast u hodh dikush e tha se vinte ai. Por piloti në vend e ktheu mendjen që të merrte një nga ne dhe iku. E gjithë kjo na shqetësoi. Nisëm për në Qafë Pejë Ilirin, Sokolin, Luanin, Mazin, dhe Gencin (Genci Lika). Detyra e yre ishte të sqaronin situatën dhe po të ishte nevoja të punonin dy dyshe, përkatësisht Sokoli me Mazin dhe Iliri me Luanin. Genci duhet të kthehej një orë e më parë dhe të na sqaronte situatën. U nisën më 20:30. Sot, deri në ora 14:45 Genci nuk ishte kthyer. Po sot, pra dt. 24, nisem unë, Sokol Hoxha, Ardi dhe Nardi (Leonard Rama) për në Rrethin e Vishnjës (*sot quhet Qafa e Arapit*) që të mësojmë ndonjë gjë. Sapo kaptuam pamjen e liqenit dëgjuaam të thirrura nga poshtë. Kish arritur Genci. Zbritëm.

Ja çfarë thanë ai dhe Iliri:

“Arritëm në Postën Kufitare Verore më ora 23:30. Kufitarët pas një hezitimi na futën brënda dhe fjetëm deri ora 04:00. Ata na thanë se “alpinistët janë tek Qershitë (Kroni i Shtrazës). Kanë mbetur alpinistë në Arap por njërin e kanë nxjerrë (*ulur*). Erdhi helikopteri por nuk bëri gjë.” Me vrap u ulëm tek Qershitë. Sapo arritëm po nisej Taxhedini me çantë për tu lëshuar ushqime nga lartë. Na priti shumë ftohtë dhe nuk na sqaroi gjë. Tek çadrat kishte një rehati të habitshme. Kishin filluar ngjitjen (në faqen jugore të Arapit) Besnik Kica dhe Xhevairi i Burrelit (*Xhevair Bozaxhiu*) më datë 21. Besniku (*mbasi ishte ngjitur deri diku*) nuk kishte mundur të avanconte më tej. Më datë 22 kishin hedhur litar nga sipër (*alpinistë të kërtij grupi*). Litarin e kishte kapur Besniku, kish marrë edhe litarin e dyshes (litarin me të cilin ishin lidhur të dy alpinistët

Besnik e Xhevair) dhe si kovë pusi e kishin ngritur lart. Ata sipër (*ata që tërhiqnin litarin*) ishin habitur që doli vetëm njëri lart. Pas kësaj, Lazja (Laze Rajta), trajneri i ekipi të Burrelit, kishte vajtur në postën kufitare, ishte lidhur me Nenkryetarin e Degës së Punëve të Brendëshme të Shkodrës dhe i kishte thënë, ndër të tjera, se “po nuk erdhi helikopteri deri nesër, alpinisti vdes.” Në kamp ishin keq me ushqime dhe sot ishin nisur për t’i hedhur Xhevairit ushqim nga lart. Në kamp nuk kishte atmosferë të këndëshme ndihme dhe gatishmërie. Xhevairi kishte ngrënë në mëngjesin e datës 21 korrik dhe çanta me ushqime i arriti në ora 10:30 të datës 24 korrik. Ne pritëm deri sa Sokoli me Luanin arritën tek Xhevairi dhe pas kësaj aty arriti nga lart çanta me ushqime. U nisëm për (*këtu*) tek ju më 10:30.”



Alpinisti Genci Lika

Thëniet e Gencit dhe Ilirit na qetësuan. Nuk kishte aksident, por edhe u indinjuam ngaqë nuk kishin kërkuar ndihmë nga grupet e tjera të alpinistëve. Indinjues ishte edhe fakti që Besniku ishte ngjitur lart pa Xhevairin si dhe i kishte marrë edhe litarin. Po ashtu indinjues ishte edhe qëndrimi i alpinistëve në kampin e Qershive (!).

Aty nga ora 15:30, kur tashmë të gjithë ishim të qetë se nuk kishim patur aksident dhe nga ne nuk do duhej ndonjë ndihmë tjetër, Kozmai u propozoi alpinistëve që, sipas dëshirës, të kryejnë ngjitje të shkallës së tretë ose të katërt të vështirësisë. Dy a tre grupe u nisën.

Më 19:30 u kthyen Luani, Mazi e Koli. Nga ata mësuam se për një orë e 30 minuta ata kishin arritur tek Xhevairi (rreth 4 litare kacavarje) të nisur nga poti. Tek ngjiteshin Xhevairi u kërkonte bukë (*ushqim*). Kur e takuan mësuam se ai kish ngrënë mëngjes të dobët më datë 21. Ai kish ndënjur në guvën e traversës së tretë me gjysëm pagure ujë dhe cigare (!). E gjetën me pak ujë e pa cigare. Kur ishte hedhur litari nga lart, Besniku i kishte kërkuar që ai t'i lëshonte litarin sa të kapte litarin e hedhur nga lart dhe pastaj kishte ikur duke u lëkundur me gjithë litarin e dyshes. Litari i hedhur nga lart nuk arrinte tek Xhevairi dhe ai kish mbetur pa litar kolektiv por me 2-3 litare personale.

Kishte vendosur që me to sot të tentonte të zbriste por ishte i pafuqishëm. Pinte ujë nga pak dhe tymoste. Me fije bari bënte natën ndonjë zjarr të vogël. Ishte tepër i indinjuar por trim dhe kurajoz. Do të martohej në shtator. Kolit dhe Luanit u ofroi ato dy gishta ujë që i kishin mbetur. Sokloi dhe Luani nuk kishin ushqime. Të pestë alpinistët e grupit tonë u nisën mbrëmë me bukë në dorë duke e ngrënë darkën rrugës (*atë që ende nuk e kishin ngrënë*). Sot në mëngjes në postën kufitare verore ushtarët u kishin dhënë në orën katër të mëngjesit bukë

e marmalatë dhe çaj. Në kampin e Qershive askush nuk i dha asnjërit për të ngrënë. Lazja (trajneri i Xhevairit) u kish thënë se i kishin vjedhur ushqimet (!). Ai e kalonte natën tek Rrethi i Vishnjes duke i dhënë kurajo Xhevairit. Ishte krejt i ngjirur nga zëri. Çanta e hedhur nga lart kishte bukë, 1/3 kavanozi me reçel dhe një copë djathë. Brënda në bukë ishte një letër e Taxhedinit të cilën Xhevairi nuk deshte ta lexonte dhe e morri Luani (kish edhe cigare). Xhevairi donte të hante por nuk mund të hante. Ja hodhën (*me litar nga lart*) ujin në reçel dhe diçka piu.

Filluan ta ulin. Ulja zgjati pesë orë. I fundit ulej Sokoli i cili na thotë se është lodhur shumë nga krahët duke ulur (Xhevairin) e duke ngritur litarët. Tek u ulën, poshtë i prisnin Lazja, Taxhedini e Mazi ynë (që priste Sokolin e Luanin që të ktheheshin bashkë në kampin tonë). Kur u ul Xhevairi, ai ja dha dorën Mazit, por jo Taxhedinit. Të gjithë alpinistët e tjerë rrinin në çadër! Si nuk ishin kuriozë të takonin këtë njeri që qëndroi katër ditë e tre netë në shkëmb!? Si nuk ishin kuriozë të shihnin se si këta djem (të ardhur nga një kamp tjetër) do të realizonin zbritjen e shokut të tyre të grupit!?”

Sokoli, Luani e Mazi (pa marrë as ujë për të pirë) u nisën për tek kampi ynë. Në Killoqe ishin ndalur në stan dhe barijtë u kishin dhënë për të ngrënë e për të pirë. Na bëri përshtypje që ata na folën mjaft mirë për Xhevairin: djalë bujar, trim dhe me karakter edhe në ato orë që kaluan bashkë nga takimi tek shpella e deri në zbritjen poshtë. Si çdo natë deri më 22:00 e kaluam tek zjarri. Tani vetëm një radio po punon, nga e cila vjen një muzikë e lehtë dhe e bukur. Gjirokastritët janë ekip që këto netë të ftohta i kalojnë të veshur dhe me mbulesa të vajtueshme (*ata nuk kanë patur pajimet e duhura për të kaluar natën në këto lartësi*).

## Data 25 korrik

Dje në ora 17:00 Pëllumb Bici uli Kujtim Ibrahimin deri tek gatra e Vuklit sepse kishte dy ditë me kriza të apandësitet. Me vështirësi i mbushën mëndjen që të ulej. Me sa duket ai e ka frikë operacionin. Sot Koli, Mazi dhe Luani bënë pushim. Iliri me Ardin ngjitën me sukses itenerarin e shkallës së VI-të të vështirësisë që realizuan në datën 22 nga Koli me Mazin. Mora Kolin dhe me të shkova tek rasa e itenerarëve të shkallëve të VI-ta të vështirësisë. Më pas ndoqa ekipet e Korçës dhe Elbasanit në ngjitje tek rasa e itenerarëve të shkallëve të IV-ra. Mbasditen e kaluam qetë. Dje kishim motin më të mirë, kurse sot dolën re. Tani sapo më solli Koli bidonin me qumësht. Është e treta ditë që ka dalë këtu me bagëtitë kooperative e Gruemirës dhe për çdo ditë na sjellin pesë litra qumësht. Koli ka zënë mik dikë në stan.

## Data 26 korrik

Ekipi ynë me kërkesën time u nda në dy grupe. Iliri me Ardin do t'i afroreshin majës së Livadhit nga Qafëkuja. Këta u ngjitën djathtas dhe u kthyen nga shtegu i këmbësorëve. Dhanë mendimin se ana veriore e malit është e vështirë për ngjitje dimërore. Sokoli, Mazi dhe unë u ngjitëm tek maja e Arushës. Prej aty nëpër kreshtë u afruam pranë majës së madhe. Koli e Mazi u ngjitën. Zbritëm nga ana perëndimore (prej andej ngjitesh më thjeshtë, si në majën kryesore ashtu edhe në atë pranë Qafëkuqes). Prej aty dolëm në Qafëkuqe e pastaj në Livadh dhe u ulëm tek liqeni. Pak të lodhur, shumë të pjekur nga dielli. Dashi ndënji me Kozmanë.

## **Data 27 korrik**

Dje u bë analiza e veprimtarisë. Sot filloi shpërngulja. Ne dhe „Dajti“ u kthyem nga shtegu i Bogës (Okol). Me ecje normale nga liqeni deri në qendër të Bogës nuk duhen më shumë se gjashtë orë.

*Mbajtës i ditarit, Aleksandër Bojaxhi*

# VITI 1987

15-26 shkurt, 1987

## Data 15 shkurt:

Udhëtuam për në Kukës nga Tirana me autobus. Kukës – Fierzë e bëm me anije dhe shumë pak në këmbë ndërsa Fierzë-Bajram Curri përsëri me autobus. Gjatë udhëtimit për në Kukës ndalëm në Rubik dhe blemë 15 shishe verë që ishte e mrekullueshme. Udhëtimi ishte interesant deri në Rrëshen ndërsa më tej bëhej monoton. Kjo ndoshta sepse rrugët tona nacionale duken si rrugë strategjike (ushtrie). Prandaj u përpoqëm që ta kalonim një pjesë të udhëtimit me gjumë, me aq sa mundemi. Pa hyrë në Gjegjan të bie në sy që pylli që shikon rrugës është prerë keqas, deri në “zero”. Gjegjan – Fushë Arës pamjet janë tërheqëse. Menduam të ndalojmë dhe të hamë drekë në Lajthizë. Më tej u zhytëm në mjegull e në re dhe grija e mjedisit ishte një monotoni që të lodhte me orë të tëra deri sa arritëm në Kukës.

Pasi zumë vend në Hotel Turizmi dolëm në qytet. Dyqanet ishin plot mallra të bukura, sidomos ato të veshmbathjeve. Vendosiëm të shkojmë në kinema. Shëtitëria kishte vetëm meshkuj të veshur me llojshmërinë e shtresës shoqërore por me

një unitet: të gjithë kokëzbuluar (me ndonjë përjashtim), me qafat të rrasura në pallto, apo nën jakat e ngritura nga të ftohtët që sot është i hidhur. Kur filloi filmi nuk ishim më shumë se 30 vetë. Dy oficerë kishin ardhur familjarisht dhe formonin dy hapësirat më të këndëshme të sallës. Pamë dy filma të rinj me metrazh të shkurtër. Skenarët ishin të “sforcuar”. Pamë heronj që duan të bëhen heronj. Ata sikur e dinë çdo gjë që do u ngjasë dhe bashkë me këtë edhe lavdinë që do të lënë pas. Janë patriotë të sajuar. Pas një ore filmat mbaruan dhe ne ishim akull të ftohtë. Dolëm dhe vrapuam për në restorant përmes një shiu të imët. Në resorant ishte një mjedis i këndëshëm. Darka e shijshme.

### **Data 16 shkurt**

Pasi shijuam nga një paçe e ca gjëra të tjera u nisëm për tek anija. Rrugë pa rrugë përmes baltës shkuam buzë liqenit të Fjerzës. I hipëm nga mundëm anijes (sigurisht nuk mund të mendohej për një skelë) e cila ishte një shëmtirë e palyer dhe që u nis në orën 07:30. Anija nga brënda ishte shumë më e pashme se sa nga jashtë. Më erdhi keq që ne, rreth 100 vetë, hymë aty me këpucët e rënduara nga balta e kuqe. Ne alpinistët udhëtonim për herë të parë në një anije. Dola jashtë për të soditur. Liqeni dukej i madh por i ndotur. Përreth mjegull dhe borë. Dukej sikur grija e natyrës sa vinte dhe bëhet edhe më ngjitetëse. Hyra brenda dhe u ula në një sedilje. Pas pak erdhi Dashi me gjysëm litër Raki Skrapari, të cilën ma dhuruan sot në mëngjes dhe unë ja dhurova Dashit. Nuk vonoi shumë dhe nga kuzhina erdhi një pjatë me peshk ballgjërë të gatuar. Përreth nesh u mblodhën dashamirës të rakisë dhe për rreth një orë mjedisi u gjallërua me biseda. Tashmë në liqen shfaqeshin “ishuj” akulli dhe nga jashtë vinte zhurma e ballit të anijes që godiste këta ishuj.



Nuk vonoi dhe brenda anijes dëgjohej hera-herës thirrja “Artiku”! Në ndalesën e tretë të anijes hynë gjashtë burra mjaft të gjatë si dhe një vajzë. Gjatësia e burrave nuk ishte më tërheqëse se tërësia e vajzës: e veshur me triko e xhakëtë ku dominonin e kaltëra dhe bluja, pantallona kadife ngjyrë blu dhe e mbathur me çizme. Mbante në prehër një çantë shpine (ndryshe ranc), të vogël, ushtarake. Fytyrbardhë dhe me mimikë tepër të lëvizëshme bisedonte shpenguar me një djalë, deli djalë, që e kish në krah të majtë dhe që sa herë fliste, ai skuqej. Në të djathtë të vajzës ishte një burrë i moshuar i cili hera-herës futej në bisedë me dy të rinjtë. Në stacionin e fundit hyri në anije një djalë që u vendos midis meje e vajzës. Ishte, besoj, 15 vjeç. Më tërhoqi vemendjen me shkathhtësinë e tij të natyrëshme për moshën që kishte. Ai nderoi të njohurit që gjeti në anije. Nga ato copëza fjalishë që vinin në veshin tim, gjatë bisedës së tij me të njojturit, mësova se ishte nxënës shkolle me arritje akademike të larta. Fytyra e tij ishte me tiparet e tipave që të përcjellin skulpturat e antikitetit. Ky djalë, vajza dhe gjatoshët (ata diku zbritën nga anija) si dhe akulli i liqenit ishin elementët më interesantë të udhëtimit prej katër orësh Kukës – Fierzë.

Arritëm në Fierzë dhe zbritëm me ngut (ndoshta ngaqë katër orë udhëtim ishin shumë për udhëtarët në një natyrë gri dimri). Gjatë udhëtimit kishin hyrë më shumë udhëtarë nga sa kishin zbritur dhe anija ishte e mbushur së tepërmi. Sa dolëm nga anija morrëm rrugën (plot baltë) që të nxirrte sipër në digën e hidrocentralit. Pjesa më e madhe morrën të ngjiten në një pjerrësi me shkallë guri të lidhura me “shporta” teli që shërbenin si prita kundër shembjes. Kur arritëm në digë u gjendëm para një postblloku me dy ushtarë që shërbenin aty dhe nuk lejonin kalimin tonë deri sa të mblidheshin të

gjithë pasagjerët. Pasi u mblodhëm ata na lejuan të kalojmë në kollonë për një. Njëri ushtar na priu dhe një i dytë mbyllte kollonën. Pas dhjetë minutash ushtari i kreut ndali. Kishim arritur pikën ku do uleshim poshtë. Kaluam përmes kantjerit të dikurshëm të ndërtimit të hidrocentralit. Kishte shumë barake të cilat e kishin kryer prej kohësh funksionin e tyre. Kishte syresh të braktisura por për çudi kishte edhe disa funksionale të cilat formonin një mikroqendër banimi që po rilindte sikur ndodh pas një “bombardimi”. Nuk kishte rrugë, por monopate që lidhnin baraket mes tyre dhe që ishin kthyer në shtigje të pjerrta që nga mosmirëmbajtja dukeshin si shkaravina. Hekura e konstruksione metalike të plota apo të shtrëmbëruara e të spërdredhura, të ndryshkura dhe të hedhura. Barake të zbërthyera, barake të mbajtura dhe barake të harruara. Kish prej tyre me parrulla të axhitacionit të parties, me fjalë të plota por edhe me gjysma fjalish. Diku emra e diku data dhe të gjitha bashkë përshkruanin një histori të kaluar por edhe të re. Histori e re për ata që ishin vendosur me familje aty, për të “ngecur” aty, me synimin për tu larguar nga fshatrae e tyre të thellë e pa perspektivë ekonomike.

Erdhi një autobus në kohën që shiu u dëndësua. Se si do i merrte ky autobus rreth 100 vetë ishte e çuditëshme! Por ja që i mori! Ne u ngjeshëm aq shumë, sa unë nuk kisha parë apo përjetuar një ngjeshje të tillë në 44 vjetët e jetës sime. Por tmerri për ne ishte kur në urën e lumit hyri në autobus polici për të na kontrolluar letërnjoftimet si dhe fatorino për të na prerë biletat. Ata thujse lëvizën mbi supe dhe koka njerëzish. U nisëm përsëri. Nga ngjeshja nuk arrita të shoh as qytezën e re të Fierzës dhe asgjë tjetër veç pjesë fytyrash të njerëzve që më rrethonin. Pas tre a katër ndalesave që bëri autobuzi për zbritje pasagjerësh e ndjeva veten që po qëndroja normalisht mbi dy këmbët e mija. Që nga çasti

që zbritëm nga anija e deri sa arritëm në Bajram Curri u deshën tre orë!

Sapo zbritëm u drejtova për tek Komiteti Ekzekutiv i qytetit por nuk gjeta askënd nga punonjësit e Fizikulturës apo të arsimit. U futa në seksionin e komunikacionit ku mësova se kishte përfunduar puna për hapjen e rrugës automobilistike për të shkuar në Valbonë. Në restorant të mbyste era e rakisë së kumbullës. Duhej vullnet që të duroje erën e rakisë që të mund të haje. Hëngra një turli me djathë!! Mbasdite na shoqëroi nëpër qytet vëllai i Nuredinit. Më pas u morra me kërkimin e nipit të Xhekut (Xheku, Efigjeni Kote, është shefja e zyrës së llogarisë në Klubin Sportiv „17 Nëntori“). Arrita të rregulloj që nga reparti ku kryente shërbimin ushtarak të ulej në qytet dhe t'i jepja letrat, lekët dhe pakot që ja dërgonin të afërmit.

## Data 17 shkurt

Dita ishte pa interesim nga pritësit për nisjen tonë. Vajta në Komitetin Ekzekutiv. Pas katër bisedave telefonike rezultoi se nuk është e mundur që të nisemi sot për në Valbonë. Andaj u nisa tek klubi i hoteli që të kaloja ca orë aty. Dje dhe sot duke lëvizur nëpër qytet mund të kem hyrë pesë herë në çdo dyqan. Por ja që në orën 11:00 ndërroi gjithshka lidhur me nisjen tonë dhe brënda 30 minutave ne ishim duke udhëtuar për në Valbonë. Shoferi, Shkëlzen quhej, për mungesë karburanti punonte 2 ose 3 ditë në javë. Teksa ne rrinim në klub ai mësoi për nevojën tonë për udhëtim dhe na propozon transportin për 1.500 lekë. Pasi na mori fjalën, ai u furnizua me 30 litra benxinë për 250 lekë dhe ne u nisëm. Arritëm në Valbonë në orën 13:30.



Panoramë nga lartësitë e majës së Roshit

Udhëtimi kaloi shumë mirë përjashtuar fundit ku një makinë zis nuk po lëvizte sepse i xhironin rrotat në borë. Personi në recepsionin e hotelit na priti fillimisht ftohtë sepse mungonte përgjegjësi, Mustafai. Buzë mbrëmjes ai arriti nga Bajram Curri (BC) me furnizime, bashkë me shefin e tregtisë së Bajram Currit, shefin e planit dhe ekonomistin. U rregulluam pasi kompletuam dhomat e zbrazta me batanie, dyshekë, etj. Shtrojet e mbulesat e hotelit po përdoreshin për të parën herë nga ne. Ishin të reja dhe ashtu sikundër duhet për Hotel Turizmin e Valbonës. Banaku i klubit ishte punuar bukur dhe ishte unik. Restoranti i mirë. Të tjerat “Mos o Zot!”. Punë e dobët në ndërtim, materiale difektose dhe personel i ngathët (ndoshta janë të habitur me këtë hotel).

### **Data 18 shkurt**

U nisëm në orën 06:30 për në malin e Roshit. Morëm itinerarin nga Qafa e Madhe e Valbonës. Fillimisht pati protesta të heshtura por më pas itinerari u pëlqye. Patëm kënaqësi kur

arritëm tek piramida kufitare (maja është kufi shtetesh) dhe gjatë itinerarit të ngjitjes hymë e dolën këndeje dhe andej kufirit. Koha nuk mbajti pasi u vrenjt dhe për 30 minuta ra borë. Por patëm edhe fat sepse kur na duhej të orjentohehim moti hapej. Gjatë kalimit nëpër pjesën kufitare patëm edhe kthjellim aq sa Vuthaj dukej shumë mirë por jo Gucia. Në rrugën e kthimit dy të tretat e alpinistëve u ngjitëm edhe në majën e Valbonës. U kthyem ora 15:00. Me postën kufitare nuk patëm shqetësime. Komandantin e Postës e takova mbrëmë në kohën kur na ktheu dokumentat (*si rregull, me paraqitjen tonë në zonën kufitare dorëzonim në postë letërnjoftimin dhe lejen kufitare*). Ai donte që ta njoftonim një ditë më parë se ku do të ngjiteshim pa të bënim ç'të donim. Pati shumë të lodhur (*kjo është normale sepse është dita e parë e veprimtarisë*). Në mbrëmje u bënë rregullime të tjera që lidheshin me akomodimin tonë në hotel. Kostoja e fjetjes është 80 lekë nata.

### Data 19 shkurt

Për ngjitje u organizuam me tre grupe, përkatësisht Poplluka, Boshi dhe Zhabore si dhe Peçmare dhe Qet Harushe. U futa me grupin e tretë. Moti që jo i mirë dhe bora të fundoste shumë. Në mbrëmje të gjithë më kërkuan që për nesër të bënim pushim.

### Data 20 shkurt

Ditë pushimi. Mbasi hëngrëm u nisëm për Rrogam. Dyqani kishte vaj ulliri (*kishte sepse fshatari kur ka gjalpin nuk para përdor vaj ulliri*), dy lloj pëlhura të bukura si dhe pulovra për të qenë. Kur u ktheva në hotel më të shumtën e kohës lexova. Sot mësova se në këtë hotel kënaqen më shumë jo ne që paguajmë fjetjen por ata që nuk paguajnë. Pra kënaqen personeli dhe ata që vinë këtu nga Bajram Curri dhe kanë një farë funksioni. Dhe këta kënaqen

sepse nuk paguajnë. Në darkë biseduam hollësi për ngjitjet nesër ndonëse parashikimi i motit nuk premtonte për ne.

### **Data 21 shkurt**

Thuaje gjithë ditën ka rënë borë. Më kërkuan në telefon nga Seksioni i Fizikulturës së BC, Cen Halki. Dëgjohej shumë mirë, pastër. Dita sot u “zvarrit” dhe mezi erdhi darka. Në orën 19:00 tek dhoma ku isha unë dhe dy skraparllinj u mbledhëm ca vetë. Më i riu prej tyre, Fitimtari, ishte dhe më i shkurtëri dhe i bëshmi midis tyre. Fytyrën e kishte paksa katrore dhe nga sa fliste e për mënyrat se si sillej e shprehej duket se ishte i kënaqur nga jeta. Shoku i tij, Bujari, kishte kryer Institutin Buqësor të Kamzës dhe ishte më i matur në komunikim. Në anën e djathtë të fytyrës, mbi sy, në vetull, hundë e në ball dikur, fatkeqësisht, ishte djegur dhe ngjyra e kuqe e lëkurës në këtë dëmtim se si më kujtonte fytyrën (turinjtë) e një dhelpre. Në dhomë bisedat më interesante bëheshin kur vinte Berti. Kishte një moshë me mua. Ishte tornitor dhe jeta e tij e sforcuar (ndoshta dhe abuzimet) e kishin konsumuar shumë. Thuhet se e mbanin në ekip pikërisht për fjalosjet e tij. Me pakë fjalë, ishte thyesi i monotonisë në ekip (e përse jo edhe për ne të tjerët) sidomos në periudhat e mërzisë. Për nesër parashikim i motit është premtues për ne dhe kam marrë masat për ngjitje.

### **Data 22 shkurt**

Është ora 18:30 dhe ka mbi 13 orë që bie borë pa pushuar. Çdo gjë është e zbardhur. Bardhësia dhe dëndësia e flokëve të borës që lëkunden gjatë rënies së tyre në tokë ndikojnë që të përjetosh një mjedis të fohhtë. Vetëm pishat e bredhat të përcjellin madhëshi dhe ashtu të veshur me borë të kujtojnë vajzën në ditën e martesës. Këto tre ditët e fundit kam bërë shpesh fizikulturë si në

tarracën veriore edhe në atë jugoren e hotelit si dhe kam lexuar.

Jashtë, nëpër monopetet mbi borë që lidhin midis tyre dyqanet dhe ndërtesat e qendrës, lëvizjet e njerëzve spikasin më shumë, po ashtu edhe ngutja e tyre në lëvizje. Ngushtësia e monopetit si dhe temperatura e ulët bëjnë që lëvizjet trupore të kalimtarëve të mos jenë të shpenguara. Lëvizjet e njerëzve sot më kujtojnë fluturimet e një zogu nga një strehë në një tjetër në kohë shiu. Tek kalimtarët shoh se më të rriturit janë të veshur më mirë. Fëmijët janë të veshur jo mirë ose ndoshta edhe keq. Bie në sy që fëmijët dhe adoleshentët janë të veshur edhe me rroba të mëdha për trupin e tyre. Ndoshta të rriturit që shkojnë edhe në punë për të siguruar jetesën janë më të kompletuarit e familjes me veshje. Megjithatë veshja e tyre nuk është funksionale për këtë klimë dhe të gjithë meshkujt janë kokëzbuluar. Gratë kanë shami ose shall mbi kokë. Klubi i hotelit (Hotel Turizmi Valbonë) ka një banak të bukur, bëhet kafe e mirë dhe çaj shumë i mirë. Kamarjerja është e shoqja e komandantit të postës kufitare. Këtë komandant e kam gjeur në lokal sa herë kam hyrë aty. Sot, për pak kohë ata, burrë e grua, u ulën në tavolinën fqinjë me mua. Ajo i serviri një çaj dhe u ul pranë tij. Ata janë, sikundër më duket, mbi e nën 30 vjeç. Janë dukshëm të pastër dhe të hekurosur dhe me gjuhën trupore të sjelljeve të tyre ata përcjellin dashuri tek njëri tjetri.

## Data 23 shkurt

Gjithë dita me dëborë. E mbusha ditën me lexime dhe pak fizikulturë. Mbasdite filloi të fryjë erë e fortë. Dritaret janë njëshe por me xhama të dyfishtë. I vura një batanije dritares dhe bëra shumë mirë. Kam harruar të shënoj se sapo arrita në Valbonë (dt. 17), meqë koha u hap e doli diell, bashkë me Ilirin shkuam tek shtëpia e Beqirit (30 min). Aty na priti e shoqja, Zonja (është motra e të ndjerit Ram Sadria). Burrat, Beqiri dhe Ibrahim, i

ishin ulur në BC për arësye pune. Ndër vëllezërit kishte mbetur vetëm Sherifi. U futëm në guzhinë ku na gostitën me kafe. U mblodhën aty edhe fëmijët. Ndër ta, Mirjeta ishte simpatike, e gjallë dhe e gjatë. Ishte në klasë të pestë dhe kjo gjë më kujtoi djalin tim të vogël, Hermesin. Pas pak u larguam. Sot Fitimtari na tregoi dy histori interesante që kanë ndodhur këto tre vitet e fundit pranë Çorovodës tek shkëmbi i Gradecit. Ky vend është pjesë e kanionit dhe shkëmbejtë janë rreth 50 metra larg njëri tjetrit dhe mbi 100 metra të lartë. Poshtë, pranë lumit është një shpellë e cila quhet Shpella e Pirogoshit.

• *Historia e pare:*

Një burrë i martuar nga një fshat aty afër që kishte dy fëmijë, në kohën që ishte me krizë nervore, hidhet në kanion. Nuk bie në lumë por ngecet në shkëmb dhjetra metra poshtë nga vendi ku u hodh. Për ta nxjerë u mblodhën tre alpinistë të ardhur nga Berati dhe katër nga të Çorovodës. Nga lart fillimisht ulen për ta nxjerrë një beratas dhe dy çorovodas. Organizimi nga organet vendore, policia dhe alpinistët, ishte i mirë. Ditën e tretë të përpjekjeve arritën të lidhnin kufomën dhe filluan ta ngrenë, por këputet litari dhe kufoma bie dhe ngecet në një pemë. Ditën e pestë të përpjekjeve kufoma u ndodh mbi shkëmbin ku dhe u hodh I ndjeri. Tani filluan peripeci të tjera. Kufomën e futur në arkivol e shpunë në fshat dhe donin ta varrosnin menjëherë. Kishte nga ata që mendonin se arkivoli nuk kishte brënda njeriun e tyre. Kishte nga ata që u vinte turp që njeriu i tyre kish bërë vetëvrasje dhe donin që të futej sa më parë në dhé, etj., etj., hamendje e thashetheme dhe hipoteza gjithfarësh. Tek e fundit arkivoli u hap: fytyra ishte dëmtuar fare pak kurse pjesa tjetër e trupit ishte një grumbull kockash. Familjarët u entuziasmuan që



panë njeriun e tyre dhe më tej çdo gjë rrodhi si për një vdekje të zakonëshme. I vdekuri u varros të nesërmen paradite me një ceremoni normale fshati.

• *Historia e dytë:*

Një burrë plak 90 vjeçar e tregon historinë në një dasëm në Pogradec ku merrte pjesë edhe një i ri nga Skrapari por me banim në Qytetin Stalin (*Kuçovë*). I riu kur vjen në Çorovodë ja tregon historinë të afërmëve të tij e këta Fitimtarit. Legjenda që tregoi i moshuari në dasëm ishte kjo: “Epiriotët e patën fshehur thesarin e tyre në Shpellën e Pirogosit. Ky thesar u fut në shpellë nga sipër dhe ju zu hyrja. Kështu që ky thesar nuk mund të merret më nga sipër, por duhet të merret nga poshtë. Nga poshtë, pasi hyn në shpellë dhe ecën ca, arrin në një koridor të madh i cili vazhdon më tej me tre degëzime. Rruga e mesit të çon në një dhomë të madhe që më rej ndahet, të nxjerr, në dy rrugë. Nëse merr djathtas kalon nëpër një pus e prej andej në një lumë. Përtej lumit është vendosur thesari”. Gojdhana përputhet me realitetet e sotme deri tek lumi. Fitimtari dhe dy shokë të tij janë betuar që të punojnë bashkë dhe të gjejnë thesarin, me qëllimin e mirë që pasi ta gjenë ta dorëzojnë në shtet dhe të marrin shpërblim. Ata kanë hapur 30 metra tunel për të dalë tek një hon ku ndjehet rrjedha e lumit. Kanë pesë vjet që punojnë cep më cep duke eksploruar lumin. E kanë aq seriozisht sa që për çdo fillim viti të ri marrin shpalljet e bankës kombëtare lidhur me kursin e këmbimit të arit në lekë.

Para dy vjetësh hyri në shpellë një plak 76 vjeçar nga Lushnja që kishte dëgjuar për legjendën. Kish hyrë me dy qirinj por kur mbeti, në kthim, pa ndriçim mbeti brënda. Hyrjen e tij në shpellë e kishin parë dy kushurinjtë të Fitimtarit që luanin rolin e rojes për

hyrjet në shpellë. Shkurt, pas pesë ditësh futet Fitimtari vet i tretë dhe gjetën plakun të gjakosur nga përplasjet në errësirë, i cili filloi të ulurijë i gëzuar nga që pa dritë dhe dëgjoi zëra njerëzish. Sapo doli jashtë ju sul manaferrave. Filloi t'i hajë me kokra e me kërcell dhe më pas ju sul ujit ku piu deri sa e hoqën prej tij.

Më pas, në një nga hyrjet për eksplorim të treshes, ata gjetën një burrë të thyer në moshë që kish ngelur brënda sepse kish mbetur pa ndriçim. Fati i tij për të jetuar ishte sepse kishte vetëm 24 orë brënda. Kur doli jashtë në dritë kujtoi se ishte mëngjes! Pra kërkuesit dhe njëherësh rojet e thesarit kanë shpëtuar dy jetë njerëzish.

## Data 24 shkurt

Koha u hap në mëngjes pas orës pesë. Fryn erë jo e fortë por e ftohtë. Në 06:45 i zgjova alpinistët. Pasiviteti fizik i këtyre ditëve me mot me rreshje i ka plogështuar të gjithë. Mensa, apo restoranti, hapet në 07:30 dhe kjo na vonon, por deri në orën tetë hëngrën të gjithë. Nisem përpara dhe lë Dashin me detyrë që të nisë gjithë grupin. Pasi lamë fshatin Rrogam kolona jonë morri formë. Synimi ishte ngjitja në majën e Rrogamit. Teksa fitohet lartësi bora fundoste gjithnjë e më shumë. Bora ishte e thatë dhe ishte ftohtë. Era me shkulme të vazhdueshme e ngrinte borën lartë dhe ta përplaste në fytyrë e trup. Ishte ftohtë, tepër ftohtë. Pas dy orë ecje nga 30 vetë që ishin fillimisht në kolonë mbetëm 19. Pas dy orësh të tjera ecje u tërhoqën edhe pesë alpinistë të tjerë dhe në Qafën e majës së Rrogamit u larguan edhe dy të tjerë.

Në qafë era dhe bora e thatë që të përplasej në fytyrë u bënë të tmerrshme. Na u desht që edhe të kacavaremi disa metra në shkëmb. Unë, por jo vetëm, jam pa doreza. Të ftohtët, era, duart e ngrira, pjerrësia e relievit, më pas edhe bora e ngrirë, ishin

lehtësira përpara erës së pandërprerë kur të përplaste në fytyrë borën e thatë. Metrat e fundit të ngjitjes u bënë me një ngutje të mirëfilltë. Tek e fundit u ngjitëm dhe menjëherë filluam zbritjen në anën tjetër të qafës. Në këtë anë na u duk se ishim në një botë të ngrohtë dhe të qetë. Diellit i ndiheshin vlerat pas atij sulmi nga qafa. Krutanët më dhanë një dorezë të djadhtë dhe mbas pak i ndjeva gishtat e mi. Teksa zbrisnim bisedohej dhe ndër të tjera mendohej se nesër në disa prej nesh duhej të shfaqeshin shënjat e ngrirjes.

### Data 25 shkurt

Ndënjëm pushim mbasi nuk arritëm të thahemi. Koha është e mirë dhe e ftohtë. Fitimtari më foli rrishtaz për shpellën. I shoqi i tezes (sot 87 vjeçar) i ka thënë se në hyrje të shpellës ka qënë një statujë, një kalorës mbi kalë. Ai kur ishte në moshën 17 a 18 vjeçare e ka thyer atë dhe e ka bërë copë-copë duke menduar që thesari është në të. Copat i hodhi në lumë. Ai dhe e shoqja dëshmojnë se përqark kalorësit ka patur statuja njerëzish. Këto statuja i kanë marrë banorët e zonës dhe i kanë vendosur nëpër varre(!?). *(tani që po hedh në kompjuter këto rrjeshta po mendoj: Po sikur këto skulptura të kenë qënë kështu sikur përshkruhen, çfarë vlerë turistike do kishin qënë ato stalagtite e stalagmite! Ato do ishin thesari!).*

Sot në darkë mësova se shtatë alpinistë nga ai mot i ditës së djeshme kanë shënja ngrirje në duar, këmbë e veshë. Për nesër jemi të gatëshëm 14 vetë për të synuar majën e Kollatës.

### Data 26 shkurt

Megjithse kam bërë gjumë të keq u ngrita në katër e tridhjetë. Në pesë e një çerek u nisëm. Koha është e mirë dhe e ftohtë. Tek stani pushuam dhe hëngrëm mëngjesin. Tashma na ra dhe

dielli. Dita është prallore, pa re, pa erë dhe me diell. Ecim plot kënaqësi përmes bardhësisë së borës që na rrethon ngado dhe me kaltërsinë e qiellit mbi kokë. Pak pas orës 08:00 na arrinë dy krutanë të nisur pas nesh. Tani jemi 13 alpinistë. Drejtimin e ngjitjes ja kam lënë kuksianëve. Ata kanë zgjedhur një itenerar ku kanë kaluar më parë. Më treguan se me ta kanë qenë edhe Shili, Kozmai, Azemi, etj. Nuk e patën arritur majën sepse ishte mjegull e dendur. Së fundi kuksianët që kryesonin kolonën më tregojnë majën e Kollatës. Por për mua ajo nuk ishte maja e Kollatës dhe ne tashmë ishim në kufi me Jugosllavinë. Prej aty mund të synohej maja më perëndimore e malit të Kollatës, por që ta bëje këtë kishte punë (por jo kohë të mjaftueshme). Bëmë një pushim në qafë prej nga soditëm shtatë dhi të egra në shpatin përballë. Shijuam pamjet përreth dhe pastaj ju drejtuam majës që kishim në krah. Itenerari ishte i thjeshtë dhe arritëm shpejt. Pasi u mblodhëm aty, të gjithë dëshironim të ngjiteshim në një majë tjetër e më të lartë nga ana perëndimore.

U nisëm dhe u ngjitëm, por kur arritëm aty pamë se shtëpitë më të sipërme të fshatit Vuthaj ishin nën këmbët tona. U trembëm! Me siguri që e kishim kaluar ndjeshëm kufirin shtetëror. Mirëpo kurioziteti për të parë atë malësi nga një pikë aq e lartë na bëri që të qëndronim ca. Qëndrimi aty dhe ndoshta qetësia përreth na e hoqën frikën dhe kështu kaluam minuta duke soditur. U larguam pasi u kërkova disa herë që të nisemi. Pas pak zbritëm të shpenguar sepse ishim të sigurtë që ishim në tokën tonë. Kthimi ishte i ngrohtë, jo vetëm sepse ende kishte diell, por edhe sepse nuk frynte erë dhe ne kishim marrë ca “fruta” alpinistike në këtë ditë të fundit të veprimtarisë. Të vinte keq ta lije malin!

Por ne e lamë për këtë sezon dimëror!...

*Mbajtësi i ditarit, Aleksandër Bojaxhi*

## 15 deri 28 korrik 1987

### 15

Autobusi u nis me vonesë. Disa herë u kontrolluan biletat! Më pas vjen erdhi dikush nga axhensia e transportit dhe biletat u rikontrolluan!! Pastaj erdhi një polic dhe na u kontrolluan pasaportat (*letërnjoftimet*). Si largohet polici shoferi nxjerr dy stola dhe fut edhe dy pasagjerë pa biletë dhe pas kësaj autobusi nis. Në të dalë të Laprakës shoferi merr edhe tre pasagjerë të tjerë që e prisnin; dhe 100 metra më tej edhe merr një pasagjer të fundit. Të gjithë këta pasagjerë porositen që po doli konrtolli do të hapet prej tij dera e autobuzit dhe ata do zbresin e do ecin përpara. Dhe kështu ndodhi pas një orë udhëtim. Kur kontrollorët ndaluan autobusin, pasagjerët që ishin në këmbë dolën jashtë dhe vazhduan rrugën në këmbë. Deri sa mbaroi kontrolli i biletave dhe i pasapotrave këta pasagjerë kishin bërë mjaft rrugë. Pasi u nis autobusi, gjatë rrugës shoferi i mblodhi “këmbësorët” e tij një e nga një. E gjithë ajo vonesë në nisje, tërë këto kontrolle që u bënë, dhe tek e fundit shoferi i bëri manovrat e tij “si t’i kishte mësuar përmendësh” dhe i morri 4-5 pasagjerë për xhepin e tij. Në 18:30 arritëm në Bajram Curri. Mbas darkës shkuam në dhomë. Na kishin caktuar në një dhomë dyshe mua dhe Kozmait.

### 16

Mëngjesi në Bajam Curri ishte i nxehtë. Pas përpjekjeve për mjet udhëtimi arritëm që të nisemi pas orës 10. Në udhëtim e sipër, gradualisht, e ndjen se po shkohet drejt freskisë. Kur hymë në “turizmin e Valbonës” mësuam se personeli kishte ndryshuar, por jo banaku: bufetjer ishte përsëri Sela kurse kamarjere e shoqja e komandantit të postës kufitare. Krahastuar me dimrin e këtij viti ajo kishte ndryshuar veshjen (me siguri që ishte punë e

administratës). Bluza e saj e bardhë kishte jakë të harkuar dhe me pala, vazhdonte e mbërthyer nga gjoksi e poshtë; e tëra kjo me pala. Teksa na morri porosinë mua dhe Kozmait, vëreja se edhe komunikimi i saj ishte përmirësuar.

Pasi firmosa lejet kufitare në postë nga komandanti, ne që quheshim grupi i parë u nisëm pas orës 15. Teksa udhëtonim ndjenim bubullima përreth si dhe freskinë dhe kënaqësinë që të jep blerimi që na rrethon ngado.

Sapo vesha pulovrin dhe bluzën e tutës mbi të ndjeva ngrohtë. Kozmai po “egzekuton” një breshëri me teshtima. Çorapet e leshta i kam veshur me kohë. Arritëm tek Buni Brahimin në ora 16:15. Brënda 30 minutave ngritëm tre tendat e ekipit dhe njëherësh filloi një shi i rrëmbyer. Reja me shi erdhi nga maja e Rrogamit. Ushtoi fillimish ahishta nga pikat e mëdha të shiut. Pas pesë minutash shiu erdhi edhe tek ne. U futëm nëpër çadra.

Pasi moti u qetësua vajta tek burimi. I mata temperaturën ujit që rezultoi 5°C. Lava disa roba nga të veshjes si dhe trupin. Në tendë dëgjuam parashikim e motit nga Radio Prishtina.

## 17

Fjeta keq dhe ndjehesha i lodhur. I imponova vetes gjimnastikën e mëngjesit dhe e bëra me pahir. Të gjithë po më duken si të “mufatur”. Dje, gjatë diskutimeve, një pjesë e ekipeve donin të qëndronin në Valbonë dhe të ushqeheshin sa të mundej në mencën e minatorëve (nga ndërmarrja e gjeologjisë në Valbonë bëheshin kërkime për baokside). Ekipet e rretheve janë të furnizuara keq me ushqime sepse është e vështirë që ato të gjinden në tregun e zakonshëm. Tirana është qytet i privilegjuar në gjithëshka që I mungon qyteteve të tjera.

U nisa me kuksjanët dhe korçarët në shpatet e malit të Rrogamit. Kontrolluam për itinerarë rrëzën shkëmbore të faqes

J-L të malit, që vazhdon e pandërprerë drejt V-L. Ka itenerarë interesantë për kacavarje. U futëm në një lug të gjatë bore që dilte sipër në një shalë e më tej, në anën tjetër, vazhdonte përsëri e tillë. Më pas, andej edhe zbritëm. Në shalë ndënjëm unë e Petrika. Koço u ul por pas 20 minutash ndali. Na thirri, komunikuam dhe i thamë të na presë. Nga nxehtësia që kishin arritur gurët e veçuar të shpatit, disa syresh filluan të bien poshtë. Kjo gjë e trembi Koçon andaj dhe ndali. Bashkë me Petrikën u ulëm poshtë. U takuam me Koçon në fund të lugut.

Rrugës hëngrëm mana toke (dredhëza). Koha e shkëlqyer! Ndjehet freski! Kur arritëm tek çadrat takuam Kolin dhe Mazin. Ata erdhën sot nga Bajram Curri. Kështu, ekipi ynë u bë me shtatë vetë.

Dashi u kthye nga mali pas meje: ka mbledhur rreth një kile kërmij dhe ka sjellë dy a tre litra qumësht (ka mjelë pesë dele që i gjeti lart në mal). Por ka sjellë edhe lule të rralla mali që i ka mbledhur rrugës.

## 18

Sot morra Kozmain që të shikonte edhe ai faqet shkëmbore të malit të Rrogamit. E shoh domosdoshmëri të fillojmë ngjitjet atje. Duket poligon shkëmbor madhështor për kacavarje, itenerarë të vëzhgueshëm dhe kampi mund të ngrihet aty pranë (një orë mbi kampin tonë) me ujë e livadhe në mes të pyllit. Edhe ai u bind.

Sot jam zgjuar herët. Ishte ende pa zbardhur kur Kozmai fillojë breshërinë e teshtimave. Ky “xhaxhai” më rri në fije të të bluzës dhe në hije të aheve gjatë mbasditeve. Luan shah me orë të tëra. Hundët e tij të zëna “gumëzhijnë” gjatë orëve të gjumit të natës. Kur dolëm nga tenda Dashi (jemi të tre në të njëjtën tendë) tha që do e rregullonte sheshin e saj që profesorit

t'i ri koka mirë e mos të gërhasë. Dhe e bëri vërtet këtë gjë pasi hëngrëm drekën.

Kthimin sot, me Kozmanë dhe Koçon, e bëmë nga itinerari i ditës së djeshme. Diku devijova i vetëm në shteg dhe pas pak gjeta shtegun “original”. Vitet e fundit (*d.m.th. pas kooperativizimit të fshatrave malorë*) trafiku nëpër bjeshkë me lëvizje bagëtishë dhe kafshë barre ka rënë shumë dhe shtigjet që dikur lidhnin stanet në bjeshkë apo bjeshkët midis tyre po humbasin nga viti në vit. Gjatë zbritjes, kur më dilnin përpara, ulesha dhe haja mana toke.

## 19

Si u zgjova hapa hyrjen e çadrës. Mali i Thatë nuk të lë që të shohësh horizont. Vështrimi rrëshqet nëpër brinjën jugore të majës e ulet n'ato pjesë të relievit që bashkohen me rrëzat e tjera malore e që formojnë Luginën e Valbonës. Tej, në majat që duken, ngjyra rozë e tyre vjen dhe bëhet me kalimin e minutave ngjyrë portokalli. E gjelbëtra e pyjeve, që i rri si shtrat luginës, gradualisht fillon e çelet deri sa bëhet një ngjyrë e qëndrueshme dhe vazhdon të mbetet e tillë deri në buzë të perëndimit.

Sot u la pushim. Mëngjesin e kalova me ushtrime fizike. Susta që ka marrë nga shtëpia Koli ka bërë që “pellgu” i pesë tendave që formojnë kampin tonë të tironsave të marrë ngjyrat e një mjedisi gjimnastikor.

Pas rrjeshtimit u nisa i vetëm për të mbledhur çaj. U ktheva shpejt sepse më thirri Koço. Korçarët kishin hapur tre shishe verë sepse djali i Koços sot bëri 10 muaj. I imponuar nga Koço (unë nuk pi gjatë ditës) piva dy gllënka. Koço është i moshuar për të patur fëmijën e parë dhe të vetëm, djalin që ja quajnë Arjan, 10 muajsh. Hareja këtu ishte e madhe. I përpilova Koços një telegram urimi për të shoqen (Valin) meqë djali i kishte këtë



përmujor. Më pas u mora me higjenën time si dhe me drekën. Djemtë e ekipit janë ulur në Valbonë.

Teksa po merrja një sy gjumë më zgjuan ca hapa. U ngrita dhe shikoj Ajet Malaj-n. Është një bari shëmbullor nga fshati Tpla të cilin e kam takuar vet i dytë 15 a 16 vjet më parë në shpat të malit të Brijasit (Brijzës). Atëherë ai më ndihmoi që të gjeja shtegun (shteg alpin) e kalimit (në lindje të majës së Brijasit) nga Valbona në Curraj.

Bisedova me të dhe me fëmijët që e shoqëronin rreth një orë. Më ofroi stanin e tij për të marrë bulmet. Stanin e ka përballë me kampin tonë, matanë përroit.

Kur Ajeti u ngit dhe u largua, filluan të vinë djemtë e ekipit. Por jo Kozmai: ai thotë se ka një dhëmballë të ënjtur dhe beson se do gjej dentist në Valbonë. Pra, erdhi Dashi dhe djemtë e ekipit. Kanë bërë blerje të mira në Valbonë dhe Rrogam.

## 20


Vendi i kampimit tonë është i këndëshëm. Është luginë mes malesh, thellimet e së cilës fillojnë midis majave të Jezerës dhe Rrogamit, nga një anë dhe rëzës së malit të Roshit nga ana veriore, ku dhe është qafa e Madhe (më e larta) e Valbonës. Kjo qafë lidh luginën e Valbonës me luginën e Vuthajve.

Të dy këto thellime bashkohen në një të vetëm mbi kampin tonë. Këtu ku jemi kjo luginë formon shtratin e përroit të Kukajve (Kukaj është një lagje e vogël e Valbonës) që derdhet në Valbonë. Burimi i pashtershëm i ujit fillon tek çadrat më jugore të kampi tonë dhe staneve. Palla për larjen e robave që kishin lënë aty gratë apo vajzat e stanit dje, kur lava rrobat, besoj se e ngritën cilësinë e larjes së robave të mia.

Përqark nesh ka pyll ahu dhe livadhe. Këta alternojnë njëri tjetrin por pylli dominon. Më në lartësi gjelbërojnë kullotat

alpine të cilat përkëmbehen me faqe shkëmbore të thikëta e të pastra si dhe me shpate bore.

Në shpinën tonë ulet kreshta e gjërë dhe e stërgjatur e pjesë J-L të malit të Rrogamit. Mbi çadtrat tona mali ngrihet me pjerrësi të madhe me një livadh me përmasa rreth 200x200 metra të prerë vende-vende me pyll. Shpesh këtu shkoj mbasditeve për të soditur dhe lexuar.



Skica e kampingut

Përballë kam malin e Thatë. Është më i ulët se mali i Roshit, por ngrihet menjëherë mbi ne, “vrullshëm”, me shpate të thepisura. Mal kryeneç. Deri tani nuk jam ngjitur në majën e këtij mali. Gjithmonë ka ndodhur diçka që është bërë shkak të dështoj. Ky mal ka shpate të veshura me pishë. E gjelbërta e pishës është më e zënë se e ahut andaj dhe rrëzat e këtij mali duken më hijerënda se hapësirat pyjore përreth.



Pëllumb Llabanishta në kacavarje

Vende-vende pylli i pishës ka pishë të bardhë. Këta drurë janë më të vjetrit dhe më të lartët këtu. Trungjet ngrihen lakuriqe me kurorën e gjelbërt lart. Diku këtu, dy vjet më parë, rrëshqiti dhe gjeti vdekjen i ndjeri Pullumb Llabanishta.

Agimi këtu fillon i argjentë. Ka kurorë të argjentë mbi majat në anën lindore. Ngadalë ngjyra thyhet në portokalli të lehtë, por jo rozë sikundër ndodh gjetkë. Ngjyra portokali pasi fillon të “piqet” kthen dhe më tej zbardhet. Më pas dielli “zë” ndonjë re dhe e portokallon atë më shumë se horizontin e kreshpësuar që kemi përpara dhe më pas, shpejt, i lë asaj bardhësinë që ka, por zë majat e maleve. Rrezet e diellit ndirçojnë grinë e faqeve shkëmbore si dhe shpatet me bar.

Ky agim e zë stanin me punë. Së pari viçat e më pas lopët nxirren nga vatha. Më pas dhinë. Kuajt dhe mëzat që kanë qenë të lirë gjatë natës afrohen natyrshëm pranë stanit. Delet rrinë në vathë dhe presin që të milen.

Dielli bie paksa vonë tek tendat tona: 06:45. Freskia e mëngjesit është e këndëshme. Sapo zgjohesh ndjen shushurimën e ujit në përroin këtu pranë. Kjo shushurimë uji gjason me çukitjen e pikave të shiut në gjethet e ahishtës dhe ka mëngjese kur për një moment, kur ende nuk je kthjelluar nga gjumi i natës, të duket sikur po bie shi në pyllin mbi ne. Shushuritja e ujit si dhe ndonjë këmborë e rrallë e gjallesave që lëvizin mëngë teksa kullosin janë pjesë e agimit në kohën e zgjimit tonë.

Sot ekipi u nis për në itenerarin e “birës” në majën e Thatë. Janë një treshe dhe një dyshe. Kozmai me Dashin qëndruan pranë kampit për t’i ndjekur. Por ata ende nuk janë kthyer dhe kjo po më shqetëson ....

Bashkë me të gjithë ekipet e tjera shkova në malin e Rrogamit për të filluar një poligon të ri me itenerarë për kacavarje. Për të shkuar deri tek itenerari i parë shkëmbor duhen 45 minuta. I ndava nëpër itenerarë, ca alpinistë shpejt e ca të tjerë vonë, në vartësi të kohës së ardhjes së tyre. Ndoqa me vemendje ngjitjen e nje tresheje të ekipit të korçarëve. Ishte ngjitje e bukur dhe them se ajo do vlerësohet e pestë. Më pas me Koçon dhe Neken (Anesti Qirio) vajtëm tek burimi i pyllit për ta vlerësuar si prurje. Kishte ujë të mjaftushëm dhe të mrekullueshëm. Aty pranë ishte edhe një stan. Ka vend të mjaftueshëm për të ngritur kampin me çadra dhe sigurisht që prej këtu itenerarët shkëmborë janë më afër krahasuar me distancën nga kampi ku jemi. Pas këtij “rikonicioni” morrëm rrugën e kthimit.

Unë me Neken morrëm si rrugë kthimi itenerarin nga erdhëm sepse gjithëkund është pyll dhe fresk. Diku, Nekja numuroi me kujdes rrathët e një trugu peme bredhi të prerë: 171 rrathë pa mundur të numurohen rrathët e qendrës. Pra bredh rreth 200 vjeçar! Bredhat e paprerë janë me të vërtetë gjigantë. Janë hapur

fjalë se këto bredha do përdoren si lëndë e parë për nevojat e mobilimit të Pallatit të Kongreseve në Tiranë.

Djemtë e ekipit ende nuk po kthehen andaj po shkruaj disa gjëra:


1. Së pari, si rregull në më të shumtën e rasteve këtë ditar e kam shkruar në çadër duke ndenjur përmbys. Ditën e parë ndjeva sikur më lëvizi diçka nën bark. U tremba por shpejt mendova se do të kish qenë lëvizje zorrësh në trupin tim. Herën e dytë këtë lëvizje e ndjeva poshtë tek këmbët. U hodha përpjetë i bindur se është gjarpër. I lëviza me frikë e kujdes të gjithë gjërat, por asgjë. Pardje lëvizja në pjesën e barkut u përsërit disa herë. U bëra më trim: vrojtova në qetësi dhe vura re se lëvizja ndodhte poshtë shtrojes së tendës. Thirra Dashin, dhe me të erdhën edhe të tjerë dhe u konstatua se kishim të bënim me urith. Ai edhe doli në sipërfaqe. Dikush futi lopatën në dheun e ngritur por urithi u largua. Që nga ai moment urithi nuk më ka shqetësuar.

2. Dashin e kemi si vjehrin e çadrës. Na udhëzon për gjithëshka: ku ta vendosim bukën, ku biskotat, ku qiriun. Si të shtrojmë thesin e fjetjes, kur duhet organizuar çadra, kur të veshim këpucët, etj. Dje e riniveloj tabanin e çadrës në mënyrë që Kozmai të mos lëvizë shumë e të mos gërhasë që ne të flemë të qetë. Mirëpo edhe mbrëmë Dashi fjeti keq, kështuqë sot ai u transferua tek çadra ku fle Mazi me Kolin.

Dje Dashi zbriti në Valbonë dhe plasi sa gjeti një shishe raki (e pëlqen) por na solli edhe ca verë të mirë. Kur hapi shishen e rakisë plasi sa më kandisi edhe mua që të marr një gotë. “Nuk shtyhet vetëm kjo”, thotë. Kur hap ndonjë shishe verë e ka më të lehtë që ta shoqëroj.

3. Parmbrëmë teksa po bëja fizikulturë (bëj pak çdo natë) më shpëton susta nga këmba dhe më godet në fytyrë. Më doli pak gjak nga goja dhe kam ënjtje të buzëve. Kam dhe dhimbje në një dhëmb që më mban protezën. Këtë të fundit e kam

hequr (nga ënjtja e mishrave) dhe tani kur flas S-ja më del Th. Bëra mjaft kompresa për të ç'ënjtur turirin tim dhe kam një farë përmirësimi gjë që më mundëson edhe të ushqehem disi i qetë.



Skica për malin e Thatë

4. Veshja ime këtu më dt 16 korrik në darkë ishte: çorape leshi, tuta të holla, fanellë pambuku, pulovër leshi, bluzë tute. Gradualisht u përshtata me temperaturën, sigurisht si edhe të tjerët, dhe tani jemi kthyer në normalitet. Gjatë ditës, pasi del dielli, jemi edhe ne këtu si në stinë vere.

Djemtë e ekipit nuk po kthehen. Do vazhdoj më vonë....

...erdhën! Çdo gjë ka vajtur mbarë. Por janë lodhur dhe zbritja u ka marrë mbi katër orë. Duan ujë me sheqer!

Tani dielli po perëndon. Këtu nuk ka horizont sikundër njihet në ultësira apo vende fushore. Këtu horizonti është kreshpor, është si një sharrë rrethore me dhëmbë të mprehtë e me gjatësi të ndryshme. Këtu ku kemi kampin, në perëndim, dielli ndriçon pjesën e sipërme të pyllit, livadhet më të sipërme si dhe majën e Thatë. Tani në perëndim konturet e faqeve shkëmbore të malit spikasin qartë. Të gjithë itenerarët shkëmborë të mundëshëm drejt majës, që fshihen gjatë ditës, tani zbërthehen dhe me lehtësi mund të lexosh anatominë e relievit shkëmbor që si një piramidë gjigante ngrihet mbi supet e blerimit.

## 21

Sot u ngrita herët por mbrëmë ramë vonë për të fjetur. Mbrëmë, në buzëmbremje, djali i Ajet Malajt solli ca kos dele. Bashkë me Dashin e hodhëm atë në një kusi dhe e futëm në tendë që ta hanim për sot. Më vonë erdhi vetë Ajeti dhe kaluam ca kohë bashkë. Nga ora 23, pasi ishim futur në thasët e fjetjes, Kozmai tha se “bylmeti e ndjell gjarpërin”. Shpejt kuptova se ai këtë që tha e kishte seriozisht. Morra kusinë dhe e vendosa lart në një pemë ndonëse Dashi kundërshtonte. Sipas tij, nëse kjo që thotë Kozmai është e vërtetë, atëherë stanet do ishin vende me njerëz të kafshuar dhe helmuar nga gjarpërinjtë.

Sot shkuaam të gjithë tek itenerarët shkëmborë në Rrogam. Unë e Petrika ishim në krye. Pas nesh Dashi, i cili rrugës vrau një gjarpër dhe e vuri mbi një gur rreth 200 metra poshtë vendit ku qëndronim. Kur më pas erdhi Kozmai me Neken, ne që nga sipër i drejtuam për nga guri duke u thënë se aty kemi harruar paguren. Kozmai kur pa gjarpërin ja dha vrapit. Ne këtë gjë prisnim për tu gajasur.

Pasi filluan ngjitjet zgjodha një itenerar për të dalë në kreshtë. Kur dola sipër takova Kozmain dhe më pas të dy shkuaam tek burimi në ahishtë. Aty takuam edhe të tjerë që kishin zbritur pas përfundimit të ngjitjeve. Më pas shkuaam tek fusha (livadhi) dhe në zbritje mblodhëm çaj.

Djemtë e ekipit tim sot u futën në një itenerar pa vlera, pa u konsultuar me askënd. Mbasdite u qëndrova rëndë. Sot është shumë vapë, aq vapë sa edhe agimi edhe perëndimi nuk i patën ngjyrat e tyre të bukura alla alpine. Edhe qielli, që këtu duket si në blu të errët (sidomos mbi kokat tona), ka një zbardhje të theksuar, aq sa të bën të mendosh se përqark maleve e prapa kreshtave janë ndezur fenerë të fuqishëm ndriçimi.

Sot në mëngjes u pashë në pasqyrë. Buzët thuajse janë çënjtur nga ajo goditje e sustës. Por dhëmbi ende më dhëmb. Duket se nuk do të shërohet. Nganjëherë kur pa dashur kafshoj gjë të fortë, më bëhen xixa tek sytë. Duhet të ha vetëm përscheshe, gjë që është e pamundur. Më mundojnë sidomos sallami, kaçkavalli dhe nganjëherë edhe buka, të cilën e kam përgjysmuar.

Në pasqyrë u ndala pak edhe tek fytyra ime. Mjekra e rritur tashmë nuk duhet thënë se nxin, por zbardh. Kam shumë thinja. Habitem se si këta djemt e mi të ekipit nuk më thonë xhaxho. Po të isha unë në vend të tyre nuk do lija pa ja thënë këtë fjalë “profesorit”. P.sh. unë Kozmait ja them hera-herës fjalën xhaxho, ndonëse kemi vetëm shtatë vjet diferencë në moshë.



## 22

Para orës 8 me ekipin u nisa për tek shkëmbejtë. Pas një ore ekipi, sipas litarëve, filloi kacavarjet. Pak nga pak erdhën edhe ekipet e tjera të cilat i drejtova nëpër itenerarë. Kur i futa të gjithë në punë shkova tek zona e borës ku u pozicionova në mënyrë të tillë që edhe të udhëzoja, por edhe të merrrja ca diell. Kozmai qëndroi poshtë. Dashi u nis për të mbledhur salep.

Mes borës, diellit si dhe freskisë, duke udhëzuar kacavarjet, ndënja nga ora 9 deri në 15:30. Nëse nuk do jem ftohur, ose nuk do jem djegur nga dielli, kjo do të jetë një mrekulli!

Ndër ngjitjet që realizoi ekipi im sot, ajo që bëri Koli me Mazin ishte e shkurtër dhe e mirë; e katërt si vështirësi. Ajo që bëri Iliri, Arturi dhe Xhemali ishte tepër e vështirë. Përfundoi në orën 16. Ishte e gjashtë e mrekullueshme. Mendoj ta caktojme “e kontrolluar” për titullin Mjeshtër Sporti. Këtë ngjitje e ndoqa deri në fund bashkë me Rahitin.

Sapo u ktheva nga ngjitja u morra me higjenën time. Kisha pas porositur Kolin me Mazin që kur të ktheheshin të mbushnin enë me ujë dhe t'i linin në diell. Ato ishin ngrohur bashkë me ujin që mbanin dhe ndjeva kënaqësi teksa hidhja ujin nëpër trup. Dreka që hëngra dhe 10 minuta gjumë ishin mrekullitë e rradhës. Për nesër është pushim, por besoj se do bëhemi një grup për të ngjitur malin e Kollatës.

## 23

Kam fjetur keq. Jam djegur nga dielli në pjesët e sipërme të kofshëve. U leva disa herë me salcë. Kjo gjëndje bëri që të mos nisesha për në Kollatë. Dita sot u bë ditë e mërzitëshme për mua. Pjesën më të madhe të kohës e kalova në çadër.

Shumica e alpinistëve zbriti në Valbonë për të siguruar ushqime. Është situatë e vështirë për të siguruar ushqime. Një



Valbona e pikturuar nga alpinisti piktor Petrika Janaq

pjesë tjetër e alpinistëve u ulën 10 minuta poshtë kampit, aty ku përroi krijon një pellg dhe mund të lahesh. Mbasdite vonë vajta dhe takova në çadër Petrika Janaqin për të parë pikturat që ka bërë në Valbonë. Ka punuar mirë. Do t'i jap një ditë leje që të përfundojë ato që ka në dorë të papërfunduara.

Djemtë e ekipit u kthyen me ca plotësime për ushqimet tona. Kryesore ishin vezët dhe dy kuti qumështi. Një alpinist nga ekipi i Krujës (Iljaz Shuli) më solli një raket film.

Sot e kam ndjerë vapën. Ndoshta ngaqë ditët e tjera kohën e kam kaluar në lartësi. Por Iljazi që erdhi sot nga Kruja tha se “këtu është fresk i madh”. Mizat pickojnë fort. Janë mizat e stanit të cilat këtë pickim e kanë për kafshët këtu dhe që me të njejtin “stil” e ushrojnë thumbin e tyre edhe tek lëkura e njerëzve. Pas orës 18 mjedisi freskohet. Është koha kur malet fshehin diellin.

Pas orës gjashtë dola nga çadra dhe i imponova vetes fizikulturën në mëngjes dhe rregjimin ditor të zakonshëm për orët në vijim. Qielli ka marrë bukurinë e zakonëshme mëngjesore. Pardje nga malet e Jezerës dhe Rrogamit vinin në drejtim të luginës re të mëdha shtëllungore të shiut, që me përparimin e tyre drejt nesh vazhdimisht zvogloheshin dhe ktheheshin në popla të vogla kur kaptonin malin përtej kufirit. Sot e kaltërta e qiellit është e bukur dhe “tymnaja” e ajrit të luginave që qëndronte e nderë në to është tretur. Kjo ka bërë që transparencja e ajrit të jetë e theksuar. E gjelbëra e thellë e pyllit, e gjelbëra e çelur e kullotave alpine, grija e shpateve të thepisura e endur me të bardhën e borës në lugjet e thella mbyllet sipër me të kaltërën joshëse të qiellit, që edhe kjo, e endur me re të pakta të bardha duken si një gëzim i natyrës që të merr sytë!

Çdo ditë që ngjitem dhe ulem në shpatet e malit të Rrogamit ndeshem me lule të bukura. “Margaritat” e verdha dhe të bardha janë tepër, tepër të bukura. Më duken një kombinim i përkryer ngjyrash që janë simbolike për gjithëshka. Por midis luleve është një e verdhë që duket si një bistak me pesë deri shtatë lule të ngjashme me manushaqen (nga forma) që janë diçka e rrallë.

Sot përsëri të gjithë u ngjitëm tek faqja shkëmbore e anës veriore të malit të Rrogamit. Iliri me Arturin u futën në një itenerar të vështirësisë së pestë. Koli Xhemali dhe Mazi morrën një diedër që kombinohej me një plasë. Kjo e gjashtë e vështirësisë. Të dyja këto ishin ngjitje të bukura. Një treshe alpinistësh të Tepelenës i futa në një ulluk interesant ndërsa dy kuksianë i futa në itenerarin e vështirësisë së gjashtë ku punoi Iliri pardje. E realizuan mirë!

Brënda orës 13 të gjithë dolën në kreshtë. Mbeta vetëm dhe fillova zbritjen për tek çadrat. Rugës takova Dashin, Kozmain,

Rahitin dhe Mëlëngun. U futëm të gjithë në rritëm të njëjtë zbritje.

Sapo arrita në kamp mora sapunin dhe u nisa për tek pellgu i përroit poshtë kampit. Zhduka salcën nga trupi, u lava si dhe lava roba. Kur u ktheva në çadër më priste dreka: sardele, sallam, djath kaçkavall dhe një gotë verë e kuqe. Më pas u shtriva. 15 minuta gjumë i plotë. Më pas muzikë, ditar dhe tani është koha e gjumit të darkës. Sot Mazi, Koço, Petrika, Marseli dhe Iliri ikën.

## 25

Mbrëmë dolën ca mushkonja të vogla që me sa duket pëlqenin lëkurën tonë. Na grinë me një egërsi të veçantë. Në këto raste dimë që teritori përqark tendave duhet të rrethohet me vatra tymmi, sa më shumë tym, që ato të largohen. Mirëpo mjedisi është aq i thatë sa çdo gjë që hidhnim në zjarr vetëm flakë bënte. Tek e fundit bëmë një zjarr të madh dhe rreth tij u mblodhëm ne “banorët” e çadrave.

Sot në mëngjes u zgjat qëndrimi në rreshtim. Ishte jo e lehtë që të vendosej se ku do bëheshin ngjitje. Unë vet i tetë u nisa në orën 8 për në Kollatë. U ulëm deri tek shtëpia e parë në Kukaj dhe prej aty morrëm përpjetë një shteg kafshësh barre. Rruga e përpjetë, shumë e përpjetë, shpejt u fut në pyll dhe në freskinë e tij arritëm pas një ore në shpatin jugor të majës së Thatë, në një çardak të mrekullueshëm për të soditur Valbonën (*përshkrimi tregon se kemi pas dalë tek Bregu i Rrethit*). Prej aty itenerari kalonte me ngjitje e zbritje të vogla nëpëpër pyje e livadhe; një mrekulli e blerimit alpin që u regjistrua në faqen e ndritur të relikeve të natyrës për shijen time. Dolëm tek Lugu i Prosllopit.

Më 9 e 30 bëmë pushimin e parë. Deri këtu Tola i Korçës ishte bufoni i grupit, me humor të kulturuar dhe humor

të shturur, por erdhi një moment që ai pushoi. Në orën 10 ishim tek stani. Kishte dele. Aty takuam një bareshë e cila na tha se bashkësia e saj kishin ardhur nga Dragobia. Paksa mbi stan ishte posta kufitare verore. Disa ushtarë – kufitarë – u bënë kuriozë dhe po na shikonin tërë vëmëndje. Këmbyem dy a tre fjalë përshëndetëse me ta dhe u kthyem djathtas për tu futur në shtegun drejt majës. Shteg gjetëm por tepër të vështirë. Diku e kemi humbur “fillin”! Nuk po gjeja atë që kërkoja. Kështu që kaloi Nekja përpara si specialist (vjen për të pestën herë në majën e Kollatës). Pasi kaluam disa pjerrësi të frikëshme me bar alpin të lartë dhe plot aromë të këndëshme gjetëm një shteg që befasoi Neken e këdo nga ne, por që ishte ai që kërkoja. Ky na nxorri tepër saktë dhe në 10 e 30 bëmë pushim tek një lug me borë....

Arritëm në majë. Rreth 100 metra poshtë majës Mishës i zuri syri një burim ujëplotë ku u mblodhëm të gjithë. Udhëtimi na morri tre orë e 30 minuta duke ngjitur një disnivel rreth 1.500 metra. Kollata e ka lartësinë 2.554 metra mbi nivelin e detit. Kaluam rreth një orë në majë ku dhe hëngrëm ato ushqime që kishim marë.

Pasi pozuam filluam zbritjen dhe pas dy orë e 30 minuta ishim në kamp. Në fakt, pa hyrë në kamp qëndruam ca kohë në lumë për tu larë e pastruar nga djersa.

Në kamp sigurisht që gjetëm një “klimë” të ngrohtë krahasuar me atë të lartësive. Në kamp gjetëm edhe grupet e tjera që kishin përfunduar veprimtaritë e ditës. Xhimi po na përfundonte makaronat me salcë dhe kimë si dhe do na servirte sallam. Mua më servirën edhe një gotë verë të kuqe.

## 26

Patëm lajme mbrëmë. Kështu Ajeti (bariu) erdhi dhe më takoi dhe në bisedë e sipër më tha se “mbasi iku nga maja e Roshit

grupi i alpinistëve, në qafë dolën dy persona nga ana jugosllave dhe bënë tre të shtëna me pushkë.

Dashi na tha se në lugun për dalje drejt Kokërhanës u kishte dalë një gjarpër. Të katër pjesëtarët e grupit e kishin goditur dhe e kishin vlarë. Ishte i gjatë si i mëparëshmi, por më i hollë dhe me ngjyrë të errët. Zjarri u ndez rishtaz, mirëpo sejcili pasi afrohej për të marrë një të ngrohur, largohej. Më zuri gjumi dhe fjeta “një copet” deri sa u zgjova. Sigurisht herët.

Dashi doli i pari nga tenda; Kozmai më pas. Unë dola pas orës gjashtë. Dashi bëri dy kafe (unë nuk pi kafe sepse ajo është kafe me (prej) çikorie. Mungesa e kafesë në treg shoqëron mangësitë e ushqimeve në treg). Fillova fizikulturën. Ajo ngjitja e djeshme, si dhe zbritja, nuk kanë ndikuar negativisht në muskujt e mi.

Pasi u rrjeshtuam, kur u nisëm, Kozmai shtoi: “po të jetë se ndonjëri nuk e ndjen veten mirë të mos shkojë”. Kjo bëri që pasi u nisëm të gjithë bashkë kollona filloi dhe u “hollua” dhe tek shkëmbi i itenerarëve aritëm unë, katër anëtarë të ekipit tim, si dhe një nga ekipi i Krujës. Këta u ngjitën në itenerarët I-2 dhe I-3 kurse unë vrojtova shpatin verior të malit. Kishte mjaft vende të tjera për ngjitje (kacavarje). Mbyllja e faqes ishte një kreshtë mjaft e dëmtuar (cokitur) dhe mua më pëlqeu të emërtoja “Gjilpërat e Rrogamit”.

Kur i lashë alpinistët në itenerarët që ngjiteshin dhe shkova të kontrolloja shpatin, kreshtat uturinin nga era që i fshikullonte majat e tyre. Më pas, kur u ktheva tek pesë alpinistët që vazhdonin ngjitjen, era pushtoi edhe pyllin që ishte poshtë nesh. Ishte e fortë dhe me shkulme; e freskët. Pasi verifikova ngjitjet që kryeshin morra rrugën për në kamp. Kur po kaloja nëpër pyll ndala që të pastroja çorapet dhe këpucët nga guriçkat që më ishin futur. Në atë qetësi pylli dëgjoheshin hera-herës komunikimet që bënin alpinistët gjatë ngjitjes.

Tek çadrat gjeta Kozmain dhe Rahitin që luanin shah. Të dy ata ulen e luajnë sa herë gjejnë kohë të lirë të përbashkët. Për t'i ngacmuar u thashë: një personalitet ka pas thënë se, “kush nuk di të shijojë jetën luan shah”. Debatuam pak por ata nuk e zgjatën sepse loja ishte shumë e ekujlibruar.

U rrojta, por lashë mustaqet. Lava kokën me ujë të ngrohtë nga bidonat e lënë në diell. U shtriva por nuk më zuri gjumi. Mizat janë shtuar. Në orën 14:30 organizuam analizën përmbyllëse të veprimtarisë. Kozmai në mbyllje bëri një diskutim shumë të goditur. Në mbyllje ai propozoi të mbajmë një minutë heshtje në kujtim të ish shokut tonë, anëtar i ekipit të K S Partizani, Pëllumb Labanishta që ndërroi jetë në malin e Thatë. Mua kjo më zgëlaqi!

Mbas mbledhjes shumica u largua. Unë, Koli, Dashi e Kozmai u futëm në çadër dhe luajtëm peskatësh. Pas kësaj Dashi me Kolin u përgatitën për tu nisur. Pas shumë hezitimesh u përgatit edhe Kozmai. Në kamp ngelëm Iliri, Xhimi, Turi, dhe unë. Kemi edhe radion e grupit!

## 27

Mbrëmë Xhimi na përgatiti darkën me pilaf e kaçkavall. Pilafin e kam të fundit në meny kur vjen momenti për të zgjedhur. Orizi që kemi do qërruar, andaj dhe ka tepruar. Sot dola dhe bëra një shëtitje në livadhin e pjerrët mbi kampin tonë, ndërkohë që çunat rrethuan një lopë në pyll për ta mjelë, por nuk ja dolën. Përtej dukej treshja e patrullës kufitare që kthehej nga shërbimi. Qielli po rëndohej me re të dendura dhe kjo bëri që erësira të vi tek ne para kohe. U futëm në çadrën time dhe filluam një pesëkatësh. Iliri solli një shishe verë. Ka 27 vjetorin e lindjes.

Pas lojës u shpërndamë dhe mbeta vetëm. Kur bubullimat u shtuan mbylla radion. Vetëtimat u shtuan gjithnjë e më

shumë dhe bubullimat ushtonin majave të maleve si këmbana të fuqishme. Filloi shi dhe pikat e tij në mbulesën e çadrës të ndjellin gjumë.

U zgjova pas orës pesë dhe fillova të përgatis çantën e shpinës për udhëtim. U bëra zë edhe djemve. Për fat, pas orës gjashtë shiu pushoi. Hëngrëm pak mëngjes dhe në ora shtatë ishim për rrugë. Pas një ore arritëm në Valbonë. Retë u përçanë dhe doli dielli që i dha një shkëlqim të ri natyrës. Retë me përtaci largoheshin nga lugina drejt majave duke u dhënë madhështi të veçantë grisë së faqeve shkëmbore si dhe majave me llojshmëri formash më të spikatura dhe të furtura e përfutura shpateve dhe grykave shkëmbore të maleve.

Në Valbonë i gjetëm të gjithë të ikur me përjashtim të Dashit, Kozmait dhe Sokolit. Me Sokolin vajta në lumë. Këtu lava çadrën, edhe veten, por u vesha shpejt sepse koha është freskuar. Më pas u mbledhëm në klub ku Iliri na gostiti të gjithëve për ditëlindjen e tij.

Deri në orën 17 pritëm për makinë. Ndërkohë moti u ftoh dhe vesha edhe pulovrin edhe xhaketën e lëkurtë. Rastësia bëri që të takoj Enver Bakiun, Komisarin e Grykave. Organizohej një ceremoni me pjesëmarrësit e stërvitjes ushtarake me rezervistë. Ai na morri në makinë e na la në BC. Në BC hoqëm deri sa rregulluam hotel, bileta udhëtimi për nesër dhe dokumentat e pagesave për transport. Nga ekipet e tjera kanë mbetur në Bajram Curri edhe shtatë alpinistë të tjerë.

## 28

Në mëngjes më zgjoi një erë e rëndë që të kujtonte erën e tutkallit. Pasi dola nga dhoma u ula në bufë. Arturi me Ilirin më gostitën me një çaj dhe u larguan. Nuk ndenja gjatë aty. U ngrita dhe hyra në restorant ku më thanë se ka vetëm pilaf. U ngrita



menjëherë. Paçja që prisja të haja ishte djegur. Andaj dhe vinte era tutkall edhe nëpër dhomat e hotelit. Shpejt u futëm në një autobus rangallë i cili na la në Mjedë 10 minuta para se të arrinte treni i nisur nga Shkodra për në Tiranë.

Në këtë veprimtari morrën pjesë:

Kozma Grillo

Ekipi Dajti

Marsel Pogaçe

Sokol Hoxha

Ilir Baraku

Aleksandër Bojaxhi

Ekipi 17 Nëntori Tiranës

Dashamir Fejzo

Artur Shehu

Sokol Doko

u paraqit një ditë me vonesë për arësye të mosgjetjes së biletës së udhëtimit

Mazllëm Feka

u paraqit një ditë me vonesë për arësye të mosgjetjes së biletës së udhëtimit

Ilir Tapia

Xhemal Begeja

Rahit Hila

Ekipi Minatori i Tepelenës

Avid Zholi

Et'hem Loçi

Rahit Mema

Ilir Koni

Ekipi Kastrioti Krujës

Arjan Sena

të dy këta erdhën një ditë me vonesë për mungesë biletash udhëtimi

Koço Ziso

Ekipi Korçës iku dt 24 sepse kishte 40 ditët e vdekjes së vëllait

Genci Lika

Anesti Qirio

Mihallaq Çollaku

Petrika Janaq

u largua dt 24 sepse kishte një ditëlindje

Petrika Opingari

Ilkë Kita

Ismail Domi

Ekipi Përparimi Kukës

Kasëm Krasniqi

u përjashtua nga veprimtaria ditën e tretë

Berzat Mane

Esat Matmuja

Rakip Cenko

Meleq Damjolli

Ky ekip u largua dt 26 para dite për arësye të transportit me anije në linjën Fierzë-Kukës (nuk ka çdo ditë)

Dt 23 erdhi në kamping alpinisti Iljaz Shuli por nuk u pranua për të marrë pjesë në veprimtari

*Nga ditari i Aleksandër Bojaxhi*

## **Aktiviteti Veror 17 – 26 korrik 1987 në Valbonë (Buni (I)brahimit)**

Pjesëmarrësit:

1. Aleksandër Bojaxhi
2. Dashamir Fejzo
3. Sokol Doko
4. Ilir Tapia
5. Mazllum Feka
6. Xhemal Begeja
7. Artur Shehu

Udhëtimi Tiranë-Bajram Curri është një udhëtim i gjatë dhe tepër i lodhshëm. Jemi pesë vetë nga ekipi ynë që udhëtojmë më 15 korrik. Kemi lënë në Tiranë dy vetë: Mazin dhe Kolin të cilët për arësye biletash vijnë më datë 16. Jemi nisur nga Tirana

më 07:45 dhe mbritëm këtu më 18:00. Punonjësit e fizikulturës këtu janë shumë indiferentë. Nuk na kanë siguruar as hotel e as mjet transporti për në Valbonë. Hotelin e rregulluam pas shumë përpjekjeve.

## 16 korrik

Dolëm tek axhensia e kamjonave. Gjejmë një skodë (*lloj kamioni*) e nisemi më 10:30. Më 12:00 jemi në Valbonë dhe presim të hapet menca e minatorëve. Pajtojmë dy kafshë për të na transportuar çantat deri tek Buni Brahimet ku në ora 18:00 ngremë kampin dhe jemi të gatëshëm për të filluar veprimtarinë që kemi.

## 17 korrik

Dita e parë e ngjitjeve. Ngrihemi më 07:00 dhe më 08:30 nisemi për ngjitje. Sot do të bëjmë ngjitje të shkallës së II-të dhe të III-të. Ne të 17 Nëntorit jemi caktuar për tu ngjitur në majën e Rupave ku realizojmë një të tretë. Në darkë jemi rreth radios dhe bisedave me Sokol Hoxhën e ekipit të Dajtit, i cili si zakonisht ka një bisedë të ëmbël dhe të pashterur.

## 18 korrik

Sot lexohet urdhëri i parë i ditës (*një plan i paraaprovuar për veprimtaritë e ditës*) si dhe orari i veprimeve në këtë veprimtari. Zgjidhimi caktohet më 06:30 dhe nisja për ngjitje në ora 08:00. Ne sot na caktuan të bëjmë ngjitje të shkallës së IV-të. Ngjitjet u realizuan duke u ndarë në dy treshe. Udhëheqës litari sot ishin Iliri dhe Sokoli. Xhemoli, si guzhinjer, s'po i tregon aftësitë e tij. Me ushqime (*si furnizim*) jemi shumë mirë. Djemtë me oreks janë mirë! Në darkë mblidhemi e pijmë nga një gotë verë. Gjumi ora 22:00.

## 19 korrik

Në grupin tonë bëjnë pjesë këto ekipe:

1. 17 Nëntori, 7 veta
2. Dajti 4 veta
3. Kastrioti 2 veta
4. Minatori i Tepelenës 5 veta
5. Skëndërbeu 6 veta
6. Kuksi 6 veta

Kampi sot e ka pushim. Alpinistët do merren me probleme të higjenës personale si dhe do të plotësohen me ushqime duke vajtur në Valbonë. Ne si ekip vajtëm në fshatin Rrogam dhe më pas në Valbonë ku blemë ca gjëra.

Sot u përjashtua nga veprimtaria alpinisti i Kuksit Kasem Krasniqi për thyerje të rëndë disiplinore. Ka ikur pa leje në Valbonë dhe është kthyer të nesërmen.

## 20 korrik

Sot ekipi ynë do të bëjë një të gjashtë në majën e Thatë. Një treshe Sokoli, Turi, Mazi dhe një litar tjetër Iliri e Xhimi. Dashi i shoqëroi deri sa dolën në traversën e majës së Thatë. Ngjitja është e vlerësuar e shkallës së gjashtë të vështirësisë por djemtë nuk e pranojnë këtë duke thënë se nuk ngulet asnjë plengë/ gozhdë. Itenerari ishte shumë i gjatë. Nga nisja prej kampit e deri në kthimin zgjati 11 orë. Djemt në orën 17:00 hëngrën edhe drekën edhe darkën. Ishin tepër të lodhur. Them se Mazi e ndjeu më shumë lodhjen ngase i doli tre herë gjak nga hundët. Gjumi si zakonisht më ora 22:00. Për nesër do të punojmë në malin e Rrogamit.

## 21 korrik

Sot ekipi ynë do të bënte dy ngjitje të reja. Kjo u vendos mbrëmë në darkë. U nisëm për në rrëzë të shkëmbit: Aci me Dashin përpara dhe pesë të tjerët pas. I pritëm të vinin sipër tek ne por ata nuk erdhën dhe filluan ngjitje atje ku nuk u tha kush që të fillonin. Aci u nevrikos shumë, aq shumë sa deshti t'i kthente që të pestë për Tiranë. Për të mësuar shkakun për këtë gjest të pahijshëm, mbasdite bëme një mbledhje të vogël ku vetë shokët morrën përsipër fajin duke u treguar të papjekur e të nxituar e duke nxjerrë si pretekst lodhjen e një dite më parë. Gjithashtu spjeguan se nuk u morrën vesht me ndërlidhësin. Premtuan se gjëra të kësaj natyre nuk do të ngjasin më. Darka kishte meny të mirë. Gjumin e bëjmë të mirë, por në mëngjes mezi na del gjumi. Shkaku nuk dihet.

## 22 korrik

Përveç Acit dhe Dashit të gjithë të tjerët mezi ngrihen në mëngjes. Sot punuam në malin e Rrogamit në itenerarë të rinj të cilët për nga vështirësia do të caktohen nga vetë ngjitesit. Sokoli, Mazi dhe Dashi u kthyen shpejt në kamp, kurse të tjerët u kthyen në ora 16:00. Ngjitjet ishin deri diku të mira por të pa shënuara.

Për drekë kemi supë të trashë me makarona e mish viçi, konservë, dhe djathë kaçkavall të shoqëruar me pak verë të kuqe, të cilën e ftohim në ujën e ftohtë të kroit.

Mazi me Kolin e vlerësuan ngjitjen e tyre të IV-të, Iliri, Turi e Xhimi të VI-të të fortë.

Disa ekipe janë dobët me ushqime. Kjo vjen nga mosvlerësimi i kushteve (*mundësive për të siguruar ushqime*) që ka zona ku zhvillohet veprimtaria. (*Faktikisht vitet 80-të ishin vite gjatë të cilave vendi ynë ishte në krizë ushqimore*).

Ky pesëmbëdhjetë ditor shënon rekord temperatursash të larta, aq sa edhe në Prishtinë termometri ka shënuar 42°C *(për parashikimin e motit ne shpesh ndiqnim radio Prishtinën ngase moti në Kosovë afronte me motin në Alpet tona)*. Kjo bëhet pengesë në realizimin e ngjitjeve edhe më të bukura nga këto që po bëhen.

## 23 korrik

Është vendosur që sot të jetë ditë pushimi. Alpinistët të përgatiten e pushojnë për të dhënë maksimumin tre ditët e fundit të veprimtarisë. Përgjithësisht të gjithë ekipet mezi e presin pushimin që të bëjnë plotësime për nevojat ushqimore, higjenë personale dhe gatishmëri të bazës materiale. Ne si ekip do bëjmë këto gjëra: Koli e Mazi do të shkojnë në dyqanin e fshatit Rrogam për të blerë gjëra të ndryshme. Iliri dhe Turi do të shkojnë për ushqime në Valbonë. Xhimi tek guzhina. Për drekë kemi makarona me mish konserve dhe një gotë verë. Acin e lyem me salcë domatesh sepse është djegur nga dielli. Të presin çfarë do na sjellin shokët nga dyqanet...

Shokët sollën vetëm 30 kokra vezë dhe bukë. Kështu që për darkë do kemi vezë të skuqura, djath dhe sallam. Gjumi gjithnjë më 22:00.

## 24 korrik

Është vapë e madhe që sapo del dielli. Morali në ekip është i lartë. Sot ekipi ynë bëri ngjitje në shkëmbejtë e malit të Rrogamit. Iliri e Turi bënë një të pestë, Sokoli, Xhimi e Mazi një të gjashtë. Acin vazhdon të drejtojë ngjitjet në një vend ku është rrëpirë bore e ngrirë. Dashi u fut në një ulluk të shkallës së dytë për të cilin konstatoi se shumë nga ngjitjet që kryen mundet ta përdorin atë për të zbritur. Kthimi në kamp në orën dy. Sot largohet nga

veprimtaria Mazi për dy gëzimë familjare që ka. I dhanë leje Aci e Kozmai.

## 25 korrik

Për sot u vendos që të ngjiten (pushtohen) tre maja: Kollata, Kokërhana dhe Roshi (*si rregul në veprimtaritë verore organizoheshin edhe ngjitje, si në këtë rast, në mënyrë që brezat e alpinistëve të njiheshin me itenerarë të cilët do mund të përdroreshin, dhe përdroreshin, gjatë ngjitjeve të sezonit dimëror*). Ekipi ynë u nda në dy pjesë: Dashi Koli dhe Xhimi në Kokërhane, kurse Aci, Iliri e Turi në Kollatë. Për të dy grupet itenerarët janë të gjatë e të lodhshëm. Grupi i parë u kthye në orën dy, kurse grupi i dytë në orën tre. Të dy majat dhe itenerarët e tyre janë me interes për ngjitjet dimërore.

Dreka u shoqërua me verë. Ju që do lexoni këtë ditar do të thoni: si nuk u mbarua kjo verë!? Kjo sepse është puna e mirë e përgjegjësit të ekipit (*Dashi, i emëruar ose i pa emëruar ishte de facto përgjegjës i ekipit tonë në çdo veprimtari ku ai merte pjesë – shënim nga Aleksandri*), i cili është edhe personi që po e mban këtë ditar.

## 26 korrik

Sot do jetë dita e fundit e veprimtarisë. Ekipi bëri dy ngjitje për tu shënuar: një të gjashtë nga Koli e Turi dhe një të pestë nga Iliri e Xhimi. Në ora tre është lënë të bëhet analiza e veprimtarisë. Sot largohet ekipi i Kukësit për arësye të orarit të transportit Fierzë-Kukës me anije. Mbas analizës ekipet u lejuan të zbresin në Valbonë.

Sot kemi lajmëruar për herë të dytë drejtuesit e sektorit të fizikulturës në Bajram Curri që të bëjnë kujdes për ne për hotel e për transport. Kemi shpresë se ata do të tregojnë kujdes për të korrigjuar pritjen e dobët që na bënë në datën 15 korrik. Dashi e

Koli duan të zbresin në Valbonë. Të tjerët e kanë me pikëpyetje.

Dashi, Koli e Kozmai zbresin në Valbonë. Natën bie një shi i dendur dhe është ftohtë. E kemi mëndjen tek shokët që mbetën lart: Aci, Iliri, Xhimi e Turi. Të nesërmen erdhën edhe ata. Mbasdite nisemi me një makinë ushtarake të cilën e rrgulloi për ne një shok i Acit dhe Dashit, Enver Bakiu, Komisar i Regjimentit Alpin në Valbonë.

Në Bajram Curri na presin shumë keq, sidomos në hotel. Megjithatë rregullohemi. Të nesërmen, më 28 korrik, nisemi me një autobus të vogël për në Mjedë, ku i hipëm trenit i cili mbrriti nga Shkodra pesë minuta pas arritjes sonë. U rregulluam në vagonin e mallrave.

Si përfundim, veprimtaria u kurorëzua me sukses dhe ne si ekip u dalluam për ngjitje të bukura si dhe sjellje e mirëkuptim me ekipet e tjera.

*Mbajtës i Ditarit Dashamir Fejzo*

## **Analiza e aktivitetit**

Kozma Grillo, komandant i ngjitjeve. “Sipas traditës, në fund të çdo aktiviteti, bëhet një analizë për punën që u bë në këto ngjitje. Kërkoj nga ju që të jepni mendime rreth këtyre ngjitjeve duke diskutuar gjithnjë nga pak”

Apostol Babo – i ekipit Skëndërbeu (Toli). Aktiviteti u kurorëzua me sukses, përgatitja teknike ishte e mirë; ne si ekip u paraqitëm mirë. Këtu është vend i përshtatshëm për ngjitje. Falenderoj shokët e 17 Nëntorit të cilët kryen ngjitje të bukura. Kam verejtje lidhur me aktivitetin dimëror; na duhet një aktivitet ku të ketë ngjitje të kategorive të VI-ta. *(klasifikimi unik sportiv për sportin e alpinizmit përmbante ngjitje, si të sezonit veror edhe të atij dimëror, me shkallë të ndryshme vështirësie. Alpinistët të cilët*



*ishin të interesuar për të rritur kategorinë e tyre sportive ishin të interesuar që në zonat e ngjitjeve ku caktoheshin ekipet e tyre të ishin të mundëshëm për ngjitje itenerarë të njohur të të gjitha kategorive që përmbante klasifikim unik sportive). Ne si ekip në të ardhmen do paraqitemi më mirë.*

Mihallaq Çollaku – i ekipit Skëndërbeu (*i qytetit të Korçës*). Në këtë aktivitet u realizuan ngjitje të mira, por më mirë do të jetë që vendi i fushimit të jetë tek Kroi i Rrogamit.

Rahit Hila – ekipi Minatori i Tepelenës. Jam dakort me parafolësit. Mendoj që të gjithë ekipet kishin përgatitje të mirë fizike. Falenderoj Ilir Tapinë, Sokol Dokon, Sokol Hoxhën të cilët kryen ngjitje të bukura. Verejtje kam për ushqimet. Duhet që ekipet t'i marrin masat për ushqime në rrethet e tyre. Ne si ekip u përpoqëm që të kryejmë ngjitje të mira.

Arjan Sena – i ekipit Kastrioti i Krujës. Ne si ekip jemi të vetmit që patëm mangësi. Kjo solli që ne të përfaqësohemi me dy vetë. Ne nuk bëjmë stërvitje të mjaftueshme. Ky është faji i trajnerit të ekipit. Falenderoj shokët e 17 Nëntorit, Sokolin dhe Ilirin.

Kozma Grillo (*drejtures i veprimtarisë dhe trajner i ekipit Dajti*). Si numur ngjitjesh dhe si shkallë vështirësie, krahasuar me veprimtaritë e tjera, ne jemi më pak. Kjo është një minus i madh. Sot, përveç ekipit të 17 Nëntorit asnjë ekip tjetër nuk vajti për ngjitje megjithëse në fillim u treguat të gatshëm. Më vjen keq për të tre ekipet, Dajti, Minatori dhe Skëndërbeu. U dalluan këto ekipe: 17 Nëntori në rradhë të parë e pastaj Kuksi. Në këtë aktivitet u vu re një gjë pozitive që në ngjitje verore këtu nuk vihet më (Buni Ibrahimit) për arsye se ne zbuluam një vend për kampim tek Kroi i Rrogamit.

Punë të mirë bëmë lidhur me pikeimin e ngjitjeve. Këtu u kryen ngjitje të bukura dhe të vështira dhe për këtë ju falenderoj. Verejtje kam për bazën ushqimore e cila ishte shumë e dobët.

Një gjë të mirë bëme në lidhje me një falsifikim të cilin e kanë bërë shokët paraardhës. (E caktuan ) të VI-të dhe nuk ishte e tillë por e IV-të dhe nuk u përdor asnjë plengë. Punë të mirë bënë Sokoli dhe Iliri të 17 Nëntorit. Në përgjithësi ne punuam mirë, por ne bëme edhe një gjë shumë të mirë duke zbuluar e piketuar një poligon të ri.

*Mbajtës i shënimeve të Ditarit Dashamir Fejzo.*

## VITI 1988

*Diku midis muajit shtator 1987 dhe muajit shkurt 1988 – nuk e mbaj mënd - një punonjës civil i Ministrisë së Punëve të Brëndëshme, me gjasë shofer, teksa shkoi me punë në një pikë kufitare, në kufi me ish RSF të Jugosllavisë, me makinë goditi traun e postbllokut të pikës kufitare dhe u arratis. Në kësi situatash partia në pushtet merrte masa të veçanta, më e rëndomta e të cilave ishte vënja në “rreth” për shqyrtim të personave me biografi “të hollë”. Unë isha një i tillë. Kisha parandjenjë që nga Drejtoria e Punëve të Brëndëshme e Tiranës nuk do të më jepej leja kufitare për të shkuar në zonën kufitare ku do të zhvillohej veprimtaria me alpinistët e kategorive të larta (14 – 25 shkurt 1988 në Valbonë). Andaj i rregullova punët që lejen për shkëputje nga puna ta kisha në periudhën 2 deri 12 shkurt, për veprimtarinë në zonën e Bogës, e cila nuk konsiderohej zonë kufitare. Parashikimi im doli. Mua nuk mu dha leja e nevojshme, dhe pas kësaj veprimtarie në Bogë ekipi që drejtoja shkoi në Valbonë pa mua. Për mua kjo qe veprimtari e rrallë në zonën e Bogës për sezonin dimëror, ndonëse fillimisht mund të kem qenë nxitësi kryesor – si anëtar i Komisionit Teknik - që Boga të futej në zonat e veprimtarive alpinistike duke përqëndruar këtu alpinistët të cilët e fillonin këtë sport me ngjitje në Alpe dhe/ose jashtë rretheve të*

*tyre. Me këtë rast dua të shtoj se për të hapur edhe zonën Ducaj për veprimtari alpinistike nuk pati kundërshti në Komisionin Teknik. Kundërshti pati nga kryetari i komisionit në atë kohë për të shtrirë kampimet dimërore në zonën Okol. Në këtë zonë kampimin e shtriu Azem Hyka, me inisiativën e tij dhe pa dijeninë e Komisionit Teknik. Askush nuk e kritikoi dhe që nga ajo kohë majat e maleve nga Ducaj në Okol, u punuan nga alpinistët. Pra u bënë ngjitje në të gjithë këtë luginë dygrykëshe.*

## Aktiviteti kombëtar i kategorive të dyta.

### 3 – 11 shkurt 1988

*(Në këtë kohë klasifikimi unik sportiv për sportin e alpinizmit mundësonte që alpinistët e rinj, të cilët përgatiteshin në rrethet e tyre, kryesisht duke kaluar nëpër sistemin zinxhir të ekipeve pionerë – të rinj, kur arrinin moshën 17 vjeçare kishin të drejtë të merrnin pjesë në veprimtaritë e quajtura kombëtare. Supozohej se ata e kishin fituar, deri në këtë kohë, kategorinë e tretë sportive nëpërmjet veprimtarive që organizonin vetë klubet. Kështu që pjesëmarrësit në veprimtaritë dimërore në grykat Bogë e Ducaj ishin alpinistë të cilët me ngjitjet që realizonin fitonin kategorinë e dytë ose të parë sportive. Ata alpinistë që kishin kategori të parë sportive e lart grupoheshin në veprimtari më vehte; shpesh këto veprimtari cilësoheshin “të kualifikuara”. Nuk më kujtohet viti kur u bënë këto lloj kufizimesh/ndarjesh. Një ndarje e tillë nuk egzistonte në vitet para dhe pas vitit kur unë fillova sportin e alpinizmit. Në vitin 1988 ose 1989 ky kufizim u hoq përsëri.)*

Pjesëmarrësit:

1. Aleksandër Bojaxhi
2. Dashamir Fejzo
3. Qamil Stafa
4. Gazmend Zajmi
5. Altin Sofroni
6. Rudi Bejtja

### 3 shkurt

Kisha shkuar paradite në Shkodër dhe sigurova hotel. E prita ekipin që erdhi me trenin e fundit.

### 4 shkurt

Pasi mbyllëm veprimet e rutinës së mëngjesit dhe hotelit dolëm tek axhensia e autobusëve. U nisëm në 12 e 30. Në Bogë arritëm pas orës tre. Teksa ulnim çantat u takuam me miq e të njohur nga Boga, njerëz bujarë e mikpritës. Meqë dita është e shkurtër, filluam menjëherë ngritjen e çadrave si dhe rregullimet e sistemimet që kërkon ngritja e një fushimi. Më pas darka, bisedat rreth zjarrit dhe fjetja që si zakonisht është në orën 22:00.

### 5 shkurt

Sipas urdhërit të ditës si ekip sot do të ngjitemi në majën e Hundës. Fillimisht u verifikua baza material për çdo ekip. Koha është e mirë. Në majë arritëm në mesditë. Soditëm dhe studjuam itinerarin e kthimit. Gjërat kaluan mirë. Kur arritëm në kamp na priti Komandanti i ngjitjeve, Kozma Grillo të cilin e përshëndetëm me një zig-zag të fortë (*Përshëndetja, urimi edhe gëzimi i arritjes në majë shprehen me thirrjen e të gjithëve bashkë të ngjitur në majën e malit: zig – zag, zig – zag, hej, hej, hej,*

*alpinista jemi ne*). Mbas kësaj të gjithë u shpërndamë duke u marrë sejcili me detyrat e tij si dhe përgatitjen e drekës dhe më vonë të darkës.

## 6 shkurt

Në ora tetë të gjithë ishin gati për ngjitje. Ne na u caktua ngjitja e majës së Pishkamit. Çdo gjë shkoi mirë. Rugës së kthimit mblodhëm dru dhe kërcunj për zjarrin e darkës. Darka si gjithnjë pranë zjarrit.

## 7 shkurt

Veprimet e zakonëshme të mëngjesit e më pas marshim drejt majës. Në majë arritëm rreth orës një. U desht të tregohej mjaft kujdes në zbritje. Gjatë zbritjes përsëri mblodhëm dru për zjarr.

Mbasdite zhvilluam ndeshje futbollit me vëndasit. Fituan ata. Meqë gjatë kohës së ndeshjes binte shi, pas saj u futëm tek furra ku përgatitet buka e fshatit. Furtari, Martini, është gjithnjë dashamirës me ne.

## 8 shkurt

Moti është i keq dhe sejcili u zgjua kur donte. Binte shi papushim. Të gjithë qëndronin në çadrat e tyre. Aty afër drekës shiu pushoi pak dhe u vendos të shkohej në pyll për dru. Dhe kështu u bë. Pasi erdhën drutë u bë një zjarr i madh ku u ngrohëm pak. Shiu vazhdonte.

## 9 shkurt

Koha është e mirë por ca e ftohtë. Ne sulmuam majën e Bridashit të Madh dhe atë të Bridashit të Vogël. Sapo kaluam shpellën filloi pjesa e mbuluar me borë. Ecja gjithnjë përpara. E them këtë jo për tu lavdëruar por sepse kryesova që në fillim e deri në fund, pra deri në majë. Ne u munduam të justifikonim plotësisht veten

tonë dhe në të njëjtën kohë të përfaqësonim plot dinjitet klubin tonë 17 Nëntori, detyrë të cilën e kryem më së miri. Në këtë ngjitje bora me bardhësinë dhe trashësinë e saj e bënte rrugën më të bukur dhe emocionuese, por edhe ca të lodhëshme për disa. Mu desht të ngarkohesha me dy litarë kolektivë, timin dhe të një tjetri. Mbërritëm në majë pas orës një. Bëmë foto. Në darkë, në radio, dëgjuaam për 10 sportistët më të mirë të vitit 1987.

*Mbajtës i Ditarit Dashamir Fejzo*

## 10 shkurt

Sot do të shkojmë në majën e Livadhut të Bogëve. Gjithashtu atje do të marrim dhe kazmën alpine dhe dy litarë kolektivë që kanë lënë grupi tjetër një ditë përpara. Është dita e fundit e aktivitetit. Nisemi nga kampi në orën 10. Rrugës na zuri mjegull, e dëndur, e cila na shoqëroi gjatë gjithë itenerarit, si në ngjitje dhe në kthim. Shtresa e borës sot fillonte më poshtë se ditët e tjera. Pas pak iu afruaam lugut ku ishin litarët (që të ndihmoheshin ngjitesit e tjerë) e lënë nga grupi që drejtonte Aleksandër Bojaxhi. I pari futem unë. Litari ishte shumë i lagur. Dorezat që kisha u bënë ujë dhe i lashë mënjanë bashkë me ca veshje që u menduan të tepërta nga shokët e togës. Filloi ngjitja plot siguri nëpër ullukun e gjatë dhe të bardhë. Shikonim vetëm një metër larg, prej mjegullës. Unë që isha i pari shikoja i përqëndruar, për arësye të mjegullës së dendur, duke shkelur mbi gjurmët që kishin lënë grupi që u ngjit dje. Megjithatë ishim të sigurtë në ngjitje dhe në 13 e 30 arritëm majën. Morrëm materialet e lëna atje dhe pasi thirrëm zig-zagun filluam uljen, me shumë kujdes e maturi. Në kamp na presin shokët. Komandanti i ngjitjeve Kozma Grillo na takon dhe na uron për suksese të tjera. Gjithashtu dhe trajneri ynë Aleksandër Bojaxhi, mjeshtr i sportit na përqafon dhe na thotë “Ju lumtë djema”.

## 11 shkurt

Mbrëmë unë Dashi e Rudi shkuam për darkë tek shtëpia e Martinut ku na pritën shumë mirë. Unë me Rudinin vendosëm të rrinim natën tek çadrat, bashkë me një alpinist të Dajtit. Filloi cikloni. Mbulesën e çadrës era e merte sa në njërën anë në tjetrën. U ngrita në orën 21 dhe fillova të vendosja gurë mbi kunjat që tendosin çadrën për të mos e marrë era, por pa rezultat. Era shoqërohej me shi dhe çadrës i hyri uji brënda. E pamë që ishte e pamundur të qëndronim brënda saj. Por, ku të shkonim? Qëndruam në pjesën e pasme të furrës (së Martinut), pa zjarr e pa gjë. Në mëngjes filloi bora.

Pritëm autobusin që do vinte nga Tirana. Një telegram i ardhur nga Tirana na njoftonte të prisnim autobusin e ekipit Dajti që do të vinte këtu për të na marrë. U futëm tek dyqani i Rokut ku luajtëm domino: Kozmai me Dashin dhe unë me Rudin. Si erdhi autobosi dhe u përqaftuam me bogianët që u ndodhën aty, udhëtuam deri ora 21, kohë kur arritëm në Tiranë.

*Mbajtës i ditarit Qamil Stafa*

## Përsëritje.

### Ditar i mbajtur në Bogë nga 2 deri në 10 shkurt 1988

Programi i veprimtarisë në Bogë ishte ndërtuar me kohë dhe unë nuk isha caktuar me funksion drejtues në veprimtari. Kjo ishte favorizuese sepse mund të zgjidhja ku të shkoja e ku të mos shkoja gjatë ditëve të veprimtarisë. Dashi ishte i caktuar në ekip në rolin e trajnerit.



## 2 shkurt

Dje me trenin e fundit arritëm në Shkodër ekipi ynë, Dajti dhe Apollonia. Në hotel u takuam edhe me ekipet e Kukësit dhe të Studentit. Në dhomë shtrati im i kishte çarçafët të pa ndruar por gjeta të rinj dhe u qetësova

Sot, në pritje për tu nisur, i shoqëruar nga Gëzim Oruçi, vizitova Kujtimin, shokun tim të dhomës në fjetore në Patos. Gëzimi njëherësh më siguroi dy kazma alpine dhe volumin Noli 2 për ta lexuar.

Në Bogë kampin e ngritëm shpejt dhe qëndruam ca kohë në klub ku u takuam me plot të njohur bogianë. Ky vit është i varfër me borë. Nga Ducaj dhe në Okol nuk ka bore veçse nëpër maja malesh. Brezi i borës në mal fillon disa qindra metra mbi qëndrën e fshatit.

Më pas, Kazmai, Dashi dhe unë shkuam tek Roku ku kaluam një natë mjaft të ngrohtë me biseda, ushqime e pije. Tek Roku jemi në 20 vjetorin e njohjes me të (11 janar 1968).

Tashti jemi të tre në dhomë dhe po bisedojmë për një vjedhje prej 1.282.000 lekë që paska ndodhur të mërkurën në Xhaj.

## 3 shkurt

Kur arritëm tek çadrat ekipet ishin në përgatitjet e fundit për nisjen e veprimtarive të ditës. Fjerakët kishin fjetur keq. Nuk kishin çadrat e duhura për të ftotin dhe shiun e natës që kaluan.

Si u nisën ekipet, të ndarë për ngjitjen e majave të ndryshme, mua më caktuan për të drejtuar një grup alpinistësh të cilët vinin për të parën herë në alpe. U nisëm drejt Birojit. Rrugës u mësova teknikat e ngjitjes dhe zbritjes me përdorim të kazmës, si dhe veprimet me litar në rast nevojë për sigurim me të. Arritëm të ngjitemi edhe në majën e Pishave edhe në majën e Birojit.

Koha është e mrekullueshme dhe u kënaqëm. Pikat e ujit që formoheshin në degët e pishave nga bora që shkrinte ndriçoheshin nga dielli dhe era e lehtë që frynte lëkundëte pikat para dhe në rënie dhe natyra dukej si e stolisur me globet e vegjël ndruçues që ndrisin nëpër mjediset dhe pemët e zbukuruara gjatë ditëve që festohet Viti i Ri. Dashi më shoqëroi gjatë gjithë kohës kurse Kozmai kishte mbetur poshtë, aty ku fillonte brezi i borës.

Zbritja ishte e bezdisëshme (*për gjurin tim me ligament të dëmtuar*) sepse terreni është uniformisht shumë i pjerrët. Nga lartësitë lugina soditej shumë bukur. Ajo është si harku i një pjese të rrethit dhe ka gjatësi gati 4 km dhe gjërësi 4-500 metra, ku në mënyrë harmonike ngrihen një mbi një livadhe. Kampi ynë është në qendër të luginës dhe njëherësh fshatit. Pas një ore isha tek çadrat dhe u morra me tharjen e një pjese të veshjeve sepse gjatë natës çanta ime kishte qenë në kontakt me çadrën dhe ato ishin lagur.

Kalova rreth një orë në furrë tek Martini (bukëpjekësi i fshatit). Thava çorapet ndëkohë që Martini më tregonte se këtë vit banorëve të fshatit gjysma e racionit u jepej bukë gruri e gjysma bukë misri; se dita e punës kishte rënë në 100 lekë dhe se thatësira është e paparë e do jemi keq për ujë në verë.

Kur u errësua u nisëm tek Mirashi. Mirashi e Prela janë vëllezër: të qetë, të zgjuar dhe puntorë të zot. Mirashi është brigadier i sektorit të ndërtimeve në kooperativë, Prela punon tek ujësjellësi dhe stacioni i tij është në hyrje të luginës. Prela tregon se tani kuotat e ujit në stacion janë ato të vjeshtës, të cilat janë më të ultat e çdo viti. Nga të gjithë fytyrat mashkullore që kam njohur në malësitë e veriut, mendoj se fytyra e Prelës është më e fismja, më e zgjuara, më fotogjenike. Kaluam këtu një natë të këndëshme dhe në orën 11 shkuam për të fjetur. Në dhomën e gjumit, dysHEMEJA, tavani, divanet e gjithëshka janë punuar nga dy vëllezërit.

#### 4 shkurt

Para se të niseshim pimë kafe dhe në bisedë e sipër mësuam se këtu qënka një mësuese e ciklit të ulët që u jep mësim klasave të treta. Pi duhan e alcohool sa të duash. Para do vitesh i shoqi e mbështolli me batanie dhe e hodhi nga dritarja. Se nga cili kat i pallatit nuk e mësova, sepse variantet ishin nga kati i tretë e deri tek i pesti. Ajo ra poshtë në një piring zhavori dhe shpëtoi nga vdekja.

Me alpinistët shkova në lugun e Brithit dhe gjatë itinerarit ju mësova teknika të ndryshme kalimi në truall me borë. Kur arritëm tek vendi ku lihet rruga e makinës dhe futesh për të shkuar në Shtegun e Dhenve, u kthyem sepse koha morri të keqësohej. Pas drekës dremita pak në çadër dhe më pas shkova tek Martini në furrë. Furra është një pikë e këndëshme për të kaluar kohën në ditët e dimrit me shi, dëgjon informacionet më të reja të fshatit dhe më gjërë. Martini ka shtatë fëmijë prej të cilëve katër janë djem dhe më i madhi është 18 vjeç. Klubi sot është i mbyllur sepse Roku ka shkuar në Koplik për furnizim. Mbasdite alpinistët bënë një lojë futbollit me bogianët, por në të errur loja u ndërpre sepse u zunë dy vetë (si zakonisht në lojën e futbollit këtu).

Aty nga ora 7 ishim tek Roku. Edhe ai u kthye nga Kopliku. U mora pak me Aleksin, me mësimet e tij në fizikë dhe algjebër. Kur u shtruam në tavolinë shikonim edhe TV. Këtu kapen tre stacione televizive dhe është në përfundim e sipër një përforcues për të kapur si duhet TVSH-në.

#### 5 shkurt

U çuam me një mëngjes ku shiu binte pandalur. Roku me Palin janë ngritur në orën katër dhe përmes shiut janë nisur, në këmbë, për në Dedaj (17 km) që të kapin autobusin për në Koplik. Sot

në mëngjes hëngra patate të skuqura me sallo derri që, për shijen time, janë mrekullia nr. 1 në tavolinat e Bogës. Fëmijët u veshën shumë mirë dhe u nisën për në shkollë. Gjelina u nis për një mbledhje (në këmbë) në Xhaj.

Kur u krijua një ndërprerje e shiut u nisëm për tek çadrat tona, por kur arritëm tek furra shiu rifilloi dhe ende nuk ka pushuar. Mësova që fjerakët janë lagur keqas dhe janë futur në dhomën e rojes. Në çadër hëngrëm drekën që e mbyllëm me biskota të sherbetosura të cilat pati fatin t'i provonte edhe Gjelina, e cila kur kish arritur në Ducaj i thanë që mbledhja është anuluar (dhe sigurisht u kthye).

Me Dashin dhe Gjelinën u nisëm dhe kur shkuam në shtëpinë e saj ku gjetëm Rokun dhe Palin që ishin kthyer në këmbë nga Dedaj (35 km vajtje ardhje). Roku ndjehej i lodhur dhe shpejt u ngjit në dhomën e gjumit.

## 6 shkurt

U ndanë grupet e ngjitjeve dhe u bashkova me togën që do ngjitej në majën e Livadhit. Kjo togë ka alpinistët e Fierit dhe dy alpinistë të ekipit Dajti. Ecëm me temp shumë të lartë (më kërkuan pushim por nuk pranova) dhe arritëm tek Shkalla e Keqe për 75 minuta. Kur panë se për të kaluar Shkallën duheshin orë, u erdhi mirë që nuk bëmë pushim.

Koha filloi të prishej dhe vargu malor nga ana e Çardakut u mbulua plotësisht. U lëkunda mjaft që të shoqëroja togën deri në majë. Kjo sepse para 2 a 3 vitesh me një togë alpinistësh u ngjitëm deri afër majës dhe aty mbetëm: mjegullaa ishte aq e dendur sa nuk dinim nga të vazhdonim. Pasi pritëm sa mundëm u kthyem duke ndjekur gjurmët që kishim bërë. Nuk më pëlqente të më ndodhte për së dyti një gjë e tillë dhe e pashë të udhës që t'i vi kësaj maje përsëri në mot me diell. I udhëzova anëtarët e grupit

një nga një deri sa kaluan të gjithë “shkallën” dhe pasi i dhashë Agronit (Shehu) porosinë për itinerarin i lashë ata në dorë të fatit për ndonjë mjegull të zgjatur. U ktheva me Lavdoshin që ndjente ngacmim nervor në shpatull.

Pasi hëngra drekën e vonuar u kthye toga. Ishin ngjitur në majë Agroni, Besniku dhe Ymeri (mjeku). Të tjerët nuk i kishte lejuar Agroni që të ngjiten në mënyrë që të ktheheshin me ditë në kamp. Në majë kishin lënë për shenjë një kazëm alpine.

Shkuam tek shtëpia e Nikollës (zdrukthtarit të fshatit) për të parë në TV ndeshjen Apollonia – 17 Nëntori që doli 1:1. Tek kjo shtëpi çdo gjë më pëlqeu sepse orenditë ishin të bukura e të punuara në dru. Aty ishte edhe një djep mjaft i bukur ku flinte një vajzë pesë muajshe e mbajtur shumë pastër dhe ishte e shëndetëshme. Më pas shkova përsëri në qendër dhe kalova nëpër të gjitha “institucionet” e fshatit: furrën e bukës, zyrën e rojes, klubin si dhe çadrat. Tek çadra jonë më futën brënda dhe më detyruan të ha supën me shumë “përbërës ushqimorë” që ma kishin lënë mënjanë për drekën. Në orën gjashtë u mblodhëm tek Roku. Sot mësova se mësuesi i historisë (Skënderi) në shkollën e fshatit ka pasion arkeologjinë dhe se ka gjetje këtu në Bogë. Do mundohem që kur ai të gjej kohë ta takoj e të ulem me të për një kafe.....

## 7 shkurt

Mbrëmë kur do flinim, Kozmai më tërhoqi vemendjen për Hënë. Ajo po lindëte midis majës së Çardakut dhe majës, për mua, pa emër. Midis këtyre dy majave ishte në qiell një dantellë e bardhë e hollë reje që e ndriçuar nga Hëna dukej si një aureolë që mbështillte të dy majat e zbardhura nga bora. Në shpatet e këndejme vargu malor ndriçonte në pjesën e epërme të tij të mbuluar nga bora. Hëna filloi të lëvizë “me hapin “ e saj mbi

kreshtë e vargmalit, kreshtë e cila, si një thurinë vigane, herë e zinte e herë e lëshonte plotëshmërinë e saj.

Sot, kur u ulëm poshtë u bëra të gjithëve kafë nga e jona. Disa herë e kam bërë unë kafen. U pëlqen ndoshta ngaqë i hedh një kokër kripë, pa tjetër edhe sheqerin e duhur, dhe e zjej gjatë. Kur arritëm tek kampimi Kozmai urdhëroi që të bëhej pastrim e sistemim brënda çadrave si dhe në kamp e rrotull tij. Moti ishte i vrenjtur dhe pasi të kryhej kjo detyrë do merrej një vendim për veprimtari. U ngjita i vetëm mbi Kishë dhe mora shtegun që shkon në drejtim të lagjes Okol. Ndala e pushova pak në një shesh me rasa shumë të gryera. Vendi ishte si çardak e binte drejt e mbi shtëpinë e Bajraktarit të Bogës. Ky është një burë i moshuar, fisnik dhe i njohur në zonë si patriot.

Kur u ktheva togat po shpërndareshin për veprimtarinë e ditës. Dashi nuk po vendoste se ku duhej të shkonte toga ku përfshihej ekipi ynë. Vendosa që ata të nisen për në majën e Livadhit. Pasi u nis toga unë e Dashi u nisëm për tek Kroj i Negovanit. Ishte hera e parë që do të shkoja atje. Fillimisht shtegu ishte i përpjetë dhe pastaj i ëmbël, duke kaluar nëpër pyje e livadhe. Tek kroj uji derdhej nëpër dhjetë korita druri të vendosura shkallë-shkallë. Vajta të pi ujë tek korita e parë, ku uji binte nga një ulluk, edhe ky i punuar me dru. U ndala: aty ishte një salamandër. Banorët e quajnë edhe picrak. Është një zvaranik i zi me damka të verdha. Vazhduam ecjen edhe rreth 30 minuta të tjera dhe më pas u kthyem këndeje nga erdhëm.

Kur u kthyem takova Vuksanin, Kryetarin e Këshillit. Prej tij mësova se Boga kishte 565 banorë që formonin 102 familje dhe të cilat jetonin në 64 shtëpi.

Bashkë me Dashin u nisëm për tek Roku që të shikonim në TV ndeshjen e futbollit që do të transmetohej.

Pas ndeshjes u mora me Aleksin: bëmë detyrat e gjuhës dhe të fizikës. Sot moti ka qenë mjaft i butë. Koha është e vranët me re “të ngrira”, si të ngjitura në faqet e maleve që nga vija e borës (e cila me ardhjen tonë këtu është ngjitur rreth 1-200 metra më lart), e sipër. Hera-herës veson nga pak. Nuk fryn fare. Të gjitha këto më bindin se kemi të bëjmë me fenomenin e fjoimit, i cili nuk dihet se sa zgjat, por që dihet se është pararendësi i një ftoni të ri (të ngrohtë ose të ftohtë).

### Fjalor:

Un kshu jam vadit = unë kështu jam mësuar

Sa me ba çajre = sa për të mos qenë keq (shes a prodhoj djath e gjalp sa për çajre), etj. fjalë e shprehje.

## 8 shkurt

Koha shumë e keqe. Shiu filloi mbrëmë dhe nuk ka pushuar. Ende po bie.... mbetëm brënda. Pasi pimë kafet Dashi mori mushamanë e tavolinës, e hodhi mbi vete, dhe doli. Ne mbetëm brënda. Na shtruan mëngjes ..... Shikoim TV. Pastaj dreka, Pastaj 10-15 minuta gjumë dhe përsëri TV. Fëmijët nuk vajtën në shkollë. Të “frymëzuar” që mbrëmë, unë e Aleksi kemi hedhur në letër fjalë të rralla (për mua) por duke u konsultuar me Raken. Pas orës 5 erdhën Gjelina e Roku. Ai është i lodhur dhe, pasi hëngri darkën iku për të fjetur.

Aleksi e Hana janë binjakë. Aleksi është shumë i lëvizëshëm dhe i zgjuar. Hana është e qetë, e matur, e brishtë... Hana është Hanë. Janë në klasë të tetë.

Sot luajtëm edhe domino edhe me letra, por TV na shpëtoi nga mërzia. Mbas orës 3 filloi të fryjë erë e fortë por e ngrohtë dhe vija e borës është ngritur edhe më sipër. Kjo lloj kohe këtu në Bogë quhet e mirë sepse nuk ka borë në fshat. Tashmë po fryn e po shfryn, bie shi dhe vetëtinë. Gjelina parashikon që nesër

koha do të jetë e mirë. Për djemtë e ekipit nuk kam informacion, por Dashi është atje.

Fjalët që u mbledhën:

Xhak = çantë për bukë

Zgobinatë = gropë me gurë brënda saj

Krepçë = kërraba, hunj që mban hardhinë

Çaranik = raft a dollap për pjata dhe bukë

Mir e n'shtrung = përshëndetja që i thuhet çobanit kur ky mjel bagëtitë

Shtrung = vatha e berave

Partare = grad

Grad = derë e ulët për hyrje në obor

Llojka = dërrasa me të cilat bëhet grad-a

Kubz = sahan druri

Ulisht = koshere bletësh

Forum = vatër

Ne nuk dimë me e **bue** jetën = ne nuk dimë që të kërkojmë jetën ku është më e mirë

Njeriu nuk duhet me kenë i shtrëngut = njeriu nuk duhet të jetë i ngushtë (mendje ngushtë)

Rfan broke = dorezë broke/kane

Mrijna buljeren = ktheje buljeren në njërën anë

Jarmë = pjesë e parmendës ku futen kularët në të

Teik = dy kularë që futen në jarmë

Stogishtë = vendi ku bëhen dhe lidhën mullarët

Strapacim = strapacë = lodhje

Mir bar = përshëndetje që i drejtohet çobanit kur ky është duke kullotur bagëtinë

Stom = kodrinë e vogël

Prajs-a = vendi në burim ku shkarkohen dhe ngarkohen buljerat



Babuke = enë prej druri për drith me nxënësi 15 kg

Neráhen = vendi ku ndryhen bagëtitë

Çaperi = lëkurë dhie ku futet mazë (një lloj qese)

Kputë = shoje = papuçe leshi

Lugicë = ndarëse, garuzhde

Të bani tahole = të bënë të çplakur, të rrjedhun

Trupicë = dërrasa ku çahet e coptohet mishi

Tharg-u = vendi ku ndryhen vetëm dhitë

Perke = pupla

Çulla = shtroje e dyshemesë me lesh dhije

Jollar = gojza e gomarit

Griz = vegël për të grirë lakra

Maj(th) = çekiç i madh që thyen gurë

Kthiç = thikë bajonete

Shkulloj-i = hekuri që kreh prushin në vatër

Prozh = pleh dhije

Liskë = thupur që epet

Plis dhe gubë = dyshek dhe jorgan

## 9 shkurt

Nata ishte e tmerrshme! Erë tepër e fortë. Bindesh se çadrat nuk i mbajnë shkulmet e erës. U mata disa herë që të ngrihesha dhe të shkoja tek djemtë e ekipit. Por tek e fundit e ndava mendjen që të mos shkoj duke patur parasysht dy gjëra: e para, ata janë në qendër të një fshati që tashmë e njohin dhe do të dinë ku të fusin kokën në rast nevojë. E dyta, ja vlente të përjetonin edhe një tufan të tillë kur edhe mund të gjejnë zgjidhje duke qenë në qendër të fshatit.

Kam fjetur me erën: teksa frynte me furi nuk më linte të flija. Më vonë, por tepër vonë ajo pushoi dhe fjeta. U zgjova, por nuk u ngrita, kur doli Kozmai nga dhoma. Kur ai u kthye e pyeta për

motin dhe ai mu përgjigj: “fli”! Por gjumi nuk më zuri dhe në gjashtë e tridhjetë dola në dritare. Binte borë edhe në fshat.

Pasi pimë kafënë dolëm nga shtëpia dhe u nisëm për tek kampi ynë. Bora dukej se po pushonte. Nuk ishte ftohtë. Tendat ishin të ngritura por djemtë më thanë se natën era i kishte rëzuar dhe ata e kishin kaluar natën në aneksin e furrës. Kur kish ardhur Martini ishin futur në furrë për tu ngrohur e për tu tharë dhe më pas i ringritën çadrat. Ndjeheshin mirë dhe nuk ishin trembur! Gazi dhe Altini kishin shkuar në një familje.

Gjatë ditës një pjesë të kohës e kalova nëpër instrucionet e Bogës e ndër të tjera edhe në klub. Më pas Ymo (mjekun) i shoqëruar nga unë dhe Gonja (që të dy janë të ekipit Apollonia) vizitoi Raken e cila që para vizitës mjeksore na shtroi mish djathë dhe raki. Pas një ore shkuam të shoqëruar nga Aleksi në shtëpinë e Prel Prekës ku vizituam dy të moshuarit e familjes si dhe nusen. Plaku ishte 92 vjeç dhe njihet si më i moçmi i Bogës. Mjeku tha se ka shëndet të mirë, më të mirë se e shoqja që është 71 vjeç dhe se nusja e djalit që është 40 vjeç.

Mjeku alpinist Ymer Banushi,  
Profesor Kozma Grillo, Ing.  
Lavdosha Celibashi



Kur ishim në qendër ndjeva dhimbje koke e cila kaloi pasi gëlltita tre aspirina si dhe më bënë dy herë masazh. Me Martinin ramë dakort që në shtëpinë e tij të kalonte natën Dashi me dy nga djemtë e ekipit. Dy djemtë e tjerë tashmë ishin sistemuar në një familje.

U nisa për tek shtëpia e Rokut ku gjeta Kozmain. Bashkë përgatitëm një paçe derri për nesër në mëngjes. Pasi erdhën Gjelina, Pali e Roku u shtruam për darkën. Kozmai sot piu një dopio raki (ai nuk pi) që të kënaqte Rokun. Unë gjysmën. Tani Pali e Kozmai po lozin domino, Aleks i ka rreth dy orë që është ngjitur lart për të fjetur dhe kështu ne kemi mbetur pa zhurmues. Roku sapo është rruar e larë. Ka ardhë koha të mbyll këto shënime, kështu që po ndez një cigare. Shtoj që Kozmait i ka ardhur një telegram nga klubi Dajti që e njofton se nesër ora 11 autobusi do jetë në Bogë për kthim të alpinistëve direkt në Tiranë.

Sot gjithë ditën ka rënë shi i lehtë (thuhet shi i butë që lag t'marrë e t'urtë). Tani nuk bie shi, as erë nuk fryn. Dita e djeshme dhe shkëlqimet e erës gjatë natës duket sikur e kanë lodhur edhe natyrën. Natën!

Kesla mishi = copa të vogla mishi

Shlyet = çngjyrosët

Shkalc = tezgë

## 10 shkurt

Mëngjesi i bukur dhe me një rrezatim të artë diellor nëpër majat e zbardhura nga një rënie e qetë bore dje dhe gjatë natës. Shiu ka shkrirë shumë borë dhe e ka ngritur vijën e borës mjaft lart. Për mëngjes hëngrëm paçen e përgatitur mbrëmë dhe më pas u ndamë me shumë përzëmërsi me Raken. Me të tjerët do ndahemi në qendrën e fshatit.

Pak pas orës 10 u nisën me autobusin e linjës alpinistët e

ekipeve Studenti dhe Apolonia. Kuksianët u nisën dje sepse linja Shkodër-Kukës niset herët në mëngjes. Ne presim autobusin e premtuar.

Ndërkohë vjen nga Shkodra një ekip kontrolli për shkollën këtu. Gjeta rastin të bisedoj me mësues Skënderin për të dhënat historike të fshatit. Ai ka hapur 2-3 varre (tha se ka edhe të tjera). Në njërin prej tyre ka gjetur një heshtë të mesjetës së herëshme. Ka gjetje që dëshmojnë për banorë që në kohët antike, por ende nuk është plotësuar kuadri i dëshmive arkeologjike. Por këto gjetje nuk janë për banorët e sotëm. Sipas gojzës, banorët e sotëm janë të ardhur në kohën e prishjes së fiseve, që d.m.th. para pak shekujve. Kanë qenë katër vëllezër: Seli, Niku, Vuku, dhe Bogu që u ndanë dhe formuan katër fshatrat kryesorë të Kelmendit: Selcën, Nikçin, Vuklin e Bogën. Banorët e atëhershëm të Bogës (pra Bogu dhe familja e tij) u vendosën fillimisht tek shpella. Këtu janë gjetur edhe sot gjurmë dhe gjetje të reja.

Pas vendosje së familjes këtu thonë se një cjan u bë zbuluesi i një burimi uji (mes një pylli të dendur të dikurshëm) burim ky që i jep edhe sot e kësaj dite ujë fshatit.

Në klub takova Prelën i cili më tha se dje prurjet e ujit në stacion kanë qenë maksimale dhe se situata e jashtëzakonëshme për keq me ujë është kapërcyer. Nga majat hera-herës rrokullisen teposhtë orteqe të fuqishme. Është butë. Nga Thethi, përmes Shtegut të Dhenve, erdhën tre udhëtarë që na dhanë mjaft informacione për Thethin. Ne i dëgjua me shumë vemendje sepse edhe Thethi është pjesë e zemrës tonë alpine. Presim autobusin.

*Mbajtës ditari, Aleksandri*

## Shkurt 1988

### Aktiviteti dimëror me kategoritë e para, Valbonë B Curri

Pjesëmarrës:

1. Dashamir Fejzo
2. Sokol Doko
3. Mazllëm Feka
4. Ilir Tapia
5. Artur Shehu
6. Shkëlqim Mema (Guxho)

#### 15 shkurt

Nisemi me autobus për në Koman dhe nga Komani me anijen LABEAT deri në Fierzë. Fierzë-Bajram Curri me autobusat e linjës. Në Bajram Curri na priste autobusi i Klubit Sportiv Valbona që na transportoi në Valbonë ku mbërritëm në orën 16:30. Udhëtimi nga Komani është më pak i lodhshëm dhe më i këndëshëm se udhëtimi direkt Tiranë – Bajram Curri vetëm me autobus. Liqeni është po aq madhështor sa ai i Fierzës. Udhëtimi ishte i bukur, i shoqëruar me rreshje bore me fjolla të mëdha. U sistemua në hotel.

#### 16 shkurt

Sot jemi pushim e vijmë rrotull nëpër Valbonë.

#### 17 shkurt

Koha shumë e mirë dhe nisemi për në majën e Rrogamit. Bora është e thatë dhe ecet shumë mirë mbi të. Kthehemi herët. Nesër themi se duhet të shkojmë në majën e Gavnit dhe Grykat e Hapta (Ismet Sali Bruçaj).

## 18 shkurt

Ngihemi më 05:30 dhe nisemi më 06:20. Koha e mirë por me pak mjegull. Në ora 7 bëjmë pak pushim. Ora 8 e 10 min qëndrojmë tek stanet (Buni Ziçit), ndezim zjarr dhe hamë mëngjesin. Ne quhemi toga e parë (17 Nëntori dhe Apollonia). Nga ekipi ynë në togë janë katër vetë, pa Dashin dhe Guxhon dhe na ka ardhur në togë një alpinist i ekipit të Apolonisë, V. Kozaj. Nisemi më 08:50 dhe në orën 11 mbërrijmë në qafë. Bora vende-vende ishte e ngrirë dhe vende-vende e butë por e thatë. Koha filloi të prishej: të ftohej dhe mjegulla të dëndësohej. Me shumë vështirësi gjejmë majën dhe me shumë vështirësi gjejmë rrugën e kthimit mbasi bora na kishte mbuluar gjurmët. Kthehemi në kamp dhe fillojmë përgatitjen e ushqimit. Më 16:30 mjegulla pushton gjithëshka. Asgjë nuk duket. Ora 20:30 sistemojmë plaçkat dhe rregullojmë shtrojet. Qiriu po mbaron. Jemi mëse mirë ngaqë nuk është ftohtë. Natën e mirë!

*Mbajtës i ditarit, Iliri.*

## 19 shkurt

Nata që kaluam nuk ishte aq e lehtë sa e mendonim. I ftohti ndjehej në shtrojet e poshtëme. Kishin ngrirë të gjitha dhe në çadrat tip NEPAL mpihesh duke ndenjur në një anë. Gjumi na doli disa herë natën. Duhet të ishte edhe më poshtë se -10°C. Filloi të agojë më 05:30. Mbasi kalohet qafa, tani në dimër, shpalosen pamje mjaft të bukura, me streha bore dhe mundësi orteku. Koha është me pak erë por me diell. Kthehemi në Valbonë. U lodhëm disi.

## 20 shkurt

Sot pushim. Me Guxhon shkoj tek posta kufitare për të bërë ski dhe kaluam aty rreth 2 orë. Koha me mjegull.

## 21 shkurt

Koha jo e mirë. Merret vendim për pushim. Mërzitemi disi por tashmë jemi të shlodhur mirë.

## 22 shkurt

Ngihemi për tu nisur për Jezerë (Maja e Rinisë). Por mbrëmë nuk kishte bukë dhe sot buka në furrë ende nuk është pjekur. Koha shumë e mirë, madje duhet thënë e shkëlqyer. Meqë u vonuam për të ngjitur Jezerën, ngjitemi në majën e Kollatës. Kthehemi më 17:40.

## 23 shkurt

Me ekipin e Fierit nisemi për Jezerë. Koha e mirë. Në këtë itenerar, nga ana e Valbonës, unë nuk kam qenë. Kur mbërritëm në masivin e Jezerës u futëm në një lug shumë majtas nga lugu i duhur. Kjo pjesë doli shumë e pjerrët dhe shumë e vështirë. Na morri kohë dhe na lodhi disi, megjithatë rezultoi si itenerar i ri dhe me vlere. U kthyem nga lugu i zakonshëm ku bora e hedhur ishte e një trashësie të madhe. Kthehemi në Valbonë të lodhur.

## 24 dhe 25 shkurt

Koha shumë e keqe dhe nuk bëjmë ngjitje. Në analizën e aktivitetit ekipi ynë u cilësua si ekipi më i mirë, i dalluar në realizimin e ngjitjeve të vështira. Mesatarja jonë e ngjitjeve rezultoi e lartë. Kthimi nga Valbona u bë i zakonshëm dhe pa ndonjë peripeci.

*Mbajtës i ditarit Ilir Tapia*

## Korrik 1988

### 15

Kur arritëm në Shkodër vajtëm drejt e në Hotel Sporti. Këtu jemi mbledhur pjesëmarrësit e të tre zonave të veprimtarisë dhe vende fjetje për të gjithë ne nuk ka. U përdorën mënyra nga më të ndryshmet për t'ja hedhur sportelistit e për tu futur nëpër dhoma. Pati edhe nga ata që ngelën jashtë dhe u hodhën shokët litar nga lart për tu ngjitur nga dritaret. Më pas sportelisti i hotelit hyri për kontroll nëpër dhoma dhe i kapi dy “mashtrulesa”. Tek dhoma me tre shtretër ku fjeta u bëmë gjashtë vetë dhe tre fjetën në dysHEME.

Në mëngjes u ngrita herët. Meqë këtu kushtet janë të papërshtatëshme, morra çantën e shpinës dhe shkova drejt e tek turizmi i vjetër. Lashë çantën në obor të hotelit dhe hyra brënda. Shfrytëzova mediset aty për tu larë e për tu rruar; më pas hëngra dhe mëngjesin dhe u nisa për në axhensi. Rregulluam një kamion rrangallë me një shofer të palarë dhe në 18:30 arritëm në Bogë. Dashi shkoi për të kaluar natën tek Mirashi kurse unë me Kozmain tek Roku.

### 16

Tematika (qeni i shtëpisë) lehu shumë dhe na zgjoi. U nisëm për në qendër e më pas tek Mirashi që na priste për kafe. Ai ka martuar vajzën, Diellën, dhe e uruam. Ajo është martuar në Reç-Rjoll. Për prindërit kjo është gjë shumë e mirë sepse vajza do të jetojë në një vend me klimë më të mirë se në Bogë; Ja dhe fjalë të rralla që “i kapa” në mëngjes. Nga biseda me Palin:

Me nej tan ditën haru = të qëndrosh gjithë ditën në këmbë ose ulur pa punuar

Tjetër, gjatë kafesë:



E mledhun dor(ë)z = e mbledhur tufë (lule, bar, ose bimë mjeksore)

Me bzhitë = me djegë

Për në Theth u nisëm me një kamion të ngarkuar me gëlqere kokër. U ulëm mbi gëlqere. Rruga e pashtuar është tërë pluhur, era na fryn nga pas dhe ne udhëtojmë në një botë pluhuri.

Kur arritëm në Theth shkova në mencë dhe hëngra. Më pas drejt e në lumë ku lava veten dhe çdo gjë tjetër që e konsideroja të pluhrosur. U nisëm për tek Kroi i Shtrazës (*ne e quajmë këtë vend edhe "Tek qershitë" sepse aty janë tre qershi të mëdha e të vjetra*). Ky vend është 15 minuta më tej pasi lë lagjen Okol dhe nisesh për në Qafë Pejë (lagjet e tjera të Thethit janë: Gjeçaj, Nik Gjonaj, Gjellaj, Kolaj, Grunas, Ulaj). Thonë se bëhen 160 shtëpi.

Është dita e tretë që jemi nisur nga Tirana dhe ende nuk jemi në vendin e veprimtarive. Udhëtimi Shkodër-Theth tepër ofendues për racën njerëzore.

## 17

Koha e vrejtur. U la që të merremi me sistemimin e kampit dhe të fillojmë me ngjitjet mbasdite. Unë vet i gjashtë u nisa për tek shpella e Arapit. Nga qershitë në hyrje të shpellës janë 30 minuta ecje. Fillimi i saj është i ngushtë dhe pastaj hapet. Dalja (hyrja) e saj është një "kanal" shkarkimi ujrash. Banorët thonë se në pranverë nga shpella del ujë sikundër në hidrocentrale në rastet kur hapet porta e shkarkimit. Ne kemi vetëm një elektrik dore. Mazi humbi shkrepshen dhe qiriri im mbeti i pandezur. Arritëm tek shkallët që ka lënë Gëzim Oruçi, i cili merret shumë seriozisht me eksplorimin e kësaj shpelle. Pas pak, për arësye se ne nuk kishim ndriçimin që duhej, u kthëm.

## 18

Në orën pesë i bëra zë Ilirit. Ai me Turin do ngjisin sot Arapin nga përpara (faqja jugore) dhe duhet të nisen herët. Unë u nisa pasi ata u nisën dhe zura një vend për të vrojtuar ngjitjen. Ishte vënd shumë i pjerrët dhe nuk kishte mundësi të ulesha. Pas dy orësh erdhën edhe alpinistë të tjerë për të vrojtuar ngjitjen Liri-Turi. Dyshe nuk i eci puna mbarë. Në pikën e parë të nxehtë (shumë të vështirë) Ilirit i ranë shkallët. Shpenzoi mbi një orë për tu ulur e për t'i marrë (i ngecën 30 metra më poshtë). Por Iliri e kaloi shumë mirë pjesën e vështirë dhe doli në traversën e dytë, por kur i erdhi rradha Turit ai morri djathtas, mbeti lavjerës në litar dhe nuk pati kurajo të ngjitej me sportive. Ai tentoi përsëri por edhe më djathtas, por nuk mundi të ngjitet. U detyruan të ulen (i mbështeta në mendimin që të ulen sepse ora kaloi nga 12). Çdo gjë kaloi pastër dhe isha me zero emocione. Tek zbrisja për në kamp mblodha bar dekorativ. Në Bogë këtë bar e quajnë kufil, kuksianët fiollë dhe tropojanët gojfil.

## 19

Jam i shqetësuar për Fotin. I janë çarë fare atletet e ngjitjeve. Janë çarë habitshëm! Është nisur për ngjitje me shapka dhe do e bëjë kacavrvjen zbathur.

Ora ka kaluar nga 18 dhe deri në të errur kam kohë që të nxis Kozmain për t'i mbushur mëndjen që të lëvizim. Megjithatë e kam ndarë mendjen që do ngjitem lart qoftë edhe i vetëm. Këtu të mbysin mizat. Edhe kur ishim në Bogë e njëjta histori me mizat. Edhe në mencën e Thethit. Aty guzhinjerja më tha “nuk kam çu baj” (Vitore quhej). Nuk është problem vetëm fakti që ka shumë miza, por ato të pickojnë edhe kur janë mbi bluzën e tutës.

Një alpinisti të tropojës i erdhi lajmi se i ka vdekur i ati. Ai u nis vet i dytë më 10 e 30 dhe kaloi nga Qafa e Valbonës. Nesër Mazi, Ardi e Koli do punojnë në faqen jugore të Arapit. Do jetë ngjitje e veçantë!

## 20

Më ora 5 më zgjuan çunat për ngjitjen. Pas 15 minutash u nisa vetë i pari drejt itenerarit të ngjitjes. Në orën 6 e 30 isha tek vendi i vrojtimit. Ngjitja filloi pas orës 7. Ajo u realizua, pastër, rrjedhshëm, pa fjalë të tepërta në komunikimet mes tyre. Kisha shumë siguri tek ta dhe isha krejt i qetë nga ana emocionale. Për të vëzhguar ngjitjen erdhën edhe alpinistë të ekipeve të tjera: të Dajtit, Kuksit dhe Përmetit. Ngjitesit në 16 e 30 filluan zbritjen nga maja e Arapit për në kamp.

## 21

Sot jemi pushim. Dashi sapo më ka sjellë kafën. Ndërkohë unë e kam sistremuar plotësisht pjesën time në çadër. Jemi vetëm ne të dy sepse Kozmai ka shkuar për të fjetur tek ekipi i tij. Ne mbetëm këtu tek Kroi i Shtrazës. Kozmai është ai që duhet të marrë vendim që të ngjitemi e të kampojmë në Qafë Pejë.

Paradite bëra një shëtitje të gjatë. Kisha plan që me një grup të ngjiteshim në majën e Alisë, mirëpo mbledhja e shtabit këtë mëngjes u bë me copa dhe u zgjat shumë. Arturi propozoi të shkonim tek ujvara e Thethit (tek katarakti). U nisëm dhe udhëtuam buzë lumit. Dita është e mrekullueshme. Tek qendra shkua në mencë dhe hëngrëm. Kishte vetëm makarona. Në dyqan blemë marmalatë fiku dhe bukë të sapodalë nga furra. Tek katarakti shkua nëpërmjet “urës në shkam” dhe nga ora 14 e deri në 16 u lamë, si dhe lamë veshjet që kishim. Në ora 18 ishim tek kampi ynë. Sot, gjatë kësaj shëtitje, nuk kisha asnjë obligim

për të tjerët dhe e shijova jashtë mase gjithëshka. Mbi të gjitha shijova pamjet e mrekullueshme të kësaj malësie. Ka bukuri të përqëndruara në mënyrë të dëndur e të larmishme duke krijuar aristokracinë e bukurive malore të vendit tonë. Ja vlen që një ditë, për disa ditë, të vi këtu familjarisht për ta prekur ndryshe këtë natyrë. Jo me mendjen se “cilin itinerar do të marrim sot” dhe të mendoj se si të realizohet me suksë. Por me mendjen “nga do shëtisim nesër”? Dhe të shëtisim!

Punët tona këtu në kamp kanë rrjedhur të tilla që unë për nesër jam planifikuar që të nisem për në Qafë Pejë. Por ja që tani që dua të mbyll këto shënime mësoj se kuksianët në ora 14 ishin nisur për në Qafë Pejë për të kaluar atje natën dhe nesër të realizonin një ngjitje të vështirë për të cilën do i udhëzoja. Mirëpo shërbimi kufitar atje i ka kthyer mbrapash dhe nuk do që askush nga ne të afrohet atje. Si është puna!? Faktikisht ka ditë që i bëj vetes pyetjen: përse nuk kanë dalë ende stanet në Qafë Pejë? Si rregull ata dalin atje brënda datës 15 korrik. Sivjet moti është i përshtatëshëm dhe bora është larguar nga kullotat. Me këto kushte të motit ato duhej të dilnin lart që në fillim të muajit.

Mbrëmë ne dëgjuam për një trazirë në Vojvodinë dhe në bisedë u përmend edhe Kosova. Kjo mund të jetë një arësye për këtë qëndrim nga ana e shërbimit kufitar sepse një trazirë diku këtu vjen si një pamje nga ana tjetër e lupës.

## 22

Pas kafesë u nisa për të ndjekur ngjitjet në Murin e Radohinës. Kozmai e Dashi do të ngjiten lart të takojnë komandën e postës kufitare për të marrë leje që të organizojmë ngjitje në zonën e Qafë Pejës.

Tani sapo u kthye dyshja e fundit e ngjitesve në Murin e Radohinës, Iliri dhe Foti. Ishin në ngjitjen që vazhdon më

shumë nga të tjerat por që e ka edhe zbritjen tepër të vështirë. Gjatë zbritjes Foti desh u rrëzua dhe Iliri na tregoi se si shkau ai dhe bëri aluzion se kështu do i ketë ndodhur edhe Pëllumbit kur ra e vdiq në Malin e Thatë.

Treshja e Përmetit u ngjit në faqen jugore të Arapit dhe punoi shumë mirë. Dashi e Kozmai u kthyen nga Qafë Peja dhe atje kishin takuar Shefin e Shtabit të kufirit për rrethin e Shkodrës. “Nuk na lejojnë të shkojmë atje” – tha Kozmai. Qënka një urdhër i ministrit që ne duhet të kemi armë që të shkojmë atje! Po të kishin dalë barinjtë e kooperativës së Grizhes, ata kanë armë, do na lejonin, sepse ata do na “mbulonin” ne (po ata përse nuk i kanë lejuar ende ata që të dalin?). Hajde kujdes për ne hajde! Lum si ne që kaq shumë mendojnë për garancinë e jetës sonë! Luuum!

Mbasdite vonë u dukën delet e kooperativës së Grizhës. Brigada e blegtorisë ka marrë rrugën për Qafë Pejë. Prej tyre mësuam që vonesa ishte shkaktuar nga Dega e Punëve të Brendëshme në Shkodër për dhënien e lejes për personelin shoqëruar të bagëtive për të veruar në zonë kufitare

Tani sapo u kthye Aleksi, përgjegjesi i ekipit të tropojës. Ai ka shoqëruar Rustemin, të cilit i kishte ndodhur vdekja. Mësuam që Rustemit i kishte vdekur xhaxhai dhe jo babai.

## 23

Mbrëmë u ngjitën dy kope me dele për lart. Barinjtë kanë fjetur tek shpella e qafës. Tani po kalon një tufë e tretë. Baza materiale për fjetje si dhe pajisje të tjera do vinë më vonë me një kamion. Mirëpo nuk po duket kamioni. Që kur janë nisur nga fshati i tyre ata flejnë keq natën. Tek bisedonim mbrëmë për këto shrrëgullime me një bari ai e mbylli bisedën duke thënë: “e huuu... Kooperativa asht shpia e budallës”.

Një nga arësytet që i paska vonuar dega e Shkodrës blegtorët për lejet kufitare ka qenë se ajo nuk i lejonte anëtarët e brigadës që të ishin dy vetë nga një shtëpi, ose edhe të afërt mes tyre. Një nga pasojat e këtij urdhëri është fakti që në grupin e tyre këtë vit nuk ka asnjë femër (bashkëshorte, motër, kunatë, etj.) gjë që ka qenë në traditën e brigadës. Kooperativa e Grizhës, me sa kam përjetuar unë, e shfrytëzon këtë kullotë në Qafë Pejë që në vitet 60-të. Për çdo vit këta ngrenë e ulin nga Qafë Peja bazë të shumtë materiale për të ngritur e pastaj çmontuar stanet, baxhon, etj., dhe kurrë nuk kanë bërë një investim që të mbetet infrastruktura atje dhe të shfrytëzohet çdo vit duke u dalë shtegtimi vajtje ardhje më i lirë dhe më i shpejtë.

Iliri me Turin u ngritën në orën 5. Do synojnë përsëri ngjitjen që nuk e realizuan në faqen jugore të malit të Arapit. Djemtë e përmetit do jenë ata që do i vëzhgojnë. Unë shoqërova përsëri grupet që do punonin në Murin e Radomirës. Më 11 e 30 u dëgjua një zig-zag nga mali i Arapit. Ishin Iliri dhe Arturi në momentin që kaluan pjesën e vështirë. Ata u kthyen në kamp në orën dy. Patëm një drekë të mjaftueshme por ushqimi ishte alla ushtrie. Nuk e di se si, por me kthimin e Ilirit dhe Arturit në kamp, mu ndez rishtaz ideja t'i afrohem malit të Boshit nga shtëpitë më të skajshme të lagjes Gjellaj. I ka ardhë rradha atij mali pasi Arapi është “zhvlerësuar”.

Tani është ora 16 dhe kanë dalë retë. Ato hera-herës popullojnë këta hektarë qiell që rrethon kjo thurrinë shkëmbore me maja maresh ku ndodhemi ne. Këtu blerimi është shumëngjyrësh: më i errët është ai i pishave, i zhytur në pyllin shumëdrurësh dhe që ngjitet drejt majave; më i çelur ai i ahishtës që pushton shpatet e maleve, por që thujse kurrë nuk është “tavani” i zonës së pyllëzuar. Blerim edhe më i çelët është në kullotat alpine që zotërojnë lartësitë e mbipyllit. Këtu kullotat mpleksen me faqet

dhe majat shkëmbore mbi të cilat qëndron kupola e kaltër e qiellit. Retë dalin që prapa majave ku duket sikur rinë të fshehura. Kur moti është i mirë sikundër tani, ato rrethojnë luginën dhe rrinë në lartësitë e majave duke lënë kështu qendrën e luginës vetëm në kaltërsinë e qiellit. Kur moti fillon e prishet, ato gradualisht, e kuposin luginën dhe ulen e mbështeten në shpatet e maleve.

Sot herët në mëngjes disa kope me bagëti u ngjitën lart. Ka të tjera që rrinë këtu poshtë dhe presin orët e freskisë (si rregull pas orës 17). Ato presin të fshihet dielli nga majat dhe të nisen.

## 24

Mbrëmë natën erdhi kamjoni me materialet e staneve. Sot djemtë e ekipit të Kozmait u ngritën herët. Edhe ata do të ngjiten në faqen jugore të malit të Arapit. U ngrita edhe unë herët. Që mbrëmë, por edhe tani, i ndjej emocionet e tyre. Tek burimi takova Idrizin. Ai është përgjegjësi i brigadës së blegtorisë. E njoh që nga viti 1964. Nuk kishte dashur të dilte me bagëtitë në Qafë Pejë sepse ishin vonë në kohë. Dega e Punëve të Brendëshme në Shkodër u kishte kthyer 10 herë kërkesën për leje. Idrizi kishte shqetësim se mos kanë dalë sipër kope me bagëti nga të Thethit dhe ja kanë shfrytëzuar kullotat.

Nisa Sokolin lart tek itenerari ku do të punojë ekipi i Dajtit. Mendoj se prania e tij atje do ndikojnë pozitivisht si për alpinistët që do ndërmarrin itenerarin ashtu edhe për Kozmain.

Tani po gjerb një kafe që ma përgatiti Foti. Jam në çadër dhe çadra është nën hijen e qershisë më të vjetër këtu. Rri në çadër që tu shmangem mizave. Gjatë ditës shoqërova alpinistët që u ngjitën në itenerarët e Murit të Radohinës. Kur u kaluan vështirësitë në kacavarjet që kryheshin, fillova të largohem nga Muri. Me disa nga alpinistët që ishin kthyer nga ngjitjet morëm kanalën që vadit një pjesë të tokave në lagjen Okol dhe dolëm

rreth 100 metra nën kampin tonë në rrëzë të pyllit. Këtu është një sharrë dhe një mulli që punojnë me ujë. Të dy këto objekte kanë bukurinë e tyre për primitivitetin apo thjeshtësinë e ndërtimit dhe punimit. Mjedisi këtu është i bukur: në pjesën e rrafshtë është pyll me pishë që shpejt mbi të ngrihet ahishta plot freski dhe e dendur që merr shpatin përpjetë drejt majës së Alisë. Nga ahishta dalin e varen teposhtë plot burime uji. Ka shumë lule margarita dhe janë shumë të bukura. Ka edhe lule që bilologët i quajnë mishëngrënësë. Insektet që ulen në petalet e tyre nuk largohen më prej tyre, por ngecin aty. Hapëm derën e mullirit dhe e vumë atë në punë. Kjo nuk ndodhi me sharrën.

Në kamp gjetëm Fotin. Nuk ka këpucë për kacavarje. Bëri dy ngjitje zbathe por i janë gjakosur këmbët dhe tashti bën punën e guzhinjerit për ne. Lart vazhdon ngjitja e faqes së Arapit nga dyshja e alpinistëve të ekipit të Dajtit. Për t'i drejtuar dhe për siguri janë atje Iliri, Arturi dhe Sokoli. Atje kanë shkuar edhe dy alpinistë të ekipit të tropojës (ata mund të bëjnë këtë ngjitje nesër) si dhe Kozmai, i cili pati rastin në mëngjes që të takonte edhe ai Idrizin.

Për një lehtizë, në 19:30 u nisa në drejtim të Shpellës së Pejës (është në gjysmën e rrugës që të nxjerr në qafë). Aty ndenja rreth 30 min. Prita deri sa u errësua pak. Këtu tek kampi ynë lugina e Thethit rrethohet nga majat Vishens, Arap, Popllukë dhe Ali. Kjo hapësirë, nga lagja Okol e deri afër Shpellës së Pejës i ngjitet qafës me një pjerrësi të fortë, që syri nuk e ndjen në atë masë që e ndjejnë këmbët që i ngjiten. Nga shpatet e maleve zbresin arterie të bardha. Janë përrej me guri (këto gurë, krejt të palatuar, quhen val) të cilat gjatë dimrit shërbejnë si trase orteqesh e më pas në pranverë shtraherë përrejt. Tani zbardhojnë si damarë pa "gjak" mes pyjeve e trashen teksa ulen drejt lumit të Shalës (Thethit) që e furnizojnë me ujë në krye të lagjes Okol. Në këtë



muaj, burimet e lumit janë ulur deri në lagjen Okol. Teksa isha nën shpellën e Qafë Pejës dhe sodisja, shikoja vetëm gropën (një valishtë gjigande e mbjellë me pisha të vockla nga ndërmarrja e pyjores vite më parë) të rrethuar me pyje dhe të përshkruar nga damarët e bardhë të përrenjve që zbresin nga pjesët më të sipërme të shpateve të majave rrethuese. Shikoja përtej edhe lagjen Gjeçaj ndërsa pjesën tjetër të luginës së Thethit ma zë një brinjë e pyllëzuar e cila ngjitet drejt majës së Alisë dhe më pengon pamjen. Kur u nisa të ulesha nga pjerrësia e nënshpellës filloi të errej. Në fillim erret fundi i luginës e më pas errësira “ngrihet” shpateve të maleve. Majat për një farë kohe mben të ndriçuara dhe sot që ka hënë vjen një moment që ndriçimi mbetet nga një lartësi e caktuar dhe përpjetë saj. Prej ku jam duket sikur lakuriqësia e majave e kthen ndriçimin kurse pylli dhe lugina sikur e përthithin atë.

Vazhdoja zbritjen. Qetësinë që mbretëronte e prishte zhurma e këpucëve nëpër zaje. Të ecësh natën e në dritë të hënës, për më tepër i vetëm, është kënaqësi. Në kamp më duket sikur hëna e hedh ndriçimin që përtej një thurrnaje majash të kreshpëzuara, të cilat herë e fshehin dhe herë e rishfaqin ndriçimin e saj, deri sa edhe ajo perëndon për ne dhe e hedh dritën e fshehur për shikimin tonë nëpër majat e maleve që janë pëkundrejtë.

Djemtë e ekipit të Dajtit u kthyen në ora 7 (u vonuan sepse u rikthyen në majë ngaqë harruan aty pajimet e ngjitjes) dhe e realizuan tenerarin me sukses. Dashi kishte qenë në fshat në dasëm dhe u kthye herët. Tha se atje kërcehej dhe këndohej vetëm popullorshe. Kishin sjellë aty nga Bajram Curri Caje Paleshin.

## 25

Psi mbaruam me mëngjesin u nisëm. Kaluam nëpër lagjen Gjellaj dhe i ramë asaj qark e përqark. Këtu ka livadhe, kopshte e

shtëpi interesante; blerim dhe ujë ngado. Këtu veshët të dëgjojnë gurgullima apo shushurima të ujit në lloje nga më të ndryshmet: të lumit që përtej, të kanalit ujitës, të përroit, të burimit. Në kthim shkuam tek pellgu i përroit që zbret nga mali i Boshit ku kaluam ca kohë.

Para se të hanim drekën piva një kafe që e bëra vetë. Tek e pija dëgjova dy alpinistë që bisedonin. Njëri prej tyre tha: kaq shumë gërhet Niku sa që tërë natën kam parë ëndëra me traktora dhe traktoristë. Drekën e kishim të bollëshme, sidomos me mish. Kjo ngaqë, në kërkim për ushqim gjatë përgatitjes për nisje, “ramë” në kuti mishi.

Tashmë është nxirë andej nga Radohina dhe njëherësh po bubullin. Maja e saj vezake, e çveshur nga bimësia dhe me ngjyrë gri, është tregues-parashikues i motit.

U kthyen alpinistët e tropojës që realizuan me suksen ngjitjen e faqes jugore të Arapit. Sukses! Urime për ta!

Sapo ka ardhur këtu një fshatar i Thethit i cili ngjitet e zbret çdo ditë malin e Arapit. Ai mbledh “bar zemre”, një bimë mjeksore kjo që shitet me çmim të mirë në pikat e grumbullimit. Duket i varfër dhe e mëshiron kushdo këtu në kampin tonë. Kalon këndeje vonë, i ngarkuar rëndë, herë i vetëm e herë me gruan. Sot ka me vete djalin 12 vjeçar. E mora – më tha – sepse kishte dëshirë të dilte lart. Kushedi se sa shumë lidhet prindi me fëmijën përmes këtij mundimi dhe mjerimi. I fala një litar personal (*litar me diametër 6 mm dhe me gjatësi 4 metra*) sepse e kërkoi. Nesër fshatari do e çvendosë zonën e mbledhjes së barit mjeksor dhe do të kalojë në zonën e Livadheve të Bogës.

## 26

Kemi 30 minuta që kemi arritur në Bogë. Na morri një karocë nga qendra e fshatit deri tek kampi i punëtorëve. Pastaj na morri

një shofer kamioni. Ai ishte me nënë e baba rus. I ati kishte 10 vjet që i kishte vdekur. Në qafë Thore ai u ngarkua me purteka për domate. Hipa mbi purteka për të arritur në Bogë. Purtekat ngriheshin 1a 2 mera mbi spontet e makinës. Fillimisht ndjeva frikë, por më pas u mësova.

*Mbajtës i ditarit, Aleksandri*

# VITI 1989

## Aktiviteti kombëtar alpinistik me kategoritë e para (Dimërore) Shtegu i Dhenve

Pjesëmarrësit:

1. Aleksandër Bojaxhi
2. Dashamir Fejzo
3. Soklo Doko
4. Mazllëm Feka
5. Ilir Tapia
6. Artur Shehu
7. Xhemal Begeja

### 16 shkurt

Nisemi nga Tirana me autobusin e Klubit Dajti dhe në ora dy arrijmë në Fushë Okol. Prej këtu nisemi e marshojmë në drejtim të Shtegut. Rrugës takojmë ekipet e Tropojës dhe Përmetit. Ngemë çadrat tek fusha dhe, ...gjumë.



Ekipi i alpinistëve të klubit Dajti dhe drejtuesit e atij klubi

## 17 shkurt

Zgjimi më 07:30; në ora 8 hamë mëngjesin dhe më ora 9 nisemi drejt itenerarëve. Të gjithë alpinistët caktohen të punojnë në Kala (është pjesa shkëmbore në veri të Shtegut të Dhenve. Itenerarët për kacavarje janë të thjeshtë) sipas itenerarëve të parashënuar. Ne na u caktua I-4-ra. Mbasi ne të pestë e ralizuam, kthehemi tek çadrat të ngarkuar me dru. Xhimi si guzhinjer nis e fillon të bëjë supën dhe tenxherja e parë i derdhet. Fillon për së dyti.

## 18 shkurt

Zgjimi më herët se një ditë më parë. Mbasi hamë mëngjesin pranë zjarrit që ka ndezur Dashi bëjmë rrjeshtimin. Alpinistët e ekipit të Valbonës dhe ata të ekipit të Dajtit vajtën tek Kalaja për të punuar, kurse ne vajtëm për të punuar në Shteg (*majën e Shtegut*) tek I-1 me shkallë të katërt vështirësie verore. Futen në

fillim Sokoli me Mazin dhe më ora 11:30 u futëm Liri (*Ilir Tapia*) Turi, Xhimi. Fillimi ishte i vështirë se kishte akull dhe ngjiteshim edhe në shkëmb me kthetra. Ja dolëm mbarë. Në mes të ngjitjes nuk del litari për rigrupim. Mua mu desht që të zgjatesha dhe t'i liroja litar Xhimit. Në kamp kaluam kohën pranë zjarrit. Koha e mirë por e ftohtë.

## 19 shkurt

Në mëngjes pasi pimë kakao bëmë rrjeshtimin. Ne na caktuan I-9-ën, Liri me Turin. Mbas nesh do vinin Koli, Xhimi, Mazi. Përmeti tek I-1, Dajti u caktua tek I-4. Nardi me Xhixhën patën një keqkuptim mes tyre dhe Nardi fluturoi nja 10 metra poshtë. Këto na i thotë Aci por nuk ndodhi gjë për tu shqetësuar. Ne mbasi mbaruam I-9 në 2 e 15 minuta arritëm tek çadrat.

Mbasdite mblodhëm dru. Nga ora 5 bëmë një mbledhje dhe morrëm vesht punën e Nardit. Bëmë zjarr të madh në darkë dhe u mblodhëm të gjithë ne alpinistët nga Tirana. Liri i kërkoi profesor Acit për të bërë I-8 me shkallë të gjashtë vështirësie që në dimër nuk është bërë ndonjëherë, por mund të bëhet për të parën herë.

## 20 shkurt

Ditë e hënë. Kjo ditë është pushim për të gjithë. Kush kishte dëshirë mund të shkonte në Bogë e kush në Theth. U nisëm me kthetra të veshura për në Theth. Kaluam Shtegun dhe për 90 minuta ishim në Theth; Liri, Turi, Xhimi, Mazi. Vajtëm tek dyqanet dhe takuam Gonen. Na dhanë të hanim drekë dhe pasi dëgjuam qyfyret e Taxhedinit u nisëm për në kampin tonë ku arritëm në orën katër. Dreka na ishte përgatitur. Pasi bëmë në çadër kakao në primus dhe e pimë atë, mblodhëm dru.

## 21 shkurt

Ditë e martë. U zgjuam në ora tetë. Pas mëngjesit ishim gati për të bërë I-8, Liri, Turi, Xhimi; kurse Koli me Mazin tek I-9. Profesorri vajti në Mark për të ndjekur të tjerët.

Në ora 11:10 ishim në majë (*të faqes shkëmbore*) të I-8, por nga bora rruga ishte e keqe dhe vazhduam ngjitjen edhe më tutje me sigurim dhe rrugës bëmë nga një fotografi. Dolëm në majë të malit dhe bëmë zig-zagun. Erdhëm tek çadrat dhe presim të hamë drekën. Pastaj u shtrimë. Unë me Lirin luajtëm nja dy orë domino, pastaj nga ora 7 e darkës pimë nga një kakao. Më pas Dashi i thotë profesorit për të gatuar paçe dhe deri më 9 e 30 e përfunduan por ajo është për ta ngrënë nesër në mëngjes.

## 22 shkurt

U zgjuam nga ora 7 e 30 minuta. Koha ishte me mjegull. Për alpinistët ishin caktuar ngjitjet dhe ashtu u bë. Tek I-8 u caktuan Mazi me Kolin si dhe Përmeti, kurse ne na caktuan në Mark për të bërë I-2 me shkallë vështirësie të IV-të. Ngjitja ishte e lodhëshme.

## 23 shkurt

Mund të themi se është dita e fundit e aktivitetit. Koha ka qenë e keqe por në mëngjes u hap. Pasi mbaruam me mëngjesin na caktuan për ngjitje I-2: Liri, Turi, Koli i Dajtit. Xhimi, Koli, Mazi bënë pushim. Filluam ngjitjen. Ishte e vështirë sepse kishte lugje me borë dhe shkëmbi ishte i ftohtë. Liri udhëhiqte, unë isha i dyti. Kur fillova ngjitjen, litari mu ngatërrua në një shkëmb dhe fillova ta tërheq me zorr të madh. Kishte ngelur në një ulluk me akull dhe me dorën e majtë tërhiqja litarin, e afroja tek dhëmbët dhe e tërhiqja më pas me gjithë forcën. Mu paralizua qafa nga sforcimi i madh. Mbasi tërhoqa litarin filluam rigrupimin dhe

nga ora 12 ishim në majë. Aty na zuri mjegulla, por rruga ishte e hapur për ne sepse kishte gjurmë. Gjatë zbritjes filluan gallatat dhe Sokol Hoxha tregonte qyfyret e Xhixhës.

Mbasi u thamë u ulëm për të ngrënë darkën dhe më pas rreth zjarrit ku sejcili tregonte gallatat e veta. Xhimi preu gishtin me brisk dhe e zuri gjaku. U pre. Filluan ta fërkonin dhe më pas erdhi në vete.

## 24 shkurt

U çuam në orën 5 nga të fohetit dhe hapëm radion. Nga ora 7 jep urdhër profesori për tu shpërngulur komplet kampi dhe të shkojmë në Bogë për të ngritur kampingun dhe të qëndrojmë dy ditë atje. Të fundit që dolëm nga çadra ishim ne. Koha shumë e keqe. Filloi të bjerë si një lloj shi dhe borë. Pas dy orësh ishim në Bogë dhe ngritëm çadrat, por filloi një erë e madhe dhe një çadër e morri era. Çadra jonë nuk pësoi gjë. Ne i vumë çadrës gurë të mëdhej. Nata kaloi me shqetësime të shumta nga era e madhe.

## 25 shkurt

Në mëngjes era filloi të bjerë dhe nuk kishte më forcë të madhe. Në ora 8 vjen profesori dhe na thotë që të shkrehim çadrat dhe të bëhemi gati për tu nisur për në Shkodër, sepse koha do të fillojë të prishet edhe më keq, aq sa edhe çadrat mund të dëmtohen. Nga ora 9 e 30 bëmë analizën e ngjitjeve. Gjatë saj të gjithë alpinistët kërkonin në mënyrë të prerë tu vihej trajtimi (kuotë ushqimore falas) si dhe të bëheshin edhe xhirime të veprimtarive që të njihet edhe sporti ynë si sportet e tjera. U fol edhe për bazën materiale, por edhe për shumë gjëra të tjera. Aty nga ora 11 erdhi autobusi (*shkrimi është thuarje i palexueshëm, por nëpër rrjeshta kuptohet se autobusi ishte për pasagjerët dhe jo për sportistat. Kthimi u bë duke udhëtuar edhe në këmbë deri në Xhaj. Tek e fundit u arrit në*



*Shkodër –AB*). Tek hotel Sporti shohim një autobus të Tiranës. Shoferi na dha fjalën për të na marrë në Tiranë. Autobusi ishte i Klubit Dinamo, për ekipet e volejbollit meshkuj e femra. Hipën të gjithë sportistët, hipëm edhe ne. Liri, Dashi, Turi, Aci, dhe Xhimi ndenjën në Shkodër.

*Mbajtës i ditarit Artur Shehu*

## Shkurt 1989

### 16 shkurt

Përfundimisht nga Tirana u nisëm në orën 8. Në Shkodër qëndruam 30 minuta dhe në Bogë, rreth 1 a 2 km mbi Fushën e Okolit, ku zbritëm, ishim para orës 14. Pas 30 minutash u nisëm për tek Gropat e Portës (nën Shtegun e Dhenve) dhe ndaluan aty ku menduam se jemi disi të mbrojtur nga era edhe me mundësi për dru ahu që të përdorim zjarr për nevojat tona. Moti mbajti për ngritjen e çadrave mbi borë, ndonëse më pas filloi edhe një borë e lehtë. Kur u errësua, çdo gjë që lidhej me ngritjen e kampit ishte përfunduar. Nuk kishim ngrënë drekë, kështu që hëngrëm darkë! Kur dukej se mbaruam me gjithëshka në çadër erdhi Sokoli i Dajtit dhe Flamuri i Përmetit që më informuan për disa çështje. Jashtë u ndez zjarri, por unë rashë të fle me pulat.

### 17 shkurt

I pari u ngrit Dashi. Turfullon sepse nuk ka radio personale. Dola dhe u morra ekupeve informacionet që më duheshin për plotësimin e dokumentave të veprimtarisë. Kur mbarova këtë punë shkova tek zjarri i ekipit të Dajtit. Profesor Kozmai ishte mirë. Kemi kaluar natën e parë në çadra të ngitura mbi borë dhe tani është dita e parë që po organizon sejcili ekip dhe sejcili

alpinist veprimet e mëngjesit. Në rrjeshim i porosita për veprimet që duheshin kryer në zonat me borë dhe para orës 10 u nisëm për ngjitje.

Ndërkohë kishte ardhur Paulini. E kishte nisur Roku që të mësonte se përse ne nuk ndalëm në Bogë. Ai erdhi me ne deri tek Kalaja e Shtegut (*mur shkëmbor në veri të Shtegut të Dhenve i cili nga Thethi duket si një fragment kalaje/kështjelle*). Që ai të mos rrëshqiste i veshëm një palë kthetra të cilat i pëlqyen shumë për funksionin që përdoren. Unë e Kozmai qëndruam për pak kohë në grykën e Shtegut duke soditur malin e Boshit si dhe duke biseduar për ngjitjet që mendonim të bëheshin në atë mal gjatë sezonit veror. Më pas u ulëm poshtë tek një pishë e tharë dhe e rrëzuar që tropojasit dhe Dashi i kishin vënë zjarrin. Ishte vend i përshtatëshëm për të vrojtur veprimet e alpinistëve që ngjiteshin këtu, në faqen shkëmbore të pjesës veriore të malit të Shtegut (*North Face*!).

Ndënjëm aty deri sa zbriti edhe litari i fundit i ngjitësve. Më pas zbritëm, me shumë kujdes, madje përdorëm edhe litarin për sigurim në një segment me akull, sepse të dy ishim pa kthetra. Kur arritëm “fushën” ku ne ngrejmë kampet e veprimtarive të sezonit veror shtruum xhupat mbi borë dhe ndënjëm e biseduam një copë herë për ekipet dhe komunikimet me anëtarët e ekipit. Kur dielli u zu nga majat u ngritëm.

Teksa alpinistët ngjiteshin, rreth orës 12, filloi një borë e lehtë për rreth 15 minuta. Tani duket që moti po kthjellohet gjithnjë e më shumë. Dje ishte më ftohtë. Kur arritëm dje këtu, ndrova kanatjeren e djersitur dhe ajo menjëherë ngriu. Më pas moti u vrenjt shumë por nuk pati rreshje. Sot vransira shtohet e pakohet por duket se nuk do kemi rreshje.

Mbas drekës së vonuar sistemova përfundimisht çadrën time, mbylla llogaritë e djetave sportive dhe mblodha shtabin e veprimtarisë për të përcaktuar itenerarët e ngjitjeve për nesër.

Më pas kaluam kohë rreth zjarrit. Piva dhe një çaj pa shije sepse bëhet duke shkrirë borën dhe vjen era tymm. Uji nuk mund të pihet (vjen era tym) andaj cilido e bën ujin çaj dhe piet edhe më mirë kur e bën kakao.

Tani i vjen rradha gjumit. Krahasuar me mbrëmë sejcili ka mundësi të përmirësojë cilësinë e gjumit. Vesha dy palë çorape leshi: një të shkurtëra e një të gjata. Vesha kofshoret, kanotjere të trashë, tutat, jelekun e gëzoftë, pulovrin dhe sigurisht kokoren. Mbi dyshemenë e çadrës kam një “platformë” me bukë peshku (janë copa polisteroli të ngjitura me beze dhe vinovil që palosen një mbi një gjatë transportit) dhe mbi to një batanie të shtrirë për së gjëri, mbi të thesin e fjetjes që ka sipër pjesën e tepërt të batanijes. Në pjesën e këmbëve thesin e fjetjes e kam futur në një “thes” apo qese të madhe plasmasi dhe sipër hedh xhaketen e shajakut. Sonte qielli është i pastër, hëna ndriçon mirë dhe për fatin tonë nuk fryn erë.

## Shkurt 18

Të gjithë u ankuan që kishin kaluat natë të ftohtë. Edhe unë. Vetëm këmbët i kisha të ngrohta. Çadra jonë nga brënda kish zënë brymë ngaqë kondensohet në fletët e saj lagështia e frymëve tona. Dita ka dalë shumë e bukur. Qielli i pastër. Për koincidence çadra jonë është e para që e shikon diellin këtu; në orën 08:30.

Pas orës 9 u rrjeshtuam dhe u nisëm. Të fundit unë e Kozmai. Për sot ka interes ngjitja sipas I-1 për në majën e Shtegut. U vendosëm përballë këtij itinerari. Dyshja e parë që filloi ngjitjen ishin Koli e Mazi (ora 09:45) dhe kur Koli doli mbi oxhak u nis treshja Iliri, Turi, Xhimi. Dyshja doli në majë pas 2 orë e 30 minuta nga nisja kurse treshja pas 3 orë e 15 minuta. Kishte vështirësi në zonat ku kalohej nga shkëmbi në borë dhe

anasjelltas. Gjithëshka kaloi mirë për të gjithë litarët e punës. Pra ishte një ditë e mbarë për qëllimin që kemi në këtë aktivitet: ngjtitjet që kryejmë në këtë mal në sezonin veror t'i realizojmë edhe në dimër.

Ekipet e tjera u ngjtën në itenerarët e Kalasë dhe kështu këtyre itenerarëve (të Kalasë) u vumë “pikë dhe vizë” për ditët në vijim. Tani sapo u mbyll mbledhja e shtabit dhe i binda që nesër të synohen itenerarët e majës së Shtegut. Pati frymë ngurimi. Më të përparuar, krahas ekipit tonë, duken përmetarët. Lidhur me sigurinë që kërkojnë alpinistët ndikon mjaft cilësia e alpinistit që udhëheq itenerarin.

Kur arrita tek çadra treshja jonë ende nuk ishte kthyer. Dreka dhe zjarri ishin përgatitur nga ata që arritën të parët aty. Më vonë vjen Agim Muça dhe më njofton që ka ardhë Roku, i cili ka ndalur tek çadra e Kozmait. Shkova atje. Ai ka ardhë që të na marrë poshtë për të fjetur, në shtëpinë e tij. E skjaruam për qëllimin tonë këtu dhe i premtuam që Kozmai nesër në darkë do jetë poshtë. Kozmai në fakt do largohet prej veprimtarisë.

## Shkurt 19

Mëngjesi ishte i vrenjtur kurse dita e djeshme dhe nata ishin të mrekullueshme. Kam fjetur ngrohtë. U nisëm për ngjitje në orën 9 e 30 me kohë të vrenjtur por që duket se nuk do ketë rreshje, të paktën për disa orë, sepse retë janë shumë lart. Përmetarët u futën në I-1, tropojanët në I-11 e Tirana në I-10. Këto ngjitje përfunduan mirë.

Ekipi i Dajtit donte të futej në I-4 por, po ta shihte më të volitëshme, morri lejë të futet në I-6. Ata ju afruan shkëmbit dhe pas një ngurimi të zgjatur, një treshe u drejtua midis I-5 dhe I-6. Avancoi rreth një litar dhe më pas nuk po lëvizte më. Një dyshe, Nardi dhe Xhixha, u futën në një oxhak midis I-4

dhe I-5 që fillonte direkt mbi borë dhe nuk i pamë më. Pas rreth një ore (unë e Kozmai bisedonim e prisnim kur do dalin - kur do i shohim, e të fillojnë ngjitjen) dëgjova zëra të tensionuar dhe pas një çasti pashë Nardin të varur në litar që lëkundej si lavjerës për rreth 2 a 3 metra mbi fillimin e oxhakut. Ai kërkoi që t'i lëshohej litar deri sa preku borën dhe u fut brënda (në oxhak) duke na u zhdukur nga pamja. Çfarë kishte ndodhur?

Nardi e Xhixha ishin futur në oxhak duke menduar se janë në I-4. Më vonë e kishin kuptuar se janë gabim. Xhixha ngulte këmbë që të ktheheshin kurse Nardi që të vazhdonin. Rreth një metër pa dalë nga oxhaku Nardi i ndjen gishtat të ngrirë (ai udhëheq ngjitjen), tenton të ngjitet më tej por nuk i punojnë gishtat. I thërret Xhixhës që të sigurojë mirë sepse do të bjerë (e ndjeu) dhe ra. Çau pak kokën mbi ballë, u çorr ca nga duart, goditi zverkun dhe shëmbi shpatullën e djathtë ca nga tensioni i litarit e ca nga ndonjë përplasje me ndonjë shkëmb. Fillimisht mezi merte frymë. U erdhi treshja e Dajtit në ndihmë si dhe u afrua Kozmai për t'i orientuar.

Kur çdo gjë kaloi dhe ata u mblodhën tek Kozmai ky i shau dhe i kërdisi sa më erdhi keq. Pastaj të gjithë i nisëm poshtë kurse Nardi, Kozmai dhe unë u kthyem bashkë. Nardi çalonte pak dhe kishte vështirësi në frymëmarrje dhe tha “më duken mushkëritë sikur i kam sa një vezë pate”. Ka mundësi që shumë-shumë të ketë krisje të brinjës.



Gëzim Hima, Leonard Rama, Sokol Hoxha

Në orën 3 ishim në kamp. Hëngra drekën, i fundit (thonë që i fundit o qan o qesh. Unë qesha!) dhe më pas vajta tek çadra e Dajtit. Gjeta Kozmain që po u bënte djemve një gjygj llogjik për gabimet që kishin bërë. Në orën 16 u ulën poshtë në Bogë Kozmai, i cili nesër duhet të niset për në Tiranë, Nardi për mjekim dhe kushte qetësuese për një o më shumë ditë, si dhe Sokoli për të shoqëruar Nardin.

Po në të njëjtën orë mblodha shtabin që tu merja mendim për punën e bërë deri sot dhe për mendimet e tyre në ditët që do të vijnë. Ishin pozitivë për qëllimin që kemi.

Më thirrën djemtë e ekipit që t'i informoja lidhur me Nardin. Çadra jonë është rreth 50 metra larg nga ajo e ekipit të Dajtit. Ndënja gjatë pranë zjarrit. Është e vetmja mënyrë për të shtyrë orët me biseda dhe me ngrohtësinë e zjarrit (por jo me tymin që të shqetëson hera-herës). Pastaj i hedh sytë nga hëna e cila duke lëvizur mbi malin e Shtegut noton nëpër retë që më së shumti janë të bardha dhe pak prej tyre të zeza. Mësuam se nesër në orën 5 e 30 do kemi eklips të hënës. Pastaj kaluam në leksion astronomie...

## Shkurt 20

Sot është ditë pushimi që d.m.th nuk ka program për ngjitje. Dashi është ngritur më herët dhe bashkë me Kolin janë nisur për në Bogë. Anëtarët e tjerë të ekipit më kërkuan lejë për të shkuar në Theth. U dhashë leje dhe të dy palët erdhën në kamp thujse në të njëjtën orë; 15:30. Nga djemtë e ardhur nga Thethi mësova se grupi i alpinistëve që duhej të kryente veprimtarinë në zonën e Qafë Pejës nuk është lejuar nga posta kufitare që të ngjitet atje. Djemve njëherësh u kanë lënë porosi nga kufiri për ne që të mos e kalojmë bjeshkën e Markut (Binjakun e Thethit). Tek drejtuesit e kufirit parimi “të jemi brënda” është parim i madh (sa për të larë gojën).

Kur u larguan djemtë e ekipit vendosa të bëja një lehtizë. U bëra ftesë atyre që ishin në kamp por nuk u përgjegj kush. U veshja, vura kthertrat, morra kazmën dhe u nisa. Tek fillova ecjen thirra Hajdar Hasën. U tregua i gatëshëm. Eca vetëm rreth 30 minuta dhe pastaj prita Hajdarin. Hajdari është nga fshati Gri i Tropojës. Njihet si alpinisti më i vjetër i ekipit të tij. E vlerësoj si alpinist i mirë. Nuk para e pëlqejnë sepse ka fjalë shumë. Por është i pa të keq. Është i dobët (peshë e lehtë) me sy të kaltër e pak të dalë; flokët gështenjë i rrinë më shumë përpjetë se të shtruara. Vuan nga tiroidet dhe është asmatik. Më thotë se gjendja e tij shëndetësore e bën që të merret me alpinizëm sepse i bën mirë. Kur filluam të ecim bashkë më kërkoi që të ul tempin e ecjes. Kur dolëm mbi Gropën e Radohinës, në qafën midis dy majave, morra të ngjitem në majën e Markut. Rashë në një nga ato zgavrat që krijohen midis borës dhe shkëmbit, por që sipër janë të mbuluara me borë. Mbeta i mbërthyer me kazëm e me brylla në sipërfaqe, gjë që më nundësoi të dal shpejt mbi borë. Pas kësaj që ndodhi ngulmimi i Hajdari që të mos e ngjisnim majën dhe mungesa e litarit bënë që të kthehemi në kamp. E gjithë kjo kënaqësi zgjati tre orë.

Më duhet të shkoj nëpër çadrat e ekipeve që të koordinojmë itenerarët e ngjitjeve për nesër. Çorapet dhe këpucët i kam lënë nëpër shkëmbinj që të thahen. Më duhet të eci zbathur nëpër borë për të shkuar deri atje. Por kjo ka një të mirë: lahen këmbët.

## Shkurt 21

Në mëngjes u realizuan dy itenerarë të bukur në malin e Shtegut: I-8 nga Iliri, Arturi e Xhimi. Fillimi i itenerarit është një diedër (dyfaqësh) mbi 40 metra i lartë që vlerësohet i shkallës së gjashtë të vështirësisë. Kjo faqe shkëmbore është pa pikë bore

sepse thuajse është vertikale. E veçantë ishte dalja në shtegun për zbritje. Kalonte në pjerrësi e traversa bore me një ngjitje të thjeshtë në fund. Ngjitja tjetër interesante për sot ishte ajo që u realizua në I-2 nga një dyshe e alpinistëve të ekipit tonë dhe një dyshe alpinistësh e ekipit të Përmetit.

U ngjita në lartësitë rrëzë majës së Markut nga ku mund të vrojtoja të gjithë itenerarët ku punohej. Fillimisht kushtet e vrojtimit i kisha të mira por kur moti filloj të rëndohej u vendosa në një pozicion prej ku vrojtimi (kjo periudhë zgjati tre orë) që të kryhej më duhej sakrificë. Ngjitjet përfunduan para orës dy (por jo zbritjet që filluan në këtë orë). Moti filloi të vrenjtej gjithnjë e më shumë dhe dielli krijoi një rreth të ylbhtë. Kjo shënjë tregon se brënda 36 orësh moti do të kthejë për keq. Më intereson shumë që të kemi mot të mirë deri në dt 24.

Drekën e hëngrëm vonë sepse të gjithë u kthyen vonë nga ngjitjet. Si rregull për drekë ndajmë një shufër sallam, bëjmë supë me tableta, kuti mishi, gjalp dhe makarona. Një herë për drekë hëngrëm edhe kremkaramel apo pudding (në fakt nuk u muar vesht se çfarë ishte). Pas drekës bëra dru. Pra ndihmova në sigurimin e druve të zjarrit. Sonte ndenjëm gjatë pranë zjarrit sepse vendosëm që të bëjmë paqe për nesër dhe e bëmë atë.

Çadrat i kemi në një vend paksa të ngritur, disi të rrethuara nga drurë ahu të një pylli të ri. Ka dy ditë që temperatura e ajrit po rritet dhe bora tashmë është zbutur. Kjo ka bërë që çadrat sado pak të fundosen në borë. Ujin e sigurojmë vetëm duke shkrirë borën. E kullojmë nëpërmjet një pecete dhe pas kësaj e përdorim për të pirë dhe për të gatuar. Uji vjen era tym edhe me të bëjmë çaj ose kakao për të mposhtur erën e tymit. Vajguri për furnelë mund të kemi edhe për nesër në mëngjes. Kërkuam në Bogë por nuk ka (ata e quajnë vajgurin, sikundër edhe Thethjanët e Kelmendasit, gas). Tani koha sikur po merr të kthjelluar porse



hëna ka vënë rreth. Uroj të kemi të paktën edhe dy ditë mot të mirë!


## Shkurt 22

Mbrëmë kam fjetur mirë: një copet, nga ora 22:30 deri në 06:30. Rekord ky i pa kapur prej kur nuk mbahet mend. Në mëngjes moti ishte i vranët. Mjegulla gati sa nuk prekte çadrat tona. Megjithëse vesa ka mbuluar gjithëshka, bora është e ngrirë. Nuk po vendosja nëse duhej të bënim ngjitje, andaj pasi shijua paçen bashkërisht mblodhëm dru për zjarr. Në orën 10 i rrjeshtova ekipet dhe i nisa për ngjitje sepse mjegulla filloi të ngrihej dhe itenerarët e ngjitjeve u bënë të dukshëm. Ngjitjet i ndoqa me Dashin dhe Agimin. Ky i fundit ka dhimbje këmbë që i fillon nga mesi (përmjeti). Ka mundësi të jetë dhimbje e nervit shiatik. Kur përfunduan ngjitjet u nisa vetëm (Dashi u ul poshtë që të merrej me gatimin) dhe dola tek Shtegu i Dhenve. Edhe andej (nga Thethi) ishte i njëjti mot suikundër këndeje nga ne. Tek rrija në grykën e shtegut arrita të shquaj shushurimën e lumit të Thethit, zëra njerëzish dhe të lehura qensh. Mu kujtua se kur dëgjohen mirë zërat e largët nga poshtë lart, kjo është një nga shënjat që paralajmëron prishjen e shpejtë të motit. Kur dëgjova thirrjet e shokëve se dreka është gati fillova zbritjen.

Jam në kamp. Po dëgjoja një “bisht” emisioni nga Radio Prishtina për Sanremon. Pa mbaruar ky emision erdhi Xhixha. Ishte partneri i Nardit ditën që ky u rëzua nga shkëmbi. Ai më tregoi se kur ra Nardi, meqë nuk ishte ngulur asnjë gozhdë/plengë sigurimi, e përdrodhi në çast litarin rreth dorës dhe tek dora pësoi një tërheqje të fortë kur ra Nardi. I është ënjtur krahua dhe nuk është më për ngjitje. Xhixha mbrëmë ishte në Bogë sepse uli materialet e Nardit atje. Nardi meqë ka dëmtime (sidomos kokën dhe brinjët i ka jo mirë) nuk është fare për ngjitje dhe do

të shkojë në Laç sepse atje ka një teze e cila punon në spital. Atje do të shkojë që të mjekohet e të pushojë ca ditë që kur të ktheht në familje të mos kuptohet dëmtimi i tij.

Xhixha e ka futur mbrëmë krahun në qepë e kripë dhe sot ndjehet disi më mirë. Tek ngjitej nga Boga për këtu në kamp e kish kapur rrugës një korier dhe i ka dhënë një telegram ku thuhet se Ilir Baraku e ka nënën sëmurë (do e ruaj telegramin). E ëma e tij ka qënë në një klasë me mua, klasa e shtatë, në shkollën Misto Mame. Ishte e treta herë që asaj i ndodhte ngatërrim zorësh. Ai e kishte lënë të ëmën të smurë kur u nis. I dërgova fjalë Ilirit që të nisej menjëherë për Tiranë.



Telegrami për Ilir Barakun

Një pjesë të kohës e kalova me përmetarët. Më bënë një kafe dhe tek e pija më kërkuan që të më shikonin filxhanin. Ja u plotësova kërkesën. Pas orës 19 megjulla filloi të ngrihet dhe tani qielli është krejt i pastër.

## Shkurt 23

Sot kam parë një lindje të bukur dielli. Ai do të lindëte mbi majën e Shtegut. Sikundër kuptohej, ai ende pa lindur ishte i rrethuar nga një ylber rrethor, kështu që fillimisht doli/lindi ylberi, që vazhdimisht e zmadhonte harkun e tij deri sa doli edhe vetë dielli aty rreth orës 8 e 30. Dita filloi e mirë por pas orës 13 qielli u mbyll.

Ngjitjet i ndoqa me Xhixhën, i cili u largua në orën 12 dhe mbeta vetëm. Më pas, me ndalesa, u ngjita deri në rrëzë të Markut dhe kur ngjitjet përfunduan dhe mjegulla zuri majat u ngjita deri në krye të kreshtës së Kalasë dhe dola në një hon që binte i thiktë nga ana e Thethit. Prej aty Thethi dukej i plotë por dhe i zhurmëshëm (krahasuar me gropën tonë) ngase tek unë vinte shushurima e lumit si dhe goditje sopatash nëpër pemë a dru. Ndenja pak dhe më pas fillova zbritjen duke rrëshqitur mbi borën e ngrirë deri sa arrita në borë të butë. Arrita kampin pak para se të arrinin edhe Iliri me Turin, të cilët janë të vetmit nga ekipi ynë që sot bënë ngjitje.

Sot i mbylla ngjitjet që bëhen në shkëmb. Ngjitjet nëpër itenerarë shkëmborë në stinën e dimrit kanë qenë një mendim i kaherëshëm dhe një kërkesë që nuk më mbështetej. U desht të vinte ky vit që të “lejohej” organizimi i ngjitjeve shkëmbore në sezonin dimëror. Sot kam një ndjesi të çlirimit moral që këto lloj ngjitjesh mund të bëhen. Jam i çliruar edhe nga tensioni dhe përgjegjësia se mos ndodhte ndonjë gjë e jashtëzakonëshme. Përsa i takon asaj që ndodhi me dyshen Nardi-Xhixha që një... çfarë të them? Ajo që ndodhi atë ditë ishte diçka që ndodhi kur ata ende nuk kishin filluar një punë të mirëfilltë alpinistike. Tashmë dëshiroj që të kem edhe një ditë tjetër me mot të mirë që të ngjitemi në majën e Radohinës.

Ndjej se të gjithë janë mërzitur. Po mbaron buka. Ekipi që drejtoj sot po i vinte rrotull bukës time. E pashë Dashin që e hoqi një fetë. Por ne kemi edhe tre ditë veprimtari! Hajdari thotë se ka parë gjurmë ujku, kurse përmetarët pohojnë se kanë dëgjuar ulërima ujku. Bëmë mjaft zjarr në mëngjes, por unë hoqa disa dru mënjanë që të ndezim zjarr nesër në mëngjes për rreth 2 a 3 orë. Ndjej se çdo pjesë e trupit dhe çdo copë robë më vjen era tym. E shkreta shampo çfarë do të heqë kur të kthehem në shtëpi!

## Shkurt 24

U gdhi mot i keq. Binte herë shi e herë borë, por më shumë binte borë. Vendosa që grupi të ulet poshtë në Bogë. Po u lagëm këtu nuk kemi si të thahemi, kurse në Bogë është ndryshe. Një alpinist të ekipit tim dhe dy përmetarë i nisa për në Shkodër sepse janë sëmure (kemi tetë netë që flejmë në çadër e mbi borë). Pasi hëngrëm mëngjesin u nisëm. Për dy orë arritëm Bogën, nëpër shi dhe nëpër borë. I shëtita të gjitha “institucionet” e fshatit. Kanë ardhur Roku, Gjelina e Paulini dhe më kanë dhënë disa “ultimatum” që të shkoj në shtëpinë e tyre, ndërkohë që e shohin se e kam të ngritur çadrën time.

Mbrëmë Xhimi, tek ishim pranë zjarrit, çau gishtin dhe i doli gjak. Ndoshka kjo ishte arsyeja që pas pak u bë keq dhe gati i ra të fikët. E futëm në çadër dhe u qetësua. U futa në klub ku dëgjua deri në fund Sanremon. Më pas u nisa tek Roku.

## Shkurt 25

Është dita me pritje për makina për të dalë në Shkodër. Shqetësime banale të përherëshme lidhur me transportin.

*Mbajtës i ditarit, Aleksandri*

## Aktiviteti veror korrik 1989

### 16 korrik

Tashmë muzgu i ka lënë rradhën mbrëmjes. Qielli është i zënë me re. Janë re shiu, që para dy orësh shkarkuan. Është fresk: kanotjerja e trashë, këmisha dhe pulovri tashmë janë domosdoshmëri për t'i mbajtur të veshura. Shushurima e lumit ndjehet gati e fortë sepse çadrat i kemi thuajse buzë ujit.

Udhëtimi ishte i freskët, ajri kishte transpsrencë të veçantë pas shiut dhe të krijonte mundësi të sodisje më mirë natyrën në zonat pa mjegull apo pa re.

Nga Boga në Theth vransira ishte mjaft e dëndur. Asgjë nuk mund të shikoje. Veçanërisht të vjen keq që nuk shikon ato pamje të bukura që të hapen kur del në Qafë të Thores e deri sa zbret në Theth.

Pasi përcollëm shoferin që na solli u shtriva në çadër ku morra një sy gjumë. Kur u zgjova pashë që retë po hapeshin dhe tashmë hëna dhe malet formonin “duetin” e madhështisë së natës alpine....

Kam marrë dy libra për të lexuar: “Etja për jetën” dhe “Klasikë rusë”. Kapa klasikët dhe fillova të lexoj...

## Korrik 17

Kam fjetur disi mirë. Them disi sepse u zgjova para kohe. Ndoshta ngaqë është pak ftohtë. Jashtë tendës ndjehet fresk dhe lagështi. Vinë lajmet e para krejt të hidhura: ekipit të Dajtit i kanë vjedhur furnelën. Më vonë mësohet se atyre u kanë vjedhur edhe tenxheren me presion ku brënda ishte gjalpi e margarina, si edhe tasat me lugët. Kozmai u nevrikos tej mase me djemtë e ekipit të tij. Nga zëmërimi nuk hëngri (në fakt ai rrallë ha mëngjes). Djemtë i kishin thënë që gjërat i fshehën në një dëllinjë, por në fakt ato i kishin lënë jashtë tendës.

Plani për sot ishte bërë dje: një grup me mua në krye do të shkonte të caktonte vendin ku do të ngrihej kampi me tenda (në lagjen Gjellaj, sa më pranë majës së Boshit), një grup do të gatuate dhe një grup me në krye Zenelin do të shkonte tek karatakti (Ujvara e Thethit) për të bërë fotografi.

Tek e fundit, ngjarjet e mëngjesit rrodhën të tilla që unë u nisa me Flamurin e Përmetit dhe Hajdarin e tropojës. Por pas gjysëm

ore ecje Hajdari u kthye ngaqë nuk ndjehej mirë. Me Flamurin eca mirë. Ai është djalë i fuqishëm, i papërtuar dhe pa fjalë. Në shtëpitë e fundit të lagjes Gjellaj (këtu fëmijët na u qepën duke na kërkuar pasaportat – shprehje kjo e vigjilencës së popullsisë kufitare) takuam një banor i cili na skjaroi për pyetjet që i drejtova. Porse fillimisht ai u tregua i ndrojtur ngaqë, sikundër më spjegoi më pas, vjet kishte ndodhur një ngjarje... ja ngjarja: Dy kampistë (*persona që kishin ardhur si pushues në kampin e pushimit në Theth*) kishin ardhur aty (në Gjellaj) dhe kishin pyetur se ku është Qafa e Pejës dhe kufiri. (Ata ishin orientur gabim sepse prej aty delet në Qafën e Valbonës). Personi që pyetën ishte një punëtor dhe ai me tallje u kishte thënë “përpara e keni”. Por dyshen e pushuesve e kapën rojet kufitare të Valbonës. Dhe kur i kishin pyetur në Shkodër, ndër të tjera, kishin treguar për punëtorin. Edhe punëtori u arrestua dhe u dënua me dy vjet burg.

Udhëtuam deri lart, ndoshta deri në 1.800 metra, më saktë aty ku fillon shkëmbi. Piketuam shtigjet, vumë shënja dhe u kthyem. Një pjesë të rrugës së kthimit e devijuam dhe u ulëm nëpër një shpat të thepisur ku katër gra e vajza po korrnin bar. Punë e habitëshme sepse korrnin me drapër. Bënin punë me drapër dhe dorë: habitesh sepse rendimenti i punës është shumë i ulët. Llogarit dhe transportin!... Çfarë nuk bën njeriu nga ngushtica!

Gratë u trembën nga ne se mos u lëshonim gurë nga lart dhe na u lutën që të tregoheshim të kujdesëshëm në vendosjen e këmbëve. Kur u afruam komunikuam një copë herë me to dhe pushuam në këmbë. Tek livadhet (lagja Gjellaj njihet për livadhe të bukura) fëmijët e stanit na drejtuan për tek stani ku dhe mbushëm ujë. Fëmijët u gëzuan kur mësuan se ne do të ngrinin aty kampin e do qëndronim disa ditë. Gëzimi i tyre u shpreh edhe me përcjelljen që na bënë.

Kur arritëm në Theth shkuam drejt e tek kulla e ngujimit. Kjo kullë është e ngritur në shkëmb (njëra anë krejt mbi shkëmb) dhe është e shpallur “Monument Kulture”. E gjetëm të mbyllur. Thirrëm dhe nuk na u përgjegj kush. Gjetëm një gardh të punuar me dërrasa dhe e ngritëm vertikalisht nën dritaren e jugut të kullës. Këtij gardhi i mbështetëm një kapërcyll që ishte aty për të kaluar një mur guri dhe u ngjitëm tek dritarja, që mezi na nxuri, porse ne hymë në kullën e ngujimit. Kulla ishte mjaft interesante dhe ja vlente që e pamë. Pas shtatë orësh nga nisja ne arritëm tek çadra.

Më priste për drekën një tas me makarona. Por para se të punoja me tasin vajta në lumë dhe u lava. Më pas hëngra drekën. Pas meje edhe Kozmai, madje ai hëngri nga tasi im. U shtriva në çadër (u futa në thesin e fjetjes sepse ndjeva ftohtë) dhe morra një sy gjumë. Filloi shi por nuk zgjati shumë. Ndërkohë erdhi Zeneli e na tregoi (ai tregon këndëshëm; me humor) histori nga jeta e tij. Në darkë u veshja mirë para se të futesha në thesin e fjetjes. Është fresk por si natë e parë në alpe, ndjej të ftohtë.

## 18

Kalova një natë me gjumë shumë të mirë. Kozmai më thotë se ka fjetur shumë keq. Dola jashtë. Ka rënë shumë vesë. Koha duket e mirë por dielli do kohë që të bjerë tek ne. Sot presim që të vinë mushkat për të mbartur materialet lart. Kur ra dielli, nxorra jashtë thesin e fjetjes dhe librin dhe fillova të lexoj.

Erdhën mushkat. Ato sollën qumshtin e staneve në baxho. Ndërkohë mësoj se Kozmai, ende i indinjuar për vjedhjet që i ishin bërë ekipit, u kishte thënë djemve të tij që të nisen për në Tiranë. Ata ishin shumë të mërzitur. U ktheva humorin duke u thënë se “unë do e nis Kozmain për në Tiranë dhe ju do të qëndroni për të kryer veprimtarinë”. Me Kozmain bisedova jo

pak dhe më në fund i ktheva edhe atij humorin duke i thënë se “djemtë e ekipit tënd nuk janë një masë e zgjuar dhe e ditur në masën që do ti”. Bëra mirë a keq nuk ka rëndësi. Rëndësi ka fakti që të dy palëve u erdhi humori dhe pas kësaj brënda gjashtë orëve i gjithë grupi ynë u vendos pranë stanit në lagjen Gjelaj.

Këtu vendi është i rrethuar me pyll: livadhet alternohen njëri pas tjetrit të rrethuar sejcili me pyll. Mali i Boshit ngrihet në lindje dhe duket si një mur shkëmbor vigan, i lartë, ndoshta, mbi 1.000 metra dhe i thiktë. Një mrekulli me një të keqe: prej këtu e deri tek rrëzat shkëmbore ku fillojnë ngjitjet është ca larg. Do shohim, duke filluar nga nesër, se si e sa do të mësohemi me këtë distancë.

Këtu jemi në rrëzë të një mali që si një dhëmb i fuqishëm dominon në anën lindore të luginës së Thethit. Mali i Boshit të prezantohet krenar që kur je në Qafë Thore (*Qafa e Tërthortë*) me të njëjtën krenari sikundër maja e Arapit. Por ndërsa ky i fundit u “gdhënd” nga alpinistët, Boshi ka mbetur “bosh” përse i takon itenerarëve për kacavarje nga alpinistë shqiparë. Duhet të “trokasin” edhe këtu kacavarësit për të hapur, d.mth. ngjitur, disa itenerarë.

E kam përjetuar hapjen e itenerarëve të shumë zonave për kacavarje për sezonin veror por edhe për sezonin dimëror. Ky i faqes veri perëndimore të malit të Boshit duket si i fundit (*në luginën e Thethit*) për tu eksploruar. Mbetet edhe diçka nga Valbona për vitin tjetër. (*për arsye të “emërtesës” Zonë Kufitare, ne si lëvizje alpinistike e kemi pas lënë të pa studjuar dhe të pa ngjitur pjesën e majtë të luginës së Runicës nga Maja e Lakojve e deri në kufi*). Uroj të na vejë mbarë me Boshin!

Në grup kemi fotograf Zenel Kokomirin. Është pedagog, stomatolog (është njeriu që është marrë më shumë se kushdo me dhëmbët e mi). Ka qenë alpinist modest i Klubit Studenti ku kam



getë edhe unë në kohën e studimeve universitare. Është energjik, inteligjent dhe ka humor të këndëshëm. Ka marrë shoqërues Agron Çuka-n, pedagog i atletikës në I.K.F. (*sot Universiteti i Sporteve*). Tani ata po forografojnë (ora 22:30) malin e Boshit dhe hënën. Natën e mirë!

## 19

Ditë e mbrapshtë! Kampingu u zgjua në ora 07:30! Vonë. Nuk e kam marrë orën me vete dhe.... Menjëherë u shtrua për të ngrënë mëngjesin. Kënaqësi është kosi që e zura mbrëmë me hirrë djathi. Më ndihmoi një bareshë e stanit fqinj me ne. Kemi marrë nga Tirana 3 kg qumësht pluhur. Sapo e zura kosin për nesër. Besoj se ky për nesër do dalë më i mirë nga sot sepse e zura me kos.

Në ora 08:00 Kozmai kërkoi që alpinistët të rrjeshtohen e të nisen. Por në rrjeshtim u mësua se ekipi i Dajtit ende nuk kishte ngrënë mëngjes. Nardi protestoi që të nisej dhe bëri fjalë... Gjatë rrugës për tek shkëmbi Sokoli më foli për mardhëniet në atë ekip. Edhe unë jam disi i ftohtë me anëtarët e mi të ekipit, por jo me këta të dy që kam me vete. Edhe unë kam shqetësime me më të rinjtë e ekipit të cilat plasën me ngritjen e problemit të vjedhjeve (*do jetë fjala për vjedhjen e një palë këpucëve në dhomën e stërvitjes kur ne ishim jashtë saj dhe në proces stërvitor*). Ekipi vërtet u bë ekip i madh por nuk ishte aq i madh niveli kuturor dhe edukimi i ekipit. Duhet që të kujdesem që këta të ngrënë nivelin e arsimimit dhe më gjërë. Të shikoj se sa nerva do të kem për këtë punë.

Tek zona e ngjitjeve arritëm pas 75 minuta ecje. Kozmai, ndonëse u nis me ne, mbeti pas dhe me sa duket e humbi shtegun. U kthye. Djemve u zgjodha itinerarë të thjeshtë (*është dita e parë e kacavarjeve*). Vetë morra drejtim për nga maja e Boshit dhe

vetëm pasi skjarova dyshen e Dajtit për drejtimin e zbritjes u nisa për në majë. Në ngjitje e sipër vura re se treshja e Tepelenës doli nga ngjitja. U propozova që të bashkohen me mua. Erdhi vetëm Et'hem (këta si ekip janë shumë keq me këpucë). U futëm në një rëpirë bore të ngrirë e u ngjitëm rreth 500 metra. Në pjesën e sipërme të saj, ku pjerrësia ishte më e madhe, kaluam djathtas dhe u ngjitëm nëpër shkëmb.

Koha ishte shumë e vranët dhe nga maja nuk shikoje veçse paksa kampimin tonë dhe një pjesë të Thethit. Pra, përsëri të pafat (*ashtu sikundër kur erdhëm dhe humbëm panorama në Qafë Thore*), që nga një lartësi aq dominuese si kjo e majës së Boshit, mos të shohësh gjë!

Zbritëm shpejt që të mos na kapte moti i keq që po afrohej. Kur arritëm tek zona e itenerarëve ku u bënë ngjitjet nuk gjetëm njeri. Ngjitjet kishin përfunduar dhe alpinistët ishin larguar. Rrugës, pasi kaluam traversën, zuri shi. Kjo është pjesa e vështirë e itenerarit për të shkuar në zonën e ngjitjeve. Pardje këtu kisha vendosur 5-6 pirgje, me gurë, batina, si shënja orientuese. Kur arritëm në kamping u futa në çdo çadër për tu informuar se çfarë përjetuan alpinistët sot. Ndërkohë u rikujtova atyre se për çfarë kemi ardhur këtu dhe çfarë duhet të konkludojmë në mbyllje të veprimtarisë.

Hëngra drekë pasi e përfundova gatimin e saj (e kishin nisur Arturi me Ilirin). Kur hyra në çadër gjeta Kozmainn që flinte. U futa në thesin e fjetjes dhe kur u zgjova isha gjeth.

Koha është e vranët. Fryn erë por me pulovër rihet këndëshëm. Dola jashtë dhe tendosa litarët e tendës të cilët janë lëruar jo pak nga shkulmet e erës. Kam frikë se mos nata do jetë me shqetësime për këtë farë tende që kam. Të shohim; natën e mirë!

## 20

Natën fryu erë dhe fjeta keq. Mëngjesi doli i kthjellët por ishte ftohtë. U rrjeshtuam në ora tetë, kohë kur bie dielli në çadrën tonë, e që është në qendër të livadhit rrëzë një gorice të re. Vendosëm të mos bëjmë kacavarje meqë fryn erë dhe amplituda e rënies së temperaturës është e ndjeshme. Ky vendim i dha kënaqësi të gjithëve. Vendosëm, me qëllim që të lëvizim, që një grup të shkojë në Qafë të Valbonës dhe një tjetër tek Shpella e Rrathëve. Tek shpella vajta unë me djemtë e ekipit tim si dhe Zeneli me Agronin. Pak pas nisjes u kthye nga rruga Zeneli ngaqë nuk ndjehej mirë.

U ulëm (duhej) deri tek shtëpitë e para të Thethit, e prej aty u ngjitëm për 35 minuta për në Gumnare. Gumnara është një livadh i pjerrët në veri të kataraktit. Është pika më e mirë për të soditur Thethin në linjën, afërsisht, jug – veri. E shohim luginën më të plotë se në çdo vend tjetër nga kjo anë. Këtu soditëm rreth 30 minuta. Më pas u nisëm drejt shpellës ku arritëm pas 20 minutash. E gjetëm menjëherë. Ndoshta kisha 10 vjet pa vajtur. Për të parën herë kam qenë aty vite më parë. Hymë dhe për 30 minuta ishim në fundin e saj. Në fund të saj dikur ishte një gropë me llum të ngjeshur. Mbi të ishin shkruar emra. Emri im ishte aty. Më erdhi habi që emri im ishte ende aty, madje i përsëritur (?). Gropa mu duk e thelluar dhe po të kishim litar ose drita më të forta (ne kishim dy qirinj dhe një elektrik me bateri të rena) do kishim mësuar më shumë për gropën e cila më dukej e ndryshme nga dikur. Tek u kthyem, jo të ngutur, pamë masakrimin që u ishte bërë stalaktiteve nga ata që kanë hyrë aty.

U ndota shumë, me baltë, ngaqë në dy vende me pjerrësi duhej të kaloja përpara. Shpella pothuajse tërësisht (përjashtoj dy vende me gjatësi 3-6 metra) përshkohet duke eur në këmbë. Nuk

është më e bukur dhe më interesante se Shpella e Pëllumbasit që kemi në Tiranë.

Nga shpella zbritën në lumë. Në fakt shkuam tek përroi që zbret nga mali i Boshit. Pikërisht aty ku nga përroi merret ujë për kanalin që shkon në drejtim të kataraktit është një pellg i mrekullueshëm. U lamë e ndenjëm në diell për më shumë se dy orë. Gjatë kësaj kohe lava dhe thava gjithëshka që kisha me vete, përfshirë këpucët.

U nisëm dhe për një orë ishim në fushimin tonë. Gatuam e pasi hëngrëm drekën u shtriva në tendë por nuk më zuri gjumi. Kozmai që dje është “transferuar” tek ekipi i tij dhe vetëm në darkë vjen për të fjetur. Dola nga tenda dhe zura kosin, piva një kafe pranë zjarrit që është shumë i këndëshëm sapo perëndon dielli.

## 21

U ngrita nga një gjumë i keq dhe i shkurtër i mbasdites. Jam si i rrahur: më dhëmb trupi, e sidomos muskujt e këmbëve i ndjej të lodhura; kam dhimbje koke. Mbrëmë më zuri gjumi vonë sepse mbarova klasikët rusë. Gjumin e bëra me copa dhe u ngrita herët. Më 07:30 u nisa me Zenelin për në zonën e ngjitjeve. U nisëm më shpejt nga të tjerët sepse Zeneli ecën me temp të ulët; është 52 vjeç dhe ka vënë shëndet të tepërt. Grupi ish nisur në ora tetë dhe na arriti në të përpjetën e fundit, vend ku ishte dhe burimi më i sipërm. Edhe Kozmai ishte pjesë e grupit.

Në zonën e ngjitjes improvizuam një dyshe alpinistësh për fotografi “të bujëshme” me dy përmetarët. Zenelit nuk i pëlqeu “kuadrati”, por dy poza i shkrep. Ndërkohë Iliri me Arturin u futën në itinerarin më të vështirë ndër ata itinerarë që kemi përcaktuar. Më pas Zeneli u josh nga ngjitja që bënin këta të dy dhe i fotografoi me teleobjektiv. Mu desht ta shoqëroj dhe të shkoj sa në një anë e në një tjetër sepse ka tre aparate dhe

i duhej t'i ndërronte sipas fotove që bënte. Relievi i pjerrët i mundësonte që me vështirësi të punonte, a mbante, vetëm një aparat fotografik.

Më pas u vendosëm përballë me majën qëndrore sepse aty, sipas një diagonaleje, u futën dy përmetarët, të cilët dolën lart më parë se të dilte Arturi me Ilirin në pikën e takimit të itinerarëve. Ndërkohë, majtas, tre tepelenas u ngjitën në një shkëmb me 3 a 4 guva të njëpsanjëshme e të mëdha.

Me Zenelin u ngjita deri tek qafa e majtë, aty ku na rekomandoi Kozmai. Prej këtu dukej shumë bukur Valbona dhe Rrogami si dhe të gjitha majat kryesore të luginës së Valbonës. Ndënjëm dhe u fotografua rreth 30 minuta. Këtu erdhën edhe përmetarët që zbritën nga maja. Pasi u fotografuan luginat e Thethit edhe e Valbonës, u ulëm dhe dolëm në pjerrësinë e borës që të çon në majë të Boshit. Aty thirrëm që të vinin edhe Iliri me Arturin që po zbrisnin nga maja. Kur u bashkuam u kryen fotografime të tjera. Pas kësaj filloi zbritja pa ndalesa. Arritëm në kamp në 16:30, pra pas nëntë orësh nga nisja.

Hëngra një drekë "të thatë". Zeneli më thotë se ka ngelur i kënaqur me mua. Ky nuk është lajm i mirë sepse ai do që nesër të ulet në Theth me disa alpinistë por do që të shkoj edhe unë me të. E përsërit këtë duke thënë që puna bëhet kur jam edhe unë. Na ka hapur punë, me disa nga kërkesat e tij, edhe mua edhe Kozmait. *(jo se nuk na pëlqente të përfsiheshim në fotografimet që bënte, por si unë edhe Kozmai ishim këtu që veprimtaria të realizohej me siguri maksimale nga dëmtimet e mundëshme dhe njëherësh të ishte sa më cilësore në aspektin sportiv).*

Nga vrojtimet më duket se kam gjetur një shteg për t'i vajtur Boshit në qendër dhe aty ka edhe itinerarë të thjeshtë. Tashti duhet të shkoj që të përfundoj gatimin e darkës që e kam nisur para një ore.

## 22

Pasi pimë kafën e mëngjesit, unë e Zeneli u nisëm për të fotografuar tek shtëpia që është pranë nesh. Erdhi edhe Agroni. Shtëpia është mjaft e veçuar në lagjen Gjellaj (*përgjithësisht ne e njohim Thethin si një fshat me shtatë lagje. Ka që e njohin edhe si luginë me shtatë fshatra*). Mësova që banorët e saj kanë ndërtuar një shtëpi të re më poshtë. Por këtu, në këtë shtëpi, kam qenë 5 a 6 vjet më parë në dimër dhe kam pushuar rreth një orë. Atëherë këtu banonin një çift të moshuarish që kishin një djalë që studjonte për ekonomi agrare. Tani, më thanë, ky djalë është shef plani në kooperativë dhe njëherësh edhe kryetar këshilli në fshat. Tashti kjo shtëpi përdoret për verim nga të zotët e saj dhe po të shkojmë do të gjejmë plakën që kujdeset për lopën.

Shtëpia ishte pa njeri. Një qen i lidhur aty na shurdhoi me lehjet e tij, aq sa na prapësoi. Ndenjëm në livadhin mbi të. Dhe ja, u duk një grua shtatëzanë e cila të habiste me shkathësinë e lëvizjeve të saj nëpër këto livadhe të pjerrta. Na premtoi se do e gjente plakën, por ne pas 20 minutash u ngitëm. Nuk u mërzitëm sepse rruga nuk të shkon dëm: bëme një shëtitje mjaft të bukur. Zona këtu është vërtet e mrekullueshme: ndjehesh i zhytur në blerimin e pylli, livadheve dhe në sfond ke maja aq joshëse të luginës që me grinë e shkëmbit të tyre, me bardhësinë e borës dhe reve si dhe me kaltërsinë e qiellit të shlodhin e vetëm të shlodhin. Asnjëherë nuk kam jetuar në një kamp alpinistik kaq të blertë, veç rastit në vitin 1964 kur kalova, me ekipin, një javë në Vermosh.

Çadra jonë këtë vit është më aromatike se çdo vit tjetër: tepelenasit, mua dhe Kozmait, na kanë sjellë racionin vjetor të çajit të maleve të tyre. Këtë vit na e sollën këtu në alpe! Ky çaj rri në krye të çadrës. Nën të është një gur thuajse i madh i cili shërben që të mbajë qirinë dhe shkrepsen. Është edhe një “vazo”

me lule nga të zonës. “Vazon” e nxorrëm jashtë dhe fotografuam lulet.

Tani është ora 19 dhe dëgjoj zërat e grave dhe vajzave që kthehen të ngarkuara me barin e korrur gjatë ditës. Janë nisur në mëngjes më parë se ne, që domethënë se kanë punuar të paktën 12 orë. Ulin barin të ngarkuara me dy rrugë gjatë ditës. Barra ka peshë në kufijtë e mundësive të tyre. Rruga e tyre është shteg i pjerrët që të këput nga këmbët (nga leqet e këmbëve). Barin e korrin me drapër, duar-duar dhe e grumbullojnë duke e hedhur në një pikë ose duke mbushur përpajsen (këtë punë e bëjnë vetëm gra e vajza, kurse për të ulur barrët kam parë edhe burra). Vendet për korrje bari janë pjerrësi të forta në zonën ku alternohen/shkëputen livadhet dhe fillojnë kullotat alpine. Kjo punë, siç më spjeguan kur i pyeta, është e domosdoshme për to sepse është e vetmja mënyrë që të sigurojnë ushqim për dimër për lopën personale, d.m.th. të familjes. Të vjen keq për to! Mësova se sonte do të ulen poshtë sepse (*nesër?*) është e djelë. Katolicizmi (megjithëse nuk e praktikojnë hapur) u ka lënë edhe doke të mira: të djelën nuk punohet.

Pas natës së parë që fjetëm këtu, në mëngjes mësova se më ishte zhdukur një e treta e bukës që më kish mbetur si dhe gjysëm shufër sallam. Pas dy netësh, në mëngjes, vumë re se na ishte marrë qesja me qumësht pluhur; ishe çarë dhe ngrënë një pjesë (tashmë nuk hamë kos). Pra është një qen që i bën këto prapësi. Iliri ja ka bërë benë që ta vrasë, por ai ka dy ditë që nuk po vjen këtu.

Sot përsëri u ngjita tek itenerarët. Zeneli dhe Kozmai nuk erdhën. Tre litarë i drejtova në qendër të Boshit (17 Nëntori – 24 Maj – Dajti) nëpërmjet traversës mbi brezin e zi. Të tjerët punuan në itenerarët më të spikatur. Pas dy orësh vrojtimi të ngjitjeve (por jo ato të qëndrës së Boshit), u ngjita në një pikë

të majës së Boshit nga ku vrojtova luginën e Currajve. Ja vlentel! Kur u ngjit edhe litari i fundit, Iliri me Arturin, të cilët e ngjitën Boshin nga qëndra (*e faqes shkëmbore*) fillova zbritjen. Në orën 3 isha në kamp.

Boshi sot “u zbërthye”: tre itenerarët e punuar ishin të vështirë dhe rreth tyre ka plot itenerarë të tjerë të mundëshëm. Traversa që të nxjerr tek këta itenerarë është mëse e përshtatëshme. Për nesër ekipi ynë dhe përmetarët do të zbresim në Theth për të fotografuar Zeneli. Tani më prët darka dhe bisedat rreth zjarrit.

## 23

Sot e lamë Bjeshkëzën, ose sikundër i thonë ndryshe Bren, sepse në skaj të livadheve është një bredh. E lamë këtë vend që në çdo moment të 24 orëshit është i mrekullueshëm. Fillimisht u larguan përmetarët që të siguronin një mushkë për materialet e Zenelit dhe Agronit. Në orën 10 u nisa i vetëm që të shkoja me kohë në këshillin e fshatit për të firmosur disa dokumenta, sepse nesër zyrat do jenë të mbyllura për arësye të fillimit të stërvitjes ushtarake. Arrita në 11:15 tek Kisha ku dhe do të ngremë kampin. Jam qullë në djersë.

Rrugës u takova me një fshatare që, e ngarkuar, po ulte bar të thatë për në shtëpi. Ishte nga lagja Fushë (ku është edhe Kisha). Ashtu të ngarkuar dhe me kokën poshtë, ajo me bar e unë me materialet e mija dhe njëri pas tjetrit, bisedonim pa patur mundësi që të shiheshim. Më tha se ishte nuse e ardhur në Theth nga Nikaj-Mërturi dhe kish tre fëmijë: dy djem dhe një vajzë. Fëmijën më të madh e kishte 9 vjeç dhe kish përfunduar klasën e tretë. E kishte kujdes që të shkonte mirë me mësimë. Deri tani – më tha – ka kryer me fletë lavdërimi. Kur i kërkonte djalit që të mësonte, të shoqit nuk i pëlqente që t’ja “mundonte” djalin.



Nuk donte të kishte fëmijë të tjerë. Tha se kishte rënë në një shtëpi me kamje. I shoqi ishte roje dhe me këtë punë që kishte ai kishin zgjidhur problemin e punëve dhe administrimit të punëve familjare që kishin: lopën, thiun dhe tokën. Si familje u duhej të ulnin 20 barrë 50 kilogramshe me bar që të siguronin dimrimin e lopës. Prindërit dhe katër vëllezërit i kishte në Ragam (tek minjera e kromit). Ata kishin shtëpinë e tyre dhe po ndërtonin një të dytë. Ishte krenare për këtë. Tashmë prindërit i kishte në pension. Një motër, më të vogël se ajo, e kishte të martuar në Bajram Curr dhe e kishte zili (*jetonte në qytet*). Më tej më tha se “tani që Thethi u ba kooperativë më vete, po punohet më mirë, por sikundër tregojnë më të vjetrit, njerëzit nuk e kanë më atë interesimin e dikurshëm për punën”. Pa arritur tek Kisha u ndamë dhe vetëm në këtë moment u pamë sy më sy: ishte simpatike dhe rrezatonte mirësi.

Si lashë materialet në vendin ku do kamponim u nisa për në qendër të fshatit. Në këshill nuk kishte njeri. Stërvitja ushtarake ishte shtyrë për në datën 27. Shkova në postë ku bëra një telegram me përgjigje që të dinim nëse do na sjellin autobus nga Tirana për të na marrë (*në Theth futeshin vetëm autobusë të vegjël, deri 30 vendesh*). I nisa dhe një telegram urimi Petrika Janaq-it (ai do martohej) në Korçë. Na ka thirrur për darkë mua dhe Kozmain. Ndërkohë pranë vaskës prej betoni pashë diçka që nuk e kisha parë kurrë më parë: delet që i qethnin aty pranë, pas qethjes, i fushnin në vaskë. Ajo ishte mbushur me një solucion dizinfektues ndaj sëmundjeve/infektiveve të lëkurës.

U rrojta, meqë “nuk i pëlqejnë” mjekrat fshatit. U preva dhe u dreqosa. U dizinfektova edhe unë me një pije alkolike që gjeta. Mustaqet i lashë. Më pas ndërtuam bashkërisht me të tjerët një kampim me tenda të rrjeshtuara. Ndërkohë erdhi mushka me materialet e Zenelit dhe Agronit. Kisha e vetme e fshatit është

përshtatur si qendër shëndetësore dhe kopësht për fëmijët. Në Theth kanë ardhur nga Shkodra dy familje për verim. Tani këtu pranë Kishës, por edhe në vende të tjera, kanë sjellë çesëm me ujë të pishëm. I gjithë uji i Thethit është i pishëm. Vendi i kampimit është pak i ngritur dhe ka fllad. Vinë mjaft banorë këtu. Ndoshta ngaqë të djelave vinin në Kishë. Por vinë edhe të rinj për të luajtur me top. Një fëmijë erdhi dhe na shiti vezë me 10 lekë kokra.

Sot përgatita edhe një darkë të bukur: patate, sallam, vezë e specia të skuqur. Përgatita edhe supë për ta ngrënë nesër. Dëshiroj që nesër të mbarojmë punë me Zenelin me fotografimet në Theth. Ai e ka lënë në dorën time për të përcaktuar vendet për foto. Sonte nuk ka zjarr sepse nuk kemi dru. Andaj do merrem me leximin e Van Gogut.

## 24

Ora po shkon 22. Sapo kam ngrënë darkë dhe kam vënë të përgatis supën për nesër. Njëherësh sapo është larguar nga ne fytyra më e poshtër që kam parë deri më sot në Theth (*nuk mbaj mend se kush?*). Erdhi këtu vet i dytë i shqetësuar sepse pa zjarr tek ne. Më të rinjtë e grupit tonë kanë gjetur dru dhe kanë ndezur zjarr në një gropë, që është si llogore për qitje me pushkë. 10 metra larg tendave. Fytyra u tregoi djemve se ç'është zjarri, se qendra shëndetësore (Kisha) është djegur 2 a 3 herë (ne jemi 70 metra larg saj) dhe se ajo ruhet si monument kulture (tabelë për këtë nuk ka), etj, etj.

Sot e lamë kampin në ora 08:30 dhe u fotografuan ca truke në shkëmbejtë përballë çadrave tona, por matanë lumit. Punuam intensivisht për dy orë e më pas u nisëm për në lagjen Nik Gjonaj. U ndalëm tek hidrocentrali i Thethit dhe më pas tek ura në Nik Gjonaj. Sot është e para herë që pashë kampista të ulur nga kampi

në lumë që bëjnë banjo; lahen. Ishin të rinj dhe familjarë. Më pas u ngjitëm tek kampi ku u bënë fotografime të tjera. Këtu takova një mësuese të gjuhës ruse që punoi për një farë kohe në Krabë. Nuk ja mbaj mend emrin sepse ajo shpejt kaloi në shkollën e Bërzhitës. Më tha se kampistët më kishin kujtuar për të huaj!

Nga kampi u ulëm dhe rrugës fotografuam ujvarën në të djathtë të rrugës automobilistike (*ujvara e Shurshelit nuk dallohet gjatë udhëtimit*). Këtu na ra në ujë një rakel filmi dhe mu desht që të hidhem ashtu i veshur që ta kapur sa më parë.

Tek kampimi gjetëm drekën të përgatitur si dhe shumë miza (si çdo ditë). U shplodhëm pak dhe pas 30 minuta u nisëm që të lahemi tek përroi që zbret nga Boshi. Pas dy orësh u larguam nga përroi: Zeneli për në qendër për një bisedë telefonike të paracaktuar me vëllanë e tij në Tiranë, kurse unë për të blerë bukë. Mbrëmë nuk kishte fshati miell dhe nuk u gatua bukë. Shitësja, Vitorja, me sa duket e kuptoi që jam alpinist dhe më dha një bukë, ndërkohë që ajo me atë furnizim që kishte mund të kënaqte jo më shumë se një të tretën e blerësve (*në muajt korrik e gusht në Theth vinin familje, kryesisht shkodrane, për të veruar. Duhet të ishin kurajozë sepse të blije produkte ushqimore në Theth ishte e vështirë. Veruesit i mbanin sytë tek makinat që vinin e që hera herës u sillte shoferi ndonjë ushqim nga të afërmit e tyre nga Shkodra*). Tani që po përfundoj ditarin sapo janë larguar Zeneli dhe Agroni që ishin miq të tendës për këtë mbrëmje.

## 25

Ora është 21:30. Zeneli u largua pasi pimë një kafe. Jam si i rrahur keqas. Jam aq i lodhur sa që çdo bisedë dhe çdo lëvizje e bëj si një automat; jam i mpirë. Mbrëmë rashë për të fjetur gati në një pas mesnate dhe sot jam ngritur kur rrezet e para të

diellit skuqën pjesët e sipërme të majave të bllokut të Radomirës: vetë Radohinën, Vishensin dhe Markun e Zagorën (*sot i quajmë Binjakët*), të cilat duken nga tenda. Dola jashtë dhe pas pak hyra përsëri e ndënja shtrirë deri sa/kur dielli ra mbi tendë. Këtu ku jam dielli bie në shtatë e njëzet dhe largohet në orën gjashtë të mbrëmjes. Jetohet një agim, si dhe një muzg, i zgjatur.

Në 08:30 u nisëm e shkuam në Ndërllysë. Rreth një orë udhëtim. Këtu u fotografua “pjesa fundore” e përroit të Kapresë, tek ura (është një urë e varur e punuar me dërrasa). Nga këtu përroi vazhdon për 3 apo 400 metra në “fushë” dhe derdhet në lumin e Shalës (Thethit). U lamë dhe më pas u nisëm për në Kapre. U shkëputa bashkë me dy përmetarët dhe arritëm në Kaprenë e Poshtme.

Kam mësuar se Kapreja është një fshat i krijuar gradualisht këto 40-50 vjetët e fundit. Si kooperativë është bashkë me Thethin. Kaprejasit janë të ardhur nga fshati Gimaj. Fillimisht për të veruar këtu bagëtinë, por me kalimi e kohës, duke u ngushtuar për toka në Gimaj, u vendosën këtu për të kaluar edhe dimrin. Kapreja e sipërme nga e poshtmjia ëshë 20 minuta larg dhe të dy kapretë bëjnë gjithësej 12 shtëpi (5 + 7).

Para 17 vjetësh, bashkë me Landën – bashkëshorten – kam kalur 3 ditë e dy netë këtu. Ngritëm tendën nën një trap hardhie në livadhin e shtëpisë së Kol Gjonit. Erdhëm këtu nga Gropat e Shtegut (ku kaluam tre ditë duke bërë ngjitje të thjeshta) nëpërmjet Qafës së Thores. Tashmë pleqtë e shtëpisë kanë ndërruar jetë. Na priti e shoqja e djalit të Kol Gjonit. Kanë shtatë fëmijë. Zonja na ftoi të hynim në shtëpi por unë isha me robat e banjos (veshjen e lamë poshtë) dhe nuk mund të hyja. Më erdhi shumë keq!

Ndërkohë Zeneli kishte mbetur mbrapa: kishte sharë e kishte uluritur dhe Agroni erdhi tek unë duke më shpjeguar gjendjen e

tij e duke e mbyllur tregimin me “i filloi zemra”. U ula shpejt tek ai dhe e gjeta shumë mirë! Ishte nevrikosur sepse me largimin tim ishte ndjerë i lënë vetëm!? Vajtëm bashkë në Kapre.

Kapreja si relief është një vend shumë interesant. Shpatet e maleve janë mjaft të thepisura dhe shumë pranë njëra tjetrës: të duket sikur mundesh të qëllosh me gur një majë nga maja tjetër. Shpatet janë krejtësisht të bleruara: me pyje e livadhe që përkëmbehen duke u ngjitur. Tek i ngre sytë lart ata shkasin nga e gjelbërta në kaltërsinë e kulluar të qiellit. Vetëm dy ngjyra ka: të gjelbërt (por me nuancat e gjethit, halorit dhe livadhit) dhe të kaltër. Tek lëviz nëpër grykën e Kapresë ndjen hera-herës melodinë e ujit të përroit që ulet prag mbas pragu deri poshtë në Ndërllysë.

Ne kishim planifikuar të fotografonim pragjet dhe pusin. *(ujvara këtu që sot quhet “Syri i Kaltër” nga vetë Kol Gjoni thirrej Pusi i Zi. Banorët aty e quanin edhe Pusi i Kol Gjoni meqë Kola (dhe pasardhësit e tij sot) e kishte aty shtëpinë. Por krahina e njihte dhe me emrin e një fatkeqi që një natë dimri, i ulur nga Qafa e Thores për të shkuar në një nga fshatrat e Dukagjinit, rrëshqiti në shteg dhe ra aty ku edhe ndërroi jetë).* Përroi ka dy degë: dega e poshtëme kalon përmes lagjes kurse dega që vjen nga Kapreja e Sipërme para se të bashkohet me të poshtëmen vjen me rrëmbim duke kaluar nëpër shkëmb të fortë që vitet e kanë latuar në ullukë e forma të tjera dhe në një pikë/vend, si nga një ulluk i gjërë, i gurtë e ujëplotë bie nga një prak i latuar në një pellg me diametër rreth 15 metra e që në pikën ku bie uji, sipas fshatrëve, thellësia është mbi 10 metra. Uji është tepër i ftohtë. U tregova më lëkurëtrashi në grup pasi hyra e dola në pellg disa herë.

Në krye të pusit, aty ku përroi hidhet mbi të, është një urë që ka plot myshk e përmbi të rritet një bimësi e harlisur, si dhe

ndjehet freski sapo futesh aty. Në urë kalon e varur në trarë, e ndërtuar me ullukë druri të bërë nga trungje pemësh ose lëvore të plota (të pa prishura) pemësh, një pjesë e njërit prej kanaleve ujitës të arave e livadheve aty. Nga ura, nën këndjen e freskisë, sodit ujin shkumbues e të pastër (që piet me ëndje) dhe që derdhet nëpër format e habitëshme shkëmbore të shtratit të përroit, që pasi kalon nën urë (7 a 8 metra) si një gjuhë e zgjatur bie duke shkumbuar në pusin me ngjyrë blu të thellë (*këtë ngjyrë blu të thellë në qendër, Kol Gjoni e quante pusin "të zi"*), ngjyrë që vjen dhe hapet në periferi duke u kthyer në të kaltër e që nën të dallohen zajet e bardhë. Pragu këtu është rreth dy metra i lartë.

Zeneli nuk fotografoi pak. Mjafton të them se ndërkohë që ai fotografonte piu 2 a 3 herë ujë që na e sillte e zonja e shtëpisë, e cila shtëpi është 15-20 metra larg urës apo pragut. Më pas u ulëm poshtë tek pusi (më saktë tek pellgu), ku vazhduan fotografimet.

Na erdhi rradha edhe ne që të fotografoheshim duke u hedhur e duke dalë disa herë nga pellgu.

Së fundi u nisëm dhe dolla në krye të grupit që të mbaja një temp të pranueshëm ecje për të gjithë. Poshtë tek ura e varur djemtë u lanë përsëri mbasi këtu uji është më i ngrohtë. Në orën 15:30 u gjendëm në hidrocentralin e Ndërlyës. Hëngrëm kumbulla e mana në pritje të ndonjë automjeti që të na çonte deri në Theth. Automjeti u duk në orën 18:20 dhe në orën 19 isha në çadër. Koha u vrejt. Pati vetëtimë e bubullima por shi ra vetëm një vesë, sa për të na freskuar. Para se të flinim në çadër erdhën Agroni, Zeneli dhe Arturi dhe kaluam minuta të këndëshme. Tani: natën e mirë!



Pusi i Kol Gjonit, ose Pusi i Zi. Pas vitit 2005 quhet Syri Kaltër

## 26

Ora po i afrohet mesnatës. Sor Zeneli ka qenë mjaft i shqetësuar për fatin e mjetit për udhëtimin e tij të kthimit. Një shqetësim ky për këdo dhe për çdo vit. Për tu miqësuar me shoferin e linjës vajti me të deri në Breg të Lumit (Bregu i Lumit është dhe qendra administrative e Dukagjinit. Si rregull autobuzi i linjës Shkodër - Breg Lumi pjesën më të madhe të udhëtarëve të nisur nga Shkodra i lë në Theth. Kështu që gjendeshin vende të lira për të shkuar nga Thethi në Breg Lum dhe anasjelltas).

Në orën 8 u nisëm për fotografime. Më poshtë urës së Kolajve, në një shkëmb mbi rrugë u fotografuan tre zbritje me litar. Këtij vendi ja vumë syrin dje. Mbaruam shpejt. Por n'atë anë spikata një ujvarë me prag 6 a 7 metrosh dhe shkova i vetëm për ta parë. Të tjerët u nisën dikush për në çadër, dikush për në postë e dikush për në Breg Lum.

Pas soditjes së ujvarës u nisa për tek çadra. Rrugës, pranë stallës dhe buzë lumit, më tërhoqi vemendjen fakti se grupi i pishave natyrore aty ishte i rrethuar me bordurë gurësh të punuar (gdhëndur). U interesova dhe mësova gjëra që nuk i kam pas ditur. Kisha e fshatit, më thanë, ka qenë më e madhe, por ka qenë djegur. Ajo ka patur edhe fjetore me 24 dhoma. Këtu vinin, ndër të tjera, edhe nxënës (besoj të shkollës franceskane) që mësonin që të dilnin priftërinj. Këta tek pishat kishin vendin ku pushonin, lexonin dhe hanin. Këto vende ishin të konturuara me gurë më të vegjël në truall. Këta nxënës njëherësh edhe shëtisnin majave e qafave përreth.

Pasditen e kalova duke gatuar. U kthye dhe grupi i alpinistëve që ne e lamë sipër. Kaloj dhe Kozmai por nuk ndali tek unë. Shkoi nga vorrezat. Them se me siguri ka shkuar tek varri i Lulashit (*Kozmai dhe Lulash Vërria ishin bërë miq shumë vite më parë. Lulashin një verë e kishin sulmuar bletët dhe u ndodh Kozmai që ja hoqi apo qërroi thumbat e bletëve nga trupi i tij. Lulashi ka ndërruar jetë*).

Në orën dy moti morri të prishur. U nisa vetë tek kulla e ngujimit nr 2. Në fakt doli se ajo ishte nr 1: ishte më e vjetra dhe me shumë “bëma”. Më shoqëroi një djalë i shtëpisë që e kishte kullën pjesë të saj.

Kur u ktheva në kamp pashë që aty ishin të gjithë. Filloi një shtrëngatë me shi por që zgjati pak. Çadrat na i tronditi keqas, por tek e fundit patëm edhe një të mirë: shpëtuam nga mizat për ca orë. Teksa moti u qetësua Zeneli vuri alarmin: u kujtua që nuk kishte foto të kataraktit/ujëvarës së Thethit/ Ujvara e Grunasit **pa** alpinistë. U nisëm për ta fotografuar. Por teksa i fola rrugës për kullën shkuam fillimisht atje. Ngjitur me kullën banonte një grua e moshuar. Ajo jetonte aty prej 22 vjetësh. Kishte lindur nëntë fëmijë por që të nëntë i kishin vdekur!



Në orën 6 u nisëm për tek ujvara që të dy. Fotografimi filloi në orën 7. Në të kthyer takuam një fshatar dhe bëmë ca rrugë bashkë. Nga ai mësova se: “nëse, vite më parë, një gjaksor ecte me mua përkrah dhe gjaksori vendoste mbas qafës një degë me gjethe, kjo d.m.th. që ai ishte në besën time. Pra nëse dikush e qëllonte me armë, kjo ishte baraz sikur të kishte qëlluar mbi mua dhe ky dikushi vihej në dy zjarre hakmarrjeje”. Punë kanuni!...



Ujvara e Thethit

Në kamp arritëm pas orës 8 dhe na mbetesh për të bërë “ceremonitë” para gjumit.

## 28

Jam në tren. Dje u ngritëm më nge dhe përgartitëm çantat e shpinës për udhëtimin e kthimit. Mbas orës 9 një karrocë e kooperativës na i morri çantat deri aty ku ndalojnë makinat. Orët kaluan. Kur erdhi autobuzi i linjës Zeneli u tërbua: dikush i kishte fshirë emrin nga lista e udhëtarëve. Por pas orës dy u gjet një mjet që e mori. Ne u nisëm pak para orës pesë dhe shkuam tek kampi i punëtorëve ku do na merrte një shofer që ishte i pirë. Pasi piu edhe dy gota uji me raki ra për të fjetur. E zgjuan në ora shtatë por nuk pranoi që të ngihej. Pas 15 minutash ja mbushën mëndjen që të nisej. U ula përpara me të, në të vetmin vend që kish në kabinë. U nisëm. U tmerrova me lëvizjet e tij në timon. Gradualisht u mësova. Mbrritëm në Shkodër pas orës 10 të natës. Fjetëm tek lulishtja e stacionit të trenit.

## VITI 1990

### Shkurt 1990; Livadhet e Bogëve

Sot është data 18 shkurt. Nuk kam patur as kushte e as mundësi që të shkruaj. Sot jam në çadër të sistemuar dhe rregulluar mirë: është shtruar poshtë buka e peshkut (polesterol) dhe është hedhur një plasmas i madh që e mbulon mirë çadrën, sidomos hyrjen e saj që është me zinxhirë të prishur.

Në datën 14 në mbrëmje mbritëm në Shkodër. Në hotel Sporti na dhanë dy dhoma të mira ku bëmë gjumë sikundër duhet, por me një fillim të keq: dy minj të vegjël u futën në çantën e ushqimeve të Dashit. U desht të ngrihemi dhe të sistemojmë gjithëshka mbi dollap.

Në datën 15 u nisëm për në Tamarë me një autobus enkas për ne. Rrugës u kontrolluam katër herë për dokumenta. U bënë shkaktarë beratasit që të njihem me komandantin e pikës kufitare në klon (*vijë kufitare me tela*) me të cilin ndënja deri sa ushtari mbaroi kontrollin e hollësishëm të dokumentave. Komandanti ishte me origjinë nga Leskoviku, por prindërit e tij jetonin në Qytetin Stalin (*Kuçovë*).

Komandanti i postës kufitare në Tamarë quhej Ilir. Ishte nga Vëzhzhda e Skraparit. Fillimisht nuk donte që të na linte të shkonim në Livadhet e Bogëve, por falë bisedës që bëra me të dhe sidomos falë faktit që unë e kisha të njohur Fatos Idrizin (ish anëtar i ekipit tonë dhe ish operativ në Kelmend), të cilin Iliri e paskësh shok të veçantë, unë sigurova lejen që të shkoja dhe të bëja çfarë të doja, me kusht që hera-herës të dërgoja tek ai informacion për gjendjen tonë.

Tamara dikur ka patur 4 a 5 shtëpi dhe ka shërbyer si pikë qendrore e fshatrave që popullojnë Kelmendin e kufijve që u caktuan në vitin 1913. U zhvillua si qendër administrative e Kelmendit dhe sot ka edhe “institucione” të tilla si hotel, shkollë të mesme, spital.

Pritja në Tamarë zgjati shumë për makinë. Kur nuk kishte më shpresë për mjet vajtëm në hotel ku ne, për gjashtë vetë që jemi si ekip, siguruam tre shtretër. Siguruam edhe dy dyshekë plus që i shtruam poshtë për të fjetur tre nga ne. Aty erdhi dhe më takoi një djalë nga Krraba (kam punuar në Krrabë mbi 13 vjet si mësues) që kryente shërbimin ushtarak me shërbimin kufitar. Kishte një simpati e adhurim të veçantë për mua! Ai iku me të shpejtë sepse merte shërbimin 10 ditë në një pikë kufitare mbi lumin e Cemit. E lamë që të takohemi në datën 26.

Në datën 16 pasi mbaruam me mëngjesin u gjet një makinë e cila do na çonte deri ku të mundëte, si ne edhe çantat tona. U nisëm pasi piva një raki dhe një kafe në dhomën e Ilirit. Rruga e makinës për në Nikç, nga ku ne do të ngjitemi tek Livadhet e Bogëve, më së shumti, kalon paralel me rrugën këmbësore, por në anën tjetër të lumit. Në fillim të luginës apo grykës ku kalon lumi Cemi i Vogël ndodhen fshatrat me pak banorë: Kozhnja, Kalca e Broja. Në Brojë kam kaluar një natë në 30 korrik 1964 dhe kam përjetur vet

i dymbëdhjetë një mikpritje të jashtëzakonëshme në shtëpinë ku ramë. Më tej, Vukli është fshati më i madh i kësaj lugine grykë. Thuhet se këtu ka gjetje arkeologjike të kohëve shumë të vjetra. Vukli ngrihet në rrëzë të malit të Dobrinjës dhe ka një lagje “të poshtme” që vjen deri në buzë të lumit e pranë rrugës automobilistike.

Pa hyrë në këtë fshat na la shoferi, sepse e trembi jo vetëm bora por edhe akulli në rrugë. Mora çantën dhe arrita i pari në fshat sepse nuk u interesova për kafshë bare, ndëkohë që të tjerët pritën sepse shpresonin të gjenin, por nuk u doli gjë. Në Nikç, për fat, u takova me të gjithë “personalitetet” e fshatit sepse ishin mbledhur tek Martini, miku im. Ata po pleqëronin me të se si të zgjidheshin problemet e lidhjes me energji elektrike të familjeve që kishin mbetur pa të nga era e fuqishme që fryu mbrëmë. Me personalitetet rashë në ujdë për kafshë bare për nesër, si dhe i binda që të na lironin dhomën e kopështit të fëmijëve në mënyrë që aty të kalonin natën ata alpinistë që nuk kishin të njohur në këtë fshat. Pasi u sistemuan të gjithë për fjetje, duke patur si “zyrë të shtabit” dyqanin e artikujve të ndryshëm, u nisa tek Martinin. Me të jam njohur para 4 a 5 dimrave. Më pas, Gjelina, e shoqja e tij me origjinë nga Gjelaj-Rrogam, pati probleme shëndetësore dhe erdhi në Tiranë. I ndihmova, etj. Martini më priti si mos më mirë. U vendosëm këtu unë Dashi e Xhimi, kurse Iliri, Koli e Foti shkuan tek Deda, mik i tyre. Tek Martini mblodha edhe këtë dimër fjalë të ralla të gjuhës sonë (të panjohura për mua).

Në datën 17 u mblodhëm në qendër të fshatit mbas orës tetë. Pritëm për kafshë transporti, por nuk po ecte puna. Në orën 10 erdhën të parat dhe u nisën ekipi i Kukësit dhe Sokoli me Ilirin. Më pas ekipi i Burelit dhe ....

Prita sa durova dhe më pas vura ngarkesën time në shpinë dhe pas tre orë ngjitje arrita tek vendi i kampimit. Çadrat

u ngritën brënda mureve gjysëm të shembura të baxhos verore. U sistemova në çadrën që ka ngritur Liri me Kolin dhe nxorra në diell gjithshka që e kisha të lagur. Më pas vajta tek zjarri i matjanëve të cilët më bënë një kafe. (kampin e kam ngritur poshtë Livadhit sepse aty ka dru ahu për zjarr. Edhe fshati duket prej këtu dhe mendoj se psikologjikisht kjo bën që alpinistët të ndjehen të qetë nëse ndodh ndonjë e papritur atmosferike). Zjarri është i domosdoshëm për shumë nga ne sepse ekipet nuk janë të pajisura si duhet për kalimin e natës

Sot është data 18. Pas orës 8 u nisëm dhe dolëm në qafën ku duken Livadhet. Prej qafës u ngjitëm në dy majat më të larta që janë këtu (i kalojnë 2000 metra). Në orën dy ishim në kamp. Ndërkohë erdhi edhe pjesa tjetër e alpinistëve që kishte ngelur mbrëmë në Nikç në pritje për kafshë bare. Një orë më pas kampi ishte i ngritur dhe i kompletuar. Ne jemi në rrëzë të një shkëmbi të stërmadh i cili ngrihet përpjetë dhe formon atë që quhet “Kështjella e Kelmendit”, vend me histori gjatë luftimeve me ushtri slave.

Në perëndimin tonë, jo më shumë se 20 metra larg çadrave, është një çukë 6 a 7 metra e lartë. Ajo në orën 15 fillon të lëshojë hije. Kjo hije i zë, i mbulon, një nga një tërë çadrat tona për 90 minuta. Pra hija nga çadra e parë ku bie në orën 15:00 (për ko incidencë është ajo ku fle unë) e deri tek ajo që e zë e fundit në orën 16:30 lëviz për 90 minuta. Ndërkohë dy çadrat më të skajshme të fushimit tonë nuk janë më shumë se 20 metra larg mes tyre.

## Shkurt, 19

Kam fjetur mirë por u zgjova nga kolla. Më mbyti! U nisën për në malin e Radohinës Iliri, Sokoli, Xhimi e Foti. Unë, Dashi dhe

Kasemi i Kukësit u ngjitem në malin e Rushkullit. Tre kuksianë të tjerë nuk erdhën me ne por ju bashkuan grupit që u ngjit në majën e Arushës. Tirana e Kukësi formojnë një togë; Berati e Bureli një togë tjetër.

Udhëtimi për të ngjitur e zbritur majat ishte i mrekullueshëm! Një para majë e pafund, rrëzë murit verior të majës së Radohinës, me formacione akulli e bore të ngrirë dhe të “punuar” nga era, të këndellin e të bëjnë të udhëtosh e të udhëtosh në këtë bardhësi me qetësi absolute. U takuam me katër çunat tanë më 12:30, aty ku edhe u ndamë për të sulmuar majat. Hëngrëm pak dhe pushuam dhe më pas morëm rrugën për në kamp. Mbasi mbaruam me drekën dhe tharjet e materialeve të nevojshme për nesër, u futa në çadër dhe po pres përfaqësuesit e ekipeve për mbledhjen e ditës.

## Shkurt 20

Ditë e mrekullueshme! Qielli është vetëm blunajë me diell. Erë thuajse nuk ka. Disa ndenjën në çadra për të pushuar. Shtatë vetë u nisën për Radohinë. Një kuksian që ishte nisur pa kthetra kishte rrëshqitur në borën e ngrirë të kreshtës dhe për tu mbajtur, frenuar, kishte ngulur thonjtë. Thonjtë dhe duart i ishin bërë gjak. Thonjtë i shin thyer duke “gërrmuar” deri sa kish frenuar (ishte ndalur). Një matjan u ul në fshat me një listë me porosi nga ekipet, kurse nga ekipi ynë dy litarë (Sokoli e Xhimi dhe Iliri e Foti) kryen ngjitje në një të gjashtë shkëmbore (mbi liqen) në majën e Trandofilles. Lart, në majë, i prise Dashi dhe më pas të gjithë bashkë u ngjiten në një majë të dytë aty pranë. Gjatë gjithë kohës ndënja në vrojtim.

Ekipet kanë ardhur të pajisur keq për kalimin e natës. Zjarrin e kanë domosdoshmëri. Për çudi e vetmja sopatë në kamp është sopata e ekipit tonë që jemi më të pajisurit për fjetje. Ne vetëm

një ditë premë dru, por zjarr nuk ndezëm sepse në çadrat tona është ngrohtë jo vetëm për të fjetur por edhe për të ndenjur. Këtu ka alpinistë të cilët natën, nga të ftohtët, dalin nga çadra dhe vine e rrinë ose flejnë pranë zjarrit. U kam dhënë leje që të shkojnë edhe në fshat për 1 a 2 net për “shplodhje” në mënyrë që ata që mbeten këtu tu përdorin mbulesat e shtresat (e njëri tjetrit). Deri tani nuk është ulur kush në fshat për këtë. Për fat!, nuk ka të sëmurë.

Ekipet kanë ardhë pa synime se çfarë do të tentojnë. Deri tani janë ngjitur aty ku i kam udhëzuar si dhe andej nga janë hapur itenerarët nga djemtë e ekipit tonë.

Liqeni në veri të kësaj grope (pranë kampi tonë) që quhet Livadhet e Bogëve është i ngrirë. Në mesin e tij, nga era, është krijuar një kodrinë e vogël bore. Në jug të tij, 60 a 70 mera larg buzës së tij, janë stanet verore. Bora është rrafsh me muret e staneve. Trarët e hollë të kulmit të staneve dhe bardhësia e kësaj bore të kujtojnë, tek i shikon nga larg, një fletore të vijëzuar.

## Shkurt 21

Dita është zgjuar me një qiell me re të holla si vello në të, dhe me temperaturë të pranueshme. Vajta tek zjarri i matjanëve dhe piva një kafe të shoqëruar me një cigare. Biseduam pleqërishte për të filluar një ditë sa më të mbarë! Pasi u nisën tre ekipe në drejtim të majave (ekipi ynë është pushim sot) unë dhe Iliri u nisëm për në majën e Arushës. Itenerari nuk ishte i vështirë ndonëse kishte segmente me shkëmb si dhe segmente me akull. Punuam mirë dhe pa ndërprerje dhe mbas orës 13 ishim në kamp.

Pas drekës u shtriva në çadër por nuk doja që të më kaplonte gjumi. Andaj u ngrita dhe fillova të rruhem. Këtu jemi 20 vetë dhe askush nuk ka pasqyrë. Dashi më ndihmoi që të shihesha tek syzet alpine. Më pas vajta tek burimi që është një curril që fillon

nga rrëza e Shnikut e vazhdon për qindra metra deri këtu ku jemi. Tek ne currili bie nga ca “mjekra” akulli. Për nesër do synoj majën e Thatë. Është e vështirë, por pranë saj është edhe një majë tjetër, më e thjeshtë, me mundësi për tu ngjitur në rast dështimi.

## Shkurt 22

Kam bërë një gjumë të mirë dhe të ngrohtë. Era uturin ndër maja malesh por ende jo këtu tek ne. Këtu ndjehet ende “ngrohtë”. Në orën 7 nisemi që të gjithë për ngjitje. Unë Iliri e Sokoli do të shkojmë drejt majës së Thatë. Për të shpejtuar nisjen e të tjerëve u nisa i vetëm dhe pas një ore më arritën Iliri e Sokoli. Itenerari ynë ishte tërësisht në hije deri në orën dhjetë e një çerek, kohë kur dolëm në Qafën e Livadhit. Nga kjo qafë, tetë vjet më parë, erdha me grupin e parë të alpinistëve në Livadhet e Bogëve, për ta studjuar këtë stadium alpin duke realizuar njëherësh edhe ngjitje. Mario dhe unë kishim marrë edhe djemt me vete: Bruno dhe Hermes. Hermes i atë shtator filloi klasën e parë.

Qafa është rreth 2200 metra e lartë. Ende pa dalë në të ndjemë tërbimin e erës, që me shkulmet e saj ngrinte nga poshtë kristale bore të thatë dhe mijra syresh formonin një rrymë vezulluese që era e hidhte matanë qafës, por pa harruar për t’i përplasur ato në trupat dhe fytyrën tonë. Nuk hëngra mëngjes por aty nga ora nëntë sejcili nga ne hëngri nga dy biskota dhe 2 a 3 karamеле. Zbresim matanë qafës rreth 20 metra që të mbrohem i nga shkulmet e erës. Nga pika ku qëndrojmë pamja jugore e alpeve na duket më e butë si reliev. Pastroja nga bora këpucën e hequr nga këmba dhe një shkulm ere ma fluturon. Për fat 10 metra më poshtë atë e mbërtheu Sokoli. Shkulmi i erës i “rërëmbu” nga dora Ilirit fetën e bukës dhe ja fluturoi tutje 2 a 300 metra poshtë.



Mbathëm kthetrat dhe u nisëm ndrejt majës. Në të përpjetën e fundit, për 200 metra a më shumë, kaluam nëpër një plan të akullt e të pjerërët ku kthetrat ishin domosdoshmëri. Njëherësh përkulja e trupit dhe ngulja e kazmës hera-herës ishin të nevojshme që të bëheshin sepse vetëm në këtë mënyrë mund të ruanim ekujlibrin gjatë shkulmeve të erës. Duhet të ishte ora 11 e 30 kur ishim në majë. Në majë dhe në kthimin nga maja bëra ca foto të cilat besoj se do jenë të veçanta.

Në zbritje, tek Shpella e Nikçit (kështu quhet një guvë në mes të Livadhit, bri itinerarit, që ka ujë të pishëm gjatë gjithë verës) me Ilirin u ngjitëm tek ajo për të parë nëse kishte ujë. Ajo ishte krejt e mbushur me borë. Në kamp arritëm para orës tre. Piva shumë ujë dhe hëngrëm një drekë të bollëshme.

Këtu poshtë (në kamp) nuk fryn erë. Atje sipër, ku bora ishte e thatë, era i ngrinte lart kristalet e saj dhe na i përplaste në fytyrë. Ishte shqetësuese sepse kristalet të “shponin” vazhdimisht fytyrën dhe vjen një moment që të duket se fytyra po të merr zjarr. Le po të mos kesh syze dielli!....

## 23 shkurt

Meqë jemi keq me ndriçimin, nuk kemi më qirinj, biem herët për të fjetur dhe kështu gjumi na del herët. U ngritëm dhe u përgatitëm për ngjitje. Me Ilirin, Sokolin dhe me dy beratas u ngjita në malin e Shnikut. Ky mal ka dy maja: maja e Shnikut dhe maja e Madhe. Me sa njoh unë bjeshkët ky është i vetmi mal në Bjeshkët e Namuna që ka emrin e një shënjtori, atë të Nikollës (Shnik = Shën Nikolla. Të tilla toponime kemi edhe në vende të tjera si: Shpal; Shkallnur, Shëmri, etj.).

Rrugës për në majë të tërheq vemendjen një rrip pylli i prerë dhe i sakatuar nga një orteq i fuqishëm. Ka qenë aq i fuqishëm sa është dëgjuar edhe në fshat. Këtë na i thanë fshatarët kur ishim

poshtë. Ngjitja ishte e thjeshtë sepse zgjodhëm si itenerar një shpat që e rreh tërë ditën dielli dhe thuajse ëshë pa borë. Shkrija e borës këtu, me sa duket, ka bërë që dhinë e egra të kullosin barin e thatë që ka dalë në sipërfaqe. Andaj dhe pamë shumë gjurmë të dhive të egra. Nga Maja e Shnikut në Majën e Madhe ngjitja na mori një orë duke ecur nëpër një kreshtë që të duket si e pafundme, vende-vende me guriçka të “ngjitura” mes tyre me akull.

Arritja në majë është mbresëlënëse. Është maja më e larta e pjesës veriore të Bjeshkëve, 2554 metra. Të duket sikur këtu Bjeshkët e Namuna “këputen” sepse në pjesën veriore të majës çdo gjë është më e ulët, ndërkohë që duke qenë majë e lartë kjo është një nga pikat më të mira për të soditur alpet. Për të parën herë kam shkelur në këtë majë në verën e vitit 1965 dhe më pas do jem ngjitur o në vitin 1969 o në vitin 1974, ose në të dy këto vite. Në kthim ndaluam e pushuam në Qafë Dobraqe, sikundër bëmë edhe gjatë ngjitjes, sepse këtu nuk mungon uji i pishëm që është me tepri. Në kamp, pasi mbaruam me drekën dhe higjenën sikundër bëjmë për çdo ditë, lajmërova anëtarët e shtabit që të mblidheshim.

## Shkurt 24

Në orën 6 e gjysëm më erdhi në çadër Bajram Koleci dhe më zgjoi. Më ftoi për kafe. Kur dola nga çadra zgjova djemt e ekipit që kishin rënë mbrëmë vonë për të fjetur ngaqë luajtën domino. Pasi mbarova me kafënë nisa grupet që do të kryenin ngjitje dhe pas kësaj me Dashin, Ilirin dhe Luanin e Burelit u ulëm të hamë mëngjesit. Që kur kemi ardhë këtu është e para ditë që e ha mëngjesin mëngjes.

Në orën 11 u nisa me Ilirin dhe Luanin që të fotografoja. Pa dalë në Dobraqë u mora me fotografimin e luginës së Cemët të

Vogël. Në qafë fotografova majat e Shtogut dhe Rrushkullit. Dhe këtu filmi mbaroi! U mërzi ta shumë! Megjithatë udhëtuam deri në fund të Qafës dhe më pas, sigurisht, u kthyem për në kamp. Rugës takuam dy të rinj nga Vukli të cilët po shkonin në Theth. Më pas me djemtë, deri sa arritëm në kamp, u “tjerr” biseda me temë “Sa të thjeshtë e kanë këta banorë që të arratisen”. Temë e kaherëshme shqiptare!

Kur arritëm në kamp një pjesë e alpinistëve ishin kthyer dhe nuk kaloi shumë dhe erdhën edhe më të vonuarit. Pas 20 minutash i mbledha të gjithë dhe u thashë që do e mbyllim veprimtarinë e ngjitjeve dimërore. Gjykova që në datën 25 të kalohet dita dhe nata në Nikç, më datë 26 në Tamarë dhe më datë 27 të jemi në Shkodër. Ndjej se ekipet që kanë probleme me fjetjen (mangësi në pajimet për të fjetur) nuk do kenë më tej mobilizim që të kalojnë netët në borë. Andaj e mora këtë vendim.

## Shkurt 25

Kur është dita për të ikur nuk është nevoja të kujdesesh për të zgjuar kampin. Mbasi ikën të gjithë, ekipi ynë u bë “zot” i gjithëshkaje e sidomos i zjarreve të lëna. Bëmë një zjarr të vetëm duke mbledhur drutë e lëna. Hëngrëm mëngjes të ngrohtë: bukë të thekur me gjalp e me kakao me tepri. Moti është i mrekullueshëm! Le pa le, po na erdhi edhe një zog që na bëri serenatë me cicërima teksa hanim mëngjesin!

Duke zbritur e duke ju larguar lartësive ndjen afsh të ngrohtë dhe kur arrita fshatin ndjeva pranverë. Sigurisht kjo ka të bëjë me diferencën e lartësive dhe temperaturave sepse këtu pranvera do edhe dy muaj që të vijë. Në orën 13 i mbledha ekipet që të bënim “shën analizën” e veprimtarisë. Kaloi mirë. Çuditërisht (nga përmasa) u përcoll si tepër respekti për ekipin tonë dhe u

tha se “kur të jeshë me 17 Nëntorin duhet të përgatitesh mirë për të bërë alpinizëm”. Furçat për mua ishin me bojë të bollshme.

Pas analizës vajta tek Dedushi, miku i Ilirit dhe Sokolit që këtë dimër dyshes ju bashkua edhe Foti. Sokoli ishte tërë ditën mëndjengritur për të shkuar në Shkodër. I dhashë leje. Ishin disa arësye që vajta tek Dedushi: ngaqë është i moshuar dhe bashkë me të shoqen kanë dobësi për Ilirin dhe Sokolin. Kur u nis Sokoli për Shkodër, qau. Dhe veç këtyre, ka kërkuar të takohet me Komandantin (unë quhem Komandant i veprimtarisë, titull që na jepej shpesh ne alpinistëve më të moshuar, andaj dhe na dukej si një monedhë e shverësuar. Por për një malësor, sidomos për një malësor të moshuar, titulli komandant kishte vlerë për respekt të veçantë).

Dedushi jeton me të shoqen; të dy aq të moshuar dhe të vrarë nga jeta saqë e kanë të pamundur që të mirëmbajnë shtëpinë. Andaj mjedisi i tyre bie në sy që është i ndotur. Por ata kanë vite që janë mësuar të mbijetojnë në këto kushte. Shtëpia e tyre është më lindorja e fshatit, e “mënjanuar” nga fshati, në të përpjetën për në Qafë Dobraçe dhe në pozicion panoramik. Po vajte tek shtëpia e Dedushit e ke rrugën pa pengesa për tu arratisur (temë e kohës), mjafton që të dishë itenerarin. Dedushi më tregoi se si në kohën e Mbretit Zog pesë ushtarë të nisir ditën e Shënkollit (6 dhjetor) për në Dukagjin i zuri moti i lig (keq) dhe mbetën të vdekur në Klllogje. I gjeti një bari pas shtatë muajsh, më 15 korrik. Ishin të gjithë bashkë, një grumbull të vdekurish. Njëri prej ushtarëve ishte dukagjinas dhe e ëma e pati kërkuar me njerëz për muaj të tërë.

Dedushi më tregoi se vite më parë, një muaj shtator, (në kohën e partisë) kish parë rastësisht në Qafë Dobraçe një frat (fillimish i ishte dukur si grua) i cili donte të arratisëj. Dedushi që e mori përsipër aratisjen e tij pasi ai e pyeti se nga ishte kufri,



Martin Lleshi me fëmijët nipat e mbesat



Djali Martinit

e mashtroi: në vend që ta nxirrte matanë kufirit e uli në fshat duke ja dorëzuar operativit. Nuk e kishte lënë operativin që të vinte dorë (ta rrihte) mbi fratin dhe për tu siguruar për këtë kish shkuar me fratin dhe operativin deri në Tamarë. Më pas e kishin thirrur në Shkodër për ta dekoruar dhe për t'i dhënë pushkë. Pushkën nuk e kishte pranuar. “Më duhet sopatë për punë (punonte drurin) se me të edhe mbrohem”, u kishte thënë pushtetarëve. Më tregoi edhe histori të tjera.

Jemi tek Martini: unë Dashi e Xhemali. Martini na skjaroi se përse në të gjithë Kelmendin ka rreth 10 familje muslimane në një lagje të Nikçit (Shipenza?). Ndërkohë Xhimi ka përgatitur ca meze qytetare dhe është shtruar tavolina. Gëzimi dhe Martini, i biri me të atin, i bien çiftelisë dhe fyellit dhe Dashi me Kreshnikun (djalin tjetër të Martinit dhe Gjelinës) kërcejnë.

## Shkurt 26

Çantat ishin të përgatitura që mbrëmë dhe pasi u ndamë me familjen e Martinit në orën shtatë u nisëm me makinën që na priste. 17 kilometrat deri në Tamarë makina i përshkoi për dy orë, jo vetëm për arësye të cilësisë së keqe të rrugës, por edhe të ndalesave hip-e-zbrit të njerëzve. Nikçin e lamë të vrejtur, por nga Vukli e tutje qielli ishte vetëm i kaltër. Në Tamarë takova ushtarin që është nga Krraba. Ishte i biri i Xhemol dhe Hane

Selbës. U ulëm në lokal por shpejt e lashë vetëm në tavolinë sepse u nis autobusi, që na dërgoi drejt e në hotel, por meqë nuk kishte vende u sulëm me shpejtësi drejt stacionit të trenit. E arritëm!...

Fjalë të rralla që mblodha tek shtëpia e Martinit:

Del kapún = plisi del me dhé dhe bar

Busë = plis

Tlana = uji me të cilin janë larë pa sapun enët e ushqimit të ngrënë dhe që i jepet thiut/derrit

Brimtar = ai ose ajo që bën/vargëzon këngë për të vdekurin

Trojak = dru me vrima e me damar të zinj

Osojn = vend ku dielli nuk qëndron/bie gjatë sepse e zënë malet

Ulun (i ulur) cuxë = i ulur galiç, i ulur në bisht

Tallagan = veshje a mbulesë leshi për bariun e punuar/bërë me kopsa

Lakomicë = hinkë

Lkostër = lëkurë, lëvozhgë

Trap = gropë ku futen patatet

Xbunim = përkëdhelje

Majsí = vendi para stallës ku rrinë bagëtia

Me e mo = me e rregullu

Zgjatje langu = fjalë që përdoret kur lëngu i turshisë bëhet si jargë

Kryelanë = bukë e ngrohtë e përsheshur me tylyn dhe qepë në tigan

Psti rrushi = rrush i shtypur

Hardadhi = mbeturinat e rrushit pas zjerjes të përziera me mbeturinat e prodhimit të verës të lëna ca kohë, u shtohet ca ujë dhe vulozet. Ky lëng (biçim vere) quhet hardadhi

Me majt thatë = me mbajt kreshëm

Çufër = dru i mpleksur dhe i pa zhvilluar  
 Voxga = lloj shkurre me gjëmba e xhufka  
 Rrushkullak = kaçurrel  
 E kan varua = e kanë plugosur  
 Méra = frika, tmerri  
 Tram-a = frika  
 Rihna = vend me pemë = megjë  
 Megjë = vend i rrethuar me kullotë e bar  
 Me bzhitë = me skuq  
 Pip = filiz në rritje  
 Pip i vetëm = njeri i vetëm, + njeri pa vëlla  
 Bull-a = grua me fe muslimane  
 Syls = një sasi parashë që lë i vdekuri për shërbimet  
 Tpini = tundësi  
 Stok = mullar me gjethe  
 Asht elti i gjallë = është një shkëmb i lëmuar  
 Lazaret = vendi (stalla) ku rrinë kafshët e ushtrisë  
 Gomit = grumbull gurësh të vegjël  
 Patatet kanë dalë gomit = është bërë patatja shumë  
 Skuqit pishe = pjesa e brëndëshme e pemës së pishës  
 Fiktohet = thahet (patatja) e bëhet si fik i thatë  
 Nuk ka dylkim = nuk ka përkulje  
 Stërpuj = shtrëngim, ngjeshje e tokës nga uji  
 Syzohe ma vonë = dalin syzat më vonë  
 Çuk = trangu i pemës që ka ngelur në tokë pas prerjes dhe ka filluar të kalbëzohet  
 Po rri çuk = po ri si i ngrirë, i pa lëvizur  
 Çuk = cung (dukagjini)  
 Kllak = llaç  
 Me currak = me çvesh (kallamoq)  
 Krih-krih = shtrega-shtrega = tufa-tufa

Ç'po lupihe = ç'po kreheshe; ç'po zbukuroheshe  
Kaçuba = për flokët kur janë pa qethur për kohë të gjatë  
Gjolla = vendi ku u hidhet deleve kripë  
Kapërcyllë = shkallë e vogël për të kaluar këmbësori një gardh  
Troke = këmbanë e vogël dhensh  
Ksaca = pinca të vjetra për të kthyer telin  
Harbaçike = qepë  
Lugicë = ndarëse e supës, gjellës  
Zgollojë = e çarë shkëmbi ku mund të ngecë bagëtia  
Zgabinatë = zgollojë  
Krozha = shportë e vogël e punuar me thupra shelgu për rrush ose fiq  
Kallajç = kuti konserve  
Lick = e poshtër (e përdorin gratë kur zihen/grinden mes tyre)  
Kulí = prostitutë  
Sharaman = zdrukth i madh një metrosh për dërrasa dysHEMEJE ose degë gaviçi  
Budermen = bashkim i drasave femër-mashkull  
Burthi (më ka ra burthi) = më ka shkuar mëndja (burthi) për....  
Me grebit = me mbledh (sanë); me grebë d.m.th. me mbledh të mbeturat pas mbledhjes së parë  
Burgi = tyrjelë  
Skrapi = supë e trashë me miell e ujë; kaçamak i hollë  
Pejka = laqe/leqe punuar me pe në grykën e thesit ku shkohet më pas gjalma për ta mbyllur atë  
Pejka = vendi ku futet grepi i peshores/kandarit  
E cingrojnë = e peshojnë  
Errfojkë = unazë druri që përdoret për litarin e barrës, etj që të mos fërkohet litari me litar.



Kizë = drapër që punohet prej kose e që përdoret për të korrur misër

Zumç = mjet që çpon rrobë të fortë për ta qepur

**Shënim:** *në zyrën ku kam pas punuar në vitet 1984-1992 kisha një koleg, Sadik Kalaja, që ishte i përfshirë në fushatën mbarë kombëtare për mbledhjen e fjalës së rrallë. Të gjitha fjalët që kisha mbledhur më parë si dhe ato të kësaj periudhe ja kam pas dorëzuar kolegut tim, i cili mbasi i përpunonte si profesionist i dorëzonte edhe fjalët e mbledhura nga unë në Institutin e Studimeve Gjuhësore. Ai më ka pas thënë që unë e “ndihmova” me rreth 500 fjalë.*

## Valbonë, korrik 1990

### Korrik 15

U nisëm në orën 10. Arturi nuk vjen. Dje ai është diagnostikuar se është me dizanteri. Edhe Foti nuk vjen sepse ka provim (ndjek fakultetin e inxhinjerisë). Në Koman kaluam nga autobusi në traget. Udhëtim i bukur. Këtu është edhe një mikrobush i një ekipi xhirimi nga Gjermania Perëndimore (kuptohet nga targa e makinës). Janë tre djem një vajzë dhe shoferi.

Në Bajram Curri jemi rregulluar mirë në hotel ku dhe hëngrëm një “biçim” darke. Më pas me Nuredinin, Kozmanë dhe Gjergjin shkuam tek klubi i oficerave për kafe ku bisedohej me indinjatë për ata që kanë hyrë nëpër ambasada.

### 16

Sot këtu u fol shumë për shirat që kanë rënë dje dhe pardje, për rrufenë që ka vrarë dy vetë dhe për lumin që erdhi papritur dhe rrëmbeu tre vetë, prej të cilëve njëri u mbyt.

Dasma e mbrëmëshme në hotel kishte mbledhur parinë e vendit si dhe të ftuar nga Kosova. Një kosovar kishte ngritur dolli duke uruar “sot çiftin e ri, nesër për Kosovën dhe ma vonë për bashkimin monetar”. Po u del frika njerëzve.

Për në Valbonë u nisëm në orën dy. Këtu gjetëm dhe ekipin Gjerman të xhirimit. E nisëm Gjergjin për tek baxho, vend ku mund të njoftoheshin të gjithë kafsharët që sillnin aty qumështin nga stanet për nevojat tona për transport me kafshë. Gjergjin në baxho e kishin gositur me kos dhe djathë. Kjo bëri që Zenelit t’i ngrihet mëndja dhe të shkojë në baxho, pasi hëngri drekën. Gostia u përsërit.

Pas orës pesë ekipi ynë u nis për në vendin ku do të ngrihej kampi (zona e Ziçit). Vendi është në mes të pyllit dhe me ujë afër çadrave. Stanin e kemi rreth 300 metra më në veri. Këtu kam pas ndenjor rreth një javë në verën e vitit 1966 dhe kemi pas marrë pjesë në xhirimin e një filmi me temë propagandistike për sportin e alpinizmit. Edhe në shkurtin e vitit 1980 kemi ndenjor rreth një javë për ngjitjet e sezonit dimëror. Herë të tjera kam qenë kalimtar këtu.

Jemi të porositur që të mos lëvizim në fshat pasi ka stërvitje ushtarake dhe do të bëhen qitje me artileri.

## 17

Alpinistët pas orës tetë filluan të ulen në luginë. Unë e Zeneli u ulëm pas orës 10 duke patur edhe aparatet e fotografimit. Shkuam lart e poshtë për të fotografuar dhe diku ramë në një “thesar” me mana toke (luleshtrydhe). Takuam edhe ekipet e ardhura me vonesë e që mbasdite do të ngjiten e të ngrenë tendat tek ne. Kur morrëm rrugën për në kamp takova Ajet Malajn. Do na sjellë çdo ditë dy litra qumësht nga stani i tij. Buzë mbrëmjes, kur u mblodhën të gjithë ekipet, i mblodha drejtuesit e tyre për rreth



Aleksandër Bojaxhi dhe Zenel Kokomiri

10 minuta dhe i sqarova për mënyrën se si do të organizojmë jetën në kamping si dhe veprimtaritë. Me ushqime jemi shumë keq. Për ndriçim unë kam vetëm dy qirinj. Edhe qirinj është e vështirë të gjesh në treg.

## 18

Mëngjesi për mua filloi me një punë intensive për të organizuar togat. Më pas afrim tek shkëmbejtë dhe ndarje e dysheve dhe tresheve të litarëve për ngjitje. Tre alpinistët e ekipit si dhe Gjergjin i futa në një oxhak të madh të cilin dikur e kam pas ngjitur edhe unë.

Në orën 10 filluan qitjet. U futëm në rrëzë të shkëmbenjve dhe njoftuam kë mundëm të ndërpresin ngjitjet sepse për disa minuta predhat oshëtinë edhe pranë nesh. Më pas pati qetësi dhe përsëri qitje.

Në orën 12 me Zenelin, me dy alpinistë të Burelit dhe një të Gjirokastrës, u ngjitëm lart në mal për fotografime. U kthyem pas katër orësh. Nisëm dy vetë në fshat për të marrë informim, të cilët kur u kthyen na njoftuan se nuk do të ketë më qitje.

## 19

Moti me mjegull dhe shi të dobët. E gjithë dita kaloi e tillë. Gjergjin, Ilirin dhe Ardin i nisa poshtë që të hanin në restorant dhe të na siguronin bukë. Mbasdite erdhi Ajeti me një shokun e tij, i cili na solli dy litra qumësht. Ndenjëm bashkë një copë herë. Në kamp dëgjohen stacione të ndryshme në radio. Kemi këtu tre radio. Mbrëmë djemve u la/u bëri përshtypje pleniumi i Tiranës dhe ai i Durrësit. Dëgjojnë dhe bëjnë komente “të forta”.

## 20

Sot përsëri ditë pa ngjitje. Moti është i vranët dhe pritet nga moment në moment që të bjerë shi. Rreth orës nëntë Gjergji dhe ekipi i Fierit u nisën për tek Buni (Kroni) i Valbonës. Është burimi më i sipërm i luginës, nën Qafën e Valbonës. Pas një ore unë, Zeneli, Iliri dhe Ardi u ulëm tek pika turistike që është poshtë nesh. Aty është një bufe e punuar e gjitha me trungje a degë të holla pishe, me streha për tu mbrojtur nga dielli dhe ndënjëse druri. Shërbente si kamarier Zymeri, djali i Ibrahimit, të cilin e kam pas njohur kur ai ishte nxënës i klasës së tetë. Tani Zymeri është student i fakultetit të mjeksisë dhe ka përfunduar vitin e tretë të studimeve. Sot Koli u nis për në Tiranë. Natën ndenjëm gjatë pranë zjarrit. Të gjithë janë të dhënë pas lajmeve.

## 21

Iku gjysma e ditëve të periudhës së veprimtarisë. Sapo u ngrita vajta tek çadrat e fierakëve. Pasi hëngrëm mëngjesin biseduam

që të ngjitemi në majat Pecmare dhe Qet Harushe. Është një nga gjërat e mundëshme që mund të bëjmë në këtë mot të paqëndrueshëm. Më pas me Zenelin u ulëm në Valbonë. Na morri rrugës një mikrobush me të rinj nga Bajram Curri që shoqëronin një Kosovar të tyrin të ardhur nga Amerika. Në restorant hëngrëm drekën por nuk na dhanë bukë për në kamp.

Kur u kthyen djemtë nga ngjitja mësova se Gjergji ishte ndeshur rrugës me dy gjarpërinj, njërin prej të cilëve e kishte vrarë. Nuk më ka ngjarë mua që kthej rrugë kur më del gjarpëri.

## 22

Në orën nëntë u nisa me Ilirin, Ardin dhe Gjergjin për në majën e Lugbatit. Ata u nisën drejt majës. Unë i pritja sipër në shteg sepse ata u kthyen nga shtegu që lidh Currain me Valbonën, nga lartësitë e Zallit të Motinës. Mbas orës gjashtë u kthyen edhe ata që kishin shkuar në Valbonë dhe Bajram Curri për bukë, Aaskush nuk të shet bukë. Mësuam se mbrëmë tek Turizmi disa të rinj të dehur janë zënë dhe kanë thyer e prishur orendi si dhe janë gjakosur.

## 23

Ditë pushimi. Iliri me Gjergjin u ulën në Valbonë dhe na sollën tre bukë (fitore!), 1 kg makarona, 1 kg miell për petulla dhe gjysëm lira vaj për gatim, por shumë të keq.

Sot na skjaruan për grindjen mbrëmë tek Turizmi. Katër shokë të pirë, “për qef” kanë thyer e përplasar orendi, kanë provuar se çfarë mund të thyejnë me grushta dhe kanë gjakosur kështu edhe duart edhe orenditë... Prokuroria e Bajram Currit ishte në vendngjarje.


Sot mbylla llogaritë me djemtë e ekipit ngase nuk kemi se çfarë të blejmë si kolektiv. Nuk ka!

## 24

Sot u ngjitëm nga Brijasi. Zgjodha një shteg, fillimisht bagëtishë, që si një shkallare gjarpëruese i ngjitet shpatit verior të malit duke na dhuruar pamje të mrekullueshme të luginës si dhe freskinë e faqeve veriore të malit. Studiuam për një itinerar të mundëshëm në faqen veriore të Brijasit: është faqe e bukur me pjesën e sipërme të thjeshtë por shumë të coptuar; me shkëmb të pasigurtë për pika kapje të kacavarsit. [shkam i mbështredhun = shkëmb që të shkoqet kur e kap me dorë].

I nxorra deri në qafë prej nga u tregova itinerarin për në majë. Në majë u ngjitën Iliri, Gjergji, Eqeremi, Pandi. Ardi u kthye sepse ju çanë këpucët.

Në buzëmbremje Gjergji në pemën e madhe tek burimi ynë pa një ketër. Kjo bëri që disa alpinistë të mblidhen atje. Madje njëri kishte llastiqe! Ketri kërcente bukur deri sa u humbi nga sytë. Për mua ishte hera e parë që u ndesha me ketër në Valbonë.



Gjergj Bojaxhi në Valbonë (Fotografoi  
Zenel Kokomiri)

## 25

Është nata e fundit që jemi këtu. Ka mbetur vetëm ekipi ynë. Të gjithë ekipet janë ulur sot në Valbonë. Është mbyllur kështu veprimtaria alpinistike e sezonit veror. Më e dobëta veprimtari alpinistike që mbaj mend. Më e dobëta në sasi dhe cilësi ngjitjesh. Për të kaluar ditën u nisëm për në Pecmare për të fotografuar. Si mbaruam këtë “mision”, në kthim patëm rastin të kënaqemi me luleshtrydhe dhe në kamp u morrëm me higjenë dhe larje robash. Sot ka qenë shumë vapë.

## 26

U ngritëm më nge dhe filluam të përgatitemi për zbritje. Një shi i shkurtër na ndërpreu vrullin e “paketimit”. U ulëm tek Fusha e Gjesë që në fshat po e quajnë “Pika Turistike”. Pasi u lamë dhe u rruam u ulëm dhe me dy shishe verë festuam ditëlindjen e Ilirit. Kur erdhi koha për tu nisur filloi shi i rrëmbyer që ende po vazhdon, por me ndërprerje. Na morri një makinë ZUK dhe kapëm autobusin e linjës në qendër të Valbonës. Por aty na thanë se ekipin tonë dhe ekipin e Dajtit e kanë planifikuar që të nisemi nesër për në Bajram Curri.

## 27

Autobusi i klubit Valbona erdhi pas orës 10 e na transportoi deri në Fjerëz. Prej aty me target në Koman dhe më pas drejt e në Tiranë.

*Mbajtur nga Aleksandri*

# VITI 1991

## Janar-Shkurt 1991, kategoritë e larta; Valbonë

### Shkurt, 4

Është dita më e këndëshme ndër ditët që kemi kaluar deri tani. Është më ngrohtë se çdo ditë tjetër e mëparëshme, nuk ka as erë e as re në qiell. Ditët që kaluan ka qenë shumë të ftohta por këtu askush nuk ka termometër që të matet temperaturura e ajrit. Madje dikush tha, “mirë që nuk kanë termometër sepse po të merrnin vesh se sa ulet temperatura do e kishin lënë këtë vend”. Nejse, këto janë ndjesi të të ardhurve. Ja një panoramë e ditëve që kaluam.

Dt 30. Udhëtim me një autobus që nga jashtë, edhe dritaret, ishte i baltosur, që prishet rrugës dy herë dhe megjithatë e arrin tragetin pa u nisur. Është shumë ftohtë. Në Fierzë ndjen dyndjen e udhëtarëve që i sulen autobusit të vetëm që na prët. Gjithkush kënaqet po u fut në të, se sa për ulëse, harroje! Unë dhe Ardi arritëm të futemi dhe jemi aq ngjeshur sa nuk përshkruhet. Në Bajram Curri sulemi tek Hotel Shkëlzeni, por ky është në riparim. Sulemi tek Hotel Kosova. Është i riparuar, por e kanë



bërë më keq se një xhaketë të vjetër të kthyer. Na dhanë vetëm një dhomë me dy shtretër. Ndërkohë arrijnë Iliri e Xhimi.

Jashtë takuam Nuredinin dhe Taxhin dhe u ulëm për kafe tek “Jezerca”. Më pas shkuam në restorant dhe prej aty përfunduam tek shtëpia e Nuredinit që u tregua ngulmues për ta vizitur në familje. Ai ka një dhomë të vetme tek i vëllai, Qazimi. Ka dy fëmijë dhe bashkëshorten, Aishen. Kanë tre vjet në këtë dhomë. Pas pak “shpërtheu” Aishja për shqetësimet që kanë. Ajo është mjeke stomatologe në Bujan që nga muaji tetor, por nuk punon as fare sepse klinika e saj nuk ka as edhe një medikament që kërkon puna e saj. Këta si familje, nga ngushtica, i kanë tërë pajisjet dhe orenditë të shpërndara ndër të njohur. “Edhe po morrëm shtëpi nesër na duhet një muaj që t’i mbledhim ato” tha Aishja.

Kaluam një natë me biseda për demokracinë dhe kur erdhi Qazimi ato “morrën rrugë komuniste”. Pasi e lamë që të fliste ndërhyra dhe fola jo më shumë se 10 minuta pa ndërprerje. Pas kësaj ai e mbylli gojën e për aq sa ndenjëm, më pas, ai nuk foli fare. Shkuam në hotel ku fjetëm dy vetë në një shtrat.

Dt 31. Në orën 9 u futëm në autobus, por ai nuk ndizej. Kaluam nëpër kafene e rrugë të qytetit që të shikonim mundësi për shofer me kamion. Takuam Shemshedinin (ish alpinist i këtij qyteti që e kam pas njohur në vitin 1969). Xhepat i kishte mbushur me programe të partisë Republikane. Ka marrë përsipër që të krijojë një degë të kësaj partie në Bajram Curri.

U nisëm në ora një, por pas 15 minutash shoferi ndali dhe ju deshën 45 minuta që “të vishte” gomat me zinxhirë. Valbona është edhe më e ftohtë. Duket sikur një metastazë polare është futur në këtë malësi. U rregullova në një dhomë me Taxhin kurse në dy dhomat ngjitur janë djemtë e ekipit. Dhomat janë

shumë të mira por akull të ftohta. Administratorët (e Hotel Turizmit!) na porositën që të mos përdorim as tualetet/banjort e as çesmat sepse çdo gjë është e ngrirë. Dhoma e ekipit të Vlorës është ngjitur me tonën. Ata siguruan një ngrohës me reflector nga administratori i hotelit. Kjo është një mrekulli e madhe! Në darkë vajta me Servetin që të shikoj lajmet në TV. Familja ku shkuaam është vetëm 100 metra larg hotelit, por thashë se mbarova nga të ftohtët. Kur u ktheva për të fjetur, në dyshek u futa duke hequr vetëm këpucët dhe xhakëtën e lëkurtë.

### Dt 1.

Nisemi vonë për ngjitje drejt Pecmarës dhe Qet Harushës. Pas një ore tërhiqem. Bëhet shkak Taxhi, i cili më propozoi kthimin. Bëri shumë mirë që ndikoi tek unë që të kthehesha. Çizmet e mija janë të ngrira dhe më shtrëngojnë këmbët tmerrësisht shumë. Pas 100 metra ulje futem në një stallë ku dy beratas kanë ndezur zjarr. Hoqa çizmet (*janë këpucë me kambale të ngjitura të modelit që dikur alpinistët kinezë i kanë pas përdorur për ngjitjen e majës Everest*) dhe njëri nga beratasit më fërkoj këmbën e ngrirë nga të ftohtët. Pas 10 minutash më erdhi shpirti në vënd. Ulem në kamp e futem në dyshek. Kam një libër dhe filloj ta lexoj për të kaluar kohën. Një dorë e mbaj jashtë, për të mbajtur librin, dhe pas disa minutash ndërroj dorën që mos më ngrijë. Në dhomë çdo gjë është e ngrirë. Kur hyn në dhomë, po ra në dysHEME borë nga këpucët, borë mbetet. Në orën 15 kthehen të gjithë ata që u ngjitën në dy majat. Lart thanë se është edhe më ftohtë (sigurisht!). Në darkë vajta përsëri për të parë lajmet. Atje është këndëshëm sepse ka sobë. Sot erdhi edhe Sokoli për të parë lajmet.

Taxhedin Shehu  
(Taxhi)



## Dt 2.

Ditë pushimi. Moti jo i përshtatëshëm. Lëviza, sa për të lëvizur, në luginë. U ngjitëm deri në Rrogam. Në darkë 30 minuta të këndëshme tek TV.

## Dt 3.

Nisemi për ngjitje në malin e Roshit. U nisëm në orën tetë dhe pas 30 minutash, ne që ishim në krye të grupit, arritëm tek kufitarët në shërbim. Janë dy ushtarë nga qytetet Elbasan dhe Krujë. Qëndruam tek zjarri i tyre dhe hëngrëm mëngjesin. Kur u mblodhëm të gjithë u nisëm për në mjaë ku kreu i grupit arriti në 12 e 30 dhe pas 45 minutash arritën të gjithë. Në kamp u ulëm/arritëm pas orës tre.

Për të parë lajmet vajta tek shtëpia ku vete çdo natë (është kohë demokracie dhe lajmet janë...). Zonja e shtëpisë, Paqoja, na poqi gështenja. I shoqi, Xhevati, është Komisari i Repartit të Mbrojtjes këtu në Valbonë. Kanë një djalë katër vjeçar dhe jetojnë në një dhomë 3.5x3.5 metra si dhe kanë një koridor 1x3.5 metra. Kanë 3-4 vjet që jetojnë këtu. Paqoja ka mbaruar fakultetin ekonomik dhe punon arkëtare.



Fusha e Gjesë në stinën e ngrohtë

#### Dt 4.

Sot është kohë e bukur. Për të lëvizur vajtëm deri në Rrogam dhe kur u kthyem ndenjëm tek Fusha e Gjesë ku ndezëm zjarr dhe hëngrëm mëngjesin. Siguruam dy shishe me benxinë që na i dha traktoristi që hap rrugën nga bora. Për të shkruar këto rrjeshta, deri këtu, më janë dashtur disa orë sepse boja e rezervës (kimikut) ngrin.

#### Dt 5.

Bie borë. Është zbutur, por kana e ujit që kemi në dhomë e ka ujin të ngrirë. Taxhi u ngrit në orën katër dhe me një grup alpinistësh u nis për në majën e Jezerës. Ne nuk u nisëm.

Përsëri monotoni dhe papritur kjo thyhet disi: na erdhën këtu të rinj vendas dhe dukagjinat. Demokracia po zjen. Caqja (Kristaq Gega) është në formë sepse i ka vënë komunistët/enveristët përpara. Këta tanët (*duhet të jetë fjala për alpinistët që janë anëtarë të PPSH*) janë komunistë demokratë. Grupi i Jezercës u kthye pas orës katër. Janë të lagur dhe të lodhur. Sokoli u nis për tek Deda. E porosita për patate.

## Dt 6.

Është ditë mjaft e bukur. Një tymnajë (mjegull) e lehtë mbulon pjesën e poshtme të majave dhe krijon një imazh të veçantë: malet duken shumë afër kurse majat e tyre duken tepër lart në qiell.

Në orën tetë e tridhjetë nisemi për në majën e Alisë. Në majë përfundon ekipi ynë dhe tre burelas. Vironi, Serveti dhe një burelas mbetën tek koridori i majës. Bash në majë vajti vetëm Iliri sepse duhej sigurim dhe frynte shumë erë. Lazja siguroi tek shkëmbi Ilirin për të ecur i siguruar deri në majë, kurse unë sigurova Lazen. Pra dy litarë të hapur dhe dy pika sigurorese që të mundësohej ngjitja e Ilirit. Kthimi dukej se nuk do përfundonte. Arritëm në hotel në orën 17. Nuk jemi dhe aq të lagur dhe kalova ca kohë me Caqen. Ai dëshiron që t'i tregosh sa më shumë negativitete të qeverisë dhe partisë (PPSH). Kënaqet!

Në orën 19:30 erdhën Serveti dhe Xhevati dhe më morrën për të parë lajmet në TV. Rrugës për tek shtëpia Serveti më tha se do jemi për darkë. Moti është i kthjellët por diku larg duken vetëtimat.

Darka ishte një mrekulli. I ftuar ishte edhe fqinji i Xhevatit, Zenuni. Ky ishte “me demokratiken”, por kundër Azem Hajdarit. Më pëcolli qëndrimin e tij. Kam kuptuar se këtu e “urejnë” Azemin sepse ai ka qenë një person krejt i zakonshëm, si këta (sikundër tregojnë për të), që shamatosej, rihej, vidhte. Ai punonte rripa ore në një galanteri. Ai nuk ka patur në jetën e këtij vendi asnjë nuancë madhështie në asgjë, ka qenë krejt i zakonshëm. Atë mund ta kritikosh sikundër të gjithë shokët e tij për jetën e pagdhendur nga një plan/këndvështrim qytetar të kultivuar.

Mirëpo Zenuni, sikundër kushdo këndeje, pasi i thashë 3 a 4 fjali, ra “sqkë” dhe nuk foli më për Azemin. Si duket, këtu xhelozia e hapur qytetare për Azemin është tepër e brishtë: për



Hotel Turizmi Valbonë

hatër të demokracisë dhe realitetit (të asaj që bëri Azemi) këta shumë shpejt e mbyllin gojën. Kur dolëm nga darka (e cila u prish shpejt sepse Xhevati duhej të interesohej me telefonata për një banor të sëmurë rëndë) bora kishte shtruar mirë.

### Dt 7.

Bora që filloi mbrëmë ende nuk ka pushuar. Jemi në dhomë. Kati ynë nuk ka rrymë elektrike kështu që ngrohësi i vlonjatëve “ka pushim”. Ka lindur mendimi që të largohemi nga Valbona. Mbasdite ka fryrë erë e fortë. Në darkë dëgjuam, lajmet.

### Dt 8.

Koha shumë e keqe. Rimë brënda. Gjetëm benxinë dhe gatuam e hëngrëm drekë shumë të mirë. Bora ra deri në orën katër mbasdite. Më pas një ndërprerje dhe filloi shi.

Mbasditja u gjallërua me ardhjen e dy oficerëve demokratë. Buka na mbaroi dhe na ka mbetur aq sa për të ngrënë mëngjesin. Dhe ja, pikërisht në këtë kohë fati na bëri me një bukë misri. Në intervalet e ndërprerjes së reshjeve kush mundi lau robe.

**Dt 9.**

Mot i pakëndëshëm. Në darkë vajtëm tek Xhevati për lajmet, por unë vajta edhe sepse kisha lënë aty pantallonat dhe pulovrin për tharje. Çifti na bëri një darkë lamtumire dhe kur u larguam i uruam që herë tjetër kur të vimë në Valbonë të mos i gjejmë aty. Në darkë ishte i pranishëm edhe Sadedini, sportelisti i hotelit, i cili është nga Babica. E shoqja e tij është drejtoreshë e shkollës 8 vjeçare Valbonë dhe jep lëndën e gjuhës ruse.

Sadedini ka pas kryer shkollën e mesme dhe të lartë ushtarake dhe ka pas qenë oficer në ushtri. E humbi pozitën e oficerit brënda një dite, një çasti, nga një ngjarje që i ndodhi në Tiranë: shkon në Tiranë dhe bashkë me të shoqen paraqitet tek Hotel Drini që të zënë vend. Sportelisti u mban letërnjoftimet dhe u thotë “ikni se i merrni kur të vini në darkë”. Dhe kur paraqiten në darkë për të fjetur sportelisti u thotë që nuk ka vende në hotel. Bëjnë fjalë dhe tek e fundit Sadedini nxjerr pistoletën dhe e qëllon. Fati i tij dhe i sportelistit që plumbi i zuri këtij të fundit vetëm një copë vesh dhe kaq. E dënuan me një vit burg dhe e çveshën si ushtarak. Darka u mbyll në orën një mbas mesnate dhe Sadedinin e “kthyem” në demokrat!

**Dt 10.**

Pasi mbaruam me mëngjesin përgatitëm çantat për udhëtim dhe u nisëm në këmbë për në Bajram Curri sepse nuk ka automjete. Moti sot “ushtroi” presion psikologjik negativ mbi ne sepse dukej nga momenti në moment që do na zinte shiu ose bora, por deri sa arritëm në Bajram Curri nuk pati rreshje. Më të shpejtët mes nesh e përshkuan këtë rrugë për gjashtë orë.

Zumë hotel dhe pjesa më e madhe nga ne është në dhoma teke. Bajram Currin e gjetëm me më shumë borë nga sa e lamë,

por nuk është ngricë dhe rrugët janë “llaç” me borë. Dolëm jashtë për të kaluar kohën porse të gjitha kafenetë janë të mbyllura!

## Dt 11.

Në traget. Mbrëmë kur e mbylla ditarin e ditës, vjen në dhomë Nuredini. Dolëm. Si vendas ai e di se ku mund të gjejmë kafene të hapura. Në kafenenë ku hymë gjetëm edhe një djalë 25 vjeçar, punonjës në SMT. Kishte pirë dhe filloi të përmbysë tavolinat. Kur përmbysi tavolinën e katërt ndërhyri shoqëria e tij si dhe policia dhe e nxorrën jashtë duke e marrë me të mirë! Donim të shkonim të takonim doktor Hazirin por ai na qenkësh me shërbim në Tiranë.

Teksa ishim në kafene na erdhi në tavolinë një inxhinjer topograf i pirë, i cili dëshironte të bisedonte me mua (!) dhe u largua pas 20 minuta. Mësova nga Nuredini që ai njihej si ish inxhinjer mjaft i aftë por që degjeneroi nga pija. Ka familje, grua dhe fëmijë. Tani pi më pak, por fle rrugëve, edhe në bunker. Nuk shkon në punë. Pasi hëngrëm darkën përfunduar në shtëpinë e Nuredinit për të parë lajmet. Rugës për në hotel më erdhi një ndjesi pranvere që nuk zgjati shumë. Bora e shumë dhe e squllur, pllaj e pllujet e mija dhe të kalimtarëve nëpër borë dhe pellgjet me ujë, pikat e currilat e ujit nga bora e shkrirë që binin nga çatitë dhe ullujet, qielli i errësuar nga retë që lëshonte hera herës një shi të dobët, krijonin një mjedis që nuk ishte aspak pranveror. Pasi vajta në dhomë erdhën dhe mu mblodhën shumë alpinistë sepse donin të dinin se çfarë u tha gjatë emisionit të lajmeve.

Tashmë që udhëtojmë për tu kthyer në familjet tona kujto se lamë pas një mjedis që ishte tërësisht i ftohtë; madje disa herë mu kujtua Valter Skot-i. Natyra e ftohtë si rrallëherë, mjedisi hera-herës jo njerëzor, emocionalisht ... i shpërndarë (!), ngjitje



pa emocione si më parë. Besoj se në këtë ditar kam “hedhur ca lopata jete alpine”, si të më ketë rastisur. Ndjej se kam kaluar ca ditë i mbyllur në një hapësitë sociale e sportive të pa jetuar më parë.

*Mbajtur nga Aleksandri*

## 1991

Në shkurt të vitit 1991, Federata jonë pat organizuar një veprimtari në rrethin e Korçës. Alpinistët e ekipeve të ndryshme u sistemuan në Vithkuq. Në këtë veprimtari kanë marrë pjesë Shefki Juma, Dashamir Fejzo, Gjergj Bojaxhi, Edvin Jeshili (ndoshta edhe ndonjë tjetër). Ishte koha që veprimtarive sportive në sistemin punist po u vinte fundi, fillimisht për mungesë fondesh por dhe pasigurie.

## Aktiviteti veror 1-11 korrik 1991

Mbajtësi ditarit Dashamir Fejzo

Pjesëmarrësit:

1. Dashamir Fejzo
2. Gjergj Bojaxhi
3. Edvin Jeshili

### 1 korrik

Udhëtim Tiranë – Shkodër me një tren ku shumica e vagonave janë pa xhama. Nisemi në ora 19:10 e mbijmë në ora 22:50. Hotele nuk ka ngaqë kanë mbetur vetëm dy: turizmi për të huajt dhe Adriatiku për fshatarët. Ne fjetëm në një hotel privat (nga tre që janë). 10 lekë personi.

## 2 korrik

Ndodhemi tek axhensia ku janë këto ekipe: 17 Nëntori me kategoritë e dyta, Kuksi, Dajti dhe Skënderbeu me kategoritë e para. Ekipet e tjera nuk janë paraqitur. Unë me çunat arrijmë në Koplik me autobuzin e Bajzës dhe nga Kopliku në Bogë me një ARO që na e rregulloi një i njohuri im. Në Bogë ngre çadrën e vetme që kemi dhe jemi në pritje të ekipeve të tjera. Veprimtaria është caktuar të zhvillohet në Shtegun e Dhenve.

## 3 korrik

Koha me shi të mërzitshëm gjatë gjithë ditës. Çadra rezistoi mirë. Me ushqime jemi dobët. Menca e fshatit nuk punon fare. Roku (dyqani i Rokut) dhe ushqimorja janë të zbrazta. Kohën e kalojmë duke lozur letra; në darkë ndezim zjarr. Në Bogë arrijnë edhe alpinistët e Dajtit dhe Kukësit dhe përshtaten nëpër shtëpitë e fshatarëve sepse nuk ka automjet që të vazhdojnë për në Theth.

## 4 korrik

Koha u qetësua. Të dy çunat i nisa për në qafë të Bridashit. Në datën 3 i pata nisur për tek stanet e Negovanit. Sot u kthyen në orën 15:00. Ishin nisur në ora 09:00. Dreka me sardele, djath e tranguj. Në darkë rreth zjarrit dhe tek klubi i Rokut. Koha ka filluar të prishet. Të shohim si do të jetë nesër. Sot ndërruam/këmbyem orizin me një djathë të bardhë shumë të mirë.

## 5 korrik

Dje vonë koha na mbyti me shi. Për rreth katër orë. Natën u kthjellua. Sot në mëngjes koha shumë e mirë. Mbas mëngjesit do të shkojmë tek mulliri i Bogës poshtë majës së Hundës. Po sot në mëngjes blemë nga një person që kishte Zetor personal 8 kg

domate. I blemë gjithë qef me nga 30 lek kilogramin. Ora 10:00 nisemi për ngjitje turistike. Kur nuk paska ekipe pjesëmarrëse nuk paskemi frymë ngjitjesh cilësore.

**Shënim:** u bënë tre ditë që kërkojmë mish për të blerë. E japin shumë shtrenjtë. Të shohim se çfarë do bëjmë nëpërmjet Gjelinës (vajza e Rokut) që është guri i fundit. Darka si zakonisht, përveç disa garave me kuaj nga Gjergji dhe Ervini.  
6 korrik.

Sot vendosëm të bëjmë pushim të plotë, pa asnjë aktivitet sportiv.

Dashi

*(nuk ka faqe të tjera nga ditari)*

## 12 deri 24 korrik 1991 Qafë Pejë

*(Kjo veprimtari, që ishte e cilësuar si veprimtari e ngjitjeve të kualifikuara, ishte planifikuar që të zhvillohej në zonën e Qafë Pejës. Kur ekipi ynë arriti në Theth, u ndodhëm para faktit që nuk u paraqit asnjë ekip tjetër për këtë veprimtari. Fillimisht menduam se ekipet mundet të vinë me vonesë për arësye nga më të ndryshmet për kohën që jetonim. Por askush nuk erdhi).*

### Korrik 12

Mbrëmë në Shkodër për të parën herë unë fjeta në një hotel privat. Pronari i shtëpisë ka përshtatur dy dhoma ( me 4 dhe 5 shtretër) fare të thjeshta por të pastra. Në hyrje të shtëpisë, shtëpi me obor e kopësht, ishte e vendosur një pllakë mermeri e cila shënonte se kjo shtëpi kishte qenë bazë e luftës Nacional Çlirimtare. Adresa: Gëzim Isufi (Sula), Lagja Sala Halili (Toplan) Rr. Ali Kelmendi 48.

U larguam, pasi u sistemuam, me një buketë me lule që Edisoni (djali i Shefkiut) e kishte që të vendosej në vendin ku u vra Arben Broci.

Për të udhëtuar na kishin vënë në dispozicion një autobus të vogël (të kohës së Stalinit) i cili dukej si një llamarinë lëvizëse. Në Bogë arritëm pas orës dhjetë. Kemi nëntë orë që presim makinë për të shkuar në Theth. Është fresk dhe bukur, përjashto mizat. Dyqanet të zbrazta nga mallrat. Bleva tre tavolla duhani të gdhendura në gur. Blemë dy kilogram djath dhe një pjesë të çmimit e kompensuam duke i dhënë fshatarit dy kilogram sheqer (në fakt sheqeri e bleu djathin).

Në Bogë janë kthyer (si vizitorë) tre ish të arratisur dhe i kanë dhënë gjallëri fshatit. Thonë se këta nuk pranojnë të takojnë anëtarë të PPSH.

Kishën e fshatit duan ta rregullojnë dhe ta kthejnë për funksionin që ka patur, Kishë. E pyeta Vuksanin (Kryetarin e Këshillit për fshatin) se përse nuk ndërtohet një tjetër. Më tha se nuk ka fonde.

Fjeta në çadër. Në mëngjes takova Gjelinën, Rokun e Palin dhe sigurova një pagure me çaj për Gjergjin.

E lamë Bogën pas orës 11 të hipur në një kamion Skoda në majë të thasëve me miell që ishin ngarkuar në të. Udhëtimet këndeje janë jashtë çdo llogjike në kuptimin e sigurisë, po të keshë parasysh llojin e rrugës, honet, etj.

Sonte jam në një nga dhomat më simpatike të Kampit të Punëtorëve në Theth. Janë këtu katër susta dhe vatra për zjarr e dëmtuar. Mjedis i mrekullueshëm: çarçafë të larë, shtrat me sustë, perde në dritare dhe një tavolinë. Jashtë kemi ujë, tavolinë, katër stola të punuar me çimento dhe të punuara bukur, dhe aty kemi edhe vendin për të vendosur furnelën për gatim. Frani, drejtori i kampit, më dha çelsin e dhomës në momentin që kisha

humbur çdo shpresë për tu sistemuar në godinën e kampit të punëtorëve.

Gjergji sot u gdhi shumë i sëmurë. Dje ka qenë tërë ditën i këputur: me bark e me temperaturë. U mata ta kthej në Tiranë. Në “ambulancën” e kampit zgjodhëm ca barna si dhe gjetëm termometrin. Ndonëse kish filluar të djersijë, temperaturën e kishte 39.3. Tani është mirë (37.6) dhe pas 12 orësh po merr pjesë në biseda dhe shaka.

Tokat dhe livadhet në Bogë e në Theth i kanë ndarë sipas kufijve të të parëve të tyre. Të gjithë janë të përfshirë në punë: sistemojnë tokat, vendosin gardhe, jo aq për kufij tokash por, si mjete për të ruajtur livadhet dhe të mbjellat nga kafshët e ndryshme

Në Bogë ishte shqetësues të siguruarit e bukës. Ka familje të cilat sot nuk kanë lekë për ta blerë. Shënojnë emrat në listë dhe do e paguajnë kur të sigurojnë lekët. Në Theth familjeve u japin miell dhe ato e gatujnë dhe pjekin bukën vetë.

## Korrik 14

Gjergjit gradualisht i ra fare temperatura. Ndoshta i kanë bërë mirë ilaçet, ndoshta dieta. Sot e lamë në kamp dhe ne u nisëm për shëtitje drejt Thores. Shtegun e saktë e humba, por tek e fundit arritëm aty ku doja: në Praçaj. Takuam Sokolin, i cili aty kishte stanin e tij. Ky është punëtor tek kampi. Stani është tek një livadh i madh. Na gostiti me qumësht dhe na dha kos për Gjergjin. Sokoli na tha se në Theth e Dukagjin tokat e livadhet janë ndarë pa konflikte. Vetëm se në fshatin Gimaj e vranë njërin me thikë. Ky kishte qënë i larguar në qytet por kishte ardhë për të marrë tokat e tij që t'i shiste.

Në kthim dolëm tek Poti i Rasave e prej aty në kamp. Gjatë kohës që ishim të laguar Gjergjit i ishte ngritur ca temperatura

por tani është mirë dhe po shëtit. Mrgjithatë nuk më pëlqen fare gjendja e tij.

## Korrik 15

Paradite shëtitëm: qendrën, kullën e ngujimit (të Zef Koçekut) Gjergji e Sokoli, dy nipat dhe një i tretë, para tre muajsh kishin ikur në Greqi. Më pas shkuam tek ura në shkam, në katarakt, pastaj banjo tek përroi që zbret nga mali i Boshit, Kishë, qendër, kamp.

Mëndjeshkatërruese nga fshati kanë bërë dëmtime tek: shkolla, Kisha (që funksiononte prej kohësh si qendër shëndetësore dhe kopësht fëmijësh), zyrat e kooperativës dhe të këshillit. Mbrëmë Sykja, drejtoresha e shkollës, na tha se “shkollën ma kanë prishur keqas”. Biblotekën e shkollës e cënuan (e kishte në ngarkim kryetari i partisë demokratike). Ajo i morri librat dhe i strehoi tek posta kufitare por atje ja kishin dëmtuar ushtarët.

Dyqanet drangull. Lëvizje makinash, 1 a 2 në ditë. Sot u ul për në Breg Lum një kamion tip “Skoda” me murgesha dhe me dhurata për t’i ndarë atje. Në qendër ramë në ujdi me një fshatar që nesër të na japin dy kilogram kos për 100 lekë. Kur arritëm në kamp filloi shi i rrëmbyer për rreth 30 minuta dhe më pas shi i lehtë.

## Korrik 16

Mot i vranët. Majat janë të zëna. Vajtëm tek shkëmbejtë e kooperativës (*shkëmbej në buzë të rrugës automobilistike sapo kalon nga qendra në drejtim të Breg Lumit*). Ardi e Gjergji bënë një ngjitje. Shkoi keq sepse Gjergji ngatëroi litarët. Më pas u nisëm drejt lagjes Nik Gjona dhe qëndruam ca kohë tek ura që e lidh këtë me lagjen Okol. Aty dalin burimet e lumit të Thethit në këtë muaj të verës. Ujët është tepër i ftohtë dhe u la vetëm

Gjergji. Më pas shkuam në kamp. Aty na u afrua një djalë i vogël që ishte nga Tirana. Kur e pyetëm “ku banon?” ai na u përgjegj: “Në katin e pestë”.

## Korrik 17

U zgjuam që në orën gjashtë sepse Martini, i cili punon me Zetor-in (lloj makine transporti në sektorin e buqësisë) e fshatit na donte të gatëshëm në orën shtatë për të na transportuar deri në Breg Lum. U nisëm në orën 8 dhe mbërritëm në orën 10, sepse Martini ndalonte dhe jepte e merrte materiale si dhe bënte ndonjë bisedë me kalimtarë. Bënte ndere për zonën dhe nuk dilte pa gjë.

Bregu i Lumit është qendra administrative e Dukagjinit. Ne erdhëm këtu për të parë zonën dhe këtë qendër. “Vizituam” dyqanet dhe shëtitëm pak dhe pastaj shkuam në lumë në pritje të orës për tu kthyer me Martinin.

U nisëm në orën 12:30. Kush nuk hypi në Zetor! Breglumasit shfrytëzuan rastin që një mjet ishte aty. Banorët këtu nuk kanë asnjë garanci për të udhëtuar me mjet. Ka raste që presin gjithë ditën dhe nuk kalon mjet që t'i marë. Ka dhe raste që u del një mjet dhe, është tejet e habitëshme, hipin, më saktë kërcejnë në automjet dhe një i dytë i “hedh” fëmijën në karoceri e një i tretë thesin ose boçen a trastën me mall. Zetori vajti në dyqanin e Ndërlsysës ku shkarkoi ca mallra pa vlerë dhe prej aty, unë Gjergji e Ardi, shkuam në Kapre. Gjatë udhëtimit vajtje-ardhe u lamë nëpër vaskat dhe ujrat e përroit. Më pas u ndalëm për të parë HEC-in e Ndërlsysës. U nisëm për Theth duke ecur nëpër rrugën këmbësore, nga Shkalla e Thethit, dhe në 17:30 ishim në kamp.

Kampin kanë filluar, që vitin e shkuar, ta shtojnë. Shtojnë godinën qendrore. Punëtorët janë të ardhur nga Shkodra dhe janë ende larg përfundimit të punimeve. Ne me veprimtarinë

e sotme mbyllëm shëtitjet. Ka dhe gjëra të tjera për të parë por nesër ndoshta do ngjitemi nga blloku i Jezerës.

## Korrik 18

Kam fjetur keq dhe nuk jam mirë. Edhe moti nuk është premtues. Nuk bëhet fjalë për Jezerë. Me makinë shkuam deri tek ura e Kolajve dhe prej aty marshuam tek Katarakti. Ardin dhe Gjergjin i futa në itenerarin shkëmbor I-1. Sapo dolën në krye të itenerarit filloi shi i rëmbyer. Ata për 30 minuta ndenjën rrëzë shkëmbjeve, sikundër dhe unë, dhe pastaj zbritën dhe shkuam drejt e tek kampi. Hëngrëm drekë në mencën e kampit, mencën e pushuesve. Në darkë shkuam tek Sykja. Pamë lajmet dhe na gostitën me ca qershi të vockla por tepër të ëmbla.

## Korrik 19

Dita erdhi duke u kthjelluar. Pas orës tetë u nisëm për tek shkëmbajtë e Murit të Radohinës (përballë Kroit të Shtrazës). Këtu Gjergji dhe Ardi bënë një ngjitje të theshtë dhe më pas shkuam tek Kroi Shtrazës. Këtu kanë filluar të bëjnë një depozitë për ujin e burimit, por puna është lënë e papërfunduar. Hëngrëm qershi ngaqë Gjergji hipi në pemë dhe këputi ca. Kaluam tek sharra, tek mulliri e më pas tek burimet e lumit. Kur u nisëm Gjergji mbeti tek ura dhe u vonua aq sa për mua ishte shqetësuese. Mu mblodhën edhe “indisiplinime” të tjera të bëra prej tij dhe vendosa ta nis, për dënim, në Tiranë. Kur u zgjova i thashë të bënte gati çantën. E përcolla me bisedë të shkurtër për arësytën që po e nis dhe e lashë tek rruga e makinës që të priste mjet transporti.

Pas rreth një ore, Shefkriu në bisedë me Ded Balën, i tregon për vendimin tim. Deda u ngrit, i mori çantën Gjergjit, e futi atë në dhomë dhe më bëri be që “djali do kthehet në Tiranë me ty”. I thirra Gjergjit që të futet në dhomë.



Deda e ka shtëpinë jo larg kampit, është malësor madhështor e me mustaqe; mirëmban kampin. I vjen doresh për shumëshka dhe nxjerr punë të bukur. Kur xhirohej filmi “Skëndërbeu” kryente shërbimin ushtarak dhe u aktivizua për nëntë muaj nga Kinostudio. Ai më tregoi histori nga të tijat.

Dy a tre javë para se të shkonte ushtar, i vdiq i ati. Gjeti nuse (duhej të paguante sepse kështu ishte zakoni ndonëse si djalosh ai ishte i bukur dhe i fuqishëm si rrallëkush) dhe u martua pa mbaruar ushtrinë sikundër ishte zakoni. Nuk e kish takuar apo prekur nusen e cila pas tre javësh ndërroi jetë.

Pas tre vjetësh u martua përsëri (dhe përsëri lekë). Krye dy vjetësh u bë me djalë, i cili që kur ishte 6 muajsh ngrihej në këmbë, i hidhte edhe hapat dhe “i fliste” ba-ba. Kur djali ishte 6 muajsh i vdiq brënda tetë orëve! Më pas pati dy vajza dhe një djalë. Ishte në stërvitje ushtarake në Breg të Lumit kur i lindi djali. Ali Spahia (mjeku deputet), e mori me zor (ishte turp që të futesh burri në maternitet) dhe e futi në maternitet që të shikonte djalin. Atë ditë i ndodheshin në kuletë 18.000 lekë. Shtroi në mbrëmje, me shokët që kryenin stërvitjen ushtarake dhe të njohur të tjerë aty, një darkë që i kostoi 20.000 lekë. Kur i vajti nusja dhe djali në shtëpi, nga vizitat, ju mblodhën 45.000 lekë!

Më pas Deda pati edhe dy vajza dhe një djalë që është në moshë me Gjergjin dhe që dëshiron të vazhdojë shkollën e lartë për matematikë.

Nga biseda me Dedën mësova se është bërë një studim për të çpuar malin në vijën Ndërllysë-Ducaj dhe tuneli të shërbejë si rrugë automobilistike dimër e verë si dhe të kalohet uji (*i lumit të Shalës*) gjatë luginës së Përroit të Thatë.

Për mbyllje. Në datën 20 që në orën gjashtë e pesëmbëdhjetë të mëngjesit, unë dhe Ardi u nisëm për në Jezerë. Më 10:30 ishim në majë. Ndjehesha i lodhur. Soditëm pak dhe u shtriva

që të shplodhem. Pas 15 minutash filluam zbritjen. Në zbritje hëngrëm një konservë dhe pimë ujë në një vijë me ujë bore. Pas 15 minutash të tjera zbritje e rrëshqitje nëpër borë të ngrirë e mora veten shumë mirë. U kthyem në kamp në orën 14:45. Hëngrëm të gjithë bashkë drekën më të mirë të gjithë këtyre ditëve. Pasi u shtrimë pak filluam përgatitjen për tu kthyer e shkuar në Bogë. Kamioni Skoda erdhi aty nga ora shtatë.

Në Bogë e kalova natën tek Roku. Pamë një koncert të këngëtarit Sherif Merdani. Tek Roku kishin ardhur dy të rinj të fisit të tyre që të nesërmen me Aleksin dhe Hanën do të niseshin për piknik në Theth me makinën e “Shqiptaro-Amerikanëve” Bogianë

Në orën 11 u nisëm për Shkodër. Fillimisht me një Skoda deri në Ducaj, pastaj me një zëtor që shkonte për një varrim, rreth 2 a 3 kilometra udhëtim, dhe më në fund me një ARO që kishte sjellë në alpe ca “Shqiptaro-Amerikanë”, deri në Shkodër.

Kishim ndërmend që të shkonim në Shirokë për dy a tre ditë, por mungesa e ushqimeve dhe pasiguria në transport bënë që kur arritëm në Vrakë të vendosim të shkojmë në shtëpitë tona, në Tiranë. Kapëm trenin dhe them pa frikë se ai ishte një skandal, jo tren: besoj se është treni më i pabesueshëm në botë!

- Çuditërisht në këtë veprimtari nuk erdhi as edhe një ekip tjetër dhe ne mbetëm vetëm.

- Ekpiipi ynë nuk kishte në këtë veprimtari përbërje cilësore si më parë dhe ne nuk do mund të bënim ngjitje cilësore në Qafë Pejë. Megjithatë mua më pëlqente që të vendoseshim atje, ndoshta më tepër ngaqë Gjergji ishte me ne.

-Komandanti i postës kufitare nuk më ndihmoi me kafshë për të transportuar materialet në Qafë Pejë. Për mirësjellje ai duhej që të paktën të më takonte pas bisedës së parë që bëra me të. Ai nuk u bë fare i gjallë.

*24 korrik 1991; Aleksandri*

**Shënime:**

Në faqet me shënime që kam në ditarin tim më tërheq vemendjen fakti se për vitin 1949 kam shkruar këtë informacion:

“Në ngjitjen për të pagëzuar malin e Marroces/majën e Hekurave me emrin Maja e Paqes, përmendet si operator (me gjasa i KinoStudios) Hamdi Kasapi”. Ndoshta ky është operatori i parë që ka shoqëruar alpinistë në një veprimtari.

\* \* \*

Për ngjitjen e majës së Korabit është bërë një përpjekje në muajin shkurt 1956. Nuk u arrit të ngjitet/pushtohet maja. Në muajin shkurt 1957 në qytetin e Peshkopisë organizohet një shkollë, apo ndryshe seminar/zbor (term i përdorur rëndom n'ato kohë) për 15 ditë me 15 veta me synimin që të përgatiteshin alpinista të rinj për të pushtuar/ngjitur majën e Korabit. Ndër pjesëmarrësit thuhet se është edhe Taxhedin Shehu, i cili u bë për atë qytet një sportist me emër në sportet alpinizëm dhe sidomos në futboll.

\* \* \*

Në bllokun tim personal (të voglin) të shënimeve dhe ditarëve, në faqen që ky bllok mban datën 1 dhjetor (e jap këtë spjegim për ta gjetur se ku është) kam edhe ca shënime që duket se janë të një mbledhjeje që ka bërë ekipi që drejtoja me shefin e Klubit Sportiv 17 Nëntori, Muharem Sinoimeri. Do ishte interesante të më kujtoheshin sot hollësitë dhe t'i shtjelloja ato shënime. Nuk më kujtohen. Por gjithësesi janë të kjarta në shënimet disa nga kritikrat që më ka bërë në atë mbledhje shoku A.O.:

Aleksandri nuk ka bërë asnjë punë për të shtuar element të rinj nga klasa puntore.

Ai mbështetet tek Universiteti Shtetëror i Tiranës.

Në Breg Lumi vjen operatori dhe njofton për mjekrat e ekipit (*17 Nëntori me trajner Aleksandrin*) të Shtegut të Dhenve. Më vonë e njëjta situatë (*e mjekrave*) me shoqen Flutura Çelkupa (*drejtuese e lëvizjes fiskulturore*).

Aty ka edhe kritika (vetëm kritika) ndaj të tjerëve apo fenomeneve në ekip. U ndala tek këto si më sipër sepse janë të shkruara kjashtë dhe brezat e rinj duhet të dinë se:

- a. Në vitet 70-të, ndër të tjera, PPSH kërkonte që sa më shumë njerëz nga klasa puntore të futeshin në të gjitha nivelet drejtuese në parti e pushtet, madje edhe në sport, sepse kështu do të rriteshin nivelet cilësore të sporteve tek ne (pa diskutim edhe në drejtim të qeverisjes më të mirë të atdheut tonë!).
- b. Ne, alpinistët, na mërzisnin me punën e mbajtjes së mjekrës. Në shënimet si më sipër ky fakt është shprehur në ditarët e mbajtur. Por këtu kam rastin të skjaroj një ndodhi të vitit 1966. Ishte marrë vendim që të xhirohej një film/kinozhurnal që lidhej me veprimtaritë tona. Ishte caktuar një treshe kacavarsish/alpinistësh me, apo rreth të cilëve, do të ndërtohej skenari. Këta ishin: Aleksandër Bojaxhi, Niko Stamo, Ismail Hoxha. Operator dhe njëherësh regjisor u caktua Mit'hat Fagu, që njëherësh ishte edhe alpinist edhe punonjës/regjisor i KinoStudios Shqipëria e Re. Astrit Omeri dhe Kristo Krisiku ishin caktuar që të ndihmonin Mit'hatin. Më së shumti, këta nëpër itenerare sa më të thjeshta, duhej të ngjiteshin sa më pranë e më paralel me itenerarin ku do ngjitej/ kacavarej treshja në fjalë, do hidhnin nga lart litarin ku do të lidhej Mit'hati dhe do e tërhiqnin/ngrinin atë që ai të filmonte kacavarjen duke qenë sa më pranë treshes në fjalë. Punë kjo që rezultoi të ishte shumë e vështirë.

Fillimisht zona e filmimit u caktua ajo e malit Gryk e Hapt. Kur u vendosëm atje me çadrat dhe ndërtuam kampin, Niko nuk pranoi që të hiqte mjekrën. Miërpo Mit'hatit nuk do i pranohej nga shefat e tij filmi i xhiruar. Zgjidhja u gjet duke ndëruar detyrën e Nikos me atë të Kristos. (!!).

\* \* \*

**Shënimi/tabela** e mbajtur për ngjitjen në majën e Arapit; itenerari veri lindor, ngjitja e kryer nga Ilir Tapia, Romeo Manxhari dhe Sokol Doko. Në dijeninë time kjo ngjitje u realizua për të parën herë nga alpinistët e Republikës Demokratike Gjermane më 1959. Alpinistët tanë, më të vjetër nga unë në këtë sport, të cilët ishin në ekipin tonë dhe që një pjesë e tyre u kacavarën me alpinistët gjermanë, e vlerësuan si ngjitjen më të vështirë që u krye. E realizuan tre alpinistë gjermanë. Më pas itenerari u realizua nga një treshe e ekipit “Dajti”: Maridon Hito, Bajram Hysa, Mario Trinkera. Unë e kam ngjitur këtë itenerar një ose dy vjet pasi u ngjit kjo treshe. Në një kartelë timen të FSHAL me ngjitje të hedhura aty kam parë që për këtë ngjitje është shënuar viti 1972. Kjo nuk është e vërtetë mbasi ngjitjen e kam bërë si anëtar i ekipit “Apollonia” (kam qenë anëtar dhe trajner i këtij ekipi në vitet 1965-1971), periudhë kjo kur kam punuar si mësues në gjimnazin e qytetit Patosi Ri), bashkë me Nasi Shtëmbarin dhe Vangjel Zenon. Ngjitjen e udhëhoqi Nasi Shtëmbari.

Ngjitja me të dhënat në këtë tabelë është realizuar në korrik të vitit 1981.

## Arapi

| Nr | Emri mbiemri | koha/ metra | koha/ metra | koha/ metra | koha/ metra | koha/ metra | Material teknik        | shumatore |
|----|--------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|------------------------|-----------|
|    | Iliri        | 25'/35-40   | 30'/30      | 85'/30      | 80'/40      | 50'/35      | plenga sipas litarëve: | 270'      |
|    | Romeo        | 15'         | 15'         | 40'         | 40'         | 20'         | 2+6+9+6+9 = 32         | 130'      |
|    | Sokoli       | 15'         | 25'         | 60'         | 25'         | 15'         | dy shkallë             | 140'      |
|    | Shuma        | 55'         | 70'         | 185'        | 145'        | 85'         | dy pyka                | 540'      |

Kjo ngjitje/kacavarje morri 540' = 9 orë. U përdorën dy litarë paralelë të shtrirë në 80 metra (pra 4 litarë 40 metrosh).

\* \* \*

Fjalë të mbledhura në fshatin Nikç gjatë bisedave me Martin Llesh Smajlin

Garavan = sahan i madh prej bakri ku më parë hanin dhjetë vetë a më shumë në sofër.

Gjeri = gjieri = kafshë më e madhe se miu (të cilit i ngjan) por me bisht si ketri. Ka gji të bardhë.

Bulgëza (në dukagjin) = gjeri

Gjierore = gjerore = ketër

Bubëlza = nuselale

Rrshaji = gjarpër i madh e i zi deri 2 m i gjatë

Shlliga = nëpërka

Maknore = bubrec i zi e shumëkëmbësh që kur e shtyp lëshon erë të keqe

Kryegoruzhda = larva e bretkocës

Unur = një copë hekur ku futen dy gishtat dhe godet gurin e strallit = mosat

Lajs = pallë = kopaçe = mjet që godet rrobat tek i lan

Test = ajo që zgjedh (p.sh. ajo që zgjedh në lojën me kapuçë)

Mazë = përdoret për të treguar edhe diçka të bardhë (p.sh.

maza e syrit = e bardha e syrit)

Shkullajë = shufër hekuri me grep që rregullon drutë e zjarrit në vatër

Gollanjë = kamare në mur

Teje = litar leshi

Kita = bora që rri në degët e pemëve (kur kita rri kemi mot të mirë)

Pocir = kthetra

Sini = sofra e bukës

Tervesë = sofra e bukës (dukagjin)

Qethë = drrasa ku shtrohet brumi i misrit para se të futet nën kaki.

Kaki = saç

Polica = vendi ku vendosen enët e guzhinës

Praj = pusho

Prán = infeksion (ruaju se po të prán = ruaju se po të infekton)

Pehar = goruzhde

Qinçe = enë për të pirë (është më pak se një litroshe)

Gzhitet = thahet shumë e bëhet i/e thërmueshëm (duhani, bari)

Krahol = pulovër me ose pa mangë

Harbaçike = qepë

Kanavetë = arkë druri që luan rolin e valixhes por që është më e madhe se valixhja

Arça = dru që rritet në kullotat alpine. Është i shtrembër dhe me gjethe si të gështenjës. Ka erë të rëndë. Përdoret si bimë mjeksore

Tredh-i = (dukagjin) vendi që sheshohet e rregullohet në borë për t'i hedhur ushqim bagëtisë

Podina = tredhi, plus: quhet vendi ku përgatiten dengjet e barit (p.sh. për transport).

Xbonim = me xbonua = me përkëdhel

Sabet = bisedë (ranë në sabet me miqtë) [them se duhet të jetë fjalë e një gjuhe orientale]

Shikull = dërrasë e çarë vetëm me sopatë

Okllaçë = pjesë e një trupi lënde drusore të prerë e pa ndarë në shikulla (është  $\frac{1}{4}$ , ose  $\frac{1}{6}$  apo  $\frac{1}{8}$  e trungut)

Skrob = kaçamak i hollë (asht skrob = asht lang).

Shtalp = djathi në hirrë

Përçatje = tingull i çjerë, i ashpër

Bash kazani = ball kazani

Kresina = pjesa e sipërme e supës, qumshtit, etj (gjëja më e mirë e diçkaje).

Çibrica = enë që zë 100-200 litra raki

Gaviç = tinar (dukagjin) = enë që mban 1-10 kv rrush

Mjalcë = enë ku milet qumështi

Torishtë (dukagjin) = vatha ku ri bagëtia

Bun = vendi ku fle bagëtia

Mriz = vend me pemë të rralla (jo pyll) ku e kalon vapën bagëtia

Asht = pyll, kryesisht pyll me dru ahu

Koçek = shkrep shkëmbor që del në një vend/shpat të ëmbël

Stenicë (dukagjin) = enë ku mblidhet misri i shkoqur = hambar

Torokop (dukagjin) = kazëm = tornogop (kelmend)

Firikac = kazëm që në njërën anë gërmon e në anën tjetër është si sopatë

Forum = vatër = sobë

Tablica/ë = një dërrasë (10x10 cm në bazë) me gjatësi sa distanca misdis dy trarëve të tavanit e që i jep këtyre presion anësor

Oxhakeshë = shtëpi fisnike



Buxhak = shtëpi jo fisnike

Tue tej = duke ndenjur (ditë shiu e tue tej)

Maj = varé

Çerem = një tra mbajtës (kryesor) i tavanit me dërrasa

Binosh = binjakë

Bobovitje = rregullim (ekonomik, etj.) duke marrë edhe atë që nuk u takon

Tamël = qumësht i mjelë, qumësht siç del nga bagëtia

Tharbun = thartuar

Kjumsht = hira e zjerë që del nga djathi, e ftohur deri në temperaturën e zënies së kosit; i hidhet farë kosi e zihet kos (është një lloj kosi). Si hira dhe kosi duan të njëjtën temperaturë që të zihen kos.

Dhallt = lëngu që del nga tundja e mazës (kremit) për të nxjerrë gjalp.

Stajnica = e zonja e shtëpisë, guzhinjerja

Plugë = kullësë djathi që punohet (bëhet) me degërmi

Degërmi = napë, garzë

Përpeq = lloj gjelle (ose ëmbëlsirë kur i shtohet, sipas dëshirës, mjaltë ose sheqer). Përgatitet me këto raporte: kullostër 1 lugë, vezë 3 kokra, miell gruri 3 lugë, sodë buke pak, sheqer ose mjaltë sipas dëshirës, gjalp deri 50 gr, përziejehet mirë dhe piqet ngadalë për 15 minuta.

Hikër = hirë kosi (që del nga kullimi i kosit).

Grec = vile (rrushi)

Lavesh = shtesa e viles së rrushit

Larushka = hardhia e egër që përdoret për shartim

Elkostër = kore (buke, etj.)

Kij = me kij = me krasit (rrushin)

Me roçkue (Traboin-Hot) = me kije

Skrap = borë e zbutur nga shiu ose temperatura tek e cila

fundosesh teksa ecën mbi të

Gon = ndeshje e papritur; përplasje pa dashur

Gon = njësi lërimi me qe (80-100 metra sipas fuqisë së qeve)

Graçim = me graçim = me ekonomi, me kursim, e përdorur nga pak (djathi, mishi, uji, etj.)

Çurak = me çurak misrin = me çvesh misrin nga lëvorja

Çurak = lakuriq, i çveshur

Kopoj/a (e tamlit) = govatë e vogël prej druri ku hidhet qumshiti

Jardun = qumësht dele i vluar kur delja millet në muajin gusht e më vonë

Zakop = shekë = enë që mban deri 1 kv

Çep = shtupë që bllokun vrimën e vozës apo shekës

Dra = pjesë e mazes që mbetet poshtë kur shkrin gjalpi

Duiq = hejbe

Mrejë = bredh

Tuc = emër përkëdhelës për fëmijë

Mutova = mundova (fjalë e vjetër)

Haak = habi (si??; bravo!!)

Lasmas = hirë e përzjerë sipas dëshirës me tamël të zier e të ftohtë (raportet sipas dëshirës)

Lasmas = zbukurim (mos ma lasmas bisedën = mos ma zbukuro bisedën)

Droçka = gjiza që del nga zjerja e hirës.

Jam tuj go rrugash = vete e vij nga shtëpia diku për arësytë të një shqetësimi, për të kryer një punë, etj.

Cerlek = currili që del kur zjen kazani i përgatitjes së rakisë

E ka punën cerlek = i shkon puna cerlek = i venë/shkojnë punët mbarë.

Karabash = mbeturinat e kazanit të rakisë pas zjerjes

Blyt = lodhë



Jam ba blyt = jam lodhur shumë

Asht ba rakia blyt = është zbutur rakia

Bren = brena = shkopi që mban fillin dhe grepin për të zënë  
peshk

## F U N D